



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E
EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

**RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT
FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIE
NË
MINISTRINË E EKONOMISË, KULTURËS DHE
INOVACIONIT**

Tiranë, prill 2026

PËRMBAJTJA	FAQE
I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3
2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	4
3. Konkluzion i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....	7
II. HYRJA	7
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	13
1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	13
2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit:	14
2.1 Planifikimi, zbatimi dhe monitorimi i buxhetit. Programi PBA dhe buxheti vjetor, çelja e fondeve vjetore dhe ndryshimet sipas akteve normative, saktësia e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.	14
2.2 Vlerësim i raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.	40
2.3 Administrimi dhe menaxhimi i marrëdhënieve të punës dhe pagat e punonjësve.....	62
2.4 Planifikimi dhe zbatimi i procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimi i kontratave për punë mallra dhe shërbime deri në marrjen në dorëzim.	69
2.5 Procedurat e realizuara në zbatim të thirrjeve për financim në mbështetje të artit, kulturës, trashëgimisë dhe inovacionit.	189
2.6 Vlerësimi i Vlerësimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe veprimtarisë së Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm.	219
IV. REKOMANDIME	226

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. PËRSHKRIM I SHKURTËR I PROJEKTIT TË AUDITIMIT

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit nr.951/1 prot., datë 13.10.2025, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH, realizuar nga data 14.10.2025 deri më datën 02.02.2026 , në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit u krye auditimi financiar dhe i përputhshmërisë për periudhën nga data 01.01.2022 deri më datë 17.09.2025. Në përfundim të fazës së auditimit në terren dhe pas kryerjes së takimit përmbyllës me subjektin e audituar janë lënë 14 Akt konstatime dhe 1 Akt Verifikim.

a. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij.

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit harton dhe zbaton politika që synojnë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit, rritjen e konkurrueshmërisë, nxitjen e sipërmarrjes dhe përmirësimin e klimës së biznesit, në përputhje me prioritetet kombëtare dhe procesin e integritetit evropian. Ajo bashkërendon politikat për zhvillimin ekonomik, mbështetjen e investimeve, promovimin e eksporteve dhe forcimin e sektorëve strategjikë të ekonomisë. Ministria harton dhe zbaton politika për zhvillimin e inovacionit, teknologjisë dhe transformimit digjital, me synim rritjen e kapaciteteve konkurruese të ekonomisë, mbështetjen e start-up-eve dhe ndërmarrjeve inovative, si dhe nxitjen e kërkimit të aplikuar në funksion të zhvillimit ekonomik. Në fushën e kulturës, Ministria harton dhe zbaton politika për mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale, zhvillimin e arteve dhe industrive kulturore e krijuese, si dhe rritjen e aksesit të publikut në jetën kulturore. Ajo siguron administrimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve kulturore kombëtare, si dhe promovimin e kulturës shqiptare brenda dhe jashtë vendit. Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin përkatës, kryesisht, por jo vetëm, në fushat e përgjegjësisë shtetërore si vijon: Zhvillimi ekonomik dhe politikat e sipërmarrjes; Inovacioni dhe teknologjia; Mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore; Artet, kultura dhe industritë krijuese; si dhe çdo fushë tjetër përgjegjësie që i ngarkohet me aktet përkatëse ligjore dhe nënligjore.

b. Qëllimi i auditimit

Në Auditimin e Përputhshmërisë, synimi është të vlerësohet shkalla në të cilën subjekti i audituar ka zbatuar ligjet, rregulloret, politikat, kodet e sjelljes dhe kushtet kontraktuale që rregullojnë veprimtarinë e tij, përdorimin e burimeve dhe respektimin e kuadrit ligjor, duke u mbështetur në analizën e praktikave të menaxhimit financiar dhe të sistemeve të kontrollit të brendshëm, me qëllim identifikimin dhe vlerësimin e nivelit të riskut në subjekt. Në auditimin financiar synohet kryerja e një vlerësimi të raportimit financiar për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare japin një paraqitje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

c. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku.

Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin¹. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

2. PËRSHKRIM I GJETJEVE KRYESORE DHE REKOMANDIMEVE

Grupi i auditimit ka konstatuar 26 masa organizative, 6 masa dëm ekonomik dhe 3 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efience dhe efektivitet të fondeve publike.

Paraqitja e gjetjeve kryesore.

-Nga auditimi i dokumentacionit mbi buxhetin e MEKI-t u konstatua një numër i konsiderueshëm rishikimesh buxhetore, shoqëruar me rishpërndarje fondesh.

-Nga auditimi u konstatuan projekte të çelura pa kaluar në procedurat e ciklit të miratimit në kuadër të mirë menaxhimit të investimeve publike, konkretisht 7 projekte investimi të çelura në vitin 2024 me një vlerë prej 339,176,10 lekë, 2 projekte në vlerën 153,430,260 lekë për vitin 2023, si dhe 2 projekte investimi në vitin 2022 me vlerë 101,100,000 lekë. Gjithashtu, u konstatuan projekte investimi në tejkalim të planifikimit në Programin Buxhetor Afatmesëm.

-Nga auditimi i procesit të inventarizimit të aktiveve në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit u konstatua një proces inventarizimi aktivesh jo i plotë.

-Nga verifikimi i saktësisë dhe ekzistencës, së elementëve të pasqyrave financiare të vitit 2024 të Ministrisë së Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) rezultoi se, pavarësisht bashkimit institucional të Ekonomisë pjesë e ish-Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me Ministrinë e Kulturës me VKM nr. 30, datë 17.01.2024, ky fakt nuk është reflektuar në pasqyrat financiare.

-Nga verifikimi i pagesave të kryera nga MEKI të gjeneruara nga sistemi SIFQ (961 urdhër shpenzime në total për vitin 2024), për respektimin e afatit të pagesave për detyrimet, afati 30 ditor në 405 raste rezultoi në shkelje të disiplinës buxhetore, për shkak të moslikuidimit në kohë të faturave tatimore, të cilat derivojnë në gjenerim të penaliteteve.

-Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik dhe të konkurrimit publik në 3 raste u konstatuan parregullsi në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe në përcaktimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, të cilat nuk janë në përputhje me natyrën, përmasën dhe objektin e prokurimit dhe nuk i përshtaten procedurës së zhvilluar.

-Nga auditimi i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrimit publik, u konstatua se në 4 raste, kualifikimi i operatorëve ekonomikë të shpallur fitues është bërë në kushtet e mos përmbushjes së kriterëve të veçanta dhe/ose të përgjithshme të kualifikimit të përcaktuara.

-Nga auditimi i zbatimit të kontratave u konstatua se në 4 raste komisionet e marrjes në dorëzim nuk kanë dokumentuar verifikimin e prodhuesit dhe vendit të origjinës së mallrave sipas ofertës dhe formularëve teknikë të paraqitur në fazën e ofertimit; në 5 raste furnizimet nuk janë marrë në dorëzim nga komisionet e ngritura me urdhërin përkatës, por nga persona të paautorizuar (punonjës të institucioneve përfituese); si dhe në 1 rast, në kuadër të kontratës, procesverbali i marrjes në dorëzim është nënshkruar pa pjesëmarrjen e specialistit të fushës, mallrat janë magazinuar dhe është pranuar fatura përkatëse pa përfunduar verifikimi teknik dhe pa shënimin “vlerë në ruajtje”.

¹ **ISSAI 1320 (ISA 320)** trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të përdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.

-Nga auditimi i projektit “Ndërhyrje restauruese në Mozaikun e Tiranës, ndërtim godine” u konstatuan mangësi në fazën e projektimit dhe zbatimit, që lidhen me mungesën e dokumentimit të projektimit dhe sigurimit të përgjegjësisë profesionale, mospërputhje teknike ndërmjet projektit arkitekturor, atij konstruktiv, dhe situatës faktike në terren, si dhe me hartimin jo të plotë të analizës së çmimeve në preventiv. Gjithashtu, u evidentuan ndryshime të paargumentuara të projekt-preventivit, fillim punimesh pa lejen përkatëse të ndërtimit dhe pa miratimet e nevojshme për ndryshimet në pasuri kulturore, si dhe mosraportim i rregullt nga mbikëqyrësi i punimeve.

-Nga auditimi i kontratës me objekt “Zbatimi i punimeve për restaurimin, rikonstruksionin dhe rinovimin e sallës së koncerteve në Universitetin e Arteve në Tiranë” u konstatuan ndryshime të paargumentuara në projekt-preventiv, të kryera pas realizimit faktik të punimeve dhe pa marrë të gjitha miratimet e detyrueshme nga organet kompetente për pasuritë kulturore. Gjithashtu, u evidentuan mospërputhje ndërmjet specifikimeve teknike të projektit dhe punimeve të realizuara në terren, përfshirë heqje zërash dhe ndryshime dimensionale me impakt financiar.

-Nga auditimi i kontratës “Restaurim, Rikonstruksion dhe rehabilitimi i hapësirave në Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria e Arteve)” u konstatua se punimet kanë nisur dhe vijuar pa leje të vlefshme ndërtimi, janë likuiduar pagesa para pajisjes me leje, si dhe janë kryer amendime të pajustificuara të afatit pa argumentim teknik dhe dokumentacion mbështetës, në kundërshtim me kuadrin ligjor përkatës. Gjithashtu, u evidentuan mangësi në raportimin dhe mbikëqyrjen e punimeve, miratim formal i ndryshimeve pas realizimit faktik të tyre dhe mungesë monitorimi efektiv nga Autoriteti Kontraktor.

-Nga auditimi u konstatua se Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit (ish MEKI dhe ish MK) nuk ka ndjekur dhe zbatuar në mënyrë efektive objektivat dhe masat e parashikuara në dokumentin strategjik për zhvillimin e artit dhe kulturës, duke mos siguruar përmbushjen e produkteve të planifikuara në drejtim të konsolidimit të kuadrit ligjor dhe institucional, si dhe nuk rezulton të jetë ngritur një mekanizëm i dedikuar për ndjekjen, monitorimin dhe raportimin e zbatimit të strategjisë. Gjithashtu ende nuk është hartuar dhe miratuar strategjia e re sektoriale pas përfundimit të periudhës së mëparshme, duke krijuar një boshllëk planifikimi dhe orientimi për politikat publike dhe mbështetjen financiare në fushën e artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore.

-Nga auditimi u konstatua se, pavarësisht menaxhimit të programeve buxhetore për artin, kulturën dhe trashëgiminë kulturore, nuk janë nxjerrë aktet nënligjore dhe aktet e brendshme rregullatore të nevojshme për zbatimin e plotë të kuadrit ligjor, duke munguar rregulla të qarta për procedurat e financimit, ndarjen e përgjegjësisë, gjurmët e auditimit, veprimtaritë e kontrollit dhe administrimin e dokumentacionit.

-Nga auditimi i procedurave të miratimit dhe zbatimit të kontratave për financimin e projekteve në fushën e artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore u konstatuan mangësi në dokumentacionin justifikues dhe mungesë e gjurmës së plotë të auditimit për vendimmarrjet në të gjitha fazat e procesit, si në projektet e financuara përmes thirrjeve publike ashtu edhe në ato jashtë tyre. Konkretisht, u evidentuan dosje me dokumentacion të paplotë ose të paformalizuar, mungesë aneksesh kontraktuale të detyrueshme, dokumente të panënshkruara, shtyrje afatesh pa amendime kontraktuale dhe mungesë dokumentacioni që provon përmbushjen e detyrimeve ligjore nga përfituesit.

-Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efience dhe efektivitet të fondeve publike nga likuidimi i vendimeve gjyqësore për ish-punonjësit në vlerën totale prej 40,735,705.5 lekë, dhe vlera e përmbaruesit për vendimet gjyqësore për shpronësimet dhe detyrime të tjera 14,207,569 lekë, në shumën totale prej 54,943,274.5 lekë.

-Dëm ekonomik nga zbatimi i kontratave të audituara ka rezultuar në vlerën **62,285,028** lekë. Me qëllim zgjidhjen e problematikave janë dhënë disa Rekomandime si vijon:

Paraqitja e Rekomandimeve kryesore:

-Titullari i Institucionit të Ministrisë së Kulturës për të garantuar saktësinë dhe plotësinë e të gjithë elementeve të PBA të marrë masa për realizimin e takimeve e GMS, të cilat duhet të jenë të dokumentuara të paktën 4 herë në vit.

-Drejtorja e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa për një planifikim më të drejtë bazuar në vlerësime të shpenzimeve faktike dhe projekteve të ardhshme, me qëllim minimizimin e rishpërndarjeve pa cënuar realizimin e plotë të të gjithë zërave buxhetorë në mënyrë që procesi i planifikimit të jetë efektiv dhe të pasqyrojë gjendjen reale të zbatimit të buxhetit. Çdo kërkesë buxhetore nga institucioni qendror apo nga njësitë e varësisë të shoqërohen me argumentimin e duhur dhe elementët e përcaktuar në udhëzimin përkatës.

-Ekipet e Menaxhimit të Programeve në bashkëpunim me sektorin e buxhetit të marrin masa për plotësimin e të gjithë formularëve për kërkesat buxhetore për projektet e reja të investimeve brenda ose jo tavanëve buxhetore, duke argumentuar çdo kërkesë shtesë, si dhe për çdo program buxhetor të kryhet analiza gjinore.

-Drejtorja e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masat e nevojshme me qëllim eliminimin e praktikave të çeljes së projekteve të reja pa kaluar në procedurat e ciklit të menaxhimit të investimeve publike, me qëllim respektimin e disiplinës buxhetore.

-Nëpunësi autorizues i Ministrisë përgjegjëse për Kulturën dhe Ministrisë përgjegjëse për Ekonominë, të marrë masa për finalizimin e procesit të plotë të inventarizimit fizik të të gjitha aktiveve në pronësi të tyre, duke përfshirë aktivet në ngarkim të punonjësve, artikujt në magazinë, si dhe aktivet e evidentuara nga Komisioni i Inventarizimit si “jashtë funksionit”, të cilat pas përfundimit të inventarizimit të vijnë me procedurat e vlerësimit të mëtejshëm, deri në paraqitjen e gjendjes faktike në regjistrat kontabël.

-Titullari i Ministrisë përgjegjëse për Kulturën dhe Ministrisë përgjegjëse për Ekonominë të marrin masat për të përfunduar ndarjen fizike mes dy ish Ministrive lidhur me të drejtat dhe detyrimet, si dhe të autorizojnë reflektimet e ndarjes në regjistrat kontabël, me qëllim përgatitjen e pasqyrave financiare, që garantojnë paraqitjen e situatës reale të të drejtave dhe detyrimeve.

-Titullari i Ministrisë përgjegjëse për Kulturën dhe Ministrisë përgjegjëse për Ekonominë të marrë masat e nevojshme organizative dhe administrative për përfundimin e procesit të regjistrimit të të gjitha pasurive të paluajtshme në pronësi të institucionit pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, duke garantuar pajisjen me dokumentacion të rregullt pronësie dhe pasqyrimin e saktë të tyre në regjistrat kontabël. Gjithashtu, të ngarkohen strukturat përgjegjëse për ndjekjen dhe monitorimin e këtij procesi, si dhe të sigurohet përditësimi periodik i të dhënave, në përputhje me legjislacionin në fuqi për administrimin e pronës shtetërore.

-Drejtorja e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit të përforcojnë monitorimin e zbatimit të afatit 30-ditor për pagesa, duke vlerësuar edhe mundësinë e krijimit të një mekanizmi automatik sinjalizimi në sistemin SIFQ për rastet që i afrohen afatit ligjor të pagesës.

-Njësitë e prokurimit dhe njësitë e hartimit të dokumenteve të konkurrimit publik të marrin masa për përcaktimin e kriterëve për kualifikim në përputhje me objektin e kontratave, të argumentuara teknikisht, për të siguruar ekonomicitet dhe eficiencë në procedurat e prokurimit publik.

-Komisionet e marrjes në dorëzim të marrin masa për dokumentimin e verifikimeve të kryera për artikujt e furnizuar jo vetëm në raport me specifikimet teknike dhe kontratën e lidhur, por edhe me ofertën e pranuar gjatë fazës së procedurës së prokurimit.

-Nga ana e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sporteve, të merren të gjitha masat e nevojshme për hartimin e projekteve me terma të plotë reference me qëllim shmangien e ndryshimeve të paargumentuara gjatë fazës së zbatimit të kontratës.

-Nga ana e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sporteve, të merren të gjitha masat e nevojshme për të argumentuar në nivel teknik dhe ekonomik ndryshimet e projekt preventivave të punimeve përpara miratimit të tyre me qëllim garantimin e përdorimit me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve.

-Nga ana e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sporteve, të merren të gjitha masat e nevojshme për të mos lejuar fillimin dhe vijimin e punimeve pa marrë më parë nga organet kompetente të gjitha miratimet e nevojshme paraprake në nisje të punimeve apo miratimin e ndryshimeve gjatë zbatimit të tyre.

-Nga ana e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sporteve, të merren të gjitha masat e nevojshme për të garantuar kryerjen e shërbimit nga ana e mbikëqyrësve të punimeve dhe mos kryerjen e pagesave ndaj tyre në rast të mos respektimit të kuadrit ligjor të sipërcituar.

-Nga ana e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sporteve, të merren të gjitha masat e nevojshme për të shmangur kryerjen e veprimeve formale të miratimit të projekteve dhe preventivave të ndryshuar pas realizimit në fakt të tyre nga ana e sipërmarrësit.

-Nga ana e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sporteve, të merren të gjitha masat e nevojshme për të mos miratuar ndryshime të pajustificuara teknike dhe ekonomike të detajeve të projektit të miratuar.

-Nga ana e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sporteve, të merren të gjitha masat e nevojshme për të mos lejuar fillimin dhe vijimin e punimeve pa marrë më parë nga organet kompetente të gjitha miratimet e nevojshme paraprake në nisje të punimeve apo miratimin e ndryshimeve gjatë zbatimit të tyre.

-Nga ana e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sporteve, të merren të gjitha masat e nevojshme për të garantuar kryerjen rregullisht të shërbimit nga ana e mbikëqyrësve të punimeve si dhe shmangien e kryerjes së veprimeve formale të miratimit të projekteve dhe preventivave të ndryshuar pas realizimit në fakt të tyre nga ana e sipërmarrësit.

-Nga ana e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sporteve, të merren të gjitha masat e nevojshme për të rritur dhe intensifikuar përpjekjet në drejtim të kontrolleve dhe monitorimit të rregullt të ndjekjes së kontratave me qëllim vënien në shfrytëzim të aseteve sipas parashikimeve të plan buxheteve përkatës.

3. KONKLuzion I Përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit

I. Opinioni për auditimin financiar (Kualifikuar²):

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, për periudhën 01.01.2024 deri më 31.12.2024, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës, pasqyrën e ndryshimeve në kapital, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë

² Referuar Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së, miratuar me vendimin nr. 246, datë 29.12.2022 “Për miratimin e manualit të auditimit financiar “ të Kryetarit të KLSH-së, kapitulli VII, pika 7.3,5 (faqe 54 dhe 60-61), “Një “Opinion i Kualifikuar”, jepet në rastet kur: audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se: anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë.”

ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i zbatimit të parimeve kontabël si dhe i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t. Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare. Ne jemi të pavarur nga subjekti dhe në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, kemi përmbushur përgjegjësitë etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të institucionit më 31 dhjetor 2024, referuar kuadrit rregullator në fuqi:

Ligjit “Për menaxhimin e sistemit buxhetor” dhe Udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi kornizën e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore, etj. Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura, krahasuar me vlerën e 2% të materialitetit me një vlerë prej 184 milion lekë. Në gjykimin profesional të audituesit të pavarur, justifikojnë dhënien e një **opinionit të kualifikuar të auditimit**, sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm:

Baza për opinionin:

-Pasqyrat financiare të vitit 2024, të paraqitura nga Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nuk reflektojnë ndarjen e bërë nga ish Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Pavarësisht se nëpërmjet dy institucioneve është iniciuar procesi i ndarjes së aktiveve dhe finalizimi i tyre me procesverbalet përkatëse, këto veprime nuk rezultojnë të jenë reflektuar në regjistrat kontabël të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Mungon evidentimi i aktiveve, të drejtave dhe detyrimeve që i përkasin asaj, si dhe reflektimin e situatës në regjistrat kontabël për të mundësuar një paraqitje reale të situatës në regjistrat kontabël, sipas përcaktimeve të pikën 26, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011. Llogaria e vetme e pozicionit financiar që është ndarë është “Shpenzime të periudhave të ardhshme” (llogaria 486). Proces i ndarjes së aktiveve ka përfunduar me datë 17.10.2025. Nga verifikimi i posteve të pasqyrës së pozicionit financiar rezultoi se disa llogari ishin paraqitur në mënyrë të pasaktë dhe të mbivlerësuar, konkretisht: Llogaria “Për aktive afatgjata materiale” paraqitet e mbivlerësuar pasi vlera shtesë e një projekti është regjistruar njëkohësisht si në këtë llogari, ashtu edhe në llogarinë “Për aktive afatgjata jo materiale”, llogaria “Kreditorë të ndryshëm” paraqet zëra, që i përkasin detyrimeve të krijuara gjatë vitit 2024, të cilat duhet të ishin pasqyruar në llogarinë 401 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to”.

Opinion për auditimin e përputhshmërisë (Kualifikuar³).

Mbështetur në, ISSAI 4000 “Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Përputhshmërisë”, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së institucionit me kriteret e vlerësimit përfshirë

³ **Opinion i modifikuar/ kualifikuar:** Referuar Manualit të Përputhshmërisë të KLSH-së (vendim nr. 24, datë 29.12.2022 fq.104) Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar: kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomali apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura”.

kuadrin ligjor, rregullat, rregulloret dhe marrëveshjet që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të këtij institucioni gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës në periudhën nga 01.01.2022- 17.09.2025.

*“Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e subjektit, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një **opinionit të kualifikuar të përputhshmërisë**”.*

Baza për opinionin e përputhshmërisë.

Ne besojmë se dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për sigurimin e bazës për përgatitjen e **opinionit të kualifikuar**, për shkak të çështjeve të identifikuara si vijon:

-Nga dokumentacioni buxhetor i MEKI-t rezultoi një numër i konsiderueshëm rishikimesh dhe rishpërndarjesh fondesh, si dhe projekte investimi të çelura pa kaluar procedurat e ciklit të miratimit, duke cenuar parimet e mirë menaxhimit të investimeve publike.

-Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik dhe të konkurrimit publik u konstatuan parregullsi në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe në përcaktimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, të cilat nuk janë në përputhje me natyrën, përmasën dhe objektin e prokurimit dhe nuk i përshtaten procedurës së zhvilluar, pasi janë vendosur kërkesa të paargumentuara teknikisht dhe të palidhura drejtpërdrejt me realizimin e kontratës, është kërkuar eksperiencë pa analizë dhe argumentim mbi domosdoshmërinë e tyre, është përcaktuar numër minimal stafi teknik pa u bazuar në preventivin dhe grafikun e punimeve.

-Nga auditimi i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrimit publik, u konstatua se në disa raste kualifikimi i operatorëve ekonomikë të shpallur fitues është bërë në kushtet e mos përmbushjes së kriterëve të veçanta dhe/ose të përgjithshme të kualifikimit të përcaktuara në DST/DSKP. Konkretisht, rezultoi përmbushje e kërkesave mbi kapacitetin ekonomik e financiar, përvojën e mëparshme, disponimin e licencave të nevojshme sipas ndarjes së punimeve në bashkim operatorësh, mospërmbushje e kriterëve të përgjithshme për licencim dhe eksperiencë, si dhe mungesë e dokumentacionit të kërkuar për vërtetimin e detyrimeve tatimore dhe përputhshmërisë së objektit të veprimtarisë me objektin e kontratës.

- Nga auditimi i zbatimit të kontratave u konstatuan problematika në marrjen në dorëzim të mallrave.

- Gjatë auditimit të zbatimit të kontratave për punime u konstatuan mangësi në fazën e projektimit dhe zbatimit, përfshirë mungesë dokumentimi, mospërputhje teknike ndërmjet projekteve dhe situatës faktike në terren, hartim jo të plotë të analizës së çmimeve, si dhe ndryshime të paargumentuara në projekt-preventiv. Po ashtu, u konstatuan mangësi në raportim, mbikëqyrje dhe monitorim të punimeve, si dhe mospërputhje ndërmjet specifikimeve teknike të projektit dhe punimeve të realizuara në terren, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 62,285,028 lekë.

-Ministria përgjegjëse për kulturën nuk ka zbatuar në mënyrë efektive dokumentin strategjik për artin dhe kulturën, nuk ka ngritur mekanizma të dedikuar monitorimi dhe raportimi, dhe nuk ka hartuar strategjinë e re pas përfundimit të periudhës së mëparshme. Procedurat e vlerësimit dhe financimit të projekteve kanë pasur mangësi, përfshirë mungesë kriteresh të standardizuara, financime të paformalizuara dhe dokumentacion të pamjaftueshëm.

-Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike nga likuidimi i vendimeve gjyqësore për ish-punonjësit në vlerën totale prej 40,735,705 lekë, dhe vlera e

përmbaruesit për vendimet gjyqësore për shpronësimet dhe detyrime të tjera 14,207,569 lekë, në shumën totale prej 54,943,274.5 lekë.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 951/1 prot., datë 13.10.2025, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 14.10.2025 deri më datën 02.02.2026, në ministrinë përgjegjëse për kulturën u krye auditimi financiar dhe i përputhshmërisë për periudhën nga data 01.01.2022 deri më datë 17.09.2025. Auditimi u krye nga:

Xh. Xh, Përgjegjëse e Grupit të Auditimit

J. H, Auditues

E.K, Audituese

D. P, Auditues

S.Z, Auditues

M.U, Audituese

1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit.

Objekti i auditimit financiar dhe të përputhshmërisë synon të vlerësojë shkallën në të cilën subjekti i audituar ka zbatuar ligjet, rregulloret, politikat, kodet e sjelljes dhe kushtet kontraktuale që rregullojnë veprimtarinë e tij, duke synuar të ofrojë një vlerësim mbi përdorimin e burimeve dhe respektimin e kuadrit ligjor, duke u mbështetur në analizën e praktikave të menaxhimit financiar dhe të sistemeve të kontrollit të brendshëm, me qëllim identifikimin dhe vlerësimin e nivelit të riskut në subjekt, si dhe një vlerësim të raportimit financiar për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare japin një paraqitje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë bazuar në kuadrin rregullator në fuqi

2. Identifikimi i çështjes

Projekt Raporti i Auditimit ka për qëllim të vlerësojë përmbushjen e rolit të Ministrisë për hartimin dhe zbatimin e politikave që nxisin zhvillimin ekonomik të vendit, promovimin e kulturës kombëtare dhe mbështetjen e inovacionit si shtyllë e rritjes së qëndrueshme. Në sektorin e kulturës Ministria ka për qëllim forcimin e institucioneve kulturore, rritjen e aksesit të publikut në aktivitete kulturore dhe përmirësimin e kuadrit rregullator në këtë fushë, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore, mbështetja e krijimtarisë artistike dhe zhvillimi i industrive kreative.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Drejtimi i Ministrisë është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Drejtimi i Ministrisë është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafi menaxherial është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

4. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë një opinion dhe të nxjerrë konkluzione mbi çështjet që janë objekt i auditimit. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI), të hartuara nga INTOSAI, të cilat kërkojnë që audituesit të respektojnë parimet etike dhe të planifikojnë e realizojnë auditimin me qëllim sigurimin e një niveli të arsyeshmërie.

Nëpërmjet auditimit të kryer, grupi i auditimit i KLSH-së synon të formulojë një opinion profesional mbi aspektet që vlerësohen, përfshirë:

- Nëse shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin vjetor të Buxhetit të Shtetit, aktet përkatëse ligjore dhe nënligjore, si dhe me parimet e ligjit “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”;
- Nëse janë respektuar parimet e përgjithshme të menaxhimit financiar në sektorin publik dhe rregullat e sjelljes së zyrtarëve publikë;
- Nëse janë zbatuar kërkesat ligjore dhe normative në fuqi, si Ligji i Buxhetit, legjislacioni financiar, tatimor;
- Nëse pasqyrat financiare japin një paraqitje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë;
- Nëse janë adresuar shkeljet e evidentuara në auditimet e mëparshme ndaj institucionit të audituar;
- Nëse janë marrë në konsideratë interesat dhe pritshmëritë e publikut, përfshirë çështje të ngritura nga media, ankesa apo sinjalizime;
- Nëse janë respektuar kërkesat ligjore në fusha specifike që përbëjnë prioritet auditimi për periudhën përkatëse.

Në përputhje me kërkesat e ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, audituesit kanë zbatuar konceptin e materialitetit gjatë planifikimit dhe zhvillimit të auditimit. Procesi auditues ka përfshirë procedura për mbledhjen e evidencave lidhur me praktikën administrative dhe financiare, si dhe me shifrat e paraqitura në Pasqyrat Financiare. Zgjedhja e procedurave është bazuar në gjykimin profesional të audituesve, duke përfshirë vlerësimin e risqeve të gabimeve materiale, qofshin ato të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Në kuadër të vlerësimit të riskut, audituesit kanë analizuar funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në Ministri, me qëllim përcaktimin e natyrës, kohës dhe shtrirjes së procedurave të auditimit.

5. Kriteret e vlerësimit

Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar;

Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 8379, datë 29.07.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë” me ndryshimet përkatëse;

Ligji nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar;

Ligji nr.10352 datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, i ndryshuar;

Ligji nr.25/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10352 datë 18.11.2010 për artin dhe kulturën”;

Ligji nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar;

Ligji 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, i ndryshuar;

VKM nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar

VKM nr. 903 datë 24.12.2019 “Strategjia Kombëtare për Kulturën”;

VKM nr. 306 datë 11.05.2022 “Për procedurat që ndiqen për financimin e projekteve artistike”;

VKM nr. 997 datë 10.12.2010, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, e ndryshuar;

VKM nr. 306 datë 11.05.2022 “Art në hapësira publike”;

VKM nr. 737 datë 17.09.2020, “Për përcaktimin e rregullave për administrimin e fondit kombëtar të kujdesit të trashëgimisë kulturore materiale”, e ndryshuar;

VKM nr. 1125 datë 30.12.2020 “Për miratimin e rregullave të projektimit, zbatimit të punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale, mbikëqyrjes dhe kolauditimit të tyre”;

VKM Nr. 737, datë 17.09.2020, “Për përcaktimin e rregullave për administrimin e fondit kombëtar të kujdesit të trashëgimisë kulturore materiale”, i ndryshuar;

VKM Nr. 1125, datë 30.12.2020, “Për miratimin e rregullave të projektimit, zbatimit të punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale, mbikëqyrjes dhe kolauditimit të tyre”;

Udhëzimi nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”;

Udhëzimi nr.26, datë 8.9.2023 i Ministrit të Financave “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar;

Urdhri nr.620 datë 13.05.2025 i Ministrit për “Miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit”;

Urdhri nr.123 datë 28.02.2023 i Ministrit “Për miratimin e rregullores së mënyrës së funksionimit të kolegjiut”;

Etj.

6. Standardet e auditimit

ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”; NTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontroleve të brendshëm”; ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë; ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”, si dhe ISSAI 4200 “Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë”.

7. Metodat e auditimit

Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve. Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin⁴. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar. Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:

- Kontrolli aritmetik. Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim.

- Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese. Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin.

⁴ ISSAI 1320 (ISA 320) trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të përdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.

Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoj përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

- Kontrolli i vlerësimit. Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre. - Konfirmim nga të tretët. Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër. - Kontrolli sipas një treguesi. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkojnë fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.

- Verifikimi i transaksioneve - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre. - Intervistimi - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.

- Raporte dhe informacione - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.

Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm.

8. Dokumentimi i auditimit

Mbi bazën e pyetësorëve dhe testeve përkatëse të miratuara në manualët e auditimit të përputhshmërisë, audituesit përgatitën dokumentacionin përkatës të auditimit, të mjaftueshëm për të mundësuar kuptimin e natyrës, kohës dhe shtrirjes së procedurave të kryera, në përputhje me standardet përkatëse si dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore në fuqi. Në vijim të këtyre procedurave dhe bazuar në evidencat e mbledhura, u hartuan Akt-Konstatimet. Pas shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i audituar, u përgatit Projekt-Raporti i Auditimit, i cili përbën bazën për hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe Opinionit të Audituesit të Jashtëm Publik. Rezultatet e procedurave të zbatuara, evidencat e mbledhura dhe çështjet e tjera me rëndësi të identifikuara gjatë procesit të auditimit janë reflektuar në përfundimet përkatëse, të cilat janë nxjerrë përmes gjykimit dhe skepticizmit profesional të ushtruar nga audituesit. Në përfundim të auditimit në terren, Akteve të Konstatimeve të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara dhe trajtimit të observacioneve të sjella nga subjekti i audituar, u përgatit Raporti Përfundimtar i Auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Për periudhën 01.01.2022 deri më 17.09.2025, fusha e përgjegjësisë së institucionit përgjegjës për kulturën ka pësuar ndryshime të rëndësishme strukturore dhe funksionale, si rezultat i ristrukturimeve të miratuara me vendime të Këshillit të Ministrave. Në fillim të periudhës (2022–2023), kultura ushtrohej si fushë përgjegjësie e një ministrie të dedikuar, me kompetenca të përqendruara në hartimin dhe zbatimin e politikave për mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë

kulturore materiale dhe jomateriale, zhvillimin e arteve, mbështetjen e krijimtarisë artistike dhe administrimin e institucioneve kulturore kombëtare, në zbatim të legjislacionit sektorial dhe dokumenteve strategjike në fuqi.

Në fillim të vitit 2024, në kuadër të riorganizimit të administratës qendrore, me VKM nr. 30, datë 17.01.2024, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit”, u krijua Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI), duke integruar në një portofol të vetëm fushat e ekonomisë, kulturës dhe inovacionit. Si rrjedhojë, përgjegjësia për kulturën vijoi të ushtrohej brenda një strukture shumë sektoriale, ku politikat për trashëgiminë kulturore, artet dhe industrinë krijuese u ndërlidhën me politikat e zhvillimit ekonomik dhe inovacionit, duke reflektuar një qasje të re ndërsektoriale në administrimin e sektorit kulturor.

Më tej, në vijim të ristrukturimit të administratës qendrore në vitin 2025, me VKM nr. 512, datë 25.09.2025, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit”, fusha e kulturës u përfshi në një ministri të re që bashkon turizmin, kulturën dhe sportin, me krijimin e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit.

Ish Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit ka si qëllim kryesor hartimin dhe zbatimin e politikave që nxisin zhvillimin ekonomik të vendit, promovimin e kulturës kombëtare dhe mbështetjen e inovacionit si shtyllë e rritjes së qëndrueshme.

Në sektorin e kulturës, fokusi ka qenë ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore, mbështetja e krijimtarisë artistike dhe zhvillimi i industrive kreative. Ministria ka për qëllim forcimin e institucioneve kulturore, rritjen e aksesit të publikut në aktivitete kulturore dhe përmirësimin e kuadrit rregullator në këtë fushë.

Në fushën e ekonomisë, ministria synon të mbështesë sipërmarrjen, veçanërisht ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, përmes skemave lehtësuese, politikave fiskale mbështetëse dhe programeve për rritjen e eksporteve, si dhe tërheqja e investimeve të huaja direkte dhe forcimi i bashkëpunimit me partnerë ndërkombëtarë për zhvillim ekonomik.

Sa i përket inovacionit, prioritet mbetet nxitja e teknologjisë, digjitalizimit dhe mbështetja e startup-eve, me synim krijimin e një ekonomie të bazuar në dije dhe teknologji, si dhe rritja e kapaciteteve konkurruese dhe të promovimi i transformimit digjital të sektorëve strategjikë.

Në tërësi, veprimtaria është orientuar drejt zhvillimit të integruar ekonomik, kulturor dhe teknologjik, duke synuar rritje të qëndrueshme, punësim dhe rritje të vlerës së shtuar në ekonomi.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit:

2.1 Planifikimi, zbatimi dhe monitorimi i buxhetit. Programi PBA dhe buxheti vjetor, çelja e fondeve vjetore dhe ndryshimet sipas akteve normative, saktësia e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

a. Zbatimi i kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit.

Për vitin 2022, 2023 buxheti i miratuar për Ministrinë e Kulturës paraqitet sipas 3 programeve buxhetore të miratuara si më poshtë vijon:

1. Planifikim, Menaxhim, Administrim;
2. Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë;
3. Arti dhe Kultura.

Për shpenzimet për paga, sigurime, mallra dhe shërbime (llog. 600, llog. 601, llog. 602 ,606 dhe 230-231) me financim të brendshëm nga fondet buxhetore;

Për shpenzimet për investime (llog. 230 & llog. 231), të cilat financohen nga fondet buxhetore dhe

financim i huaj.

Me VKM nr. 30 datë 17.01.2024 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacioni”, Ministria e Kulturës u bashkua me Ministrinë e Ekonomisë ku nga 3 programe buxhetore, u shtuan edhe 8 programe të tjera. Financimi i MEKI-it kryhet si më poshtë:

Buxheti i miratuar për MEKI-n paraqitet sipas njëmbëdhjetë programeve të miratuara si mëposhtëm vijon:

1. Planifikim Menaxhim Administrimi; 2. Mbështetje për Inovacion; 3. Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik; 4. Mbështetje për Mbikëqyrjen e Tregut, Infrastruktura Cilësisë dhe Pronësia Industriale; 5. Sigurimi Shoqëror; 6. Tregu i Punës; 7. Inspektimi në Punë; 8. Arsimi i Mesëm (profesional); 9. Strehimi; 10. Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë; 11. Arti dhe Kultura.

Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Ekipet e Menaxhimit të Programeve 2022-2025

Për vitin 2025, me shkresën nr. 4109 datë 13.03.2025 është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), me anë të Urdhrit të Ministrit nr. 325 datë 13.03.2025 “*Për krijimin dhe përbërjen e grupit të menaxhimit strategjik (GMS)*” i ndryshuar. Me urdhrin e Ministrit nr. 320 datë 12.03.2023 protokolluar me shkresën nr. 4041 datë 12.03.2025 “Për ngritjen e ekipeve të menaxhimit të programeve buxhetore (EMP)”, i ndryshuar janë ngritur grupet e punës për 11 programet buxhetore të MEKIT-t. Për vitin 2024, me shkresën nr. 3412 prot. datë 11.03.2024 është ngritur është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), me anë të Urdhrit të Ministrit nr. 128 datë 11.03.2024 “*Për krijimin dhe përbërjen e grupit të menaxhimit strategjik (GMS)*” i ndryshuar, për 11 programe buxhetore. Për vitin 2023, me shkresën nr. 2062/1 prot. datë 28.04.2023 është ngritur është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), me anë të Urdhrit të Ministrit nr. 264 datë 28.04.2023 “*Për krijimin dhe përbërjen e grupit të menaxhimit strategjik (GMS)*”. Me shkresën nr. 2062/2 prot., datë 28.04.2023 janë ngritur Ekipet e Menaxhimit për tre Programet Buxhetore me anë të Urdhrit të Ministrit nr. 265 datë 28.04.2023 “*Ngritja e ekipeve të menaxhimit të Programeve Buxhetore (EMP)*”. Për vitin 2022, Grupi të Auditimit nuk ju dorëzuan urdhri i ngritur nga titullari për Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS), për 3 programe buxhetore të Ministrisë së Kulturës. Grupi i auditimit konstatoi se për vitin 2022 dhe vitin 2024 nga titullari i institucionit nuk është caktuar grupi i punës për ngritjen e ekipeve të menaxhimit të programeve buxhetore. Gjithashtu, grupit të auditimit për vitet 2022 - 2025, nuk iu dorëzua asnjë dokument vërtetues mbi takimet periodike të cilat janë zhvilluar nga grupet e menaxhimit strategjik. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*”, i ndryshuar, neni 27, pika 1 si dhe me Udhëzimin nr. 16 të MFE, datë 20.07.2016 “*Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike*” pika nr. 3, paragrafi 2.2.4 “*Roli i GMS në sistemin e MFK*”, së, e cila përcakton se: “*GMS duhet të mbledhet të paktën katër herë në vit...*”

Programimi i PBA-së 2022-2024 dhe i buxhetit të shpenzimeve të vitit 2022

Procedurat e planifikimit në kuadër të hartimit të fazës së I-rë të PBA 2023-2025

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “*Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.02.2018 “*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*”, Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 26.02.2021 “*Për përgatitjen e PBA 2022-2024*”, MK me shkresën nr. 2263 datë 30.04.2021 ka hartuar dhe dorëzuar në Ministrinë e Financave dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 në zbatim të Udhëzimit plotësues nr. 19, datë 09.07.2021, “*Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024*”, pika 10/a (deri me datë 1 maj 2022). Grupi i auditimit konstatoi se PBA 2022-2024 e hartuar nga MK është dorëzuar brenda afatit të përcaktuar në udhëzim.

Procedurat e planifikimit në kuadër të hartimit të fazës së II^{të} të PBA 2022-2024

Tavanet përfundimtare të shpenzimeve buxhetore për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 janë miratuar me VKM nr. 440 datë 22.07.2021 “Për miratimin e tavanëve përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”. Me shkresën nr. 4493 prot., datë 01.09.2021 të Ministrit të MK-s, janë përcjellë në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në MFE, kërkesat buxhetore, pasqyrat plotësuese të projektbuxhetit të vitit 2022 dhe relacioni shoqërues (në përputhje me pikën 8.6, kapitulli 1 i udhëzimit standard për përgatitjen e PBA-së) për institucionet e varësisë dhe aparatit të MK-s në kuadër të hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024, sipas formatit të përcaktuar në Udhëzimin plotësues nr. 19, datë 09.07.2021 “Për përgatitjen e PBA 2022-2024”, brenda datës 1 shtator. Me shkresën nr.6441/1 datë 20.12.2021 nga MK është dërguar faza e III e PBA 2022-2024 Ministrisë së Financave.

Tabela nr.a/1 - Planifikimi i fondeve sipas programeve në PBA 2022-2024 të hartuar nga MK krahasuar me tavanet buxhetore të miratuara me VKM 440/2021 paraqitet në mënyrë të përmbledhur paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Ministria e Kulturës	Tavanet buxhetore 2022	Kërkesat shtesë 2022	% e kërkesave shtesë
Shpenzime personeli (600+601)	962,347		
Shpenzime të tjera korrente (602+606)	927,413	155,353	4%
Shpenzime kapitale me financim të brendshëm (230+231)	2,262,500	3,604,210	92%
Shpenzime kapitale me financim të huaj (230+232)	160,000	158,595	4%
Totali	4,312,260	3,918,158	100%

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MK

Nga sa më sipër, MK përveç kërkesave ekzistuese, ka paraqitur kërkesa shtesë për të tre programet buxhetore që ka në administrim, të cilët të analizuara në nivel programi paraqiten si më poshtë vijon:

Në Programin *Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë* me rreth 2.29 miliard lekë në total, ku pjesa më e madhe e këtyre fondeve janë kërkuar për projekte që kanë kërkuar financim për ndërhyrje emergjente restauruese konsoliduese në objekte monumente kulture të kategorisë së I-rë të cilët rrezikojnë të zhduken, me vlerë 1,720,625,633 lekë dhe për projekte / objekte në risk që kërkojnë financim për vitin 2022 me vlerë 385,785,300 lekë.

Për programin *Arti dhe Kultura*, kërkesat shtesë lidhen me hartimin e projektit për Bibliotekën Kombëtare, hartimin e projektit për Teatrin e Kukullave dhe blerje vegla muzikore me vlerë për Teatrin e Operës dhe Baletit. Gjithashtu, është kërkuar vendosja e tavanëve (kapitulli 2) me vlerë 90 milion lekë për vitin 2022 me qëllim përdorimin e financimit të huaj.

Programimi i PBA-së 2023-2025 dhe i buxhetit të shpenzimeve të vitit 2023

Procedurat e planifikimit në kuadër të hartimit të fazës së I-rë të PBA 2023-2025

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe Udhëzimin e MFE nr.9, datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e PBA 2023-2025”, MK me shkresën nr. 1358/2 datë 29.04.2022 ka hartuar dhe dorëzuar në Ministrinë e Financave dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 në zbatim të Udhëzimit plotësues nr. 9, datë 28.02.2022, “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”, pika 10/a (deri me datë 1 maj 2024). Grupi i auditimit konstatoi se PBA 2023-2025 e hartuar nga MK është dorëzuar brenda afatit të përcaktuar në udhëzim.

Procedurat e planifikimit në kuadër të hartimit të fazës së II^{të} të PBA 2023-2025

Tavanet përfundimtare të shpenzimeve buxhetore për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 janë miratuar me VKM nr. 130 datë 02.03.2023 “Për miratimin e tavanëve

përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”.

Me shkresën nr. 4717 prot., datë 01.09.2022 të Ministrit të MK-s, janë përcjellë në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në MFE, kërkesat buxhetore, pasqyrat plotësuese të projektbuxhetit të vitit 2023 dhe relacioni shoqërues (në përputhje me pikën 8.6, kapitulli 1 i udhëzimit standard për përgatitjen e PBA-së) për institucionet e varësisë dhe aparatit të MK-s në kuadër të hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025, sipas formatit të përcaktuar në Udhëzimin plotësues nr.22, datë 08.07.2022 “Për përgatitjen e PBA 2023-2025”, brenda datës 1 shtator. Me shkresën nr.6950/3 datë 20.12.2022 nga Ministria e Kulturës është dërguar faza e III e PBA 2023-2025 Ministrisë së Financave.

Tabela nr.a/1 - Planifikimi i fondeve sipas programeve në PBA 2023-2025 të hartuar nga MK krahasuar me tavanet buxhetore të miratuara me VKM 535/2022 paraqitet në mënyrë të përmbledhur si më poshtë

Në mijë lekë

Ministria e Kulturës	Tavanet buxhetore 2023	Kërkesat shtese 2023	% e kërkesave shtese
Shpenzime personeli (600+601)	1,116,328	130,818	3%
Shpenzime të tjera korrente (602+606)	1,044,153	1,032,630	28%
Shpenzime kapitale me financim të brendshëm (230+231)	1,712,000	2,526,734	67%
Shpenzime kapitale me financim të huaj (230+232)	100,000	64,247	2%
Totali	3,972,481	3,754,429	100%

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MK

Nga sa më sipër MK përveç kërkesave ekzistuese, ka paraqitur kërkesa shtesë për të tre programet buxhetore që ka në administrim, të cilët të analizuara në nivel programi paraqiten si më poshtë vijon:

Për shpenzimet korrente:

- Shtesa është paraqitur në programin *Planifikim/Menaxhim/Administrim*, për gjashtë vendime gjyqësore dhe për mbulimin e shpenzimeve të ushtrimit të funksioneve të znj. L. M. si dhe riemërimin e saj në detyrën e Sekretarit të 1 në Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Romë, me vlerë totale 318 milion lekë.

- Në programin *Trashëgimia Kulturore dhe Muzet*, janë kërkuar fonde shtesë në vlerën 250 milion lekë për aktivitetet si: shërbimi i Sigurimit dhe Ruajtjes me roje në vlerën 65,000,000 lekë, zhvillimi i Festivalit Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës me vlerë 95,000,000 lekë, Konkursi Kombëtar *Novelat Grafike 2023*, edicioni 8-të në zërin 604 në vlerën prej 3,400,000 lekë, Dita Kombëtare e Trashëgimisë Kulturore dhe Ditët Europiane në Qarkun Vlorë në vlerën 6,000,000 lekë, përmirësimi dhe integrimi i sistemeve të IKRTK" dhe IKTK (vlera e mirëmbajtjes) 26,160,000 lekë, përmirësimi i Sistemit të Biletave Elektronike për Sitet Kulturore (vlera mirëmbajtjes) 54,297,914 lekë.

- Në programin “Arti dhe Kultura”, janë kërkuar shtesë në vlerën 144 milion lekë për mbulimin e shpenzimeve mbi Vendimin Gjyqësor, midis Cirkut Kombëtar dhe ndaj kreditorit.

"Sh.U shpk" në vlerën 50,353,471 lekë, për përballimin e shpenzimeve të shërbimit të sigurimit dhe ruajtjes si rezultat i efekteve financiare që rrjedhin nga ndryshimi i legjislacionit për pagesën e rojeve 26,000,000 lekë, pjesëmarrjen e Ministrisë së Kulturës në edicionin e vitit 2023 në Bienalen e Muzikës 6,000,000 lekë, zhvillimi i një konkursi kombëtar për dramën më të mirë në vitin 2023 7,000,000 lekë, pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në Programin Rrugët Kulturore 612,500 lekë, Rrjeti Evropian i Kujtesës dhe Solidaritetit- parashikohet anëtarësimi si anëtar me të drejta të plota në 2023 me vlerë 6,125,000 lekë, Dixhitalizimi dhe përmirësimi i sistemeve të AQSHF 18.078,014 lekë, Ngritja e platformës dixhitale për të drejtën e Autorit në vlerën 30,240,000 lekë.

Për shpenzimet kapitale:

Për programin "Arti dhe Kultura", është paraqitur kërkesë shtesë prej rreth 1.1 miliard lekë për vitin 2023 për 5 projekte si dhe 3 pagesa TVSH. Gjithashtu është paraqitur kërkesë shtesë dhe për tavan të financimit të huaj për vitin 2023 në vlerën 54 milion lekë me qëllim përdorimin e financimit të huaj për disa projekte. Për programin "Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë", është paraqitur kërkesë shtesë për financim të brendshëm në total rreth 1.46 miliard lekë për dy shpronësime si dhe për:

- Dixhitalizimi dhe përmirësimi i sistemeve të AQSHF. "Ngritja e platformës dixhitale për të drejtën e autorit" Përmirësimi dhe integrimi i sistemeve të IKRTK dhe IKTK (implementimi), në vlerën 212.930,400 lekë.
- Përmirësimi i Sistemit të Biletave Elektronike për Sitet Kulturore (vlera implementimit) 205,123,548 lekë.
- TVSh për Projekt IPA "S.M" Korçë në vlerën 1.500,000 lekë.
- Projekte që kërkojnë financim për ndërhyrje emergjente restauruese konsoliduese në objekte monumente kulture të kategorisë së I-rë të cilët rrezikojnë të zhduken me vlerën 55 milion lekë.
- Projekte të listës së riskut që kërkojnë financim për vitin 2023 me vlerë 203 milion lekë.

Programimi i PBA-së 2025-2027 dhe i buxhetit të shpenzimeve të vitit 2025

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është instrument operacional për menaxhimin e shpenzimeve publike dhe një komponent i Sistemit të Planifikimit të Integruar. Ky dokument përdoret për të informuar Kuvendin e Shqipërisë dhe publikun e gjerë lidhur me planet e shpenzimeve të qeverisë për tre vitet e ardhshme, të cilat do të çojnë në arritjen e objektivave politike të qeverisë. Ai përcakton kontekstin afatmesëm të buxhetit vjetor. Kërkesat buxhetore të institucionit hartohen në bazë të programit buxhetor afatmesëm, në mënyrë që shpërndarjet e fondeve buxhetore të reflektojnë qëllimet e politikës dhe iniciativat e përcaktuara në programin e qeverisë gjatë një periudhe 3-vjeçare, në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, Udhëzimit të MFE nr.7 datë 28.02.2018, "*Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm*" dhe udhëzimit plotësues nr. 9, datë 10.07.2024 "*Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027*". Planifikimi i zërave të shpenzimeve për "Fondin e pagave & sigurimeve shoqërore" (llog 600 dhe 601), është bazuar në nivelin aktual të punonjësve dhe strukturës së miratuar për secilin program buxhetor të pagave sipas kategorive të përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Llogaritja për shpenzime të tjera korrente (llog 602-606) është bazuar në kërkesat e institucioneve të varësisë së këtij institucioni, limiteve të miratuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, limiteve të shpenzimeve të periudhave paraardhëse dhe realizimi i pritshëm të vitit.

Procedurat e planifikimit në kuadër të hartimit të fazës së I-rë të PBA 2025-2027

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.02.2018 "*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*" dhe Udhëzimin e MFE nr.9, datë 10.07.2024 "*Për përgatitjen e PBA 2025-2027*", MEKI me shkresën nr. 5624 datë 02.05.2024 ka hartuar dhe dorëzuar në Ministrinë e Financave protokolluar me shkresën nr.4242/97 datë 22.05.2024 dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 në zbatim të Udhëzimit plotësues nr. 9, datë 10.07.2024 "*Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027*", pika 10/a (deri me datë 1 maj 2024). Grupi i auditimit konstatoi se PBA 2025-2027 e hartuar nga MEKI është dorëzuar 22 (njëzet e dy) ditë më vonë se afati i përcaktuar në udhëzim.

Procedurat e planifikimit në kuadër të hartimit të fazës së II-të të PBA 2025-2027

Tavanet përfundimtare të shpenzimeve buxhetore për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 janë miratuar me VKM nr. 535 datë 12.08.2024 "*Për miratimin e taveve*

përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027”.

Me shkresën nr. 10736 prot., datë 02.09.2024 të Ministrit të MEKI-t, janë përcjellë në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në MFE, kërkesat buxhetore, pasqyrat plotësuese të projektbuxhetit të vitit 2025 dhe relacioni shoqërues (në përputhje me pikën 8.6, kapitulli 1 i udhëzimit standard për përgatitjen e PBA-së) për institucionet e varësisë dhe aparatit të MEKI-t në kuadër të hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027, 1 ditë me vonesë por sipas formatit të përcaktuar në Udhëzimin plotësues nr. 9, datë 10.07.2024 “Për përgatitjen e PBA 2025-2027”, brenda datës 1 shtator.

Tabela nr.a/1 - Në PBA 2025-2027 buxheti i planifikuar sipas programeve paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

12	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit	Buxheti 2024	Plan 2025	Plan 2026	Plan 2027
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	3,137,678	446,979	506,979	511,979
08220	Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë	1,078,623	869,378	875,378	880,378
08230	Arti dhe kultura	2,646,348	3,014,063	3,031,063	2,336,063
04130	Mbështetje për zhvillim ekonomik	483,243	646,309	502,119	349,388
04160	Mbështetje për mbikq. e tregut, infrast. e cilës. dhe pron. industr.	410,060	389,922	400,422	390,922
10220	Sigurimi Shoqëror	46,219,801	35,137,530	37,023,530	37,604,530
10550	Tregu i Punës	2,557,271	2,876,547	2,818,547	2,828,547
04170	Inspektimi në Punë	238,205	265,984	266,984	266,984
09240	Arsimi i Mesëm (profesional)	3,668,182	3,960,469	3,845,469	3,846,469
01150	Mbështetje për Inovacion dhe Teknologji	121,847	319,388	339,388	507,119
06190	Strehimi	1,195,442	1,395,000	1,345,000	1,345,000
Totali		61,756,700	49,321,569	50,954,879	50,867,379

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MEKI-t

- Sa i takon programit të *Planifikim / menaxhim / administrim* (01110) së MEKI-t, buxheti në vitin 2024 është 3,137,678 mijë lekë. Në PBA 2025-2027, MEKI parashikon shumën 446,979 mijë lekë si buxhet total për vitin 2025, duke reflektuar një ulje prej 86% në raport me vitin 2024. Gjithashtu për vitin 2026 MEKI parashikon shumën 506,979 mijë lekë si buxhet total duke reflektuar një rritje prej 13% në raport me vitin 2025, si dhe për vitin 2027 është parashikuar shuma prej 511,979 mijë lekë si buxhet total duke reflektuar një rritje prej 0.1% në raport me vitin 2026.

- Sa i takon programit të *Trashëgimisë Kulturore dhe Muzetë* (08220), buxheti në vitin 2024 është 1,078,623 mijë lekë. Në PBA 2025-2027, MEKI parashikon shumën 869,378 mijë lekë si buxhet total për vitin 2025, duke reflektuar një ulje prej 20% në raport me vitin 2024.

Gjithashtu për vitin 2026 MEKI parashikon shumën prej 875,378 mijë lekë si buxhet total duke reflektuar një rritje prej 0.1% në raport me vitin 2025, si dhe për vitin 2027 është parashikuar shuma prej 880,378 mijë lekë si buxhet total duke reflektuar një rritje prej 0.6% krahasuar me 2026;

- Sa i takon programit *Arti dhe Kultura* (08230), buxheti në vitin 2024 është 2,646,348 mijë lekë. Në PBA 2025-2027, MEKI parashikon shumën 3,014,063 mijë lekë si buxhet total për vitin 2025, duke reflektuar një rritje prej 14% në raport me vitin 2024.

Gjithashtu për vitin 2026 MEKI parashikon shumën prej 3,031,063 mijë lekë si buxhet total duke reflektuar një rritje prej 0.1% në raport me vitin 2025, si dhe për vitin 2027 është parashikuar shuma prej 2,336,063 mijë lekë si buxhet total duke reflektuar një ulje prej 23% krahasuar me 2026;

- Sa i takon programit *Mbështetje për zhvillimin ekonomik* (04130), buxheti në vitin 2024 është 483,243 mijë lekë. Në PBA 2025-2027, MEKI parashikon shumën 646,309 mijë lekë si buxhet total për vitin 2025, duke reflektuar një rritje prej 14% në raport me vitin 2024.

Gjithashtu për vitin 2026 MEKI parashikon shumën prej 502,119 mijë lekë si buxhet total duke reflektuar një ulje prej 23% në raport me vitin 2025, si dhe për vitin 2027 është parashikuar shuma prej 349,388 mijë lekë si buxhet total duke reflektuar një ulje prej 30% krahasuar me 2026;

- Sa i takon programit *Mbështetje për zhvillimin e tregut, infrastrukturës e cilësisë dhe pronësia industriale* (04160), buxheti në vitin 2024 është 410,060 mijë lekë. Në PBA 2025-2027, MEKI parashikon shumën 389,922 mijë lekë si buxhet total për vitin 2025, duke reflektuar një ulje prej 5% në raport me vitin 2024.

Gjithashtu për vitin 2026 MEKI parashikon shumën prej 400,422 mijë lekë si buxhet total duke reflektuar një rritje prej 3% në raport me vitin 2025, si dhe për vitin 2027 është parashikuar shuma prej 390,922 mijë lekë si buxhet total duke reflektuar një ulje prej 3% krahasuar me 2026;

- Sa i takon programit *Sigurimi Shoqëror* (010220), buxheti në vitin 2024 është 46,219,801 mijë lekë. Në PBA 2025-2027, MEKI parashikon shumën 35,137,5230 mijë lekë si buxhet total për vitin 2025, duke reflektuar një ulje prej 23% në raport me vitin 2024.

Gjithashtu për vitin 2026 MEKI parashikon shumën prej 37,023,530 mijë lekë si buxhet total duke reflektuar një rritje prej 5% në raport me vitin 2025, si dhe për vitin 2027 është parashikuar shuma prej 37,604,530 mijë lekë si buxhet total duke reflektuar një rritje prej 1% krahasuar me 2026;

- Sa i takon programit *Tregu i Punës* (01550), buxheti në vitin 2024 është 2,557,271 mijë lekë. Në PBA 2025-2027, MEKI parashikon shumën 2,876,547 mijë lekë si buxhet total për vitin 2025, duke reflektuar një rritje prej 13% në raport me vitin 2024.

Gjithashtu për vitin 2026 MEKI parashikon shumën prej 2,818,547 mijë lekë si buxhet total duke reflektuar një ulje prej 3% në raport me vitin 2025, si dhe për vitin 2027 është parashikuar shuma prej 2,828,547 mijë lekë si buxhet total duke reflektuar një rritje prej 0.4% krahasuar me 2026;

- Sa i takon programit *Inspektimi në Punë* (04170), buxheti në vitin 2024 është 238,205 mijë lekë. Në PBA 2025-2027, MEKI parashikon shumën 265,984 mijë lekë si buxhet total për vitin 2025, duke reflektuar një rritje prej 12% në raport me vitin 2024.

Gjithashtu për vitin 2026 MEKI parashikon shumën prej 266,984 mijë lekë si buxhet total duke reflektuar një rritje prej 0.4% në raport me vitin 2025, si dhe për vitin 2027 është parashikuar shuma prej 266,984 mijë lekë si buxhet total, e njëjta vlerë krahasuar me vitin 2026;

- Sa i takon programit *Arsimi i Mesëm Profesional* (09240), buxheti në vitin 2024 është 3,668,182 mijë lekë. Në PBA 2025-2027, MEKI parashikon shumën 3,960,469 mijë lekë si buxhet total për vitin 2025, duke reflektuar një rritje prej 8% në raport me vitin 2024.

Gjithashtu për vitin 2026 MEKI parashikon shumën prej 3,845,469 mijë lekë si buxhet total duke reflektuar një ulje prej 0.3% në raport me vitin 2025, si dhe për vitin 2027 është parashikuar shuma prej 3,846,469 mijë lekë si buxhet total duke reflektuar një rritje prej 0.01% krahasuar me 2026;

- Sa i takon programit *Mbështetje për Inovacion dhe Teknologji* (09240), buxheti në vitin 2024 është 121,847 mijë lekë. Në PBA 2025-2027, MEKI parashikon shumën 319,388 mijë lekë si buxhet total për vitin 2025, duke reflektuar një rritje prej 62% në raport me vitin 2024.

Gjithashtu për vitin 2026 MEKI parashikon shumën prej 339,388 mijë lekë si buxhet total duke reflektuar një rritje prej 3% në raport me vitin 2025, si dhe për vitin 2027 është parashikuar shuma prej 507,119 mijë lekë si buxhet total duke reflektuar një rritje prej 49% krahasuar me 2026;

- Sa i takon programit *Strehimi* (06190), buxheti në vitin 2024 është 1,195,442 mijë lekë. Në PBA 2025-2027, MEKI parashikon shumën 1,395,000 mijë lekë si buxhet total për vitin 2025, duke reflektuar një rritje prej 17% në raport me vitin 2024.

Gjithashtu për vitin 2026 MEKI parashikon shumën prej 1,345,000 mijë lekë si buxhet total duke reflektuar një ulje prej 3.6% në raport me vitin 2025, si dhe për vitin 2027 është parashikuar shuma prej 507,119 mijë lekë si buxhet total e njëjta vlerë krahasuar me vitin 2026.

Tabela nr.a/2 - Planifikimi i fondeve sipas programeve në PBA 2025-2027 të hartuar nga MEKI krahasuar me tavanet buxhetore të miratuara me VKM 535/2024 paraqitet në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

Në mijë lekë

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit	Tavanet buxhetore 2025	Kërkesat shtese 2025	% e kërkesave shtese
Shpenzime personeli (600+601)	5,726,936	652,824	11.4
Shpenzime të tjera korrente (602+606)	39,816,472	1,407,900	3.5
Shpenzime kapitale me financim të brendshëm (230+231)	2,963,469	1,214,162	41.0
Shpenzime kapitale me financim të huaj (230+232)	814,690	46,574	5.7
Totali	49,321,567	3,321,460	6.7

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MEKI-t

Nga sa më sipër MEKI përves kërkesave ekzistuese, ka paraqitur kërkesa shtesë për 8 nga 11 programet buxhetore që ka në administrim, të cilët të analizuara në nivel programi paraqiten si më poshtë vijon:

Programi *Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi*

Në këtë program është kërkuar shtesë në llogarinë (602) për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, në vlerën 127,896,981 lekë.

Programi *Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë*

Në këtë program është kërkuar shtesë në financimin e brendshëm prej 210 milion lekësh për ndërhyrje dhe restaurim në objektet pasuri kulturore.

Programi *Arti dhe Kultura*

Në këtë program është kërkuar shtesë 75 milion lekë, në artikullin (604) për sezonin turistik 2025 dhe Danci kontemporan i A.P.

Programi *Mbështetje për Zhvillim Ekonomik*

Në këtë program është kërkuar një shtesë në shpenzimet e personelit si më poshtë:

- Nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), është kërkuar një shtesë prej 20,213,022 lekë, pasi AIDA ka finalizuar procesin e ristrukturimit të organikës ekzistuese dhe struktura e re organizative sjell shtim të numrit faktik të punonjësve me 12 punonjës

- Nga Qendra Kombëtare e Biznesit, është kërkuar një shtesë prej 7,166,000 lekë, për arsye se fondi i pagave është i pamjaftueshëm.

Në shpenzimet korrente është kërkuar një shtesë prej 81 milion lekësh, e detajuar si më poshtë:

- Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve, kërkon 2 milion lekë shtesë për shkak se pritet ndryshimi i ligjit për koncesionet dhe PPP si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, për t'i përafruar me acquis të BE-së. Në vijim të ndryshimeve ligjore kanë kërkuar të ndërmerren trajnime për stafet përkatëse të autoriteteve kontraktuese.

- Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, kërkon 50 milion lekë, për fondin për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme dhe 29 milion lekë për zhvillimin e detyrave, si Pjesëmarrjet në panaire brenda dhe jashtë vendit, Takime të ndryshme me bizneset shqiptare, Fushatat e marketimit, etj

Është kërkuar shtesë në shpenzimet kapitale me financim të brendshëm prej 31.2 milion lekësh.

Programi *Tregu i Punës*

Është kërkuar shtesë në shpenzimet e personelit prej 195.5 milion lekësh nga ri-llogaritjet sipas strukturës së planifikuar ka rezultuar se nevojitet me shumë fond.

Gjithashtu është kërkuar shtesë për shpenzime kapitale në kapitullin e financimit të huaj në vlerën 46,574,400 lekë për vitin 2025 me argumentin se AKPA ka aplikuar dhe janë duke përfutur grande për disa projekte.

Programi *Arsimi i Mesëm (profesional)*

Është kërkuar shtesë në shpenzimet të personelit prej rreth 430 milion lekë si pasojë e reformës dhe proceseve në vazhdim nga shtatori i vitit 2024 e në vijim të cilat kërkojnë shtimin me 175 punonjës në arsimin profesional.

Është kërkuar një shtesë në Shpenzimet operative në total 72 milion lekë për:

- Mallra dhe shërbime (hapja e shkollës së Kukësit dhe procedimi i kërkesës së shkollës jo publike "Sh.J" për të kaluar në shkollë publike, si dhe proceset që po ndodhin në strukturën e AP llogariten rreth 30 milion lekë;

- Gjithashtu, është kërkuar shtesë dhe një fond për bursat e nxënësve rreth 42 milion lekë.

Është kërkuar fond shtesë për shpenzime kapitale me financim të brendshëm prej 266 milion lekë për Ndërtime/Rikonstruksione të godinave të shkollave dhe bazave të praktikave profesionale, si dhe pajisja e reparteve të praktikës profesionale me pajisje dhe makineri për realizimin e praktikave profesionale.

Programi *Mbështetje për Inovacion dhe Teknologji*

Në shpenzimet korrente, janë kërkuar 200 milion lekë në artikullin (602) për Qendrën shqiptare për inovacion dhe zhvillim, për të zhvilluar aktivitete gjithëpërfshirëse në rajon dhe më gjerë, dhe 100 milion lekë në artikullin (604), për Fondin për inovacionin dhe teknologji për financimin e projekteve.

Për investimet e brendshme është kërkuar shtesë në total 556 milion lekë, të detajuara si më poshtë:

- Biletimi qendror on line për muzetë dhe sitet e trashëgimisë kulturore (projekt i nisur në 2024) në vlerën 210 milion lekë;

- Ngritja e platformës dixhitale për të drejtën e autorit në vlerën 25 milion lekë;

- Krijimi i databazës së arkivit online për muzeun "M" në vlerën 28 milion lekë;

- Përmirësimi dhe integrimi i sistemeve të IKRTK dhe IKTK në vlerën 57 milion lekë;

- Digjitalizimi i arkivave të administratës (investim i qendëruar për të mundësuar digjitalizimin e arkivave fizike të cilat nevojiten për shërbimet online) në vlerën 100 milion lekë;

- Sistemi i administrimit të pronave shtetërore (real estate) në vlerën 50 milion lekë;

- Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të informacionit për koncesionet Atrako, shtim moduli të koncesioneve për ministrinë e ekonomisë, kulturës dhe inovacionit si dhe shtim i modulit të pronës publike në vlerën 36 milion lekë;

- Ngritja e regjistrit elektronik për metrologjinë në vlerën 50 milion lekë.

Programi *Strehimi*

Është kërkuar shtesë për shpenzimet korrente detajohen si më poshtë:

- Grant në vlerën 220 milion lekë;

- Produkt i ri kësti për një vit në vlerën 72 milion lekë;

- Subvencionimi i interesave të kredisë me 0% në vlerën 60 milion lekë;

- Kredi të reja në vlerën 200 milion lekë.

Janë kërkuar fonde shtesë për shpenzime kapitale me financim të brendshëm, në vlerën prej 150 milion lekësh.

Grupi i auditimit ka konstatuar se *kërkesat buxhetore për projekte të reja të investimeve publike brenda tavaneve buxhetore nuk janë shoqëruar me formularët F2-Formulari i Konceptimit të investimit për shpenzime administrative kapitale (FKISHAK, F3-Formulari i Konceptimit të Projektit të Investimit (FKPI), veprim ky jo në përputhje me shtojcën 2,3 të VKM nr. 887 datë 27.12.2022 "Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike", i ndryshuar. Gjithashtu, kërkesat shtesë buxhetore për projekte të reja të investimeve publike nuk janë shoqëruar me formularin F-1 Formulari i Prezantimit të Projekt-Idesë (FPPI), veprim ky jo në përputhje me*

shtojcën 1 të VKM nr.887 datë 27.12.2022 “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”, i ndryshuar. Nga grupi i auditimit është konstatuar se ka disa mungesa në analizën e programeve buxhetore siç është mungesa e raporteve dhe analizave gjinore si pjesë e planit buxhetor afatmesëm si dhe kryerja e seancave dëgjimore me përfaqësues të shoqërisë civile, ku përkatësisht në programin *Tregu i Punës*, programi *Sigurimet Shoqërore* për të evidentuar përfituesit femra për secilin nga programet. Është konstatuar se në disa raste treguesit e performancës në nivel qëllimi janë vendosur dhe në nivel objektiv, ku përkatësisht në programin *Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë* dhe programin *Mbështetje për mbikëqyrjen e tregut, infrastrukturës cilësisë dhe pronës industriale*, dy elemente të cilat janë krejtësisht të ndryshëm nga njëra tjetra. Gjithashtu grupi i auditimit ka konstatuar se jo në të gjitha rastet janë shpjeguar dhe janë argumentuar kërkesat shtesë në relacionin përmbledhës siç është rasti i kërkesave shtesë në programet *Mbështetja për Zhvillimin Ekonomik* dhe *Strehimi*, veprim ky në kundërshtim me pikën 8 të kapitullit 1 të udhëzimit nr. 7 datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”.

Tabela nr.a/3 - Planifikimi i fondeve sipas programeve në PBA 2025-2027 të hartuar nga MEK krahasuar me realizimin faktik të buxhetit të vitit paraardhës (viti 2024), paraqitet në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

Në mijë lekë

12	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit	Fakti 2024	Plan 2025	Plan 2026	Plan 2027
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	2,741,886	446,979	506,979	511,979
08220	Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë	1,006,536	869,378	875,378	880,378
08230	Arti dhe kultura	2,400,734	3,014,063	3,031,063	2,336,063
04130	Mbështetje për zhvillim ekonomik	389,682	646,309	502,119	349,388
04160	Mbështetje për mbikq. e tregut, infrast. e cilës. dhe pron. industr.	383,415	389,922	400,422	390,922
10220	Sigurimi Shoqëror	46,217,950	35,137,530	37,023,530	37,604,530
10550	Tregu i Punës	2,457,660	2,876,547	2,818,547	2,828,547
04170	Inspektimi në Punë	236,378	265,984	266,984	266,984
09240	Arsimi i Mesëm (profesional)	3,265,969	3,960,469	3,845,469	3,846,469
01150	Mbështetje për Inovacion dhe Teknologji	70,972	319,388	339,388	507,119
06190	Strehimi	1,070,622	1,395,000	1,345,000	1,345,000
	Totali	60,241,804	49,321,569	50,954,879	50,867,379

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MEKI-t

Nga të dhënat e paraqitura më sipër rezulton se shumica e planifikuar prej 446,979 mijë lekë për vitin 2025 në PBA është më e ulët krahasuar me buxhetin faktik të vitit 2024 në shumën 60,241,804 mijë lekë, ose **me një ulje në masën prej 18%**, fakt i cili tregon se përgjatë planifikimit të PBA 2025-2027, nuk është kryer një analizë e mirë përcaktuar nga ana e MEKI-t për t’iu referuar vlerave faktike të paraqitura gjatë realizimit të buxhetit të vitit 2024 dhe cilat kanë qenë shkaqet të cilat kanë shfaqur këto diferenca midis planit të vitit 2025 në PBA dhe buxhetit faktik të vitit 2024.

b. Zbatimi i kriterëve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimi i planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar.

Viti 2022

Në zbatim të ligjit nr.115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, Udhëzimit të MFE-së, nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar si dhe në përgjigje të shkresës nr. 6706 prot., datë 29.12.2021 të MK-s, ku është dërguar detajimi i buxhetit për shpenzimet korrente të vitit 2022 për të gjitha institucionet si dhe ato të varësisë, miratimi i

detajimit sipas strukturave respektive është përcjellë nga Sekretari i Përgjithshëm i MFE me shkresën nr. 22922/63, prot., datë 11.01.2022 protokolluar në MK me shkresën nr.6706/1 datë 12.01.2022. Miratimi për shpenzime kapitale është kryer nga Ministri i MFE-së me shkresën nr. 22922/187, prot datë 31.01.2022 protokolluar në MK me shkresën nr.6705/1, në përgjigje dhe mbështetje të shkresës së Ministrisë së Kulturës me nr.6705 prot. datë 29.12.2021.

Tabela nr.a/4 - Buxheti i vitit 2022 krahasuar me kërkesat sipas PBA 2022-2024

Në mijë lekë

Kodi/P	Emërtimi i Institucionit Buxhetor / Programit	Kërkesa PBA2022-2024 faza III	Plani fillestar i miratuar	Plan i rishikuar 12 mujor	Diferenca (Kërkesa/Plani n i rishikuar)
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrim	172,400	172,400	159,979	12,421
08220	Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë	715,840	715,840	699,931	15,909
08230	Arti dhe kultura	3,424,020	3,424,020	3,515,832	-91,912
	Total	4,312,260	4,312,260	4,375,741	-63,582

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MK

Nga sa më sipër, për vitin 2022 kanë ndodhur ndryshme që nga kërkesat në PBA të vitit 2025-2027, e cila krahasuar me planin e rishikuar ka konsistuar në një rritje në vlerën 63,582 mijë lekë ose në masën 2%. Gjatë vitit 2022, buxheti i miratuar sipas ligjit nr. 115 datë 25.11.2021, ka pësuar ndryshime të cilat konsistojnë në shtesa fondi të veçantë dhe akte normative. Ndryshimet e buxhetit sipas shkresave përkatëse në nivel programi dhe kapitulli si më poshtë:

1. Akti Normativ nr.3 datë 12.03.2022

Janë prekur institucionet në të tre programet kryesisht në llogaritë 600, 601 dhe 602 duke u pakësuar në total në vlerën 60,568,875 lekë dhe është bërë shtesë në llogarinë 604 te *Art Kultura* në produktin *Promovimi i veprave të artit në hapësirat publike* në vlerën 200,000,000 lekë.

2. Akti Normativ nr. 12 datë 29.07.2022

Është bërë shtesë në llogarinë 604 për *Fototekën Marubi* në vlerën 1,600,000 lekë, *QKVF* në vlerën 2,000,000 lekë, *Aparatin e Artit* në vlerën 16,400,000 lekë dhe në llogarinë e 605 në vlerën 26,000,000 lekë, në total shtesa në vlerën 46,000,000 lekë.

3. Akti Normativ nr. 17 datë 01.12.2022

Janë bërë shtesa dhe pakësime për shpenzimet kapitale që rezultojnë të jenë pakësuar në vlerën 631,000,000 lekë.

1. Vendim nr. 287 datë 29.04.2022; Shtesë për Bashkinë Tiranë në produktin “Tirana kryeqyteti evropian e rinise 2022” në llogarinë 604 në vlerën 700,000,000 lekë.

2. Vendimi nr. 898 datë 29.12.2022; Për ndihmat ekonomike (mbështetje financiare për punonjësit e institucioneve për zbutjen e impaktit të krizës)

Fondi i akorduar në llogarinë 606 të çdo institucioni në varësi të MK-së. Në total vlera që është shtuar ka qenë 14,150,000 lekë.

Gjatë vitit 2022 janë kryer 14 transferime me MF për shpenzimet korrente për institucionet dhe aparatin e Ministrisë dhe 11 transferime me MF për shpenzimet kapitale, ku përfshihen transferime të cilat janë bërë për llogari të institucioneve të varësisë dhe aparatin.

Viti 2023

Në zbatim të ligjit nr. 84/2022, *Për buxhetin e vitit 2023*, udhëzimit plotësues të MFE-së nr. 2 datë 19.01.2023 *Për zbatimin e buxhetit 2023* dhe Udhëzimit të MFE-së, nr. 9, datë 20.03.2018 *Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*, i ndryshuar si dhe në përgjigje të shkresës nr. 7213 prot., datë 28.12.2022 të MK-s, ku është dërguar detajimi i buxhetit për shpenzimet korrente

të vitit 2023 për të gjitha institucionet si dhe ato të varësisë, miratimi i detajimit sipas strukturave respektive është përcjellë nga Sekretari i Përgjithshëm i MFE me shkresën nr. 7213/1, prot., datë 26.01.2023. Miratimi për shpenzime kapitale është kryer nga Ministri i MFE-së me shkresën nr. 438/1, prot datë 10.02.2022, në përgjigje dhe mbështetje të shkresës së Ministrisë së Kulturës me nr.438 prot. Datë 30.01.2023.

Tabela nr.a/5 - Buxheti i vitit 2023 krahasuar me kërkesat sipas PBA 2023-2025

Në mijë lekë

Kod i Prog.	Emërtimi i Institucionit Buxhetor / Programit	Kërkesa PBA2023-2025 faza III	Plani fillestar i miratuar	Plan i rishikuar 12 mujor	Diferenca (Kërkesa/Plani n i rishikuar)
1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrim	176,408	176,408	307,448	-131,040
8220	Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë	826,635	826,635	986,730	-160,095
8230	Arti dhe kultura	2,969,438	2,969,438	3,100,838	-131,400
	Total	3,972,481	3,972,481	4,395,016	-422,535

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MK

Nga sa më sipër për vitin 2023 kanë ndodhur ndryshime që nga kërkesat në PBA të vitit 2023-2025, e cila krahasuar me planin e rishikuar ka konsistuar në një rritje në vlerën 422,535 mijë lekë ose në masën 11%. Për vitin 2023 buxheti i miratuar sipas ligjit nr. 84/2022, gjatë vitit ka pësuar ndryshime të cilat konsistojnë në ndryshime shtesa fondi të veçantë dhe akte normative. Ndryshimet e buxhetit sipas shkresave përkatëse në nivel programi dhe kapitulli si më poshtë:

Gjatë vitit 2023 janë zbatuar aktet dhe vendimet si më poshtë:

1. VKM nr.202 datë 07.04.2023; Është bërë shtesë në aparatën e trashëgimisë në projektin “Ndërhyrje emergjente në objektin, Monument Kulture”, Kategoria I "Ura e Matit" në llogarinë 231 në vlerën 57,515,644 lekë.

2. VKM nr. 228 datë 13.04.2023; Për financimin e Festivalit Folklorik Kombëtar Gjirokastrë, 24 Qershor – 2 Korrik 2023, është prekur aparati i trashëgimisë në llogarinë 604 në vlerën 117,335,200 lekë.

3. VKM nr. 406 datë 05.07.2023; Janë prekur disa institucione në programin art kulturë dhe trashëgimi kulturore në kuadër të promovimit e të aktiviteteve artistiko-kulturore përgjatë sezonit turistik veror 2023.

Janë shtuar 60,000,000 lekë në kuadër të sezonit artistik.

4. Akti Normativ nr.5 datë 18.10.2023

Është prekur programi planifikim menaxhim administrim në llogarinë 602 duke u shtuar 118,000,000 lekë, shtuar në programin *Trashëgimia kulturore dhe muzetë* në llogarinë 604 përkatësisht në vlerën 5,000,000 lekë dhe në programin *Art kulturë* në vlerën 376,000,000 lekë. Pakësuar në llogarinë 606 në programin *Trashëgimia kulturore dhe muzetë* në vlerën 6,000,000 lekë. Gjithashtu pakësuar në zërin *Investime* në programin *Trashëgimia kulturore dhe muzetë* në vlerën 16,000,000 lekë dhe në *Art kulturë* 320,000,000 lekë.

5. Akti Normativ nr. 6, datë 14.12.2023

Është pakësuar në vlerën 9,000,000 lekë në programin *Trashëgimi* në shpenzimet korrente.

Është pakësuar në vlerën 32,760,000 në shpenzimet kapitale në programin *Trashëgimi kulturore dhe muzetë*.

Është pakësuar në vlerën 107,300,000 lekë në shpenzimet korrente në *Art dhe kulturë*.

Është pakësuar në vlerën 9,000,000 lekë në shpenzimet kapitale në *Art dhe kulturë*.

Gjatë vitit 2023 korrente janë 7 transferime me MF për shpenzimet korrente për institucionet dhe aparatën e Ministrisë dhe 5 transferime me MF për shpenzimet kapitale, ku përfshihen transferime

të cilat janë bërë me institucionet e varësisë dhe aparatin.

Viti 2024

Në zbatim të ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, Udhëzimit të MFE-së, nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar si dhe në përgjigje të shkresës nr. 211 prot., datë 25.01.2024 të MEKI-t, ku është dërguar detajimi i buxhetit për shpenzimet korrente të vitit 2024 për të gjitha institucionet si dhe ato të varësisë, miratimi i detajimit sipas strukturave respektive është përcjellë nga Sekretari i Përgjithshëm i MFE me shkresën nr. 23917/135, prot., datë 02.02.2024.

Miratimi i detajimit pjesor për shpenzime kapitale është kryer nga Ministri i MFE-së me shkresën nr. 2236/7, prot datë 08.03.2024.

Tabela nr.a/6 - Buxheti i vitit 2024 krahasuar me buxhetin e miratuar e ligjin nr. 97/2023

Në mijë lekë

Titulli	Emërtimi i Institucionit Buxhetor / Programit	Ligji 97/2023	AN nr. 1, datë 21.02.2024	Plan i rishikuar	Diferenca Buxhet i miratuar/Planin i rishikuar)
1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrim		391,760	3,137,678	700%
1150	Mbështetje për inovacion	-	172,267	121,847	(30)
4130	Mbështetje për Zhvillim Ekonomik	714,536	669,003	483,243	(23%)
4160	Mbështetje për Mbikq. e Tregut, Infrast. e Cilës. dhe Pron. Industr.	390,000	307,772	410,060	33%
10220	Sigurimi Shoqëror	36,605,810	33,895,810	46,219,801	36%
10550	Tregu i Punës	2,904,613	2,470,871	2,557,271	3.5%
4170	Inspektimi ne Pune	259,105	209,475	238,205	14%
9240	Arsimi i Mesëm (profesional)	3,530,469	3,060,411	3,668,182	20%
6190	Strehimi	1,395,000	1,358,451	1,195,442	(13%)
8220	Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë	996,173	322,449	1,078,623	234%
8230	Arti dhe Kultura	3,328,523	2,187,151	2,646,348	20%
	Total	50,124,229	45,045,419	61,756,700	37%

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MEKI-t

Nga sa më sipër për vitin 2024 si rezultat i zbatimit të VKM nr. 30/2023 në të cilin u krijua MEKI, si bashkim i Ministrisë së Kulturës, me Ministrinë e Ekonomisë, institucioni iu shtuan fushat e përgjegjësisë çka ka sjell ndryshime të shumta gjatë vitit të cilat konsistojnë në ndryshime me VKM, shtesa të fondit të veçantë, shtesa në fondin e shpenzimeve të personelit dhe transferime si dhe 2 akte normative. Këto ndryshime kanë ndikuar në realizim e planit të rishikuar në vlerën 61,756,700 mijë lekë ose 37% më shumë sesa akti normativ nr. 1 datë 21.02.2024, i cili ka detajuar shpenzimet (korrente+kapitale) sipas kërkesave të MEKI-t, edhe pse ky akt ka miratuar një detajim pjesor të shpenzimeve kapitale dhe korrente, duke vazhduar me miratime të tjera gjatë vitit. Ndryshime e buxhetit sipas shkresave përkthëse në nivel programi dhe kapitulli si më poshtë:

Transferime dhe Fond i veçantë

- Fondi veçantë (3.5 milionë lekë çelur në fillim të vitit për Ministrinë e Kulturës, 6.47 milionë lekë çelur në Ministrinë e Financave për programet të cilat u transferuan në MEKI, si dhe 6.7 milionë lekë shtesa gjatë vitit).

- Pagesa kalimtare, në vlerën 1.82 milionë lekë.

Vendime të Këshillit të Ministrave

- VKM nr. 324, datë 31.05.202 "Për miratimin e kalendarit të integruar të veprimtarive, në kuadër të Vitit Mbarëkombëtar të 80- Vjetorit të Çlirimit, në vlerën 17.7 milionë lekë.

- VKM-së nr. 531, datë 01.08.2024 "Një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2024, miratuar për Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për Sezonin Turistik 2024"; në vlerën 48 milionë lekë.

- VKM nr. 421 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.325,datë 31.5.2023, të këshillit të ministrave, "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike", të ndryshuar";

- VKM nr. 422 "Për një ndryshim në vendimin nr.326, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike", të ndryshuar" ;

- VKM nr. 425 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jo mësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor para universitar";

(Referuar VKM-ve sipërcituar kontigjenca për rritjen e pagave të grup 12, arrin një kosto faktike rreth 319 milionë lekë).

- VKM 582 datë 18.09.2024 "Për indeksimin e pensioneve", në vlerën 1.65 miliardë lekë.

- VKM nr. 736, datë 27.11.2024 "Për shpërblimin e pensionistëve për festat e fund vitit 2024", në vlerën 9.84 miliardë lekë.

- VKM nr. 846, datë 27.12.2024 "Për dhënien e një ndihme të menjëhershme financiare për punonjësit mbështetës të qeverisjes qendrore", në vlerën 8.3 milionë lekë.

Akte Normative

-AN nr. 1, datë 21.02.2024;

-AN nr. 3, datë 28.08.2024;

-AN nr. 5, datë 19.12.2024.

Buxheti i 8-mujorit të vitit 2025 krahasuar me kërkesat sipas PBA 2025-2027

Në zbatim të ligjit nr. 115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", Udhëzimit të MFE-së, nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar si dhe në përgjigje të shkresës nr. 16474 prot., datë 31.12.2024 të MEKI-t, ku është dërguar detajimi i buxhetit për shpenzimet korrente të vitit 2025 për të gjitha institucionet përfshirë dhe ato të varësisë, miratimi i detajimit sipas strukturave respektive është përcjellë nga Sekretari i Përgjithshëm i MFE me shkresën nr. 17786/17, prot., datë 21.01.2025. Miratimi i detajimit pjesor për shpenzime kapitale është kryer nga Ministri i MFE-së me shkresën nr. 1110/1, prot datë 25.02.2025.

Në mijë lekë

Kodi/P	Emërtimi i Institucionit Buxhetor / Programit	Kërkesa PBA 2025-2027	Plani fillestar i miratuar	Plan i rishikuar	Diferenca (Kërkesa/Plan in i rishikuar)
1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrim	446,979	526,979	528,388	18%
1150	Mbështetje për inovacion	319,388	349,388	1,163,688	264%
4130	Mbështetje për Zhvillim Ekonomik	646,309	511,619	674,652	4.30%
4160	Mbështetje për Mbikq. e Tregut, Infrast. e Cilës. dhe Pron. Industr.	389,922	389,922	392,822	0.70%
4170	Inspektimi në punë	265,984	282,984	283,384	6.50%
6190	Strehimi	1,395,000	1,295,000	1,295,000	-8%
8220	Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë	869,378	1,119,378	1,141,236	31%

8230	Arti dhe kultura	3,014,063	2,989,063	3,011,482	-0.1
8240	Arsimi i Mesëm (profesional)	3,960,469	3,940,469	4,513,939	14%
10220	Sigurimi Shoqëror	35,137,530	40,800,090	40,800,090	16%
10550	Tregu i Punës	2,876,547	2,926,547	3,027,547	5.20%
	Total	49,321,569	55,131,439	56,832,228	15%

Nga sa më sipër për vitin 2025 kanë ndodhur ndryshme që nga kërkesat në PBA të vitit 2025-2027, e cila krahasuar me planin e rishikuar ka konsistuar në një rritje në vlerën 7,510,659 lekë ose në masën 15%. Për vitin 2025 buxheti i miratuar sipas ligjit 115/2024, gjatë vitit ka pësuar ndryshime të cilat konsistojnë në ndryshime shtesa fondi të veçantë dhe akte normative. Ndryshimet e buxhetit sipas shkresave përkatëse në nivel programi dhe kapitulli si më poshtë:

Transferime dhe Fond i veçantë

- Fondi veçantë sipas shkresës së MF protokolluar në MEI me nr.2503/1 datë 18.03.2025;
- Pagesa kalimtare sipas shkresës së MF protokolluar në MEKI me shkresën nr.16153/2 datë 10.02.2025 ;
- Fondi i veçantë sipas shkresës së MF nr. 4513/1 datë 8.03.2025 protokolluar në MEKI me shkresën nr. 2503/1 datë 19.03.2025; shkresa nr. 8030/1 datë 30.05.2025 e MF, shtesë fond në vlerën 1,270,000 në programin *Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë*.

Akte Normative

- AN nr. 3, datë 30.04.2025;
- AN nr. 6, datë 11.06.2025.

Grupi i auditimit krahasoi projektet e njëjta të planifikuara nga MEKI në PBA 2022-2024, PBA 2023-2025 dhe PBA 2024-2026.

Kodi	PBA 2022-2024			PBA 2023-2025			PBA 2024-2026		
	2022	2023	2024	2023	2024	2025	2024	2025	2026
91203AA	296,948,000	302,948,000	307,948,000	416,028,000	413,328,000	413,328,000	535,255,091	551,103,851	551,103,851
91203AB	95,630,000	98,630,000	101,130,000	98,138,000	98,128,000	98,128,000	117,480,711	120,446,293	120,446,293
91203AC	31,300,000	33,300,000	34,300,000	33,824,000	33,824,000	34,024,000	39,305,330	40,215,887	40,215,887
91203AD	36,390,000	36,390,000	37,390,000	34,814,000	34,814,000	34,814,000	42,578,787	43,732,517	43,732,517
91203AF	40,250,000	39,250,000	40,250,000	39,198,000	41,498,000	41,798,000	46,092,249	47,348,018	47,348,018
91203A G	44,950,000	44,950,000	44,950,000	47,436,000	47,024,000	47,224,000	59,622,529	61,312,149	61,312,149
18AE706	200,574,000	260,318,000	434,847,000	409,392,000	7,500,000	0	650,000,000	302,352,000	0
18AE707	447,597,000	110,000,000	57,653,000	110,000,000	0	0	0	0	0
18AE715	250,000,000	250,000,000	250,000,000	392,089,000	0	0	479,338,000	70,000,000	0
18AE716	900,000,000	1,500,000,000	1,000,000,000	338,039,000	0	7,500,000	470,312,000	486,362,000	1,096,118,000

Nga sa më sipër grupi i auditimit konstatoi se projektet për të cilat kanë pasur investimin dhe parashikimin që në vitin 2022 e të shtrira në kohë për periudhë 2 - 3 vjeçare, parashikimet e kryera në PBA e vitit 2023-2025 apo PBA 2024-2026, nuk kanë reflektuar të njëjtën vlerë për vitet respektive sipas atyre të parashikuar në PBA 2022-2025. Grupi i auditimit konstatoi diferenca të konsiderueshme të vlerave të projekteve të parashikuara për një periudhë 3 vjeçare nga një PBA në tjetrin, çka konsiderohet si mos qëndrueshmëri e parashikimit buxhetor të vitit 2024 nga PBA 2022-2024, PBA 2023-2025 në PBA 2024-2026. Ky planifikim jo të saktë zbeh parimet e disiplinës buxhetore dhe cënon prioritetizimin e shpenzimeve.

Konkluzion:

Nga ana e Grupit të Auditimit u konstatua se për periudhën objekt auditimi nga MEKI është kryer një numër i konsiderueshëm rishikimesh duke kërkuar lëvizje fondesh në projektet ekzistuese, si dhe duke shtuar projekte të reja gjatë vitit, të cilat nuk janë çelur pa kaluar në procesin ligjor të miratimit të Planit Buxhetor Afatmesëm. Këto ndryshime kanë ardhur jo vetëm si rezultat i akteve normative të miratuara gjatë vitit, por edhe si pasojë e vendimmarrjes për kryerjen e rishpërndarjes

së fondeve me impakt në buxhetin MEKI-t, e cila konsiderohet me impakt negativ në treguesit e monitorimit të buxhetit.

Një numër i konsiderueshëm i kërkesave për shtesë dhe pakësime fondesh nuk janë të shoqëruara me argumentet si:

- a) arsyet e mosplanifikimit në kohën e përgatitjes së buxhetit;
 - b) produktet, që përfitohen nga veprimtaritë, që do të financohen nga kërkesat shtesë;
 - c) kontributin në qëllimet dhe objektivat e politikave;
 - ç) zërat e tjerë të fondeve buxhetore të miratuara, që mund të reduktohen për të siguruar fondin e nevojshëm, si dhe pasojat që një reduktim i tillë do të kishte mbi arritjen e objektivave të tjerë
- Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018, i ndryshuar i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” pika 71 ku përcaktohet se:

“Çdo kërkesë për fonde shtesë ose rishpërndarje fondesh shoqërohet me analizë ku identifikohet arsyeja, rezultatet e pritshme, kontributi në arritjen e qëllimit dhe objektivave dhe risqet e lidhura, pakësimet e mundshme dhe pasojat.” dhe pika 75. “Numri i rishpërndarjeve të fondeve buxhetore për çdo njësi të qeverisjes qendrore mund të përbëjë një nga treguesit për vlerësimin e performancës gjatë zbatimit të buxhetit”.

Analizë e investimeve

Investimet, viti 2022

Referuar planit të investimeve të miratuar në projekt buxhet për vitin 2022 të Ministrisë së Kulturës, grupi i auditimit krahasoi se këto projekte për dy programe buxhetore *Arti dhe Kultura* (8230) dhe programi *Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë* (8220) me projektet e çelura në vijim të miratimit të ligjit vjetor. Më hollësisht, tabela e mëposhtme paraqet planifikimin në PBA të projekteve respektive, ndryshimet mes fondit të çelur me ligjin e buxhetit për vitin 2022, planin sipas projekt buxhetit për projektet me financim të brendshëm si dhe faktin (realizimin) e tyre:

Emri i Projektit	PBA faza III	Buxheti i miratuar	Periudha e ndryshimeve	Shtesat/pakesimet	Totali pas ndryshimeve	Fakti	Diferenca
Godina e Teatrit Tiranë	900,000,000	900,000,000	07-2022	293,000,000	607,000,000		
		607,000,000	12-2022	607,000,000	0		
Ndërtimi i Qendrës Kombëtare Kulturore për Fëmijë dhe Teatri i Kukullave	250,000,000	250,000,000	03-2022	49,228,093	200,771,907		
		200,771,907	05-2022	500,000	200,271,907		
		200,271,907	08-2022	50,000,000	250,271,907		
		250,271,907	11-2022	15,873,477	234,398,430		
		234,398,430	11-2022	205,831,359	28,567,071		
		28,567,071	12-2022	28,567,071	0		
Restaurimi, Rikonstruksioni dhe Rehabilitimi i hapësirave në Muzeun e Arteve të bukura (Galerisë Kombëtare të Arteve)	200,574,000	200,574,000	08-2022	72,238,350	128,335,650		
		128,335,650	08-2022	6,409,237	121,926,413		
		121,926,413	11-2022	30,773,909	91,152,504		
		91,152,504	11-2022	14,847,496	106,000,000		
		106,000,000	12-2022	106,000,000	0		
Parku i artit, rivitalizimi dhe rikualifikimi i territorit të ish-Kinostudios "Shqipëria e Re", Tiranë		0	06-2022	100,000,000	100,000,000		
		100,000,000	11-2022	5,000,000	95,000,000		
		95,000,000	12-2022	29,154,726	65,845,274	65,713,401	131,873
Projektim dhe Implementim i Mozaikut Tiranë	30,000,000	30,000,000	08-2022	6,000,000	36,000,000		
		36,000,000	11-2022	6,622,395	42,622,395		
		42,622,395	11-2022	36,000,000	6,622,395	6,122,395	500,000
Restaurimi për ndërtesën e Fondit të Bibliotekës Kombëtare (Faza1)	14,500,000	14,500,000	08-2022	21,838,350	36,338,350		
		36,338,350	11-2022	852,089	37,190,439	26,077,768	11,112,671
Promovimi i veprave të artit në hapësirat publike	200,000,000	200,000,000	04-2022	200,000,000	0		

Mbikëqyrje për Parku i artit, rivitalizimi dhe rikualifikimi i territorit të ish-Kinostudios "Shqipëria e Re", Tiranë		0	11-2022	1,100,000	1,100,000		
		1,100,000	11-2022	173,892	1,273,892	0	1,273,892
Shpenzime të tjera ndërtimore		0	12-2022	149,412,594	149,412,594	123,852,593	25,560,001
Restaurim, Rikonstruksion dhe Rinovim i sallës Koncerteve në Universitetin e Arteve, Tiranë	99,829,000	99,829,000	11-2022	76831359	176,660,359		
		176,660,359	12-2022	71000	176,731,359	171,252,114	5,479,245

Nga ana e grupit të auditimit është kryer analizimi dhe kryqëzimi i të dhënave për sa i përket projekteve të investimeve të realizuara gjatë vitit 2022 në raport me projektet e planifikuara në PBA 2022-2024. Gjithashtu, janë analizuar projektet për të cilat edhe pse janë planifikuar në PBA 2022-2024 si dhe janë çelur fondet në fillim të vitit, këto projekte nuk janë finalizuar ose nuk janë finalizuar me shumën e planifikuar në vlerën totale të mos realizimit prej 44,057,682 lekë duke çuar në një djegie të fondit apo mos përdorim të tij për projekte të cilat edhe pse janë planifikuar nuk janë realizuar, ku më konkretisht si më poshtë:

- Projekti me kod 18AE710 Restaurimi për ndërtesën e Fondit të Bibliotekës Kombëtare (Faza1), projekt i parashikuar në PBA dhe i çelur në vlerën 14,500,000 lekë, pas ndryshimeve të ndodhura në nëntor të vitit 2022 buxheti është rritur në vlerën 37,190,439 lekë është finalizuar duke u realizuar në vlerën 26,112,671 lekë me një diferencë në vlerën 11,112,671 lekë.

- Projekti me kod 118AE713 Restaurim, Rikonstruksion dhe Rinovim i sallës Koncerteve në Universitetin e Arteve, Tiranë, projekt i parashikuar në PBA në vlerën 99,829,000 lekë, pas ndryshimeve të ndodhura në dhjetor të vitit 2022 në vlerën 176,731,359 lekë është finalizuar duke u realizuar në vlerën 171,252,114 lekë me një diferencë në vlerën 5,479,245 lekë.

- Projekti me kod 18AE714 Projektim dhe Implementim i Mozaikut Tiranë, parashikuar në PBA në vlerën 30,000,000 lekë dhe miratuar po në të njëjtën vlerë, pas ndryshimeve të ndodhura gjatë vitit në nëntor të vitit 2022 është ulur në vlerën 6,622,395 dhe realizuar në vlerën 6,122,395 me një difference prej 500,000 lekë.

- Projekti me kod 18AE710 Restaurimi për ndërtesën e Fondit të Bibliotekës Kombëtare (Faza1) parashikuar në PBA në vlerën 14,500,000 lekë dhe miratuar po në të njëjtën vlerë, pas ndryshimeve të ndodhura gjatë vitit në nëntor të vitit 2022 është rritur fondi në vlerën 37,190,439 dhe realizuar në vlerën 26,077,768 lekë me një difference prej 11,112,671 lekë.

- Gjithashtu për tre projekte të cilat nuk janë parashikuar në PBA- 2022-2024 e për të cilat miratimet për fondet e tyre janë kryer në muajin nëntor ose dhjetor janë si më poshtë:

- Projekti me kod 19AA303 *Parku i artit, rivitalizimi dhe rikualifikimi i territorit të ish-Kinostudios Shqipëria e Re*, Tiranë, miratuar fondi në muajin qershor në vlerën 100,000,000 lekë ndryshuar në muajin nëntor dhe dhjetor më një ulje në vlerën 65,845,274, me një realizim në vlerën 6,122,395 lekë, me difference prej 500,000 lekë.

- Projekti me kod 19AA304 *Mbikëqyrje për Parku i artit, rivitalizimi dhe rikualifikimi i territorit të ish-Kinostudios Shqipëria e Re*, Tiranë dhe projekti me kod 22AE 401 i cili është përshkruar si Shpenzime të tjera ndërtimore janë dy projekte për të cilat çelja e fondit është kryer në muajin dhjetor ku njëri prej projekteve nuk ka pasur finalizim ndërsa projekti tjetër është realizuar me një difference prej 25,560,001 lekë.

- Gjithashtu grupi i auditimit konstatoi se për tre projekte të parashikuara në PBA 2022-2024, për të cilat ka pasur shumë ndryshime gjatë vitit, në muajin dhjetor për të tre projektet është zeruar fondi, projektet si më poshtë:

- Projekti 18AE716 *Godina e Teatrit Tiranë*, parashikuar në PBA në vlerën 900,000,000 lekë, projekti 18AE 715 *Ndërtimi i Qendrës Kombëtare Kulturore për Fëmijë dhe Teatri i Kukullave*

parashikuar në PB në vlerën 250,000,000 lekë dhe projekti me kod 18AE706 *Restaurimi, Rikonstruksioni dhe Rehabilitimi i hapësirave në Muzeun e Arteve të bukura (Galerisë Kombëtare të Arteve)* parashikuar në PBA në vlerën 200,574,000 lekë.

Investimet viti 2023

Referuar planit të investimeve të miratuar në projekt buxhet për vitin 2023 të Ministrisë së Kulturës, grupi i auditimit krahasoi këto projekte për dy programe buxhetore Arti dhe Kultura (8230) dhe programi Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë (8220) me projektet e çelura në vijim të miratimit të ligjit vjetor. Më hollësisht, tabela e mëposhtme paraqet planifikimin në PBA të projekteve respektive, ndryshimet mes fondit të çelur me ligjin e buxhetit për vitin 2023, planin sipas projekt buxhetit për projektet me financim të brendshëm si dhe faktin e tyre:

Në lekë

Emri i Projektit	PBA faza III	Buxheti i miratuar	Periodha e ndryshimeve	shtesat/pakesimet	totali pas ndryshimeve	fakti	diferenca
Godina e Teatrit Tiranë	338,039,000	338,039,000	06-2023	338,039,000	0		0
		0	09-2023	60,000,000	60,000,000		0
		60,000,000	12-2023	10,730,014	70,730,014	70,730,014	0
Parku i artit, rivitalizimi dhe rikualifikimi i territorit të ish-Kinostudios Shqipëria e Re, Tiranë	pa parashikuar	93,010,000	11-2023	2,050,634	90,959,366		0
		95,060,634	12-2023	19,058,260	76,002,374	74,930,146	1,072,228
Restaurimi, Rikonstruksioni dhe Rehabilitimi i hapësirave në Muzeun e Arteve të bukura (Galerisë Kombëtare të Arteve)		409,392,000	11-2023	50,000,000	359,392,000	0	0
	409,392,000	359,392,000	12-2023	705,972	358,686,028	360,097,970	1,411,942
Ndërtimi i Qendrës Kombëtare Kulturore për Fëmijë dhe Teatri i Kukullave	392,089,000	367,774,000	04-2023	17,094,458	350,679,542		0
		350,679,542	07-2023	1,352,824	349,326,718		0
		349,326,718	09-2023	60,000,000	289,326,718		0
		289,326,718	11-2023	190,000,000	99,326,718		0
		99,326,718	12-2023	68,163,330	167,460,048	162,176,314	5,283,734
Rijetezimi i Piramidës Tiranë	110,000,000	110,000,000	06-2023	338,039,000	448,039,000	448,039,000	0
Projektim dhe Implementim i Mozaikut Tiranë	141,767,000	141,767,000	11-2023	28,353,400	113,413,600		0
		113,413,600	12-2023	20,040,478	93,373,122	93,158,206	214,916
Projekti teknik i ndërhyrjes emergjente në objektin Monument Kulture kategoria e I "Ura e Matit"	pa parashikuar	0	05-2023	57,515,644	57,515,644	0	57,515,644
Rikonstruksion i magazinave të TKOB	pa parashikuar	0	11-2023	2,904,616	2,904,616	0	2,904,616

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të thesarit & MEKI-t

Nga ana e grupit të auditimit është kryer analiza dhe kryqëzimi i të dhënave përsa i përket projekteve të investimeve të realizuara gjatë vitit 2023 në raport me projektet e planifikuara në PBA 2023-2025, gjithashtu janë analizuar projektet për të cilat edhe pse janë planifikuar në PBA 2023-2025 si dhe janë çelur fondet në fillim të vitit, këto projekte nuk janë finalizuar ose nuk janë finalizuar me shumën e planifikuar në vlerën totale të mos realizimit prej 65,579,196 lekë duke çuar në një djegie të fondit apo mos përdorim të tij për projekte të cilat edhe pse janë Planifikuar nuk janë realizuar, ku më konkretisht si më poshtë:

- Projekti me kod 18AA303 *Parku i artit, rivitalizimi dhe rikualifikimi i territorit të ish-Kinostudios Shqipëria e Re*, Tiranë, është një projekt i pa parashikuar në PBA 2023-20225, për të cilën edhe pse është akorduar fondi përfundimtar pas ndryshimeve (ndryshime të ndodhura në dhjetor të vitit 2025) në vlerën 76,002,374 lekë është realizuar në vlerën 74,930,146 lekë me një difference prej 1,072,228 lekë;

- Projekti me kod 18AE706 *Restaurimi, Rikonstruksioni dhe Rehabilitimi i hapësirave ne Muzeun e Arteve te bukra (Galerisë Kombëtare të Arteve)*, projekt i parashikuar në PBA në vlerën 409,392,000 lekë, pas ndryshimeve të ndodhura në dhjetor të vitit 2023 në vlerën 358,686,028 lekë është finalizuar duke u realizuar në vlerën 360,097,970 me një tejkalim në vlerën 1,411,942 lekë.

- Projekti me kod 18AE715 *Ndërtimi i Qendrës Kombëtare Kulturore për Fëmijë dhe Teatri i Kukullave*, edhe pse është planifikuar në PBA në vlerën 392,089,000 lekë, pas 5 ndryshimeve të ndodhura gjate vitit deri në dhjetor të vitit 2023 në vlerën 167,460,048 lekë është realizuar në vlerën 162,176,314 lekë, me një difference mosrealizimi në vlerën 5,283,734 lekë;

- Projekti me kod 23AA001 *Projekti teknik i ndërhyrjes emergjente ne objektin Monument Kulture kategoria e I Ura e Matit* dhe projekti me kod 18AE712 *Rikonstruksion i magazinave të TKOB*, dy projekte të cilat nuk kanë qenë të parashikuara në PBA, për të cilat edhe pse është çelur fondi prej 60,420,260 lekë, nuk janë kryer si investime.

Investimet viti 2024

Referuar planit të investimeve të miratuar në projekt buxhet për vitin 2024 të Ministrisë së Kulturës, grupi i auditimit krahasoi këto projekte për dy programe buxhetore *Arti dhe Kultura* (8230) dhe programi *Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë* (8220) me projektet e çelura në vijim të miratimit të ligjit vjetor. Më hollësisht, tabela e mëposhtme paraqet planifikimin në PBA të projekteve respektive, ndryshimet mes fondit të çelur me ligjin e buxhetit për vitin 2024, planin sipas projekt buxhetit për projektet me financim të brendshëm si dhe faktin e tyre:

Në lekë

Emri i Projektit	PBA faza III	Buxheti i miratuar	Periudha e ndryshimeve	Shtesat/pak esimet	Totali pas ndryshimeve	Fakti	Diferenca
Godina e Teatrit Tiranë	470,312,000	745,312,000	12-2024	275,000,000	470,312,000	367,447,437	102,864,563
		470,312,000	10-2024	275,000,000	745,312,000	0	0
Restaurimi, Rikonstruksioni dhe Rehabilitimi i hapësirave ne Muzeun e Arteve të bukra (Galerisë Kombëtare të Arteve)	650,000,000	650,000,000	10-2024	400,000,000	250,000,000	0	0
		250,000,000	12-2024	100,000,000	150,000,000	149,895,001	104,999
Ndërtimi i Qendrës Kombëtare Kulturore për Fëmijë dhe Teatri i Kukullave	479,338,000	479,338,000	10-2024	347,583,958	131,754,042	114,881,711	16,872,331
Godina e Teatrit (Pajisje, Mobilim) Tiranë	275,000,000	275,000,000	10-2024	275,000,000	0		0
Restaurimi, rikonstruksioni, riformulimi i Linjës muzeore në Muzeun Historik	pa parashikuar	121,219,000	10-2024	18,245,958	139,464,958	139,464,958	0
Projektim dhe Implementim i Mozaikut Tiranë	pa parashikuar	0	03-2024	80,641,677			
		80,641,677	11-2024	200,000	80,441,677		0
		80,441,677	12-2024	9,117,476	71,324,201	69,698,758	1,625,443
Rehabilitim i Amfiteatrit të Durrësit	42,043,000	30,000,000	01/12/2024	30,000,000	0		0
		58,249,000	10-2024	28,249,000	30,000,000		0
		42,043,000	03-2024	16,206,000	58,249,000		0
Projekti teknik i ndërhyrjes emergjente në objektin Monument	57,659,000	57,756,462	12-2024	41,993	57,714,469	57,713,820	649
		57,659,000	03-2024	97,462	57,756,462		0

Kulture kategoria e I Ura e Matit		6,959,000	01/01/2024	50,700,000.0 0	57,659,000		0
Rehabilitim i ambienteve të Burgut të Spaçit, 7 godina	48,750,000	51,147,538	12-2024	4,999,538.00	4,999,538	0	4,999,538
		51,146,538	10-2024	51,146,538	0		0
		48,750,000	03-2024	2,396,538	51,146,538		0
Rivitalizimi i Sallës qendrore të Pallatit të Kulturës Shefqet Doda, rikonstruksioni i Galerisë së Arteve Tahir Tahiraj dhe mobilimi i bibliotekës Pjetër Budi, Bashkia Mat	pa parashikuar	40,000,000	12-2024	559,995	39,440,005	20,387,080	19,052,925
		0	01/10/2024	40,000,000	40,000,000		0
Parku i artit, rivitalizimi dhe rikualifikimi i territorit të ish-Kinostudios "Shqipëria e Re", Tiranë	pa parashikuar	34,258,323	12-2024	33,643,136	615,187	0	615,187
		0	01/03/2024	34,258,323	34,258,323		0
Rikonstruksioni Pallati të Kulturës "Artan Cuku" (Hidroizolimi i tarracës dhe riparimi i fasadës)	pa parashikuar	32,000,000	12-2024	7,175,648	24,824,352	0	24,824,352
		0	01/10/2024	32,000,000	32,000,000		0
Instalimi i sistemit të kondicionimit të Teatrit Migjeni	pa parashikuar	30,000,000	12-2024	30,000,000	0	0	0
		0	10-2024	30,000,000	30,000,000		0
Rikonstruksion i magazinave të TKOB	pa parashikuar	0	12-2024	1,057,104	1,057,104	1,057,104	0

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MEKi-t

Nga ana e grupit të auditimit është kryer analiza dhe kryqëzimi i të dhënave përsa i përket projekteve të investimeve të realizuara gjatë vitit 2024 në raport me projektet e planifikuara në PBA 2024-2026, gjithashtu janë analizuar projektet për të cilat edhe pse janë planifikuar në PBA 2024-2026 si dhe janë çelur fondet në fillim të vitit, këto projekte nuk janë finalizuar ose nuk janë finalizuar me shumën e planifikuar në një vlerën totale të mos realizimit prej 170,959,104 lekë duke çuar në një djegie të fondit apo mos përdorim të tij për projekte të cilat edhe pse janë Planifikuar nuk janë realizuar, ku më konkretisht si më poshtë:

- Projekti me kod 18AE718 *Godina e Teatrit Tiranë*, është parashikuar në PBA në vlerën 470,312,000 lekë, i cili edhe pse ka pasur ndryshime gjatë vitit në dhjetor është miratuar për të njëjtën vlerë, por duke u realizuar në fund të vitit në vlerë prej 367,447,437 lekë më një diferencë mos realizimi në vlerën 102,864,563 lekë;

- Projekti me kod 18AE706 *Restaurimi, Rikonstruksioni dhe Rehabilitimi i hapësirave në Muzeun e Arteve të bukura (Galerisë Kombëtare të Arteve)*, është planifikuar në PBA në vlerën 650,000,000 lekë, i cili pas dy ndryshimeve gjatë vitit (tetor & dhjetor) është miratuar në vlerën 150,000,000 lekë, me një realizim në vlerën 149,895,001 lekë më një diferencë prej 104,999 lekë. Gjithashtu grupi i auditimit konstatoi se ky projekt në PBA 2023-2025, shpenzimet për vitin 2024 është parashikuar në vlerën 7,500,000 lekë;

- Projekti me kod 18AE715 *Ndërtimi i Qendrës Kombëtare Kulturore për Fëmijë dhe Teatri i Kukullave*, është planifikuar dhe miratuar si projekt për vlerën 479,338,000 lekë dhe është finalizuar duke u likuiduar në vlerën 114,881,711 lekë me një diferencë mos realizimi në vlerën 16,872,331 lekë;

- Projekti me kod 18AE509 është planifikuar në PBA dhe çelur si buxhet në fillim të vitit në vlerën 48,750,000 lekë, por gjatë vitit ka pasur disa ndryshime ku në dhjetor është miratuar në vlerën 4,999,538 lekë. Ky projekt nuk është finalizuar në fund të vitit;

Grupi i auditimit konstatoi se për vitin 2024, 7 projekte të cilat nuk kanë qenë të planifikuara në PBA prej të cilave katër prej tyre janë finalizuar dhe tre prej tyre nuk janë finalizuar si më poshtë vijon:

- Projekti me kod 18AE703 *Restaurimi, rikonstruksioni, riformulimi i Linjës muzeore në Muzeun Historik*, i cili pas ndryshimeve gjatë vitit është miratuar me fond 139,464,958 ku dhe për të njëjtën vlerë është realizuar.

- Projekti me kod 18AE714 *Projektim dhe Implementim i Mozaikut Tiranë*, i cili pas ndryshimeve gjatë vitit është miratuar në vlerën 71,324,201 lekë dhe është realizuar në vlerën 69,698,758 lekë më një diferencë prej 1,625,443 lekë;

- Projekti me kod 18AE722 *Rivitalizimi i Sallës qendrore të Pallatit të Kulturës Shefqet Doda, rikonstruksioni i Galerisë së Arteve Tahir Tahiraj dhe Mobilimi i bibliotekës Pjetër Budi, Bashkia Mat*, i cili pas ndryshimeve gjatë vitit në dhjetor është miratuar në vlerën 39,440,005 lekë dhe është realizuar në vlerën 20,387,080 lekë më një diferencë prej 19,052,925 lekë;

- Projekti me kod 18AE712 *Rikonstruksion i magazinave të TKOB*, i cili në dhjetor është miratuar vlera prej 1,057,104 lekë dhe për të njëjtën vlerë është likuiduar në fund të vitit;

Gjithashtu, janë çelur fonde për tre projekte të pa planifikuara të cilat nuk janë realizuar në fund të vitit të cilat janë:

- Projekti me kod 19AA303 *Parku i artit, rivitalizimi dhe rikualifikimi i territorit të ish-Kinostudios Shqipëria e Re*, Tiranë, për të cilin është çelur fondi prej 34,258,352 lekë, fond i cili në dhjetor të vitit 2024 është ulur në vlerën 615,187 lekë si dhe nuk është realizuar;

- Projekti me kod 18AE719 *Rikonstruksioni Pallatit të Kulturës A.C (Hidroizolimi i tarracës dhe riparimi i fasadës)*, është çelur fond në muajin tetor në vlerën 32,000,000 lekë, fond i cili në dhjetor të vitit 2024 është ulur në vlerën 24,824,352 lekë dhe nuk është realizuar;

- Projekti me kod 18AE604 *Instalimi i sistemit të kondicionimit të Teatrit Migjeni*, për të cilin është çelur në tetor fondi prej 30,000,000 lekë, fond i cili në dhjetor është pakësuar në vlerën 0 lekë.

Sa më sipër, projektet e çelura në fillim të vitit me ligjin e Buxhetit rezultojnë të pa përfshira në listën e investimeve të miratuara në PBA dhe janë miratuar me ligj pa kaluar procedurat e përgatitjes së kërkesave buxhetore të Programit Buxhetor Afatmesëm, duke reflektuar kështu ndryshimet që ka pësuar plani i financimit të projekteve nga momenti i miratimit të PBA-së deri në ligjin e buxhetit.

Konkluzion:

Nga auditimi u konstatua se për 7 projekte investimesh të çelura në vitin 2024 me një vlerë prej 339,176,10 lekë, për vitin 2023, 2 projekte në vlerën 153,430,260 lekë si dhe për 2 projekte investimi në vitin 2022 me vlerë 101,100,000 lekë, projektet janë çelur, pa kaluar në procedurat e ciklit të miratimit në kuadër të mirë menaxhimit të investimeve publike sikundër përcakton VKM nr.887, datë 27.12.2022, “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike” aneksi 1, pasi **këto projekte nuk kanë kaluar në procesin ligjor të miratimit të Planit Buxhetor Afatmesëm**, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe Udhëzimet plotësuese “Për zbatimin e buxhetit” për vitin 2022, 2023 2024, ku përcaktohet se projektet e reja të propozuara për financim duhet të kenë kaluar procedurat e miratimit në kuadër të PBA-së, dhe duhet të jenë në përputhje me prioritetet sektoriale të propozuara nga njësitë e qeverisjes qendrore.

Gjithashtu, u konstatuan projekt investime në tejkalim të planifikimit të Programit Buxhetor Afatmesëm, konkretisht:

- Projekti i investimit me kod 18AE707 – *Rrjetëzimi I Piramidës Tiranë* është parashikuar në PBA 2023-2025 në shumën 110,000,000 lekë dhe është realizuar në shumën 448,039,000 lekë, me një diferencë prej 338,039,000 lekë në tejkalim të planifikimit. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, neni 40 ku përcaktohet “e drejta për të kryer shpenzime”, Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018, i MFE-së “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*”, i ndryshuar, pika nr. 64, VKM nr. 887, datë 27.12.2022 “*Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike*”, Aneksi 1- “*Procedurat e Menaxhimit të Investimeve Publike*” ku përcaktohet se:

“Diagrama e mëposhtme përshkruan fazat e Ciklit të Menaxhimit të Investimeve Publike. Identifikimi i projektit është procesi i identifikimit e shqyrtimit të ideve për projekte investimi të bazuara në analizën e nevojave publike, ndërhyrjeve të qeverisë dhe përshtatjes me strategjitë kombëtare dhe sektoriale. Hapi 5–Paraqitja e projekt-propozimit të investimit nga Institucionet Buxhetor Ministrisë përgjegjëse për Financat : Projekt-propozimet e investimeve përcillen në Ministrinë përgjegjëse për financat: -nëpërmjet paraqitjes normale të kërkesave për shpenzime sipas afateve të PBA-së/Buxhetit Vjetor; Hapi 9 Miratimi përfundimtar: Pas miratimit në KM të projekteve të investimeve në kuadër të PBA/buxhetit vjetor, lista e projekteve të investimeve paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë vetëm si tabelë shoqëruese e paketës së PBA/Buxhetit vjetor, por që nuk miratohet nga Kuvendi.”

Realizimi dhe Zbatimi i buxhetit për vitet 2022, 2023, 2024, 9-mujori i vitit 2025 dhe Raportet e Monitorimit

Viti 2022

Realizimi i shpenzimeve të buxhetit ne raport me planin e rishikuar për vitin 2022, paraqitet si më poshtë vijon:

Në 000/lekë

Kodi Prog.	Emërtimi	Buxheti 2022	Shpenzime Faktike të Periudhës 12 mujore	% e realizimit
1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	159,979	154,857	96%
8220	Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë	699,931	608,138	87%
8230	Arti dhe Kultura	3,515,832	3,273,190	93%
	Totali i Shpenzimeve buxhetore te Ministrisë	4,375,741	4,036,185	92%

Në total shpenzimet e Ministrisë së Kulturës paraqiten në vlerën 4,036 milion lekë, krahasuar me planin prej rreth 4,375 milion lekë (realizimi në masën 92%). Referuar programeve rezulton se për programin 01110 *Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi* janë realizuar fondet në vlerën rreth 154 milion lekë krahasuar me planin prej 159 milion lekë (96%). Për programin 8220 *Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë* janë realizuar fondet në vlerën rreth 608 milion lekë krahasuar me planin prej 699 milion lekë (87%). Për programin 8230 *Arti dhe Kultura* janë realizuar fondet në vlerën rreth 3,273 milion lekë krahasuar me planin prej 3,515 milion lekë (93%).

Viti 2023

Realizimi i shpenzimeve të buxhetit ne raport me planin e rishikuar për vitin 2023, paraqitet si më poshtë vijon:

në mijë lekë

Kodi Prog.	Emërtimi	Buxheti 2023	Shpenzime Faktike të Periudhës 12 mujor	% e realizimit
1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	307,448	280,702	91.3%

8220	Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë	986,730	801,948	81.2%
8230	Arti dhe Kultura	3,100,838	2,942,643	84.8%
	Totali i Shpenzimeve buxhetore te Ministrisë	4,395,016	4,025,293	91.5%

Në total shpenzimet e Ministrisë së Kulturës paraqiten në vlerën 4,025 milion lekë, krahasuar me planin prej rreth 4,395 milion lekë (realizimi në masën 91%). Referuar programeve rezulton se për programin 01110 *Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi* janë realizuar fondet në vlerën rreth 280 milion lekë krahasuar me planin prej 307 milion lekë (91%). Për programin 8220 *Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë* janë realizuar fondet në vlerën rreth 801 milion lekë krahasuar me planin prej 986 milion lekë (81%). Për programin 8230 *Arti dhe Kultura* janë realizuar fondet në vlerën rreth 2,942 milion lekë krahasuar me planin prej 3,100 milion lekë (95%).

Viti 2024

Realizimi i shpenzimeve të buxhetit ne raport me planin e rishikuar për vitin 2024, paraqitet si më poshtë vijon:

në mijë lekë				
Titulli	Programi	Plan i Rishikuar Viti 2024	Fakti 2024	% realizimi
1110	Planifikim, Menaxhim dhe Administrimi	3,137,678	2,741,886	87.40%
1150	Mbështetje për inovacion	121,847	70,973	58.20%
4130	Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik	483,243	389,682	80.60%
4160	Mbështetje për Mbikq. e Tregut, Infrast. e Cilës. Dhe Pron. Industr.	410,060	383,415	93.50%
10220	Sigurimi Shoqëror	46,219,801	46,217,951	100.00%
10550	Tregu i Punës	2,557,271	2,457,661	96.10%
4170	Inspektimi ne Pune	238,205	236,379	99.20%
9240	Arsimi i Mesëm (profesional)	3,668,182	3,265,970	89.00%
6190	Strehimi	1,195,442	1,070,622	89.60%
8220	Trashëgimia kulturore dhe Muzetë	1,078,623	1,006,537	93.30%
8230	Arti dhe Kultura	2,646,348	2,400,735	90.70%
	Totali i Shpenzimeve te Ministrisë	61,756,700	60,241,810	97.50%

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MEKI-t

Në total shpenzimet e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit paraqiten në vlerën 60,241 milion lekë, krahasuar me planin prej rreth 61,756 milion lekë (realizimi në masën 97.5%). Referuar programeve rezulton se për programin 01110 *Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi* janë realizuar fondet në vlerën rreth 2,741 milion lekë krahasuar me planin prej 3,137 milion lekë (87.4%). Për programin 1150 *Mbështetje për inovacion* janë realizuar fondet në vlerën rreth 70 milion lekë krahasuar me planin prej 121 milion lekë (58.2%). Për programin 4130 *Mbështetje për zhvillimin ekonomik* janë realizuar fondet në vlerën rreth 389 milion lekë krahasuar me planin prej 483 milion lekë. Për programin 4160 *Mbështetje për mbikëqyrjen e tregut, infrastrukturës cilësisë dhe pronës* janë realizuar fondet në vlerën rreth 383 milion lekë krahasuar me planin prej 410 milion lekë (93.5%). Për programin 10220 *Sigurimi Shoqëror* janë realizuar fondet në vlerën rreth 46,217 milion lekë krahasuar me planin prej 46,219 milion lekë (100%). Për programin 10550 *Tregu i Punës* janë realizuar fondet në vlerën rreth 2,457 milion lekë krahasuar me planin prej 2,557 milion lekë (98.6%). Për programin 4170 *Inspektimi në punë* janë realizuar fondet në vlerën rreth 236 milion lekë krahasuar me planin prej 238 milion lekë (99.2%). Për programin 9240 *Arsimi i Mesëm Profesional* janë realizuar fondet në vlerën rreth 3,265 milion lekë krahasuar me planin prej 3,668 milion lekë (89.6%). Për programin 6190 *Strehimi* janë realizuar fondet në vlerën rreth 1,070 milion lekë krahasuar me planin prej 1,195 milion lekë (89.6%). Për programin 8220 *Trashëgimia kulturore dhe Muzetë* janë realizuar fondet në vlerën rreth 1,006 milion lekë krahasuar me planin prej 1,078 milion lekë (93.3%). Për programin 8230 *Arti dhe Kultura* janë

realizuar fondet në vlerën rreth 2,400 milion lekë krahasuar me planin prej 2,646 milion lekë (90.7%).

Zbatimi i buxhetit për periudhën, shtator 2025

Realizimi i shpenzimeve të buxhetit ne raport me planin e rishikuar për periudhën deri në shtator të vitit 2025, paraqitet si më poshtë vijon:

në mijë lekë

Kodi i Prog.	Emërtimi	Buxheti 2025	Shpenzime Faktike të Periudhës	% e realizimit
1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	526,979	357,972	68%
1150	Mbështetje për Inovacion dhe Teknologji	349,388	1,046,338	299%
4130	Mbështetje për Zhvillim Ekonomik	511,619	293,689	57%
4160	Mbështetje për Mbikëqyrjen Tregut, Infrastruktura Cilësisë & Pronësia Industriale	389,922	256,804	66%
4170	Inspektimi në Punë	282,984	170,490	60%
6190	Strehimi	1,295,000	389,565	30%
8220	Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë	1,119,378	521,925	47%
8230	Arti dhe Kultura	2,989,063	1,351,716	45%
9240	Arsimi Mesëm Profesional	3,940,469	2,336,447	59%
10220	Sigurimet Shoqërore	40,800,090	26,814,238	66%
10550	Tregu i Punës	2,926,547	1,485,432	51%
	Totali i Shpenzimeve buxhetore te Ministrisë	55,131,439	35,024,617	64%

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MEKIT

Në total shpenzimet e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit paraqiten në vlerën 35,024 milion lekë, krahasuar me planin prej rreth 55,131 milion lekë (realizimi në masën 64%). Referuar programeve rezulton se për programin 01110 *Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi* janë realizuar fondet në vlerën rreth 357 milion lekë krahasuar me planin prej 349 milion lekë (68%). Për programin 1150 *Mbështetje për inovacion* janë realizuar fondet në vlerën rreth 1,046 milion lekë krahasuar me planin prej 349 milion lekë (299%). Për programin 4130 *Mbështetje për zhvillimin ekonomik* janë realizuar fondet në vlerën rreth 293 milion lekë krahasuar me planin prej 511 milion lekë. Për programin 4160 *Mbështetje për mbikëqyrjen e tregut, infrastrukturës cilësisë dhe pronës* janë realizuar fondet në vlerën rreth 256 milion lekë krahasuar me planin prej 389 milion lekë (66%). Për programin 10220 *Sigurimi Shoqëror* janë realizuar fondet në vlerën rreth 26,814 milion lekë krahasuar me planin prej 40,800 milion lekë (66%). Për programin 10550 *Tregu i Punës* janë realizuar fondet në vlerën rreth 1,485 milion lekë krahasuar me planin prej 2,926 milion lekë (51%). Për programin 4170 *Inspektimi në punë* janë realizuar fondet në vlerën rreth 170 milion lekë krahasuar me planin prej 282 milion lekë (60%). Për programin 9240 *Arsimi i Mesëm Profesional* janë realizuar fondet në vlerën rreth 2,336 milion lekë krahasuar me planin prej 3,940 milion lekë (89.6%). Për programin 6190 *Strehimi* janë realizuar fondet në vlerën rreth 389 milion lekë krahasuar me planin prej 1,295 milion lekë (30%). Për programin 8220 *Trashëgimia kulturore dhe Muzetë* janë realizuar fondet në vlerën rreth 521 milion lekë krahasuar me planin prej 1,119 milion lekë (47%). Për programin 8230 *Arti dhe Kultura* janë realizuar fondet në vlerën rreth 1,351 milion lekë krahasuar me planin prej 2,989 milion lekë (45%).

Raportet e monitorimit për 8 mujorin e vitit 2025

Me shkresën nr. 7234/1 prot., datë 30.05.2025 është dorëzuar në Ministrinë e Financave, Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, raporti i monitorimit për 4-mujorin e parë të vitit 2025, relacioni i monitorimit së bashku me anekset përkatëse. Me shkresën nr. 239 prot., datë 03.10.2025 është dorëzuar në Ministrinë e Financave, Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, raporti i monitorimit për 8-mujorin e parë të vitit 2025, relacioni i monitorimit së bashku me anekset përkatëse.

Për vitin 2024

Me shkresën nr. 7068/2 prot., datë 20.05.2024 është dorëzuar në Ministrinë e Financave, Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, raporti i monitorimit për 4-mujorin e vitit 2024, relacioni i monitorimit së bashku me anekset përkatëse. Me shkresën nr. 11979 prot., datë 30.09.2024 është dorëzuar në Ministrinë e Financave, Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, raporti i monitorimit për 8-mujorin e vitit 2024, relacioni i monitorimit së bashku me anekset përkatëse. Me shkresën nr. 3423 prot., datë 08.02.2025 është dorëzuar në Ministrinë e Financave, Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, raporti i monitorimit për vitin 2024, relacioni i monitorimit së bashku me anekset përkatëse.

Për vitin 2023

Me shkresën nr. 2512/2 prot., datë 29.05.2023 është dorëzuar në Ministrinë e Financave, Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, raporti i monitorimit për 4-mujorin e vitit 2023, relacioni i monitorimit së bashku me anekset përkatëse. Me shkresën nr. 4709/1 prot., datë 18.09.2023 është dorëzuar në Ministrinë e Financave, Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, raporti i monitorimit për 8-mujorin e vitit 2023, relacioni i monitorimit së bashku me anekset përkatëse.

Grupi i auditimit konstatoi se nga Ministria e Kulturës për vitin 2023 nuk është hartuar, miratuar dhe dorëzuar në Ministrinë e Financave, raporti i monitorimit mbi veprimtarinë vjetore të Ministrisë së Kulturës.

Për vitin 2022

Me shkresën nr. 2934 prot., datë 27.05.2022 është dorëzuar në Ministrinë e Financave, Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, raporti i monitorimit për 4-mujorin e vitit 2022, relacioni i monitorimit së bashku me anekset përkatëse. Me shkresën nr. 5076/1 prot., datë 28.09.2022 është dorëzuar në Ministrinë e Financave, Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, raporti i monitorimit për 8-mujorin e vitit 2022, relacioni i monitorimit së bashku me anekset përkatëse. Me shkresën nr. 499/3 prot., datë 28.02.2023 është dorëzuar në Ministrinë e Financave, Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, raporti i monitorimit për vitin 2022, relacioni i monitorimit së bashku me anekset përkatëse.

Me shkresën nr. 951/27 datë 13.03.2026 nga Ministria Turizmit, Kulturës dhe Sportit janë paraqitur observacionet mbi rekomandimet nr.1.1; 2.1; 3.1; për të cilat Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, nuk shfaq kundërshtime por përcakton masat të cilat do të marri në vijimësi në lidhje me realizimin e tyre. Zbatimi i tyre do të jetë objekt rishikimi në auditimin që do të zhvillojnë gjatë vitit 2026 KLSH, për zbatimin e rekomandimeve.

Proceset gjyqësore dhe ekzekutimi i vendimeve gjyqësore

Me qëllim uljen e riskut dhe koston shtesë të pagesave të vonuara për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, pranë çdo institucioni/njësie publike, në zbatim të Urdhrit nr. 5151, datë 28.10.2015 të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike “*Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil*”, Kreu IV, pika 1, krijohet Komisioni i Posaçëm i cili në zbatim të pikës 3, kryen këto detyra:

a-shqyrtimin e fakteve dhe rrethanave të reja të lindura pas marrjes së vendimeve gjyqësore të formës së prerë, në favor të kreditorit gjyqësor;

b- shqyrtimin e rasteve kur Urdhritet e gjykatës përcaktojnë zbatimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, nëpërmjet zgjidhjeve alternative për njësitë debitorë;

c- shqyrtimin e mundësisë së sistemimit të gjyq fituesit në një pozicion të rregullt në shërbimin civil.

MEKI për periudhën objekt auditimi ka likuiduar 19 vendime gjyqësore të Gjykatës Administrative të Apelit, të cilat janë tituj ekzekutiv. Për të gjitha vendimet gjyqësore është pritur

njoftimi nga zyrat përbarimorë private, të cilat kanë njoftuar institucionin me shkresat përkatëse që datojnë nga viti 2022-2024 , si më poshtë vijon:

N/R	Kreditorin	Zyra Përbarimore	Vendimi gjyqësor	Shuma totale në lekë pa tarife përbarimore	Shpenzime gjyqësore	Tarifa përbarimore
1	F. B	"S" sh.p.k	Vendim i Gjykatës së Apelit Tiranë, Nr. 1789, date 30.09.2011	14,583,678		1,271,000
2	R. L & Sh. L. M	"A "sh.p.k	Vendim i Gjykatës Administrative të Apelit 1731, 25.04.2017	275,336,000	3,089,080	10,023,302
3	M. Z	"E " sh.p.k	Vendim i Gjykatës Administrative të Apelit 1731, 25.04.2017	14,673,678		356,044
4	D.T(Z)	"T " sh.p.k	Vendim i Gjykatës Administrative të Apelit nr. 4139, datë 16.11.2018	1,568,000		168,000
5	A. P	"T " sh.p.k	Vendim i Gjykatës Administrative te Apelit Nr.170, date 24.05.2022	1,683,584		180,384
6	Th. D	E	Vendim i Gjykatës Administrative te Apelit Nr. 1112, date 20.12.2023	65,189,440	771,032	1,306,016
7	A.H	Z. Permbarimore F. Sh	Vendim i Gjykatës se Apelit Tiranë Nr.634, date 14.12.2022	1,057,238	51,600	73,183
8	M.H	"H. M", Permb. Gjyqesor	Vendim i Gjykatës se Apelit Tiranë Nr. 114, date 22.09.2022	1,270,200	3,400	84,058
9	O.L (M)	A. S	Ndryshimin e VKM nr.727, dt 02.11.2014 vetëm për sa i përket vlerës se shpërblimit, që i përket paditëses O. M	75,846,914	761,470	1,516,846
10	M.K	Kërkesë e paraqitur nga vetë personi	Vendimi Nr. 650, date 25.05.2002, i Gjykatës së Apelit Tiranë	10,110,000	2,520	
11	L.V	A. K	Vendim I Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Tiranë Nr.6744, date 14.10.219	698,080		46,073
12	A.H	B. M	Vendim I Gjykatës se Apelit Vlorë, nr. 144, datë 06.03.2018	1,607,400		96,444
13	A.T	Nuk është paraqitur kërkesë	Vendim I Gjykatës Administrative te Apelit nr. 4188, datë 30.11.2016	646,468		
14	M.B	Nuk është paraqitur ende kërkesë nga përbaruesi	Vendim I Gjykatës Administrative te Apelit Nr.3497, date 30.09.2016	298,315		
15	N.M	Z.Përmb E	Vendimi gjyqësor i formës së prerë nr. 1748 datë 11.07.2017, të Gjykatës së Apelit Tiranë	9,109,238		300,605
16	G. Sh	Z. Përmb Tr	Vendim gjyqësor i formës së prerë nr.19, dt.13.01.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, lënë në fuqi me vendimin nr.169 dt.22.02.2007 të Gjykatës së Lartë	8,343,862		227,348
17	D.K	"S" sh.p.k	Vendimi gjyqësor i formës së prerë nr. 100 datë 01.11.2011, të Gjykatës së Apelit Tiranë	19,893,327		488,224
18	Sh. Gj	F.T, P. Gjyqësor	Vendimi gjyqësor i formës së prerë nr. 1033, datë 06.05.2016, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.	681,000		44,946
19	Shoq. "E. V", S.R.L	Shoq. "E.B" O" sh.p.k	Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë, Nr.40, date 23.02.2017	2,315,330	104,035	129,024
Totali i Shpenzimeve				504,911,752	4,783,137	16,311,497

Konstatim:

Referuar Kodit të Procedurës Civile, neni 510, germa “a” dhe 511, germa “a” shprehet në mënyrë eksplicite se:

“Ekzekutimi i detyrueshëm mund të bëhet vetëm në bazë të një titulli ekzekutiv. Janë tituj ekzekutivë:

a) vendimet civile të formës së prerë të gjykatës, që përmban një detyrim, vendimet e dhëna prej saj për sigurimin e padisë, si dhe për ekzekutimin e përkohshëm”...

“Titulli ekzekutiv vihet në ekzekutim nëpërmjet lëshimit të urdhrit të ekzekutimit, i cili:

a) për rastet e parashikuara nga shkronjat “a” dhe “b” të nenit 510 të këtij Kodi, lëshohet nga gjykata që ka dhënë vendimin”.

Në kushte të tilla Institucionit, menjëherë pas njoftimit të formës së prerë të vendimit, i kërkon gjyq fituesit paraqitjen e titullit ekzekutiv të vendimit të formës së prerë, me qëllim ekzekutimin vullnetar të detyrimit si dhe shmangien e kostove shtesë të tarifave për shërbimin përmbarimor.

Për sa më sipër, grupi i auditimit konstatoi se edhe pse vendimet gjyqësore datojnë që prej vitit 2011-2023 (njoftuar nga përmbarues privat dhe likuiduar në periudhën 2022-2024), nga institucioni nuk është marrë asnjë masë për marrëveshje midis palëve për likuidim vullnetar, apo bashkëpunim me Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror si i vetmi institucion publik shtetëror i cili ka autoritet për veprimtarinë përmbarimore për ekzekutimin e titujve ekzekutiv. Vendimet gjyqësore nuk janë ekzekutuar vullnetarisht nga Institucioni, pas marrjes së njoftimit të vendimit të formës së prerë dhe kthimit të tij në titull ekzekutiv, por është zbatuar nëpërmjet urdhrave të ekzekutimit të lëshuara nga përmbarues privatë, veprime këto në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, nenin 130, nenin 451/a dhe nenin 510/a. Vlera e të gjithë gjyqfituesve e cila është paguar nga institucioni për periudhën 2022-2024 është **526,006,386** lekë nga ku tarifa përmbarimore është në vlerën totale prej **16,311,497** lekë.

Me shkresën nr.951/27 datë 13.03.2026 nga Ministria Turizmit, Kulturës dhe Sportit është paraqitur observacioni nga znj. S.Sh. mbi proceset gjyqësore dhe ekzekutimi i vendimeve gjyqësore; për të cilin nuk u dorëzua asnjë argumentim/dokument shtesë nga sa është trajtuar në projekt-raportin e auditimi

2.2 Vlerësim i raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

Ministria e Ekonomisë dhe Kulturës dhe Inovacionit (MEKI), është krijuar nga bashkimi i Ministrisë së Ekonomisë që ishte pjesë e Ministrisë së Financave me Ministrinë e Kulturës ku përgjegjësitë janë përcaktuar me VKM nr. 30, datë 17.01.2024 *“Për përcaktimin e fushës së Përgjegjësisë Shtetërore të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit”.*

Procesi i ndarjes së aseteve të MEKI dhe Ministrisë së Financave (ish Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë).

Me shkresën nr. 6205 prot; datë 14.05.2024 Ministri i MEKI i është drejtuar Ministrisë së Financave, duke kërkuar bashkëpunimin mes tyre për të vijuar bashkërisht me procedurat e ndarjes e inventarit ekonomik sipas kartelave, aseteve si dhe kontratës së energjisë elektrike dhe ujësjellës kanalizimeve.

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave me shkresën nr. 6767/1 prot., datë 29.05.2024 i ka kthyer përgjigje MEKI-t, protokolluar pranë kësaj të fundit me nr. 6250/1, datë 31.05.2024, ku është sqaruar si më poshtë: *“Në lidhje me ndarjen e aseteve, MF ka marrë masa për ngritjen e një grupi pune konkretisht me urdhrin nr. 4333 prot., datë 03.04.2024 “Për përgatitjen e dokumentacionit për identifikimin dhe inventarizimin e aseteve në ngarkim/ përdorim të punonjësve të ish MFE-së, të cilët i janë transferuar MEKI-t; bashkëlidhur janë dërguar:*

-Lista e aseteve në ngarkim/ përdorimin nga punonjësit e transferuar tek MEKI;

-Tabelën e investimeve të realizuara për rikonstrukcionin e shkollave të mesme profesionale”.

Gjithashtu, ka kërkuar ngritjen e një urdhri të përbashkët për transferimin kapital, me përbërje përfaqësues nga të dy institucionet (MF dhe MEKI), për të mundësuar sistemimin me zyra të punonjësve, identifikuar nevojat e secilit institucion bazuar në numrin e punonjësve dhe përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm, për ndërmarrjen e iniciativës ligjore për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të pronës së MFE-së dhe në përfundim të procedurës së dhënies në përdorim/administrim të ambienteve të punës do të vijohet edhe me procedurat për ndarjen e matësve të energjisë dhe të ujit. Në vijim të komunikimit Sekretari i Përgjithshëm i MEKI-t, me shkresën nr. 8988 prot., datë 11.07.2024 i ka dërguar MF listën e personave të cilët do të jenë pjesë e grupit të përbashkët të punës. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave me shkresën nr. 9779/1 prot., datë 30.07.2024 i ka kthyer përgjigje MEKI-t, protokolluar pranë kësaj të fundit me nr. 8988/1, datë 01.08.2024, ku bëjnë me dije se Me urdhrin nr. 97, datë 26.07.2024, me nr. 4333/2 prot; datë 26.07.2024 të Ministrit të Financave “Për një ndryshim në Urdhrin nr. 4333 prot., datë 03.04.2024 “*Për ngritjen e komisionit për ndarjen e aseteve të ish MFE-së*” është bërë ndryshimi i anëtarëve të komisionit. Për sa më sipër grupi i ngritur me shkresën nr. 8988 prot., datë 11.07.2024 dhe komisioni i ngritur nga MF, do të koordinojnë punën për përgatitjen e procedurës së kalimit kapital të aseteve nga MF te MEKI, bazuar në VKM nr. 153, datë 03.04.1993, “*Për kalimin e objekteve, të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore*”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar. Në datë 08.08.2024 në prani të grupeve përkatëse të punës, nga MF dhe MEKI, është firmosur procesverbali ku grupi i përbashkët i punës pas diskutimeve ka rënë dakord të propozojë si më poshtë:

- Zyrat të ndahen në zbatim të VKM nr. 965, datë 25.10.2023, të ndryshuar;

- Më qëllim vazhdimësinë e punës në të dyja ministrinë, asetet që kanë qenë në inventar të punonjësve të transferuar në MEKI, të cilët kanë qenë punonjës të MFE-së të kalojnë në inventarin e MEKI-t;

- Lidhur me nevojën për automjet, nga grupi i punës së MEKI-t u kërkuar kalimi kapital dhe u propozua që të merret paraprakisht vendimi nga titullarët që të vijojnë me procedurën e mëtejshme

- Lidhur me dosjet e Drejtorisë së Përgjithshme të Pronës Publike, që janë në arkivën e ish MFE-së, të ngrihet një grup i posaçëm pune i cili do të merret me identifikimin dhe procedurën e transferimit të dosjeve.

Sipas procesverbalit nga ana e anëtarëve të MEKI, një anëtar, ka shënimin jo prezent dhe një nuk ka nënshkruar procesverbalin. Në datë 23.10.2024 në prani të grupeve përkatëse të punës, nga MF dhe MEKI, është firmosur procesverbali ku grupi i përbashkët i punës pas diskutimeve ka rënë dakord të propozojë si më poshtë:

- *Për shkak të mungesës së magazinierit të MEKI-t, i cili është me raport mjekësor si pasojë e një ndërhyrje kirurgjikale, si dhe të mungesës së disa prej anëtarëve të grupit të punës të cilët janë me shërbim jashtë vendi, procesi i marrjes në dorëzim dhe i verifikimit të aseteve në ngarkim të punonjësve të ish MFE-së që kanë kaluar pranë MEKI-t, do të shtyhet për ditën e hënë datë 28.10.2024.*

Sipas procesverbalit nga ana e anëtarëve të MEKI, dy anëtar, kanë shënimin jo prezent dhe dy anëtarë nuk kanë nënshkruar procesverbalin, ndërsa nga anëtarët e MF dy anëtarë nuk ka nënshkruar procesverbalin. Sekretari i Përgjithshëm i MEKI-t znj. Ll. M, me shkresën nr. 8988/2 prot., datë 20.11.2024 i ka dërguar MF të gjithë praktikën, shoqëruar me dokumentacionin dhe kartelat individuale të punonjësve për vazhdimësinë e mëtejshme të procedurave të kalimit kapital.

Më urdhrin nr. 448, datë 14.04.2025, me nr. 4357/1 prot., datë 14.04.2025 të Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit *“Për ngritjen e komisionit për dorëzimin e magazinës dhe inventarizimin fizik të magazinës dhe pajisjeve në zyra të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit”*, është urdhëruar kryerja e inventarizimit fizik të pajisjeve dhe inventarit të imët të magazinave dhe pajisjeve të zyrave në MEKI. Sekretari i Përgjithshëm i MEKI-t, me shkresën nr. 6851 prot., datë 20.05.2025 i ka kërkuar MF ti vendoset në dispozicion Urdhri i përbashkët për kalimin kapital nga MF tek MEKI. Në këtë shkresë citohet se *“...grupet e punës me përfaqësues nga të dy Ministrinë kanë kryer verifikimin fizik të të gjitha aseteve duke hartuar proces verbalin e përbashkët mbi ndarjen e aseteve midis Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Ministrisë së Financave*. Në përgjigje të shkresës së mësipërme Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave ka përcjellë për nënshkrim, me shkresën nr. 9068/1 prot., datë 09.06.2025 me numër protokollit hyrës të MEKI nr. 6851/1 prot., datë 09.06.2025, draft urdhrin e përbashkët *“Për kalimin e kapitalit të disa aktiveve nga Ministria Financave të Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit”*. Me MEMON nr. 6851/2 datë 17.06.2025 është përcjellë tek Ministri urdhri i përbashkët për nënshkrim. Urdhri i përbashkët nr. 83 datë 09.06.2025 *“Për kalimin kapital të disa aktiveve nga Ministria e Financave tek Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit”*, me nr. 9068 prot., datë 09.06.2025 të Ministrisë së Financave dhe nr. 6851/3 prot., datë 17.06.2025 të MEKI, i nënshkruar nga ministrat respektivë ka urdhëruar:

1. Të bëhet kalimi pa pagesë i disa aktiveve nga Ministria e Financave te Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.
2. Aktivët për të cilat do të bëhet kalimi kapital janë të përcaktuara në listën bashkëngjitur, e cila është pjesë integrale e këtij urdhri.

Procesi i Inventarizimit të aseteve pranë MEKI-it.

Me Urdhrin nr. 778 datë 17.06.2025 me nr. 4357/2 prot., datë 17.06.2025 të MEKI-t *“Për ndryshim në Urdhrin nr.448, datë 14.04.2025 “Për ngritjen e komisionit për dorëzimin e magazinës dhe inventarizimin fizik të magazinës dhe pajisjeve në zyra të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit”* është urdhëruar si më poshtë:

Ndryshimi i pikës 3, të urdhrit të Ministrit nr. 448, datë 14.04.2025.

Ishte: Inventari të përfundojë brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.

Bëhet: Procesi i inventarizimit të përfundojë brenda 30 ditëve pune nga vendosja në dispozicion të kartelave të inventarit të secilit punonjës referuar Urdhrit të Përbashkët midis dy Ministrive.

Me MEMON nr. 6851/2 prot., datë 17.06.2025 Drejtoria e Aseteve dhe Shërbimeve të Përgjithshme, drejtuar Ministrit të MEKI, bën me dije se: *“Ministria e Financave me shkresën nr.9068/1 prot; datë 09.06.2025, ka përcjellë për nënshkrim draft urdhrin e përbashkët, “Për kalimin e kapitalit të disa aktiveve nga Ministria Financave të Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit” dhe ndryshimi i afatit të Urdhrit për procesin e inventarizimit në MEKI. Sa më sipër, pas verifikimit të listës bashkëlidhur urdhrit të përbashkët nga grupi i punës për ndarjen e aseteve është e nevojshëm nënshkrimi i këtij draft urdhri të përbashkët për kalimin e aseteve nga MF tek MEKI”*.

Më shkresën nr. 6851/4 prot., datë 19.06.2025 Drejtori i Përgjithshëm Ekonomik dhe i Shërbimeve Mbështetëse, drejtuar Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, ka dërguar pranë kësaj të fundit kopje të Urdhrit të Përbashkët nr. 83 datë 09.06.2025 *“Për kalimin kapital të disa aktiveve nga Ministria e Financave tek Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit”*. Më shkresën nr. 11420 prot., datë 04.09.2025 Drejtori i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, ka përcjellë pranë Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, kartelat e punonjësve të MEKI-it në të cilat janë pasqyruar ndryshimet (F. hyrjet dhe F daljet) deri më 30.06.2025. Më

shkresën nr. 770/1 prot; datë 17.10.2025, Kryetari i Komisionit të Inventarizimit ka dërguar pranë Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Relacioni mbi inventarin fizik të vitit 2025 me nr. 770 prot; datë 17.10.2025 në zbatim të urdhrin 778 datë 17.06.2025. Në këtë relacion citohet se “..komisioni ka kryer inventarizimin fizik për aktivet që ndodhen në ish Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për vitin 2025 sot Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit dhe Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit. Gjendja e inventarit ekonomik në mënyrë analitike pasqyrohet sipas kartelave personale të secilit punonjës. Inventari ekonomik është i ndarë sipas kateve, me vlerat përkatëse për një identifikim më të qartë të aktiveve”.

Me poshtë janë tabelat pjesë e relacionit mbi inventarizimin fizik

Tabela nr. 1 “Inventari Fizik dhe Kontabël MEKI”

lekë

Emërtimi	Gjendje kontabël 30.06.2025	Gjendja fizike në përdorim 17.10.2025
Mjete Transporti	42,923,348	42,923,348
Inventari Ekonomik	113,241,813	113,241,813
Inventari i imët	1,762,417	1,762,417
Totali	157,927,578	157,927,578

Burimi: MEKI, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Materialet e dëmtuara janë evidentuar sipas natyrës së dëmtimit në një kartelë të veçantë dhe kanë vlerën 317,200 lekë.

Ky raport është nënshkruar nga z. I.L, z. E. D, znj. I. M, znj. I. P, z. E. B, z. F. V, z. A. A, dhe znj. F. H ndërsa z. E. R nuk ka nënshkruar.

Tabela nr. 2 e Aneksit nr. 2, të këtij projekt-raporti auditimi paraqet përmbledhjen e inventarit fizik nga komisioni.

Nga verifikimi i kartelave personale të punonjësve mbi inventarin e aktiveve në ngarkim të tyre rezulton se në 15 raste punonjësit janë larguar nga puna dhe nuk kanë nënshkruar kartelat, në 14 raste gjendja kontabël është më e madhe se sa gjendja në përdorim e aktiveve dhe në 10 raste gjendja kontabël është më e vogël se sa gjendja në përdorim e aktiveve. Pra në 24 raste duhet të merren masa për vlerësimin dhe sistemimin e kartelave të aktiveve.

Ndërsa për sa i përket aktive për nxjerrje nga përdorimi tabela e mëposhtme paraqet në mënyrë të detajuar vlerën e këtyre aktiveve.

Tabela nr. 3: Përmbledhëse e Aktive për nxjerrje nga përdorimi

lekë

Nr.	Emërtimi i Kartelës	Gjendje kontabël	Gjendja fizike e konstatuar		
			Jashtë përdorimit	Jo në gjendje pune	Prishur
1	Materiale të dëmtuara	317,200.00	317,200		
2	T.H	274,921.00	6,398.00		
3	E. A	279,544.00	89,944.00		
4	B. H	284,086.00	95,812.00		
	Totali	1,155,751.00	509,354.00	-	

Burimi: MEKI, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për aktivet e propozuara si “jashtë funksionit”, në Raportin e Komisionit të Inventarizimit, nuk ka vijuar procesi i mëtejshëm i vlerësimit të tyre, proces i cili sipas pikës 95 të Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kryhet gjatë ose pas procesit të inventarizimit.

Pasqyrat financiare të vitit 2024, të paraqitura nga Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nuk reflektojnë ndarjen e bërë nga ish Ministria e Financave dhe Ekonomisë, pasi nga titullari i institucionit dhe nëpunësi i parë autorizues nuk është nxjerrë asnjë akt për të finalizuar procesin e ndarjes jo vetëm fizikisht, por të reflektuar edhe në regjistrat kontabël.

Për sa më sipër, nga auditimi konstatohet se procesi i inventarizimit të aktiveve për efekt të hartimit të pasqyrave financiare të vitit 2024 nuk rezulton të jetë kryer nga ana e Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Pavarësisht se nëpërmjet dy institucioneve është iniciuar procesi i ndarjes së aktiveve dhe finalizimi i tyre me procesverbalet përkatëse, këto veprime nuk rezultojnë të jenë reflektuar në regjistrat kontabël të MEKI-t. Në librat kontabël të MEKI-t nuk është iniciuar asnjë veprim për të pasqyruar aktivet që vërtet ka në përdorim dhe kontroll. Si rezultat, pasqyrat financiare të MEKI-t për vitin 2024, nuk pasqyrojnë gjendjen reale të aktiveve të institucionit.

Mbi sa më sipër, është paraqitur observacioni nga znj. Ll. M, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i MEKI dhe znj. F.G, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Financës me shkresën nr. 244/38 prot., datë 13.03.2026, protokolluar në KLSH me nr.951/27 datë 13.03.2026, në lidhje me sa trajtuar në projekt raport nr. 244/36, datë 18.02.2026, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

Pretendimi i subjektit:

Sqarojmë se nga titullarët e Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit dhe Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sporteve është nxjerrë Urdhri i përbashkët nr. 113, datë 26.11.2025, “Për ndarjen e aseteve dhe kontratave të mallrave dhe shërbimeve të ish Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit”.

Gjithashtu, nga ana e Nëpunësit Autorizues të MTKS janë ndërmarrë hapa konkretë për inventarizimin fizik të aktiveve, duke u ngritur komisioni përkatës me Urdhrin nr. 162, datë 27.02.2026.

Ky komision ka për detyrë:

- inventarizimin fizik të aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara,
- verifikimin e aktiveve qarkulluese në magazinë,
- identifikimin e aktiveve në përdorim nga punonjësit.

Qëllimi i këtij procesi është finalizimi i inventarizimit të plotë të aktiveve në pronësi të MTKS, përfshirë edhe ato që më parë kanë qenë në administrim të ish MEKI..

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin e paraqitur me sipër, sqarojmë se në analizën dhe vlerësimin e situatës nuk merren në konsideratë zhvillimet dhe faktet e reja të ndodhura pas periudhës së auditimit.

Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit

Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (këtu e më poshtë MEKI) e ka organizuar kontabilitetin në përputhje me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 të Ministrit të Financave. Organizimi i kontabilitetit është bërë sipas metodës së njohjes së të ardhurave dhe shpenzimeve. Regjistrimi i të dhënave në kontabilitet, në mënyrë kronologjike është bërë nëpërmjet programit Excel, janë përdorur klasat e llogarive sipas planit të kontabilitetit, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Elementët monetarë janë paraqitur me monedhën funksionale “lekë” dhe periudha e raportimit fillon më 1 janar dhe mbyllet më 31 dhjetor. Për vitin 2024, rezultoi se nga MEKI pasqyrat financiare janë hartuar në përputhje me kërkesat e Udhëzimit Ministrit të Financave (UMF) nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE Nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”. Pasqyrat e paraqitura nga MEKI janë si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 4 “Pasqyrat financiare 2024 të paraqitura nga MEKI”

Formati	Emërtimi i pasqyrës	Paraqitur
Nr.1	Pasqyra e pozicionit financiar;	✓
Nr.2	Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike);	✓

Nr.3	Pasqyra e flukseve monetare (Cash-Flow), sipas metodës direkte;	✓
Nr.4	Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto;	✓
Nr.5	Shënimet shpjeguese;	✓
Pasqyrat statistikore:		
Nr.6	Investimet dhe burimet e financimit;	✓
Nr.7/a	Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve (kosto historike);	✓
Nr.7/b	Format Nr. 7/b –Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve (vlera neto);	✓
Nr.8	Format Nr. 8 –Numri i punonjësve dhe fondi i pagave .	✓

Burimi: MEKI, Përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Me shkresën përcjellëse nr. 4354, datë 21.03.2025 pasqyrat financiare i janë dërguar Degës së Thesarit Tiranë, kjo në zbatim të pikës të 117 të Udhëzimit të MFE nr. 8 datë 09.03.2018. Pasqyrat financiare, të vitit ushtrimor 2024 rezultojnë të nënshkruara nga Sekretari i Përgjithshëm znj. Ll.M, si nëpunës autorizues dhe nga nëpunësi zbatues, (hartuesi i pasqyrave) znj. F.G.

Pasqyrat financiare, janë ngarkuar në Sistemi Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ) në datë 24.04.2025 në përputhje me përcaktimin në paragrafin 37 dhe 38 të Udhëzimit të MFE nr. 8 datë 09.03.2018 *“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”*.

Pasqyra e pozicionit Financiar më 31.12.2024

Pasqyra e pozicionit financiar të Ministrisë së Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit, më 31.12.2024 paraqitet si në tabelën 5 të Aneksit nr. 2 të këtij projekt raporti auditimi. Nga pasqyra e pozicionit financiar të datës 31.12.2024 u konstatua se i vetmi zë që është ndarë mes Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit është zëri “Shpenzime të periudhave të ardhshme” (llog. 486). Me ndarjen e fushës së përgjegjësi, konkretisht me VKM nr. 30/2024 dhe VKM nr. 31/2024 është bërë ndarja e buxhetit dhe e llogarisë 486 të ish-MFE. Në lidhje me këtë klasë llogarie, nga auditimi konstatohet se është bërë ndarja e tyre mes MF dhe MEKI në momentin e ndarjes së fushave të përgjegjësisë me kalimin e buxhetit përkatës u bë dhe kalimi i detyrimeve. Zërat e kësaj llogarie, që i kanë kaluar MEKI paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 6: “Lista e zërave të detyrimeve të prapambetura të transferuara nga MF”

Nr. Ref	Përshkrimi	Vleftha
4673	Det.të prapamb për pag e TVSH-se sipas fat nr. 1191/2023, dt. 20.11.2023	15,882,983
4684	Det.të prapamb për pagesën sipas Urdhrit nr. 239. date 16.10.2023 (pagese e TVSH-se për projektin Risi Albania)	5,301,670
4685	Det. te prap. për pagen sipas Urdhrit nr. 244/1. dt25.10.23 (pagese e TVSH-se për projektin Zvill i qend.Ekon. &Rajonal	5,468,351
4926	Det.të prapamb për pagesën sipas faturës nr. 1/2024, dt. 01.04.2024	250,578
4927	Det.të prapamb për pagesën sipas faturës nr.28/2023, dt. 05.12.2023	179,158
4928	Det.të prapamb për pagesën sipas faturës nr.77/2023, dt. 23.12.2023	732,209
4929	Detyrime te prapambetura për pagesën sipas faturës nr.14/2023, dt. 28.12.2023	23,107,109
4930	Det.të prapamb për pagesën sipas faturës nr.33/2023, dt. 28.12.2023	161,197
4931	Det.të prapamb për pagesën sipas faturës nr.29/2023, dt. 11.12.2023	587,380
4932	Det.të prapamb për pagesën sipas faturës nr.159/2023, dt. 13.07.2023 (Pagese TVSH)	1,425,026
4933	Det.të prapamb për pagesën sipas faturës nr.157/2023, dt. 11.07.2023 (Pagese TVSH)	1,546,100
4934	Det.të prapamb për pagesën sipas faturës nr.54/2023, dt. 09.08.2023	80,048
4935	Det.të prapamb për pagesën e TVSh për projektin Aftësia ne Pune - Faza II	26,520,520
Totali		81,242,328

Burimi: MEKI, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

I. Aktivet Afatshkurtra

Në pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31.12.2024 aktivet afatshkurta paraqiten në vlerën **3,613,888,748 lekë** dhe përbëhen nga:

Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre” në shumën 165,831,907 lekë;

Llogaritë e Klasës 2 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 27,747,418 lekë;

Llogaritë e Klasës 3 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 3,420,309,423 lekë.

Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre (klasa 5) përbëhet nga:

“Mjete monetare në Bankë” (llog. 512,56) në fund të vitit 2024 kjo llogari paraqitet në shumën 888,275 lekë e njëjtë me gjendjen në fund të vitit 2023. Në këtë llogari është paraqitur gjendja në bankën e nivelit të dytë për projektet IPA në datën 31.12.2024 si më poshtë vijon:

Tabela nr. 7: “Mjete monetare në Bankë”

lekë

Nr.	Përshkrimi	Vlera
1	Projekti: Adrifort: Adriatic Fortresses and Military Area	279,572
2	Projekti: MONET MK "Culture in motion in Adriatic NETwork of Museums"	34,124
3	Projekti: 3 C Mk Cross - border Exchange for the Development of Cultural and Creative Industries	229,435
4	Projekti: Green Waters Adventure	345,144
	Shuma	888,275

Burimi: MEKI, Përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

–“Disponibilitete në Thesar” (llog. 520), në fund të vitit 2024 kjo llogari paraqitet në shumën 164,943,632 lekë, nga e cila 61,813,148 lekë pasqyrojnë pjesën e të ardhurat që i takojnë institucionit nga të ardhurat totale të realizuara dhe 103,130,484 lekë janë fondet e ngurtësuar në thesar për garancitë e punimeve 5%. Ndërsa në fund të vitit 2023 kjo llogari ishte në shumën 109,917,758 lekë.

Shuma e këtyre dy llogarive, përkatësisht 110,806,033 për vitin 2023 dhe 165,831,907 lekë për vitin 2024, rakordojnë më shumat përkatëse në rubrikën V “Teprica në fillim të vitit ushtrimor” në dhe rubrikën VI “Teprica e Likuiditete në fund të vitit ushtrimor” (sipas formatit F3 “Pasqyra e flukseve monetare”).

Gjendje e inventarit qarkullues (klasa 3).

Kjo klasë llogarie, krahasuar me një vit më parë është pakësuar me 1,120,669 lekë, diferencë e cila është paraqitur po kaq në llogarinë 63, në rreshtin 130 të formatit nr. 2 “Pasqyra e performancës financiare”. Llogaritë analitike të kësaj klase paraqiten si më poshtë:

–“Materiale” (llog. 31) në pasqyrën e pozicionit financiar të mbyllur më 31.12.2024 paraqitet në shumën 8,922,019 lekë dhe paraqet inventarin e materialeve të konsumi. Nga grupi i auditimit u verifikua kartela e kësaj llogarie dhe u bë verifikimi i lëvizjeve të saj si dhe testimi mbi saktësinë e paraqitjen në pasqyrën e pozicionit financiar të mbyllur më 31.12.2024.

Tabela nr. 8 “Lëvizjet e llogarisë 31 për vitin 2024”

Teprica kreditore 31.12.2023	Lëvizjet debitoare	Lëvizjet kreditore	Teprica kreditore 31.12.2024	Paraqitur në PF 31.12.24	Test i paraqitjes
9,210,066	6,387,397	6,675,429.00	8,922,019	8,922,019	E saktë

Burimi: MEKI, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga tabela më sipër rezulton se llogaria 31 “Materiale” ka reflektuar drejtë shtesat dhe pakësimet e vitit 2024.

–“Inventar i imët” (llog. 32) në pasqyrën e pozicionit financiar të mbyllur më 31.12.2024 paraqitet në shumën 18,825,399 lekë, nga e cila 11,445,690 lekë janë inventar i imët, libra ndërsa 7,379,709 lekë janë goma në inventar., etj. Nga grupi i auditimit u krye verifikimi i kartelave të kësaj llogarie

dhe i lëvizjeve të saj si dhe testimi mbi saktësinë e paraqitjes në pasqyrën e pozicionit financiar të mbyllur më 31.12.2024.

Tabela nr. 9: “Lëvizjet e llogarisë 32 për vitin 2024”

Teprica kreditore 31.12.2023	Lëvizjet debitoare	Lëvizjet kreditore	Teprica kreditore 31.12.2024	Paraqitur në PF 31.12.24	Test i paraqitjes
12,043,407.00	8,879,709.00	2,097,717.00	18,825,399	18,825,399	E saktë

Burimi: MEKI, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga tabela më sipër rezulton se llogaria 32 “*Inventar i imët*” ka reflektuar drejtë shtesat dhe pakësimet e vitit 2024.

Llogari të arkëtueshme

-“*Klientë e llogari të ngjashme*” (llog. 411) më 31.12.2024 paraqitet në shumën 420,000 lekë. Nga verifikimi i kartelës së kësaj llogarie rezultoi se kjo shumë përfshin paradhëniet e 60% për tu kthyer për thirrje që nuk janë realizuar 240,000 lekë për “Projekti konkursi Kombëtar rinor Ernest Hoxholli” dhe 180,000 lekë “Projekti 100 vjet nudo”.

Për këtë llogari MEKI nuk ka mbartur asnjë shumë nga ish MFE, pra nuk disponohet asnjë evidencë apo korrespondencë, që pasqyron ndarjen apo metodologjinë e ndarjes së kësaj llogarie mes dy ministrive të ndara, MF dhe MEKI.

-“*Personeli, paradhënie, deficite, gjoba*” (llog. 423) në fund të vitit 2024 paraqitet në shumën 43,579 lekë dhe përfaqëson detyrime të personelit të Ministrisë, në lidhje me pagesa të marra si paradhënie. Për këtë llogari MEKI nuk ka mbartur asnjë shumë nga ish MFE, pra nuk disponohet asnjë evidencë apo korrespondencë, që pasqyron ndarjen apo metodologjinë e ndarjes së kësaj llogarie mes dy ministrive të ndara, MF dhe MEKI.

-“*Debitorë të ndryshëm*” (llog. 468) paraqitet më 31.12.2024 në shumën 3,309,508,091 lekë. Në këtë llogari janë përfshirë faturat e dhjetorit likuiduar me bankë në muajin janar 2025. Shuma e kësaj llogarie, është e njëjtë me shumën përkatëse në I. “*Pasivet Afat shkurtër*”, 1. “*Llogari të Pagueshme*”, “*Furnitorë e llogari të lidhura me to*” të (sipas formatit F1 “*Pasqyra e pozicionit financiar*”).

- “*Të tjera operacione me shtetin debitor*” (llog. 4342) në pasqyrën e pozicionit financiar rezulton në shumën 110,337,753 lekë dhe paraqitet detyrimin, që shteti i ka MEKI-t për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara.

Për vitin 2024 kjo llogari përbëhet nga pagat, sigurimet shoqërore e shëndetësore (të punëdhënësit dhe punëmarrësit), detyrimet për tatimin mbi të ardhurat nga punësimi (TAP), që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor të vitit, por paguhen nga buxheti i vitit të ardhshëm në total 35,485,894 lekë. Detyrimin që shteti i ka MEKI-t për TVSH projektsh në total është 32,007,559 lekë, për detyrimet për fatura investimeve të pa paguara “Kolaudimit të ndërhyrje emergjente ne objekt Ura e Matit” në vlerë 50,396 lekë dhe “Situacioni nr. 6 të ndërhyrjes/ restaurimit në Mozaikun e Tiranës” në vlerën 10,943,010 lekë. Gjithashtu në këtë zë paraqitet edhe “Projekti shpronësim për tu paguar në interes publik sipas VKM nr. 106 dt. 01.03.2023 znj. A. P” në vlerë 176,283 lekë. Në mënyrë të detajuar llogaritë analitike të kësaj llogarie dhe testimi i saktësisë së paraqitjes në pasqyrën e pozicionit financiar paraqitet si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 10 “Detajimi i llogarive të 4342 më 31.12.2024”

Nr.	Ref. Llog.	Emërtimi i Llogarisë	Përshkrimi	Shuma (në lekë)
1			TVSH IPA projekt	105,095
2			TVSH IPA projekt	80,275

3			TVSH projekti aftësi për pune nuk ka dal VKM ndaj nuk mund të bëhet pagesa, aftësi për pune faza II GIZ	26,520,520
4			TVSH risi A drejtoria integrimi faza e tret për një treg pune ne dobi të rinis shqiptare	5,301,669
5			Kolaudim ndërhyrje emergjente ne objekt Ura e Matit	50,396
6			Projekti shpronësim për tu paguar në interes publik sipas VKM nr. 106 datë 01.03.2023 znj.A.P	176,283
7			Situacioni nr. 6 I ndërhyrje restauruese në Mozaikun e Tiranës	10,943,010
8	421	“Detyrime ndaj personelit”	Paga Dhjetor 2024	23,219,094
9	431	“Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”	TAP Dhjetor 2024	3,043,229
10	435	“Sigurime shoqërore”	Sigurime shoqërore Dhjetor 2024	8,182,606
11	436	“Sigurime shëndetësore”	Sigurime Shëndetësore Dhjetor 2025	1,040,965
12	486	Detyrimeve të prapambetura	Detyrimet e mbartura të MK	31,674,611
Totali				110,337,753
Llogaria 4342 në Aktiv të BK				110,337,753
Diferenca				0
Paraqitja në PF				<i>E saktë</i>

Burimi: MEKI, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

II. Aktivët afatgjatë

Në pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31.12.2024 aktivët afatgjatë paraqiten në shumën 5,558,360,847 lekë, të cilat në mënyrë të detajuar trajtohen si në vijim:

1. Aktivë Afatgjatë jo materiale (AAJM)

- “Studime dhe kërkime” (llog. 202), në fund të vitit 2024 paraqitet në shumën 79,493,019lekë; Kjo vlerë përfaqëson vlerën e projekteve dhe studimeve lidhur me investimet e bëra nga viti 2006 e vijim.

Në lidhje me këtë llogari nga grupi i auditimit u bënë verifikimet mbi saktësinë e paraqitjes, nga ku rezultoi situata si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 11 “Verifikimi i llogaritjes së amortizimit për klasën 20, për vitin 2024”

lekë

Nr. Llog.	Teprica neto	Amortizim vitit sipas PF 24	Pakësim amortizimi Gjurmë Fishtiane 2024	Teprica neto në PF	% e amortizimit e aplikuar
20	93,662,314	14,049,347	119,948	79,493,019	15%
201					
202	93,662,314	14,049,347	119,948	79,493,019	15%

Burimi: MEKI, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga tabela më sipër rezulton se për llogaritë e klasës 20, amortizimi vjetor është llogaritur mbi vlerën kontabël neto më 31.12.2023 duke aplikuar normën e amortizimit 15%, në përputhje me pikën 36/4 të UMF nr. 8/2018 ku përcaktohet se: “Për aktivët afatgjatë jo materiale, amortizimi të llogaritet me metodën lineare me normë amortizimi 15%”. Në lidhje me këtë klasë aktivesh nuk

ka pasur shtesa përgjatë vitit ushtrimor 2024. Pakësimi ka ardhur si rezultat i amortizimit të vitit 2024 në shumën 14,049,347 mijë si dhe amortizimit të projektit “Projekti Itenerari Kulturor Gjurmët Fishtiane” në vlerën 119,948 lekë. Vlerat përkatëse në fillim dhe në fund të vitit, të amortizimit vjetor dhe të akumuluar në 31.12.2024 rakordojnë me vlerat përkatëse të paraqitura në pasqyrat statistikore 7/a dhe 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera bruto/neto)”. Vlerat e amortizimit u verifikuan dhe nëpërmjet kartelave të llogarisë, të gjeneruara nga programi Excel.

2. Aktivët Afatgjatë Materiale

- “Toka, Troje, Terrene” (llog. 210) në bilancin kontabël të datës 31.12.2024 paraqitet në shumën 261,298,634 lekë pa ndryshuar nga viti i mëparshëm 2023. Kjo vlerë përfaqëson vlerën e tokë/truall në pronësi të Ministrisë së Kulturës.

Tabela 12: “Toka, Troje, Terrene” për klasën 210

lekë

Viti	Nomenklatura. sipas Planit Kontabël	Emërtimi i Asetit	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
2015	210	Toke truall godina ish kinostudio	m ²	3,593	21,593	77,583,649
2015	210	Toke truall godina ish kinostudio	m ²	4,998.5	21,593	107,932,611
2017	210	Toke truall laborator kostumografia	m ²	2,918	21,593	63,008,374
2018	210	Truall në Sauk	m ²	4,990	2,560	12,774,400
		TOTALI				261,299,034

Burimi: MEKI, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për këtë zë Ministria nuk ka kartela të sakta të regjistrimit të tokave dhe terreneve ku të pasqyrohet numri i pronësisë dhe vlera e tyre, (mungojnë kartelat e pronësisë së regjistruar në ASHK).

- “Ndërtime e konstruksione” (llog. 212) në bilancin kontabël të datës 31.12.2024 paraqitet në shumën 681,672,325 lekë. Kjo vlerë përfaqëson vlerat neto të gjithë objekteve sipas tabelës së mëposhtme. Për vitin 2024, kjo llogari nuk ka pasur shtesa. Pakësimet kanë ardhur si rezultat i kalimit kapital tek Universiteti i Arteve Tiranë, sipas urdhrit nr. 118 datë 07.03.2024 të Ministrisë të MEKI, të investimit të realizuar për Restaurimin, rikonstruksionin dhe rinovimin e sallës së koncerteve në Akademinë e Arteve Tiranë në shumën 402,332,373 pa TVSH ose 489,482,945 lekë me TVSH (sipas procesverbalit nr.3254/2 prot., datë 23.09.2024). Për këtë zë është bërë sistemimi i vlerës 362,539,057 lekë hedhur gabimisht 2 herë, një herë në 2022 dhe një herë në 2023. Gjithashtu pakësimi i aktiveve ka ardhur edhe nga amortizimi i vitit me normën 5%, i cili është aplikuar mbi VKN e datës 01.01.2024, në përputhje me pikën 36/1 të UMF nr. 8/2018. Vlerat e datës 31.12.2023, 31.12.2024 dhe shuma e amortizimit vjetor është pasqyruar saktë dhe në pasqyrën statistikore 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)”.

Drejtorja e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar nuk i paraqet të detajuar zërat analitikë në të dhënat e kartelave përkatëse të llogarive. Kartelat nuk përmbajnë minimumin e kërkuar të informacionit për çdo zë siç kërkohet në pikën 30 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, ku përcaktohet se: “Formati i regjistrimit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër, si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia”.

Nga auditimi rezulton se në lidhje me këto asete MEKI paraqet vetëm emërtimin dhe koston historike. Lista analitike e kësaj llogarie dhe llogaritja e amortizimit vjetor paraqitet si më poshtë vijon:

Tabela nr.13: “Llogaria analitike e llogarisë 212 me ndryshime përgjatë vitit 2024”

Në lekë

Përshkrimi	Kosto historike	Amortizim i akumuluar 01.01.2024	VKN më 01.01.2024	Amortizimi i 2024	Pakësime	VKN 31.12.2024
Ish komiteti qendror	7,767,013	2,697,963	5,069,050	253,453		4,815,598
Rikonstruksion i godinës Lidhja e Shkrimtarëve	222,483,651	64,112,319	158,371,332	7,918,567		150,452,765
Korpusi kryesor Ndërtuar 1952 1 sipërfaqja e katit përdhe 2024 m ² , 2 sip katit të parë 1843 m ² , 3 sipërfaqe e katit nën çati 527 m ²	127,586,473	48,002,533	79,583,940	3,979,197		75,604,743
Ambienti i animacionit (IMK)	64,298,245	22,554,733	41,743,512	2,087,176		39,656,336
Studio e zërit	11,212,425	9,466,271	1,746,154	87,308		1,658,846
Laboratori i filmit	35,501,284	20,258,132	15,243,152	762,158		14,480,995
Skena e re (Turbina)	479,629,494	68,406,084	411,223,410	20,561,170		390,662,239
Objekti 1 zyra komande ndërtësë dy katesh sip. 354.75 m ² viti I ndërtimit 1982 Sauk	237,682	53,768	183,914	9,196		174,718
Objekti 2 Lavanteri ndërtësë një kateshe sip. 98.06 m ² viti i ndërtimit 1962	45,107	10,204	34,903	1,745		33,158
Objekti 3 Truproje ndërtësë një katëshe sip. 117m ² viti 1962	61,518	13,917	47,601	2,380		45,221
Objekti tip tunel 60 m ² viti i ndërtimit 1962	26,791	6,061	20,730	1,037		19,694
Objekti 10 depo v 1988	59,867	23,440	36,427	1,821		34,605
Objekti 11 depo v 1976	333,000	153,369	179,631	8,982		170,649
Objekti 17 depo v 1973	180,000	85,689	94,311	4,716		89,596
Objekti 17 depo v 1976	145,687	48,546	97,141	4,857		92,284
Transferim kapital nga SHISH	3,680,878	0	3,680,878	0		3,680,878
Universiteti i Arteve	852,022,002		852,022,002	0	852,022,002	0
Totali	1,805,271,117	235,893,029	1,569,378,088	35,683,760	852,022,002	681,672,325

Burimi: MEKI, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

- “Instalime Teknike makineri, pajisje” (llog. 214) paraqitet në shumën 4,662,783 lekë. Lëvizja e kësaj llogarie për vitin 2024 paraqitet si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 14: “Lëvizja e llogarisë 214 për vitin 2024

lekë

Përshkrimi	Kosto historike	Am i akumuluar 01.01.2024	VKN më 01.01.2024	Amortizimi i 2024	VKN 31.12.2024
Sistemi i kondicionimit , kompresor njësi kondicionimi tokësore, tavanore , sistemi i	12,000,000	10,086,816	1,913,184	382,637	1,530,547

ajrimet dhe aksesoret Godina Lidhja e shkrimtarëve					
Sistemi i furnizimit me ujë, rezervuar 5000 litra, elektropompa thithëse dhe shtytëse, aksesoret	500,000	420,284	79,716	15,943	63,773
Kondicionimi kati I dhe II në godinën e ish Kinostudios	16,018,854	12,908,944	3,109,910	621,982	2,487,928
sistemi i kamerave	2,764,800	2,202,374	562,426	112,485	449,941
Instalim i rrjetit të internetit imk	778,400	615,158	163,242	32,648	130,594
Totali	32,062,054	26,233,576	5,828,478	1,165,696	4,662,783

Burimi: MEKI, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga tabela më sipër rezulton se për llogarinë e klasës 214, amortizimi vjetor është llogaritur mbi vlerën kontabël neto më 31.12.2023 duke aplikuar normën e amortizimit 20%, në përputhje UMF nr. 8/2018. Në lidhje me këtë klasë aktivesh nuk ka pasur shtesa përgjatë vitit ushtrimor 2024, pakësimi ka ardhur si rezultat i amortizimit të vitit 2024 në shumën 1,165,696 mijë lekë. Vlerat përkatëse në fillim dhe në fund të viti, amortizimit vjetor dhe të akumuluar në 31.12.2024 rakordojnë me vlerat përkatëse të paraqitura në pasqyrat statistikore 7/a dhe 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera bruto/neto)”. Vlerat e amortizimit u verifikuan dhe nëpërmjet kartelave të llogarisë, të gjeneruara nga programi Excel.

-“Mjete Transporti”, (llogaria 215), në pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31.12.2024 paraqitet në shumën 34,559,502 lekë. Lëvizja e kësaj llogarie për vitin 2024 paraqitet si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 15: “Llogaria analitike 215 me ndryshime përgjatë vitit 2024”

Në lekë

Nr.	Emërtimi i Asetit	Kosto historike	Amortizimi I akumuluar	VKN më 01.01.2024	Shtesa v.2024	Pakësim v.2024	Amortizimi vjetor 2024	VKN 31.12.2024
1	Mjete transporti	25,928,055	14,744,676	11,183,379	27,938,000	2,906,502	1,655,375	34,559,502

Burimi: MEKI, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga verifikimi i saktësisë së llogarisë 215 për vitin 2024, referuar pasqyrave statistikore 7/a dhe 7/b, rezulton se kosto historike e mjeteve të transportit është paraqitur në vlerën 25,928,055 lekë dhe amortizimi i akumuluar në vlerën 14,744,676 lekë. Ndërsa nga verifikimi i kartelave të mjeteve të transportit, kosto historike transportit duhej të ishte 15,578,405 lekë dhe amortizimi i akumuluar 4,395,026 lekë. Paraqitja e Vlerës në fund dhe e amortizimit vjetor është paraqitur saktë dhe në pasqyrat statistikore 7/a dhe 7/b.

Tabela nr. 16: Verifikimi i saktësisë së llogarisë 215 për vitin 2024

lekë

Nr.	Emërtimi i Asetit	Kosto historike	Amortizimi I akumuluar	VKN më 01.01.2024	Shtesa v.2024	Pakësimet v.2024	Amortizimi vjetor 2024	VKN 31.12.2024
1	Automjeti tip Toyota Rav 4 targ A	5,102,269	3,151,706	1,950,563			390,113	1,560,451
2	Automjeti tip Toyota Rav 4 targ A	2,426,279	1,106,383	1,319,896			263,979	1,055,917
3	Automjet Toyota Rav 4 A	2,221,814		2,221,814		2,221,814		-
4	Toyota Pirus nr shasie J	5,006,418		5,006,418			1,001,284	4,005,134

5	Automjet Ssangyeng Tivoli AA	821,625	136,938	684,688		684,688		-
6	Atomjeti tip fouristrad landrover				5,544,000			5,544,000
7	c90 me nr shasie y				9,144,000			9,144,000
8	Automjet tip furgon renaul trafik				4,056,000			4,056,000
9	Automjet tip volvo e*30 me nr. shasie y				3,386,000			3,386,000
10	Automjet tip skoda octavia				2,904,000			2,904,000
11	Automjet tip skoda octavia				2,904,000			2,904,000
	TOTALI	15,578,405	4,395,026	11,183,379	27,938,000	2,906,502	1,655,375	34,559,502

Burimi: MEKI, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Norma e amortizimit e përdorur nga MEKI, për këtë llogari është 20%, në përputhje kjo me pikën 36/3 të UMF nr. 8/2018. Në lidhje me këtë klasë aktivesh *shtesat* i referohen blerjeve të 6 automjeteve gjatë 2024 e cila është bërë me procedurë prokurimi, ndërsa *pakësimi* ka ardhur si rezultat i amortizimit të vitit 2024 në shumën 1,655,375 mijë lekë dhe i kalimit të automjeteve “Toyota rav 4” a dhe “Sangyeng Tivoli A” tek Korporata e Investimit Shqiptare (KISH) në shumën 2,906,502 lekë, kalime të cilat janë bërë me Urdhër të Ministrit.

- “*Inventar ekonomik*”, (llogaria 218), në pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31.12.2024 paraqitet në shumën 74,970,607 lekë. Lëvizja e kësaj llogarie për vitin 2024 paraqitet si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 17: “Lëvizja e llogarisë 218 për vitin 2024

Në lekë

Emërtimi i Asetit	Kosto historike	Amortizimi i akumuluar	VKN më 01.01.2024	Shtesa v.2024	Pakësim v.2024	Pakësim amort. 2024	Amortizimi vjetor 2024	VKN 31.12.2024
Inventar ekonomik	84,153,367	37,591,612	46,561,755	51,201,543	9,708,000	1,800,000	14,753,190	75,102,108
TOTALI	84,153,367	37,591,612	46,561,755	51,201,543	9,708,000	1,800,000	14,753,190	75,102,108

Burimi: MEKI, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Norma e amortizimit e përdorur nga MEKI, për këtë llogari është 25%, në përputhje kjo me pikën 36/3 të UMF nr. 8/2018. Në lidhje me këtë klasë aktivesh *shtesat* i referohen blerjeve të pajisjeve kompjuterike, printera, laptop dhe pajisje të tjera zyre gjatë 2024 e cila është bërë me procedurë prokurimi dhe 4,411,240 lekë janë dhurime nga “E.I” dhe “G”, ndërsa *pakësimi* ka ardhur si rezultat i kalimit tek TOB i 60 kostumeve popullore dhe manekineve në vlerën 9,000,000 lekë, i kalimit tek OBP të 5 kompjuterëve AIO 23 DELL në vlerën 708,000 lekë, kalime të cilat janë bërë me dhurime. Ndërsa pakësimi nga amortizimi për vitit 2024 është në shumën 14,753,190 mijë lekë. Paraqitja e Vlerës në fund dhe e amortizimit vjetor është paraqitur saktë dhe në pasqyrat statistikore 7/a dhe 7/b.

4. Investimet

-“*Për Aktive afatgjata jo materiale*” (llog. 230) më 31.12.2024 paraqitet në shumën 25,147,105 Lekë ose 9,754,680 lekë me shumë se një vit më parë, paraqet shpenzime të kryera për rritjen e aktiveve, të cilat nuk kanë përfunduar ende, në mënyrë analitike, kjo llogari paraqitet si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 18 “Llogaria analitike 230”

lekë

Nr. i llogarisë	Kod projekti	Përshkrimi	Gjendje datë 31.12.2024
230		Gjendje nga 2023	15,392,425
230	18AE507	Projekt Restaurim dhe Muzealizimi i ish banesës se Toptanasve (pasuri shteti) Muzeu Besa	9,754,680
		Shuma	25,147,105

Burimi: MEKI, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga auditimi rezulton se në lidhje me aktive afatgjata jo materiale, për gjendjen e mbartur nga 2023 MEKI paraqitet **vetëm kostoja historike, pra as emërtim e as detaje**.

–“Për aktive afatgjata materiale” (llog. 231) paraqitet në postin e pasqyrës së pozicionit financiar të mbyllur më 31.12.2024 në shumën 4,396,556,872 lekë dhe paraqet shpenzime të kryera për rritjet e aktiveve afatgjata materiale. Lista analitike e kësaj llogarie paraqitet si në tabelën nr. 19 të Aneksit nr. 2, të këtij projekt-raporti auditimi. Nga verifikimi i elementëve analitikë të kësaj llogarie rezultoi se pjesë e saj janë rikonstruksione, ndërtime të realizuara mbi aktive të institucioneve nën varësi të MEKI. Ndërsa pakësimet e llogarisë 231 janë nga kapitalizimi i vlerës se blerjeve të automjeteve dhe i pajisjeve TIK. Në përfundim kjo llogari paraqitet si vijon:

Tabela nr. 20: “Lëvizjet e llogarisë 231 për vitin 2024”

lekë

Për vitin 2024 lëvizjet e llogarisë 231	Vlerat
Gjendja në fillim e 231	3,515,645,619.00
Shtesat e Vitit nga blerjet për pjesën që i takon MEKI	945,884,877.00
Kaluar në llog. 218 Blerje pajisje tik për MEKI 2024	(46,790,304.00)
Kaluar në llog. 215 Blerje automjeteve për nevojat e MEKI	(27,938,000.00)
Gjendja në fund e 231	4,386,802,192.00

Burimi: MEKI, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga auditimi rezulton se kjo llogari është paraqitur në PF e mbivlerësuar me 9,754,680 lekë, kjo pasi vlera e “Projekt Restaurim dhe Muzealizimi i ish banesës se Toptanasve (pasuri shteti) Muzeu Besa” në shumën 9,754,680 lekë, e cila i takon llogarisë 230 është llogaritur si shtesë edhe tek llogaria 231.

B. Pasivet

Më 31.12.2024, detyrimet e paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar paraqiten si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 21 “Paraqitja e llogarive të detyrimeve në Pasqyrën e pozicionit financiare, më 31.12.2024”

lekë

Nr.	Referenca e Llogarive	Emërtimi	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi Paraardhës
65	B	PASIVET(DETYRIMET)	3,523,439,907	194,855,955
66		I.Pasivet Afat shkurtër	3,491,765,296	194,855,955
67		1. Llogari të Pagueshme	3,491,345,296	194,855,955
68	401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	3,309,508,091	36,380,370
69	42	Detyrime ndaj personelit	23,219,094	6,879,920
72	431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	3,043,229	872,193
75	435	Sigurime Shoqërore	8,182,606	2,342,229
76	436	Sigurime Shëndetësore	1,040,965	307,901
81	466	Kreditorë për mjete në ruajtje	103,130,484	79,956,051
82	467	Kreditorë të ndryshëm	43,177,248	35,153,805
83	4341	Operacione me shtetin (detyrime)	43,579	32,963,486
85		2. Te tjera pasive afatshkurtra	420,000	0
86	419	Kreditorë, Parapagime	420,000	
91		II.Pasivet Afat Gjata	31,674,611	0
92	Klase 4	Llogari të pageshme	31,674,611	

Burimi: MEKI përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

1. Pasivet Afatshkurtra

- “Furnitorë e llogari të lidhura me to” (llog. 401 – 408) paraqitet në shumën 3,309,508,091 lekë dhe krahasuar me një vit më parë është rritur me 3,273,127,721 lekë. Lëvizja e kësaj llogarie për vitin 2024 paraqitet si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 22: “Lëvizja e llog. 401-408, për vitin 2024”

lekë

Teprica kreditore 31.12.2023	Lëvizjet debitore	Lëvizjet kreditore	Teprica kreditore 31.12.2024	Paraqitur në PF 31.12.24	Test i paraqitjes
36,380,370		3,273,127,721	3,309,508,091	3,309,508,091	

Burimi: MEKI, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Kjo llogari mbart detyrime të muajit dhjetor 2023 në shumën 36,380,370 lekë dhe detyrimet e lindura gjatë vitin 2024. Nga shuma 3,309,508,091 lekë gjendje në fund të periudhës, 2,941,183,063 lekë janë detyrime të vitit 2024, të paguara në periudhën 31.12.2024-27.01.2025. Referuar analizës së bërë me poshtë të llogarisë 467, kjo llogari duhej të kishte pasqyruar edhe vlerat e detyrimeve nga furnitorëve të lindura gjatë 2024 për “Kolaudim ndërhyrje emergjente në objekt Ura e Matit” me vlerë 50,396 lekë dhe “Situacioni nr. 6 i ndërhyrjes restaurimin në Mozaikun e Tiranës” me vlerë 10,943,010 lekë. Për sa më sipër kjo llogari rezulton e nënvlerësuar në shumën 10,993,406 lekë në pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31.12.2024.

-“Personeli dhe llogari të lidhur me to” (llog. 42) në vlerën 23,219,094 lekë, përfaqëson pagat e muajit e papaguara të MEKI, konkretisht për muajin dhjetor të cilat paguhen në janar të vitit 2025. Nga grupi i auditimit në lidhje me pagat e muajit dhjetor 2024, u bë verifikimi i pagave më formularin e-sig 025 të dorëzuar në sistemin e-filling, nga ku rezultoi si më poshtë:

Tabela nr. 23: “Verifikimi i pagave të pagueshme nga e-sig 025”

Përshkrimi	42	431	435	436
Në PF	23,219,094	3,043,229	8,182,606	1,040,965
Sipas llog të KLSH	23,243,152	3,043,229	8,181,606	1,040,501
Diferenca	- 24,058	0	+ 1,000	+ 464

Burimi: MEKI, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga tabela më sipër rezulton se pagat e pagueshme për muajin dhjetor janë në shumën 23,219,094 lekë, pra 24,058 lekë më pak se shuma e sipas përlllogaritjeve të bëra nga grupi i auditimit.

-“Detyrim ndaj shtetit për tatim taksa” (llog. 431) në vlerën 3,043,229 lekë përfaqëson tatimin e të ardhurave nga punësimi dhe tatimin në burim të muajit dhjetor 2024 dhe nuk ka diferenca mes shumës së paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar dhe detyrimeve të tatimore të përlllogaritura nga grupi i auditimit sipas të dhënave në sistemin e-filling. Nga verifikimi i tatimeve të llogaritura nga Aparati i Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, rezultoi se në plotësimin e deklaratave të tatimit në burim ka pasur muaj me pasaktësi në përlllogaritjen e masës së tatim në burim, konkretisht muajt në të cilët janë konstatuar pasaktësi paraqiten si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 24. “Deklarata të tatimit në burim të paplotësuara saktë nga Aparati i MEKI për vitin 2024”

Muaji	Shuma e të ardhurës	I. Tatimi i llog më 15%	II.Tatimi i deklaruar	Saktësia e paraqitjes	Dif (II-I)
Janar	51,149,295	7,672,394	7,672,394	E saktë	0
Shkurt	261,818	39,273	39,272	E saktë	-1
Mars		0			0
Prill	2,593,962	389,094	389,094	E saktë	0
Maj	1,960,000	294,000	294,000	E saktë	0
Qershor		0			0
Korrik	12,630,715	1,894,607	1,894,608	E saktë	1
Gusht	4,082,649	612,397	612,397	E saktë	0

Shtator	11,189,373	1,678,406	1,698,493	<i>E pasaktë</i>	20,087
Tetor	8,414,623	1,262,193	1,264,902	<i>E pasaktë</i>	2,709
Nëntor	5,281,330	792,200	795,493	<i>E pasaktë</i>	3,294
Dhjetor	33,955,800	5,093,370	5,099,168	<i>E pasaktë</i>	5,798
Totali	131,519,565	19,727,935	19,759,821		31,886

Burimi: Burimi: MEKI, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga auditimi, bazuar në Deklaratat e Tatimit të Mbajtur në Burim dhe të Ardhura të Tjera për periudhat Janar-Dhjetor 2024, rezulton **se 4 muaj kanë pasur deklarata të pasakta** të tatimit në burim dhe shuma e deklaruar në total për 2024 është **31,886 lekë më shumë**. Shuma e llogaritur e tatimit në burim ju përket pagesave të bëra për këshilltarët e jashtëm si dhe pagesat e bëra në kuadër të realizimit të projekteve artistike nga individë. Diferenca ka ardhur si rezultat i llogaritjes me normën tatimore 23% për pagesat e bëra për anëtarët e komisionit të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë, të Këshillit Kombëtar të Menaxhimit të Pasurive Kulturore, pjese e stafit, si dhe për pagesat e lejeve vjetore të pakryera.

-“*Sigurimet shoqërore*” (llog. 435) paraqitet në shumën 8,182,606 lekë dhe përfaqëson sigurimet shoqërore për muajin Dhjetor 2024, kjo llogari sipas përllogaritjeve të grupi të auditimit, bazuar në Listë pagesën e muajit Dhjetor 2024 sipas formularit e-sig25, paraqitet e mbivlerësuar në shumën 1,000 lekë.

-“*Sigurime Shëndetësore*” (llog. 436) në shumën 1,040,965 lekë paraqet detyrimin e MEKI për kontributet e papaguara të kontributeve të sigurimeve shëndetësore, sipas përllogaritjeve të grupi të auditimit paraqitet e mbivlerësuar në shumën 464 lekë.

-“*Kreditorë për mjete në ruajtje*” (llog. 466) në pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31.12.2024, paraqitet në shumën 103,130,484 lekë. Kjo llogari pasqyron, garanci për sigurim kontrate. Krahasuar me vitin 2023, kjo llogari është rritur me shumën 23,174,433 lekë. Nga analizimi i kartelës së kësaj llogarie rezulton si poshtë vijon:

- Garancitë e punimeve të kryera për rikonstruksionet e shkollave të mesme profesionale dhe garancive të objekteve të trashëguara nga MK -102,932,643

- Mjete në ruajtje, (466) e transferuar nga 1012017 ZAKP Butrint me periudhë 11-2024 në vlerën -197,841

Totali 103,130,484 lekë

Nga verifikimi i lëvizjes së kësaj llogarie, rezultoi se për vitin 2024, teprica e kësaj llogarie është paraqitur saktë:

Tabela nr. 25: “Lëvizja e llogarisë 466 për vitin 2024”

lekë

Teprica kreditore 31.12.2023	Lëvizjet debitore	Lëvizjet kreditore	Teprica kreditore 31.12.2024	Paraqitur në PF 31.12.24	Test i paraqitjes
79,956,051		23,174,433	103,130,484	103,130,484	E saktë

Burimi: MEKI, përpunim nga grupi i auditimit KLSH

Shuma e kësaj llogarie (shesat) konfirmohet dhe me akt rakordimin me degën e thesarit, siç parashikohet në pikën 50 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme, ku përcaktohet se: “Tepricat e llogarisë 520, “Disponibilitete në thesar” dhe të llogarisë 466, “Kreditorë për mjete në ruajtje” duhet të vërtetohen me akt rakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëngjitet llogarisë vjetore...”*

Kjo llogari paraqitet në total dhe për gjendjet e rezultuara më para, për ish MFE-në dhe nuk ka ende një ndarje apo metodologji për ndarjen e kësaj llogarie midis MF dhe MEKI.

-“Kreditorë të ndryshëm” (llog. 467) paraqitet në shumën 43,177,248 lekë, krahasuar me një vit më parë kjo llogari është shtuar me 8,023,443 lekë, në mënyrë analitike kjo llogari paraqitet në tabelën në vijim;

Tabela nr. 26: “Paraqitja analitike e llogarive 467, më 31.12.2024”

lekë

Nr.	Përshkrimi	Vlera
1	TVSH IPA projekt	105,095
2	TVSH IPA projekt	80,275
3	Kolaudim ndërhyrje emergjente ne objekt Ura e Matit	50,396
4	TVSH projekti aftësi për pune nuk ka dal VKM ndaj nuk mund te behet pagesa, aftësi për pune faza II GIZ	26,520,520
5	TVSH risi Albania drejtoria integrimi faza e tretë për një treg pune ne dobitë rinis shqiptare	5,301,669
6	Projekti shpronësim për tu paguar ne interes publik sipas VKM nr 106 dt 01.03.2023 znj.A.P	176,283
7	Situcioni nr. 6 I ndërhyrje rest ne Mozaikun e Tiranës	10,943,010
Totali		43,177,248

Burimi: MEKI, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga analiza e llogarisë vihet re se në të përfshihen zërat si “Kolaudim ndërhyrje emergjente në objekt Ura e Matit” dhe “Situcioni nr. 6 i ndërhyrjes restaurimin në Mozaikun e Tiranës” referuar faturës nr. 980/2024, datë 25.09.2024, me përshkrimin “Situcioni nr.6 “Ndërhyrje Restauruese në Mozaikun e Tiranës (Ndërtim Godine)”. Të dy këto zëra ju referohen detyrimeve të lindura gjatë 2024 dhe si të tilla duhet të përfshiheshin në llogarinë 401 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”. Për sa më sipër kjo llogari rezulton e mbivlerësuar në shumën 10,993,406 lekë në pasqyrën e pozicionit financiar të datës, 31.12.2024 .

Mbi sa më sipër, është paraqitur observacioni nga znj. Ll. M, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i MEKI dhe znj. F.G, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Financës me shkresën nr. 244/38 prot., datë 13.03.2026, protokolluar në KLSH me nr.951/27 datë 13.03.2026 , në lidhje me sa trajtuar në projekt raport nr. 244/36, datë 18.02.2026, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me këtë gjetje, sqarojmë se:

- në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” janë përfshirë detyrimet për investime,
- ndërsa në llogarinë 401 janë përfshirë detyrimet për mallra dhe shërbime.

Duke qenë se posti i bilancit 401–408 përfshin edhe llogarinë 404 “Detyrime për investime”, është konsideruar e nevojshme që këto detyrime të paraqiten të ndara në pasqyrat financiare.

Kjo mënyrë paraqitjeje është përdorur me qëllim që:

- të rritet qartësia e informacionit financiar,
- të bëhet më i lehtë identifikimi dhe monitorimi i detyrimeve sipas natyrës së tyre.

Kjo praktikë është në përputhje me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të NjQP”, sipas të cilit kreditimet për llogaritë e klasës 6 dhe 23 trajtohen në llogari të ndryshme.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me pretendimin se detyrimet për investime janë përfshirë në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, ndërsa në llogarinë 401 janë përfshirë vetëm detyrimet për mallra dhe shërbime, sqarojmë se ky klasifikim nuk është në përputhje me trajtimin kontabël të parashikuar në planin e llogarive të sektorit publik. Sipas klasifikimit kontabël, llogaritë e grupit 40 “Furnitorë dhe llogari të pagueshme” përdoren për regjistrimin e detyrimeve ndaj furnitorëve që lindin nga furnizimi me

mallra, kryerja e punimeve apo ofrimi i shërbimeve, përfshirë edhe detyrimet që lidhen me investimet. Për këtë qëllim përdoren nënlllogaritë përkatëse të këtij grupi, si dhe llogaria 404 “Detyrime për investime”, e cila bën pjesë në të njëjtin post të bilancit. Ndërkohë, llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” përdoret për regjistrimin e detyrimeve që nuk lidhen me marrëdhënie furnizimi, si penalitete, shpenzime gjyqësore apo detyrime të tjera të natyrave të ndryshme që nuk burojnë nga faturat e furnitorëve. Për sa më sipër, klasifikimi i detyrimeve për investime në llogarinë 467 nuk paraqet një trajtim të drejtë kontabël. Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

- “Operacione me shtetin (detyrime)” (llog. 4341) paraqitet në vlerën 43,579 lekë, e cila në krahasim me vitin e kaluar ka një pakësim në shumën 32,919,907 lekë. Në këtë llogari janë paraqitur paradhëniet e pakthyera të punonjësve për vitin 2024.

-Llogaria 419 “Kreditorë, Parapagime” paraqitet në vlerën 420,000 lekë, kjo shumë paraqet paradhëniet në masë 60% për tu kthyer për thirrje që nuk janë realizuar 240,000 lekë për “Projekti konkursi Kombëtar rinor E.H” dhe 180,000 lekë “Projekti 100 vjet nudo”.

2. Pasivet Afat Gjata

- “Llogari të pagueshme” Klase 4 (llog. 486) paraqitet në vlerën 31,674,611 lekë. Për vitin e kaluar 2023 nuk ka pasur gjendje. Kjo shumë i referohet detyrimeve të prapambetura të ish-MK që prej vitit 2021.

C. Aktivët neto/ fondet:

Seksioni i aktiveve neto, në pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31.12.2024 paraqitet si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 27: “Aktivët neto në Bilancin Kontabël e datës 31.12.2024”

lekë

Ref	Emërtimi	31.12.2024	31.12.2023
C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	5,648,809,688	5,588,424,695
D	FONDI I KONSOLIDUAR:	5,648,809,688	5,588,424,695
101	Teprica(Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar	1,164,404,288	1,762,748,866
12	Rezultatet e mbartura	30,374,823	127,195,442
85	Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore	32,326,600	167,442,343
111	Rezerva		
115	Nga Fondet e veta të investimeve		
15	Shuma të parashikuara për rrezeqe e Zhvlerësime		
105	Teprica e Granteve kapitale të Brendshme	4,421,703,977	3,531,038,044
106	Teprica e Granteve kapitale të Huaja		
107	Vlera e mjeteve të caktuara në përdorim		
109	Rezerva nga Rivlerësimi i Aktiveve Afatgjata		
	Të Tjera		
E	TOTALI I PASIVEVE(B+C)	9,172,249,595	5,783,280,650

Burimi: MEKI, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga auditimi i fondeve neto në “Pasqyrën e pozicionit financiar”, konstatohet se llogaria nr. 12 “Rezultati i mbartur nga funksionimi” paraqitet në vlerën 30,374,823 lekë, ndërsa llogaria 85 “Rezultati I Veprimtarisë Ushtrimore” paraqitet në vlerën 32,326,600 lekë po aq sa rezulton dhe nga pasqyra e performancës financiare (llog. 85).

Formati Nr.2 “Pasqyra e Performancës Financiare”

Pasqyra e Performancës Financiare, për vitin 2024 nga MEKI është përgatitur bazuar në klasifikimin sipas natyrës ekonomike. Për vitin 2024 kjo pasqyrë paraqitet si në tabelën nr. 28 të Aneksit 2 pjesë e këtij projekt raporti auditimi. Të ardhurat e shpenzimet e paraqitura në pasqyrën e performancës financiare i përkasin vetëm MEKI-t, pasi me ndarjen e fushës së përgjegjësisë me

VKM-të përkatëse është bërë dhe ndarja e buxhetit. Në mënyrë të detajuar realizimit të ardhurave për vitin 2024 paraqitet si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 29: “Të ardhurat e rakorduara me thesarin”

lekë

Klasifikimi buxhetor	Përshkrimi	Shuma (progresive) e arkëtuar	Pjesa e institucionit	Rritje të autorizuara	Derdhur në buxhet
7109600	Të ardhura nga qiraja e ndërtesave	5,215,200	1,564,560	-	5,215,200
7109200	Qira trualli	795,500	238,650	-	795,500
7115600	Të ardhura për tu derdhur në buxhet zhdëmtime	4,960,521	-	-	4,960,521
7110199	Te ardhura të tjera sekondare	6,000	-	-	6,000
7111099	Tarife regjistrimi për të drejtën e autorit	17,956,199	-	-	17,956,199
7111099	Të ardhura		-	-	-
7113099	Të ardhura të tjera nga kazinotë	43,077	-	-	43,077
7207010	Sponsorizime për mirëmbajtje	1,858,110	1,858,110	1,858,109	-
7207011	Grante nga organizata ndërkombëtare	-	-		-
7211100	Grante nga organizata ndërkombëtarë	58,068,059	58,068,059	58,068,059	-
7780100	Të ardhura të tjera	100	-		100
7109800	Të ardhura nga tarifa koncesionare	29,911,999	-		29,911,999
7113006	Te ardhura te tjera	500	-		500
7190101	Takse për te Ardhurat (nga insig për makinën)	50,000	50,000	50,000	-
		118,865,265	61,779,379	59,976,168	58,889,096

Burimi: MEKI, përpunim nga grupi i KLSH-së

Nga auditimi konstatohet se të ardhurat nga qiratë konkretisht “Të ardhura nga qiraja e ndërtesave” (llog. 7109600) pjesë e institucionit në shumën 1,564,560 lekë dhe “Qira trualli” (llog. 7109200) pjesë e institucionit në shumën 238,650 lekë, nuk janë pasqyruar në pasqyrën e të ardhurave të periudhës. Por shuma (progresive) e arkëtuar prej 118,865,265 lekë është e pasqyruar saktë në pasqyrën “cash flow” në zërin “Të hyra, Sponsorizime nga të tretë”, po ashtu edhe shuma e derdhur në buxhet të shtetit prej 58,889,096 lekë e cila është pasqyruar saktë në zërin “Derdhje e Transferime të të Ardhurave në Buxhet në pasqyrën “cash flow”.

-“Të ardhura sekondare dhe pagesë shërbimesh” (llog. 7114), në shumën 164,289,220 lekë paraqet pjesën e përdorur nga të ardhurat e shitjes së biletave të Butrintit për shpenzime korrente. Ndërsa në datë 27.12.2024 është bërë transferimi i pjesës tjetër të të ardhurave të papërdorura dhe të mbartura në shumën 356,346,849 lekë nga Ministria e Kulturës tek Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit, referuar nenit 18 të Marrëveshjes për Administrimin e Pasurisë Kulturore të Nën zonave së Trashëgimisë Kulturore dhe Peizazhit Kulturor të Parkut Kombëtar të Butrintit, nr. 953 prot, date 24.02.2021, ligjit 50/2022 “Për miratimin e marrëveshjes për administrimin e nën zonave të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit”, Vendimit nr.34, datë 24.04.2024 të Gjykatës Kushtetuese, ku Gjykata ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesës”: “Pas shqyrtimit të kërkesës së jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, me objekt: “Shfuqizimin e ligjit nr. 50) 2022, datë 23.5.2022 “Për miratimin Marrëveshjes për administrimin e nën zonave të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit,

ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit” si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Pezullimin e zbatimit të ligjit nr. 5012022, datë 23.5.2022 “Për miratimin e marrëveshjes për administrimin e nën zonave të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit”, deri në hyrjen në fuqi të vendimit të Gjykatës Kushtetuese”.

- “Të tjera të ardhura jo tatimore” (llog.719) kjo llogari paraqet të ardhura nga “I” për makinën. Në PASH kjo llogari paraqitet në shumën 50,000 lekë. Teprica e kësaj llogarie rezulton të jetë paraqitur saktë dhe nga verifikimi i kartelës analitike përkatëse.

- “Grant korrent i brendshëm nga buxheti për NJQP (qendrore)” (llog. 7200) paraqet të ardhurat e kaluara nga buxheti i shtetit në shumën 3,305,646,019 lekë.

- “Financim i pritshëm nga buxheti” (llog. 7206) paraqitet në shumën 21,614,628 lekë dhe praqet detyrime të vitit 2024, që paguhen në vitin 2025.

- “Sponsorizime të brendshme (nga të tretë)” (llog. 7207) paraqitet në shumën 1,858,109 lekë dhe praqet sponsorizimet për mirëmbajtjen.

- “Grant korrent i Huaj” (llog. 721) paraqitet në shumën 58,068,059 lekë të ardhura nga grantet sipas përcaktimeve të tabelës nr.25 në vijim;

Tabela nr. 30: “Të ardhurat nga Grant korrent i Huaj”

Në lekë

Nr.	Përshkrimi	Shuma
1	“U.Nation UNESCO”	2,871,505
2	“Ce Desk Albania”	4,167,699
3	UNITED NATION	2,452,963
4	ORD.EUROPEAN COMMISSION 7	1,564,546
5	ORD.EUROPEAN COMMISSION 8	46,993,856
6	SISTEMIM	17,490
	SHUMA	58,068,059

Burimi: MEKI, përpunim nga grupi i KLSH-së

- “Ndryshimi i gjendjes së inventarit të produkteve” (llog. 73) paraqitet në shumën 1,120,669 lekë dhe praqet ndryshimin pozitiv të gjendjes së inventarit të produkteve.

B. Shpenzimet

I. Pagat dhe përfitimet e punonjësve (klasa 600)

- “Paga personel i përhershëm” (llog. 6001) për periudhën 2024 paraqitet në shumën 258,995,752 lekë, e cila përfaqëson shpenzimet për pagat bruto të punonjësve. Nga grupi i auditimit, për të vlerësuar plotësinë, saktësinë dhe dokumentimin e këtyre shpenzimeve u përzgjodhën 4 muaj nga ku rezultoi se praktikat ishin të shoqëruara me: liste pagesat mujore, listë prezencat e drejtorëve të drejtorive, transfertat bankare sipas bankave. Nga verifikimi i këtyre praktikave rezultoi se dokumentacioni shoqërues dhe autorizues ishte i plotë, çdo pagesë ishte e miratuar nga personat përgjegjës., pagesat e pagave janë kryer brenda datës. Për verifikimin e saktësisë së paraqitjes së shpenzimeve të pagave, e kontributeve shoqërore dhe shëndetësore në Pasqyrën e Performancës Financiare, nga grupi i auditimit u llogaritën shpenzimet vjetore bazuar në formularët e-sig 025 të Aparatit të Ministrisë së Financave, në sistemin e-filling. Nga përmbledhja e pagave, kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, u evidentuan shpenzimet në total për vitin 2024 dhe u bë krahasimi me llogaritë përkatëse 600, 601 dhe 6011 duke bërë sistemin e këtyre llogarive me pagesat përkatëse të muajit dhjetor 2023 që paguhen në janar të vitit 2024 dhe pagesat e dhjetor 2024 që paguhen në 2025. Në mënyrë të përmbledhur nga krahasimi rezultoi si më poshtë vijon:

Tabela nr. 31: “Përmbledhëse e pagave dhe kontributeve për vitin 2024, nga formularët esig 025”

Emërtimi	600	6010
Paga dhe sigurime llogaria thesar	232,041,723	36,652,598
-Pagat e Dhjetor 23 Paguar në Janar 24	(8,988,346)	(1,413,897)
+Pagat e Dhjetor 24 Paguar në Janar 25	30,578,914	4,906,980
Llog pas sistemimit	253,632,291	40,145,681
Paga PASH	258,995,752	36,652,598
Diferenca	(5,363,461)	3,493,083

Burimi: MEKI, përpunim nga grupi i KLSH-së

Referuar formularët e-sig 025, Evidencës së shpenzimeve Janar-Dhjetor 2024 nga thesari nga grupi i auditimit u hartua përmbledhësja e pagave dhe sigurimeve. Kjo përmbledhëse u krahasua me postet e paraqitura në pasqyrën e performancës, pas rregullimeve të lartpërmendura nga ku rezultoi se:

- Pagat e personelit të përkohshëm dhe të përhershëm për vitin 2024 paraqiten të mbivlerësuar me 5,363,461 lekë. Llogaria 600 e pagave është e mbivlerësuar për faktin se në të janë përfshirë edhe pagat si dëmshpërblime të dhëna për punonjësit e larguar nga puna;

- Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore paraqiten të nënvlerësuar me 3,493,083 lekë. Vihet re se vlera e sigurimeve të pasqyruara në PASH është e njëjtë me shumën e llogarisë 601 tek shpenzimet buxhetore janar-dhjetor 2024, pra nuk është marrë në konsideratë fakti që pagat e Janar 2023 janë shpenzime të periudhës 2023 dhe ato të Dhjetor 2024 i takojnë shpenzimeve të vitit 2024.

II. “Mallra dhe Shërbime”, llogaria 602 paraqitet në masën 706,625,984 lekë dhe përbëhet nga:

- “Mallra dhe Shërbime te tjera“, llogaria 6020 në masën 3,935,873 lekë paraqet shpenzimet për material zyre të përgjithshme;

- “Materiale dhe shërbime speciale“ llogaria 6021 në masën totale prej 40,0104,497 lekë shërbime te ndryshme si përkthime;

- “Shërbime nga të tretë“, llogaria 6022 në masën totale prej 28,544,019 lekë paraqet shpenzimet për ujë të pijshëm, shpenzime postare, shërbime bankare, detyrime tatimore, printime, sigurimi I godinave shërbime të tjera për mirëmbajtje etj.;

- “Shpenzime transporti“, llogaria 6023 në masën totale prej 1,186,140 lekë, përfshihen shpenzimet e transportit nga ish kinostudio të godina e MEKI-it të pajisjeve të zyrave.

- “Shpenzime udhëtimi“, llogaria 6024, në masën totale prej 21,423,874 lekë. Këtu përfshihen shpenzimet e udhëtimeve e dietave brenda dhe jashtë vendit si dhe shpenzimet për akomodim.

- “Shpenzime për qiramarrje“, llogaria 6026, në masën prej 36,409,184 lekë. Këtu përfshihen shpenzime mujore të qeras për ambientin ku ushtrojnë aktivitetin një pjesë e punonjësve të MEKI-it.

- “Shpenzime për detyrime dhe kompensime“, llogaria 6027 në masën prej 380,634,721 lekë. Këtu përfshihen pagesat e detyrimeve për vendimet gjyqësore. Likuiduar sipas data bazës së detyrimeve për vendimet gjyqësore.

- “Shpenzime të tjera operative“, llogaria 6029 në masën 194,481,676 lekë, nga e cila **98,741,009** lekë janë pagesat e detyrimeve për vendimet gjyqësore 11,862,026 lekë janë pagesat e këshilltarëve dhe tatimit në burim për këtë zë, ndërsa pjesa tjetër përfshin të gjitha shpenzimet e tjera operative për vitin 2024.

- “Transferime korrente tek organizata jofitimprurëse“, llogaria 6044 në masën prej 2,416,045,755 lekë. Në këtë llogari 416,045,755 lekë janë pagesat e projekteve kulturore me thirrje dhe projekteve kulturore të brendshme të cilat rrjedhin nga kontratat e lidhura me individë, persona fizik, organizata jofitimprurëse sipas ligjit të nr. 10352 datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”. Ndërsa

shuma prej 2,000,000,000 lekë sipas urdhër shpenzimit nr. 1342, datë 23.01.2025 me objekt “*Transfertë për Albcontrol- dhënie hua*” i referohet transferuese së bërë për Albcontrol sh.a. sipas aktit normativ nr. 5, datë 19.12.2024, fondi është përcaktuar si mbështetje financiare në formën e huasë. Me shkresën nr. 525/1 datë 17.1.2025, MEKI i është drejtuar zyrtarisht Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrisë së Financave, ku i ka përcjell për veprime të mëtejshme pasi periudha e transformimit të “Albcontrol” në ent publik jobuxhetor ishte drejt përfundimit, Marrëveshjen e huasë, referuar nenit 3 të së cilës është përcaktuar se afati, monedha, pagesa, shlyerja, penalitetet do të përcaktohen në marrëveshje MIE, MF dhe “Albcontrol” duke qenë se ligji nr. 40/2024, ka parashikuar prishjen e shoqërisë “Albcontrol”, duke i dhënë dhe statusin juridik të entit publik jobuxhetor, nën mbikëqyrjen e ministrit përgjegjës për çështjet e transportit ajror.

IV. “*Transferime për Organizata Ndërkombëtare*”, llogaria 6051 në masën prej 49,117,102 lekë. Përfshin të gjitha pagesat e kuotizacioneve dhe Fee-të e pjesëmarrjes në organizatat Ndërkombëtare dhe në tregjet Ndërkombëtare.

V. “*Transferta të paguara nga ISSH*”, llogaria 6060 në masën prej 51,762,244 lekë. Përfshin të gjitha pagesat për kompensimet e ndryshme që ju njihen punonjësve sipas pozicionit përkatës me VKM të veçanta.

VI. “*Ndryshimi i Gjendjes së inventarit*”, llogaria 63, në masën prej 1,120,669 lekë, përfaqëson diferencën në shpenzim midis gjendjes së inventarit qarkullues në fund të vitit 2023 dh 2024.

Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës.

Për testimin e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës, nga grupi i auditimit u bë përzgjedhja e 10 urdhër shpenzimeve të paguara nëpërmjet llogarisë bankare, përzgjedhja e praktikave u bë në bazë të vlerës, kampioni të përfshinte lloje të ndryshme të pagesave dhe muaj të ndryshëm. Në lidhje me praktikën e përzgjedhura u verifikua nëse janë të shoqëruara me dokumentacionet justifikuese përkatëse dhe si është bërë kontabilizimi i tyre, nëse janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues. Nga verifikimi i praktikave të përzgjedhura rezultuan 3 pagesa në tejkalim të afatit të parashikuar në germën “a” të nenit 6, të ligjit nr. 48, datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, të ndryshuar.

Në lidhje me pagesat e kryera nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, nga grupi i auditimit u bë verifikimi i shpenzimeve të gjeneruara nga sistemi SIFQ (961 urdhër shpenzime në total për vitin 2024), për respektimin e afatit të pagesave për detyrimet, afati 30 ditor, nga ku rezultoi si më poshtë:

- **405 raste ose (31%)** rezultoi shkelje e disiplinës buxhetore, për shkak të moslikujdimin në kohë të faturave tatimore, të cilat krijojnë premisa për lindjen e penaliteteve, veprime në mospërputhje me nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor” i ndryshuar, nenin 7 të ligjit nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” të ndryshuar, si dhe UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 184.
- 906 raste ose (69%) faturat janë likuiduar brenda afatit 30 ditor.

Konkluzion:

Nga verifikimi i dokumentacioni mbështetës për përgatitjen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor 2024 të Aparatit të Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit u konstatua se:

- Aktivitetet e Aparatit të Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nuk janë inventarizuar për vitin 2024 në mënyrë të plotë. Sipas raportit të hartuar nga komisioni i ngritur me Urdhrin nr. 7, datë 01.02.2024 paraqitet informacioni: “... duke qenë se magazina është e mbushur me asete për

vlerësim për nxjerrje jashtë përdorimit dhe rrugët e kalimit të zëna nga këto materiale, nga ana e komisionit ishte e pamundur identifikimi i mëtejshëm i aktiveve të listës së aktiveve të magazinës “MK”, pra rezultoi se procesi i inventarizimit të aktiveve ku përcaktohet numri dhe ana cilësore e aktiveve është i paplotë;

- Nga verifikimi i kartelave personale të punonjësi, mbi inventarin e aktiveve në ngarkim të tyre rezultoi se në 15 raste punonjësit janë larguar nga puna dhe nuk kanë nënshkruar kartelat, në 14 raste gjendja kontabël është më e madhe se sa gjendja në përdorim e aktiveve dhe në 10 raste gjendja kontabël është me e vogël se sa gjendja në përdorim e aktiveve. Pra në 24 raste duhet të merren masa për vlerësimin dhe sistemimin e kartelave të aktiveve. Gjithashtu nga raporti i sipërpërmendur rezultoi një listë me aktive të gjykuara për vlerësim nga komisioni i vlerësimit të asgjësimit dhe një listë me kartela të punonjësve që kanë nevojë për veprime sistemuese, për këtë nuk është ndërmarrë asnjë veprim nga Nëpunësi Autorizues, në kundërshtim me pikën 87 të Udhëzimit nr. 30/2018, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Nëpunësi autorizues me të marrë dokumentacionin e inventarizimit, nxjerr urdhrin për ndjekje nga nëpunësi zbatues në lidhje me masat për kompensimin dhe sistemimin e diferencave të rezultuara.”

- Nga verifikimi i pasqyrave kanë rezultuar, disa elementë pasaktësie të trajtuara përgjatë materialit.

Mbi sa më sipër, është paraqitur observacioni nga znj. Ll M, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i MEKI dhe znj. F.G, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Financës me shkresën nr. 244/38 prot., datë 13.03.2026, protokolluar në KLSH me nr.951/27 datë 13.03.2026, në lidhje me sa trajtuar në projekt raport nr. 244/36, datë 18.02.2026, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

Pretendimi i subjektit:

Sqarojmë se evidentimi i këtyre aktiveve në pasqyrat financiare të MEKI nuk ka qenë i mundur për arsye procedurale dhe kontabël.

Konkretisht, nga Drejtoria e Financës në Ministrinë e Financave nuk janë reflektuar në pasqyrat financiare për vitin 2024 pakësimet e aktiveve që i përkisnin kësaj ministrie dhe që duhet të transferoheshin në institucionin pritës.

Për rrjedhojë:

- nuk mund të regjistrohen aktive në institucionin pritës, nëse më parë nuk është kryer pakësimi në institucionin dhurues,

- kjo situatë krijon një mbivlerësim të aktiveve në bilancin e konsoliduar të ministrive.

Ndërkohë, për sa i përket detyrimeve dhe të drejtave të lidhura me programet e ministrisë përgjegjëse për ekonominë, ato janë pasqyruar në llogarinë 486, sipas dokumentacionit të përcjellë nga ish MFE.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Për sa pretenduar me sipër, nuk keni paraqitur asnjë dokumentacion shtesë, nga sa grupi i auditimit ka verifikuar.

Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

2.3 Administrimi dhe menaxhimi i marrëdhënieve të punës dhe pagat e punonjësve.

Auditimi i këtij drejtimi të programit u bazua në shqyrtimin e dokumentacionit si më poshtë:

-Respektimi i strukturave organike të miratuara dhe krahasimi me faktin.

-Baza ligjore e nënligjore që specifikon trajtimin e punonjësve të MEKI, të ndara në kategori të veçanta;

-Listëpagesat dhe libri i pagave;

-Dosjet e personelit;

-Zbatimi i vendimeve gjyqësore mbi punonjësit e larguar nga puna dhe ekzekutimi i tyre”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë;

-Baza e të dhënave/data baza mbi personelin;

-Baza e të dhënave/Data baza e vendimeve gjyqësore për punonjësit e larguar;

-Urdhër shpenzimet e realizuara nga MEKI për likuidimin e këtyre detyrimeve;

Auditimi iu referua akteve ligjore e nënligjore në vijim:

-Ligji Nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar;

-VKM Nr.108, datë 26.2.2014 “Për planin vjetor të pranimet në shërbimin civil”;

-VKM Nr. 242, datë 18.03.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” i ndryshuar.

-Për vitin 2025 MEKI ka funksionuar me “Rregullore e brendshme, miratuar nga ministri me vendimin nr. 620 dhe me nr.6618 prot., datë 13.05.2025”.

1. Respektimi i strukturave organike të miratuara dhe krahasimi me faktin.

Në drejtim të objektivave të institucionit, struktura organizative në Ministrinë e Kulturës ka funksionuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 164, datë 05.10.20217 “Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Ministrisë së Kulturës”, ku numri i punonjësve ka qenë 91. Në drejtim të objektivave të institucionit, struktura organizative në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit ka funksionuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 37, datë 19.02.2024 “Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Ministrisë së ekonomisë, Kulturës dhe inovacionit”, ku numri i punonjësve ka qenë 275. MEKI e ka ndryshuar strukturën organike të saj, me Urdhrin e Kryeministrit nr. 204, date 23.10.2024 “Disa ndryshime dhe shtesa në urdhrin nr.37, datë 19.2.2024, të Kryeministrit, “për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit”, i ndryshuar” dhe numri total i punonjësve në aparatin MEKI është 281. Nga auditimi:

Për vitin 2022, numri total i punonjësve në strukturë është 91 (plani) ndërsa numri faktik i punonjësve rezulton 71 (fakti).

-Referuar të dhënave të marra nga MEKI (Sektori i burimeve njerëzore) për vitin 2022, numri i vendeve të lira/vakante është 20 (njëzet), vetëm për institucionin e Ministrisë së Kulturës.

Për vitin 2023, numri total i punonjësve në strukturë është 91 (plani) ndërsa numri faktik i punonjësve rezulton 83 (fakti).

-Referuar të dhënave të marra nga MEKI (Sektori i burimeve njerëzore) për vitin 2023, numri i vendeve të lira/vakante është 8 (tetë), vetëm për institucionin e Ministrisë së Kulturës.

Në vijim të urdhrin të Kryeministrit nr.37, datë 19.02.2024 “Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit”, është ngritur urdhri nr. 143 datë 28.02.2024 për krijimin e komisionit të ristrukturimit në kuadër të ristrukturimit të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Ky komision është marrë me sistemimin e punonjësve për vendet e parashikuara në strukturë dhe nga të dhënat e siguruar nga ministria nuk ka rezultuar të ketë ankesa për përcaktimet e pozicioneve.

Për vitet 2024-2025, numri total i punonjësve në strukturë është 281 (plani) ndërsa numri faktik i punonjësve rezulton 236 (fakti).

-Referuar të dhënave të marra nga MEKI (Sektori i burimeve njerëzore) për vitet 2024-2025, numri i vendeve të lira/vakante është 45 (dyzet e pesë), vetëm për institucionin e MEKI.

Konkluzion: Nga auditimi mbi strukturën organizative dhe burimet njerëzore të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI), u konstatua se, pavarësisht miratimit të strukturave të reja me Urdhrat e Kryeministrit me nr.37, datë 19.02.2024 dhe nr. 204, datë 23.10.2024 struktura nuk është plotësuar sipas organikës ku:

Për vitin 2024 në një total prej 281 pozicioneve të planifikuara në strukturë edhe pas shpalljeve të kryera nga institucioni, numri mesatar faktik i punonjësve ka qenë 207, duke rezultuar në 74 pozicione vakante. Për vitin 2025, në një total prej 281 pozicioneve të planifikuara në strukturë edhe pas shpalljeve të kryera nga institucioni, numri mesatar faktik i punonjësve ka qenë 236, duke rezultuar në 45 pozicione vakante. Kjo situatë tregon një mospërputhje të vazhdueshme ndërmjet numrit të planifikuar dhe atij real të punonjësve, situatë e cila çënon në mënyrë të drejtpërdrejtë në:

- efikasitetin e funksionimit të ministrisë,
- realizimin në kohë dhe me cilësi të objektivave institucionale,
- ngarkesën e punës për stafin ekzistues.

2. Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve. Realizimi i fondit të pagave.

Pagat e punonjësve në Aparatin e Ministrisë janë përcaktuar sipas funksionit dhe kategorisë referuar VKM nr. 187, datë 03.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”, i ndryshuar me VKM-në nr.696, datë 22.11.2017; VKM-në me nr.1, datë 4.1.2018; dhe me VKM-në me nr.116, datë 23.2.2018, Vendim Nr. 610, datë 24.7.2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 717, datë 23.6.2009 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore”, i ndryshuar, i cili është shfuqizuar nga Vendimi nr. 325, datë 31.5.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike” i ndryshuar.

Nga auditimi me përzgjedhje e listë pagesave, për punonjësit e Aparatit të Ministrisë, rezultoi se pagesat janë kryer në përputhje me bazën ligjore në fuqi.

3. Dosjet e personelit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet 40 dosjeve fizike, u konstatua se për nëpunësit e MEKI janë zbatuar procedurat e legjislacionit për nëpunësin civil dhe Kodi i punës parashikuar për institucionet e administratës shtetërore. Nga auditimi me përzgjedhje rastësore të dosjeve të personelit, rezultoi se ato administrohen të inventarizuara në zbatim VKM nr. 117, datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”. Në dosjen teknike të nëpunësit janë përfshirë:

LIDHJA NR 1. “Fletë inventari me listën e gjithë dokumentacionit që ndodhet në dosje dhe

LIDHJA NR 2. “Të dhënat që duhet të përmbajë fleta prezantuese e dosjes teknike të nëpunësit 1. Numri i identifikimit të nëpunësit civil; 2. Emri, atësia, mbiemri; 3. Numri kombëtar i identifikimit; 4. Shtetësia; 5. Gjinia; 6. Datëlindja; 7. Gjendja civile; 8. Përbërja familjare; 9. Adresa e vendbanimit të përhershëm; 10. Adresa e vendbanimit të përkohshëm; 11. Arsimiti; 12. Diploma; 13. Kualifikimi (llojet); 14. Gradë shkencore (titulli); 15. Njohuri gjuhe të huaja; 16. Data e fillimit të punës në pozicionin përkatës;” 17. Trajnimet e ndryshme pranë DAP, nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA).

Nga auditimi me zgjedhje të dosjeve të personelit konstatohet se, në të gjitha rastet dosjet e personelit janë të inventarizuara dhe me kërkesat e përcaktuara (diplomat ose diplomën e nivelit të dytë bashkë me dokumentet e tjera) të noterizuara. Raporti mjeko- ligjorë i ndodhur në 9 dosje e

personelit nuk është i azhurnuar në zbatim të VKM nr. 124, datë 17.02.2016 (i ndryshuar me VKM nr. 747, datë 19.12.2018) “Për pezullimin dhe lirim nga Shërbimi Civil” kreu III, pika 23, paragrafi 2 “Nëpunësi civil paraqet pranë njësisë së burimeve njerëzore të institucionit dokumentacionin e shëndetit në punë, sipas legjislacionit në fuqi për sigurinë dhe shëndetit në punë, brenda datës 10 janar të çdo viti”.

Gjithashtu për periudhën objekt auditimi, u verifikua nëse është kryer vlerësimi periodik i rezultateve individuale në punë dhe a janë të bashkëlidhura në dosjet e nëpunësve dhe ka rezultuar se janë kryer vlerësimet periodike të performancës së punonjësve, në zbatim të Vendimit Nr. 109, datë 26.2.2014 “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë” i ndryshuar, ndër të tjera, në kreun II, parashikon sistemin e vlerësimit të rezultateve në punë, si procesi i verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuar në fillim të periudhës së vlerësimit, si dhe i aftësive apo i dobësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave, që realizohet çdo 6 muaj të vitit kalendarik. Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësin civil të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese kryhet bashkërisht nga zyrtari raportues, zyrtari kundër firmues dhe zyrtari autorizues.

Nga verifikimi i dokumentacionit pjesë e dosjeve të personelit, për nëpunësit civil, vërehet se vlerësimet e performancës, janë pjesë e tyre. Këto të fundit administrohen në dosje në përputhje me VKM-në nr. 833, datë 28.10.2020, pika II/1 sipas të cilës: “Dosja e personelit është individuale dhe përmban të dhëna të karakterit të përgjithshëm, profesional, akademik, masa disiplinore, të dhëna për vlerësimin e rezultateve në punë, si dhe të dhëna të tjera...”.

Nga verifikimi i dokumentacionit pjesë e dosjeve të personelit, për punonjësit me kontratë pune, konstatohet se ka vlerësime të performancës.

Gjatë procesit të verifikimit u konstatua se, formularët e vlerësimit të punës janë hartuar, sipas (formatit të miratuar në Lidhjen nr. 2, të VKM nr. 109, datë 26.2.2014, e ndryshuar, ku janë materializuar të gjitha rubrikat që kanë të bëjnë me të dhënat personale (ndarja A); të dhënat për kontekstin e punës ku identifikohen objektivat e institucionit dhe të njësisë organizative ku bën pjesë nëpunësi (ndarja B); objektivat dhe matësit e performancës, ku duke mbajtur parasysh përshkrimin e punës, bëhet vlerësimi për çdo objektiv (ndarja C); sjellja profesionale, e cila ka të bëjë me saktësinë në punën e kryer dhe realizimin në kohë, punën në grup e marrëdhëniet me kolegët, kërkesën për këshillim, aftësinë menaxheriale për nëpunësit në pozicionet e nivelit të ulët e të mesëm drejtues (ndarja C); vlerësimi i përgjithshëm i rezultateve në punë ku bëhet një vlerësim i përmblendhur i arritjes së objektivave kryesore të punës nga nëpunësit.

4. Planifikimi rekrutimeve dhe procedurat e ndjekura për rekrutimin e punonjësve në shërbimin civil.

Në zbatim të nenit 18, të Ligjit Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe VKM Nr. 108, datë 26.2.2014 “Për planin vjetor të pranimi në shërbimin civil”, përgatitet plani vjetor i pranimi në shërbimin civil për pozicionet e administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm, si dhe për pozicionet e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues.

Për vitin 2022 me shkresën nr. 6614/1 Prot., datë 31.12.2021 nga ana e ministrisë i është dërguar kërkesa për shpallje për rekrutimet vjetore bazuar në vendet vakante dhe parashikimet mbi daljet në pension me një numër total prej 20 vendesh nga ku janë bërë 21 shpallje dhe kanë rezultuar 12 fitues.

Për vitin 2023 me shkresën nr. 7105/1 Prot., datë 28.12.2022 nga ana e ministrisë i është dërguar kërkesa për shpallje për rekrutimet vjetore bazuar në vendet vakante dhe parashikimet mbi daljet

në pension me një numër total prej 18 vendesh nga ku janë bërë 30 shpallje dhe kanë rezultuar 19 fitues.

Për vitin 2024 nga ana e ministrisë nuk janë dërguar shkresat me kërkesat vjetore por kanë funksionuar me emaile kërkesa për shpallje për rekrutimet vjetore bazuar në vendet vakante dhe parashikimet mbi daljet në pension ku janë bërë 185 shpallje dhe kanë rezultuar 91 fitues.

Për vitin 2025 nga ana e ministrisë nuk janë dërguar shkresat me kërkesat vjetore por kanë funksionuar me emaile kërkesa për shpallje për rekrutimet vjetore bazuar në vendet vakante dhe parashikimet mbi daljet në pension nga ku janë bërë 26 shpallje dhe kanë rezultuar 17 fitues.

Konstatim:

Nga auditimi i veprimtarisë së menaxhimit të burimeve njerëzore, u konstatua se Sektori i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore nuk ka dërguar pranë Departamentit të Administratës Publike (DAP) planin vjetor të nevojave për pranime në shërbimin civil për vitin 2024-2025. Mungesa e këtij plani ndikon në procesin e planifikimit dhe mbulimit me burime njerëzore, si dhe në vonesa në plotësimin e pozicioneve vakante.

Veprime në kundërshtim me pikën 1, 2 të nenit 18 të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ku citohet: “...1. *Administrimi i shërbimit civil bazohet në planin vjetor të pranimi. 2. Këshilli i Ministrave, jo më vonë se fundi i muajit shkurt, miraton planin vjetor të pranimi në institucionet e administratës shtetërore. Njësitë e qeverisjes vendore dhe çdo institucion i pavarur, jo më vonë se muaji shkurt, miratojnë planet e veta të pranimeve vjetore. Planet vjetore të miratuara sipas kësaj pike publikohen...*”.

Dhe në kundërshtim me pikën 2,3 të VKM Nr. 108, datë 26.2.2014 “Për planin vjetor të pranimi në shërbimin civil”, ku citohet: “...2. *Në vendimin e Këshillit të Ministrave, vendimet e institucioneve të pavarura dhe vendimet e organeve të qeverisjes vendore për planifikimin vjetor duhet të përcaktohen: a) numri i vendeve vakante për të cilat duhet të shpallet konkurrimi për çdo kategori dhe klasë; b) numri i anëtarëve të TND-së që do të rekrutohen gjatë vitit; c) grupet e administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm; ç) institucionet ku planifikohen vendet vakante.*

3. *Institucionet e administratës shtetërore/institucionet e pavarura/njësitë e qeverisjes vendore, për planifikimin vjetor të pranimi në shërbimin civil, të kenë parasysh: a) mbushjen e moshës së pensionit të nëpunësit civil; b) parashikimin e vendeve të reja në shërbimin civil; c) ecurinë e krijimit të vendeve vakante në shërbimin civil për arsye të tjera të paparashikuara në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike...*”.

5. Zbatimi i vendimeve gjyqësore mbi punonjësit e larguar nga puna dhe ekzekutimi i tyre.

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr.5151, datë 28.10.2015 “Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil”, Kreu II, pika 1, Sektori i Burimeve Njerëzore ka krijuar “bazën e të dhënave gjyqësore” për gjyqe fituesit e larguar nga puna e si pjesë përbërëse e Regjistrit Qendror të Personelit.

Baza e të dhënave gjyqësore përfshin: informacionin mbi numrin dhe datën e vendimit gjyqësor, palët ndërgjyqës objektin, diapozitivin e vendimit, aktin e largimit ose lirimit të nëpunësit nga shërbimi civil, fakte dhe rrethana të lidhura, në lidhje me pozicionin e punës, pas dhënies së vendimit gjyqësor të formës së prerë etj.

Nga auditimi rezultoi se, “Baza e të dhënave gjyqësore” nga kjo njësi është përditësuar rast pas rasti deri në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për gjyqe fituesit.

-Për vitin 2022 është ngritur Urdhër nr.668, datë 05.10.2022 “Për krijimin e komisionit të posaçëm të shqyrtimit të detyrimeve që rrjedhin nga vendimet gjyqësore të formës së prerë për rikthimin në një pozicion të shërbimit civil të Nëpunësit civil gjyqfitues, të Ministrisë së Kulturës”.

-Për vitin 2024 është ngritur urdhri nr.528, datë 19.07.2024 “Për krijimin e komisionit të posaçëm të shqyrtimit të detyrimeve që rrjedhin nga vendimet gjyqësore të formës së prerë për rikthimin në një pozicion të shërbimit civil të Nëpunësit civil gjyqfitues, të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit”.

-Për vitin 2025 është ngritur urdhri nr.127 datë 04.12.2025 “Për krijimin e komisionit të posaçëm të shqyrtimit të detyrimeve që rrjedhin nga vendimet gjyqësore të formës së prerë për rikthimin në një pozicion të shërbimit civil të Nëpunësit civil gjyqfitues, të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit”.

Nëpunësit civil gjyq fitues për rikthimin në një pozicion të rregullt të shërbimit civil, të cilët aktualisht janë në listën e pritjes:

1. F. S, me Vendim nr. 433 date 29.05.2023 Gjykata Administrative e Apelit Tiranë.
2. G. K, me Vendimi nr. 2106, datë 07.07.2016, i Gjykatës Administrative të Apelit.
3. F. I, me Vendimi nr. 227, datë 18.02.2014, i Gjykatës Administrative të Apelit.
4. S. M, me Gjykata e Lartë, Kolegji Administrativ. Nr. 00-2017-1342 Vendimi (165)
5. Xh. I, me Vendimi nr. 4342, datë 01.12.2014 I Gjykatës Administrative të Apelit
6. E. L
7. E. B
8. Y. D, me Vendimi Nr.1 (86-2025-1) I Gjykatës se Apelit Administrativ Tiranë
9. D. D, me vendimin nr. 43, datë 07.02.2023 te Kolegjit Administrativ te Gjykatës së Lartë ka vendosur: Prishjen e vendimit nr. 2613, datë 03.12.2015 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë me tjetër trup gjykues.

Konstatim:

Nga auditimi i dokumentacionit, u konstatua se për punonjësit e përmendur më sipër, nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për rikthimin në detyrë, pavarësisht ekzistencës së një vendimi gjyqësor të formës së prerë në favor të tij.

Veprime në kundërshtim me detyrimet kushtetues të parashikuar në nenin 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku sanksionohet se vendimet gjyqësore janë të detyrueshme për zbatim, si dhe me nenin 66/1 të Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, që përcakton detyrimin e institucionit për rikthimin në detyrë të nëpunësit civil ose dëmshpërblimin e tij, sipas vendimit të gjykatës.

Nga auditimi mbi shpenzimet financiare të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) në lidhje me gjyqfitusit përsa i përket viteve program auditimi, u konstatua se:

1. F. B, me Vendim i Gjykatës se Apelit Tiranë, Nr. 1789, date 30.09.2011 (Kthimin e paditësit F. B në pozicionin e mëparshëm të punës si Drejtor i Auditit të Brendshëm në M.T.K.R.S.; Detyrimin e palës së paditur Ministria e Turizmit Kulturës Rinisë dhe Sporteve të bëjë pagesën e pagës së paditësit nga dita e ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në zbatimin e këtij vendimi; Detyrimin e të paditurit M.T.K.R.S të paguajë paditësin F. B me diferencën e pagës ndërmjet pagës së Sekretarit të Përgjithshëm dhe pagës së Drejtorit të Përgjithshëm të Auditit të Brendshëm të M.T.K.R.S. për dy muaj”) është paguar 14,583,678 lekë. Gjithashtu janë paguar dhe 1,271,000 lekë tarifa përmbartimore.
2. A. H, Vendim i Gjykatës se Apelit Tiranë Nr.634, date 14.12.2022 (Detyrimin e palës se paditur t'i paguaje paditësit 12 muaj page për zgjidhje te menjëhershme dhe te pajustificuar te kontratës se

punës) është paguar 1,057,238 lekë. Gjithashtu janë paguar shpenzime gjyqësore në vlerën 51,600 lekë dhe tarif përmbartimore në vlerën 73,183 lekë.

3. M. H, Vendim i Gjykatës së Apelit Tiranë Nr. 114, datë 22.09.2022 (Detyrimin e të paditur Ministria e Kulturës, ti paguaje paditësit M. H, si dëmshpërblim për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës në mënyrë të pajustificuar në masën e 12 pagave mujore. Si page referuese për pagimin e dëmshpërblimit të merret paga e fundit bruto e paditësit në shumen 105.850 lekë në muaj. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur) është paguar 1,270,200 lekë. Gjithashtu janë paguar 3,400 lekë shpenzime gjyqësore dhe 84,058 lekë tarifa përmbartimore.
4. L.V, Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë Nr.6744, datë 14.10.2019 (Pagim page) është paguar 698,080 lekë. Gjithashtu janë paguar dhe 46,073 lekë tarifa përmbartimore.
5. A.H, Vendim i Gjykatës së Apelit Vlorë, nr. 144, datë 06.03.2018 (Detyrimin e palës së paditur Ministria e Kulturës që të dëmshpërblejë paditësin A.H në bazë të kërkesave të nenit 143/1 të Kodit të Punës me 2 muaj pagë për mosrespektim të afatit njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës. Detyrimin e palës së paditur Ministria e Kulturës që të dëmshpërblejë paditësin A.H në bazë të kërkesave të nenit 144/5 të Kodit të Punës me 2 muaj pagë për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës. Detyrimin e palës së paditur Ministria e Kulturës që të dëmshpërblejë paditësin A.H në bazë të kërkesave të nenit 155 të Kodit të Punës me 12 muaj pagë për shkak të zgjidhjes në mënyrë të menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës. Detyrimin e palës së paditur Ministria e Kulturës që të dëmshpërblejë paditësin A.H në bazë të nenit 145 të Kodit të Punës me tre paga pesëmbëdhjetëditëshe, 1,5 paga mujore, si shpërblim për vjetërsi në punë) është paguar 1,607,400 lekë. Gjithashtu janë paguar dhe 96,444 lekë tarifa përmbartimore.
6. A. T, Vendim i Gjykatës Administrative të Apelit nr. 4188, datë 30.11.2016 (Detyrimin e palës së paditur t'i paguajë paditësit A. T 2 muaj pagë për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës. Detyrimin e të paditurit, t'i paguajë paditësit A. T, 2 muaj pagë si dëmshpërblim për zgjidhjen e kontratës së punës përspektuar afatin e njoftimit. Detyrimin e palës së paditur t'i paguajë paditësit A. T, 3 muaj pagë për zgjidhje të kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme dhe të pajustificuar. Detyrimin e palës së paditur, t'i paguajë paditësit A. T, 1.5 muaj pagë si shpërblim për vjetërsi në punë) është paguar 646,468 lekë.
7. M.B, Vendim i Gjykatës Administrative të Apelit Nr.3497, datë 30.09.2016 (Detyrimin e palës së paditur, Ministria e Kulturës, që të dëmshpërblejë paditësen M.B me 2 (dy) paga mujore për zgjidhje të menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës, me 1 (një) pagë mujore për mosrespektim të afatit të njoftimit, si dhe me 2 (dy) paga mujore për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës, gjithsej me 5 (pesë) paga mujore, ku si pagë bazë të merret paga neto që ka patur paditësja në momentin e përfundimit të marrëdhënieve të punës) është paguar 298,315 lekë.
8. D.K, Vendimi gjyqësor i formës së prerë nr. 100 datë 01.11.2011, të Gjykatës së Apelit Tiranë (Komisioni i Shërbimit Civil me vendimin nr.125 datë 25.04.2011 ka vendosur shfuqizimin e vendimit për masën disiplinore dhe kthimin e ankuesit D.K, në pozicionin e mëparshëm të punës dhe pagimit të pagës nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënies financiare deri në ekzekutimin e vendimit) është paguar 19,893,327 lekë. Gjithashtu janë paguar dhe 488,224 lekë tarifa përmbartimore.
9. Sh.Gj, Vendimi gjyqësor i formës së prerë nr. 1033, datë 06.05.2016, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë (Pranimin e pjesshëm të padisë së paditësit Sh.Gj. Detyrimin e palëve të paditura, Ministria e Zhvillimit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Drejtoria e Përgjithshme e Pronës Shtetërore dhe Drejtoria e Privatizimeve Tiranë, t'i paguajnë paditësit Sh.Gj 6 (gjashtë) paga mujore si

dëmshpërblim për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës. Detyrimin e palëve të paditura, Ministria e Zhvillimit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Drejtoria e Përgjithshme e Pronës Shtetërore dhe Drejtoria e Privatizimeve Tiranë, t'i paguajnë paditësit Sh.Gj 2 (dy) paga mujore si dëmshpërblim për mosrespektimin e afatit të njoftimit. Detyrimin e palëve të paditura, Ministria e Zhvillimit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Drejtoria e Përgjithshme e Pronës Shtetërore dhe Drejtoria e Privatizimeve Tiranë, t'i paguajnë paditësit Sh.Gj ,2 (dy) paga mujore si dëmshpërblim për mosrespektimin e procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur") është paguar 681,000 lekë. Gjithashtu janë paguar dhe 44,946 lekë tarifa përmbartimore.

Vendimet gjyqësore nuk janë ekzekutuar vullnetarisht nga institucioni, pas marrjes së njoftimit të vendimit të formës së prerë dhe kthimit të tij në titull ekzekutiv, por është zbatuar nëpërmjet urdhrave të ekzekutimit të lëshuara nga përmbartues privatë, veprime në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, nenin 130, nenin 451/a dhe nenin 510/a, duke paguar tarifa përmbartimore.

Bazuar në Udhëzimin e Përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Drejtësisë, nr. 1, datë 04.06.2014 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njërive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit" pika 5 ku citon se:

"Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore që janë parashikuar të shlyhen nga buxheti përkatës, bëhet sipas radhës së paraqitjes zyrtare të tyre në vitin paraardhës dhe grafiku i shlyerjes bëhet publik nëpërmjet publikimit në faqen on-line të njësive shpenzuese, apo në formë të tjera të publikimit, që ju bëhen të ditura publikut. Përmbartuesi i përmbahet grafikut të shlyerjes së detyrimit të publikuar".

Në vijim të këtij detyrimi ligjor MEKI rezultoi se nuk ka publikimin on line në faqen zyrtare të saj, grafikun e shlyerjes së detyrimeve sipas përcaktimit të bërë në këtë udhëzim, e cila fillon me likuidimin e detyrimeve duke njoftuar menjëherë gjyqëfituesin, ku sipas përcaktimit të pikës 2:

"Njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë përgjegjëse për zbatimin e vendimeve gjyqësore dhe për shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin prej tyre".

2.4 Planifikimi dhe zbatimi i procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimi i kontratave për punë mallra dhe shërbime deri në marrjen në dorëzim.

Në zbatim të drejtimit 4 të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni, si më poshtë: Dokumentacioni i ngarkuar në SPE; Dokumentacioni i praktikave të procedurave të prokurimit dhe konkurrimit publik; Dokumentacioni i administruar për zbatimin e kontratave; Urdhërshpenzimet përkatëse. Mbështetur edhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga ana e subjektit, në total procedurat e prokurimit dhe zbatimet e kontratave të realizuara dhe ato të audituara për periudhën objekt auditimi paraqiten si më poshtë. Në total në lidhje me procedurat e prokurimit, nga

Viti	Vlera e kontratave	Audituar Prokurimi ⁵	Në %	Audituar Zbatimi	Në %
Para 2021 ⁶	1,327,402,701	-	-	1,327,402,701	100
2022	1,326,682,922	1,179,456,364	89	1,180,946,364	89
2023	79,172,714	46,659,645	59	56,060,455	71
2024	235,557,867	217,520,507	92	(në proces)	-
2025	69,463,685	69,463,685	100	(në proces)	-

⁵ Procedura të prokuruar nga ana e MK / MEKI / MTKS.

⁶ Kontrata të lidhura përpara periudhës objekt auditimit, por në proces brenda periudhës objekt auditimi.

Tabela nr. 1

Lista e kontratave të prokuruar në periudhat e mëparshme dhe marrë në dorëzim/përfunduar gjatë periudhës së audituar

Objekti i kontratës	Autoriteti përgjegjës për prokurimin dhe zbatimin e kontratës	OE	Vlera e kontratës pa tvsh / data e lidhjes së kontratës	Lloji i procedurës
Restaurim, rikonstrukcion dhe rehabilitimi i hapësirave në Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria e Arteve)	Ministria e Kulturës	BOE 4 A	884,070,328 10.06.2021	Konkurrim publik
Restaurimi, rikonstrukcioni dhe rinovimi i sallës së koncerteve në Akademinë e Arteve të bukura, Tiranë	Ministria e Kulturës	BOE K.	402,332,373 02.04.2021	Konkurrim publik
Hartim projekti për 'Ndërtimi i një objekti/qendre të re multifunkionale në funksion të së ardhmes së edukimit artistik të fëmijëve në kryeqytet, pranë qendrës kombëtare të kulturës për fëmijë dhe teatrit të kukullave'	Ministria e Kulturës	BOE I	41,000,000 31.12.2021	Prokurim Publik

Tabela nr.2

Lista e kontratave të prokuruar dhe marrë në dorëzim / përfunduar gjatë vitit 2022

Objekti i kontratës	Autoriteti përgjegjës për prokurimin dhe zbatimin e kontratës	OE	Vlera e kontratës pa tvsh / data e lidhjes së kontratës	Lloji i procedurës
Ndërtimi i një objekti/qendre të re multifunkionale në funksion të së ardhmes së edukimit artistik të fëmijëve në kryeqytet, pranë qendrës kombëtare të kulturës për fëmijë dhe teatrit të kukullave	Ministria e Kulturës	BOE R	1,000,449,285 10.11.2022	Prokurim Publik
Ndërhyrje restauruese në mozaikun e Tiranës	Ministria e Kulturës	F	149,382,639 19.08.2022	Konkurrim Publik
Parku i Artit, rivitalizimi dhe rikualifikimi i territorit të ish kinostudios Shqipëria e Re	Ministria e Kulturës	BOE A	144,027,705 12.09.2022	Konkurrim Publik
Restaurim për ndërtesën e aneksit të bibliotekës kombëtare (faza III)	Ministria e Kulturës	BOE K	29,624,440 03.11.2022	Konkurrim Publik
Mbikëqyrje "Parku i Artit, rivitalizimi dhe rikualifikimi i territorit të ish kinostudios Shqipëria e Re"	Ministria e Kulturës	BOE F	1,708,853 14.12.2022	Konkurrim Publik
Blerje Karburanti	Agjencia e Shtetërore e Prokurimit të Përqendruar / Ministria e Kulturës	K	1,556,000 25.10.2022	Marreveshje Kuadër
Mbikëqyrje 'Ndërhyrje restauruese në Mozaikun e Tiranës'	Ministria e Kulturës	BOE F	1,490,000 19.08.2022	Konkurrim Publik

Tabela nr. 3

Lista e kontratave të prokuruar dhe marrë në dorëzim/ përfunduar gjatë vitit 2023

Objekti i kontratës	Autoriteti përgjegjës për prokurimin dhe zbatimin e kontratës	OE	Vlera e kontratës pa tvsh / data e lidhjes së kontratës	Lloji i procedurës
Ndërhyrje emergjente në monumentin e kulturës "Ura e Matit"	Ministria e Kulturës	BOE A. S	46,659,645 27.12.2023	Konkurrim Publik
Projektimi, restaurimi dhe muzealizimi i ish banesës Toptanasve/Libohoviteve "Muzeu Besa"	Ministria e Kulturës	BOE O	20,000,000 27.10.2023	Konkurs Projektim

Mbikëqyrje 'Ndërtimi i një objekti/qendre të re multifunkionale në funksion të së ardhmes së edukimit artistik të fëmijëve në kryeqytet, pranë qendrës kombëtare të kulturës për fëmijë dhe teatrit të kukullave'	Ministria e Kulturës	H	9,400,810 08.02.2023	Prokurim Publik
Kontrate furnizimi me lëndë djegëse për automjetet diesel	Ministria e Kulturës	K	3,112,259 27.09.2023	Marreveshje Kuadër

Tabela nr. 4

Lista e kontratave të prokuruar dhe marrë në dorëzim/ përfunduar gjatë vitit 2024

Objekti i kontratës	Autoriteti përgjegjës për prokurimin dhe zbatimin e kontratës	OE	Vlera e kontratës pa TVSH	Data e lidhjes së kontratës	Lloji i procedurës	Shënim
Blerje e laboratorëve të lëndëve të përgjithshme, blerje makineri dhe pajisje për repartet e praktikave profesionale, kafshe (lope, dele) për shkollat bujqësore	OBP / MEKI	A loti I; L Loti II; L Loti III; A Loti IV	34,453,190 34,863,103 46,290,500 30,786,500	20.12.2024 21.11.2024 27.11.2024 18.11.2024	Prokurim Publik	
Blerje pajisje IT për nevojat e MEKI	AKSHI / MEKI	B Loti II; S III & VII; B loti IV; Gj Loti V	217,100 171,933 2,500,000 463,500 150,000 (Totali) 3,502,533.3	23.12.2024 23.12.2024 26.12.2024 23.12.2024 30.12.2024	Prokurim Publik	
Ndërtim të ri të Shkollës dhe repartit të shkollës "Pavarësia" Vlorë	OBP / MEKI	BOE Z	360,157,072	20.02.2025	Prokurim Publik	Pa u hapur kantieri
Ndërtim i ri i shkollës profesionale "Karl Gega" Tiranë	MEKI	BOE L	217,520,507	02.04.2025	Prokurim Publik	Pa u hapur kantieri
Rikonstruksion i shkollës së Mesme profesionale "Arben Broci" Shkodër	OBP / MEKI	BOE N	139,598,518	03.02.2025	Prokurim Publik	Pa u hapur kantieri
Rikonstruksion i shkollës së mesme profesionale "Bajram Curri" Kukës	OBP / MEKI	I	120,571,164	20.12.2024	Prokurim Publik	Pa u hapur kantieri
Rikonstruksion i shkollës së mesme "Hasan Gina" Lushnjë	OBP / MEKI	L	98,023,514	28.04.2025	Prokurim Publik	Pa u hapur kantieri
Ndërtim/rikonstruksion i repartit të praktikave profesionale të shkollës "Karl Gega" Tirane	OBP / MEKI	T	66,435,000	31.12.2024	Prokurim Publik	Pa u hapur kantieri
Rikonstruksion dhe ndërtim i shtesës në objektin arsimori shkolla e mesme profesionale "Hamdi Bushati" Shkodër	OBP / MEKI	I	56,815,841	26.02.2025	Prokurim Publik	Pa u hapur kantieri
Rikonstruksion i shkollës së mesme profesionale "Enver Qiraxhi" Pogradec	OBP / MEKI	N	44,111,585	12.02.2025	Prokurim Publik	Pa u hapur kantieri
Blerje pajisje IT për nevojat e MEKI	AKSHI / MEKI	I	30,920,000	07.05.2024	Prokurim Publik	
Blerje automjete për nevoja të MEKI	OBP / MEKI	E	24,320,000	24.12.2024	Prokurim Publik	
Investim ne impiantistiken e godinës lidhur me sistemin ngrohje-ftohje me chiller silencioz	MEKI / MEKI	E	18,037,360	14.02.2025	Prokurim Publik	
Rikonstruksion i shkollës se mesme profesionale Kolin Gjoka	OBP / MEKI	A	13,641,705	30.01.2025	Prokurim Publik	Pa u hapur kantieri
Blerje pajisje zyre për nevojat e MEKI	OBP / MEKI	S	4,572,720	02.12.2024	Prokurim Publik	
Rikonstruksion i tarracës së shkollës së mesme profesionale Kamëz	OBP / MEKI	O	4,501,560	31.10.2024	Prokurim Publik	
Rikonstruksion çatie për repartin e praktikave profesionale (stalle) për shkollesn Irakli Terova	OBP / MEKI	I	2,069,373	11.11.2024	Prokurim Publik	

Tabela nr. 5

Lista e kontratave të prokuruar dhe marrë në dorëzim/ përfunduar gjatë vitit 2025

Objekti i kontratës	Autoriteti përgjegjës për prokurimin dhe zbatimin e kontratës	OE	Vlera e kontratës pa tvsh / data e lidhjes së kontratës	Lloji i procedurës	Shënim
Rikonstruksion i Godinës MEKI	MEKI	A	48,506,572	Prokurim Publik	
Blerje pajisje për rjetëzimin e hapësirave të Teatrit të Kukullave	MEKI	E	20,957,113	Prokurim Publik	
Blerje Letër A4 dhe A3	OBP / MEKI	I	1,990,800	Prokurim Publik	
Mbikëqyrje punimesh për objektin "Rikonstruksion i shkollës së mesme profesionale "Bajram Curri" Kukës	OBP / MEKI	BOE A	1,417,916	Marreveshje kuader	Pa u hapur kantieri
Mbikëqyrje punimesh për objektin "Rikonstruksion i shkollës së Mesme profesionale "Arben Broci" Shkodër	OBP / MEKI	BOE A	1,410,437	Marreveshje kuadër	Pa u hapur kantieri
Mbikëqyrje punimesh për objektin "Ndërtim/rikonstruksion i repartit të praktikave profesionale të shkollës "Karl Gega" Tiranë	OBP / MEKI	BOE A	763,606	Marreveshje kuadër	Pa u hapur kantieri
Mbikëqyrje punimesh për objektin "Rikonstruksion dhe ndërtim i shtesës në objektin arsimor shkolla e mesme profesionale "Hamdi Bushati" Shkodër	OBP / MEKI	BOE A	680,641	Marreveshje kuadër	Pa u hapur kantieri
Mbikëqyrje punimesh për objektin "Rikonstruksion i shkollës së mesme profesionale Kolin Gjoka	OBP / MEKI	BOE "I"	198,657	Marreveshje kuadër	Pa u hapur kantieri

Rezultatet e auditimit në lidhje me procedurat e prokurimit dhe ato të zbatimit të kontratave për punë / mallra / shërbime paraqiten si më poshtë të ndara sipas viteve të periudhës objekt auditimi.

➤ AUDITIMI I PROCEDURAVE TË PROKURIMITViti 2022**1. Procedura e prokurimit me objekt Ndërhyrje restauruese në Mozaikun e Tiranës**

Procedura e konkurrimit publik "Ndërhyrje restauruese në Mozaikun e Tiranës" viti 2022,		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 333, datë 06.06.2022	3. Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Konkurrimit Publik Urdhri nr. 333 me nr. 1815/5 prot, datë 06.06.2022 J.H A. T O. P	4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Urdhri nr. 333 me nr. 1815/5 prot, datë 06.06.2022 N. M B. K N. D
2. Lloji i Procedurës "Konkurrim publik", bazuar në VKM-në nr. 425, datë 27.05.2020, i ndryshuar		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 154,901,302 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) 149,382,639 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 5,518,663 lekë
8. Data e publikimit të procedurës 16.06.2022	9. Burimi i financimit Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2; 1.F SHPK me ofertë 149,382,639 lekë pa TVSH 2.Sh SHPK me ofertë 150,321,397 lekë pa TVSH Fitues 1. F SHPK

11. Ankimime AK: Nuk ka.		
12. Lidhja e kontratës nr. 1815/24 Prot., datë 19.08.2022	13. Vlera e kontratës (me TVSH) 55,991,574 lekë	14. Afati i kontratës 12 muaj nga nënshkrimi.

Kjo procedurë është kryer bazuar në VKM-në nr. 425, datë 27.05.2020 “Për procedurat e përzgjedhjes së subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore”, i ndryshuar.

Mbi përlllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike:

Nëpërmjet Vendimit nr. 16 datë 21.01.2022, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale ka miratuar projektin “Projekti arkitektonik Mozaiku i Tiranës”, me aplikues dhe zhvillues Ministrinë e Kulturës, duke bashkëlidhur preventivin paraprak të hartuar nga grupi i punës i DRTK, Tiranë, ku është përcaktuar vlera totale e preventivit prej 150,451,918 lekë pa TVSH. Me shkesën nr. 2476/2 prot., datë 16.05.2022 është marrë në dorëzim raporti paraprak i vlerësimit të ndikimit në mjedis. Me MEMON nr. 1857/4 prot., datë 06.02.2022 i është kërkuar titullarit zhvillimi i procedurës së konkurrimit dhe me urdhrin nr. 333 me nr. 1815/5 prot., datë 06.06.2022 është nxjerrë urdhri i prokurimit ku është vendosur zhvillimi i procedurës me fond limit 150,763,252 lekë pa TVSH me NJHDKP J. H, A. T, O. P dhe NJVO N. M, B. K dhe N. D. Me shkresën nr. 1815/7 prot., datë i është kërkuar APP të kryejë publikimin në buletin e prokurimeve të njoftimit të formularit të konkurrimit publik. Me shkresën nr. 1815/8 prot., datë 10.06.2022 i është kërkuar DRTK Tiranë informacion në lidhje me vlerat e parashikuara në preventiv për shkak të daljes së Aktit Normativ nr. 10 datë 18.05.2022 “Për kompensimin financiar të çmimit për disa materiale ndërtimi, sipas përcaktimeve në kontrata publike për punë, si pasojë situatës së veçante të krijuar në treg gjatë vitit 2022”. Me shkresën nr. 155/3 prot., datë 10.06.2022 nga ana e DRTK Tiranë, është sjellë preventivi i rishikuar ku ka pasur ndryshime. Me shkresën nr. 306 prot., datë 13.06.2022 DRTK Tiranë ka sjellë dhe oponencën teknike mbi projektin e lëshuar nga Universiteti Politeknik i Tiranës. Me urdhrin nr. 368 me nr. 1815/11 prot., datë 16.06.2022 është bërë ndryshimi i urdhrit të prokurimit për vlerën e tij e cila pas ndryshimeve të ardhura nga ana e DRTK ka dalë në vlerën 154,901,302 lekë pa TVSH. Me shkresën nr. 1815/13 prot., datë 16.06.2022 i është kërkuar APP publikimi i njoftimit të ri me ndryshimet përkatëse. Nga NJHDPK është mbajtur procesverbali i datës 16.06.2022 në lidhje me përlllogaritjen e fondit limit ku është shpjeguar që pas ndryshimeve kanë ndryshuar fondin limit në zbatim të Aktit Normativ nr. 10 datë 18.05.2022 “Për kompensimin financiar të çmimit për disa materiale ndërtimi, sipas përcaktimeve në kontratat publike për punë, si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg gjatë vitit 2022”.

Mbi përcaktimin e kriterëve të kualifikimit:

Me procesverbalin e datës 16.06.2022 NJHDKP ka hartuar procesverbalin e hartimit të dokumenteve të konkurrimit publik ku shpjeguar hapat për zgjedhjen e procedurës dhe vendosjeve të kriterëve ku ka dhënë argumentim për çdo kriter të vendosur.

Konstatim:

Në pikën 4.1 të Kriterëve të posaçme përcaktohet se “OE duhet të ketë një punësim mesatar të të paktën 80 personave, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit...”. Në argumentimin shoqëruar citohet se “numri i punëtorëve dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën, si dhe kohëzgjatjen... gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore...”. Ky kriter nuk është i argumentuar në nivel teknik, kjo pasi mënyra e përcaktimit dhe dokumentacioni i kërkuar nuk kërkojnë fuqi punëtore ose staf punëtorë, por punonjës që figurojnë

në listë-pagesa, të cilët në mungesë të përcaktimit mund të jenë staf administrativ, që nuk lidhen me kryerjen e punimeve. Në pikën 4.2 është kërkuar që operatorët të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e punimeve si me poshtë: 1 inxhinier ndërtimi dega gjeoteknik; 1 inxhinier ndërtimi dega transport; 1 inxhinier mekanik; 1 inxhinier elektrik; 1 arkitekt; 1 inxhinier hidroteknik; 1 inxhinier gjeodet; 1 inxhinier mjedisi.

Nga auditimi i procedurës është konstatuar se ky projekt është sjellë nga projektuesi mbi restaurimin e mozaikut dhe si i tillë vlerësojmë që kërkesa për 1 arkitekt nuk është e nevojshme për shkak se projekti është dhe me zbatimin do të merren inxhinierët e tjerë të kërkuar për pjesën e ndërtimit dhe vlerësojmë që kjo kërkesë nuk është në përputhje me natyrën e procedurës. Në pikën 4.4 është kërkuar që të operatori duhet të ketë të punësuar staf teknik si më poshtë: 2 punonjës teknik ndërtimi (Kategoria 2); 2 punonjës mekanik (kategoria 2); 2 punonjës hidraulik (Kategoria 2); 2 punonjës elektrikist (Kategoria 3); 2 punonjës karpentier (Kategoria 1).

Nga auditimi i procedurës vlerësojmë se kërkesa me një numër prej 2 punonjësish për çdo specialiteti nuk është i argumentuar përse ky numër duhet të jetë aq dhe ku ndikon kjo në procedurë dhe si e tillë vlerësojmë që ky numër me këtë kërkesë nuk është e argumentuar dhe jo në përputhje me natyrën e procedurës.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën 1 të nenin 77 LPP dhe pikën 2 të nenit 41 të VKM 285 “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”. Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit.

Mbi vlerësimin e ofertave

Sipas procesverbalit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave me nr. 1815/16 prot., datë 14.07.2022 kanë marrë pjesë 2 operatorë sipas tabelës së mësipërme nga të cilët është s’kualifikuar OE Sh.I SHPK për shkak nuk plotëson germën f, pika 1 të kriterëve të përgjithshme të kualifikimit si dhe pikën 1.1 Punë të ngjashme të kapaciteteve teknike, nuk plotëson pikën ë, pika 1 të kriterëve të përgjithshme të kualifikimit si dhe pikën 2.2 të pikës 2 Licenca profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës. Në vijim, është miratuar raporti përmbledhës nga ana e titullarit ku është shpjeguar procedura dhe është vendosur fitues OE F SHPK me shkresën nr. 1815/19 prot., datë 20.07.2022. Ndërmjet OE dhe AK është lidhur kontrata publike për punë me nr. 1815/24 port., datë 19.08.2022. Për sa i përket procedurës së prokurimit nuk u konstatuan shkelje në përzgjedhjen e fituesit si dhe në plotësimin e Kriterëve të Përgjithshme dhe të Veçanta të vendosura nga NJP.

2. Procedura e prokurimit me objekt Ndërtimi i një objekti/qendre të re multifunkionale në funksion të së ardhmes së edukimit artistik të fëmijëve në kryeqytet, pranë qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë dhe Teatrit të Kukullave

Procedura e prokurimit: “Ndërtimi i një objekti/qendre të re multifunkionale në funksion të së ardhmes së edukimit artistik të fëmijëve në kryeqytet, pranë qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë dhe Teatrit të Kukullave”, 2022		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 179 prot., 29.03.2023	3. Njësia e Prokurimit Urdhër nr. 432, datë 12.07.2022	4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Urdhër nr. 433, datë 12.07.2022, i ndryshuar me nr. 647, datë 23.09.2022
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”	- N. M; - O .P (arkitekt); - N. D (inxhinieri).	- A. A (kryetar); - A. B;

		- R. P (arkitekt).
5. Fondi Limit (pa TVSH) 1,035,362,461.19 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) 1,000,449,285.07 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 34,913,176.12 lekë (3%)
8. Data e hapjes së tenderit 06.04.2023	9. Burimi i financimit Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender: 1 BOE b) Skualifikuar: -
11. Ankimime AK: - KPP: -		
12. Lidhja e kontratës (MK) Nr. 3252/25 prot., datë 10.11.2022	13. Vlera e kontratës 1,200,539,142.08 lekë me TVSH	14. Afati i kontratës 24 muaj

Mbi projektimin dhe përlogaritjen e fondit limit

Në zbatim të kontratës “*Shërbim konsulence*” nr. 6758 prot., datë 31.12.2021, është hartuar dhe marrë në dorëzim Projekti për ndërtimin e një objekti/ qendre të re multifunkionale në funksion të së ardhmes së edukimit artistik të fëmijëve në kryeqytet, pranë QKKF dhe Teatrit të Kukullave, ku vlera fillestare e preventivuar (*janar 2022*) ka qenë 1,002,247,145.43 lekë pa TVSH. AK ka kërkuar nga BOE hartues i projektit verifikimin lidhur me çmimet për materialet e ndërtimit si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg gjatë vitit 2022, bazuar në Aktin normativ nr. 10, datë 18.05.2022. Nëpërmjet shkresës administruar në MK me nr. 3252/2 prot., datë 08.07.2022, nga “i Ri” është dërguar preventivi (*korrik 2022*) ku është përcaktuar vlera prej 1,035,362,461.19 lekë pa TVSH. Në dosjen e prokurimit administrohet korrespondenca me Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimin Financiar në MK dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për marrjen e masave për disponueshmërinë e fondeve buxhetore lidhur me ndryshimet në vlerën totale të parashikuar për projektin. Nëpërmjet Urdhrit nr. 432, datë 12.07.2022, është ngritur Njësia e prokurimit, e përbërë nga znj. N.M, z. O. P (arkitekt) dhe znj. N.D (inxhinierë), përgjegjëse për hartimin e dokumenteve standarde të tenderit dhe dokumentacionin e nevojshëm për zhvillimin e procedurës së prokurimit në përputhje me legjislacionin në fuqi. Nëpërmjet Urdhrit nr. 433, datë 12.07.2022, i ndryshuar me Urdhrit nr. 647, datë 23.09.2022, është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, i përbërë nga z.A. A (kryetar), z. A.B dhe znj. R. P (arkitekt, specialist fushe). Nëpërmjet VKM nr. 561, datë 29.07.2022 është ndryshuar përgjegjësia e administrimit e një pjese të pasurisë nr. 4/867, ZK 8270, me emërtim “*Garda e Republikës Garnizon*”, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë te Ministria e Kulturës, për sipërfaqe truall 6,445m² dhe sipërfaqe ndërtese 1,010m², për realizimin e projektit “*Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë dhe Teatri i Kukullave*”. Njësia e prokurimit ka dokumentuar përcaktimin e fondit limit nëpërmjet PV nr. 3252/8 prot., datë 11.08.2022, sipas preventivit të projektit të marrë në dorëzim të sipërcituar (*korrik 2022*) në vlerën totale prej 1,035,362,461.19 lekë pa TVSH, nga të cilat fondi i llogaritur për vitin buxhetor 2022 është 208,559,922.86 lekë pa TVSH.

Mbi hartimin e DST, përcaktimin dhe argumentimin e kriterëve për kualifikim

Nëpërmjet Urdhrit të Prokurimit nr. 535, datë 11.08.2022, Titullari i AK ka kërkuar kryerjen e procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur – punë, mbi kufirin e lartë monetar*”, duke ngarkuar njësinë e prokurimit për hartimin e kërkesave për kualifikim, specifikimeve teknike, kriteret dhe

çdo informacion tjetër specifik të nevojshëm. Njësia e prokurimit ka hartuar DST, ku është përcaktuar afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave data 15.09.2022. Nëpërmjet shkresës administruar në MK me nr. 4395 prot., datë 18.08.2022, OE “4 A” ka paraqitur ankesën lidhje me kriteret e veçanta për kualifikim, duke kërkuar rishikim kriterit 2.3.1 mbi përvojën e suksesshme në realizimin e punëve të ngjashme, duke pretenduar se kriteri është diskriminues për OE vendas duke kufizuar konkurrencën. Nga korrespondenca ndërmjet strukturave të MK-së rezulton se ankesa nuk është marrë në konsideratë, pasi nuk është bashkëlidhur mandat pagesa sipas kërkesave ligjore. Nëpërmjet e-mail të datës 29.08.2022, Koordinimi APP Koordinimi.App@app.gov.al ka paraqitur asistencën lidhur me kriteret e përcaktuara nga MK, duke kërkuar rivlerësimin, në të kundërt mirë argumentimin, e disa kriterëve të lidhura me kapacitetin teknik të operatorëve. Nga ana e MK N.M@kultura.gov.al është kthyer përgjigje duke sqaruar kriteret e vendosura, si dhe duke bërë me dije se është hedhur në SPE shtojca për modifikimin e DST, ku është bërë dhe ndryshimi i afatit të fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave. Nëpërmjet shkresës nr. 3252/15 prot., datë 06.09.2022, Njësia e prokurimit ka informuar Titullarin e AK lidhur me asistencën e dhënë nga APP-ja, ku i është bërë me dije se pasi u morën në shqyrtim sugjerimet, u bënë ndryshimet, si më poshtë:

Kriteri	Ishte	Bëhet
KVK, 1	Pika 1. Ofertuesi duhet të paraqesë: a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8; b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; c. <i>Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.</i>	Pika 1. ofertuesi duhet të paraqesë: a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8; b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.
KVK, 2.3.1	Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim... Shënim: Punët e ngjashme të kërkuara në kriterin e mësipërm, të realizuara nga OE duhet të kenë punime të kryera në: a) Fasadë xhami e panele/ elemente dekorativ: minimalisht 2,000 m ² ; b) Struktura të ngjashme në beton arme: minimalisht 4,000 m ³ ; c) Sistem Evac dhe Presurizimi shkalle: minimalisht 1 Kafaz shkalle.	Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim...
Afati i fundit për paraqitjen	15.09.2022, ora 10:00	26.09.2022, ora 10:00

dhe hapjen e ofertave		
-----------------------	--	--

Njësia e prokurimit ka miratuar Shtojcën për modifikimin e DST nr. 3252/16 prot., dhe nr. 3252/17 prot., (në gjuhën angleze), datë 06.09.2022 dhe ka publikuar shtojcat në SPE. Nga auditimi u konstatua se:

Në KVK 2.3.4, njësia e prokurimit ka përcaktuar se OE pjesëmarrës duhet të kenë një punësim mesatar prej 190 personash, për 3 muajt e fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës. Në argumentimin e paraqitur, njësia citon se *“dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të OE e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës”*. Kërkesa për 190 punonjës nuk është në proporcion me objektin e kontratës dhe nuk garanton realizimin e saj, kjo pasi:

- Në kriteret pararendëse, njësia e prokurimit ka kërkuar dëshmi të punëve të ngjashme në një vlerë të caktuar, për të provuar kapacitetin teknik të OE pjesëmarrës;

- Në kriteret vijuese (2.3.5, 2.3.6, 2.3.7), njësia e prokurimit ka përcaktuar stafin e nevojshëm teknik dhe inxhinierik për kryerjen e procedurës;

- Në përgjigjen me e-mail drejtuar APP-së (N.M@kultura.gov.al, data 09.07.2025, ora 17:08, drejtuar Koordinimi.App@app.gov.al), citohet se *“marrë shkas nga tipologjia e objektit të kontratës që prokurohet, kohëzgjatja e kësaj kontrate, orët e punës që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës, vendosja e kriterit për një punësim të paktën 190 persona duke përfshirë edhe stafin teknik (përafërsisht 70 punonjës në pozicionin e inxhinierëve, stafit teknik dhe shoferët e automjeteve) është në përputhje me volumin e punës dhe natyrën ku do të kryhen punimet”*. Fillimisht, sqarimi për 70 punonjës në pozicionin e inxhinierëve, stafit teknik dhe shoferët, nuk është përcaktuar në KVK, duke përcaktuar vetëm 190 punonjës, pa përcaktuar të dhëna për të argumentuar lidhjen objektive të kësaj kërkesë me realizimin e kontratës. Nga ana tjetër, inxhinierët dhe stafi teknik janë përcaktuar nominalisht në KVK nr. 2.3.5 dhe 2.3.7, ndaj përfshirja edhe njëherë e kësaj kërkesë nuk është e nevojshme.

Në KVK 2.3.5, njësia e prokurimit ka përcaktuar se OE pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierike për kryerjen e punimeve në objekt, ndër të tjerë:

- 3 inxhinierë ndërtimi (një prej të cilëve të ketë të paktën 15 vite eksperiencë);

- 2 inxhinierë mekanik (një prej të cilëve të ketë të paktën 10 vite eksperiencë);

- 1 inxhinier elektrik (një prej të cilëve të ketë të paktën 15 vite eksperiencë);

- 2 arkitekt (një prej të cilëve të ketë të paktën 10 vite eksperiencë).

Njësia e prokurimit ka dokumentuar argumentimin e stafit të nevojshëm, por në asnjë rast nuk ka argumentuar në nivel teknik *vitet e eksperiencës të kërkuara për stafin përkatës*. Në argumentim parashtrihen risqet që sjell mungesa e stafit të sipërpërmendur, por në asnjë rast lidhur me vitet e eksperiencës të kërkuar. Veprimet e mësipërme, duke mos garantuar që çdo kriter të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës dhe duke mos u argumentuar teknikisht dhe ligjërisht secilin prej tyre, janë në kundërshtim me nenin 77, pika 1, të LPP, si dhe me nenin 39, pika 4 dhe nenin 78 të RPP.

Për veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit.

Mbi sa trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nëpërmjet korrespondencës elektronike (e-mail të datës 13.03.2026), anëtarët e Njësisë së Prokurimit kanë paraqitur observacionet, si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: 1. Kërkesa për numrin e punonjësve është e lidhur ngushtësisht me objektin e kontratës. Njësia e prokurimit, në momentin kur ka hartuar kriterin përkatës, ka

përcaktuar në procesverbalin e argumentimit të kriterëve të kualifikimit se kjo kërkesë është e nevojshme për realizimin e objektit të kontratës.

Referuar procesverbalit të argumentimit, njësia e prokurimit ka argumentuar se: *“Po t’i referohemi projektit, preventivit, relacionit dhe matjeve përkatëse të kryera nga projektuesi, rezulton se numri i punonjësve është plotësisht i justifikuar”*. Gjithashtu, referuar e-mail-it të APP-së dhe përgjigjes së kthyer nga njësia e prokurimit, është sqaruar sa vijon: *“Në lidhje me pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik, të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor: ‘Një punësim mesatar i të paktën 190 (njëqind e nëntëdhjetë) personave për 3 (tre) muajt e fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës’. Marrë shkas nga tipologjia e objektit të kontratës që prokurohet, kohëzgjatja e kësaj kontrate, si dhe orët e punës që kërkojnë për përmbushjen e zbatimit të saj, vendosja e kriterit për një punësim mesatar prej të paktën 190 (njëqind e nëntëdhjetë) personash, duke përfshirë edhe stafin teknik (përafërsisht 70 punonjës në pozicionin e inxhinierëve, stafit teknik dhe shoferëve të automjeteve), është në përputhje me volumin e punës dhe me natyrën e punimeve që do të kryhen. Po t’i referohemi projektit, preventivit, relacionit dhe matjeve përkatëse të realizuara nga projektuesi, rezulton se numri i punonjësve është plotësisht i justifikuar. Kriteri për kualifikim është vendosur me qëllim që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit përkatës vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.”*

Nga sa u referua më sipër, njësia e prokurimit e ka lidhur numrin e punonjësve ngushtësisht me objektin e prokurimit, megjithatë, në vijimësi sqarojmë se njësia e prokurimit ka marrë në konsideratë konstatimin tuaj dhe do të jetë më e kujdesshme në përdorimin e terminologjisë, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit të prokurimit publik.

2. Njësia e prokurimit në procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të kualifikimit ndër të tjera ka argumentuar se....*“Nevoja për inxhinierët në objekt është diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Kërkesa specifike për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Kërkesa specifike për inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë preventivit të punimeve si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 3, kapaciteti teknik në DST”*. Në përgjigjen e përcjellë APP-së njësia ka argumentuar ... *“Lidhur me numrin e inxhinierëve dhe eksperiencën e kërkuar, sqarojmë se Njësia e Prokurimit bazuar në kërkesat dhe specifikimet teknike të projektit (i projektuar nga kompani e kontraktuar nga AK) në të cilat është kërkuar staf inxhinierik i kualifikuar, specializuar dhe me eksperiencë, i cili do të kontrollojë cilësinë në të gjitha nivelet e punimeve të cilat do të realizohen”*. Specifikisht në projekt është përcaktuar për zërin *“punime betoni dhe beton arme”* inxhinier me eksperiencë i cili do të kontrollojë cilësinë e realizimit të këtij zëri. Gjithashtu numri i inxhinierëve të ndërtimi lidhet me natyrën komplekse të punimeve në objekt si dhe nisur nga grafiku i ekzekutimit të punimeve inxhinierët e kërkuar do të punojnë njëkohësisht të ndarë sipas detyrave për realizimin në kohë të punës, konkretisht për betonin, inxhinier zbatimi për hekurin, kapriatat, etj.

Qëndrimi i grupit të auditimit: 1. Neni 39 i RPP-së, përcakton se, për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, AK kërkon listën e personelit kryesor të nevojshëm për zbatimin e objektit të prokurimit (ku nga ana e NJP është përcaktuar stafi inxhinierik dhe teknik) si dhe fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Numri mesatar i punonjësve në listëpagesa nuk përcakton fuqinë minimale punëtore, kjo pasi punonjësit në listëpagesa, në

momentin kur nuk përcaktohet asnjë specifikë mbi pozicionin e tyre, jo domosdoshmërisht përfshihet në fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Për këtë arsye, grupi i auditimit e konsideron të paargumentuar teknikisht dhe jo në lidhje me objektin e prokurimit këtë kriter. Edhe nga APP-ja është kërkuar që ky kriter të argumentohet ose të rishikohet, dhe nga MK është vijuar pa asnjë ndryshim. *Për sa më sipër, observacioni nuk merret parasysh.*

2. Grupi i auditimit, sa i përket viteve të kërkuara të eksperiencës për stafin inxhinierik ka cituar “nuk ka argumentuar në nivel teknik vitet e eksperiencës të kërkuara për stafin përkatës”, sipas përcaktimeve ligjore përkatëse. Ky argumentim kryhet gjatë fazës së hartimit dhe miratimit të DST dhe PV përkatës për hartimin dhe argumentimin e kriterëve të përcaktuara. Edhe nga APP-ja është kërkuar që ky kriter të argumentohet ose të rishikohet, dhe nga MK është vijuar pa asnjë ndryshim. Për sa më sipër, kjo pjesë e observacionit trajtohet dhe pasqyrohet në Raportin Përfundimtar të Auditimit, por nuk impakton konstatimet e grupit të auditimit.

Mbi vlerësimin e ofertave

Në momentin e hapjes së ofertave konstatohet se në procedurë ka marrë pjesë vetëm 1 OE, konkretisht B.K. sh.p.k, me ofertë ekonomike 1,000,449,285.07 lekë pa TVSH. BOE ka ngarkuar në SPE kontratën e bashkëpunimit të datës 23.09.2022, ku dakordësohet përqindja e pjesëmarrjes për realizimin e objektit të kontratës, 2 30%, K 30%, R 30% dhe B shpk 10%. Në nenin 4 të kontratës përcaktohet se OE R do të përmbushë kushtin e punëve të ngjashme për një objekt të vetëm në vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së kontratës dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit. *Në kontratë është përcaktuar gjithashtu pjesa e punës që do të kryhet nga secili, sipas përcaktimit në nenin 88, pika 1, të RPP-së, ku konstatohet se ndarja është e njëjtë për secilën prej punëve që do të kryhen, pra të gjithë operatorët do të përfshihen në të gjithë zërat e situacionit, në përpjesëtim me përqindjen e pjesëmarrjes.* Nëpërmjet shkresës nr. 5676 prot., datë 14.10.2022, Titullari i AK ka kërkuar sqarim nga BOE, pas konstatimit gjatë shqyrtimit të ofertave se dokumenti “4. Grafiku i punimeve Teatri” në përmbajtje i përket preventivit të punimeve të një objekti tjetër, ndërkohë që në Shtojcën 8 është BOE ka deklaruar përmbushjen e specifikimeve teknike dhe grafikut të realizimit të objektit të kontratës. Nga ana e BOE është kthyer përgjigje, administruar në MK me nr. 5676/1 prot., datë 18.10.2022, ku sqarohet se “gabimisht në SPE është paraqitur dokumentacion që i përket një procedure prokurimi tjetër... nëse kërkohet mund t’ju përcjellim grafikun e punimeve të detajuar... ose mund ta dorëzojmë bashkë me dokumentet e tjera në fazën e dorëzimit të dokumentacionit”.

Nëpërmjet PV nr. 3252/21 prot., datë 18.10.2022, KVO ka dokumentuar vlerësimin e procedurës së prokurimit, pas shqyrtimit të ofertës së paraqitur, duke konkluduar se oferta është e rregullt, nuk ka gabim aritmetik dhe nuk është anomalisht e ulët, për këtë arsye oferta e BOE K. shpk & B shpk & 2 shpk & R shpk, në vlerën prej 1,000,449,285.07 lekë pa TVSH dhe 1,200,539,142.08 lekë me TVSH, kualifikohet. Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE në ofertën e paraqitur, grupi i auditimit ka konstatuar se:

Sa i përket KVK 2.2.1, lidhur me xhirot vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021:

OE R dhe OE K nuk përmbushin KVK 2.2.1, ku kërkohet që OE të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019 – 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit të kontratës objekt prokurimi. Të dy këto operatorë kanë përqindje të njëjtë pjesëmarrjeje për realizimin e objektit, nga 30% secili, dhe vlera takuese për t’u tejkaluar do të ishte $(0.3 * 1,035,362,461.19 * 2 =) 621,217,476.714$ lekë. Nga vërtetimet e xhiros vjetore të ngarkuara në SPE, u konstatua se xhiro

vjetore e OE R dhe OE K në asnjë nga vitet (2019, 2020, 2021) nuk barazon/ tejkalon dyfishin e vlerës së fondit limit të kontratës (pjesës përkatëse sipas përqindjes) objekt prokurimi.

Sa i përket KVK 2.3.1, lidhur me përvojat e suksesshme në realizimin e kontratave të mëparshme:

- OE “R”, sipas përcaktimit në kontratën e bashkimit të operatorëve, duhet të paraqiste dokumentacionin për një punë të realizuar në vlerë 50% të fondit limit të kontratës brenda 5 viteve të fundit. Për këtë, ka paraqitur dokumentacionin e zbatimit të kontratës me objekt *“Objektet 1 kat dhe 2 kat me ambiente shërbimi të qendrës universitare UNIZKM dhe Rikonstruksioni i objektit ekzistues dhe shtesë...”, AK “Fondacioni Z”, 1,618,738,936.27 lekë pa TVSH, ku ka marrë pjesë si BOE me përqindje 35%. OE nuk ka ngarkuar në SPE faturat tatimore të situacionit përfundimtar.*
- OE K ka paraqitur vetëm formularin e vlerësimit dhe një vetë deklarambi realizimin e kontratave, por jo pjesën tjetër të dokumentacionit të kërkuar, si kontratë sipërmarrje, situacion përfundimtar, akt kolaudimi dhe certifikatë të marrjes në dorëzim, për objektet (i) *“Lidhja e Shkrimtarëve”, 100,797,273.24 lekë me TVSH, (ii) “Rikonstruksion i ambienteve të Kolegjit të Apelit”, 84,199,294.28 lekë me TVSH, (iii) “Rikonstruksion i hyrjes kryesore të Kolegjit të Apelit dhe Komisionerit Publik (holli)”, 9,558,985.2 lekë me TVSH, (iv) “Rikualifikim i zonës së klasit të parë dhe klasit të dytë MEPJ”, 89,855,880 lekë me TVSH, (v) “Realizimi i projektit, planimetrisë, skemave të instalimeve të brendshme të godinës së BKH-së dhe SPAK (kontratë e klasifikuar)”, 429,667,316.58 lekë pa TVSH. Gjithashtu, për realizimin e kontratës me objekt “Rikonstruksion ish Hotel Drini”, 27,200,106.6 lekë me TVSH, ku ka marrë pjesë si BOE, nuk është paraqitur kontrata e bashkimit të operatorëve dhe prokura e posaçme e deklaruar në fazën e tenderimit.*

- OE 2 ka paraqitur projektin *“Strukturë banimi dhe shërbime”* me vlerë 153,299,540 lekë. Referuar relacionit të kolaudimit, punimet kanë mbaruar në datën 08.02.2017, pra puna e kryer është jashtë periudhës 5-vjeçare.

- OE B nuk ka paraqitur dokumentacionin *“certifikatë e marrjes në dorëzim/ certifikatë e përkohshme e marrjes në dorëzim”,* për objektet (i) *“Qendër multifunksionale e shërbimeve për sipërmarrjet e reja (ISTN)”*, në vlerën prej 79,403,396 lekë me TVSH, ku ka marrë pjesë si BOE me 49% pjesëmarrje, (ii) *“Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Dora D'Istria”* në vlerën prej 81,006,137 lekë me TVSH, ku ka marrë pjesë si BOE me 34.35% pjesëmarrje.

Sa i përket KVK 2.3.2, lidhur me licencat profesionale të operatorëve, grupi i auditimit konstaton se në tërësi BOE i zotëron licencat e specifikuara, por neni 88, pika 3, i RPP-së përcakton se kërkesat për kualifikim duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi në përputhje me përqindjen dhe/ ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Fillimisht, OE K dhe OE R nuk zotërojnë disa nga licencat në kategoritë e kërkuara, sipas volumit të punimeve, si p.sh. NP2E, NS-4E, NS-8C, sidoqoftë, duke qenë se kategoria është përcaktuar nga volumi i punimeve, i cili do të përpjesëtohet ndërmjet operatorëve, pavarësisht se licencat nuk zotërohen nga secili prej operatorëve në kategoritë respektive, kjo në dukje nuk cenon kryerjen e punimeve në vetvete.

Nga ana tjetër, **OE “R” nuk zotëron licencë** NP-11 (*Ndërtim për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike*), NP-12 (*Punime të inxhinierisë së mjedisit*), NS-3 (*Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues)*), NS-12 (*Impiante teknologjike, termike dhe te kondicionimit*), NS-14 (*Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV, etj.*), NS-18 (*Punime topogjeodezike*) dhe **OE K nuk zotëron licencë** NP-11 (*Ndërtim për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike*), NS-18 (*Punime topogjeodezike*), **pavarësisht se në ndarjen e punëve rezultojnë të jenë përfshirë sipas përqindjes përkatëse në secilin prej zërave të punimeve.**

Sa i përket KVK 2.3.4, ku kërkohet që OE të ketë punësim mesatar të paktën 190 persona për 3 muajt e fundit, konstatohet se, OE pjesëmarrës në BOE kanë respektivisht numrin e punonjësve, si më poshtë:

	RGR Gr. 30%	2T 30%	KAEXH 30%	BE-IS 10%
Maj	19	281	66	159
Qershor	18	284	63	146
Korrik	18	298	61	151
Gusht	18	285	57	153

Ky kriter plotësohet në raport me përqindjet respektive ($0.3 * 190 = 57$ punonjës; $0.1 * 190 = 19$ punonjës) të OE 2 (30%), OE K (30%) dhe OE B (10%), por nuk plotësohet nga OE “R” i cili ka 18-19 punonjës për periudhën në fjalë, në mospërputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë të përcaktuar kontratën ndërmjet operatorëve.

Sa i përket KVK 2.3.5, ku përcaktohet stafi inxhinierik për kryerjen e punimeve në objekt, nga 14 staf inxhinierik të përcaktuar, OE R ka paraqitur vetëm 1 inxhinier ndërtimi dhe 1 inxhinier hidroteknik, në mospërputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë të përcaktuar kontratën ndërmjet operatorëve.

Sa i përket KVK 2.3.7, ku përcaktohet se OE duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, ku citohet se “për sa më sipër operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr. 8”, OE “K.” dhe OE “R” nuk kanë përfshirë stafin teknik sipas këtij KVK në Formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr. 8, por vetëm stafin inxhinierik sipas KVK 2.3.5. Nga dokumentacioni i ngarkuar në sistem, rezulton se OE “K” ka ngarkuar në SPE dokumentacion për vetëm 3 punonjës staf teknik (2 elektrikistë dhe 1 hidraulik) nga 22 staf teknik të kërkuar, ndërsa OE “R” nuk ka ngarkuar në SPE asnjë punonjës staf teknik, në mospërputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë të përcaktuar kontratën ndërmjet operatorëve.

Sa i përket KVK 2.3.10, ku përcaktohen mjetet dhe pajisjet që OE duhet të disponojë për realizimin e kontratës, nga 24 artikuj të përcaktuar në tabelë në sasi totale 57 copë (mjete dhe pajisje, pa përfshirë zyrën e kantierit dhe skeleritë në njësi matëse m²), (i) OE R ka paraqitur gjithsej 3 artikuj në sasi totale 3 copë gjithsej (1 kamionçinë, 1 miniekskavator, 1 vinç kullë me krah 50m me kapacitet në majë 1 ton) dhe (ii) OE “K” ka paraqitur gjithsej 4 artikuj në sasi totale 6 copë (2 gjeneratorë, 1 saldatriçe, 1 kompresor ajri, 2 matrapikë), në mospërputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë të përcaktuar kontratën ndërmjet operatorëve.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka kualifikuar ofertën në kundërshtim me nenin 82, pika 2, të RPP-së, pavarësisht mosplotësimit të kriterëve të përcaktuara në DST. Për veprimet e mësipërme, ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e KVO.

Titullari i AK ka miratuar Raportin përmbledhës nr. 3252/22 prot., datë 24.10.2022, për procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtimi i një objekti/ qendre të re multifunksionale në funksion të së ardhmes së edukimit artistik të fëmijëve në kryeqytet, pranë QKKF dhe Teatrit të Kukullave”. BOE ka paraqitur formularin e sigurimit të kontratës, administruar në MK me nr. 5922 prot., datë 27.10.2022.

Ndërmjet AK dhe BOE është lidhur kontrata nr. 3252/25 prot., datë 10.11.2022, me afat 24 muaj nga hyrja në fuqi e kontratës, në vlerën prej 1,000,449,285.07 lekë pa TVSH dhe 1,200,539,142.08 lekë me TVSH.

Mbi sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nëpërmjet shkresës administruar në KLSH me nr. 951/24 prot., datë 12.03.2026, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave kanë paraqitur observacionet, si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: 1. Qëndrimi ynë teknik mbetet i pandryshuar dhe i bazuar në argumente profesionale teknike dhe interpretim të kujdesshëm të materialeve dhe elementeve të trajtuara në dokumentacion. Observacionet e paraqitura nga ana jonë trajtojnë çështje që lidhen drejtpërdrejt me vlerësimin teknik të objektit në shqyrtim dhe për rrjedhojë vlerësojmë se ato përbëjnë elemente të rëndësishme për një analizë sa më të plotë të çështjes. Në përgjithësi është pranuar se edhe në rastet kur pjesëmarrësit në operacionin ekonomik (OE) nuk kanë detyrimin për të plotësuar kapacitetet e munguara, ata mbeten gjithsesi përgjegjës në mënyrë të pavarur dhe të plotë për garantimin e realizimit të objektit të kontratës/ projektit. Kjo përgjegjësi përfshin sigurimin që zbatimi të kryhet me cilësinë e kërkuar dhe në përputhje të plotë me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentacionin përkatës.

2. Punimet e ndërtimit janë procese multidisiplinare, të integruara dhe të pandashme, të cilat realizohen përmes bashkëveprimit të vazhdueshëm të stafit, ato nuk mund të vlerësohen bazuar në përqindjet e përcaktuara në kontratat e bashkëpunimit, por kërkojnë bashkimin efektiv të kapaciteteve njerëzore dhe teknike për të garantuar realizimin cilësor dhe të plotë të objektit. Bashkëpunimi në kuadër të BOE-s mbështetet nga njëra anë në përcaktimin e përqindjeve të pjesëmarrjes më karakter kryesisht ekonomik dhe nga ana tjetër në parimin e solidaritetit teknik dhe operacional sipas të cilit operatorët plotësojnë dhe mbështesin njëri tjetrin në staf, ekspertizë, mjete, makineri dhe punime specifike gjatë gjithë fazës së zbatimit të kontratës. Vlerësimi që kam kryer në cilësinë e anëtares së KVO-së dhe specialistes së fushës së ndërtimit është bazuar mbi kapacitetin total dhe të integruar të BOE-s, duke respektuar parimin e solidaritetit teknik dhe operacional.

Në nenin 36, pika 5 të LPP-së përcaktohet se në rast se AK përcakton specifikimet teknike, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente. Në nenin 92, pika 3 të LPP-së përcaktohet se AK vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe dokumentet e tenderit. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera. Në nenin 8 të kontratës së bashkëpunimit datë 23.09.2022 përcaktohet se *“secili prej pjesëtarëve të këtij bashkimi operatorësh është individualisht dhe solidarisht bashkëpërgjegjës përballë AK dhe ligjit për çdo gjë që ka lidhje me kontratën. Secili prej pjesëtarëve të këtij bashkimi, në rast nevojë dhe në rast se ka mundësi, vë në dispozicion të pjesëtarëve të tjerë të këtij bashkimi kapacitetet e tepërta apo të lira të çdo lloji që ai mund të disponojë”*... Pra, palët kanë rënë dakord që burimet njerëzore dhe teknike të lëvizin sipas nevojës së objektit, jo sipas tabelave të përqindjes financiare, duke mos imponuar një ndarje që vetë marrëveshja e bashkimit e ka lënë fleksibël në të mirë të punës. Si konkluzion, BOE është trajtuar si një ofertues i vetëm, me dokumentacion të plotë, ku kapacitetet e tyre teknike janë marrë në konsideratë në mënyrë të kumuluar dhe janë planifikuar të përdoren në mënyrë dinamike dhe fleksible, në përputhje me ligjin dhe kushtet e marrëveshjes së bashkëpunimit.

3. Sa i përket KVK 2.3.2 (lidhur me licencat profesionale) duke qenë se kategoritë e licencave janë përcaktuar nga volumi i punimeve, pavarësisht se disa prej kategorive të licencave nuk zotërohen nga disa prej OE-ve, kjo nuk çënon kryerjen e punimeve në vetvete. Megjithatë, në kuptimin teknik BOE i zotëron të gjitha kategoritë e licencave, kjo nuk çënon kryerjen e punimeve pasi thelbi funksional i BOE-s qëndron në bashkimin dhe komplementaritetin e kapaciteteve teknike. Vlerësimi teknik në mënyrë të fragmentuar do të deformonte vetë funksionin e BOE-s, i cili merr

kuptimin ekzistencial pikërisht për të bashkuar kapacitete të shpërndara dhe për t'i vënë ato në funksion të një objekti të vetëm kontraktual.

4. Sa i përket KVK 2.3.4 (lidhur me punësimin mesatar prej 190 punonjësish) në bazë të kontratës shoqëritë kanë të drejta dhe tagrin të vendosin në dispozicion gjatë fazës së realizimit të punimeve në varësi të natyrës së punimeve, mungesa apo plotësime sa i përket stafit teknik, fuqisë punëtore, specialistë, etj. Pra, në varësi të nevojave që do të lindin, BOE arrin realizimin e punimeve sipas objektit të prokurimit.

5. Sa i përket KVK 2.3.5 (lidhur me stafin inxhinierik) dhe KVK 2.3.7 (lidhur me stafin teknik), këto kriterë kanë për objekt sigurimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale të nevojshme për realizimin e plotë dhe korrekt të të gjithë zërave të preventivit, përmes vënies në dispozicion të një stafi inxhinierik/ teknik, si tërësi teknike funksionale. Nga pikëpamja teknike, specialitetet inxhinierike nuk janë të ndashme proporcionalisht sipas përqindjeve të pjesëmarrjes, pasi lidhen me zëra konkretë dhe specifikë të preventivit, të cilët kërkojnë prezencë profesionale të plotë jo të pjesshme. Nuk është teknikisht e mundur dhe as e arsyeshme që një inxhinier i një specialiteti të caktuar të përpjesëtohet në funksion të përqindjes së pjesëmarrjes së operatorit në kontratë. Për më tepër, DST nuk parashikojnë në asnjë rast detyrimin që stafi inxhinierik/ teknik të ndahet sipas përqindjeve të pjesëmarrjes në BOE, por kërkojnë që ky staf të vihet në dispozicion për realizimin e kontratës. Edhe për stafin teknik, të 4 shoqëritë pjesëmarrëse të marra së bashku e përmbushin kërkesën për stafin teknik të përcaktuar, duke garantuar kapacitetet e nevojshme njerëzore për realizimin e objektit të prokurimit. Për rrjedhojë, të gjithë zërat e preventivit dhe punimet objekt të prokurimit realizohen nga BOE në tërësi dhe jo nga secili operator në mënyrë të pavarur.

6. Sa i përket KVK 2.3.10 (mjetet dhe pajisjet), ky kriter nuk mund dhe nuk duhet të vlerësohet përmes një grumbullimi aritmetik të mjeteve dhe pajisjeve në një total sasior, pasi mjetet dhe pajisjet e kërkuara nuk janë homogjene, nuk kanë funksion të njëjtë dhe nuk janë të zëvendësueshme ndërmjet tyre. Për rrjedhojë ndarja e tyre sipas përqindjeve të përcaktuara nuk është teknikisht e aplikueshme dhe as e realizueshme në praktikë. Një ndarje e tillë do të ishte formale dhe pa asnjë vlerë funksionale për realizimin real të kontratës. Në këtë kuadër, disponimin i mjeteve dhe pajisjeve nga një pjesë e operatorëve të BOE-s i shoqëruar me kontratë bashkëpunimi të nënshkruar prej tyre garanton plotësisht përmbushjen e kriterit, pasi mjetet janë funksionalisht të aksesueshme dhe të përdorshme nga të gjithë operatorët për realizimin e kontratës.

7. Sa i përket KVK 2.2.1 (xhiroja vjetore), në BOE kriteret vlerësohen në mënyrë kumulative, përveç rasteve kur në DST thotë shprehimisht ndryshe. Ky kriter ka natyrë financiare dhe në DST nuk është parashikuar ndarje proporcionale e këtij kriteri sipas përqindjes së pjesëmarrjes në BOE.

8. Sa i përket KVK 2.3.1 (eksperiencat e mëparshme), KVO ka vlerësuar si devijime të vogla mangësitë në dokumentacionin mbi punët e ngjashme, për rrjedhojë ka vijuar me kualifikimin e operatorit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Neni 88, pika 3, e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcakton në mënyrë eksplicite se kërkesat për kualifikim duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi **në përputhje me përqindjen dhe/ ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në aktmarrëveshje.** Në kontratën e datës 23.09.2022 të ngarkuar në SPE, dakordësohet përqindja e pjesëmarrjes për realizimin e objektit të kontratës, “2” SHPK 30%, “K” SHPK 30%, “R” 30% dhe “B” shpk 10%. Në kontratë është përcaktuar gjithashtu pjesa e punës që do të kryhet nga secili, sipas përcaktimit në nenin 88, pika 1, të RPP-së, ku konstatohet se **ndarja është e njëjtë për secilën prej punëve që do të kryhen, pra të gjithë operatorët do të përfshihen në të gjithë zërat e situacionit, në përpjesëtim me përqindjen e pjesëmarrjes.** Për sa më sipër, nuk ka nevojë që të ketë një

përcaktim shtesë në DST se si do të kryhet vlerësimi i ofertës së paraqitur nga BOE, pasi kjo është përcaktuar në dispozitën e sipërcituar. Në kundërshtim me pretendimet tuaja, **dispozita përcakton nominalisht se të gjitha kërkesat për kualifikim, qofshin ato ekonomike, financiare, profesionale dhe teknike, duhet të vlerësohen në atë mënyrë.**

Në nenin 8 të kontratës, ku përcaktohet përgjegjësia brenda bashkimit të operatorëve, përcaktohet se **në rast nevojë dhe në rast se ka mundësi**, vë në dispozicion të pjesëtarëve **kapacitetet e tepërta apo të lira** të çdo lloji. Thënë këtë, fillimisht “*në rast nevojë*”, nënkupton situata ku mund të lindë nevoja përgjatë zbatimit të kontratës, dhe jo të merret *a priori* si detyrim për të plotësuar kapacitetet që mungojnë nga operatorët pjesë të BOE. Së dyti, “*në rast se ka mundësi*” është një klauzolë e papranueshme për të konsideruar të plotësuar kriterin. Kjo pasi vlerësimi i ofertës duhet të jetë i tillë që vetëm shkaqet madhore të përbëjnë shkak për mosrealizim të kontratës sipas kushteve, dhe jo pranimi i ofertës ku pjesëtarë të BOE-s nuk provojnë kapacitetet sipas përqindjes së ndarjes dhe kontrata të riskohet në rast se operatorët e tjerë nuk kanë mundësi të ndihmojnë në plotësimin e kapaciteteve, të cilët nuk kanë detyrim përderisa kanë ndërmarrë një angazhim *në një përqindje të caktuar*. Së treti, e njëjta logjikë rrjedh edhe për përcaktimin se do të vihen në dispozicion “*kapacitetet e tepërta apo të lira*”, pra në momentin që kapacitetet e operatorëve të tjerë që plotësojnë specifikimet sipas përqindjes **nuk janë të tepërta ose nuk janë të lira**, ato nuk kanë asnjë detyrim të plotësojnë kapacitetet e munguara të operatorëve që nuk i plotësojnë këto kapacitete.

Gjithë sa më sipër, përveç faktit se oferta nuk duhej të ishte kualifikuar për shkak se vlerësimi duhet të kryhej sipas përcaktimeve ligjore, mbart risk të lartë që kontrata të mos realizohet sipas përcaktimeve e kushteve në DST e në kontratë.

Sa i përket pretendimit në observacion se mungesa e dokumentacionit të plotë për KVK 2.3.1 (eksperiencat e mëparshme) vlerësohet si devijim i vogël nga ana e KVO-së, ky pretendim nuk është pasqyruar në procesverbalin nr. 3252/21 prot., datë 18.10.2022, ku pas shqyrtimit dhe vlerësimit KVO ka konkluduar se “*oferta është e rregullt, nuk ka gabim aritmetik dhe nuk është anomalisht e ulët*”.

Për sa më sipër, observacioni nuk merret parasysh.

3. Procedura e prokurimit me objekt Restaurim për ndërtesën e Aneksit të Bibliotekës Kombëtare (Faza III)

Procedura e konkurrimit publik “Restaurim për ndërtesën e Aneksit të Bibliotekës Kombëtare (Faza III)”, 2022		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 659, datë 29.09.2022	3. Projekt-ideja dhe fondi limit Urdhër nr. 439, datë 15.07.2022 - A. O, arkitekt; - V. G, inxh. Elektrik (eksp. i jashtëm); - D. G, inxh. Mekanik (sp. PMNZH).	4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Urdhër nr. 659, datë 29.09.2022 - P.M; - H.Sh (arkitekt); - Ll. B (arkitekt).
2. Lloji i Procedurës “Konkurrim publik”, bazuar në VKM-në nr. 425, datë 27.05.2020, i ndryshuar	Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Konkurrimit Publik Urdhër nr. 659, datë 29.09.2022 - O.P (arkitekt); - N.M; - I.Y.	
5. Fondi Limit (pa TVSH) 30,110,943.84 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) 29,624,440.35 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 486,503.49 lekë (0.02%)

8. Data e publikimit të procedurës 03.10.2022	9. Burimi i financimit Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender: 1 BOE b) Skualifikuar: -
11. Ankimime AK: -		
12. Lidhja e kontratës Nr. 5317/15 prot., datë 03.11.2022	13. Vlera e kontratës (me TVSH) 35,549,328.42 lekë	14. Afati i kontratës 9 javë nga hyrja në fuqi e kontratës

Kjo procedurë është kryer bazuar në VKM-në nr. 425, datë 27.05.2020 “Për procedurat e përzgjedhjes së subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore”, i ndryshuar.

Nëpërmjet Urdhrit nr. 439, datë 15.07.2022, Sekretari i Përgjithshëm i MK ka krijuar komisionin për hartimin e projekt-idesë fillestare dhe përllogaritjen e fondit limit për fillimin e procedurës me objekt “Restaurimi i ndërtesës së fondit të Bibliotekës Kombëtare (Faza III)”, të përbërë nga z.A. O (arkitekt), z. V. G (inxhinier elektrik, ekspert i jashtëm) dhe znj. D. Gj (inxhinier mekanike, specialiste PMNZH). Ky komision ka hartuar projekt-idenë dhe një preventiv me punime ndërtimore, pajisje elektrike dhe mobilim. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se grupi i punës ka kryer studim tregu zërat e përfshirë në preventiv, për të përllogaritur fondin limit të sipërcituar. Nëpërmjet shkresës nr. 4925/2 prot., datë 09.08.2022, grupi i punës ka përcjellë projekt-idenë dhe përllogaritjen e fondit limit për procedurën e konkurrimit publik, me vlerë totale të përllogaritur prej 30,110,943.84 lekë pa TVSH. Nga auditimi nuk u konstatuan parregullsi në lidhje me procedurën e ndjekur për përllogaritjen e fondit limit.

Nëpërmjet Urdhrit nr. 5317/1 prot., nr. 659, datë 29.09.2022, Titullari i AK ka kërkuar zhvillimin e procedurës së konkurrimit publik, me fond limit 30,110,943.84 lekë pa TVSH, duke ngritur komisionet, si më poshtë:

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO), i përbërë nga z. P.M, znj. H. Sh (arkitekt), z. Ll. B (arkitekt);

- Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Konkurrimit Publik (NJHDKP), e përbërë nga z. O P (arkitekt), znj. N. M dhe znj. I.Y.

NJHDKP ka dokumentuar hartimin dhe argumentimin e DKP-së nëpërmjet PV të datës 29.09.2022, i pa protokolluar, si dhe miratimin e DKP-së nëpërmjet PV nr. 5317/2 prot., datë 29.09.2022. Sa i përket Kriterit të Përgjithshëm për Kualifikim në germën ë, lidhur me licencën për projektim, zbatim, mbikëqyrje ose kolaudim, NJHDKP ka përcaktuar se në rastin e BOE-s, secili prej anëtarëve duhet ta plotësojë, por në dokumentacionin e përcaktuar për t’u paraqitur për plotësimin e këtij kriteri, është përcaktuar “*Subjekti duhet të jetë i pajisur me licencë... ose të krijojë bashkëpunim kontraktual me një subjekt të licencuar, për realizimin e kontratës dhe të paraqesë një kontratë bashkëpunimi*”, duke bërë që ky kriter të mos jetë kufizues në rastet e bashkimit të operatorëve kur jo të gjithë operatorët disponojnë licencë për pasuritë kulturore të lëshuar nga Ministria e Kulturës. Sa i përket kriterit mbi punë të ngjashme në pasuri kulturore, ky kriter është përcaktuar të plotësohet bashkërisht, pra jo domosdoshmërisht nga secili prej operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në bashkim, sipas përcaktimit në Udhëzimin nr. 269, datë 11.08.2020, i ndryshuar. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, i administruar në praktikën përkatëse të secilës prej procedurave të sipër listuara, nuk rezulton të ketë pasur ankime nga operatorë ekonomikë lidhur me hartimin e dokumenteve të konkurrimit publik dhe/ ose vlerësimin e ofertave. KVO ka dokumentuar hapjen e ofertave nëpërmjet PV nr. 5317/6 prot., datë 19.10.2022,

ku ka rezultuar se është paraqitur një kërkesë për pjesëmarrje nga BOE K dhe V shpk, me ofertë ekonomike 29,624,440.35 lekë pa TVSH. Nëpërmjet PV nr. 5317/7 prot., datë 27.10.2022, KVO ka dokumentuar shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës, duke konkluduar se oferta e dorëzuar nga BOE kualifikohet, pasi plotëson të gjithë dokumentet e kërkuar në DSKP. Ndërmjet K dhe V është lidhur kontrata e bashkëpunimit nr. rep. 10442, nr. kol. 6802, datë 18.10.2022, ku janë përcaktuar pjesët e punimeve që do të marrë përsipër secili nga anëtarët e këtij bashkimi, por jo pjesa në përqindje e totalit. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nuk u konstatuan parregullsi lidhur me shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit të paraqitur nga BOE, në raport me kriteret për kualifikim dhe DSKP. Raporti përmbledhës i procedurës së konkurrimit publik nr. 5317/10 prot., datë 28.10.2022, është nënshkruar anëtarët e KVO dhe është miratuar nga Titullari i AK, për dijeni Ministri i Kulturës. Ndërmjet AK dhe BOE është lidhur kontrata publike për investime në pasuritë kulturore nr. 5317/15 prot., datë 03.11.2022, me vlerë 29,624,440.35 lekë pa TVSH dhe 35,549,328.42 lekë me TVSH, me afat për realizimin e punimeve 9 javë.

Viti 2023

4. Procedura e prokurimit me objekt Ndërhyrje emergjente në objektin Monument Kulture Kategorisë I, Ura e Matit

Kjo procedurë është kryer bazuar në VKM-në nr. 425, datë 27.05.2020 “Për procedurat e përzgjedhjes së subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore”, i ndryshuar.

Nëpërmjet Vendimit nr. 56 datë 13.02.2023, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale ka miratuar projektin “Hartimi i projektit teknik të zbatimit për ndërhyrje emergjente në objektin Monument Kulture Ura e Matit”, me aplikues dhe zhvillues Ministrinë e Kulturës/ IKTK, duke bashkëlidhur preventivin paraprak të hartuar nga grupi i punës i Universitetit Politeknik të Tiranës, ku është përcaktuar vlera totale e preventivit prej 46,663,423 lekë pa TVSH. Nëpërmjet VKM nr. 202, datë 07.04.2023, është miratuar shtesa e fondit në buxhetin e Ministrisë së Kulturës për financimin e projektit teknik të ndërhyrjes emergjente në objektin Monument Kulture të Kategorisë I “Ura e Matit”, fond i cili përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2023. Ministria e Kulturës ka iniciuar disa procedura të konkurrimit publik për këtë objekt, rezultuar të pasuksesshme, si më poshtë:

Nr.	Urdhër prokurimi	OE pjesëmarrës	Oferta ekonomike	Statusi	Arsyeja
1	5045 prot., nr. 592, 02.10.2023	1. AI	46,073,960,66	S’kualifikuar	Gabim mbi 2% në ofertë
2	5526 prot., nr. 676, 26.10.2023	1. AI	44,709,495.9	S’kualifikuar	Mosplotësim i kriterëve të veçanta të kualifikimit
3	5760 prot., nr. 713, 09.11.2023	(Nuk ka)	-	-	
4	5930 prot., nr. 740, 17.11.2023	(Nuk ka)	-	-	
5	6039 prot., nr. 762, 23.11.2023	1. BOE “G”, “M”, “R”	46,164,300	S’kualifikuar	Mosplotësim i kriterëve të veçanta të kualifikimit
6	6218 prot., nr. 796, 07.12.2023	(Nuk ka)	-	-	

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk rezulton që Autoriteti Kontraktor të ketë analizuar shkaqet që kanë çuar në dështimin e procedurës 6 herë, sic parashikohet në nenin 93 të RPP-së, *për të siguruar konkurrencën në procedurën e konkurrimit publik*, por ka vijuar në çdo rast me fillimin e procedurës së re me të njëjtat kushte e kritere. Ky proces për të garantuar sigurimin e konkurrencës nuk është i parashikuar në VKM nr. 425, datë 27.05.2020, i ndryshuar, por vazhdimisht NJHDKP i referohet për analogji RPP-së gjatë fazës së hartimit të kritereve për kualifikim dhe dokumenteve të konkurrimit publik. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, i administruar në praktikat përkatëse të secilës prej procedurave të sipër listuara, nuk rezulton të ketë pasur ankime nga operatorë ekonomikë lidhur me hartimin e dokumenteve të konkurrimit publik dhe/ ose vlerësimin e ofertave.

Asnjë nga praktikat e mësipërme nuk rezulton të jetë inventarizuar dhe arkivuar, në kundërshtim kjo me nenin 21 të Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, duke riskuar dëmtimin dhe humbjen e dokumentacionit të gjeneruar për secilën prej tyre.

Procedura e realizuar

Procedura e konkurrimit publik “Ndërrhyrje emergjente në objektin Monument Kulture Kategoria I, Ura e Matit”, 2023		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 816, datë 13.12.2023	3. Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Konkurrimit Publik Urdhër nr. 816, datë 13.12.2023 - M. S; - G. K; - R.C.	4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Urdhër nr. 816, datë 13.12.2023 - A. Sh; - A. K; - E. M.
2. Lloji i Procedurës “Konkurrim publik”, bazuar në VKM-në nr. 425, datë 27.05.2020, i ndryshuar		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 46,663,423 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) 46,659,645 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 3,778 lekë (0%)
8. Data e publikimit të procedurës 18.12.2023	9. Burimi i financimit Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender: 1 BOE b) Skualifikuar: -
11. Ankimime AK: -		
12. Lidhja e kontratës Nr. 6367/9 prot., datë 27.12.2023	13. Vlera e kontratës (me TVSH) 55,991,574 lekë	14. Afati i kontratës 30 ditë

Praktika nuk rezulton të jetë inventarizuar (me përjashtim të dokumentacionit të përcjellë nga BOE) dhe arkivuar, në kundërshtim kjo me nenin 21 të Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, duke riskuar dëmtimin dhe humbjen e dokumentacionit të gjeneruar për secilën prej tyre. Nëpërmjet Urdhrit nr. 6367 prot., nr. 816, datë 13.12.2023, Titullari i AK ka kërkuar zhvillimin e procedurës së konkurrimit publik, me fond limit 46,663,423 lekë pa TVSH, duke ngritur komisionet, si më poshtë:

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO), i përbërë nga znj. A. Sh, znj. A. K, znj. E.M;
- Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Konkurrimit Publik (NJHDP), e përbërë nga z. M. S, znj. G. K, znj. R. C.

Titullari i AK ka nënshkruar Formularin e njoftimit të konkurrimit publik nr. 6367/1 prot., datë 14.12.2023, duke përcaktuar hapjen e ofertave në datën 21.12.2023. Njoftimi është publikuar në

Buletinin e APP-së nr. 101, datë 18.12.2023 (faqet 749-750), ku citohet: “Afati dhe mënyra për tërheqjen e dokumenteve të konkurrimit publik: Kandidatët e interesuar mund të tërheqin dokumentet e procedurës së konkurrimit nga faqja zyrtare e website të Ministrisë së Kulturës”. Në seksionin përkatës në faqen zyrtare të Ministrisë së Kulturës (<https://meki.gov.al/newsrooms/>), nuk identifikohet publikimi i kësaj shpalljeje, ndërkohë që lidhur me këtë procedurë, evidentohet vetëm publikimi i njëres prej procedurave të mëparshme (të dështuar) (<https://meki.gov.al/newsroom/konkurrim-publik-me-objekt-nderhyrje-emergjente-ne-objektin-monument-kulture-ura-e-matit/>), ku përcaktohet se afati i fundit për hapjen e ofertave është data 19.10.2023. Edhe në këtë procedurë, gjatë klikimit mbi dokumentacionin e ngarkuar, shfaqet shënimi “404: Faqja të cilën kërkuat nuk u gjet”.

NJHDKP ka dokumentuar hartimin e dokumenteve për konkurrimin publik nëpërmjet PV nr. 6367/3 prot., datë 18.12.2023 dhe miratimin e dokumenteve të konkurrimit publik nëpërmjet PV nr. 6367/4 prot., datë 18.12.2023. Në pikën 4 të Kriterëve të posaçme përcaktohet se: “OE duhet të ketë një punësim mesatar të të paktën 10 personave, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit...”. Në argumentimin shoqërues citohet se “numri i punëtorëve dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën, si dhe kohëzgjatjen... gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore...”. Ky kriter nuk është i argumentuar në nivel teknik, kjo pasi mënyra e përcaktimit dhe dokumentacioni i kërkuar nuk kërkojnë fuqi punëtore ose staf punëtorë, por punonjës që figurojnë në listë-pagesa, të cilët në mungesë të përcaktimit mund të jenë staf administrativ, që nuk lidhen me realizimin e punimeve. Në pikën II të Kriterëve të Përgjithshme të Kualifikimit, NJHDKP ka përcaktuar se “Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë...secili prej anëtarëve duhet të përmbushë kriteret sipas parashikimeve në dokumentet e procedurës së konkurrimit, **të listuara më sipër**”. Ky kriter është në kundërshtim me Udhëzimin e Zëvendësministrit të Kulturës nr. 269, datë 11.08.2020 “Për miratimin e dokumenteve standarde të konkurrimit publik...”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 285, datë 27.08.2020, ku kriteri i sipërcituar vijon: “...përkatësisht gerrat a, b, c, ç, ndërsa kriteret e përcaktuara në gerrat d, dh, e, ë, kriteret do të plotësohen bashkërisht nga i gjithë bashkimi i operatorëve, sipas natyrës së punimeve që marrin përsipër në aktmarrëveshjen e bashkëpunimit”. Për këtë kriter, NJHDKP i është referuar versionit fillestar të Udhëzimit nr. 269, datë 11.08.2020 dhe jo aktit të përditësuar. Ndër kriteret të cilat DSKP i përcakton si të detyrueshme për t’u plotësuar nga secili prej anëtarëve të BOE, përfshihen (d) subjekti duhet të jetë i pajisur me licencë të lëshuar nga Ministria e Kulturës dhe (dh) subjekti të ketë përvojë të mëparshme në kryerjen e ndërhyrjeve në pasuritë kulturore, ndërkohë që Udhëzimi i Ministrit nr. 269, datë 11.08.2020, pas përditësimit me udhëzimin nr. 285, datë 27.08.2020, i përcakton si të detyrueshme për t’u plotësuar bashkërisht (pra mjafton që njëri nga OE t’i plotësojë, në varësi të natyrës së punimeve që marrin përsipër). Ky kriter ka mbetur i pandryshuar edhe në 6 procedurat e konkurrimit publik për të njëjtin objekt të sipërlistuar, të mbyllura pa fitues. Sipas formulimit të kriterit në DSKP, në rastin e bashkimit të operatorëve, secili prej operatorëve pjesëmarrës në bashkim duhet të disponojë licencë të lëshuar nga MK dhe eksperiencë të mëparshme (punë të ngjashme) në pasuri kulturore. Ky kriter kufizon konkurrencën në procedurën e konkurrimit publik, kjo pasi nga të dhënat e publikuara në Regjistrin e licencave në veprimtari ndërhyrëse në pasuri kulturore, aktualisht (duke përfshirë edhe subjektet e licencuar në vitet e mëvonshme, pra nga viti 2023 deri në dhjetor 2025) rezultojnë që disponojnë licencë në

zbatim (i) 37 persona juridikë (azhornuar shtator 2025⁷), ndër të cilët vetëm 28 disponojnë licencën për kategorinë N-Z/A/4 sipas kërkesës, dhe (ii) 1 person fizik (azhornuar mars 2025⁸), por jo në kategorinë e kërkuar. Për veprimet e mësipërme, ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e Njesisë për Hartimin e Dokumenteve të Konkurrimit Publik.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, i administruar në praktikën përkatëse të procedurës së konkurrimit publik, nuk rezulton të ketë pasur ankime nga operatorë ekonomikë lidhur me hartimin e dokumenteve të konkurrimit publik. KVO ka dokumentuar hapjen e ofertave nëpërmjet PV nr. 6367/5 prot., datë 01.12.2023, ku ka rezultuar se është paraqitur 1 kërkesë për pjesëmarrje nga BOE ANK shpk dhe Ad-S shpk, me ofertë ekonomike 46,659,645 lekë pa TVSH. Nëpërmjet PV nr. 6367/6 prot., datë 22.12.2023, KVO ka dokumentuar shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave, duke konkluduar se oferta ekonomike e dorëzuar nga BOE kualifikohet, pasi plotëson të gjithë dokumentat e kërkuar në DSKP.

Në analogji me nenin 75, pika 4, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 (pasi VKM-ja nr. 425, datë 27.05.2020 nuk e detajon procedurën e ndjekur në këto raste), Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk rezulton të ketë kërkuar sqarime nga Njësia për Hartimin e Dokumenteve të Konkurrimit Publik lidhur me përcaktimin e pikës II të Kriterëve të Përgjithshme të Kualifikimit, sa i përket bashkimit të operatorëve ekonomikë, si dhe nuk rezulton t'i ketë propozuar Titullarit të AK anulimin e procedurës me arsyen se kriteri i vendosur është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 269, datë 11.08.2020, i ndryshuar.

Ndërmjet A dhe Ad është lidhur kontrata e bashkëpunimit nr. rep. 11101, nr. kol. 2202, datë 21.12.2023, ku është përcaktuar se pjesëmarrja e kompanive do të jetë përkatësisht 48.81% A dhe 51.19% Ad, duke pasqyruar në Aneksin 1 ndarjen e detajuar të punëve/ shërbimeve për objektin “Ndërhyrje emergjente në objektin Monument Kulture “Ura e Matit””.

Nga auditimi u konstatua se njëri nga operatorët ekonomikë nuk plotëson kriteret e përgjithshme për kualifikim, të përcaktuar në DSKP të detyrueshme për t'u plotësuar nga secili prej operatorëve, si më poshtë:

- OE A nuk është i licencuar për projektim, zbatim, mbikëqyrje ose kolaudim në pasuritë kulturore, veprim ky në kundërshtim me pikën e të Kriterëve të përgjithshme për kualifikim në DSKP.

- Për përvojë të mëparshme, OE A ka paraqitur zbatimin e kontratës nr. 6160/5, datë 08.10.2020 me objekt “Ndërtim rruga Korçë – Ersekë, Loti IP”, me vlerë kontrate 2,822,415,011 lekë me TVSH, të lidhur ndërmjet ARRSH dhe OE A shpk, si dhe dokumentacionin plotësues. Objekti i kësaj kontrate nuk lidhet me pasuritë kulturore, në kundërshtim me pikën f të Kriterëve të përgjithshme për kualifikim në DSKP, rrjedhimisht nuk duhej të ishte pranuar si punë e ngjashme. Pavarësisht sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk rezulton të ketë identifikuar mospërputhjet e mësipërme me përcaktimet në DSKP dhe ka vijuar me kualifikimin e ofertës së paraqitur nga BOE A shpk dhe Ad shpk pa plotësuar kriteret e vendosura në DSKP për ofertuesit që paraqiten si bashkim operatorësh ekonomikë. Për veprimet e mësipërme ngarkohen më përgjegjësi anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Viti 2024

5. Procedura e prokurimit me objekt Ndërtimi i ri i shkollës së mesme profesionale Karl Gega, Tiranë

⁷ <https://iktk.gov.al/wp-content/uploads/2025/09/Lista-e-Personave-Juridik-te-licencuar-ne-zbatim-azhornuar-Shtator-2025-1.pdf>

⁸ <https://iktk.gov.al/wp-content/uploads/2025/09/Lista-e-Personave-Fizik-te-licencuar-ne-zbatim-azhornuar-2025-1.pdf>

Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Ndërtimi i ri i shkollës së mesme profesionale Karl Gega, Tiranë”, REF- 30350-11-20-2024		
1. Urdhër Prokurimi 2.1 Lloji i Kontratës Realizimi i punimeve, Punime me matje. 2..2 Lloji i Procedurës “Procedurë e Hapur”, format elektronik 2.3. Kriteri i vlerësimit Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në çmim	3. Përlllogaritja e vlerës së Fondit Limit dhe Specifikimet teknike Njësia e Prokurimit - znj. G. K – Person përgjegjës për prokurimin z. A. C – Specialist i fushës për prokurimin z. M.I – Specialist i fushës për prokurimin	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave z. I. L z. B.T znj. N.M
5. Fondi Limit (pa TVSh) 329,526,334 lekë 5.1 Afati 36 muaj	6. Oferta e kualifikuar e para L K & V K Kontrata datë 02.04.2025 me vlerë 261,024,609 lekë me TVSH	
8. Data e hapjes së tenderit 06.12.2024, ora 10:00	9. Burimi Financimit Buxheti i shtetit	10. Operatorët Ekonomikë (oferta lekë pa TVSH & pikët të renditur sipas vlerës së ofertës) <u>Pjesëmarrës (19 OE):</u> I- 214,024,666 L & V - 217,520,507 D- 218,129,853 ED- 226,627,207 AR- 226,723,849 NI - 227,278,405 LL - 230,286,219 L.T- 235,913,104 AL - 236,053,948 IN- 239,517,142 HA- 245,607,074 AS- 249,059,856 PE- 251,987,210 DA- 255,647,264 AU- 269,600,000 KE- 270,128,457 RA - 273,556,875 AD - 278,008,925 RE - 278,076,008 <u>S’kualifikuar (12 OE):</u> IN- 214,024,666 DI- 218,129,853 ED- 226,627,207 AR- 226,723,849 L.T- 235,913,104 IN- 239,517,142 HA- 245,607,074 AS- 249,059,856 PE- 251,987,210 DA- 255,647,264 AU269,600,000 KE- 270,128,457
11. Ankimime Po	12. Përgjigje Ankesës Vendimi i Komisionit Prokurimit Publik nr. datë 19.02.2025, si dhe datë 28.02.2025 mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik datë 19.02.2025	
Titullari i Autoritetit Kontraktor znj. Ll. M		

Në lidhje me këtë procedurë rezultojn se fitues është shpallur OE i renditur i dyti pas s’kualifikimit të OE të renditur i pari. Në lidhje me këtë s’kualifikim, nga ana e OE IN është bërë ankesë në KPP. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës rezultojn se KPP ka refuzuar ankesën e OE IN dhe në vijim AK ka vijuar me shpalljen e fituesit dhe lidhjen e kontratës me OE të renditur i dyti LI K& V K.

6. Investim në impiantistikën e godinës lidhur me sistemin ngrohje-ftohje me chiller silencioz

Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Investim në impiantistikën e godinës lidhur me sistemin ngrohje-ftohje me chiller silencioz”, REF- 31698-03-12-2024		
1. Urdhër Prokurimi 2.1 Lloji i Kontratës Projektimi dhe realizimi i punimeve, Kontratë me çelësa në dorë. 2..2 Lloji i Procedurës “Procedurë e Hapur”, format elektronik 2.3. Kriteri i vlerësimit Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në çmim	3. Përlogaritja e vlerës së Fondit Limit dhe Specifikimet teknike Njësia e Prokurimit znj. G. K – Person përgjegjës për prokurimin z. I. L – Specialist i fushës për prokurimin z. M. I – Specialist i fushës për prokurimin	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave z. M. S znj. N. M znj. E.L
5. Fondi Limit (pa TVSh) 22,500,000 lekë 5.1 Afati 2 muaj	6. Oferta e kualifikuar e para E.C Kontrata me nr. datë 14.02.2025 me vlerë 21,644,832 lekë me TVSH	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 4,462,640 lekë, 19.8 %
8. Data e hapjes së tenderit 19.12.2024, ora 10:00	9. Burimi Financimit Buxheti i shtetit	10. Operatorët Ekonomikë (oferta lekë pa TVSH & pikët të renditur sipas vlerës së ofertës) Pjesëmarrës (6 OE): EC - 18,037,360 AL - 18,450,000 GS - 19,187,288 LO - 19,350,000 ZE - 21,084,100 AL - 21,190,000 S’kualifikuar (2 OE): AL- 18,450,000 ZE - 21,084,100
11. Ankimime -	12. Përgjigje Ankesës -	

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me këtë procedurë prokurimi nuk u konstatuan mangësi në drejtim të hartimit të specifikimeve teknike, fondit limit, kriterëve si dhe vlerësimit të ofertave. Në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpalur fitues OE EC me vlerën ekonomike më të ulët të ofertuar mes OE pjesëmarrës.

Viti 2025

7. Procedura e prokurimit me objekt Ri jetësimi i hapësirave të brendshme të Teatrit të kukullave

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ri jetësimi i hapësirave të brendshme të Teatrit të kukullave” viti 2025			
1. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar, REF:53860-07-07-2025	2. Grupi i hartimit i specifikimeve teknike dhe fondit limit: Urdhri nr. 729 me nr. 2979/6 prot, datë 03.06.2025 K.L B. D E. B	3. Njësia e Prokurimit Urdhri nr. 822 me nr. 5961/19 prot, datë 27.06.2025 K. L E. D E. Lami	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 818 me nr. 2979/12 prot, datë 25.06.2025 A .P B. K G. K
5. Fondi Limit (pa TVSh) 24,948,944 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSh) 20,957,113 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 3,991,831 lekë	

8/1 Data e publikimit të tenderit 08.07.2025	9. Burimi Financimit Fondet e Buxheti i Shtetit	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 1; Fitues 1. E. K PF
8/2 Kohëzgjatja e kontratës 2 muaj nga nënshkrimi I kontratës.		
12. Ankimim Nuk ka.	13. Përgjigje Ankesës AK	14. Përgjigje Ankesës nga KKP
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimit		
15. Lidhja e kontratës Lidhja e kontratës me nr. 11114/1 Prot., datë 28.08.2025 me afat 2 muaj nga nënshkrimi.	Zbatimi i kontratës: Në proces.	

Titullari i AK ka nxjerrë urdhrat në lidhje me grupet përkatëse dhe komisionet në zbatim të nenit 73 të VKM 285 datë 19.05.2021, i ndryshuar “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Mbi përlllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike:

Me Proces-Verbalin me nr. 2979/8 Prot., datë 13.06.2024 grupi i punës ka hartuar specifikimet teknike dhe fondin limit për këtë procedurë, i cili është 24,938,733 lekë me TVSH. Ky fond ka dal nga mesatarja e 3 ofertave që ka marrë institucioni nga 3 operatorë të ndryshëm.

Mbi përcaktimin e kriterëve të kualifikimit:

Për përcaktimin e kriterëve të kualifikimit për këtë procedurë, NJP është bazuar në specifikimet teknike të hartuara nga grupi i punës i ngritur për këtë qëllim.

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se për kriteret e veçanta të vendosura në DT nga Njësia e Prokurimit, është mbajtur procesverbali me datë 07.07.2025, veprim në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 78, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2.

- Nga verifikimi i kriterëve të vendosura, u konstatua se përgjithësisht janë vendosur në përputhje me legjislacionin e Prokurimit Publik.

Konstatim:

Nga auditimi i dokumenteve të tenderit vihet re se nga ana e njësisë në kriteret e veçanta janë vendosur kriteret të cilat kanë të bëjnë me fushën artistike por nga auditimi i zërave të kërkuar për tu përmbushur shihet që pjesë e tyre janë dhe disa mallra të cilat nuk kanë të bëjnë me profesionin e artistit siç janë: 31. Kolltuk me formë të çrregullt; 32. Perde; 33. Sistem ndriçimi; 34. Poltron.

Duke parë specifikimet teknike mbi këto zëra kuptohet që nuk kanë të bëjnë me punë artistike. Këto zëra nuk duhet të ishin bërë pjesë e kësaj procedurë për shkak të natyrës të ndryshme që kanë nga pjesa tjetër e punimeve artistike të kërkuara nga MEKI dhe duhet të ishin shpallur në një procedurë të re ose të ndahej në lot më vete ku të ndahej nga pjesa e punimeve artistike. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 2 të LPP dhe të pikës 1 të nenit 42 të VKM 285. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: Njësia e Prokurimit.

Mbi vlerësimin e ofertave

Sipas procesverbalit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave me nr. 2979/14 prot., datë 11.08.2025 ka marrë pjesë vetëm Ergys Krisiko PF ku dhe është kualifikuar si ofertë e vlefshme. Pas shqyrtimit të dokumentacionit fizik të marrë në dorëzim me procesverbalin e marrjes në dorëzim të dokumenteve nga ana e AK është bërë njoftimi i fituesit dhe me shkresën me nr. 11114/1 prot., datë 28.08.2025 është nënshkruar kontrata midis autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik.

Raporti përmbledhës është miratuar nga ana e titullarit të institucionit me shkresën nr. 11185 prot., datë 01.09.2025.

Konstatim:

Titullari i institucionit ka nënshkruar kontratën me OE fitues në datën 28.08.2025 disa ditë më përpara se nga ana e KVO ti ishte përcjellë për miratim raporti përmbledhës me nr. 11185 prot., datë 01.09.2025, mbi procedurën e prokurimit i ku shprehet me hollësi të gjitha hapat e ndërmarra për të dalë deri te fituesi i përzgjedhur. Pra titullari i institucionit ka nënshkruar kontratën pa miratuar raportin përmbledhës sipas të cilit ai njihet me gjithë hapat e ndjekur për të arritur të fituesi. Gjithashtu KVO ka kaluar afatet për nxjerrjen e raportit përmbledhës siç janë parashikuar dhe në VKM. Këto janë veprime në kundërshtim me Kreun X, pika 1 e nenit 84 të VKM 285 datë 19.05.2021 *“1. Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimit përgatit një raport përmbledhës për procesin e shqyrtimit të vlerësimit të ofertave dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit/entit kontraktor”*.

Nga ana e KVO duhet të ishte s'kualifikuar OE E. K për shkak se në nga hulumtimi i objektit të veprimtarisë së tij në QKB ka të parashikuar shërbime që lidhen përgjithësisht me fushën e artit dhe nuk ka të parashikuar veprimtarinë për disa nga zërat e kërkuar që lidhen me prodhimin ose tregtimin e poltronëve, kolltukëve, perdeve dhe sistemeve të ndriçimit e cila rrit riskun për AK për mos përmbushjen e kërkesave sipas specifikave të kërkuara. Gjithashtu, ofertuesi ka sjellë një vërtetim nga ana e përbarimit ku thuhet se ofertuesi nuk ka detyrime por ky vërtetim nuk shpjegon n.q.s. ky subjekt ka vlera të pashlyera ndaj tatimeve dhe për të përmbushur këtë kriter subjekti duhet të kishte sjellë vërtetim nga ana e organeve tatimore që AK ta kuptonte nëse kishte apo jo detyrime të pashlyera ndaj organeve tatimore siç është kërkuar në pikën *dh* të kriterëve të përgjithshme të DST. Sa më sipër janë veprime në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, neni 82, pika 2 dhe pika 3, neni 92 i LPP *“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”*. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi anëtarët e KVO.

Për sa më lart është dërguar projekt raporti dhe nga subjekti i audituar MEKI, është paraqitur observacion me shkresën nr.244/38 prot., datë 13.03.2026, protokolluar në KLSH me nr. 951/27 prot., datë 13.03.2026, si më poshtë vijon.

Pretendimet e subjektit:

1.Në lidhje me këtë konstatim, dëshirojmë të sqarojmë se në këtë procedurë prokurimi publik ka marrë pjesë vetëm një ofertues, i cili është kualifikuar dhe shpallur fitues. Në këto kushte, referuar nenit 96, pika 1 dhe pika 2, shkronja "b", të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, citohet se: "Periudha e pritjes e parashikuar në pikën 1 të këtij neni nuk zbatohet: b) në rastin e procedurave me një ofertues të vetëm, i cili është kualifikuar dhe shpallur fitues." Për rrjedhojë, autoriteti kontraktor vijon drejtpërdrejt me publikimin e njoftimit përfundimtar të fituesit dhe, pas paraqitjes së sigurimit të kontratës nga operatori ekonomik, mund të procedojë me lidhjen e kontratës. Gjithashtu, sqarojmë se raporti përmbledhës i procedurës së prokurimit ka qenë i përgatitur dhe i sigluar paraprakisht nga titullari i institucionit përpara lidhjes së kontratës me operatorin ekonomik fitues. Diferenca në data lidhet vetëm me regjistrimin formal në protokoll, i cili është kryer në një moment të mëvonshëm për shkak të rrethanave organizative dhe logjistike në të cilat ka operuar institucioni gjatë kësaj periudhe, përfshirë procesin e rikonstruksionit të godinës dhe zhvendosjen e përkohshme të strukturave administrative.

2. Referuar nenit 77, pika 2 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, citohet se: "Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë". Gjithashtu, referuar Dokumenteve Standarde të Tenderit të miratuara me VKM nr. 710, datë 23.09.2024 "Për miratimin e dokumenteve standarde të tenderit për mallra, punë dhe shërbime për procedurën e prokurimit 'e hapur', ofertuesi duhet të deklarojë se është i regjistruar në regjistrin tregtar, sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ka status aktiv dhe se në fushën e veprimtarisë së tij përfshihet objekti i prokurimit. Nga verifikimi i ekstraktit tregtar të operatorit ekonomik rezulton se aktiviteti i tij përfshin "realizimin e veprave të artit në metal, rezinë, inox, bronz dhe materiale të tjera; krijimtari artistike; organizim konferencash dhe eventesh; realizim ekspozitash; aktivitete në fushën e reklamës, marketingut, pasurive të paluajtshme; tregti mallrash; si dhe shërbime konsulence, kuratoriale dhe menaxhimi". Objekti i procedurës së prokurimit lidhet me furnizimin me pajisje për rijetëzimin e hapësirave të Teatrit të Kukullave, në funksion të krijimit të një hapësire kulturore dhe artistike, e cila shërbeje si destinacion turistik. Në këtë kuadër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka zbatuar parimin e proporcionalitetit dhe ka vlerësuar se objekti i veprimtarisë së operatorit ekonomik përputhet me natyrën e kontratës. Legjislacioni në fuqi kërkon që operatori ekonomik të ketë në objektin e veprimtarisë objektin e përgjithshëm të prokurimit dhe jo çdo zë të veçantë të specifikimeve teknike të kontratës.

3. Referuar nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, operatori ekonomik, në fazën e ngarkimit të dokumentacionit në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), paraqet dokumentin "Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit", i cili shërben si provë paraprake për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit. Gjithashtu, në përputhje të pikës 6 të nenit 26, operatori ekonomik, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe pas përfundimit të fazës së vlerësimit, dorëzon dokumentacionin e plotë të ofertës, si dhe dokumentet provuese në përputhje me deklaratimet e bëra në formularin e vetëdeklarimit. Në rastin konkret, operatori ekonomik ka dorëzuar dokumentacionin provues përkatës, përfshirë edhe vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë që konfirmon mungesën e detyrimeve tatimore, sipas kriteret e përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit (DST). Mosgjetha e këtij dokumenti në momentin e auditimit lidhet me lëvizjen e dosjeve gjatë procesit të ristrukturimit të ministrive dhe zhvendosjes së institucionit, dhe kur dosja iu dorëzua grupit të auditimit nga anëtari i KVO-së, pas procesit të arkivimit, mungesa e këtij dokumenti nuk u konstatua. Nga verifikimet e mëvonshme rezultoi se dokumenti gjendej në dosjen e operatorit ekonomik dhe i është bashkëlidhur këtij observacioni.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për pikën 1 të observacionit sqarojmë se argumentimet e paraqitura nuk përbëjnë provë të re dhe pasqyrojnë konstatimin e bërë nga grupi i auditimit. Sa më sipër, pretendimet e observuesve nuk qëndrojnë, nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.

Për pikën 2 të observacionit sqarojmë se në lidhje me pretendimet mbi fushën e veprimtarisë sqarojmë se argumentimet e paraqitura nuk përbëjnë provë të re për shkak se nga ana e KVO duhet të s'kualifikohet sepse nuk i kishte kapacitet teknike për përmbushjen të gjitha zërave të kërkuara. Sa më sipër, pretendimet e observuesve nuk qëndrojnë, nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.

Për pikën 3 të observacionit sqarojmë se në dosjen e subjektit nuk ka pasur vërtetim tjetër përveç vërtetimit nga përmbartimi. Gjithashtu për të njëjtin fakt keni dy pretendime të ndryshme për shkak se në observacionet mbi aktin keni sjellë një vërtetim nga tatimet të cilit shpreheni që ishte në dosje dhe tani keni sjellë një vërtetim tjetër të cilin pretendoni që ka qenë në dosje i cili nuk skanohet

dhe ka problematika me nr. e vërtetimit dhe me datat. Sa më sipër, pretendimet e observuesve nuk qëndrojnë, nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.



6. Kontrata me objekt “Rikonstruksioni i Godinës së MEKI-t”, viti 2025

Tabela nr. 2

Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstruksioni i Godinës së MEKI-t”, REF- 43966-04-07-2025		
1. Urdhër Prokurimi Urdhri nr. 342 datë 19.03.2025 me nr. 4285 prot., datë 13.03.2025	3. Përlllogaritja e vlerës së Fondit Limit dhe Specifikimet teknike - Njësia e Prokurimit Urdhri nr. 342 datë 19.03.2025 me nr. 4285 prot., datë 13.03.2025 znj. G. K – Person përgjegjës për prokurimin z. L. T – Specialist i fushës për prokurimin znj. N. M – Specialiste e fushës për prokurimin	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 997 datë 19.11.2024 me nr. 14560/5 prot., datë 19.11.2024, i ndryshuar me Urdhër nr. 580, datë 23.04.2025, me nr. 4285/14 prot., datë 23.04.2025, i ndryshuar me Urdhër nr. 617, datë 09.05.2025 me nr. 4285 prot., datë 09.05.2025. z. I .L – Kryetar z. G. T – Anëtar znj. O. Sh – Anëtare
2.1 Lloji i Kontratës Projektimi dhe realizimi i punimeve, Kontratë me çelësa në dorë.		
2.2 Lloji i Procedurës “Procedurë e Hapur”, format elektronik		
2.3. Kriteri i vlerësimit Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në çmim		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 64,675,430 lekë 5.1 Afati 7 muaj	6. Oferta e kualifikuar e para “AR” Kontrata me nr. 4825/9 prot., datë 12.06.2025 me vlerë 58,207,886 lekë me TVSH	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 16,168,858 lekë, 25 %
8. Data e hapjes së tenderit 23.04.2025, ora 10:00	9. Burimi Financimit Buxheti i shtetit	10. Operatorët Ekonomikë (oferta lekë pa TVSH & pikët të renditur sipas vlerës së ofertës) <u>Pjesëmarrës (2 OE):</u> AR - 48,506,572 IN - 58,207,887 <u>S’kualifikuar (0 OE):</u> S’ka
11. Ankimime -	12. Përgjigje Ankesës -	
Titullari i Autoritetit Kontraktor znj. Ll. M		

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se përmes një shkrese me nr. 4001/2 prot., datë 01.04.2025 drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm znj. Ll. M është kërkuar fillimi i procedurës së prokurimit me objekt *Rikonstruksioni i Godinës së MEKI-t*. Shkresa citon faktin se *duke qenë se nga Drejtoria e Shërbimeve nuk është parashikuar fond limit për hartimin e projektit, por është mbajtur një relacion nga kjo drejtori*, atëherë është propozuar lloji i procedurës së prokurimit e hapur, kontratë me çelësa në dorë sipas të cilës kontraktori ka përgjegjësinë e realizimit të punëve, sipas projekt preventivit të miratuar paraprakisht nga autoriteti kontraktor, pa kërkuar asnjë fond shtesë, përveç vlerës së kontratës së prokurimit, që në çdo rast, përfshin të gjitha detyrimet fiskale në fuqi. Me shkresën nr. 4285 prot., datë 19.03.2025, përmes Urdhrit nr. 342, datë 19.03.2025 nga ana e Titullarit të AK znj. Ll.M është iniciuar procedura e prokurimit me objekt *Rikonstruksioni i Godinës së MEKI-t*. Në këtë shkresë është vlera e fondit limit prej 64,675,430 lekë pa TVSH, lloji i procedurës *Procedurë e hapur – Punë, me çelësa në dorë* si dhe është bërë edhe caktimi i anëtarëve të NJP znj. N. M person përgjegjës për prokurimin me pozicion Drejtor Drejtore e Prokurimeve, me profesion juriste, znj. G. K, person përgjegjës për prokurimin me pozicion specialiste, me profesion ekonomiste dhe z. L.T arkitekt, përfaqësues i IKTK. Sipas

dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në datën 26.03.2025 është bërë miratimi i argumentimit të specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim nga ana anëtarëve të NJP. Sipas shkresës me nr. 14560/5 prot., datë 19.11.2024 është bërë emërimi i anëtarëve të KVO me përbërje të këtij komisioni z. I. L, Kryetar me profesion inxhinier IT dhe me pozicion Drejtor DSH, z. G. T dhe z. M. I anëtar me profesion jursit, me pozicion specialist. Me shkresën me nr. 4285/14 prot., datë 23.04.2025, me Urdhër nr. 580, datë 23.04.2025 të Titullarit znj. Ll. M është bërë zëvendësimi i anëtarit z. M. I me znj. E. L dhe në vijim, me shkresën nr. 4285 prot., datë 09.05.2025, me Urdhër nr. 617, datë 09.05.2025 nga ana e Titullarit të AK znj. Ll.M është bërë zëvendësimi i anëtares së KVO znj. E. L me znj. O. Sh me pozicion specialiste në sektorin e shërbimeve, me profesion ekonomiste.

Me shkresën nr. 4285/12 prot., datë 07.04.2025 është bërë njoftimi i shkurtuar i kontratës dhe përmes shkresës me nr. 4285/13 prot., datë 11.04.2025 është bërë njoftimi i ndryshimit të DT, referuar e-mailit të sugjerimeve të ardhura nga APP, ndryshim i cili nuk ka bërë ndryshimit e datës së dorëzimit të ofertave.

NË LIDHJE ME VLERËSIMIN E OFERTAVE

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në procedurë kanë marrë pjesë dy OE sipas tabelës nr. 1 si më sipër. Në përfundim të procesit të vlerësimit të kryer nga ana e KVO, sipas shkresës me nr. 4285/19 prot., datë 28.05.2025 është bërë miratimi i Raportit Përmbledhës së Procedurës nga ana e Titullarit të AK dhe në vijim, përmes shkresës me nr. 4852/9 prot., datë 12.06.2025 është bërë lidhja e kontratës së sipërmarrjes së punimeve mes OE AR dhe Titullarit znj. Ll. M me vlerë të kontratës **58,207,886 lekë me TVSH** dhe me afat 7 muaj. Sipas të dhënave nuk rezulton të ketë patur ankesa në lidhje me vlerësimin e ofertave.

Nga verifikimet rezulton se OE AR i renditur i pari nuk ka ngarkuar në SPE dokumentin e kërkuar *Kopje të deklaratimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (2022, 2023, 2024) lëshuar nga Autoriteti përkatës.* Për këtë arsye KVO ka kërkuar asistencë përmes një e-maili të datës 07.05.2025 nga AKSHI mbi verifikimin e dokumentacionit pasi referuar edhe faturave elektronike të punëve të ngjashme KVO ka arritur në konkluzionin se ky subjekt ka xhirim të konsiderueshëm vjetor. Në mungesë të përgjigjes nga ana e AKSHI-t, në zbatim të LPP (neni 82, pika 3) dhe VKM të RrPP (neni 26, pika 5) ka administruar dokumentacionin e ngarkuar nga po ky OE në një procedurë tjetër ku ka qenë pjesëmarrës, konkretisht në procedurën e prokurimit me objekt *Ndërtimi i ri i shkollës së mesme profesionale Karl Gega, Tiranë*, me Autoritet Kontraktor Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit me nr. REF-30350-11-20-2024.

Në përfundim të analizimit të të gjithë dokumentacionit dhe sqarimeve të dhëna nga ana e subjektit të audituar përmes observacioneve dhe takimit ballafaques është arritur në konkluzionin se në vijimësi nga ana e Ministrisë përgjegjëse për kulturën duhet të merrën të gjitha masat e nevojshme për të sqaruar saktësisht natyrën dhe llojin e punëve të ngjashme të kërkuara ndaj OE pjesëmarrës në rastet e prokurimit të punimeve civile në objektet monument kulturë. Gjithashtu, kur është e mundur AK duhet të marrë masat e nevojshme për të diferencuar dhe prokuruar vecmas punimet në objektet monument kulture (realizimi i të cilave dikton nevojën e disponimit të licencave specifike) nga punimet e zakonshme civile.

➤ AUDITIMI I ZBATIMIT TË KONTRATAVE

1. Kontrata me objekt “Ndërhyrje restauruese në Mozaikun e Tiranës, ndërtim godine”

Në zbatim të Programit të Auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Dosja teknike e zbatimit të punimeve të kontratës me objekt ‘Ndërhyrje restauruese në Mozaikun e Tiranës, ndërtim godine’;

Korrespondenca të ndryshme;

Projekti i zbatimit

Sipas shkresës së administruar në Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore (DRTK) Tiranë me nr. 181 prot., datë 11.04.2022 është lidhur marrëveshje mes UPT, Drejtorisë së Shërbimeve mbështetëse në UPT e përfaqësuar nga drejtori i kësaj drejtorie z. B. A. dhe DRTK Tiranë e përfaqësuar nga z. O. P, për kryerjen e opionencës teknike të projektit të ndërtimit. Në lidhje me projektin e zbatimit të punimeve nuk disponohet një urdhër apo një kontratë shërbimi me terma reference përkatëse për këtë detyrë të kryer nga ana e grupit të projektimit i cili referuar Oponencës Teknike të hartuar nga ana e UPT, përcjellë në DRTK Tiranë sipas shkresës me nr. 641/3 prot., datë 09.06.2022, është hartuar nga personat si më poshtë:

Projekti arkitekturor – SO, ark. E. B;

Projekti konstruktiv – ing. A. P;

Projekti hidraulik – ing. I.B;

Projekti elektrik – ing. S. H

Projekti i ngrohjes – ing. I. B;

Projekti i mbrojtjes nga zjarri – I.B;

Gjeologjia – NO 2012;

Sizmiteti – NO 2012;

Për sa i takon opionencës teknike rezulton se ky material është përgatitur nga ana e ana e grupit të ekspertëve i përbërë nga: znj. J. M – Arkitekt; z. A. L – Hidroteknik; z. L. M – MNZ + HVAC; znj. N. Sh – Ing. Elektrik; znj. L. A – VNM; znj. A. F – Studimi Gjeologjik; z. Rr.O – Studimi sizmik. Përpara dërgimit të tij për kryerjen e opionencës teknike, projekti ka marrë miratimin e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM) sipas Vendimit me nr. 16, datë 21.01.2022 me nr. 44 prot., datë 21.01.2022 dhe më pas ky vendim i është përcjellë DRTK Tiranë nga ana e KKTKM sipas shkresës me nr. 44/1 prot., datë 26.01.2022. Sipas shkresës së Agjencisë së Zhvillimit të Territorit (AZHT) me nr. 3592/3 prot., datë 19.10.2023, administruar në Ministrinë e Kulturës (MK) me nr. 5450 prot., datë 23.10.2023 është njoftuar MK për lëshimin e dokumentit të lejes së ndërtimit me nr. 3592 prot., datë 12.09.2023. Kjo shkresë i është përcjellë DRTK Tiranë përmes aktit me nr. 5450/1 prot., datë 30.10.2023.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, në dosje nuk administrohet një kontratë e sigurimit të përgjegjësisë profesionale nga ana e hartuesve të këtij projekti për dëmet që mund të shkaktohen si pasojë e veprimtarisë së tyre, veprim ky në kundërshtim me parashikimet e bëra në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 5/1 Përgjegjësia e projektuesit ku përcaktohet se:

“3. Çdo projektues ose grup projektimi është i detyruar të lidhë një kontratë të sigurimit të përgjegjësisë profesionale për çdo dëm që mund të shkaktohet si pasojë e veprimtarisë së tij dhe duhet të mbulojë të paktën dëmet e mëposhtme:

a) çdo shpenzim të nevojshëm e të domosdoshëm të projektimit të ri, si dhe shpenzimet shtesë të kryera nga zhvilluesi ose organet e administratës publike, që kanë rrjedhur si pasojë e gabimeve në projektim;

b) kostot shitesë që mund të lindin për zhvilluesin, si pasojë e gabimeve në projektim gjatë zbatimit të projektit.”

Në relacionin konstruktiv përmendet një dimension i pllakës me lartësi 170 cm, po aq sa përmendet edhe në projektin konstruktiv kur në fakt, dimensionin sipas projektit arkitekturor është në lartësinë prej 60 cm dhe dimensionin sipas projektit *As build* (sipas faktit) është në lartësinë prej 80 cm. Sa më sipër është në kundërshtim me parashikimet e bëra në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*”, i ndryshuar, neni 4 *Përgjegjësia e projektuesit ku përcaktohet se:*

“Punimet e ndërtimit, të përkufizuara në nenin 3, duhet të projektohen dhe të zbatohen në tërësi ose në pjesë të veçanta në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre, duke pasur parasysh edhe anën ekonomike të tyre. Ato duhet të plotësojnë kërkesat që kanë të bëjnë me:

1. rezistencën dhe qëndrueshmërinë mekanike;

3. higjienën, shëndetin dhe mjedisin;

4. sigurinë në përdorim;”

Gjatë verifikimi në objekt, në ambientet e zyrës së DRTK Tiranë, në dispozicion të grupit të auditimit u vendosën materiale të ndryshme e ndër të tjera edhe ato si më poshtë cituar:

-Me shkresën e administruar në DRTK Tiranë me nr. 126 prot., datë 09.03.2022, nga ana e Drejtorit të këtij institucioni z. O.P, i është kërkuar MK kryerja e procedurës mbi eficiencën e energjisë në kuadër të projektit arkitektonik Mozaiku i Tiranës.

-Me shkresën e administruar në DRTK Tiranë me nr. 155 prot., datë 31.03.2022, nga ana e Drejtorit të këtij institucioni, i është kërkuar MK plotësimi i dosjes me studimin sizmik, studimin gjeologjik dhe VNM me qëllim kryerjen e opionencës së projektit.

Në bazë të kërkesës si më sipër është paraqitur certifikata e performancës së energjisë me kod 20220329477763 e hartuar nga ekspertja znj. A. L më datë lëshimi 29.03.2022 sipas të cilës ka rezultuar një nivel A i klasit të energjisë.

Nga analiza e Raportit të auditimit të energjisë të hartuar për Mozaikun e Tiranës konstatohen disa mospërputhje si më poshtë:

- Në kapitullin 3.2 citohet se muret perimetrale do të realizohen me mur beton arme dhe termoizolim në mes me trashësi 5 cm, kur në fakt projekti arkitekturor nuk e paraqet si detaj dhe për më tepër as në fakt nuk rezulton të jetë realizuar një detaj i tillë;

- Në pjesën e jashtme të murit mbështjellës të ndërtesës përshkruhet se do të ketë një veshje me termoizolim (5 cm) + gips (2.5 cm) + ajër (15 cm) + gips (2.5 cm), kur në fakt projekti arkitekturor nuk e paraqet si detaj dhe për më tepër as në fakt nuk rezulton të jetë realizuar një detaj i tillë;

- Në pjesën e brendshme të murit mbështjellës të ndërtesës përshkruhet se do të ketë një veshje gips (2.5 cm) + termoizolim (5 cm) + gips (2.5 cm), kur në fakt projekti arkitekturor nuk paraqet asnjë detaj të tillë dhe për më tepër as nuk rezulton të jetë realizuar si detaj;

Nga sa më sipër rezulton se Raporti i Auditimit të Energjisë nuk është hartuar për detajet sipas të cilit ky projekt është projektuar nga ana arkitekturore dhe as sipas projektit sipas të cilit është zbatuar. Pra, ka mospërputhje mes detajeve teknike të përshkruara në raport me ato të paraqitura në projekt dhe me ato të zbatuara në fakt.

Sa më sipër është në kundërshtim me parashikimet e bëra në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*”, i ndryshuar, neni 4 *Përgjegjësia e projektuesit ku përcaktohet se:*

“Punimet e ndërtimit, të përkufizuara në nenin 3, duhet të projektohen dhe të zbatohen në tërësi ose në pjesë të veçanta në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet

teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre, duke pasur parasysh edhe anën ekonomike të tyre. Ato duhet të plotësojnë kërkesat që kanë të bëjnë me:

6. kursimin e energjisë dhe ruajtjen e ngrohtësisë.”

Për sa i takon preventivit të punimeve i cili ka shërbyer edhe për përcaktimin e fondit limit të procedurës, ky material rezulton i hartuar nga ana e OE S & C me administrator z. E.B. Në vijim ky material i është përcjellë Ministrisë së Kulturës nga ana e Drejtorit të DRTK Tiranë z. O.P përmes shkresës me nr. 155/3 prot., datë 10.06.2022, administruar në MK me nr. 1815/ 9 prot., datë 10.06.2022.

Nga dokumentacioni i administruar në lidhje me fazën përpara fillimit të punimeve, pra projektin, preventivin dhe relacionet teknike shoqëruese, rezulton se jo për të gjithë zërat janë hartuar analiza përkatëse të çmimeve sipas parashikimeve të VKM nr. 514/2007 e “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, në fuqi në momentin e dorëzimit të këtij preventivi. Analizat e çmimit për këtë zëra duhet të ishin të detajuara qartë me të gjithë elementët e kostos:

-shpenzimet për pagat bazë dhe shtesën mbi pagë;

-shpenzimet për materialet;

-shpenzimet për transportin;

-shpenzimet për makineritë.

Mangësitë e mësipërme në lidhje me projektin dhe preventivin e zbatimit janë në kundërshtim me parashikimet e bëra në:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 4 Përgjegjësia e projektuesit ku përcaktohet se:

“Punimet e ndërtimit, të përkufizuara në nenin 3, duhet të projektohen dhe të zbatohen në tërësi ose në pjesë të veçanta në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre, duke pasur parasysh edhe anën ekonomike të tyre.

- VKM nr. 514 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

“2. Hartimi i çdo preventivi apo situacioni në fushën e ndërtimit, si dhe zbatimi e mbikëqyrja e çdo punimi ndërtimi, që realizohet nga persona fizikë dhe juridikë, publikë ose privatë, me fonde publike ose private, në territorin e Republikës së Shqipërisë, bëhen në përputhje me këtë vendim.

3. Metodologjia e llogaritjes së kostos, sipas këtij vendimi, është pjesë e dokumentacionit teknik të çdo objekti të projektuar apo ndërtuar në Republikën e Shqipërisë.

9. Vlera e zërave të punës të preventivave të objekteve që ndërtohen me financim publik të projektuara nga subjekte, publike apo private, llogariten si prodhimi i volumeve të punës, të llogaritura në librezën e masave të projektit me çmimet për njësi të manualit teknik të çmimeve në fuqi.

11. Të gjitha institucionet shtetërore, që kryejnë programime të fondeve, për efekt planifikimi investimesh për ndërtimin e veprave publike, me fonde publike, nga Buxheti i Shtetit apo nga donatorë të huaj, detyrohen të llogarisin çmimet e zërave të punës, për të përcaktuar vlerën limit të objektit, në bazë të manualit të miratuar të çmimeve të ndërtimit, mbështetur në analizat teknike të çmimeve.

12. Të gjitha institucionet shtetërore, që kryejnë prokurime të punimeve të ndërtimit me fonde publike, nga Buxheti i Shtetit apo nga donatorë të huaj, detyrohen të kontrollojnë çmimet për zërat e punës, të ofertave të paraqitura në tender, me çmimet e bazuara në manualin e çmimeve të ndërtimit dhe në analizat teknike të këtyre çmimeve. Në rastin kur zëri i punës nuk figuron në

manual, institucioni u kërkon subjekteve ofertuese të paraqesin analizën teknike, bazuar në metodologjinë e përcaktuar në Udhëzimin nr. 2, datë 8.5.2003 të Këshillit të Ministrave dhe të paraqitur me formatin e unifikuar. Një fotokopje të analizave të paraqitura nga subjektet ofertuese për zërin e punës, institucioni ia dërgon ministrisë, e cila e shqyrton analizën e re dhe nëse e gjykon të drejtë, e reflekton çmimin në manualin e çmimeve të periudhës vijuese.

- Udhëzimin nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Struktura e kostos së punimeve të ndërtimit, ku përcaktohet se:

“Shpenzimet e punimeve të ndërtim-montimit përbehen nga:

- shpenzime të drejtpërdrejta;
- shpenzime të përgjithshme;
- fitimi dhe tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH).

A. SHPENZIMET E DREJTPERDREJTA

Janë shpenzimet që përcaktohen nëpërmjet llogaritjeve analitike në analizat e çmimeve njësores, për procese dhe zëra të ndryshëm punimesh ndërtim-montimi, ku përfshihen:

- shpenzimet për pagat bazë dhe shtesën mbi page
- shpenzimet për materialet
- shpenzimet për transportin
- shpenzimet për makineritë

Lidhur me sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi Drejtori i DRTK Tiranë z. O. P si dhe përfaqësuesi ligjor i OE S & C, z. E. B.

Historiku i zbatimit të punimeve

Në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues OE F me të cilin është lidhur kontrata me Autoritetin Kontraktor Ministria e Kulturës e përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm znj. Z. B sipas shkresës me nr. 1815/24 prot., datë 19.08.2022 me vlerë 179,259,167 lekë me TVSh dhe me afat të zbatimit të punimeve 24 muaj pas datës së:

- Dorëzimit të paketës së plotë të firmosur të projektit të zbatimit;
- Lejet e nevojshme për fillimin dhe disiplinimin e punimeve, sipas legjislacionit në fuqi;
- Dorëzimin e kantierit;
- Përzgjedhjen e mbikëqyrësit të punimeve nga AK.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit nr. 41185/17 prot., datë 30.09.2022 është lidhur kontrata përkatëse e shërbimit mes Ministrisë së Kulturës në cilësinë e AK e përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm i MK znj. Z. B dhe BOE F & N të përfaqësuar këta nga OE F.A, me administrator z. E. K me vlerë 1,788,000 lekë me TVSH. Sipas procesverbalit pa nr. prot., datë 22.08.2022 të mbajtur mes sipërmarrësit dhe mbikëqyrësit të punimeve është bërë pezullimi i punimeve të ndërtimit për shkak të mos pajisjes me leje ndërtimi. Me shkresën nr. 1815/26 prot., datë 30.08.2022, nga ana e Titullarit të AK, me Urdhër nr. 574, datë 30.08.2022, është bërë caktimi i përfaqësuesit të AK përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratës, z. O. P (larguar nga puna në datën 13.11.2024, referuar shkresës me nr. 14199 prot., datë 08.11.2024). Me procesverbalin e mbajtur mes palëve pa nr. protokolli, datë 17.11.2022, punimet kanë rifilluar. Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi sipas aktit me nr. 8731/2 prot., datë 30.06.2025 me OE T.A me përfaqësues ligjor znj. D. Q. Në datën 17.11.2022 është bërë dorëzimi i sheshit të ndërtimit tek sipërmarrësi. Me shkresën e administruar në MK me nr. 6429 prot., datë 21.11.2022, është bërë njoftim nga ana e sipërmarrësit për fillimin e punimeve në datën 19.11.2022. Po në të njëjtën datë është bërë njoftim edhe nga mbikëqyrësi i punimeve. Në vijim mes palëve është mbajtur procesverbali përkatës i fillimit të punimeve dhe në datën 25.11.2022

është bërë akti i piketimit të objektit. Me shkresën e administruar në MK me nr. 5789 prot., datë 10.11.2023 nga ana e mbikëqyrësit të punimeve është bërë dorëzimi i shkresës me objekt *Kërkesë dhe dorëzim dokumentacioni për Preventivin e rishikuar nr. 1*. Kjo kërkesë është bërë pas asaj të sipërmarrësit të punimeve me po të njëjtin objekt kërkesë. Sipas procesverbalit të datës 09.11.2023, mes sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe ndjekësit të kontratës z. O. P është bërë negociimi i çmimeve për zërat e rinj të punimeve të cilët, sipas procesverbalit, citohet të kenë rezultuar të paparashikuar në preventivin fillestar por të domosdoshëm për shkak të ndryshimeve në projektin e zbatimit. Sipas këtij procesverbali, çmimet e pranura janë më të ulëta nga ato të ofruara nga ana e kontraktorit. Në dosje rezulton i miratuar nga AK gjithashtu preventivi i rishikuar dhe tabelat e volumeve që hiqen dhe shtohen. Ndryshimet si më sipër janë shoqëruar edhe me relacionin e datës 09.11.2023 të hartuar nga ana e kontraktorit të punimeve sipas të cilit vlera e punimeve që janë shtuar dhe zbritur kanë qenë në vlerën prej 40,788,019 lekë a TVSH. Përmes këtij relacioni është sqaruar gjithashtu se edhe vlera e fondit rezervë është përfshirë në preventivin e rishikuar e të kërkuar për miratim. Materialet si më sipër janë përcjellë në MK nga ana e OE FU sipas shkresës me nr. 5789/3 prot., datë 10.11.2023. Me shkresën nr. 5789/1 prot., datë 10.11.2023 nga ana e mbikëqyrësit të punimeve, është kërkuar përdorimi i fondit rezervë për shkak të volumeve të ndryshimeve të përmendura edhe më sipër. Me shkresat e administruara në MEKI me nr. 7173 prot., datë 31.05.2024 dhe nr. 7174 prot., datë 31.05.2024, nga ana e sipërmarrësit është kërkuar respektivisht lidhja e kontratës për furnizimin më ujë dhe lidhja me energjinë elektrike me qëllim testimin përfundimtar dhe kolaudimin e pajisjeve të vendosura.

Përmes një shkrese pa nr. prot., datë 14.11.2024, nga ana e mbikëqyrësit të punimeve është dorëzuar shkresa me objekt *Kërkesë dhe dorëzim dokumentacioni për Preventivin e rishikuar nr. 2*, kjo në vijim të po të njëjtës kërkesë të bërë edhe nga ana e OE FU pa nr. prot., datë 14.11.2024. Në dosje rezultojnë të miratuara preventivi i rishikuar nr. 2 si dhe tabelat e volumeve që hiqen dhe shtohen së bashku me analizat e çmimeve të zërave të rinj. Në datën 15.11.2024, nga ana e sipërmarrësit të punimeve është bërë njoftim për përfundim punimesh. Nga data 30.06.2025 deri në datën 09.07.2025 është kryer kolaudimi i punimeve të përfunduara nga OE TA i kontraktuar për ofrimin e këtij shërbimi.

Historiku i situacioneve

Sipas dokumentacionit të dosjes teknike rezulton se nga ana e kontraktorit dhe mbikëqyrësit, respektivisht janë hartuar dhe miratuar situacionet si më poshtë:

Tabela nr. 3

Situacioni nr.	Vlera e situacionit	Data e dorëzimit
1	6,122,395	28.12.2022
2	8,640,792	02.06.2023
3	33,456,000	30.06.2023
4	18,076,728	29.08.2023
5	32,321,484	29.12.2023
6	41,830,414	26.09.2024
7 / Përfundimtar	38,811,354	15.11.2024

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se mes palëve Autoritet Kontraktor – Mbikëqyrës – Sipërmarrës janë miratuar dy rishikime të projekt preventivit të kontratës të cilat nuk janë argumentuar në mënyrë shteruese dhe nuk janë shoqëruar me një sqarim tekniko – ekonomik për tu krahasuar më pas në raport me detyrën e projektimit (nëse do të kishte një të tillë). Sa më sipër është në kundërshtim me parashikimet e bëra në Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu I, ku përcaktohet se:

3.4 Sipërmarrësi, brenda një afati të pranuar nga palët paraqet kërkesë-propozimet për korrigjime, plotësime apo përmirësime në projekt dhe për mungesat e pasaktësitë, ligjore a

kontraktuale të dokumentacionit të dorëzuar. Kërkesë-propozimet i paraqiten mbikëqyrësit nga sipërmarrësi, gjatë zhvillimit të punimeve, sa herë që gjykohet e arsyeshme prej tij.

7.3 Ndryshimet e miratuara nga investitori sipas pikave 7.1 e 7.2 të këtij kreu, së bashku me dokumentacionin e nevojshëm teknik, ekonomik e administrativ, i dorëzohen zyrtarisht, sipërmarrësit.

8.2 Me kërkesë të investitorit, përshkrimet teknike të projektit dhe specifikimet teknike mund t'u referohen standardeve, normave e rregullave teknike të vendeve të tjera, kur ato janë më të përparuara se ato në fuqi, kur nuk sjellin rritjen e vlefës së investimit apo ndryshime të kushteve thelbësore të kontratës dhe i dorëzohen sipërmarrësit para fillimit të punimeve.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se kontrata me objekt 'Ndërhyrje restauruese në Mozaikun e Tiranës, ndërtim godine' ka nisur punimet në datën 19.11.2022 në një kohë kur leja e ndërtimit i është dhënë zhvilluesit nga ana e KKT sipas aktit me nr. 3592 prot., datë 12.09.2023. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 107/2014 "Për planifikim dhe zhvillim e territorit", i ndryshuar, neni 39 Leja e ndërtimit, ku përcaktohet se: "1. Leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim, riparim, restaurim apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 41 i këtij ligji".

Gjithashtu, rezulton se kontrata është prokuruar sipas parashikimeve të bëra nga ligji nr. 27/2018 'Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë', VKM nr. 425/2020 'Për procedurat e përzgjedhjes së subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore', i ndryshuar si dhe Udhëzimit nr. 269, datë 11.08.2020 të Ministrit të Kulturës 'Për miratimin e dokumenteve standarde të konkurrimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të pajisura me licencë, për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore' pasi zona ku është parashikuar të realizohet investimi është Monument Kulture i kategorisë së parë (Mozaiku në Bllokun Partizani, I-07). Në fakt, sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se nga ana e Ministrisë së Kulturës, sipërmarrësit dhe mbikëqyrësit të punimeve nuk janë marrë masat e nevojshme për miratimin në KKTKM të dy ndryshimeve në projekt – preventiv. Sa më sipër është në kundërshtim me parashikimet e bëra në VKM nr. 1125, datë 30.12.2020 "Për miratimin e rregullave të projektimit, zbatimit të punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale, mbikëqyrjes dhe kolaudit të tyre", Kapitulli IV, ku përcaktohet se:

18. Zbatuesi i punimeve nuk mund të ndryshojë më nismën e vet projektin ose përshkrimet teknike të tij.

19. Zbatuesi i punimeve i paraqet zhvilluesit kërkesë propozimet për korrigjime, plotësime apo situata të paparashikuara gjatë zbatimit të ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale. Zhvilluesi i kërkon mbikëqyrësit dhe projektuesit vlerësimin dhe miratimin e këtyre kërkesë propozimeve, brenda një afati të caktuar nga palët. Në rastet kur kërkesë propozimet ndikojnë në ndryshimin e projektit fillestar, ato paraqiten për shqyrtim në KKTKM dhe, pas miratimit me vendim, vijohet me realizimin e ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse. Vendimi i KKTKM-së për ndryshimet e projektit fillestar është i detyrueshëm për zbatim".

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se nga ana e mbikëqyrësit të punimeve nuk është raportuar rregullisht në AK, sipas parashikimeve të bëra në kontratën përkatëse të shërbimit të lidhur sipas aktit me nr. 41185/17 prot., datë 30.09.2022 me BOE F. N, Kushtet e Veçanta, neni 5 Kërkesat e raportimit ku përcaktohet se:

“Gjatë kohëzgjatjes së kontratës, kontraktuesi duhet të sigurojë raporte mujore për AK çdo muaj sipas formës së kërkuar nga AK dhe të parashikuar në legjislacionin në fuqi.”

Nga krahasimi i volumeve të situacionuara e të likuiduara si dhe atyre të kryera në fakt rezulton një diferencë me pasojë dëm ekonomik vlerën **760,949 lekë pa TVSH**, e argumentuar kjo si më poshtë:

- Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se mes zërave të rinj të sjellë përmes dy urdhër ndryshimeve janë propozuar ndër të tjera edhe zërat:

Mobilja 6 dollap me melaminë lisi rigato (3.2 x 2.2), me çmim njësi 283,200 lekë / copë;

Mobilja 10 dollap me melaminë lisi rigato (2.3 x 2.2) , me çmim njësi 202,176 lekë / copë;

Mobilja 9 dollap me melaminë lisi, me çmim njësi 420,672 lekë / copë;

Me shtimin e këtyre zërave është hequr zëri *Rafte për zyrat* me çmim njësi 14,060 lekë / ml. Në vijim janë situacionuar këto zëra me çmimet e reja respektive. Në fakt, një ndryshim i tillë nuk duhet të ishte miratuar mes palëve pasi zëri i punës i realizuar në fakt është raft dhe jo dollap. Praktikisht, kontraktori duhet të kishte situacionuar sasinë prej $(4.82 + 3.2 + 2.3) \times 14,060$ lekë ml = 145,099 lekë pa TVSH dhe jo shumën totale prej 906,048 lekë pa TVSH. Për rrjedhojë rezulton se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve shuma prej **760,949 lekë pa TVSH**.

Sa më sipër janë në kundërshtim me:

-Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, *“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”*, i ndryshuar, neni 7/1, *“Përgjegjësia e mbikëqyrësit”*, ku përcaktohet se: *“1. Mbikëqyrësi/grupi i mbikëqyrësve të punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit. Kur mbikëqyrësi i punimeve konstaton raste të ndryshimit të projektit, është i detyruar të njoftojë menjëherë Inspektoratin Vendor të Mbrojtjes së Territorit të bashkisë. 2. Mbikëqyrësi/grupi i mbikëqyrësve të punimeve, në çdo rast, kur gjatë mbikëqyrjes së punimeve, sipas fazave përkatëse, konstaton mospërputhjen e punimeve të kryera me lejen e ndërtimit, me dokumentet e planifikimit e të kontrollit të zhvillimit dhe me legjislacionin në fuqi që rregullon veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, urdhëron pezullimin e punimeve të ndërtimit dhe njofton menjëherë Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit të bashkisë ku kryhen punimet e ndërtimit dhe autoritetin përgjegjës të planifikimit ose, sipas rastit, edhe Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.”*, neni 12 ku përcaktohet se: *“Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudit teknikoe-konomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse: 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve.”*;

-VKM nr. 610, 22.09.2022 *“Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”*, neni 1, ku përcaktohet se: *“1. Mbikëqyrja e punimeve bëhet për të gjitha llojet e objekteve të ndërtimit dhe kryhet nga mbikëqyrës/grupi i mbikëqyrësve të punimeve, i cili ka përgjegjësi kontrollin e mbarëvajtjes të të gjithë procesit të zbatimit të punimeve, në përputhje me projektin, rregullat dhe standardet teknike të projektimit, zbatimit, si dhe destinacionin e objektit, duke pasur parasysh edhe anën ekonomike të tij.”*; neni 5 ku përcaktohet se: *“1. Zhvilluesi lidh kontratë me mbikëqyrësin e punimeve, duke përcaktuar detyrimet e ndërsjella, kushtet e punës, tarifën, rastet e zëvendësimit, sipas pikës 2, të nenit 6, të*

këtij vendimi, dhe detyrimin e mbikëqyrësit për të raportuar pranë autoriteteve çdo 45 (dyzet e pesë) ditë për gjendjen e zhvillimit të punimeve.”; neni 7 ku përcaktohet se: “Mbikëqyrësi i punimeve në bashkëpunim me zbatuesin e punimeve programon punimet që do të kryhen në objekt nëpërmjet një plani të shprehur në grafik për çdo muaj. Ai mbikëqyr grafikun e punimeve, kontrollon librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumentacionit që mbahet në objekt.”; neni 8 ku përcaktohet se: “1. Mbikëqyrësi ka detyrimin të raportojë te zhvilluesi, çdo 45 (dyzet e pesë) ditë për kryerjen e punimeve, sipas fazave të akteve të kontrollit, në përputhje me nenin 42, të këtij vendimi. 2. Mbikëqyrësi ka detyrimin të njoftojë on-line në sistemin e-leje pranë autoriteteve përkatëse kryerjen e punimeve, sipas fazave të akteve të kontrollit, në përputhje me nenin 42, të këtij vendimi. Ai njofton on-line brenda 5 (pesë) ditëve pune në sistemin e-leje pranë autoriteteve përkatëse në rastet kur vëren se punimet e kryera janë në shkelje apo tejkalim të lejes së ndërtimit, si dhe kryen on-line çdo 45 (dyzet e pesë) ditë raportimin e kryerjes së punimeve, sipas metodologjisë së përcaktuar nga organi i lëshimit të lejes së ndërtimit”, neni 12 ku përcaktohet se: “Mbikëqyrësi i punimeve kontrollon dhe pranon paraprakisht situacionet pjesore në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të miratuara nga zhvilluesi.”; neni 15 ku përcaktohet se: “Mbikëqyrësi i punimeve kryen matjet në kantier në bashkëpunim me zbatuesin e punimeve dhe për çdo shmangie të konstatuar mbi atë të lejuarën, të përcaktuar në aktet ligjore për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, pezullon punimet dhe njofton menjëherë zhvilluesin, autoritetin e lëshimit të lejes së ndërtimit dhe Inspektoratin Vendor të Mbrojtjes së Territorit/Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit në sistemin e-leje.”; neni 18 ku përcaktohet se: “1. Mbikëqyrësi i punimeve kontrollon zbatimin e grafikut të punimeve dhe i raporton çdo 45 (dyzet e pesë) ditë zhvilluesit për realizimin e tij, Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit/Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, si dhe autoritetit që lëshon lejen e ndërtimit”, neni 19 ku përcaktohet se: “1. Mbikëqyrësi i punimeve njoftohet nga zbatuesi i punimeve kur punimet që do të mbulohen, do të maskohen ose do të betonohen janë gati për t’u kontrolluar prej tij. Me marrjen e njoftimit nga zbatuesi i punimeve, mbikëqyrësi i punimeve kontrollon dhe miraton çdo punim përpara se të mbulohet, maskohet ose betonohet. 2. Në rast se mbikëqyrësi nuk njoftohet në kohë dhe punimet për maskimin ose betonimin janë kryer, mbikëqyrësi mban një procesverbal në prezencë të drejtuesit të punimeve, dhe njofton zhvilluesin dhe IKMT-në. Punimet fillojnë pas përcaktimit nga IKMT-ja për ecurinë e procesit të ndërtimit.”; neni 22 ku përcaktohet se: “Mbikëqyrësi i punimeve kontrollon faturat e blerjes së materialeve dhe të çdo shpenzimi tjetër, që është i lidhur me ndërtimin e objektit, situacionet e paraqitura nga zbatuesi i punimeve në fazat e ndryshme të punimeve, si dhe kontabilitetin.”; neni 38 ku përcaktohet se: “1. Korrespondenca e mbikëqyrësit të punimeve me zhvilluesin dhe zbatuesin e punimeve është pjesë e dokumentacionit të objektit. 2. Në dosjen e mbikëqyrjes së punimeve pasqyrohen të gjitha aktet e mbajtura gjatë zbatimit të objektit, si akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit, urdhrat e ndryshëm të dhënë nga mbikëqyrësi i punimeve, kundërshtitë dhe kontradiktat e lindura gjatë punës, si dhe zgjidhjet e tyre, ndërprerjet e punimeve dhe shkaqet që kanë diktuar këto ndërprerje, relacionet teknike të kërkuara ose të paraqitura gjatë zbatimit, si dhe të gjitha rrethanat e nevojshme për të dhënë kuadrin e plotë të të gjitha fazave të zbatimit të punimeve.”;

- Udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu II Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, pika 3 ku përcaktohet se: “Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi: a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike. b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar. c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension,

formë, sasi dhe cilësi. ç. Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes.”;

- Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, ku përcaktohet se: “1.2 Drejtuesit ligjorë dhe teknikë të sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi; 3. Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit detyrohet të zbatojë punimet, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit e të zbatimit, normat e kushtet e legjislacionit të ndërtimit e të kontraktimit; 8.1 Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasitë, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës. 8.2 Situacionet financohen nga investitori sipas kushteve që parashikohen në kontratë (sigurimi i kantierit, garancia e kontratës dhe e punimeve, paradhënia, periodiciteti, afatet e pagesës, ndalesat për vonesat, defektet e pakorrigjuara, gjobat), pasi kontrollohen e pranohen paraprakisht nga mbikëqyrësi i punimeve. 8.3 Çmimet jashtë kontratës caktohen sipas analizave teknike në fuqi, **me vlerën ekonomike më të mirë.**”

- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve e lidhur sipas aktit nr. 41185/17 prot., datë 30.09.2022;

- Kontrata e shërbimit të kolaudit të punimeve e lidhur sipas aktit me nr. 8731/2 prot., datë 30.06.2025;

- Kontratën e lidhur sipas aktit me nr. 41185/17 prot., datë 30.09.2022 mes AK dhe OE;

- Urdhrat e Titullarit për ndjekjen e kontratës;

- Etj.

Për sa më sipër, është mbajtur Akt Konstatimi nr. 9, datë 02.02.2026 dhe nga ana e ish Drejtorit të DRTK Tiranë z.O.P, përmes postës elektronike të datës 11.02.2026 janë paraqitur observacionet si më poshtë trajtuar.

Pretendimi i subjektit:

“Për objektin, Ndërhyrje restauruese në Mozaikun e Tiranës (ndërtim godine), bazuar në Urdhërin n. 574 datë 30.08.2022, unë O.P jam ngarkuar me detyrat si më poshtë

1. Përgjegjës për ndjekjen e kontratës

2. Përgjegjës i kontratës duhet të ndjekë me përpikmëri ecurinë e zbatimit të kontratës, për tu siguruar që zbatimi të bëhet sipas termave dhe kushteve të kontratës.

3. Personi përgjegjës ecurinë dhe zbatimin e kontratës ka këto detyra:

4. Kryen monitorimin e zbatimit të detyrimeve të palëve në kontratë në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë

5. Administron dhe verifikon dokumentacionin e dorëzuar nga kontraktori në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës.

6. Menaxhon dhe trajton problematikat që shfaqen gjatë ekzekutimit të kontratës.

7. Raporton tëk titullari i autoritetit/entit kontraktor për shkelje të dispozitave kontraktuale.

8. Administron kërkesat për ndryshime/modifikime/përshtatje të zbatimit të kontratës dhe sigurohet që këto kërkesa të kalojnë për miratim në strukturat përkatëse, brenda afateve të përcaktuara në kontratë.

9. Mban korrespondencën e përditësuar me të gjitha dokumentet e shkëmbyera me kontraktorin mbikëqyrësin lidhur me zbatimin e kontratës

Pra siç shihet dhe në urdhër unë O. P kam funksione administrative të mirë përcaktuara në urdhër të cilat kanë të bëjnë vetëm me anën dokumentare dhe në asnjë moment me anën teknike të zbatimit të punimeve. Duhet pasur në konsideratë se ky objekt është dhënë me konkurrim bazuar në VKM 425 datë 17.05.2020...”

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Pretendimet si më sipër nuk merren në konsideratë nga ana e Grupit të Auditimit pasi ato nuk sjellin fakte shtesë nga ato të konstatuara gjatë fazës së auditimit në terren.

2. Kontrata me objekt “Ndërtimi i një objekti / qendre të re multifunksionale në funksion të së ardhmes së edukimit artistik të fëmijëve në kryeqytet, pranë qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë dhe Teatrit të Kukullave”

Në zbatim të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Korrespondencat mes Autoritetit Kontraktor – sipërmarrësit – mbikëqyrësit

Projekti i zbatimit

Për shërbimin e projektimit për këtë objekt, në shtator të vitit 2021 është zhvilluar procedura përkatëse e prokurimit me objekt *Hartim projekti për ndërtimin e një objekti/qendre të re multifunksionale në funksion të së ardhmes së edukimit artistik të fëmijëve në kryeqytet, pranë Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë dhe Teatrit të Kukullave* nga ana e Autoritetit Kontraktor Ministria e Kulturës. Në përfundim të procedurës, sipas aktit me nr. 6758 prot., datë 31.12.2021, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me Autoritetin Kontraktor Ministria e Kulturës (MK) e përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm znj. E .Ç dhe BOE I & S të përfaqësuar këta nga ana e OE I me administrator z. G.A dhe me vlerë të kontratës **49,200,000 lekë pa TVSH** dhe me afat dorëzimi projekti 30 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës. Për zbatimin e punimeve nga ana e Këshillit Kombëtar të Territorit, me mbledhjen e datës 16.03.2022 është marrë vendimi nr. 6 “*Për miratimin e lejes së ndërtimit për objektin: “Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë”, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë*” dhe kjo leje është zbardhur me nr. 45/6, datë 14.02.2023, me afat 36 muaj.

Historiku i zbatimit të punimeve

Në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues BOE IS & R & K, të përfaqësuar këta nga OE 2 me përfaqësues ligjor z. A.S në bazë të kontratës së bashkëpunimit me nr. 6138 rep. datë 21.10.2022. Me BOE fitues është lidhur kontrata e sipërmarrjes së punimeve me Autoritetin Kontraktor Ministria e Kulturës e përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm znj. Z. B sipas shkresës me nr. 3252/25 prot., datë 10.11.2022 me vlerë **1,200,539,142 lekë me TVSh** me afat të zbatimit të punimeve 24 muaj duke filluar nga hyrja në fuqi e kontratës. Për mbikëqyrjen e punimeve, sipas aktit me nr. 6526/18 prot., datë 08.02.2023 është lidhur kontrata përkatëse e shërbimit me OE H.S me përfaqësues ligjor z. F.B. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se njoftimi për fillimin e punimeve është bërë në datën 21.02.2023 dhe në bazë të kësaj punimet duhet të kishin përfunduar në datën 21.02.2025.

2023

Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve H me nr. 85 prot., datë 01.06.2023, është dërguar në AK Ministria e Kulturës shkresa me objekt *Njoftim pezullim pune në objektin: “Ndërtimi i një objekti/qendre të re multifunksionale në funksion të së ardhmes së edukimit artistik të fëmijëve në kryeqytet, pranë qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë dhe Teatrit të Kukullave”*. Sipas shkresës pezullimi i punimeve është bërë me argumentin si më poshtë citohet:

“Gjatë kryerjes së punimeve të gërmimit është konstatuar ekzistenca e linjave kabllore hyrëse dhe dalëse nga kabina e tensionit të mesëm, të cilat janë bërë pengesë për vazhdimin e kryerjes së

punimeve. Ekzistenca e tyre në sheshin e ndërtimit rrezikon jetën e punonjësve në objekt si dhe dëmtimi i tyre mund të sjellë ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të banorëve dhe të institucioneve që furnizohen prej tyre. Ky shqetësim është ngritur dhe më parë nga ana jonë referuar shkresës me nr. 40 prot., datë 03.03.2023 me lëndë ‘Kërkesë për lirim të sheshit të ndërtimit’ si dhe në shkresën me nr. ref. 6., datë 01.03.2023 me lëndë ‘Kërkesë për lirim të sheshit të ndërtimit në objekt nga sipërmarrësi B.O.E “2” & B & “R sh.p.k & “K” sh.p.k’.

Për sa më sipër deri në zgjidhjen e problemit, për spostimin e linjave kabllore të tensionit, njoftojmë pezullimin e punimeve në objekt. Bashkëngjitur shkresa e sipërmarrësit të punimeve Ref. QKKF-14p., datë 31.05.2023, me lëndë ‘Kërkesë për pezullim punimesh në objekt’.

Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve me nr. 106 prot., datë 24.07.2023, është dërguar në AK Ministria e Kulturës shkresa me objekt ‘Njoftim për heqje pezullimi’. Përmes kësaj shkrese është cituar si më poshtë:

“Për sa më sipër ju bëjmë me dije për rifillimin e punimeve në pjesët që nuk ka probleme me spostimin e kabinës, e konkretisht përfundimi i gërmimeve dhe betonimi i pllakës së themelit e në vazhdim”.

2024

Sipas aktit së administruar në MK me nr. 10369 prot., datë 19.08.2024, nga ana e sipërmarrësit të punimeve është dërguar në AK dhe për dijeni mbikëqyrësit të punimeve shkresa me objekt ‘Mbi lirim të sheshit të ndërtimit në objektin: ‘Ndërtimi i një objekti/qendre të re multifunkionale në funksion të së ardhmes së edukimit artistik të fëmijëve në kryeqytet, pranë qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë dhe Teatrit të Kukullave’’. Përmes kësaj shkrese është cituar si më poshtë:

“Nga azhurnimi topografik i sheshit të ndërtimit është konstatuar se ky shesh vazhdon të jetë pjesërisht i lirë, pasi brenda pronës që kërkohet të zhvillohet, e cila është në administrim të Ministrisë së Kulturës (VKM nr. 561, datë 29/07/2022), ndodhen disa objekte ekzistuese në anën veriore, të cilat pengojnë ndërtimin e objektit. Problematikë për kryerjen e punimeve dhe që është pengesë për vazhdimin e tyre, janë kabina ekzistuese e tensionit të mesëm e linjat elektrike kabllore hyrëse dhe dalje të kësaj kabine. Pavarësisht se punimet në objekt kanë vazhduar, duke i dhënë një zgjidhje provizore problemit, ky shqetësim ende nuk është zgjidhur. Gjatë kryerjes së punimeve të gërmimit, siç jeni në dijeni, është konstatuar se nga ana Jug - Lindore është aktivizuar rrëshqitje dherash të cilat përkohësisht për shkak të mungesës së reshjeve janë stabilizuar. Megjithatë me fillimin e reshjeve këto rrëshqitje do të aktivizohen dhe përveç se përbëjnë rrezik potencial për sigurinë në punë të jetës së punonjësve në objekt, agravimi i tyre për shkak të afërsisë së objektit, mund të sjellë edhe problematika të tjera, siç është zënia e sheshit të ndërtimit, rrezikimi i rrëshqitjes së faqes juglindore të shpatit të Parkut të liqenit, etj. Theksojmë se deri më tani nuk disponojmë projektin se si do të zhvillohet sistemimi i objekti në këtë anë. Për sa më sipër lutemi për ndërhyrjen tuaj konform ligjit, për zgjidhjen e shqetësimeve të ngritura me qëllim ecurinë normale të zbatimit të punimeve në objekt”.

2025

Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve me aktin nr. 8 prot., datë 10.02.2025, administruar në MK me nr. 2365 prot., datë 11.02.2025, është dërguar në AK Ministria e Kulturës shkresa me objekt ‘Kërkesë për shtyrje afati të kontratës’. Përmes kësaj shkrese është cituar si më poshtë:

“Nisur nga shkresa e ardhur nga kontraktori me Ref.QKKF-32, datë 05.02.2025 me anë të së cilës na vë në dijeni për zgjatje të afatit të punimeve për objektin: ‘Ndërtimi i një objekti/qendre të re multifunkionale në funksion të së ardhmes së edukimit artistik të fëmijëve në kryeqytet, pranë Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë dhe Teatrit të Kukullave’, ne si mbikëqyrës në bazë të kontratës me nr. 6526/18 prot., datë 08.02.2023 të lidhur me Autoritetit Kontraktor, sa më sipër

kërkojmë miratimin nga ana juaj për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve me 1 vit duke filluar nga data 21.02.2025. Në mënyrë të përmbledhur po përmendim edhe një herë arsyet që kanë çuar në kërkesën për shtyrje të afatit të punimeve:

1. Lirimi pjesërisht i sheshit të ndërtimit:

1.1 Brenda pronës që zhvillohet objekti ndodheshin disa objekte ekzistuese në anën veriore;

1.2 Kabina ekzistuese e tensionit të mesëm e linjat elektrike kabllore hyrëse dhe dalëse të kësaj kabine;

1.3 Rrëshqitja e dherave nga ana Jug-Lindore;

1.4 Problematikat me rrugicën në anën e teatrit veror.

2. Problemet me miratimin e projekt-preventivit të zbatimit të objektit:

2.1 Mungojnë detaje të ndryshme për realizimin e projektit si detajet e fasadës së objektit, detajet për konstruksionet metalike të rrëshqitëses në tarracë, detajet për realizimin e shkallëve të brendshme që do të ndërtohen në katin e VI dhe të VII., etj.

Të gjitha problematikat lidhur me projektin janë konstatuar gjatë zbatimit të punimeve në objekt. Sa më sipër kanë sjellë vonesa në ecurinë e punimeve, pezullime të përkohshme duke e bërë të pamundur përfundimin sipas grafikut të miratuar të punimeve.”

Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve me aktin nr. 25 prot., datë 07.05.2025, administruar në MK me nr. 6431 prot., datë 08.05.2025, është dërguar në AK Ministria e Kulturës shkresa me objekt ‘Kërkesë për rishikim projekti dhe preventivi’. Kjo kërkesë rezulton të ketë ardhur pas kërkesës së bërë nga vet sipërmarrësit sipas shkresës me nr. QKKF-35 prot., datë 29.04.2025. Përmes kësaj shkrese janë dërguar materialet si më poshtë:

1. Projekti konstruktiv i ripunuar;

2. Projekti i konstruksionit metalik i ripunuar;

3. Projekti i dyerve, i shtresave, tavanëve, i sistemimeve të jashtme dhe i mureve të brendshme, i ripunuar;

4. Projekti i plotë i zbatimit të skenës së shfaqjeve;

5. Projekti konstruktiv i fasadës së lëvizshme;

6. Projekti i strukturës së mbulesës metalike të lëvizshme;

7. Preventivi i rishikuar pas ripunimit të projektit të zbatimit;

8. Relacioni teknik për punimet që shtohen dhe që zbriten (Rishikimi Nr. 1);

9. Proces-verbali i volumeve që shtohen dhe që hiqen;

10. Tabela e ndryshimit të volumeve.

Në vijim është kërkuar miratimi i këtyre ndryshimeve të punimeve, si të detyrueshme e që janë të nevojshme të realizohen në fakt. Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve, është bërë gjithashtu njoftim në datën 08.05.2025 për pezullim punimesh, kjo bazuar edhe në shkresën e sipërmarrësit me nr. QKKF-35 prot., datë 29.04.2025. Ky pezullim është parashikuar të vazhdojë deri në vënien në dispozicion të projektit dhe preventivit të rishikuar nga ana e investitorit, kjo pasi ndryshimet që janë propozuar në projektin e rishikuar nuk lejojnë realizimin e zërave të tjerë. Me urdhrin nr. 756, datë 10.06.2025 është bërë caktimi i strukturës përgjegjëse për autoritetin kontraktor për ndjekjen e zbatimit të kontratës me përbërje të këtij komisioni z. M. S, znj. G. K dhe znj. A. A.

Sipas shkresës me nr. 9180 prot., datë 10.07.2025, nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm i janë dërguar për vlerësim dhe interpretim materialet e dërguara nga ana e mbikëqyrësit si më sipër projektuesit OE I. Në vijim AK ka parashtruar kërkesat konkrete ndaj projektuesit nëse:

“1. Pretendimet e parashtruara nga mbikëqyrësi i punimeve, në vijim të kërkesës së sa më kontraktorit, janë të domosdoshme dhe të paparashikuara në projektin fillestar;

2. Ndryshimet e propozuara a sjellin ndikim në kalendarin e miratuar të punimeve, i cili sipas kontratës nr. 3252/25, datë 10.11.2022, është përcaktuar në 2 vite nga momenti i fillimit të punimeve, dhe këto ndryshime "zgjatje të afatit përtej afatit kontraktual" janë si pasojë e mangësive në projektin fillestar apo vonesa të shkaktuara nga zbatuesi i punimeve "kontraktori"; Ju lutemi që përgjigjen tuaj **ta bazoni në analizë teknike dhe të detajuar, duke specifikuar çdo ndryshim të kërkuar dhe ndikimin përkatës në zbatimin e projektit dhe afatet përkatëse.**”.

Me shkresën e administruar në MK me nr. 9180/1 prot., datë 22.07.2025, nga ana e OE I, në cilësinë e projektuesit i është kthyer përgjigje si më poshtë:

“Gjatë fazës së punimeve, ekipi i projektuesve ka kryer vizita të vazhdueshme në kantier, me qëllim ndjekjen e procesit të zbatimit dhe sigurimin e përputhshmërisë së punimeve me projektin e dorëzuar. Gjatë këtyre vizitave janë evidentuar disa problematika të cilat kanë ndikuar në ecurinë dhe zbatueshmërinë e projektit në terren. Konkretisht:

1. Ndryshimet e ndodhura në kuotat e terrenit, si rezultat i ndërhyrjeve të kryera nga Bashkia Tiranë për ndërtimin e rrugës "D.D". Gjatë fazës së projektimit, rilevimi është realizuar mbi një terren me kuota të ndryshme nga ato që janë gjetur në fillim të punimeve për teatrin, pasi ndërkohë kishin përfunduar punimet për rrugën;

2. Rrëshqitja e dheut në pjesën e pasme të kantierit, ndonëse jashtë territorit të drejtpërdrejtë të projektit, ka shkaktuar shtresa dherash të shembura që kanë depërtuar brenda zonës së projektit. Kjo ka sjellë nevojën për përforsimin e terrenit në këtë zonë dhe rivizatimin e plansistemimit, me qëllim garantimin e sigurisë në ndërtim dhe funksionalitetit të objektit;

3. Kërkesa e kontraktorit për përshtatje të projektit, për të reflektuar situatën reale në terren dhe për të siguruar zbatim të drejtë dhe efikas të objektit, është trajtuar me seriozitet nga ana jonë. Projektuesi ka ofruar të gjitha sqarimet e nevojshme teknike dhe mbështetjen e kërkuar në kohë, duke përfshirë: **plotësime të detajeve teknike, përmirësime të pjesshme në projekt dhe vizatimet përkatëse të domosdoshme për vijimin e punimeve.**

Për të gjitha arsyet e mësipërme, kemi mbështetur kontraktorin me dokumentacion dhe vizatime shtesë, **të domosdoshme për përmirësimin dhe finalizimin e projektit**, gjithnjë në përputhje me standardet teknike dhe objektivat arkitektonike të parashikuara. **Pra ndryshimet e paraqitura janë të nevojshme për vijimin e realizimit të projektit sipas idesë së parashikuar.**

Jemi të mendimit se afati i përfundimit të kryerjes së punimeve në objektin e sipërpërmendur të jetë data 21.02.2026, në përputhje me afatin e vlefshmërisë së Lejes së Ndërtimit nr. 45/6 prot. dt. 14.02.2023, me afat të vlefshmërisë 36 muaj, të miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit, në zbatim të Vendimit nr. 06, datë 16.03.2022”.

Sipas shkresës me nr. 9180/2 prot., datë 05.08.2025, nga ana e strukturës përgjegjëse për AK për ndjekjen e zbatimit të kontratës, është përgatitur një relacion me lëndë *Relacion mbi kërkesën e BOE përfaqësuar nga subjekti 2 ShPK për zgjatjen e afatit të kontratës nr. 3252/25, datë 10.11.2022 ‘Ndërtimin e një objekti/qendre të re multifunkionale në funksion të së ardhmes së edukimit artistik të fëmijëve në kryeqytet, pranë Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë dhe Teatrit të Kukullave’.*

Ky relacion ka bërë një përshkrim të situatës deri në datën e përgatitjes së tij duke bërë me dije pretendimet e kontraktorit sipas shkresës me nr. 2356 prot., datë 11.02.2025 për zgjatjen me 1 vit të afatit të realizimit të kontratës bazuar në argumentet në lidhje me:

- a. Problemet që lidhen me lirin e sheshit të ndërtimit;
- b. Problemet që lidhen me projekt-preventivin e objektit.

Në përfundim, nga ana e këtij grupi është sugjeruar ngritja e një grupi pune për amendimin e kontratës.

Me shkresën nr. 9180/4 prot., datë 09.09.2025, përmes Urdhrit nr. 1061, datë 09.09.2025 është bërë ndryshimi i urdhrit nr. 1006, datë 27.08.2025 *‘Për ngritjen e grupit të punës për shqyrtimin e dokumentacionit dhe hartimin e amendimit për ndryshimin e afatit të kontratës nr. 3252/25, datë 10.11.2022’*, duke përcaktuar në përbërje të këtij grupi anëtarët si më poshtë:

Znj. A. A Kryetare

Znj. K. B, Anëtare

Znj. Z. R, Anëtare

Z. M. S, Anëtar

Znj. G. K, Anëtare.

Sipas shkresës me nr. 9180/5 prot., datë 17.09.2025, nga ana e grupit të punës ngritur me urdhrin nr. 1061, datë 09.09.2025, është përgatitur një informacion dhe propozimi i amendimit të kontratës. Në përfundim të analizës së dokumentacionit të administruar, nga ana e këtij grupi është propozuar shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve me 36 muaj nga hyrja në fuqi e kontratës si dhe aplikimi i penaliteteve për 22 ditë kalendarike (16.04.2025 – 08.05.2025), pra duke justifikuar periudhën prej 53 ditësh të pezullimit të punimeve midis datave 01.06.2023 – 24.07.2023. Në vijim, përmes shkresës me nr. 9180/7 prot., datë 17.09.2025 është bërë amendimi i kontratës sipas propozimeve të grupit të ngritur me urdhrin nr. 1061, datë 09.09.2025 mes Sekretarit të Përgjithshëm znj. Ll. M dhe BOE. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se pagesat ndaj kontraktorit të punimeve janë situacionuar dhe likuiduar sipas të dhënave si më poshtë:

Situacioni	Periudha	Vlera pjesore e situacionuar Lekë me TVSh	Vlera e likuiduar ⁹ Lekë me TVSH	Data e likuidimit
1	21.02.2023-18.05.2023, 5/2023, datë 25.05.2023	16,415,922	16,415,922	05.06.2023
2	deri më 12/09/2023, fat. 86/2023, datë 14.09.2023	49,954,388	66,370,311	25.09.2023
3	deri më 21/11/2023, fat. 140/2023, datë 24.11.2023	26,770,848	26,770,848	05.01.2024
4	deri më 28/12/2023, fat. 175/2023, datë 29.12.2023	38,264,160	38,264,160	05.01.2023
5	deri më 30/04/2024, fat. 68/2024, datë 13.05.2024	11,152,080	11,152,080	27.09.2024
6	deri më 30/06/2024, fat. 113/2024, datë 17.07.2024	25,991,280	25,991,280	27.09.2024
7	deri më 02.12.2024, fat. 253/2024, datë 04.12.2024	25,404,720	25,404,720	28.01.2025
8	deri më 27/12/2024, fat. 273/2024, datë 30.12.2024	50,005,632	50,005,632	27.01.2025
9	deri më 01.04.2025, fat. 55/2025, datë 10.04.2025	20,881,296	20,881,296	23.01.2026
10	deri më 30/09/2025, fat. 315/2025, datë 02.12.2025	47,962,904	47,962,904	15.01.2026
11	fat. 364/2025, datë 30.12.2025	81,048,000	81,048,000	26.01.2026
	Vlera progresive	312,997,211	312,997,211	
	Vlera e Kontratës	1,200,539,142		

Nga analiza e tabelës së situacioneve pjesore të likuiduara nga ai me nr. 1 deri në atë me nr. 11, faturave tatimore dhe urdhër shpenzimeve rezulton se i është paguar kontraktorit të punimeve, përmes pagesës së situacionit pjesor nr. 2 një diferencë tepër në vlerë prej **16,415,922 lekë me TVSH**. Sa më sipër ka ndodhur për shkak të likuidimit përmes urdhër shpenzimit nr. 882, datë 18.09.2023 të vlerës progresive të punimeve (66,370,311 lekë me TVSH) dhe jo të vlerës pjesore të tyre (49,954,388 lekë me TVSH). Veprimet dhe mosveprimet si më sipër janë në kundërshtim me parashikimet e bëra nga Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”*, i ndryshuar ku përcaktohet se: *“35. Regjistrimi i veprimeve ekonomike*

⁹ Përfshirë vlerën e garancisë së punimeve.

në librat e kontabilitetit bazohet në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim dhe grupohen në:

a) Dokumente autorizuese - janë ato dokumente që autorizojnë kryerjen e një veprimi të caktuar ekonomik e që i bashkëlidhet dokumentit vërtetues. Të tilla janë urdhrat e blerjeve, kontratat, urdhri për krijimin e komisioneve, urdhër për nxjerrje jashtë përdorimit, etj.

b) Dokumente vërtetuese - vërtetojnë kryerjen në fakt, dhe në mënyrë kronologjike, të veprimeve ekonomike. Të tilla janë fletëhyrjet, faturat, situacionet e shpenzimeve, fletëdaljet, mandat arkëtimet, mandat pagesat, procesverbalet, dhe të tjera akte me natyrë verifikues shpenzimi.

c) Dokumente të kontabilitetit - janë dokumentet përmbledhëse, ose regjistrat kontabël (libri i madh, librat analitikë, kartelat e aktiveve, etj.) të çdo lloji forme, bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.”

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi ish Titullari i AK znj. Z. B në cilësinë e Zyrtarit Autorizues, Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar znj. S. T si dhe znj. F. G në cilësinë e regjistruarit të urdhër shpenzimit.

Për sa më sipër, është mbajtur Akt Konstatimi nr. 13, datë 02.02.2026 dhe nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të MKTS, sipas shkresës me nr. 244/38 prot., datë 13.03.2026, administruar në KLSH me nr. 951/26 prot., datë 13.03.2026, janë paraqitur observacionet si më poshtë trajtuar.

Pretendimi i subjektit:

“Në zbatim të konstatimeve të KLSH, është nxjerrë Urdhri nr. 84, datë 05.02.2026 për aplikimin e penalteteve dhe marrjen e masave për arkëtimin e tyre megjithatë këto argumente nuk janë marrë në konsideratë. Në vijim, MTKS i ka përcjellë kontraktorit “2” njoftimin dhe faturën për arkëtimin e penaltetit. Kontraktori ka paraqitur kundërshtime lidhur me mënyrën e përlllogaritjes së penaltetit, duke argumentuar se ai duhet të përlllogaritet mbi vlerën e kontratës pa TVSH dhe jo me TVSH. Duke marrë në konsideratë parashikimet e Ligjit nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit TVSH përbën detyrim tatimor dhe nuk është pjesë e vlerës reale të punimeve, penalteti u rlllogarit mbi vlerën e kontratës pa TVSH. Për një vonesë prej 22 ditësh, penalteti rezulton në vlerën **17,154,636 lekë**, sipas formulës së përcaktuar në kontratë. Në vijim, kontraktori 2T ka kryer pagesën e penaltetit në llogarinë e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit, duke mbyllur kështu financiarisht procesin. Mandat-pagesa përkatëse gjendet bashkëlidhur këtij observacioni. Në këto kushte, duke qenë se penalteti është vendosur dhe arkëtuar në buxhetin e institucionit, vlerësojmë se konstatimi për favorizim të sipërmarrësit nuk qëndron. Bashkëlidhur gjeni mandat-pagesën e kryer nga kontraktori 2T në llogari të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit për likuidimin e vlerës së penaltetit.”

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Pretendimet tuaja si më sipër janë marrë në konsideratë nga ana e Grupit të Auditimit duke bërë edhe korrigjimet përkatëse gjatë materialit.

3. Kontrata me objekt Ndërrhyrje emergjente në objektin monument kulture Ura e Matit
Projekti i zbatimit

Në zbatim të Programit të Auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Dosja teknike e zbatimit të punimeve të kontratës me objekt ‘Ndërrhyrje emergjente në objektin monument kulture Ura e Matit’;
- Korresponenca të ndryshme;

Projekti i zbatimit

Projekti i zbatimit rezulton të jetë hartuar nga ana e Universitetit Politeknik i Tiranës (UPT) dhe ka marrë miratimin nga ana e Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT) sipas Vendimit nr. 3, datë 26.12.2023. Leja e ndërtimit rezulton të jetë me nr. 212/9, datë 26.03.2024. Nga ana e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM) është miratuar projekti sipas vendimit nr. 56, datë 13.02.2023, administruar në KKTKM me nr. 148 prot., datë 13.02.2023.

Zbatimi i kontratës

Në përfundim të procedurës së konkurrimit, rezulton se fitues është shpallur fitues BOE A.N.K & AD-S, të përfaqësuar këta nga OE A. me përfaqësues ligjor z. A. K. Mes palëve Autoritet Kontraktor (Ministria e Kulturës) me përfaqësues znj. Z. B, Sekretar i Përgjithshëm dhe BOE A. & A, është lidhur kontrata e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 6367/9 prot., datë 27.12.2023 me vlerë të kontratës **55,991,574 lekë me TVSH** dhe me afat 30 ditë. Me shkresën e kontraktorit datë 23.01.2024 i është kërkuar MK:

- Pasaporta për regjistrimin e pasurisë kulturore;
- Dorëzimi i kantierit;
- Sigurimi i lejeve nga institucionet publike përgjegjëse për punimet e ndërhyrjes;

Kontrata rezulton të jetë amenduar sipas aktit me nr. 886/3 prot., datë 23.08.2024 të lidhur mes Autoritet Kontraktor (Ministria e Kulturës) dhe BOE A. & A në lidhje me afatin e përfundimit të punimeve, duke e shtyrë atë me 24 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës së amenduar. Për shërbimin e mbikëqyrjes është lidhur kontrata përkatëse mes palëve Autoritet Kontraktor (Ministria e Kulturës) me përfaqësues znj. Z.B, Sekretar i Përgjithshëm dhe UPT me përfaqësues Administratorin z. B. A, është lidhur kontrata e sipërmarrjes së punimeve e administruar në MK sipas aktit me nr. 353/18 prot., datë 05.01.2024 me vlerë të kontratës 1,666,899 lekë me TVSH sipas të cilës inxhinierët mbikëqyrës rezultojnë ing. M. B, ing. A.S dhe ing. O.B. Për shërbimin e kolaudit të punimeve të përfunduara është lidhur kontrata përkatëse me OE A.E me përfaqësuese ligjore znj. E.C sipas aktit me nr. 11170/8 prot., datë 19.12.2024. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në datën 11.06.2024 është bërë dorëzimi i sheshit të ndërtimit, njoftimi për fillimin e punimeve si dhe procesverbali përkatës mes palëve. Në datën 12.06.2024 është mbajtur edhe procesverbali i piktimit të objektit. Në datën 27.06.2024, sipërmarrësi i punimeve me një shkresë drejtuar MEKI dhe mbikëqyrësit të punimeve ka sqaruar problematikën e prurjeve në shtratin e lumit Mat që kanë ndikuar dhe pritësin të ndikonin në vijimin e punimeve. Të tilla, nga ana e sipërmarrësit janë përmendur:

- Ngritja e nivelit të ujit për shkak të shkarkimeve të hidrocentraleve në rrjedhën e sipërme të lumit Mat;
- Ndërtimi dhe meremetimi i pritës për udhëzimin e ujit të lumit për vaditje në krahun verior – Lezhë;

Në lidhje me këtë dy aspekte, kontraktori ka kërkuar marrjen sa më parë të masave të nevojshme. Në datën 07.07.2024, sipërmarrësi i punimeve me një shkresë drejtuar MEKI dhe mbikëqyrësit të punimeve, ka kërkuar shtyrjen e afatit të dorëzimit të punimeve duke cituar faktin se gjatë kësaj periudhë në objekt janë realizuar 65 % e punimeve dhe se gjatë kësaj kohe punimet janë pezulluar disa herë për arsye të nivelit të lartë të ujit të lumit Mat, gjë që ka bërë të pamundur vazhdimin e punimeve për betonimin e bazamenteve të betonit. Gjatë zbatimit rezulton se projekti dhe preventivi i kanë pësuar ndryshime. Me procesverbalin e mbajtur mes palëve në datën 15.07.2024 është bërë miratimi i ndryshimeve të preventivit të kontratës, i përdorimit të fondit rezervë si dhe i zërit të ri në preventiv nga ana e mbikëqyrësit dhe AK të përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm i MEKI. Sipas shkresës me nr. 8861/2 prot., datë 22.07.2024, nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm

të MEKIT i është përcjellë mbikëqyrësit dhe sipërmarrësit miratimi i ndryshimeve në projekt preventiv duke kërkuar edhe aplikimin në KKTKM për miratimin e ndryshimeve. Me shkresën e administruar në UPT me nr. 1594/4 prot., datë 05.08.2024 nga ana e sipërmarrësit është bërë kërkesë për shtyrjen e afatit të dorëzimit të punimeve. Sipas shkresës citohet se:

“... deri në këtë fazë është kryer 75 % e punimeve të parashikuara në projekt dhe se gjatë kësaj periudhë punimet janë pezulluar disa herë për arsye të nivelit të lartë të ujit të lumit Mat, gjë që ka bërë të pamundur vazhdimin e punimeve për betonimin e bazamenteve të betonit. Gjatë kësaj kohe kemi propozuar edhe zgjidhje alternative të ndërtimit të themeleve duke rrethuar zonën e tyre me palankola çeliku, por këto zgjidhje nga njëra anë do të shtonin kostot dhe nga ana tjetër do të kërkonin kohë. Si rrjedhojë u vendos që të vijonte puna sipas parashikimit në projekt, por me ecuri më të ngadaltë sesa e parashikuara për shkak të ndërtimit të themeleve në prani të lartë uji. Ndërkohë, vështirësi janë shfaqur edhe në piketimin e strukturës mbajtëse e cila kërkon përpikmëri të lartë gjeodezike për tu pozicionuar në vendin e duhur dhe për të shërbyer sipas qasjes së parashikuar në projekt. ...”

Në dosje rezultojnë gjithashtu disa shkresa të sipërmarrësit drejtuar mbikëqyrësit dhe AK por të pa dorëzuar në MEKI zyrtarisht.

Tabela nr. 1

Nr.	Vlera e situacionit	Fatura tatimore
1	50,067,314	2762, datë 06.09.2024
2 Përfundimtar	5,923,637	3158, datë 05.12.2024

Me shkresën e administruar në MEKI me nr. 11335 prot., datë 16.09.2024 është bërë njoftimi nga ana e sipërmarrësit për përfundimin e punimeve në po këtë datë. Në lidhje me përfundimin e punimeve është mbajtur edhe procesverbali përkatës mes palëve sipas të cilit është konfirmuar po kjo datë e përfundimit të punimeve.

Nga krahasimi i zërave të likuiduar e me ato të situacionuara e të pasqyruara në librezën e masave rezultojnë diferenca në volume me pasojë dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën prej **5,986,400 lekë pa TVSH**.

- Zëri Shtresë stabilizanti:

Sipas librezës së masave dhe situacionit përfundimtar ky zë paraqitet në sasinë prej 2000 m³. Në fakt, referuar preventivit të hartuar nga ana e grupit të punës të ngritur me urdhër të brendshëm të UPT me nr. 252/4 prot., datë 30.01.2023 (preventivi i projektuesit) ky zë është parashikuar në sasinë prej 2000 m², pra në njësi m² dhe jo m³. Në vijim, referuar materialit fotografik të ndodhur në dosjen teknike dhe ditarit të punimeve rezulton se nga ana e kontraktorit nuk është përdorur material stabilizant dhe asnjë prej nën zërave të përshkruar në analizën me nr. 3.212/d të manualit teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit. Për rrjedhojë duke bërë korrigjimin për zërin *Mbushje me zhavorr pas mureve*, me çmim njësi 1,037 lekë/m³ rezulton se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit vlera prej **2,126,000 lekë pa TVSH** [(2,100 lekë/m³ – 1,037 lekë/m³) x 2,000 m³].

- Zëri Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri në 1.0 km:

Sipas librezës së masave ky zë rezulton në sasinë prej 5,430 m³ kurse sipas situacionit përfundimtar ky zë paraqitet në sasinë prej 5,200 m³. Në këtë sasi janë përfshirë transporti i materialeve si më poshtë:

- Mbushje me gur kave D>75 cm rreth këmbës së urës;
- Transport gurë prita ekzistuese;
- Mbushje me gurë prita e re;
- Transport dheu (rruga);
- Gërmim dheu me ekskavator me goma 0.25 m3 (pllakat e konstruksionit);

f. Transport stabilizanti;

Në fakt, referuar preventivit të hartuar nga ana e grupit të punës të ngritur me urdhër të brendshëm të UPT me nr. 252/4 prot., datë 30.01.2023 (preventivi i projektuesit) rezulton se disa prej zërave të mësipërm e kanë të përfshirë zërin e transportit në çmimin e realizimit të zërit të punës. Konkretisht, volumi *Mbushje me gur kave* $D > 75 \text{ cm}$ rreth këmbës së urës, sipas analizës së grupit të projektimit me emërtim An-Fin-1 rezulton se ka të përfshirë edhe vlerën e nevojshme për transportin e materialit. Gjithashtu në mënyrë të ngjashme rezultojnë edhe volumet volumin *Mbushje me gurë prita e re*, ose sasia prej $3,698 \text{ m}^3$. Duke bërë llogaritjet rezulton se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve sasia prej vlera prej $1,732 \text{ m}^3$ ($5,430 \text{ m}^3 - 3,698 \text{ m}^3$), ose vlera **519,600 lekë pa TVSH**.

- Zëri Skelë metalike deri 10 m:

Sipas librezës së masave ky zë rezulton në sasinë direkte të pa detajuar prej $2,400 \text{ m}^2$ dhe po kaq rezulton edhe në situacionin përfundimtar. Në fakt, referuar preventivit të hartuar nga ana e grupit të punës të ngritur me urdhër të brendshëm të UPT me nr. 252/4 prot., datë 30.01.2023 (preventivi i projektuesit) rezulton se skela metalike për montimin konstruksionit të skeletit mbajtës, është parashikuar te analiza përkatëse e këtij zëri, konkretisht në analizë me nr. An-Fin-3. Për rrjedhojë likuidimi si zë më vete i zërit *Skelë metalike deri në 10 m* është zë i likuiduar dy herë. Në këtë rast vlen të theksohet fakti, se edhe si nën zë i analizës me nr. An-Fin-3, referuar materialeve fotografike të ndodhura në dosje, ky proces pune nuk është kryer. Duke bërë llogaritjet rezulton se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit vlera prej **1,440,000 lekë pa TVSH**.

- Zëri Rrethim rruge me rrjetë teli (për ngritjen e kantierit):

Sipas librezës së masave ky zë rezulton në sasinë prej $1,056 \text{ m}^2$ dhe po kaq rezulton edhe në situacionin përfundimtar. Në fakt, referuar Udhëzimit nr. 2, datë 08.05.2003 "*Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit*", kreu II Struktura e kostos së punimeve të ndërtimit, paragrafi *Shpenzime të përgjithshme, përcaktohet se:*

"Në shpenzimet e përgjithshme përfshihen:

1. Pagat bazë, shtesat mbi pagë e lejet e zakonshme të personelit inxhiniero-teknik e administrativ, rojeve, shofereve etj. Këtu përfshihen pagat bazë dhe shtesat mbi pagë të fuqisë punëtore, që punon në objekt edhe për kohën e ndërprerjes së punës për arsye atmosferike etj.
2. Shpenzimet për amortizimin e mekanizmave, inventarit të imët mjeteve vetjake (trapano, kriko, makara, karroca dore, vegla pune etj.).
3. Shpenzimet për masat e sigurimit teknik, **rrethimet e përkohshme gjatë ndërtimit në lartësi, skelat, makineritë, tabelat sinjalizuese etj.** për mbrojtjen në pune si trajtimi me veshmbathje, ushqimore, antidode, ndihme e shpejtë etj.
4. Shpenzimet e ndryshme për marketing, udhëtime e dieta, kancelari, ndriçim, telefoni, poste, autovetur, mjetet e furnizimit, **të parkimit e magazinimit** etj., si dhe interesat, siguracionet, taksat etj.
5. Shpenzimet periodike për punimet gjeotopografike gjatë ndërtimit, për provat e materialeve, prodhimeve e konstruksioneve, si dhe gjatë marrjes në dorëzim dhe kolaudit të punimeve etj.
6. Shpenzimet për marrjen me qira të ndërtesave të ndryshme dhe për ndërtime të përkohshme për zyra, magazina, nyje llaç-betoni e hekur-beton etj., rrugët e vinç-kullave, ndriçimi e territorit, linjat e furnizimit me energji elektrike, telefoni, ujësjellës, kanalizime si dhe sheshe e rruge, brenda e jashtë sheshit të ndërtimit etj.

Për vepra të mëdha ose dhe ato të veçuara, në varësi të vendit të ndërtimit, kohëzgjatjes së punimeve etj., në marrëveshje dhe në mbështetje të projekt organizimit e preventivit përkatës mund të parashikohen me vete punimet për ndërtimet e përkohshme që nuk përfshihen në shpenzimet e

përgjithshme të sipërmarrësit, si ndërtimi i fjetoreve dhe magazinave të përkohshme, të fabrikës të betonit, asfaltbetonit, laboratorëve, bazave të prodhimeve dhe konstruksioneve etj.

7. Shpenzimet e parashikuara në zërat e punës dhe në shpenzimet e drejtpërdrejta: zgjedhja e kampioneve, të rifiniturave, lagia, mirëmbajtja dhe mbrojtja e punimeve nga shiu e ngricat pas kohës normale të punës, pastrimi dhe sistemimi i objektit e sheshit të ndërtimit, para dhe gjatë marrjes në dorëzim etj.”

Nga sa më sipër rezulton se vlera e likuiduar prej **1,900,800 lekë pa TVSH** është përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve. Në situacionin përfundimtar rezultojnë gjithashtu edhe zërat si më poshtë për të cilët janë likuiduar edhe vlerat respektive për sasitë përkatëse:

- Zëri Ekskavator 0.5 m³, 80 orë pune, vlera prej 200,000 lekë pa TVSH;
- Zëri Buldozer S-80/100 KF, 80 orë pune, vlera prej 280,000 lekë pa TVSH;
- Zëri Kamion 25-30 ton, 80 orë pune, vlera prej 168,000 lekë pa TVSH;

Sipër librezës së masave këta zëra në vlerë totale prej nuk janë të justifikuar në mënyrë analitike por janë të vendosur në mënyrë direkte prej 80 orë pune.

Përveç sa më sipër rezulton se në dosje nuk janë dorëzuar raportime të rregullta çdo 45 ditë.

Si përfundim, rezulton se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve vlera prej 5,986,400 lekë pa TVSH e cila përbën dëm ekonomik dhe si e tillë duhet të arkëtohet ndaj sipërmarrësit të punimeve BOE si dhe janë përdorur pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet fondet në shumën prej 648,000 lekë pa TVSH.

Veprimet dhe mosveprimet e kryera nga personat përgjegjës janë në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7/1, “Përgjegjësia e mbikëqyrësit”, ku përcaktohet se: “1. Mbikëqyrësi/grupi i mbikëqyrësve të punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit. Kur mbikëqyrësi i punimeve konstaton raste të ndryshimit të projektit, është i detyruar të njoftojë menjëherë Inspektoratin Vendor të Mbrojtjes së Territorit të bashkisë. 2. Mbikëqyrësi/grupi i mbikëqyrësve të punimeve, në çdo rast, kur gjatë mbikëqyrjes së punimeve, sipas fazave përkatëse, konstaton mospërputhjen e punimeve të kryera me lejen e ndërtimit, me dokumentet e planifikimit e të kontrollit të zhvillimit dhe me legjislacionin në fuqi që rregullon veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, urdhëron pezullimin e punimeve të ndërtimit dhe njofton menjëherë Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit të bashkisë ku kryhen punimet e ndërtimit dhe autoritetin përgjegjës të planifikimit ose, sipas rastit, edhe Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.”, neni 12 ku përcaktohet se: “Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshetrohen kolaudit tekniko-ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse: 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve.”; VKM nr. 610, 22.09.2022 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”, neni 1, ku përcaktohet se: “1. Mbikëqyrja e punimeve bëhet për të gjitha llojet e objekteve të ndërtimit dhe kryhet nga mbikëqyrës/grupi i mbikëqyrësve të punimeve, i cili ka përgjegjësi kontrollin e mbarëvajtjes të të gjithë procesit të zbatimit të punimeve, në përputhje me projektin, rregullat dhe standardet teknike të projektimit, zbatimit, si dhe destinacionin e objektit,

duke pasur parasysh edhe anën ekonomike të tij.”, neni 5 ku përcaktohet se: “1. Zhvilluesi lidh kontratë me mbikëqyrësin e punimeve, duke përcaktuar detyrimet e ndërsjella, kushtet e punës, tarifën, rastet e zëvendësimit, sipas pikës 2, të nenit 6, të këtij vendimi, dhe detyrimin e mbikëqyrësit për të raportuar pranë autoriteteve çdo 45 (dyzet e pesë) ditë për gjendjen e zhvillimit të punimeve.”, neni 7 ku përcaktohet se: “Mbikëqyrësi i punimeve në bashkëpunim me zbatuesin e punimeve programon punimet që do të kryhen në objekt nëpërmjet një plani të shprehur në grafik për çdo muaj. Ai mbikëqyr grafikun e punimeve, kontrollon librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumentacionit që mbahet në objekt.”, neni 8 ku përcaktohet se: “1. Mbikëqyrësi ka detyrimin të raportojë te zhvilluesi, çdo 45 (dyzet e pesë) ditë për kryerjen e punimeve, sipas fazave të akteve të kontrollit, në përputhje me nenin 42, të këtij vendimi. 2. Mbikëqyrësi ka detyrimin të njoftojë on-line në sistemin e-leje pranë autoriteteve përkatëse kryerjen e punimeve, sipas fazave të akteve të kontrollit, në përputhje me nenin 42, të këtij vendimi. Ai njofton on-line brenda 5 (pesë) ditëve pune në sistemin e-leje pranë autoriteteve përkatëse në rastet kur vëren se punimet e kryera janë në shkallë apo tejkalim të lejes së ndërtimit, si dhe kryen on-line çdo 45 (dyzet e pesë) ditë raportimin e kryerjes së punimeve, sipas metodologjisë së përcaktuar nga organi i lëshimit të lejes së ndërtimit.”, neni 12 ku përcaktohet se: “Mbikëqyrësi i punimeve kontrollon dhe pranon paraprakisht situacionet pjesore në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të miratuara nga zhvilluesi.”, neni 15 ku përcaktohet se: “Mbikëqyrësi i punimeve kryen matjet në kantier në bashkëpunim me zbatuesin e punimeve dhe për çdo shmangie të konstatuar mbi atë të lejuarën, të përcaktuar në aktet ligjore për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, pezullon punimet dhe njofton menjëherë zhvilluesin, autoritetin e lëshimit të lejes së ndërtimit dhe Inspektoratin Vendor të Mbrojtjes së Territorit/Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit në sistemin e-leje.”, neni 18 ku përcaktohet se: “1. Mbikëqyrësi i punimeve kontrollon zbatimin e grafikut të punimeve dhe i raporton çdo 45 (dyzet e pesë) ditë zhvilluesit për realizimin e tij, Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit/Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, si dhe autoritetit që lëshon lejen e ndërtimit”, neni 19 ku përcaktohet se: “1. Mbikëqyrësi i punimeve njoftohet nga zbatuesi i punimeve kur punimet që do të mbulohen, do të maskohen ose do të betonohen janë gati për t’u kontrolluar prej tij. Me marrjen e njoftimit nga zbatuesi i punimeve, mbikëqyrësi i punimeve kontrollon dhe miraton çdo punim përpara se të mbulohet, maskohet ose betonohet. 2. Në rast se mbikëqyrësi nuk njoftohet në kohë dhe punimet për maskimin ose betonimin janë kryer, mbikëqyrësi mban një procesverbal në prezencë të drejtuesit të punimeve, dhe njofton zhvilluesin dhe IKMT-në. Punimet fillojnë pas përcaktimit nga IKMT-ja për ecurinë e procesit të ndërtimit.”, neni 22 ku përcaktohet se: “Mbikëqyrësi i punimeve kontrollon faturat e blerjes së materialeve dhe të çdo shpenzimi tjetër, që është i lidhur me ndërtimin e objektit, situacionet e paraqitura nga zbatuesi i punimeve në fazat e ndryshme të punimeve, si dhe kontabilitetin.”, neni 38 ku përcaktohet se: “1. Korrespondenca e mbikëqyrësit të punimeve me zhvilluesin dhe zbatuesin e punimeve është pjesë e dokumentacionit të objektit. 2. Në dosjen e mbikëqyrjes së punimeve pasqyrohen të gjitha aktet e mbajtura gjatë zbatimit të objektit, si akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit, urdhrat e ndryshëm të dhënë nga mbikëqyrësi i punimeve, kundërshtitë dhe kontradiktat e lindura gjatë punës, si dhe zgjidhjet e tyre, ndërprerjet e punimeve dhe shkaqet që kanë diktuar këto ndërprerje, relacionet teknike të kërkuara ose të paraqitura gjatë zbatimit, si dhe të gjitha rrethanat e nevojshme për të dhënë kuadrin e plotë të të gjitha fazave të zbatimit të punimeve.”; Udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu II Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, pika 3 ku përcaktohet se: “Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi: a. Realizimin e objektit, në përputhje me

projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike. b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar. c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi. ç. Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes.”; VKM nr. 216, datë 13.04.2023, “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”, neni 6 ku përcaktohet se: “Hartimi i preventivit apo situacionit, si dhe zbatimi i mbikëqyrjes së çdo punimi ndërtimi, që realizohet nga persona fizikë dhe juridikë, publikë ose privatë, me fonde publike ose private, në territorin e Republikës së Shqipërisë, do të bëhet nëpërmjet sistemit të integruar të manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim.”, neni 7 “Preventivat për çdo objekt, të hartuara nëpërmjet sistemit të integruar të manualit të çmimeve për zërat e punimeve në faqen e preventivave të unifikuar në portalin unik qeveritar e-Albania, sipas metodologjisë së llogaritjes së kostos, janë pjesë e dokumentacionit teknik të çdo objekti të projektuar apo të ndërtuar në Republikën e Shqipërisë”, neni 8 “1. Vlerat e zërave të punës së preventivave të objekteve ndërtimore, të projektuara nga subjekte, publike apo private, përcaktohen nga prodhimi i volumeve të punës, të llogaritura në librezën e masave të projektit, me çmimet për njësi në sistemin e integruar të manualit të çmimeve. 2. Vlera e zërave të punës, të situacioneve e të ndërtimit përcaktohen nga prodhimi i volumeve të punës, të llogaritura në librezën e masave të zbatimit me çmimet për njësi të llogaritura mbi bazën e analizave teknike të punimeve të ndërtimit, sipas vlerave faktike; neni 12 “Të gjitha subjektet, private apo publike, që kryejnë veprimtari në fushën e tregtimit të materialeve apo të produkteve të ndërtimit ose në fushën e ndërtimit nëpërmjet shërbimit të dedikuar elektronik në portalin unik qeveritar e-Albania, paraqesin analizat teknike dhe çmimet për çdo zë pune në ndërtim, për materialet e reja dhe/ose për teknologjitë e reja, të përdorura prej tyre, për të cilat nuk ekziston një analizë teknike e çmimit në manualin elektronik. Analizat teknike paraqiten në përputhje me metodologjinë e parashikuar në udhëzimin nr. 2, datë 8.5.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”; Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, ku përcaktohet se: “8.1 Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasitë, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës. 8.3 Çmimet jashtë kontratës caktohen sipas analizave teknike në fuqi, **me vlerën ekonomike më të mirë**; Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve e lidhur me UPT & Ministrisë së Kulturës sipas aktit nr. 353/18 prot., datë 05.01.2024, neni 7 Detyrime të Kontraktuesit; Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve e lidhur sipas aktit me nr. 11170/8 prot., datë 19.12.2024.

Lidhur me sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi mbikëqyrësit e punimeve z. M. B, z. A. S si dhe z. O.B si dhe kolaudatori i punimeve znj. E. C, përfaqësuese ligjore e OE A.E

3. Zbatimi i kontratës me objekt “Blerje pajisje TIK”, me vlerë 30,920,000 lekë pa TVSH
Nëpërmjet shkresës nr. 5147 prot., datë 22.04.2024, Drejtori i Drejtorisë së Aseteve dhe Shërbimeve të Përgjithshme pranë MEKI ka kërkuar nga Drejtoria e Prokurimeve zhvillimin e procedurave për nevojat për pajisje elektronike. Nëpërmjet shkresës nr. 5147/1 prot., datë 22.04.2024, drejtuar AKSHI-t, Ministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit ka kërkuar zhvillimin e procedurës së prokurimit për blerje pajisje informatike, sipas llojit dhe sasive në kërkesën nga njësia, si më poshtë:

Nr.	Pajisja	Sasia
1	Kompjuter All-in-one (AIO) 23’’	160
2	Kompjuter All-in-one (AIO) 27’’	20
3	Kompjuter Workstation	20
4	Laptop Advanced	20

Nëpërmjet shkresës administruar në MEKI me nr. 5147/2 prot., datë 09.05.2024, AKSHI ka përcjellë autorizimin për lidhje kontrate, sipas kërkesave nga MEKI, me OE “I.S” shpk, me ofertë ekonomike 30,920,000 lekë pa TVSH, duke bashkëlidhur dokumentacionin shoqërues të procedurës së prokurimit.

Ndërmjet MEKI dhe OE “I.S” shpk është lidhur kontrata e furnizimit nr. 5147/3 prot., datë 29.05.2024, me vlerë totale prej 30,920,000 lekë pa TVSH dhe 37.104,000 lekë me TVSH, me afat lëvrimi 30 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës.

Nëpërmjet Urdhrit nr. 372, datë 03.06.2024 është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të artikujve, i përbërë nga A. O, E. M dhe M. C (magaznier).

1. Nëpërmjet PV të datës 06.06.2024 (i paprotokolluar), Komisioni i marrjes në dorëzim ka pranuar sasinë prej 20 laptop Dell, duke bashkëlidhur Aneksin I të PV ku janë specifikuar numrat serial dhe barcode-t për secilin prej artikujve, dhe një listë me të dhëna mbi specifikimet teknike të artikujve, që përputhen me specifikimet teknike të përcaktuara në ofertë. Artikujve u është bërë hyrje në magazinë nëpërmjet Fletë-hyrjes nr. 4, datë 06.06.2024.

OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 693, datë 03.09.2024**, në vlerën prej **4,771,200 lekë**, bazuar në faturën elektronike nr. 778/2024, datë 06.06.2024.

2. Nëpërmjet PV nr. 5147/7 prot., datë 24.06.2024, Komisioni i marrjes në dorëzim ka dokumentuar furnizimin me sasinë prej 160 kompjuter AIO 23’’, 20 kompjuter AIO 27’’, dhe 20 kompjuter workstation, duke cituar *“grupi i punës ka bërë magazinimin e mallit për të zbatuar afatet e kontratës, por ka kërkuar kohën e nevojshme për verifikimin e specifikimeve teknike”*, ndërkohë që PV është nënshkruar nga anëtarët E. M dhe M.C, ndërsa për anëtarin specialist fushe A.O citohet *“me leje”*. Pavarësisht sa më sipër, artikujve u është bërë hyrje në magazinë nëpërmjet Fletë-hyrjes nr. 7, datë 24.06.2024 dhe është pranuar fatura elektronike e lëshuar nga OE. Fletë-hyrja nr. 7, datë 24.06.2024 nuk përmban shënimin *“vlerë në ruajtje”*, në kundërshtim me pikën 49 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”*. Ky veprim, së bashku me pranimin e faturës së lëshuar nga subjekti nr. 850/2024, pamundëson kryerjen e hapave korrektive në rast se artikujt nuk do të ishin në përputhje me specifikimet teknike.

Nëpërmjet PV nr. 5147/8 prot., datë 16.07.2024, Komisioni i marrjes në dorëzim ka pranuar artikujt e furnizuar, duke pasqyruar numrat serial dhe barcode-t e secilit prej artikujve. OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 694, datë 03.09.2024**, në vlerën prej **32,332,800 lekë**, bazuar në faturën elektronike nr. 859/2024, datë 24.06.2024.

4. Zbatimi i kontratës me objekt Loti I “Blerje pajisje për kabinetet Hoteleri – Turizëm”, me vlerë 34,453,180 lekë pa TVSH

Nëpërmjet shkresës administruar në MEKI me nr. 15638 prot., datë 12.12.2024, Operatori i Blerjeve të Përqendruara ka përcjellë dokumentacionin për lidhjen e kontratës për procedurën e prokurimit, duke bashkëlidhur dokumentacionin e procedurës dhe ofertës së operatorit të shpallur fitues. Në formularin e ofertës teknike janë paraqitur artikujt që do të furnizohet, 18 artikuj për shkollën “Hysen Çela”, Durrës, 10 artikuj për shkollën “Hamdi Bushati”, Shkodër, 17 artikuj për Shkollën Profesionale të Shërbimeve Korçë, 10 artikuj për Shkollën Profesionale Hoteleri – Turizëm, Tiranë dhe 15 artikuj për Shkollën e Mesme “Enver Qiraxhi” Pogradec, në total 70

artikuj. Në këtë formular janë paraqitur nominalisht artikujt, emri i kompanisë prodhuese, origjina e mallit, emërtimi i katalogut të produktit dhe numri i faqes dhe i referencës në katalogun e prodhuesit, si dhe certifikimet respektive të produkteve.

Ndërmjet AK “MEKI” dhe OE “A.Z” shpk është lidhur kontrata e furnizimit nr. 15638/2 prot., datë 20.12.2024, me vlerë totale prej **34,453,180 lekë pa TVSH** dhe **41,343,816 lekë me TVSH**, me afat zbatimi 60 ditë. Në nenin 5.2 të kontratës përcaktohet se dorëzimi i mallit do të bëhet direkt pranë shkollave përkatëse.

Nëpërmjet Urdhrit të Ministrit nr. 1137, datë 23.12.2024 është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të mallit, i përbërë nga I.P, E. L, D. V. Në komisionin e marrjes në dorëzim të mallit nuk rezultoi të jetë përfshirë personi përgjegjës për materialin (magazineri), në kundërshtim me pikën 43 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

1. Nëpërmjet procesverbalit të datës 26.12.2024 (i paprotokolluar), Komisioni ka dokumentuar marrjen në dorëzim të një pjese të artikujve, përkatësisht për 18 artikuj për shkollën “*Hysen Çela*”, Durrës, 10 artikuj për shkollën “*Hamdi Bushati*”, Shkodër, dhe 10 artikuj për *Shkollën Profesionale Hoteleri – Turizëm*, Tiranë. Artikujve u është bërë hyrje në magazinë nëpërmjet fletë-hyrjes nr. 28, datë 26.12.2024. OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 1267, datë 20.01.2025**, në vlerën prej **20,189,820 lekë**, bazuar në Faturën elektronike nr. 92/2024, datë 26.12.2024. Komisioni ka dokumentuar me PV përkatës shpërndarjen e artikujve në shkollat respektive.

2. Nëpërmjet procesverbalit të datës 27.12.2024 (i paprotokolluar), Komisioni ka dokumentuar marrjen në dorëzim të pjesës së mbetur të artikujve, përkatësisht 17 artikuj për Shkollën Profesionale të Shërbimeve Korçë dhe 15 artikuj për Shkollën e Mesme “*Enver Qiraxhi*” Pogradec. OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 1332, datë 22.01.2025**, në vlerën prej **21,153,996 lekë**, bazuar në Faturën elektronike nr. 96/2024, datë 27.12.2024. Komisioni ka dokumentuar me PV përkatës shpërndarjen e artikujve në shkollat respektive.

Në të dyja rastet, Komisioni ka përcaktuar në procesverbalet e marrjes në dorëzim artikujt sipas sasive dhe çmimit, *por nuk ka dokumentuar kryerjen e verifikimit lidhur me prodhuesin dhe vendin e origjinës, sipas ofertës dhe formularit teknik të paraqitur nga operatori ekonomik në fazën e ofertimit*, në kundërshtim me nenin 107, pika 6, të RPP-së, nenin 6.3 të Kontratës nr. 15638/3 prot., datë 23.12.2024, si dhe me Rekomandimet e vazhdueshme të APP-së mbi problematikat e konstatuara gjatë zbatimit të kontratave të furnizimit të mallrave, ndër të fundit përcaktuar në pikën 7 të Rekomandimit të APP-së nr. 2118 prot., datë 04.03.2024, ku citohet se *PV duhet të përshkruajë me saktësi mallrat e furnizuara me treguesit e tyre sasiorë, cilësorë dhe të vlerës, si dhe të gjitha veprimet e kryera për verifikimin e mallrave të lëvruar, dokumentacionin shoqërues dhe çdo të dhënë të nevojshme që i japin këtij dokumenti forcën e një prove ligjore ose administrative, për të garantuar përputhshmërinë jo vetëm me DST, por edhe me ofertën e paraqitur nga operatori. Edhe në procesverbalet e shpërndarjes në shkollat përkatëse, nuk janë përcaktuar elementët identifikues të artikujve sipas ofertës teknike, si emri i prodhuesit dhe vendi i origjinës.*

5. Zbatimi i kontratës me objekt Loti II “Blerje pajisje për kabinetet e shërbimit të mjeteve të transportit”, me vlerë 34,879,770 lekë pa TVSH

Nëpërmjet shkresës administruar në MEKI me nr. 14395 prot., datë 13.11.2024, Operatori i Blerjeve të Përqendruara ka përcjellë dokumentacionin për lidhjen e kontratës për procedurën e prokurimit, duke bashkëlidhur dokumentacionin e procedurës dhe ofertës së operatorit të shpallur fitues. Në formularin e ofertës teknike janë paraqitur artikujt që do të furnizohen, 31 artikuj për

Shkollën profesionale Elbasan, 11 artikuj për Shkollën profesionale “Petro Sota”, Fier, 1 artikull për Shkollën e mesme profesionale “Thoma Papano”, Gjirokastrë, 7 artikuj për Shkollën Industriale “Pavarësia”, Vlorë, dhe 6 artikuj për Shkollën Profesionale Teknike Korçë, në total 56 artikuj. Në këtë formular janë paraqitur nominalisht artikujt, emri i kompanisë prodhuese, origjina e mallit, emërtimi i katalogut të produktit dhe numri i faqes dhe i referencës në katalogun e prodhuesit, si dhe certifikimet respektive të produkteve.

Ndërmjet AK “MEKI” dhe OE “L” shpk është lidhur kontrata e furnizimit nr. 14395/2 prot., datë 21.11.2024, me vlerë totale prej **34,879,770 lekë pa TVSH** dhe **41,855,724 lekë me TVSH**, me afat zbatimi 4 muaj.

Nëpërmjet Urdhrit të Ministrit nr. 1089, datë 12.12.2024 është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të mallit, i përbërë nga Xh. P, M. I, A.A, i ndryshuar me Urdhrin nr. 569, datë 18.04.2025, ku M.I zëvendësohet nga S.L. Në komisionin e marrjes në dorëzim të mallit nuk rezulton të jetë përfshirë personi përgjegjës për materialin (magazinieri), në kundërshtim me pikën 43 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

1. Nëpërmjet procesverbalit të datës 26.12.2024 (i paprotokolluar), Komisioni i marrjes në dorëzim ka dokumentuar furnizimin dhe marrjen në dorëzim të 8 artikujve në total, të destinuara për Shkollën profesionale “Petro Sota”, Fier, Shkollën e mesme profesionale “Thoma Papano”, Gjirokastrë, dhe Shkollën Industriale “Pavarësia”, Vlorë. Artikujve u është bërë hyrje në magazinë nëpërmjet fletë-hyrjes nr. 27, datë 26.12.2024. Komisioni ka dokumentuar dorëzimin e pajisjeve në shkollat profesionale respektive nëpërmjet tre procesverbaleve të datës 30.12.2024. OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 1259, datë 20.01.2025**, në vlerën prej **5,708,640 lekë**, bazuar në faturën elektronike nr. 5/2024, datë 26.12.2024.

2. Nëpërmjet procesverbalit të datës 27.12.2024 (i paprotokolluar), Komisioni i marrjes në dorëzim ka dokumentuar furnizimin dhe marrjen në dorëzim për 26 artikuj për Shkollën Profesionale Elbasan. Artikujve u është bërë hyrje nëpërmjet fletë-hyrjes nr. 37, datë 27.12.2024. OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 1258, datë 20.01.2025**, në vlerën prej **8,467,260 lekë**, bazuar në faturën elektronike nr. 7/2024, datë 27.12.2024.

3. Nëpërmjet procesverbalit të datës 26.03.2025 (i paprotokolluar), i nënshkruar nga përfaqësues të Shkollës Profesionale Teknike Korçë dhe OE “L” shpk, është dokumentuar marrja në dorëzim e artikullit “Kaldajë mësimore me sistem ngrohje”, në vlerën prej 2,356,800 lekë me TVSH, pasqyruar në Fletë-hyrjen në magazinë nr. 4, datë 26.03.2025, cituar “Pajisje në ruajtje”. Veprimi i mësipërm është kryer në mungesë të dokumentit autorizues për punonjësit respektivë, pasi Komisioni i marrjes në dorëzim ishte përcaktuar në Urdhrin e Ministrit nr. 1089, datë 12.12.2024, komision i cili sipas nenit 5.4 të kontratës ka detyrimin të hartojë procesverbalin përkatës menjëherë me mbërritjen e mallrave.

Nëpërmjet procesverbalit të datës 09.05.2025 (i paprotokolluar), Komisioni ka dokumentuar marrjen në dorëzim të artikullit “Kaldajë mësimore me sistem ngrohje”. Në PV citohet se “grupi i punës... pas marrjes dijeni për ndryshimin e përbërjes së komisionit nëpërmjet njoftimit elektronik të datës 23.04.2023, u vu në kontakt me përfaqësuesit e shkollës private dhe nisi procesin e verifikimit të dorëzimit të pajisjeve. Duke marrë në konsideratë shpërndarjen gjeografike të shkollave përfituese, si dhe detyrat e tjera funksionale të anëtarëve të komisionit, procesi i verifikimit dhe marrjes përfundimtare në dorëzim ka kërkuar kohë të shtuar”. Ndryshimi i grupit të marrjes në dorëzim ka ndodhur rreth 28 ditë pas procesverbalit të marrjes në dorëzim të hartuar nga përfaqësuesit e Shkollës profesionale Korçë. Në nenin 5.4 të kontratës përcaktohet specifikisht se “Menjëherë me mbërritjen e mallrave në vendin e përcaktuar, Komisioni për marrjen në

dorëzim të mallrave do të hartojë procesverbalin e pritjes së mallit, i cili do të nënshkruhet nga të dy palët, në çastin e pritjes së mallrave në vendin e dorëzimit". Për sa më sipër, për veprimet dhe mosveprimet në kundërshtim me Urdhrin nr. 1089, datë 12.12.2024 dhe nenin 5.4 të kontratës, ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e komisionit të marrjes në dorëzim të përcaktuar në Urdhrin nr. 1089, datë 12.12.2024. Artikulli i është bërë hyrje në magazinë nëpërmjet Fletë-hyrjes nr. 36, datë 09.05.2025. Komisioni ka dokumentuar dorëzimin e pajisjeve në Shkollën Profesionale Teknike Korçë nëpërmjet procesverbalit të datës 21.05.2025.

OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 825, datë 03.07.2025**, në vlerën prej **2,356,800 lekë**, bazuar në Faturën elektronike nr. 5/2025, datë 26.03.2025.

4. Nëpërmjet procesverbalit të datës 28.03.2025 (i paprotokolluar), i nënshkruar nga përfaqësues të Shkollës Profesionale Teknike Korçë dhe OE "L" shpk, është dokumentuar marrja në dorëzim 4 artikujve, në vlerën prej 6,172,800 lekë me TVSH, pasqyruar në Fletë-hyrjen në magazinë nr. 5, datë 28.03.2025, cituar "*Pajisje në ruajtje*". Veprimi i mësipërm është kryer në mungesë të dokumentit autorizues për punonjësit respektivë, pasi Komisioni i marrjes në dorëzim ishte përcaktuar në Urdhrin e Ministrit nr. 1089, datë 12.12.2024, komision i cili sipas nenit 5.4 të kontratës ka detyrimin të hartojë procesverbalin përkatës menjëherë me mbërritjen e mallrave.

Nëpërmjet procesverbalit të datës 09.05.2025 (i paprotokolluar), Komisioni ka dokumentuar marrjen në dorëzim të 4 artikujve. Në PV citohet se "*grupi i punës... pas marrjes dijeni për ndryshimin e përbërjes së komisionit nëpërmjet njoftimit elektronik të datës 23.04.2023, u vu në kontakt me përfaqësuesit e shkollës private dhe nisi procesin e verifikimit të dorëzimit të pajisjeve. Duke marrë në konsideratë shpërndarjen gjeografike të shkollave përfituese, si dhe detyrat e tjera funksionale të anëtarëve të komisionit, procesi i verifikimit dhe marrjes përfundimtare në dorëzim ka kërkuar kohë të shtuar*". Ndryshimi i grupit të marrjes në dorëzim ka ndodhur rreth 26 ditë pas procesverbalit të marrjes në dorëzim të hartuar nga përfaqësuesit e Shkollës profesionale Korçë. Në nenin 5.4 të kontratës përcaktohet specifikisht se "*Menjëherë me mbërritjen e mallrave në vendin e përcaktuar, Komisioni për marrjen në dorëzim të mallrave do të hartojë procesverbalin e pritjes së mallit, i cili do të nënshkruhet nga të dy palët, në çastin e pritjes së mallrave në vendin e dorëzimit*". Për sa më sipër, për veprimet dhe mosveprimet në kundërshtim me Urdhrin nr. 1089, datë 12.12.2024 dhe nenin 5.4 të kontratës, ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e komisionit të marrjes në dorëzim të përcaktuar në Urdhrin nr. 1089, datë 12.12.2024. Artikujve u është bërë hyrje në magazinë nëpërmjet Fletë-hyrjes nr. 38, datë 09.05.2025. Komisioni ka dokumentuar dorëzimin e pajisjeve në Shkollën Profesionale Teknike Korçë nëpërmjet procesverbalit të datës 21.05.2025.

OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 826, datë 03.07.2025**, në vlerën prej **6,172,800 lekë**, bazuar në Faturën elektronike nr. 10/2025, datë 28.03.2025.

5. Nëpërmjet PV të nënshkruara nga përfaqësues të shkollave profesionale dhe OE "L" shpk, është dokumentuar marrja në dorëzim e artikujve pasqyruar në Fletë-hyrje "*pajisje në ruajtje*", si më poshtë:

Nr.	Shkolla	Nr. art.	Vlera	Nr. FH	Datë FH
1	Shkolla "Petro Sota", Fier	7	1,068,804	2	10.04.2025
2	Shkolla "Pavarësia", Vlorë	4	1,871,928	1	10.04.2025
3	Shkolla Profesionale Elbasan	16	12,480,324	10	10.04.2025
4	Shkolla Profesionale Korçë	1	3,409,200	8	10.04.2025

Veprimet e mësipërme janë kryer në mungesë të dokumentit autorizues për punonjësit respektivë, pasi Komisioni i marrjes në dorëzim ishte përcaktuar në Urdhrin e Ministrit nr. 1089, datë

12.12.2024, komision i cili sipas nenit 5.4 të kontratës ka detyrimin të hartojë procesverbalin përkatës menjëherë me mbërritjen e mallrave.

Nëpërmjet procesverbalit të datës 09.05.2025 (i paprotokolluar), Komisioni ka dokumentuar marrjen në dorëzim të artikujve. Në PV citohet se *“grupi i punës... pas marrjes dijeni për ndryshimin e përbërjes së komisionit nëpërmjet njoftimit elektronik të datës 23.04.2023, u vu në kontakt me përfaqësuesit e shkollës private dhe nisi procesin e verifikimit të dorëzimit të pajisjeve. Duke marrë në konsideratë shpërndarjen gjeografike të shkollave përfituese, si dhe detyrat e tjera funksionale të anëtarëve të komisionit, procesi i verifikimit dhe marrjes përfundimtare në dorëzim ka kërkuar kohë të shtuar”*. Ndryshimi i grupit të marrjes në dorëzim ka ndodhur rreth 26 ditë pas procesverbaleve të marrjes në dorëzim të hartuar nga përfaqësuesit e shkollave profesionale. Në nenin 5.4 të kontratës përcaktohet specifikisht se *“Menjëherë me mbërritjen e mallrave në vendin e përcaktuar, Komisioni për marrjen në dorëzim të mallrave do të hartojë procesverbalin e pritjes së mallit, i cili do të nënshkruhet nga të dy palët, në çastin e pritjes së mallrave në vendin e dorëzimit”*. Për sa më sipër, për veprimet dhe mosveprimet në kundërshtim me Urdhrin nr. 1089, datë 12.12.2024 dhe nenin 5.4 të kontratës, ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e komisionit të marrjes në dorëzim të përcaktuar në Urdhrin nr. 1089, datë 12.12.2024. Artikujve u është bërë hyrje në magazinë nëpërmjet Fletë-hyrjes nr. 40, datë 09.05.2025. Komisioni ka dokumentuar dorëzimin e pajisjeve në shkollat profesionale (Fier, Vlorë, Elbasan, Korçë) nëpërmjet 4 procesverbaleve të datës 21.05.2025.

OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 827, datë 04.07.2025**, në vlerën prej **18,896,784 lekë**, bazuar në Faturën elektronike nr. 34/2025, datë 10.04.2025.

Në të gjitha rastet e sipërcituara, Komisioni ka përcaktuar në procesverbalet e marrjes në dorëzim artikujt sipas sasive dhe çmimit, *por nuk ka dokumentuar kryerjen e verifikimit lidhur me prodhuesin dhe vendin e origjinës, sipas ofertës dhe formularit teknik të paraqitur nga operatori ekonomik në fazën e ofertimit*, në kundërshtim me nenin 107, pika 6, të RPP-së, nenin 6.3 të Kontratës nr. 15638/3 prot., datë 23.12.2024, si dhe me Rekomandimet e vazhdueshme të APP-së mbi problematikat e konstatuara gjatë zbatimit të kontratave të furnizimit të mallrave, ndër të fundit përcaktuar në pikën 7 të Rekomandimit të APP-së nr. 2118 prot., datë 04.03.2024, ku citohet se PV *duhet të përshkruajë me saktësi mallrat e furnizuara me treguesit e tyre sasiore, cilësore dhe të vlerës, si dhe të gjitha veprimet e kryera për verifikimin e mallrave të lëvruar, dokumentacionin shoqërues dhe çdo të dhënë të nevojshme* që i japin këtij dokumenti forcën e një prove ligjore ose administrative, për të garantuar përputhshmërinë jo vetëm me DST, por edhe me ofertën e paraqitur nga operatori. Edhe në procesverbalet e shpërndarjes në shkollat përkatëse, nuk janë përcaktuar elementët identifikues të artikujve sipas ofertës teknike, si emri i prodhuesit dhe vendi i origjinës.

6. Kontrata me objekt “Zbatimi i punimeve për restaurimin, rikonstruksionin dhe rinovimin e sallës së koncerteve në Universitetin e Arteve në Tiranë”, viti 2021

Projekti i zbatimit

Projekti për këtë investim është hartuar nga ana e OE AT.

Historiku i zbatimit të punimeve

Në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues BOE K. & U, të përfaqësuar këta nga OE K. me të cilin është lidhur kontrata me Autoritetin Kontraktor sipas shkresës me nr. 904/12 prot., datë 02.04.2021 me vlerë 482,798,847 lekë me TVSh dhe me afat të zbatimit të punimeve 14 muaj pas datës së fillimit të punimeve. Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit nr. 3278/12 prot., datë 26.06.2021 është lidhur kontrata përkatëse e shërbimit mes Ministrisë së Kulturës në cilësinë e AK e përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm i MK znj. E. Ç dhe OE A e

përfaqësuar nga z. A. E me vlerë 6,240,000 lekë me TVSH. Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit nr. 3580 prot., datë 07.07.2023 është lidhur kontrata përkatëse e shërbimit mes Ministrisë së Kulturës në cilësinë e AK dhe OE M. CH e përfaqësuar nga z. B.Y. Sipas shkresës së administruar me nr. 624/1 prot., datë 13.04.2021, nga ana e IKTK është bërë caktimi i mbikëqyrësve znj. A. V dhe B. K si dhe i kolaudatorit të punimeve z. D. P. Për fillimin e punimeve është dhënë vendimi nr. 6, datë 17.03.2021 *Për miratimin e lejes së ndërtimit* nga ana e KKT dhe më pas i është dhënë zhvilluesit (Ministrisë së Kulturës) dokumenti Leje Ndërtimi me nr. 85 prot., datë 09.01.2023 sipas vendimit të mëparshëm të KKT me afat 14 muaj. Dorëzimi i sheshit është kryer sipas shkresës me nr. 904/18 prot., datë 14.07.2021 dhe referuar ditarit, punimet kanë nisur në datën 14.07.2021. Përmes shkresës me nr. 5794 prot., datë 09.11.2021, nga ana e mbikëqyrësit të punimeve, është bërë kërkesë për miratimin e përdorimit të fondit rezervë dhe punimeve shtesë në objektin e kontratës. Një kërkesë e tillë rezulton të jetë kryer edhe nga ana e vet sipërmarrësit të punimeve në datën 08.11.2021 sipas shkresës me nr. 5777 prot., të po kësaj date. Sipas procesverbalit të datës 08.11.2021 është bërë negociimi dhe më pas miratimi i çmimeve të reja si dhe është miratuar përdorimi i fondit rezervë nga ana e Titullarit të AK Ministria e Kulturës dhe në datën 29.12.2021 është bërë edhe miratimi i preventivit të ripunuar. Sipas shkresës së datës 24.12.2021, nga ana e sipërmarrësit të punimeve është bërë *Kërkesë për miratimin e preventivit të rishikuar nr. 1*. Në vijim e njëjta kërkesë i është përcjellë AK nga ana e mbikëqyrësit të punimeve sipas shkresës së administruar në MK me nr. 19/1 prot., datë 05.01.2022. Njëkohësisht, rezulton se, me shkresën e administruar në subjekt me nr. 154 prot., datë 03.12.2021, projekti i rishikuar i është nënshtruar edhe oponencës teknike e cila ka arritur në konkluzionin se projekti i propozuar me porositës MK plotëson kushtet teknike të projektimit. Projekti i rishikuar është miratuar gjithashtu edhe nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale (shkresa e administruar në MK me nr. 1682 prot., datë 13.12.2021). Përmes shkresës me nr. 735 prot., datë 21.06.2022, nga ana e Ministrisë së Kulturës, KKTKM është marrë vendimi nr. 239, datë 21.06.2022 për miratimin e ndryshimit të projektit në lidhje me shkallën e emergjencës. Përmes shkresës së administruar në Ministrinë e Kulturës me nr. 1767/2 prot., datë 16.08.2022 mes sipërmarrësit dhe AK është miratuar amendimi i kontratës në lidhje me afatin e punimeve me 17 muaj (+3 muaj nga kontrata bazë), duke parashikuar kështu datën 14.12.2022 për përfundimin e kontratës. Sipas korrespondencave rezulton se në datën 21.12.2022 nga ana e shoqërisë mbikëqyrëse A, janë njoftuar përfaqësuesit e sipërmarrësit dhe Autoriteti Kontraktor për faktin se afati i përfundimit të kontratës ka qenë data 14.12.2022 dhe se kjo datë ka kaluar dhe ende nuk është bërë njoftimi i përfundimit të punimeve. Përmes shkresës me nr. 354 prot., datë 26.01.2023 (43 ditë pas datës në të cilën punimet duhet të kishin përfunduar), drejtuar mbikëqyrësit të punimeve dhe Autoritetit Kontraktor, nga ana e sipërmarrësit të punimeve është paraqitur një shkresë me objekt *Kërkesë për miratimin e çmimeve të reja në objektin 'Zbatimi i punimeve për restaurimin, rikonstruksionin dhe rinovimin e sallës së koncerteve në Universitetin e Arteve në Tiranë'*. Sipas pretendimeve përmendet fakti se ka patur ndryshime më volumet e punimeve si dhe kanë dalë zëra të rinj me çmime të reja jashtë preventivit të kontratës fillestare dhe të pa përfshira edhe preventivin e ripunuar nr. 1. Gjatë hartimit të preventivit të ri, nga ana e sipërmarrësit janë paraqitur edhe analizat e çmimeve si dhe ofertat e marra prej tij për punimet të cilat nuk përfshihen në manualin e çmimeve të punimeve të ndërtimit. Në përfundim është kërkuar ndjekja e procedurave për miratimin e çmimeve të reja. Në përgjigje të kësaj shkrese, nga ana e mbikëqyrësit të punimeve, sipas shkresës me të datës 09.02.2023, i është kthyer përgjigje sipërmarrësit dhe për dijeni Autoritetit Kontraktor se ... *nuk është e mundur*

të bëhet vlerësimi i asnjë zëri të ri, pa bërë më parë vlerësimin total të preventivit të kontratës, kjo pasi çdo zë i ri do të çonte në tejkalim të vlerës së kontratës.

Në dosjen teknike rezultojnë miratuar preventivi i rishikuar nr. 2 së bashku me volume në vlerën prej 47,572,888 lekë me TVSH (gati 10 % e vlerës totale të kontratës) që shtohen dhe hiqen. Ky preventiv rezultojnë miratuar nga sipërmarrësi, mbikëqyrësi dhe AK të përfaqësuar nga Titullari znj. Z. B dhe administratori i kontratës znj. A P. Për miratimin e këtij preventivi të ripunuar është mbajtur procesverbali përkatës në datën 10.03.2023, ose 14 ditë përpara përfundimit të punimeve mes palëve të përfaqësuar nga sipërmarrësi, mbikëqyrësi dhe Titullari i AK. Sipas shkresës së administruar në MK me nr. 1225 prot., datë 08.03.2023, nga ana e sipërmarrësit është bërë kërkesë për miratimin e preventivit të rishikuar nr. 2, në të cilin janë përfshirë edhe zëra të rinj jashtë preventivit të kontratës fillestare. Pas kësaj, nga ana e mbikëqyrësit të punimeve, sipas shkresës me nr. 20/1 prot., datë 10.03.2023 është paraqitur shkresa me lëndë *Kërkesë për miratimin e preventivit të ripunuar nr. 2 në objektin e kontratës*. Sipas procesverbalit të datës 10.03.2023 mes palëve (sipërmarrës, mbikëqyrës, Autoritet Kontraktor) është bërë miratimi i ndryshimit nr. 2 të volumeve (preventivi të ripunuar nr. 2). Sipas të dhënave të marra rezultojnë se situacionet / pagesat e kryera ndaj kontraktorit janë si më poshtë:

Situacioni nr.	Vlera ¹⁰ e situacionit	Vlera e likuiduar	Fatura	Data e regjistrimit	Data e pagesës
1	7,337,104	7,318,761	29/2021, datë 10.11.2021	15.12.2021	21.12.2021
2	90,978,069	90,750,625	85/2021, datë 22.02.2022	26.01.2022	28.01.2022
3	70,228,264	70,052,695	38/2022, datë 23.05.2022	26.01.2022	28.01.2022
4	34,884,425	34,797,214	66/2022, datë 13.09.2022	17.10.2022	28.10.2022
5	99,652,328	99,343,161	83/2022, datë 01.12.2022	02.12.2022	05.12.2022
6	5,418,079	1,053,068	86/2023, datë 15.12.2023	08.01.2024	10.01.2024
7	174,300,527	171,131,072	44/2023, datë 27.10.2023	04.01.2024	11.01.2024

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultojnë se mes palëve Autoritet Kontraktor – Mbikëqyrës – Sipërmarrës janë miratuar rishikime të projekt preventivit të kontratës nga të cilët i fundit prej tyre, në një masë prej gati 10 % të vlerës totale të kontratës, është kryer vetëm 14 ditë përpara datës së përfundimit të punimeve, situatë kjo e cila dëshmon për faktin se miratimi i këtyre ndryshimeve në preventiv ka ardhur pas kryerjes në fakt të tyre nga ana e sipërmarrësit. Sa më sipër është në kundërshtim me parashikimet e bëra në nenin 29 *Ndryshimi i Porosisë të kontratës* së sipërmarrjes ku përcaktohet se: “Çdo amendament i kontratës¹¹ duhet të bëhet me shkrim dhe firmosur nga Institucioni publik dhe kontraktori” si dhe me Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimi”, pika 7 ku përcaktohet se:

“7. Sipërmarrësi nuk mund të ndryshojë me nismën e vet, të subjektit projektues a mbikëqyrës, projektin dhe përshkrimet teknike të tij.

7.1 Sipërmarrësi është i detyruar të zbatojë çdo ndryshim të urdhëruar me shkrim nga investitori ose persona të autorizuar prej tij, që nuk ndryshon, në thelb, kushtet kryesore të projektit, të kontratës dhe nuk rrit vlefshësin e saj.

7.3 Ndryshimet e miratuara nga investitori sipas pikave 7.1 e 7.2 të këtij kreu, së bashku me dokumentacionin e nevojshëm teknik, ekonomik e administrativ, i dorëzohen zyrtarisht, sipërmarrësit.”.

Në rastin konkret, ndryshimet janë miratuar pas realizimit faktik të tyre dhe përtej afatit të parashikuar të përfundimit të punimeve.

¹⁰ Në vlerën e tabelës së mësipërme është përfshirë edhe vlera e mbajtur e garancisë së punimeve.

¹¹ Sipas nenit 2 Përkufizime, **Kontratë:** Marrëveshja e shkruar e lidhur midis institucionit publik dhe Kontraktorit dhe përbëhet nga dokumentet e konkurrimit publik duke përfshirë të gjitha bashkëngjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentet e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti standard.

Nga ana e investitorit, mbikëqyrësit dhe sipërmarrësit janë marrë masat për miratimin në KKTKM (vendimi nr. 239, datë 21.06.2022) për ndryshimet e kryera sipas Urdhër - ndryshimit nr. 1 por nuk janë marrë masat e nevojshme për miratimin e ndryshimit nr. 2 të projektit, veprim ky në kundërshtim me parashikimet e bëra në: Ligjin nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, neni 38, pika 2 ku përcaktohet se: KKTKM-ja ka kompetencë: “b) Të miratojë projektet e mirëmbajtjes, të ruajtjes dhe restaurimit të pasurive kulturore materiale, të hartuara nga institucionet e trashëgimisë kulturore që mbulojnë veprimtarinë përkatëse, si dhe subjektet e licencuara për këtë qëllim; c) Të mbikëqyrë veprimtarinë në fushën e pasurive kulturore materiale dhe të pasurive të peizazhit; ç) Të miratojë lejet për ndërhyrjet me karakter ruajtës e mbrojtës të pasurive kulturore të paluajtshme, sipas parashikimeve të këtij ligji, si dhe lejet e parashikuara në këtë ligj;”; VKM nr. 208/2019 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, kapitulli II, pika 13 ku përcaktohet se: “Këshilli teknik ka kompetencë të miratojë kërkesa që lidhen me ndërhyrjet me karakter mirëmbajtje të pasurive kulturore, sipas listës së ndërhyrjeve të miratuara nga KKTKM-ja. ”, Kapitulli IV, ku përcaktohet se: 1. Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, përfshirë edhe ato të përcaktuara në nenin 38, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, ka këto kompetenca: b) miraton projektet e mirëmbajtjes, të ruajtjes dhe restaurimit të pasurive kulturore materiale, të hartuara nga institucionet e trashëgimisë kulturore që mbulojnë veprimtarinë përkatëse, si dhe subjektet e licencuara për këtë qëllim; ç) miraton lejet për ndërhyrjet me karakter ruajtës e mbrojtës të pasurive kulturore të paluajtshme, sipas parashikimeve të këtij ligji, si dhe lejet e parashikuara në këtë ligj;”; VKM nr. 1125, datë 30.12.2020 “Për miratimin e rregullave të projektimit, zbatimit të punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të tyre”, Kreu IV Zbatimi i punimeve për ndërhyrjet ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale, pika 5, germa b ku përcaktohet se: “Drejtuesit ligjorë dhe teknikë të zbatuesit të punimeve janë përgjegjës përpara institucioneve shtetërore të specializuara dhe zhvilluesit për ndërhyrjet ruajtëse e mbrojtëse në pasurinë kulturore, në zbatim të projektit të miratuar në KKTKM-ja, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi; Pika 19: “Zbatuesi i punimeve i paraqet zhvilluesit kërkesë propozimet për korrigjime, plotësime apo situata të paparashikuara gjatë zbatimit të ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale. Zhvilluesi i kërkon mbikëqyrësit dhe projektuesit vlerësimin dhe miratimin e këtyre kërkesë propozimeve, brenda një afati të caktuar nga palët. Në rastet kur kërkesë propozimet ndikojnë në ndryshimin e projektit fillestar, ato paraqiten për shqyrtim në KKTKM dhe, pas miratimit me vendim, vijohet me realizimin e ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse. Vendimi i KKTKM-së për ndryshimet e projektit fillestar është i detyrueshëm për zbatim. Pika 20: “Në rastet kur gjatë zbatimit të punimeve ruajtëse e mbrojtëse të pasurisë kulturore materiale paraqiten të nevojshme ndërhyrje të paparashikuara në kontratë, mbikëqyrësi i punimeve, pas miratimit të projektuesit, i paraqet zhvilluesit propozimet për ndërhyrjet e paparashikuara. Pas konfirmimit nga zhvilluesi, këto propozime paraqiten për miratim edhe në KKTKM”

Referuar dokumentacionit të dosjes teknike rezulton se përmes shkresës nr. 5581/1 prot., datë 11.12.2023, nga ana e grupit të ndjekjes së kontratës z. O. P, znj. G. K dhe z. T. H është hartuar një relacion për përfundimin e zbatimit të punimeve të kontratës drejtuar Titullarit të AK znj. Z. B. Sipas këtij relacioni, numri i ditëve për të cilat është aplikuar penaliteti është përlllogaritur si 41 ditë. Në fakt, nga analiza e relacionit rezulton se ky numër nuk është përlllogaritur saktë pasi numri i ditëve për të cilat punimet janë ndërprerë ka qenë:

13 ditë, ndërprerje për efekt të reshjeve shiut, miratuar edhe nga mbikëqyrësi me procesverbal;
10 ditë ndërprerje për efekt të mungesës së energjisë
4 ditë testim.

Në total numri i ditëve me një vonesë të justifikuar është 27, çka do të thotë se numri i ditëve mbi të cilat do të duhet të ishte aplikuar penaliteti është 73 ditë. Për rrjedhojë duke bërë llogaritjet rezulton se ndaj kontraktorit do të duhet të ishin aplikuar penalitetet në vlerën prej 12,282,374 lekë, ose **4,911,441 lekë më tepër nga vlera e mbajtur deri aktualisht**¹². Përveç sa më sipër, nga analiza e kronologjisë së dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se nga ana e kontraktorit, në periudhën nga dita në të cilën punimet duhet të kishin përfunduar deri në ditën aktuale të përfundimit të tyre, janë kryer punimeve në zërat si më poshtë:

24.12.2022 – 20.12.2022

-Perde për mbrojtje akustike në korridore +6.3 në lartësi kati $h=4.5$ m;

-Shinë për perdet akustike;

-Perde për mbrojtje akustike në dhomat e artistë me lartësi kati $h=2.2$ m;

-Tub alumini me diametër 48.3 mm, $L=2.2$ metër

-Perde për mbrojtje akustike për hyrjen në sallë në lartësi kati $h=2.4$ m;

-Tub alumini me diametër 48.3 mm, $L=3.2$ m

27.12.2022 – 04.01.2023

-Televizor LED 55'' për skenën dhe monitorimin e dirigjentit

-Kamera për vëzhgimin e pjesës balllore të skenës;

-Kamera për dirigjentin;

05.01.2023 – 09.01.2023

-Montim ndriçuesish dhe pajisje të tjera për ndriçimin

(10.01.2023 pezulluar prej reshjeve)

11.01.2023

-Instalimi i kuadrove

12.01.2023

-Testimi i kuadrove

16.01.2023

-Instalimi i sistemit të komunikimit të skenës

(17.01.2023 – 26.01.2023 pezulluar prej reshjeve)

27.01.2023 – 30.01.2023

-Montimi i poltronave të reja

-Montimi i poltronave të reja individuale me tapiceri (llozha)

31.01.2023

-Tapet kërcimi

-Karroca për ruajtjen e tekstilit

-Karroca për tapetet e tekstilit

01.02.2023

-Montim i siparit

02.02.2023

-Montim Shina e siparit

-Perde balllore

¹² Vlera e penalitetit është korigjuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit duke e përllogaritur atë në bazë të vlerës pa tvsh të punimeve të kryera jashtë datës së parashikuar të afatit të kontratës.

(03.02.2023 pezulluar prej reshjeve)

04.02.2023 – 05.02.2023 rifilluar puna por nuk përshkruhet në ditar se çfarë është kryer

(06.02.2023 pezulluar prej reshjeve)

07.02.2023

-Montimi i cikloramës

-Montimi i shinës së cikloramës

08.02.2023

-Shufra ngarkese

-Perde projektori

(09.02.2023 pezulluar prej reshjeve)

10.02.2023

-Pëlhurë e hollë perdesht ngjyrë e zezë

-Pëlhurë e hollë perdesht ngjyrë e bardhë

Duke analizuar korrespondencat pjesë e dosjes teknike rezultojnë se kontraktori i punimeve, gjatë periudhës kohore në të cilën ka qenë në tejkalim të afatit ka qenë duke punuar me zëra punimesh jo domosdoshmërisht të lidhur me kushtet atmosferike, çka do të thotë se argumenti i lidhur me kushtet atmosferike nuk duhet të ishte marrë në konsideratë. Referuar Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, pika 9 citohet se: **“Mbikëqyrësi i punimeve ka të drejtë të ndërpresë punimet për arsye të ndikimit të kushteve klimatike në to, kundrejt një zgjatjeje korresponduese të afatit.”**

Veprimet dhe mosveprimet si më sipërë, përveç sa cituar më sipër rast pas rasti, janë në kundërshtim edhe me parashikimet e bëra në ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Kreu II Përgjegjshmëria Menaxheriale neni 8, ku përcaktohet se: “1. Titullarët e njësive publike, të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

8. Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore:

a) hartimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ata drejtojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të planveprimeve për arritjen e objektivave;

c) miratimin e sistemeve të menaxhimit të informacionit;

ç) miratimin e sistemit të rregullave e të procedurave për ruajtjen, mbrojtjen e nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike, sipas udhëzimeve të nxjerra nga Ministri i Financave;

d) miratimin e një strukture të përshtatshme organizative dhe vendosjen e linjave të raportimit, që mundësojnë kryerjen efektive të përgjegjësisë të tyre;

dh) rregullimin e funksionit të auditimit të brendshëm dhe garantimin e pavarësisë funksionale të tij;

ë) sigurimin, nëpërmjet akteve të brendshme administrative, të zbatimit të rregullave për kontrollin e brendshëm.”;

Kontratën e sipërmarrjes së punimeve të lidhur sipas aktit nr. 904/12 prot., datë 02.04.2021, neni 27;

Lidhur me sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi ish Titullari i AK znj. Z.B ish Sekretar i Përgjithshëm si dhe grupi i ndjekjes së kontratës i përberë nga z. O. P, z. T. H si dhe znj. G. K.

Nga krahasimi i zërave të likuiduar e me ato të situacionuara e të pasqyruara në librezën e masave rezultojnë diferenca në volume me pasojë dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën prej **1,884,625 lekë pa TVSH.**

- Zëri Transport i mbeturinave inerte dhe dheut te gërmuar me auto deri 12 km landfilli i Sharrës përfshirë dhe taksen e depozitimit sipas specifikimeve nga Bashkia Tiranë

Sipas situacionit përfundimtar dhe librezës së masave rezulton sasia prej 1,208 m³. Në fakt nga verifikimi i numrave të analizës dhe zërave përkatës rezulton se nën këtë zë janë përfshirë edhe zëra në të cilët është i përfshirë vet transporti i materialeve. Konkretisht kjo rezulton në zërat si më poshtë:

Mure tulle

Shtresa betoni

Prishje soleta dhe shkalle beton arme

Prishje kollona, trarë b/a

Prishje mure betoni

Duke bërë llogaritjet rezulton se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve vlera prej **88,441 lekë pa TVSH.**

- Zëri Tipi-2 VG/2, veshje muri $\hat{W}623$ 2x 12.5 mm GKF, ose të ngjashëm

Sipas situacionit përfundimtar dhe librezës së masave rezulton sasia prej 283 m². Në fakt, nga analiza e librezës së masave rezulton se janë pasqyruar me gabime lartësitë e kateve duke mos bërë zbritjet përkatëse për efekt të lartësisë së soletave/trarëve. Konkretisht në lartësinë e kateve përdhe, të parë, të dytë, të tretë dhe të katërt do të duhet të ishin llogaritur respektivisht lartësitë, 60 cm, 30 cm, 30 cm, 30 cm, 85 cm. Për rrjedhojë duke bërë llogaritjet rezulton se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve sasia prej 27.7 m², ose vlera prej **55,400 lekë pa TVSH.**

- Zëri Tipi-12 VG/12, veshje shunti $\hat{W}628$ 2x20 mm FireBoard C $\hat{W}$ 100 ose të ngjashëm

Sipas situacionit përfundimtar dhe librezës së masave rezulton sasia prej 188.5 m². Nga analiza e dokumentacionit rezulton se ky zë në këtë sasi është paraqitur në situacionin përfundimtar si zë i ri jashtë kontrate i miratuar me procesverbalin e datës 10.03.2023. Në fakt, referuar projekt – preventivit të hartuar nga ana e projektuesit e mbi të cilin edhe është paraqitur oferta e sipërmarrësit rezulton se ndër të tjerë është edhe zëri Tipi-12 VG/12, veshje shunti $\hat{W}628$ 2x20mm FireBoard C $\hat{W}$ 100, lesh guri 40 kg/m³, 100 mm, ose të ngjashëm me çmim të projektuesit në masën 5,917 lekë/m². Për këtë zë kontrate nga ana e sipërmarrësit është paraqitur oferta prej 5,846.4 lekë/m². Duke krahasuar rezulton se diferenca mes dy zërave është se në zërin e ri është hequr leshi i gurit me dendësi 40 kg/m³ dhe ky ndryshim është konsideruar si zë i ri dhe me rritje çmimi. Nga sa më sipër rezulton se mbikëqyrësi, sipërmarrësi dhe Autoritetit Kontraktor duhet ti ishin referuar ofertës fillestare të kontraktorit duke bërë zbritjet për efekt të heqjes së leshit të gurit dhe ky ndryshim të shoqërohej me ulje të çmimit dhe jo me rritje të tij. Duke bërë korrigjimet dhe duke marrë për referencë çmimin e ofertës për zërin Tipi-12 VG/12, veshje shunti $\hat{W}628$ 2x20mm FireBoard C $\hat{W}$ 100, lesh guri 40 kg/m³, 100 mm, ose të ngjashëm me çmim të projektuesit në masën 5,917 lekë/m², rezulton se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit prej diferencës në çmim vlera prej **496,905 lekë pa TVSH.**

- Zëri Shtresë gome 12 mm

Sipas situacionit përfundimtar dhe librezës së masave rezulton sasia prej 78.3 m². Në fakt, nga verifikimi i dokumentacionit fotografik të ndodhur në dosje rezulton se ky zë pune nuk është kryer për pjesën e paraqitur në librezës e masave si të vendosur në *Listelat e SLS* $241.3\text{ ml} \times 0.12 = 28.96\text{ m}^2$. Për rrjedhojë rezulton se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit vlera prej **277,651 lekë pa TVSH.**

- Zëri Lesh guri $d = 100 \text{ mm}$ densiteti 50 kg/m^3 për tavane

Sipas situacionit përfundimtar dhe librezës së masave rezulton sasia prej 99.9 m^2 . Në fakt, nga verifikimi i në terren i punimeve rezulton se ky zë pune është realizuar me trashësi 5 cm dhe jo 10 cm sa parashikon zëri. Për rrjedhojë rezulton se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit vlera prej **118,132 lekë pa TVSH**.

- Zëri Lesh guri $d = 100 \text{ mm}$ densiteti 50 kg/m^3 për mure

Sipas situacionit përfundimtar dhe librezës së masave rezulton sasia prej 105.3 m^2 . Në fakt, nga verifikimi i në terren i punimeve rezulton se ky zë pune është realizuar me trashësi 5 cm dhe jo 10 cm sa parashikon zëri. Për rrjedhojë rezulton se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit vlera prej **124,517 lekë pa TVSH**.

- Zëri Suva strukturore $t=4 \text{ cm}$ (për përforsim muresh ekzistues perimetral)

Sipas situacionit përfundimtar dhe librezës së masave rezulton sasia prej 1600.2 m^2 . Në fakt, nga analiza e librezës së masave rezulton se janë pasqyruar me gabime lartësitë e kateve duke mos bërë zbritjet përkatëse për efekt të lartësisë së soletave/trarëve. Konkretisht në lartësinë e kateve përdhe, të parë, të dytë, të tretë dhe të katërt do të duhet të ishin llogaritur respektivisht lartësitë, 60 cm , 30 cm , 30 cm , 85 cm . Për rrjedhojë duke bërë llogaritjet rezulton se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve sasia prej 14.72 m^2 , ose vlera prej **56,392 lekë pa TVSH**.

- Zëri Mbulim i fasadave copë plastike me vrima për depërtimin e ajrit, e printuar me pamjen e fasadës së objektit

Sipas situacionit përfundimtar dhe librezës së masave rezulton sasia prej $1,004.8 \text{ m}^2$. Në fakt referuar materialeve fotografike të ndodhura në dosjen teknike rezulton se ky zë nuk është kryer. Për rrjedhojë, janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit vlera prej **667,187 lekë pa TVSH**.

Gjithashtu, nga auditimi i zbatimit të kontratës rezultojnë edhe disa mangësi si më poshtë:

- Përmes dy urdhër ndryshimeve konstatohet se nga ana e AK në mënyrë të paargumentuar, është miratuar propozimi i sipërmarrësit për heqjen e 14 ventilatorë ajri për tualetet duke i lenë këto ambiente pa asnjë mundësi ajrosjeje, një pjesë e të cilave janë edhe pa dritare;

- Nga ana e sipërmarrësit nuk janë respektuar specifikimet teknike në lidhje me disa zëra në një vlerë totale prej **9,687,942 lekë pa TVSH** si më poshtë:

a. *Plintuesat e drurit, me një vlerë të likuiduar prej **211,304 lekë pa TVSH**, sipas vizatimeve teknike janë parashikuar të jenë me dru arre por në fakt nuk rezulton të jenë realizuar të tillë. Ky në nuk rezulton të jetë realizuar në asnjë prej llozhave.*

b. *Shinat e perdeve, me një vlerë të likuiduar prej **176,638 lekë pa TVSH**, sipas preventivit janë parashikuar të jenë me tubo alumini me diametër 48.3 mm por në fakt nuk rezulton të jenë realizuar të tillë;*

c. *Ashensori për kullën e skenës, me një vlerë të likuiduar prej **9,300,000 lekë pa TVSH**, i parashikuar për tu realizuar me dimensione të brendshme 120 cm (thellësi) $\times$ 170 cm (gjerësi) në fakt është realizuar me dimensione 110 cm (thellësi) $\times$ 115 cm (gjerësi), pra me një diferencë prej 0.775 m^2 më pak;*

- Etj.

Sa më sipër është në kundërshtim me parashikimet e bëra në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7/1, “Përgjegjësia e mbikëqyrësit”, ku përcaktohet se: “1. Mbikëqyrësi/grupi i mbikëqyrësve të punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit. Kur mbikëqyrësi i punimeve

konstaton raste të ndryshimit të projektit, është i detyruar të njoftojë menjëherë Inspektoratin Vendor të Mbrojtjes së Territorit të bashkisë. 2. Mbikëqyrësi/grupi i mbikëqyrësve të punimeve, në çdo rast, kur gjatë mbikëqyrjes së punimeve, sipas fazave përkatëse, konstaton mospërputhjen e punimeve të kryera me lejen e ndërtimit, me dokumentet e planifikimit e të kontrollit të zhvillimit dhe me legjislacionin në fuqi që rregullon veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, urdhëron pezullimin e punimeve të ndërtimit dhe njofton menjëherë Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit të bashkisë ku kryhen punimet e ndërtimit dhe autoritetin përgjegjës të planifikimit ose, sipas rastit, edhe Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.”, neni 12 ku përcaktohet se: “Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse: 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve.”. VKM nr. 610, 22.09.2022 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”, neni 1, ku përcaktohet se: “1. Mbikëqyrja e punimeve bëhet për të gjitha llojet e objekteve të ndërtimit dhe kryhet nga mbikëqyrës/grupi i mbikëqyrësve të punimeve, i cili ka përgjegjësi kontrollin e mbarëvajtjes të të gjithë procesit të zbatimit të punimeve, në përputhje me projektin, rregullat dhe standardet teknike të projektimit, zbatimit, si dhe destinacionin e objektit, duke pasur parasysh edhe anën ekonomike të tij.”; neni 7 ku përcaktohet se: “Mbikëqyrësi i punimeve në bashkëpunim me zbatuesin e punimeve programon punimet që do të kryhen në objekt nëpërmjet një plani të shprehur në grafik për çdo muaj. Ai mbikëqyr grafikun e punimeve, kontrollon librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumentacionit që mbahet në objekt.”, neni 8 ku përcaktohet se: “1. Mbikëqyrësi ka detyrimin të raportojë të zhvilluesi, çdo 45 (dyzet e pesë) ditë për kryerjen e punimeve, sipas fazave të akteve të kontrollit, në përputhje me nenin 42, të këtij vendimi. 2. Mbikëqyrësi ka detyrimin të njoftojë on-line në sistemin e-leje pranë autoriteteve përkatëse kryerjen e punimeve, sipas fazave të akteve të kontrollit, në përputhje me nenin 42, të këtij vendimi. Ai njofton on-line brenda 5 (pesë) ditëve pune në sistemin e-leje pranë autoriteteve përkatëse në rastet kur vëren se punimet e kryera janë në shkelje apo tejkalim të lejes së ndërtimit, si dhe kryen on-line çdo 45 (dyzet e pesë) ditë raportimin e kryerjes së punimeve, sipas metodologjisë së përcaktuar nga organi i lëshimit të lejes së ndërtimit.”, neni 12 ku përcaktohet se: “Mbikëqyrësi i punimeve kontrollon dhe pranon paraprakisht situacionet pjesore në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të miratuara nga zhvilluesi.”, neni 15 ku përcaktohet se: “Mbikëqyrësi i punimeve kryen matjet në kantier në bashkëpunim me zbatuesin e punimeve dhe për çdo shmangie të konstatuar mbi atë të lejuarën, të përcaktuar në aktet ligjore për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, pezullon punimet dhe njofton menjëherë zhvilluesin, autoritetin e lëshimit të lejes së ndërtimit dhe Inspektoratin Vendor të Mbrojtjes së Territorit/Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit në sistemin e-leje.”, neni 22 ku përcaktohet se: “Mbikëqyrësi i punimeve kontrollon faturat e blerjes së materialeve dhe të çdo shpenzimi tjetër, që është i lidhur me ndërtimin e objektit, situacionet e paraqitura nga zbatuesi i punimeve në fazat e ndryshme të punimeve, si dhe kontabilitetin.”; VKM nr. 15.8.2007¹³ “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me VKM nr. 664/2012, ku përcaktohet se: “1. Unifikimin e metodologjisë së llogaritjes dhe të formatit të

¹³ Aktualisht i shfuqizuar por në fuqi në momentin e realizimit të kontratës.

paraqitjes së preventivave, situacioneve dhe të analizave teknike të çmimeve me qëllim lehtësimin e veprimtarisë së subjekteve, që zhvillojnë veprimtari në fushën e ndërtimit, si dhe lehtësimin e kontrollit tekniko-financiar në këtë fushë. 2. Hartimi i çdo preventivi apo situacioni në fushën e ndërtimit, si dhe zbatimi e mbikëqyrja e çdo punimi ndërtimi, që realizohet nga persona fizikë dhe juridikë, publikë ose privatë, me fonde publike ose private, në territorin e Republikës së Shqipërisë, bëhen në përputhje me këtë vendim. 3. Metodologjia e llogaritjes së kostos, sipas këtij vendimi, është pjesë e dokumentacionit teknik të çdo objekti të projektuar apo ndërtuar në Republikën e Shqipërisë. 8. Të gjitha subjektet, private apo publike, që kryejnë veprimtari në fushën e tregtimit të materialeve apo të produkteve të ndërtimit ose në fushën e ndërtimit detyrohen të paraqesin pranë Drejtorisë së Politikave të Ndërtimit analizat teknike dhe çmimet për çdo zë pune në ndërtim, për materialet e reja dhe/ose për teknologjitë e reja, të përdorura prej tyre, për të cilat nuk ekziston një analizë teknike e çmimit. Analizat teknike do të përgatiten në përputhje me metodologjinë e përcaktuar në kreun I të udhëzimit nr. 2, date 08.05.2003 të Këshillit të Ministrave, duke përdorur programin e miratuar. 9. Vlera e zërave të punës të preventivave të objekteve që ndërtohen me financim publik të projektuara nga subjekte, publike apo private, llogariten si prodhimi i volumeve të punës, të llogaritura në librezën e masave të projektit me çmimet për njësi të manualit teknik të çmimeve në fuqi. Vlera e zërave të punës të situacioneve të ndërtimit del nga prodhimi i volumeve të punës, të llogaritura në librezën e masave të zbatimit me çmimet për njësi të llogaritura mbi bazën e analizave teknike të punimeve të ndërtimit, sipas vlerave faktike. 10. Të gjitha subjektet, private apo publike, që kryejnë veprimtari në fushën e tregtimit të materialeve apo të produkteve të ndërtimit ose në fushën e ndërtimit e që marrin pjesë në tenderë publike, detyrohen të paraqesin analizat teknike për çmimet e ofertave të tyre për çdo zë punimi ndërtimor, sipas formatit të unifikuar dhe programit të miratuar dhe metodologjisë së përcaktuar në kreun I të udhëzimit nr.2, date 8.5.2003 të Këshillit të Ministrave. 12. Të gjitha institucionet shtetërore, që kryejnë prokurime të punimeve të ndërtimit me fonde publike, nga Buxheti i Shtetit apo nga donatorë të huaj, detyrohen të kontrollojnë çmimet për zërat e punës, të ofertave të paraqitura në tender, me çmimet e bazuara në manualin e çmimeve të ndërtimit dhe në analizat teknike të këtyre çmimeve. Në rastin kur zëri i punës nuk figuron në manual, institucioni u kërkon subjekteve ofertuese të paraqesin analizën teknike, bazuar në metodologjinë e përcaktuar në udhëzimin nr. 2, datë 8.5.2003 të Këshillit të Ministrave dhe të paraqitur me formatin e unifikuar. Një fotokopje të analizave të paraqitura nga subjektet ofertuese për zërin e punës, institucioni ia dërgon ministrisë, e cila e shqyrton analizën e re dhe nëse e gjykon të drejtë, e reflekton çmimin në manualin e çmimeve të periudhës vijuese.”; Udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu II Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, pika 3 ku përcaktohet se: “Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi: a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike. b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar. c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi. ç. Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes.”; Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, ku përcaktohet se: “1.2 Drejtuesit ligjorë dhe teknikë të sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi; 3. Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit detyrohet të zbatojë punimet, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit e të zbatimit, normat e kushtet e legjislacionit të ndërtimit e të kontraktimit; 8.1

Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasi, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës. 8.2 Situacionet financohen nga investitori sipas kushteve që parashikohen në kontratë (sigurimi i kantierit, garancia e kontratës dhe e punimeve, paradhënia, periodiciteti, afatet e pagesës, ndalesat për vonesat, defektet e pakorrigjuara, gjobat), pasi kontrollohen e pranohen paraprakisht nga mbikëqyrësi i punimeve. 8.3 Çmimet jashtë kontratës caktohen sipas analizave teknike në fuqi, **me vlerën ekonomike më të mirë.**”; Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve e lidhur sipas aktit 3278/12 prot., datë 26.06.2021; Kontrata e shërbimit të kolaudimit të punimeve e lidhur sipas aktit me nr. 3580 prot., datë 07.07.2023; Kontratën e lidhur sipas aktit me nr. 904/12 prot., datë 02.04.2021 mes AK dhe BOE; Urdhrin e Titullarit për ndjekjen e kontratës; Etj.

Lidhur me sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve z. A.E përfaqësues ligjor i OE A si dhe kolaudatori i punimeve z. B.Y, përfaqësues ligjor i OE M. CH.

Për sa më sipër, është mbajtur Akt Konstatimi nr. 12, datë 02.02.2026 dhe nga ana e ish Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë znj. Z.B, përmes postës elektronike të datës 19.03.2026 janë paraqitur observacionet si më poshtë trajtuar.

Pretendimi i subjektit:

“ ... Në lidhje me miratimin e ndryshimeve sqarojë se ... Bazuar në parashikimet e sipërcituara, konstatimi i grupit të auditimit se “miratimi i ndryshimeve në preventiv ka ardhur pas kryerjes në fakt të tyre” nuk qëndron, pasi kërkesa për ndryshime të preventivit dhe të projektit janë bërë nga Mbikëqyrësi i punimeve, i cili mban përgjegjësi për saktësinë, vërtetësinë e dokumentacionit që mbahet në objekt. Mbikëqyrësi i punimeve mban përgjegjësi ligjore nëse jep informacion të pasaktë mbi realizimin e punimeve në respektim të lejes së ndërtimit, preventivit dhe gjendjes së punimeve në terren. Gjithashtu, në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, sistemi i menaxhimit financiar në institucionet publike bazohet në parimin e ndarjes së përgjegjësi dhe mbështetjes së vendimmarrjes në informacionin e prodhuar nga strukturat përgjegjëse teknike dhe administrative. Në këtë kuadër, sipas nenit 8 dhe nenit 9 të këtij ligji, Nëpunësi Autorizues është përgjegjës për menaxhimin e përgjithshëm financiar të institucionit, por ushtrimi i kësaj përgjegjësie realizohet nëpërmjet strukturave zbatuese dhe mbi bazën e dokumentacionit dhe informacionit të paraqitur nga njësitë përgjegjëse për zbatimin teknik të kontratës. Në rastin konkret, dokumentacioni mbi ecurinë e punimeve, nevojën për ndryshime në projekt/preventiv dhe justifikimin teknik të tyre është përgatitur dhe përcjellë nga mbikëqyrësi i punimeve dhe strukturat përgjegjëse për ndjekjen e kontratës, të cilët, sipas legjislacionit të fushës së ndërtimit dhe kontratës përkatëse, mbajnë përgjegjësi të drejtpërdrejtë për saktësinë dhe vërtetësinë e të dhënave teknike dhe dokumentacionit të kantierit. Për rrjedhojë, çdo vendimarrje administrative e Autoritetit Kontraktor, përfshirë miratimin e ndryshimeve në preventiv, është marrë mbi bazën e dokumentacionit dhe propozimeve të strukturave teknike përgjegjëse, në përputhje me parimet e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të parashikuara nga ligji nr. 10296/2010.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Pretendimet si më sipër nuk merren në konsideratë nga ana e Grupit të Auditimit pasi ato nuk sjellin fakte shtesë nga ato të konstatuara gjatë fazës së auditimit në terren. Sqarojmë se

përgjegjësia për sa përshkruani nuk është vetëm e mbikëqyrësit por edhe e zhvilluesit, kjo në referencë të Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 14/3 Përgjegjësia e zhvilluesit, pika 1 dhe 2 ku përcaktohet se:

“1. Zhvilluesi është solidarisht përgjegjës me projektuesin, zbatuesin, mbikëqyrësin dhe kolaudatorin e punimeve të ndërtimit për projektimin dhe kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, me dokumentet e planifikimit e kontrollit të zhvillimit dhe me legjislacionin në fuqi që rregullon veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, përfshirë dispozitat antisizmike, të sigurisë, të mbrojtjes nga zjarri, higjiëno-sanitare, si dhe eficiencën energjetike.

2. Zhvilluesi është i detyruar të njoftojë menjëherë Inspektoratin Vendor të Mbrojtjes së Territorit ose, sipas rastit, Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, në rastet kur kryhen punime në kundërshtim me lejen e ndërtimit, me dokumentet e planifikimit e kontrollit të zhvillimit dhe me legjislacionin në fuqi që rregullon veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë.”

Gjithashtu, edhe pretendimet e dhëna në lidhje me çështjet e tjera nuk qëndrojnë dhe si të tilla nuk merren në konsideratë nga ana e Grupit të Auditimit.

Për sa më sipër, është mbajtur Akt Konstatimi nr. 10, datë 02.02.2026 dhe nga ana e mbikëqyrësit të punimeve OE A, është paraqitur observacioni i datës 12.02.2026, përcjellë në KLSH përtej afatit 7 ditor nga marrja dijeni si dhe observacioni i datës 05.03.2026 të cilët gjejnë trajtim në këtë Raport Përfundimtar Auditimi.

Pretendimi i subjektit:

“Situata 1:

Shoqëria A vlerëson se konstatimi për miratimin e ndryshimeve në preventiv pas realizimit faktik të tyre nuk mund t'i atribuohet mbikëqyrësit si shkelje ligjore apo kontraktuale, as në kuptim të përgjegjësisë administrative dhe as në kuptim të përgjegjësisë kontraktuale. Është e vërtetë që preventivi i ripunuar është paraqitur me vonesë nga ana e Kontraktorit të punimeve, çka ka sjellë edhe miratimin e tij në një moment të mëvonshëm nga Autoriteti Kontraktor. Megjithatë, gjatë gjithë kësaj periudhe, palët kanë qenë të informuara se Kontraktori ndodhej në proces ripunimi të projekt-preventivit dhe se dokumentacioni përkatës do të paraqitej për miratim pas përfundimit të formalizimit teknik dhe ekonomik të tij. Punimet e lidhura me këto ndryshime janë kryer nga Kontraktori me nismën e tij dhe nën përgjegjësinë e plotë dhe riskun e vet, pa miratim paraprak dhe pa autorizim zyrtar. Shoqëria A, në cilësinë e mbikëqyrësit, nuk ka certifikuar, situacionuar apo pranuar financiarisht asnjë punim që lidhet me këto ndryshime, deri në momentin formalizimit dhe miratimit zyrtar të projekt-preventivit të ripunuar. Në këtë kontekst, roli i mbikëqyrësit është ushtruar në përputhje të plotë me nenin 29 "Ndryshimi i Porosisë" të kontratës së sipërmarrjes, Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", pika 7, sipas të cilit sipërmarrësi nuk mund të ndryshojë me nismën e vet projektin apo përshkrimet teknike dhe çdo ndryshim duhet të formalizohet me shkrim nga investitori dhe parimin e ligjshmërisë dhe ndarjes së përgjegjësisë, të sanksionuar në Kodin e Procedurave Administrative, sipas të cilit përgjegjësia administrative ngarkohet vetëm nëse ekziston një veprim ose mosveprim i kundërligjshëm i subjektit, i lidhur drejtpërdrejt me kompetencat e tij ligjore. Nga këndvështrimi i Kodit Civil, veprimet e Kontraktorit të kryera pa miratim paraprak përbëjnë ushtrim të një rreziku kontraktual që i atribuohet vetëm palës që e ka ndërmarrë veprim, pa krijuar pasoja juridike për mbikëqyrësin, për sa kohë ky i fundit nuk i ka pranuar, certifikuar apo legjitimuar këto punime. Për rrjedhojë, fakti që miratimi i ndryshimeve në preventiv është kryer në një moment të mëvonshëm lidhet drejtpërdrejt me vonesën në paraqitjen e dokumentacionit nga

Kontraktori dhe nuk përbën shkelje nga ana e mbikëqyrësit, i cili ka respektuar kufijtë e kompetencave të tij, duke vepruar në përputhje me kuadrin ligjor, kontraktual dhe parimet e përgjegjësisë administrative dhe kontraktuale.

Situata 2:

Përlllogaritja e ditëve të vonesës është realizuar nga Mbikëqyrësi i punimeve vetëm pas njoftimit zyrtar me shkrim nga ana jonë se afati kontraktual i përfundimit të punimeve, sipas kontratës në fuqi, kishte përfunduar. Ky veprim është kryer në ushtrim të funksionit teknik dhe raportues të mbikëqyrësit dhe në përputhje me kuadrin ligjor dhe kontraktual përkatës. Gjatë procesit të verifikimit kronologjik të punimeve dhe ndërprerjeve të tyre, Mbikëqyrësi ka identifikuar dhe ka njoftuar Autoritetin Kontraktor për ditët e papunuara për shkaqe të justifikuara, në zbatim të Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", ku parashikohet shprehimisht se ndërprerjet për arsye objektive, përfshirë kushtet klimaterike, nuk përbëjnë bazë për penalizim automatik të kontraktorit. Në këtë kuadër, ditët e papunuara për shkak të kushteve klimaterike janë konsideruar të justifikuara, pasi gjatë këtyre periudhave Kontraktori kishte të planifikuara punime që lidhen drejtpërdrejt me sistemimet e jashtme, vendosjen e bordurave, shtrimin e pllakave travertin për shkallët dhe sheshpushimet e jashtme, shtresat e çakllit, punimet për linjën e lidhjes së kabinës të cilat, për nga natyra e tyre teknike, nuk mund të realizohen në kushte atmosferike të pafavorshme pa rrezikuar cilësinë dhe sigurinë e punimeve. Referuar pikës 9 të Kreut II të Udhëzimit nr. 2/2005, Mbikëqyrësi ka të drejtë të urdhërojë ndërprerjen e punimeve për arsye që lidhen me ndikimin e kushteve klimatike, kundrejt një zgjatjeje korresponduese të afatit. Në këtë kuptim, mosllogaritja e këtyre ditëve si vonesë e penalizueshme përbën zbatim korrekt të normës ligjore dhe jo shmangie të përgjegjësisë kontraktuale. Theksohet se përlllogaritja dhe aplikimi i penaliteteve nuk përbën kompetencë ekskluzive dhe as diskrecion të Mbikëqyrësit, por është atribut i Autoritetit Kontraktor, i cili vendos mbi bazën e dokumentacionit teknik, kontraktual dhe ligjor të paraqitur. Roli i Mbikëqyrësit kufizohet në evidentimin faktik të ecurisë së punimeve, ndërprerjeve të justifikuara dhe informimin e AK-së, në përputhje me detyrimet e tij kontraktuale dhe ligjore. Civil, Në dritën e parimit të mirëbesimit dhe bashkëpunimit kontraktual, të sanksionuar në Kodin si dhe të parimit të proporcionalitetit dhe ligjshmërisë, të parashikuar në Kodin e Procedurave Administrative, çdo vlerësim mbi penaltetet duhet të mbështetet në analizën reale të rrethanave faktike dhe teknike dhe jo në një llogaritje formale të ditëve kalendarike. Për rrjedhojë, mënyra e ndjekur për evidentimin e ditëve të vonesës dhe përjashtimin e ditëve të justifikuara nga penalizimi është në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi dhe nuk përbën shkelje të detyrimeve të Mbikëqyrësit, as favorizim të palëve kontraktuale, por zbatim korrekt dhe proporcional të ligjit dhe kontratës.

Në lidhje me konstatimin për zërin e transportit, sqarojmë se pagesat janë kryer mbi bazën e zërave të preventivit kontraktual dhe të situacioneve të punimeve të realizuara në terren. Sipas Manualeve Teknike të Çmimeve të Ndërtimit (VKM nr. 514, datë 15.08.2007 dhe përditësimet e vitit 2015), analizat e çmimeve të zërave të punimeve janë ndërtuar mbi kushte standarde të realizimit, të cilat përfshijnë vetëm transportin lokal të materialeve brenda një distance standarde rreth 5 km nga kantieri. Kjo distancë konsiderohet si zonë e ndikimit normal të kantierit dhe përfshihet në analizat bazë përmes shpenzimeve të përgjithshme të transportit të brendshëm dhe të zhvendosjes së materialeve në afërsi të objektit. Manualët parashikojnë në mënyrë të veçantë analiza të dedikuara për transport me automjete për km, të cilat aplikohen kur materialet ose mbetjet duhet të transportohen përtej distancës standarde, pra jashtë kushteve tipike të realizimit të punimeve. Në këto raste transporti konsiderohet proces më vete, me ndikim të drejtpërdrejtë në kohën e ciklit të transportit, konsumin e karburantit dhe amortizimin e mjeteve, nevojën për

organizim logjistik të posaçëm, kostot e menaxhimit të mbetjeve jashtë kantierit. Në objektin konkret, materialet e dala nga punimet e prishjes janë klasifikuar si mbetje inerte ndërtimore dhe janë transportuar drejt landfillit të autorizuar të Sharrës, në një distancë rreth 12 km nga kantieri, pra më shumë se dyfishi i distancës standarde të përfshirë në analizat bazë. Ky operacion përfshin një cikël të plotë teknik të menaxhimit të mbetjeve ngarkim mekanik dhe transport rrugor në distancë të konsiderueshme jashtë zonës standarde të kantierit, dorëzim në vend depozitim të licencuar, pagesë të tarifës së depozitimit në landfill sipas kërkesave të autoritetit vendor. zonës Për rrjedhojë, ky proces nuk përfshihet në transportin lokal të parashikuar në analizat standarde të zërave të punimeve dhe përbën operacion të veçantë logjistik dhe mjedisor, i cili justifikon likuidimin e tij si zë më vete në preventiv. Në këto kushte, pagesa për transportin dhe depozitimin e mbetjeve nuk përbën pagesë të dyfishtë, por aplikim korrekt të metodologjisë së llogaritjes së kostove sipas manualeve teknike në fuqi.

Në lidhje me konstatimin për zërin "Tipi-2 VG/2, veshje muri W623 2x12.5mm GKF", ose të ngjashëm, duhet të sqarohet se nga verifikimi në terren dhe nga evidencat fotografike rezultojnë gjatësia e matur nuk i referohet vetëm zhvillimit linear të mureve, por përfshin edhe veshjen e kanalave në çdo kat. Kanalinat, bokset e instalimeve dhe elementet e ngjashme përbëjnë pjesë integrale të sistemit të veshjes me gips (drywall). Këto realizohen me të njëjtin sistem konstruktiv (profile metalike + pllaka gipsi) dhe për rrjedhojë konsiderohen sipërfaqe reale pune. Sipas metodologjisë standarde të matjes së punimeve, sistemet e veshjes me gips maten mbi bazën e sipërfaqes efektive të realizuar dhe jo vetëm të projeksionit linear të mureve. Për këtë arsye në matje përfshihet çdo sipërfaqe e krijuar nga sistemi, përfshirë veshjen e kanalave dhe soffiteve. Kjo qasje mbështetet nga dokumentacioni teknik për sistemet "drywall", konkretisht EN 520, EN 14195, EN 13964, të cilat trajtojnë pllakat e gipsit dhe nënkonstruktionet metalike si sisteme sipërfaqësore që maten mbi bazën e sipërfaqes efektive të mbuluar; Manualët teknike Knauf dhe Rigips, ku specifikohet qartë se veshjet e bokseve të instalimeve, soffitet dhe kanalinat konsiderohen pjesë e të njëjtit sistem ndërtimor dhe përfshihen në matje si sipërfaqe të realizuar. Duke qenë se matjet përfshijnë edhe këto elemente (siç evidentohet nga dokumentimi fotografik) sasia e raportuar rezultojnë teknikisht të justifikuar dhe në përputhje me praktikën standarde të llogaritjes së punimeve.

Në lidhje me konstatimin për zërin: "Tipi-12 VG/12, veshje shunti W628 2x20 mm FireBoard CW100 ose të ngjashëm" sqarohet që, vlerësimi i çmimit të këtij zëri është kryer në momentin e miratimit të tij dhe është bazuar në kushtet reale të realizimit të punimeve, duke respektuar plotësisht VKM nr. 514, datë 15.08.2007 dhe manualët teknike të çmimeve të ndërtimit. Analizat e kryera kanë marrë parasysh kostot aktuale të materialeve, punës dhe transportit, sipas praktikës së zbatimit në terren dhe standardeve profesionale. Duke iu referuar kushteve ligjore, kjo mënyrë e vlerësimit nuk përbën shkelje të rregullave. Ligji parashikon qartë që kur manualët e çmimeve nuk ofrojnë një vlerësim të detajuar për zërat e rinj ose materialet e veçanta, çmimet mund të përcaktohen mbi bazën e të dhënave aktuale të tregut, duke siguruar një vlerësim të drejtë dhe të verifikueshëm. Ky zë u vlerësua dhe miratua rreth tre vite pas hartimit të preventivit fillestar, periudhë gjatë së cilës çmimet e materialeve kanë ndryshuar ndjeshëm, veçanërisht për sistemet e mbrojtjes ndaj zjarrit. Kontraktori kërkoi që analiza të kryhej në momentin e paraqitjes së kërkesës për zërin e ri, duke marrë parasysh kushtet reale të furnizimit dhe çmimeve të tregut. Ky zë ka zëra të ngjashëm të parashikuar në kontratë, por vlerësimi i tij aktual është bërë për të reflektuar ndryshimet e çmimeve dhe kushtet reale të tregut. Çmimi i aplikuar pasqyron analizat e përditësuara të kostos dhe situatën e tregut, duke siguruar që vlerësimi është i drejtë, i verifikueshëm, i bazuar në të dhëna të sakta, respekton standardet profesionale dhe nuk cenon

zërat e ngjashëm të kontratës, por siguron një përcaktim të qartë dhe të saktë për zërin specifik të kërkuar.

Në lidhje me këtë konstatim për zërin "Shtrese Gome 12 mm", duhet të sqarohet se nga verifikimi në terren rezulton se punimi është i realizuar në objekt. Prania e tij konstatohet gjatë kontrollit në fakt në ambientet përkatëse, ndërsa realizimi i tij evidentohet edhe në dokumentacionin fotografik të fazave të zbatimit që gjendet në dosjen teknike të objektit. Fotot e disponueshme paraqesin momente të realizimit të këtij punimi dhe përbëjnë provë mbështetëse të ekzekutimit të tij. Në këto kushte, duke qenë se punimi verifikohet fizikisht në objekt dhe mbështetet edhe nga evidenca fotografike, rezulton se ky zë pune është realizuar dhe përfshirja e tij në situacion është e justifikuar.

Në lidhje me konstatimin për zërin "Lesh guri $d = 100$ mm, densiteti 50 kg/m^3 për tavane", duhet të sqarohet se ky punim është realizuar fillimisht në përputhje me projektin, pra me trashësi 10 cm. Gjatë verifikimeve të mëvonshme u evidentua problematikë në pjesën tavanore, e cila është pasqyruar edhe në akt-konstatimet e Kolaudatorit, ku citohet: "SALLA E PROVAVE PARA SHFAQJES: Pjesa tavanore ka pësuar një cedim, i shkaktuar nga lesh guri i përdorur për akustik, i cili duhej të fiksohej para elementeve tavanor të dukshëm" Si pasojë e këtij konstatimi, punimi u çmontua dhe u realizua sërish. Në fazën e ribërjes, për të shmangur përsëritjen e të njëjtit fenomen të cedimit dhe për të garantuar stabilitetin e sistemit të tavanit, trashësia e shtresës u rishikua dhe u reduktua gjatë zbatimit. Në këtë kuptim, ndryshimi i trashësisë nuk lidhet me mosrealizim të punimit, por me ndërhyrje korrigjuese teknike të kryer pas konstatimeve të kolaudatorit, me qëllim eliminimin e defektit dhe sigurimin e funksionimit të qëndrueshëm të sistemit të tavanit.

Në lidhje me konstatimin për zërin "Lesh guri $d = 100$ mm, densiteti 50 kg/m^3 për mure", duhet të sqarohet se ky punim është realizuar në përputhje me kërkesat e projektit. Realizimi i tij mund të verifikohet drejtpërdrejt në terren, ku evidentohet zbatimi i shtresës përkatëse në muret e objektit. Gjithashtu, kjo gjë mbështetet edhe nga dokumentacioni fotografik i fazave të zbatimit, i cili paraqet vendosjen e materialit gjatë realizimit të punimeve. Në këto kushte, duke qenë se punimi verifikohet në fakt dhe evidentohet edhe në materialin fotografik, rezulton se ky zë pune është realizuar sipas projektit dhe përfshirja e tij në situacion është e justifikuar.

Në lidhje me konstatimin për zërin "Suva strukturore $t = 4$ cm (për përforcim muresh ekzistues perimetral)", duhet të sqarohet se ky punim është realizuar sipas metodologjisë së përcaktuar nga projektuesi. Suvatimi përforcues është kryer pas prishjes së soletave ekzistuese dhe përpara realizimit të soletave të reja, pra në fazën ndërmjetëse të zbatimit të strukturës. Për shkak të natyrës së këtij procesi ndërtimor, një pjesë e punimit mbulohet nga elementet e rinj strukturore dhe nuk është plotësisht e dukshme në fazën përfundimtare të objektit. Megjithatë, realizimi i tij lidhet drejtpërdrejt me sekuencën teknologjike të zbatimit të projektit dhe përbën pjesë integrale të ndërhyrjes strukturore të parashikuar.

Në lidhje me konstatimin mbi zërin "Mbulesa e fasadave me copë plastike me vrima për depërtimin e ajrit, e printuar me pamjen e fasadës së objektit", sqarojmë se ky zë është realizuar gjatë zbatimit të punimeve në kantier dhe është dokumentuar më anë të dokumentacionit teknik të objektit (librezë masash) sipas parashikimeve ligjore. Mungesa e materialeve fotografike në dosjen teknike nuk dokumenton mos kryerjen e këtij zëri pasi nuk ka asnjë parashikim ligjor që të përcaktojë se ky zë duhet të dokumentohet me anë të fotografive. Ajo çka kuadri ligjor parashikon janë librezat e masave, të cilat siç u sqarua edhe më lart kanë dokumentuar këtë zë dhe ndodhen

të firmosura në dosjen e objektit. Sipas legjislacionit në fuqi për zbatimin e punimeve të ndërtimit, konkretisht VKM nr. 514, datë 15.08.2007 "Për miratimin e rregullores së zbatimit të punimeve të ndërtimit", parashikohet detyrimi për hartimin e akteve të mbulimit dhe dokumentimin përkatës (përfshirë dokumentimin fotografik) vetëm për punimet e fshehta. Në rastin konkret, ky zë nuk përbën punim të fshehtë, por element të përkohshëm dhe të dukshëm gjatë zhvillimit të punimeve në kantier. Realizimi i tij evidentohet nga situacionet përfundimtare, librezat e masave dhe dokumentacioni i ndjekjes së punimeve. Për rrjedhojë, mungesa e fotove nuk përbën dokumentacion të detyrueshëm dhe nuk mund të shërbejë si argumentim për mosrealizimin e këtij zëri, ndaj konstatimi për përfitim të padrejtë të vlerës përkatëse nuk qëndron.

Në lidhje me konstatimin për zërin "Plintuesat e drurit", nga verifikimet në terren, analiza e dokumentacionit teknik dhe shqyrtimi i materialit fotografik rezultoi se ky zë pune është realizuar dhe nuk qëndron pretendimi se ai nuk është zbatuar. Në ambientet me parket janë vendosur plintues me bazë MDF të veshur me rimeso druri, të përputhshëm me parketin e instaluar, ndërsa në ambientet e lozhave janë realizuar plintues me material të përshtatur me shtresën përfundimtare të dyshemesë. Në të dy rastet është përdorur paketë plintuesish e projektuar për t'iu përshtatur llojit të shtresës së dyshemesë mbi të cilën është realizuar ambienti, duke garantuar përputhje estetike, funksionale dhe teknike. Nga pikëpamja teknike, specifikimet e materialeve të përdorura për shtresat përfundimtare të dyshemeve janë përcaktuese për tipologjinë e plintuesave që duhet të vendosen dhe kanë përparësi ndaj emërimit të përgjithshëm të zërit në preventiv. Për rrjedhojë, realizimi i plintuesave në përputhje me materialet reale të dyshemeve përbën zbatim korrekt teknik dhe konsiderohet realizim i plotë i këtij zëri pune.

Në vijim të të njëjtit arsyetim të paraqitur për zërin pararendës, edhe për zërin "Shinat e perdeve..." theksohet se pretendimi për mosrealizim nuk qëndron. Verifikimet në terren dhe dokumentacioni fotografik konfirmojnë se elementi është instaluar dhe funksional, duke respektuar logjikën teknike të përzgjedhjes së sistemeve që përshtaten me zgjidhjen përfundimtare të ambienteve. Ashtu si në rastin e mëparshëm, prioritet ka përputhshmëria teknike dhe integrimi me sistemin përfundimtar të përdorur në objekt, për rrjedhojë, zëri konsiderohet i realizuar.

Në lidhje me konstatimin për zërin "Ashensori i skenës", sqarojmë se çmimi i referuar në konstatim nuk i përket këtij ashensori, por ashensorit të orkestrës. Për ashensorin e skenës janë realizuar dhe verifikuar të gjithë parametrat teknikë dhe funksionalë nga inxhinieri mbikëqyrës. Ndryshimi i vetëm lidhet me dimensionet e kabinës, të cilat janë përshtatur me dimensionet ekzistuese të kafazit të ashensorit, të cilat nuk mund të ndryshoheshin pa ndërhyrje strukturore në objekt. Kjo përshtatje nuk përbën devijim teknik thelbësor, pasi nuk ndikon në kapacitetin mbajtës, sistemet e sigurisë dhe funksionimin e pajisjes, nuk ndryshon tipologjinë dhe performancën e ashensorit dhe përfaqëson vetëm një përshtatje gjeometrike ndaj kushteve reale të objektit dhe nuk përbën ndryshim të specifikimeve teknike të këtij zëri. Po ashtu, referuar pretendimit mbi mospërputhjen e dimensioneve të ashensorit, sqarojmë si më poshtë ...

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Situata 1:

Pretendimet tuaja mbi këtë pikë nuk merren në konsideratë nga ana e Grupit të Auditimit pasi ato janë të një natyre të përgjithshme dhe nuk interpretojnë drejtë dhe saktë bazën ligjore të cituar. Sqarojmë se ndryshimet duhet të miratohen përpara kryerjes së tyre.

Situata 2:

Pretendimet tuaja mbi këtë pikë nuk merren në konsideratë nga ana e Grupit të Auditimit pasi ato nuk sjellin fakte shtesë nga ato të konstatuara në fazën e auditimit në terren. Rikujtojmë që nga auditimi është konstatuar fakti se në periudhën nga dita në të cilën punimet duhet të kishin përfunduar deri në ditën aktuale të përfundimit të tyre, janë kryer punimeve në zëra të cilët jo domosdoshmërisht kanë qenë të lidhur me kushtet atmosferike.

Në lidhje me zërin e transportit sqarojmë se gjatë fazës së auditimit në terren, për projekt - preventivin final të hartuar, u kërkuar analizat teknike të çmimeve të cilat nuk u vendosën në dispozicion as në atë kohë dhe as përmes materialeve të sjella me observacion. Për sa më sipër pretendimet Tuaja nuk merren në konsideratë.

Në lidhje me zërin "Tipi-2 VG/2, veshje muri $\hat{W}623$ 2x12.5mm GKF", sqarojmë se argumentimet e dhëna nga ana Juaj nuk qëndrojnë dhe si të tilla nuk merren në konsideratë nga ana e Grupit të Auditimit.

Në lidhje me zërin "*Tipi-12 VG/12, veshje shunti $\hat{W}628$ 2x20 mm FireBoard $\hat{C}\hat{W}100$ ose të ngjashëm*", sqarojmë se referuar kuadrit ligjor në fuqi në momentin e shpalljes fitues të BOE K. & U, nga ana juaj, nuk janë mbajtur në konsideratë parashikimet e VKM nr. 514, datë 15.08.2007 "*Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit*", ndryshuar me vendim nr. 664, datë 26.9.2012 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 514, datë 15.8.2007 të këshillit të ministrave "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit"*", pikat si më poshtë:

10. Të gjitha subjektet, private apo publike, që kryejnë veprimtari në fushën e tregtimit të materialeve apo të produkteve të ndërtimit ose në fushën e ndërtimit **e që marrin pjesë në tenderë publike, detyrohen të paraqesin analizat teknike për çmimet e ofertave të tyre për çdo zë punimi ndërtimor**, sipas formatit të unifikuar dhe programit të miratuar dhe metodologjisë së përcaktuar në kreun I të udhëzimit nr.2, datë 8.5.2003 të Këshillit të Ministrave.

12. Të gjitha institucionet shtetërore, që kryejnë prokurime të punimeve të ndërtimit me fonde publike, nga Buxheti i Shtetit apo nga donatorë të huaj, detyrohen të kontrollojnë çmimet për zërat e punës, të ofertave të paraqitura në tender, me çmimet e bazuara në manualin e çmimeve të ndërtimit dhe në analizat teknike të këtyre çmimeve. Në rastin kur zëri i punës nuk figuron në manual, institucioni u kërkon subjekteve ofertuese të paraqesin analizën teknike, bazuar në metodologjinë e përcaktuar në udhëzimin nr. 2, datë 8.5.2003 të Këshillit të Ministrave dhe të paraqitur me formatin e unifikuar. Një fotokopje të analizave të paraqitura nga subjektet ofertuese për zërin e punës, institucioni ia dërgon ministrisë, e cila e shqyrton analizën e re dhe nëse e gjykon të drejtë, e reflekton çmimin në manualin e çmimeve të periudhës vijuese."

Nga sa më sipër, duke zbritur nga analiza e paraqitur vlerën e leshit të gurit me dendësi 40 kg/m^3 , çmimi i ri do të duhet të ishte reflektuar domosdoshmërisht me zbritje dhe kurrsesi me rritje. Për rrjedhojë pretendimet Tuaja nuk qëndrojnë dhe si të tilla nuk merren në konsideratë nga ana e Grupit të Auditimit.

Në lidhje me zërin "*Shtresë gome 12 mm*", sqarojmë se referuar materialit fotografik të ndodhur në dosjen teknike dhe atyre të sjella me observacion nga ana Juaj ky zë nuk është kryer për pjesën e paraqitur në librezës e masave si të vendosur në *Listelat e SLS* $241.3 \text{ ml} \times 0.12 = 28.96 \text{ m}^2$. Për rrjedhojë pretendimet Tuaja nuk qëndrojnë dhe si të tilla nuk merren në konsideratë nga ana e Grupit të Auditimit.

Për sa i takon pretendimeve të sjella nga ana Juaj në lidhje me zërin "*Lesh guri $d = 100 \text{ mm}$, densiteti 50 kg/m^3 për tavane*" sqarojmë se pretendimet tuaja nuk rrëzojnë konstatimin e grupit të auditimit.


Për sa i takon pretendimeve të sjella nga ana Juaj në lidhje me zërin "*Lesh guri $d = 100\text{ mm}$, densiteti 50 kg/m^3 për mure*" sqarojmë se gjatë verifikimit në terren u kryen sondazhe në katër llozha nga ku rezultoi se nuk është respektuar trashësia prej 10 cm pasi materiali është realizuar me një trashësi prej 5 cm.

Për sa i takon pretendimeve të sjella nga ana Juaj në lidhje me zërin "*Suva strukturore $t = 4\text{ cm}$ (për përforcim muresh ekzistues perimetral)*" sqarojmë se argumenti nuk qëndron pasi nuk është i arsyetuar logjikisht dhe teknikisht.

Për sa i takon pretendimeve të sjella nga ana Juaj në lidhje me zërin "*Mbulesa e fasadave me copë plastike me vrima për depërtimin e ajrit, e printuar me pamjen e fasadës së objektit*" sqarojmë se argumenti nuk qëndron dhe nuk citon saktë bazën ligjore. VKM nr. 514, datë 15.08.2007 është "*Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit*" dhe jo "*Për miratimin e rregullores së zbatimit të punimeve të ndërtimit*". Gjithashtu, referuar Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 "*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*", Kreu I, pika 8.3 citohet se:

"8.3 Dokumentacioni fotografik apo videoregjistruesi sigurohet nga sipërmarrësi për çastet më të rëndësishme të zbatimit të punimeve, veçanërisht për ato që bëhen të padukshme, që mund të jenë objekt diskutimi në të ardhmen dhe që pasqyrojnë masat mbrojtëse e të kontrollit të cilësisë së materialeve e të punimeve, etj. Kopje të mjaftueshme i dorëzohen mbikëqyrësit çdo javë." Nga sa më sipër rezulton se materiali fotografik nuk duhet të paraqitet vetëm për punime të fshehta por edhe për ato të cilat pasqyrojnë masat mbrojtëse (siç është mbulesa) apo ato që mund të jenë objekt diskutimit (siç është rasti i mos dokumentimit me material fotografik). Për sa më sipër pretendimet Tuaja nuk qëndrojnë dhe si të tilla nuk merren në konsideratë nga ana e Për sa i takon pretendimeve të sjella nga ana Juaj në lidhje me zërat "*Plintuesat e drurit*" dhe "*Shinat e perdeve*" sqarojmë se ato nuk merren në konsideratë pasi zërat nuk janë kryer sipas parashikimeve të projektit.

Grupi i auditimit merr pjesërisht në konsideratë observacionin në lidhje me zërin e emërtuar Ashensori i skenës dhe vlerën respektive prej 44,400,000 lekë pa TVSH duke bërë korrigjimet përkatëse përmes zëvendësimit me zërin Ashensor për kullën e skenës me vlerën 9,300,000 lekë pa TVSH. Sqarojmë gjithashtu se argumentet e dhëna, nuk qëndrojnë për sa i takon dimensioneve të brendshme të ashensorit si më poshtë:



C37035 - D - A – 8, faqe 6/20

Në fakt, nga verifikimi në terren rezultuan dimensione 110 cm (thellësi) x 115 cm (gjerësi), pra me një diferencë prej 0.775 m² më pak. Për sa më sipër pretendimi Juaj nuk qëndron dhe si i tillë nuk merret në konsideratë.

Grupi i auditimit merr pjesërisht në konsideratë observacionin, konkretisht për argumentimin e dhënë në lidhje me zërin "Hapje vrimash në kolona/trarë për vendosjen e ankorit. Ankorim me rezinë epokside Mapefix" pas saktësimit të faktit se çmimi i ri është pranuar si analizë pas marrjes së ofertave në treg nga operatorë të ndryshëm në treg.

Për sa më sipër, është mbajtur Akt Konstatimi nr. 10, datë 02.02.2026 dhe nga ana e ish Drejtorit të DRTK Tiranë z. O.P, përmes postës elektronike të datës 11.02.2026 janë paraqitur observacionet si më poshtë trajtuar.

Pretendimi i subjektit:

"... sqaroj se nuk kam qenë në asnjë moment ndjekës kontrate për kontratën me objekt: "Zbatimi i punimeve për restaurimin, rikonstrukcionin dhe rinovimin e sallës së koncerteve, në Universitetin e Arteve në Tiranë". Për rrjedhojë, nuk kam pasur kompetencë funksionale, detyrë të ngarkuar apo përgjegjësi ligjore në lidhje me ndjekjen, monitorimin, administrimin apo raportimin mbi ecurinë e zbatimit të kësaj kontrate. Nuk kam ushtruar asnjë veprim në cilësinë e ndjekësit të kontratës, nuk kam administruar dokumentacion përkatës në këtë rol dhe nuk kam firmosur akte apo shkresa që lidhen me funksionin e ndjekësit të saj. Sqaroj se ndjekës kontrate fillimisht ka qenë znj. B. K, dhe më pas këtë detyrë e ka ushtruar znj. A. P, të cilat kanë qenë të ngarkuara zyrtarisht me ndjekjen e kontratës. Gjithashtu, deklaroj se nuk kam pasur dijeni mbi Urdhrin nr. 505 datë 22.08.2023 dhe nuk kam qenë pjesë e procesit të hartimit apo zbatimit të tij. Çdo përgjegjësi që lidhet me ndjekjen dhe administrimin e kontratës së sipërcituar i përket personave të caktuar në këtë funksion. Nuk kam marrë dhe nuk kam sigluar asnjehere marrjen e një urdhri të tillë që më ngarkon me këtë detyrë. Për sa më sipër, konfirmoj se nuk mbaj asnjë përgjegjësi në lidhje me ndjekjen e kontratës me objektin e mësipërm apo me çfar përcakton Urdhri nr. 505 datë 22.08.2023 për sa kohë unë edhe sot nuk e di përmbajtjen e atij urdhri..."

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Pretendimet si më sipër nuk merren në konsideratë nga ana e Grupit të Auditimit pasi ato konsiderohen si të pavërteta dhe bien në kundërshtim me sa na është vendosur në dispozicion. Situacioni përfundimtar rezulton i sigluar si më poshtë:



Burimi: Dosja teknika e zbatimit të punimeve

Përgjegjësia Juaj është përmendur kryesisht në lidhje me përlogaritjen e gabuar të ditëve të vonësës. Relacioni i hartuar nga ana Juaj rezulton të jetë si më poshtë:

Në datë 20 tetor 2023 është kryer edhe marja në dorëzim e objektit nga ana e Ministrisë së Kulturës.

Konceptoi: Olsi PLASA

Taulant HANI

Greta KURTBALAJ

Rruga Alexander Moisiu, nr 76, ish Kinostudio "Shqipëria e Re", Tiranë, www.kultura.gov.al, e-mail: info@kultura.gov.al

6

Burimi: Dosja teknika e zbatimit të punimeve

Për sa më sipër pretendimet tuaja nuk qëndrojnë dhe si të tilla nuk merren në konsideratë nga ana e Grupit të Auditimit.

Për sa më sipër, nga ana e sipërmarrësit të punimeve OE K, është paraqitur observacioni i datës 02.03.2026, administruar në KLSH me nr. 951/21 prot., datë 04.03.2026.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Nga shqyrtimi i pretendimeve të shtjelluara në këtë observacion, konstatohet se argumentet dhe shpjegimet e dhëna janë të tilla që kanë gjetur trajtim gjatë vlerësimit të observacioneve të dërguara nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit për aktin e konstatimit nr. 10, datë 02.02.2026 dhe për Projektraportin e Auditimit. Në këto kushte, përgjigjet e dhëna për palët mbikëqyrës / kolaudator vlejné edhe për sipërmarrësin e punimeve.

Grupi i auditimit ka marrë pjesërisht në konsideratë observacionin në lidhje me zërin e emërtuar Ashensori i skenës dhe vlerën respektive prej 44,400,000 lekë pa TVSH duke bërë korrigjimet përkatëse përmes zëvendësimit me zërin Ashensor për kullën e skenës me vlerën 9,300,000 lekë pa TVSH. Gjithashtu, Grupi i auditimit ka marrë pjesërisht në konsideratë observacionin për argumentimin e dhënë në lidhje me zërin "Hapje vrimash në kolona/trarë për vendosjen e ankorit.

Ankorim me rezinë epokside Mapefix" pas saktësimit të faktit se çmimi i ri është pranuar si analizë pas marrjes së ofertave në treg nga operatorë të ndryshëm në treg.

7. Kontrata me objekt "Restaurim, Rikonstruksion dhe rehabilitimi i hapësirave në Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria e Arteve)", viti 2021

Projekti i zbatimit

Në zbatim të Programit të Auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Dosja teknike e zbatimit të punimeve të kontratës me objekt 'Restaurim, Rikonstruksion dhe rehabilitimi i hapësirave në Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria e Arteve)';

Korrespondenca të ndryshme.

Projekti i zbatimit

Projekti për këtë investim është hartuar nga ana e BOE A& A S.P.S & K në zbatim të kontratës së konsulencës të lidhur me AK Ministria e Kulturës sipas aktit me nr. 6855/16 prot., datë 27.09.2019 duke parashikuar një vlerë totale investimi prej **1,356,395,879 lekë me TVSH**. Referuar termave të referencës ky projekt ka për objektiv:

-Krijimin e një hapësire të re qytetare;

-Përmirësimi i mënyrës së komunikimit me vizitorin duke rimodeluar modulën dhe lëvizjen;

-Krijimi i hapësirave për ekspozime të reja;

-Përmirësimi i sistemeve teknike;

-Zgjidhja e hapësirave të magazinimit dhe ruajtjes në kushte të përshtatshme të fondit të objekteve muzeore;

-Rritja e kapacitetit të objektit;

-Përmirësimi i komfortit termik dhe parametrave fiziko-ambiental.

Qëllimi kryesor i projektit është rehabilitimi i të gjithë elementëve të objektit dhe zbatimi i projektit pritet të përmirësojë në mënyrë cilësore, hapësirat e këtij objekti duke sjellë një risi në aktivitetin e Muzeut Kombëtar të Arteve të Bukura.

Projekti si më sipër i është nënshtruar opionencës teknike të hartuar nga ana e Institutit të Ndërtimit, ku ky i fundit i ka përcjellë Ministrisë së Kulturës (MK) përmes shkresës së administruar në IN me nr. 445/3 prot., datë 07.01.2019 dhe në MK sipas shkresës me nr. 104/1 prot., datë 08.01.2019 materialin më lëndë Dërgim opionence teknike të projektit të zbatimit "*Hartim projekti për objektin "Restaurimi, Rikonstruksioni dhe Rehabilitimi i hapësirave në Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria e Arteve), Tiranë"*. Përmes shkresës me nr. 3919 prot., datë 26.07.2021 nga ana e Ministrit të MK znj. E. M. i është kërkuar Bashkisë Tiranë bashkëpunim institucional në lidhje me realizimin e projektit përmes dhënies së pëlqimit për përdorimin ose transferimin e pronësisë së një pjese të pronës e cila rezulton brenda gjurmës së objektit të investimit të parashikuar, me qëllim realizimin e këtij projekti me vlerë në fushën e artit dhe trashëgimisë kulturore. Në përfundim të korrespondencave në lidhje me këtë çështje, përmes shkresës së administruar në MK me nr. 4131 prot., datë 04.08.2021, i është përcjellë institucionit VKM nr. 494, datë 30.07.2021 "*Për kalimin në përgjegjësi administrimi, te Ministria e Kulturës, të pasurive nr. 1/507, lloji "shesh", nr. 1/102, lloji "truall", nr. 1/260, lloji "truall", zona kadastrale 8150, Tiranë, dhe për kalimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Shërbimi Informativ i Shtetit te Ministria e Kulturës, të pasurisë nr. 1/509, lloji "truall", zona kadastrale 8150, Tiranë"*. Nga ana e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM), përmes aktit me nr. 1392 prot., datë 29.12.2020, është marrë Vendimi nr. 542, datë 29.12.2020 "*Për miratimin e projektit Restaurim, Rikonstruksion dhe rehabilitimi i hapësirave në Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria e Arteve)"*. Për zbatimin e punimeve nga ana e Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT), me

mbledhjen e datës 17.03.2021 është marrë vendimi nr. 5 *“Për miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: ‘Restaurimi, rikonstruksioni, shtesë anësore të objektit ekzistues dhe rehabilitimi i hapësirave në Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura’”, me zhvillues Ministrinë e Kulturës, në përputhje me Ligjin nr. 107/2014 ‘Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit’* dhe kjo leje i është përcjellë MK nga ana e AZHT, përmes shkresës së administruar në institucion me nr. 5384 prot., datë 15.10.2021 së bashku me hartën e Plan Vendosi. Në vijim, nisur nga fakti se dhënia e lejes është miratuar me kushtin e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm tekniko ligjor si dhe kryerjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë, leja rezulton të jetë miratuar sipas aktit me nr. 636/1, datë 08.02.2023, me afat 24 muaj.

Historiku i zbatimit të kontratës

Në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues BOE 4 & K. & I.C, të përfaqësuar këta nga OE 4 AM me përfaqësues ligjor z. A.M të cilin është lidhur kontrata me Autoritetin Kontraktor sipas shkresës me nr. 3047 prot., datë 10.06.2021 me vlerë 1,060,884,393.36 lekë me TVSh (21.8% më pak se fondi limit) dhe me afat të zbatimit të punimeve 24 muaj duke filluar nga:

1. Dorëzimi i paketës së plotë të firmosur të projekt zbatimit;
2. Lejet e nevojshme për fillimin dhe disiplinimin e punimeve, sipas legjislacionit në fuqi;
3. Dorëzimin e kantierit;
4. Përzgjedhja e mbikëqyrësit të punimeve nga Autoriteti Kontraktor;

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit nr. 3306/14 prot., datë 22.07.2021 është lidhur kontrata përkatëse e shërbimit mes Ministrisë së Kulturës në cilësinë e AK e përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm i MK znj. E. Ç dhe OE A e përfaqësuar nga z. A. E me vlerë 15,590,400 lekë me TVSH.

Koordinator projekti nga ana e Ministrisë së Kulturës, përmes Urdhrit të Ministrit të Kulturës me nr. 727, datë 10.11.2021, me nr. 5825 prot., datë 10.11.2021 është caktuar z. O. P me profesion arkitekt. Nga ana e IKTK është caktuar fillimisht z. J. M i cili është zëvendësuar më pas me znj. K. M përmes shkresës me nr. 2148 prot., datë 30.12.2021.

PASQYRIM I KORRESPONDENCAVE:

2021

Referuar dokumentacionit, punimet kanë nisur në datën 28.10.2021. Në këtë datë janë mbajtur edhe aktet si më poshtë:

- Shkresa nr. 5599 prot., datë 28.10.2021 *Procesverbal mbi fillimin e punimeve* në prezencë të sipërmarrësit, mbikëqyrësi, AK e përfaqësuar nga znj. E. Ç.
- Shkresa nr. 5599/1 prot., datë 28.10.2021 *Akt dorëzimi i objektit pasuri kulturore materiale* në prezencë të sipërmarrësit, mbikëqyrësi, AK e përfaqësuar nga znj. E. Ç. Sipas këtij dokumenti rezulton se dorëzimi i sheshit është bërë pjesërisht pasi një pjesë e sipërfaqes (pjesa paralele me rrugën Murat Toptani) rezulton e pa liru.

Përmes shkresës me nr. 3859 prot., datë 28.10.2021 të subjektit A dhe të MK me nr. 5637 prot., datë 01.11.2021, nga ana e mbikëqyrësit është kërkuar vënia në dispozicion e dokumentacionit si më poshtë:

- Akt për Dorëzim të objektit;
- Procesverbalin e fillimit të punimeve;
- Kopjen e kontratës (Kushtet e Veçanta dhe Specifike);
- Lejen për ndërhyrjet ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale, miratuar me vendim të KKTKM-së;
- Projektin e plotë të zbatimit, të vulosur nga Autoriteti Kontraktor, përfshirë relacionin teknik dhe specifikimet teknike të miratuar në KKTKM;

- Preventivin e ofertës fituese, të vulosur nga Autoriteti Kontraktor, i cili duhet të përputhet me zërat dhe volumet e miratuara në KKTKM;
- Grafikon fillestar të punimeve dhe grafikon e përditësuar;
- Licencat e kompanisë;
- Staf i sipërmarrësit (përfshi koordinatorin e sigurisë), me diplomat, autorizimet, certifikatat apo licencat përkatëse;
- Vlerësimin e riskut dhe Planin e Masave për evitimin e riskut;
- Aktin e Piketimit;
- Plan organizimi i kantierit;
- Listë makinerish që do të përdoren dhe certifikatat e kolaudimit të tyre;
- Manualin e kontrollit të cilësisë, përfshirë formatet që do të përdoren gjatë realizimit të punimeve;
- Programin e punës dhe metodat e përgjithshme dhe specifike për realizimin punimeve;
- Formatet e kërkesave për inspektim dhe Kërkesave për miratim materialesh (beton, hekur, etj.);
- Dokumentacionin e laboratorit që do të përdoret për analizat Laboratorike;
- Kontratën me pikën e depozitimit për depozitimin e mbetjeve;
- Njoftimet për fillimin e punimeve.

Përmes aktit të administruar në MK me nr. 5770 prot., datë 08.11.2021, nga ana e sipërmarrësit është dërguar shkresa më objekt Kërkesë për spostimin e kabinës elektrike dhe linjave elektrike ekzistuese. Konkretisht, përmes është kësaj shkrese është cituar si më poshtë: “Pas azhornimeve të linjave elektrike ekzistuese të marra nga O.S.SH dhe kontrollit e verifikimit të bërë në objekt nga ana e kontraktorit, rezulton se kabina ekzistuese dhe linja elektrike e TM që e furnizon atë, ndodhet në gjurmën e objektit të ri që do të ndërtohet. Për këtë arsye për fillim e punimeve në objektin ekzistues dhe ndërtimin e godinës së re është e domosdoshme të realizohet spostimi i kabinës elektrike dhe kabllave të furnizimit të saj për të lejuar punimet e prishjes dhe ndërtimin e godinës së re. Gjithashtu nevojitet spostimi i linjave 6 kV, nga brenda objektit që do të restaurohet dhe jashtë tij për të lejuar punimet për rikonstruksionin dhe restaurimin e godinës ekzistuese. Bashkëngjitur do të gjeni vizatimin e infrastrukturës ekzistuese pas azhornimit të bërë nga Kontraktori dhe azhornimi ardhur nga O.S.SH. Propozojmë që të kryhet një spostim provizor i kabinës ekzistuese dhe në përfundim të punimeve kabina të vendoset në brendësi të objektit të ri që do të ndërtohet në ambientin teknik elektrik të përcaktuar në projekt zbatimin e miratuar të punimeve sipas kontratës nr. 3047 prot., datë 10.06.2021 dhe lejes përkatëse të ndërtimit. Për sa më sipër është e domosdoshme të merren masa nga autoritetet përkatëse (O.S.SH), të hartohet projekti dhe preventivi i punimeve të nevojshme për spostimin e kabinës dhe linjave elektrike me qëllim fillimin e punimeve”.

Në vijim të sa më sipër, nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të MK, znj. E.Ç, përmes shkresës me nr. 5770/1 prot., datë 15.11.2021 i është kërkuar bashkëpunim institucional O.S.SH. dhe O.SH.E.E. me tekst si më poshtë: “Nëpërmjet shkresës me nr. 456 prot., datë 05.11.2021, protokolluar me tonën me nr. 5770 prot., datë 08.11.2021, zbatuesi i punimeve në kantier, për shkak të vijimit të punimeve që parashikon zbatimi i kësaj kontrate, kërkon zhvendosjen e kabinës elektrike dhe kabllave të furnizimit të GKA, për të lejuar punimet e prishjes dhe ndërtimin e godinës së re. Gjithashtu nëpërmjet kësaj kërkesë zbatuesi i punimeve, kërkon zhvendosjen e linjave 6 KV, nga brenda objektit të GKA që do të restaurohet dhe jashtë tij për të lejuar punimet për rikonstruksionin dhe restaurimin e godinës ekzistuese. Për sa më lart, lutemi marrjen e masave dhe bashkëpunimin tuaj institucional, për mundësimin e kërkesave të zbatuesit të punimeve në një kohë sa më të shpejtë”. Me shkresën nr. 5906 prot., datë 15.11.2021 nga ana e Sekretarit të

Përgjithshëm të MK, znj. E. Ç, është kërkuar zëvendësimi i Galerisë Kombëtare të Arteve si palë në kontratën e energjisë elektrike me Nr. TR2A080002107846 dhe vendosja në vendin e saj të shoqërisë 4 sh.p.k, si përfaqësuese e BOE. Në përgjigje të shkresës nr. 5770/1 prot., datë 15.11.2021, nga ana e O.S.SH është kthyer përgjigje përmes shkresës së administruar në O.S.SH me nr. 10367/1 prot., datë 25.11.2021 sipas të cilës është cituar si më poshtë: “ ... Për sa më sipër kërkohet që nga ana e palës së interesuar të vihet në dispozicion dokumentacioni i mëposhtëm:

- Projekt-Preventivi i spostimit të rrjetit elektrik (Linje, Kabinë, shtylla, aksesore etj.) që ndodhet në objektin: "Restaurimi, rikonstruksioni dhe rehabilitimi i hapësirave në Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura";

- Pronësia e sheshit ku do të spostohet rrjeti elektrik, kabina etj.. (vërtetim dokumenti hipotekor).

- Leje ndërtimi nga Bashkia Tiranë, për shtrirjen e rrjetit elektrik etj.

Pasi merret miratimi nga OSHEE sh.a. për vazhdimin e procedurës, spostimi i paisjeve të kabinës elektrike tip muraturë/BOX pranë një kabine tjetër tip muraturë/BOX, apo spostimi i linjave ajrore/kabllore dhe shtyllave elektrike, do të realizohet me shpenzimet e Shoqërisë së interesuar dhe sipas kushteve teknike të OSHEE sh.a. Subjekti i interesuar duhet të sigurojë që do e zhvendosë Kabinën/linjën në një ambient me kushte të njëjta ose me të mira kundrejt kabinës/linjës ekzistuese. Detyrimet kryesore të Shoqërisë së interesuar janë:

Merr përsipër, që me shpenzimet e veta të sigurojë truallin ku do të ndërtohet kabina/linja e re elektrike, të përballojë të gjitha shpenzimet e ndërtimit të kabinës/linjës, kostot për sigurimin e pajisjeve, kostot e montimit të pajisjeve tek kabina/linja e re si dhe kostot e riparimeve apo zëvendësimeve të kabllove që këputen apo dëmtohen, shtesat e kabllove si dhe çdo shpenzim tjetër që nevojitet për vënien në efikasitet të kabinës së re elektrike, konform kushteve dhe kërkesave teknike të përcaktuar nga aktet ligjore e nënligjore si dhe nga OSHEE sh.a.

Pasi të merret miratimi përkatës për spostimin e kabinës/linjës me shpenzimet e kërkuarit, sipas projekt preventivit të miratuar dhe kushteve teknike nga O.S.H.E.E. sha, si dhe pas ndërtimit të kabinës, Pala e interesuar merr përsipër të kryejë kalimin e pronësisë pa kundër shpërblim në favor të shoqërisë O.S.SH sh.a”.

Me shkresën e administruar në A nr. 3909 prot., datë 18.11.2021 dhe në MK me nr. 6040 prot., datë 19.11.2021, mbështetur në letrën e kontraktorit të punimeve me lëndë Për korrigjim, plotësim e përmirësim projekti, nga ana e mbikëqyrësit është bërë vlerësimi dhe aprovimi i kërkesës së kontraktorit pas vlerësimit të dokumentacionit të dërguar. Për rrjedhojë nga sa më sipër, nga ana e tij i është propozuar MK në cilësinë e AK:

- Aprovimi i këtij preventivi të ripunuar, për realizimin e punimeve të kontratës;

- Rishikimi i afateve të realizimit;

- Marrja e masave për fonde shtesë për realizimin e të gjitha punimeve sipas projektit dhe preventivit të kontratës së paraqitur (bazë dhe shtesë) pasi fondet e parashikuar në vlerën e kontratës bazë nuk mjaftojnë për realizimin e projektit të paraqitur.

Në përgjigje të shkresës nr. 5770/1 prot., datë 15.11.2021, nga ana e O.S.SH është kthyer përgjigje përmes shkresës së administruar në MK me nr. 5770/2 prot., datë 01.12.2021, sipas të cilës janë sqaruar masat dhe hapat e nevojshëm që duhet të merren nga ana sipërmarrësit për plotësimin e kërkesës së sipërmarrësit në lidhje me kabinën dhe punimet elektrike. Korrespondenca si më sipër i është përcjellë edhe O.S.SH përmes shkresës me nr. 5770/3 prot., datë 10.12.2021.

Pas hartimit të projekt-preventivit për zhvendosjen e kabinës elektrike të hartuar nga ana e sipërmarrësit dhe të dorëzuar në MK sipas shkresës me nr. 6453 prot., datë 15.12.2021, me shkresën e administruar në MK me nr. 5770/4 prot., datë 15.12.2021, nga ana e institucionit i janë

përcjellë dokumentacionet për miratimin e zhvendosjes së kabinës elektrike dhe kablllove të furnizimit të GKA.

Me shkresën e administruar në A me nr. 3909/1 prot., datë 18.11.2021, administruar në MK me nr. 6040/1 prot., datë 19.11.2021, është bërë kërkesa e mbikëqyrësit drejtuar AK për miratimin e përdorimit të fondit rezervë dhe punimeve shtesë shoqëruar me autorizimin përkatës të datës 18.11.2021, i nevojshëm për përdorimin e këtij fondit. Gjithashtu, përmes kësaj shkrese është cituar si më poshtë vijon: *“Në lidhje me punimet e propozuara nga ana e Kontraktorit, për përmirësimin e projektit të kontratës, për të cilat jeni vënë në dijeni me anë të korrespondencave dhe takimeve përkatëse, ju njoftojmë se jemi në pritje të aprovimit tuaj. Duke ju falënderuar për bashkëpunimin, mbetemi në pritje të miratimit Tuaj”*.

Me shkresën nr. 5825/1 prot., datë 26.11.2021, nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të MK znj. E. Ç. janë njoftuar sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi për caktimin e z. O.P si Menaxher Projekti / Ndjekës kontrate.

2022

Përmes shkresës së administruar në MK me nr. 185 prot., datë 13.01.2022 janë përcjellë në Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, Tiranë shkresat me nr. 6699 prot., datë 29.12.2021 dhe nr. 6700 prot., datë 29.12.2021, respektivisht kërkesa e mbikëqyrësit dhe e sipërmarrësit për likuidimin e situacionit pjesor nr. 1 me vlerë 14,268,912 lekë me TVSH.

Me shkresën nr. 399 prot., datë 26.01.2022, nga ana e sipërmarrësit i është dërguar mbikëqyrësit shkrese me lëndë *Kërkesë për sondazh në lidhje me restaurimin e fasadave*. Konkretisht sipas shkresës është cituar si më poshtë: *“Nga vëzhgimi i gjendjes aktuale në objekt, është vënë re që pjesa më e madhe e suvatimit të fasadës e veshur me teserin është në një stad të avancuar degradimi. Për këtë arsye e shohim të nevojshëm që të kryhet një sondazh në prezencë të të gjithë palëve të interesuara për të evidentuar në objekt gjendjen faktike të suvatimit të fasadave dhe marrjen e mostrave të cilat duhet të analizohen në laborator për të vijuar më tej me punimet për rikonstruksionin e godinës ekzistuese. Theksojmë që procesi i restaurimit dhe zëvendësimit të veshjes me pllaka teserin në fasadat e objektit është i pamundur që të kryhet në këtë gjendje që paraqitet suvatimi i fasadave. Gjithashtu pas tërmetit të Nëntorit 2019 janë vërejtur edhe një sërë çarjesh në muraturën e fasadës. Nga sondazhi i bërë nga ana jonë i këtyre çarjeve shihet e domosdoshme që muratura e fasadës të bëhet e re për të garantuar qëndrueshmërinë dhe Jetëgjatësinë e fasadës së objektit.”*

Shkrese si më sipër, përmes aktit me nr. 399/1 prot., datë 02.02.2022 i është përcjellë DRTK Tiranë.

Përmes shkresës me nr. 695 prot., datë 09.02.2022, nga ana e sipërmarrësit i është kërkuar MK dhe mbikëqyrësit të punimeve caktimi i vend depozitimit të dherave dhe inerteve.

Në përgjigje të shkresës së dërguar nga ana e MK me nr. 5770/4 prot., datë 15.12.2021, përmes të cilës nga ana e ministrisë i janë përcjellë O.S.SH dokumentacioni për miratimin e zhvendosjes së kabinës elektrike dhe kablllove të furnizimit të GKA të hartuar paraprakisht nga ana e vet sipërmarrësit (shkrese e administruar prej tij me nr. 517 prot., datë 13.12.2021), nga ana e O.S.SH është kthyer përgjigje përmes shkresës së administruar në O.S.SH me nr. 11306/3 prot., datë 10.02.2022, administruar në MK me nr. 5770/5 prot., datë 14.08.2022 (?), Nga kjo shkrese citohet si më poshtë: *“... Pas verifikimit nga ana jonë të kërkesës suaj, në mënyrë që nga ana e kompanisë sonë të garantohet siguria dhe cilësia e furnizimit me energji elektrike në formë të pandërprerë dhe të qëndrueshme të konsumatorëve të saj, të cilët siç e theksuam më sipër janë të një rëndësie të veçantë, bashkëngjitur gjeni projektin e spostimit të përkohshëm të këtyre dy kabinave. Në këtë projekt paraqitet spostimi i këtyre dy kabinave për fazën e kryerjes së punimeve të rikonstruksionit*

të GKA dhe rikthimin e tyre me të njëjtën sipërfaqe në gjendjen dhe pozicionin e mëparshëm, ose më të mirë, pas përfundimit të këtij rikonstruksioni....

Aplikanti duhet të sigurojë që do i zhvendosë Kabinat/linjën në një ambient me kushte të njëjta të përcaktuara nga O.S.SH sh.a. ose më të mira kundrejt kabinave/linjës ekzistuese. Për sa më sipër kërkohet që nga ana e Aplikantit të vihet në dispozicion dokumentacioni i mëposhtëm:

-Leje zhvillimi nga Bashkia Tiranë, për vendosjen e Kabinës Provizore dhe shtrirjen rrjetit elektrik TM&TU, etj.

Pas përfundimit të punimeve të rikonstruksionit të objektit, aplikanti merr përsipër të kryejë kalimin e pronësisë së kabinës ekzistuese 6 kV dhe kabinës ekzistuese tip BOX 20kV, pa kundër shpërblim në favor të shoqërisë O.S.SH sh.a”.

Nga analiza e korrespondencës së mësipërme nuk rezulton e argumentuar një kalim i tillë prej 6 muajsh nga data e dërgimit të shkresës nga ana e O.S.SH (10.02.2022) në datën e marrjes në dorëzim të praktikës nga ana e Ministrisë së Kulturës (14.08.2022)

Përmes shkresës me nr. 915 prot., datë 17.02.2022, nga ana e MK i janë përcjellë DRTK Tiranë shkresat me nr. 695 prot., datë 09.02.2022, nr. 739 prot., datë 11.02.2022 dhe nr. 5770/5 prot., datë 14.02.2022. Pas dërgimit të shkresës nr. 5770/5 prot., datë 14.02¹⁴.2022 tek mbikëqyrësi i punimeve sipas shkresës me nr. 5770/6 prot., datë 17.02.2022 nga ana e tij është hartuar një relacion i administruar në MK sipas shkresës me nr. 5770/7, prot., datë 21.02.2022, sipas të cilës janë përcjellë bashkëlidhur, plani i propozuar për plotësimin e ambienteve të nevojshme për kabinën elektrike për tu marrë në konsideratë nga ana e O.S.SH. Me shkresën nr. 5770/8 prot., datë 22.02.2022 nga ana e MK i janë përcjellë O.S.SH komunikimet për marrjen e masave dhe bashkëpunimin institucional për zhvendosjen e kabinës elektrike dhe kablllove të furnizimit të GKA. Përmes shkresës me nr. 5770/9 prot., datë 22.02.2022 të MK, i është përcjellë DRTK Tiranë për trajtim / dijeni shkresa me nr. 5770/7¹⁵, prot., datë 21.02.2022 e mbikëqyrësit të punimeve nga ana e të cilit është njoftuar AK se mbikëqyrësi i punimeve, pasi ka vlerësuar kërkesën e AK dhe bazuar në komentet e bëra nga O.SHE.E. ka dërguar bashkëngjitur planin e propozuar për plotësimin e ambienteve të nevojshme për kabinën elektrike, për t’u marrë në konsideratë nga ana e AK. Përmes shkresës me nr. 993/1 prot., datë 23.02.2022, bazuar edhe në kërkesën e vet sipërmarrësit sipas shkresës së administruar në MK me nr. 993 prot., datë 22.02.2022, nga ana e mbikëqyrësit të punimeve është dorëzuar në MK shkresa me objekt *Rekomandim për riprojektimin e konstruksionit të strukturave* sipas të cilës është rekomanduar *riprojektimi struktural i objektit të ri të GKA dhe rivlerësimin e strukturës së godinës ekzistuese të GKA, kjo bazuar në parametrat aktuale të publikuara nga IGJEO. Ky projekt është parashikuar se duhet të shoqërohet po ashtu edhe me një vlerësim të sasive të preventivit, ku të reflektohen ndryshimet që mund të rrjedhin nga ky projektim i strukturave si dhe me ndryshime në pjesët e tjera të projektit, elektrik, mekanik dhe arkitekture.* Shkresa si më sipër i është përcjellë DRTK Tiranë sipas aktit me nr. 993/2 prot., datë 24.02.2022. Në vijim, përmes shkresës me nr. 112 prot., datë 03.03.2022, nga ana e ndjekësit të kontratës z. O. P i është dërguar znj. E. Ç, Sekretar i Përgjithshëm i MK dhe për dijeni znj. E M, Ministër, shkresa me lëndë *Rekomandime për riprojektimin e konstruksionit të strukturave.* Ky rishikim është argumentuar me faktin se për Qytetin e Tiranës, pas tërmeteve të vitit 2019 dhe

¹⁴ Në dokumentin zyrtar është shkruar 14.22.2022;

Nga kartela e administrimit të shkresës së OSSH rezulton se ky dokument i administruar në O.S.SH me nr. 11306/3 prot., e datës 10.02.2022, nuk është shumë e qartë se kur është marrë në dorëzim nga arkiva pasi ka korrigjime në shkresë.

¹⁵ Në shkresën përcjellëse është shkruar gabimisht fraksioni nga 5770/7 prot. që duhet në 5770/1 prot.

sipas VKM nr. 1162, datë 24.12.2020 *“Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për pajisjen me vërtetim për riskun të subjekteve, të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi / ndërtimi”*, Instituti i Gjeoshkencave IGJEO ka publikuar hartat e rrezikut sizmik dhe vlerat e rrezikut në terma PGA për çdo Bashki dhe Njësi Administrative të vendit duke ndryshuar vlerën e parametrin agR për llogaritjen strukturale sipas Euro kodeve. Kjo vlerë ka ndryshuar $agR=0.248g$ në $agR=0.293g$. Me shkresën nr. 915/1 prot., datë 03.03.2022 nga ana e ndjekësit të kontratës, përmes një MEMO drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm dhe për dijeni Ministrit, i është kthyer përgjigje pretendimit të sipërmarrësit në lidhje tarifën e vend depozitimit të inerteve duke kundërshtuar dhe hedhur poshtë një pretendim të tillë. Në vijim, kjo përgjigje i është përcjellë edhe sipërmarrësit përmes shkresës së administruar në MK me nr. 695/2 prot., datë 15.03.2022. Përmes shkresës me nr. 1278 prot., datë 04.03.2022, nga ana e MK i janë përcjellë DRTKT shkresat me nr. 538/5 prot., datë 21.02.2022 dhe nr. 993 prot., datë 22.02.2022. Me shkresën nr. 993/5 prot., datë 18.03.2022, drejtuar sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe ndjekësit të kontratës, nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të MK, në mbështetje të konkluzionit të arritur nga ana e ndjekësit të kontratës sipas aktit të administruar në DRTK Tiranë me nr. 112 prot., datë 03.03.2022 dhe në MK me nr. 993/4 prot., datë 10.03.2022, është dhënë dakordësia për: *“... kryerjen e rishikimit të projektit konstruktiv duke marrë të gjitha arsyetimet të kushtëzuara nga institucionet mbi bazën e llogaritjeve të reja me Eurokode dhe me parametrin e ri të miratuar mbas tërmeteve të vitit 2019. Ky projekt duhet të shoqërohet po ashtu edhe me një vlerësim të sasive të preventivit, ku të reflektohen ndryshimet që mund të rrjedhin nga ky projektim. Të na vihen në dispozicion sa më shpejt të jetë e mundur ndryshimet arkitektonike dhe konstruktive pasi duhet proceduar për miratimin e tij për të mos penguar ecurinë e zbatimit të kontratës.”*. Përmes shkresës së datës 2525, prot., datë 05.05.2022 drejtuar Ministrisë së Kulturës në cilësinë e AK dhe mbikëqyrësit të punimeve “A”, nga ana e përfaqësuesit të BOE, OE 4 i është kërkuar informacion palëve mbi miratimin e preventivit të ripunuar. Sipas shkresës citohet se: *“... nga ana e kontraktorit të punimeve është plotësuar dosja teknike për ndryshimet e nevojshme që janë evidentuar nga ana e Kontraktorit dhe supervizorit. Kjo dosje është dorëzuar pranë autoritetit Kontraktor së bashku me projektet, specifikimet, relacionet dhe preventivat përkatës. ... Kontraktori është në pritje të vlerësimit të këtyre propozimeve për të vazhduar me punimet sipas grafikut të punimeve dhe kushteve teknike të zbatimit. Gjithashtu, m.q.s këto propozime vazhdojnë të jenë pa vlerësim nga ana e AK, do të paraqesë edhe ndikimin që kanë këto vonesa në përfundimin e punimeve. Procese të caktuara si ndërtimi i pilotave, janë procese të cilat bllokojnë të gjitha proceset pasardhëse dhe si pasojë kontraktorit i lind e drejta të kërkojë shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve”*. Përmes shkresës së administruar në MK me nr. 2611/4 prot., datë 31.05.2022 dhe në DRTK Tiranë me nr. 274 prot., datë 31.05.2022, nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të MK i është përcjellë OE A në cilësinë e projektuesit të punimeve, IKTK, sipërmarrësit të punimeve si dhe ndjekësit të kontratës oponenca teknike e lëshuar nga ana e Institutit të Ndërtimit për projekt – preventivin e ri të propozuar paraprakisht nga ana e sipërmarrësit sipas shkresës së datës 12.11.2021 dhe mbikëqyrësit të datës 18.11.2021. Po përmes kësaj shkrese është kërkuar edhe aplikimi në KKTKM për miratimin e projektit. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se nga ana e Grupit të Oponencës Teknike është arritur në konkluzionin se ... *Projekti plotëson kushtet teknike projektimit. Të gjitha ndryshimet në projekt janë bërë bazuar në argumente teknike sipas kushteve teknike të projektimit dhe funksionit sa më të mirë të objektit*. Përmes shkresës së datës 3898, prot., datë 20.07.2022, nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të MK i është kthyer përgjigje kontraktorit duke i përcjellë atij shkresën me nr. 374 prot., datë 14.07.2022 të ndjekësit të kontratës z. O.P në lidhje me propozimet e bëra prej kontraktorit. Konkretisht sipas kësaj shkrese është cituar si më poshtë: *“Propozimi i*

ardhur nga Bashkimi i Operatorëve ekonomikë nëpërmjet procesverbalit të mbajtur nga kontraktori i zbatimit të punimeve dhe mbikëqyrësit të punimeve A. 4 sh.p.k, me objekt "Mbi rakordimin e volumeve brenda preventivit të ofertës" për heqjen e një pjese të zërave që i përkasin mobilimit të godinës nuk mund të pranohet pasi kjo do të ndryshonte preventivin e hartuar nga projektuesi dhe do të ndryshonte mjaftueshëm kushtet e kontratës së lidhur mes palëve. Në vazhdim të argumentimit të bërë nga palët në pikën 4, "Punime shtresash" në procesverbalin e sipërcituar sqarojmë se: Bazuar në kontratën nr. 3047 prot, datë 10.06.2021, neni 29 "Ndryshimi i porosisë", pika 3, citojmë "Çmimet më të larta se ato të ofruara në ofertë nuk aplikohen, me përjashtim të atyre zërave të cilat nuk janë të specifikuara në preventiv-ofertë nga Institucioni publik dhe me kushtin që të arrihet rezultati i pritshëm". Nëpërmjet shkresës me nr. 4380 prot., datë 27.09.2022, administruar në MK me nr. 5252 prot., datë 27.09.2022, me objekt "Propozim për miratim të preventivit të ripunuar, përfshi punime shtesë dhe shtesë afati, në objektin e kontratës", nga ana mbikëqyrësit të punimeve, është përcjellë në AK shkresa e sipërmarrësit punimeve BOE 4 & K. & I me nr. 451 prot., datë 20.09.2022 sipas të cilës është bërë dorëzimi i propozimit tekniko-ekonomik përfshirë edhe kërkesë për shtyrje të afatit të punimeve me 8 muaj. Në datën 19.10.2022, është mbajtur procesverbal mes mbikëqyrësit të punimeve, sipërmarrësit dhe Drejtuesit Teknik të OE 4.A si dhe AK e përfaqësuar nga ndjekësi i kontratës mbi pezullimin e punimeve. Argumenti mbi të cilin është bërë kjo ndërprerje është cituar si më poshtë: "Me përfundimin e Punimeve të mundshme brenda kontratës, projektit të zbatimit, preventivit si dhe verifikimin në terren kemi konstatuar se është e pa mundur nga ana e Kontraktorit të vazhdojë me realizmin e punimeve. Nga sa më sipër jemi të detyruar të pezullohen punimet deri në Miratimin e Projekt-preventivit të revizionuar. Pas këtij miratimi, punimet do të ri-fillojnë pas firmosjes nga palët të proces-verbalit përkatës".

Sipas shkresës me nr. 555 prot., datë 20.10.2022 të DRTK Tiranë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm dhe Ministrit të MK, nga ana e ndjekësit të kontratës, përmes një MEMO me lëndë *Mbi ndjekjen e kontratës me objekt 'Restaurimi, rikonstruksioni dhe rehabilitimi i hapësirave në Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria e Arteve)'*, në vijim të kërkesës së mbikëqyrësit sipas shkresës me nr. 4380 prot., datë 27.09.2022, nga ana e ndjekësit të kontratës është kërkuar dërgimi i projektit për oponencë teknike¹⁶. Sipas shkresës së administruar në MK me nr. 5252/3 prot., datë 21.10.2022, nga ana e MK i është kërkuar UPT kryerja e oponencës teknike për projektin e rishikuar dhe në vijim nga e tij është kthyer përgjigje përmes shkresës së administruar në MK me nr. 5252/4 prot., datë 26.10.2022 sipas të cilës për kryerjen e shërbimit të oponencës teknike për objektin "Restaurimi, rikonstruksioni dhe rehabilitimi i hapësirave në Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura (GKA)", nevojitet edhe Relacioni Arkitektonik. Sipas shkresës me nr. 5252/5 prot., datë 31.10.2022 drejtuar ndjekësit të kontratës z. O. P dhe për dijeni mbikëqyrësit të punimeve "A", nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm është kërkuar marrja e masave për plotësimin e dokumentacionit të munguar (Relacionit Arkitektonik). Pas dërgimit të dokumentacionit të munguar, nga ana e UPT, përmes shkresës së administruar në këtë institucion me nr. 2378/5 prot., datë 17.11.2022 dhe në MK me nr. 6270/1 prot., datë 18.11.2022, është përcjellë në MK oponenca e plotë teknike për projektin e zbatimit të objektit "Restaurimi, rikonstruksion dhe rehabilitim i hapësirave në Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria e Arteve), Tiranë".

2023

¹⁶ Kryerjen e oponencës teknike të projekt propozimit të ri pasi oponenca e projektit të parë është administruar në Ministrinë e Kulturës përmes shkresës me nr. 104/1 prot., datë 08.01.2019.

Përmes shkresës me nr. 6579/2 prot., datë 02.03.2023 nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të MK i është dërguar DRTK Tiranë kërkesa *Mbi hartimin e termave të referencës mbi profesionet, kualifikimet dhe eksperiencën e eksperteve të grupit që do të vlerësojë ndryshimin e projektit të Muzeut Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria e Arteve)*. Në përgjigje të kësaj kërkesë, përmes shkresës së administruar në DRTKT me nr. 133 prot., datë 13.03.2023, nga ana e z. O. P ndjekës i kontratës dhe njëkohësisht Drejtor i kësaj drejtorie, janë rekomanduar kapacitete profesionale që duhet të ketë grupi i punës (*projektues arkitekt, projektues konstruktor, inxhinierik - hidrogeologjik / gjeolog, inxhinier i sizmologjisë dhe preventivues (ing. ndërtimi ose arkitekt)*) si dhe një relacion shpjegues.

Me Urdhër nr. 1250/8 prot., datë 05.05.2023, nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm është ngritur Grupi i Punës së ekspertëve me specialistë të fushave të ndryshme në sektorin e ndërtimit, për vlerësimin e propozimit dhe domosdoshmërisë së ndryshimeve të kërkuara në projektin e objektit '*Restaurimi, rikonstruksioni dhe rehabilitimi i hapësirave në Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria e Arteve)*'. Në përbërje të këtij grupi rezultojnë të kenë qenë:

1. Ing. A. G hidrogeolog pranë Shërbimit Gjeologjik Shqiptar;
2. Ing. F.N gjeolog, sizmolog dhe inxhinier ndërtimi, K. K. SHPK;
3. Ing. N. M, inxhinier ndërtimi, specialist ARRS;
4. Ing. L.S, inxhinier ndërtimit, specialiste ARRS;
5. Ark. D. Gj, arkitekt, Instituti i Ndërtimit.

Nga ana e të këtij Grupi Pune, përmes aktit me nr. 1250/9 prot., datë 07.07.2023, është mbajtur relacioni përkatës, i cili, përmes shkresës me nr. 1250/10 prot., datë 10.07.2023, nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të MK, i është përcjellë ndjekësit të kontratës z. O. P. Përmes shkresës me nr. 364/1 prot., datë 12.07.2023 nga ana e ndjekësit të kontratës, bazuar në relacionin përfundimtar të hartuar nga grupi i ekspertëve të ngarkuar për analizimin e ndryshimeve në projektin me objekt "*Restaurimi, Rikonstruksioni dhe Rehabilitimi i hapësirave në Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura*" (*Galeria e Arteve*) është kërkuar vendosja në dispozicion të KKTKM për miratimin e projekt preventiv të ripunuar, përfshirë punimet shtesë dhe shtesën e afatit në objektin e kontratës shoqëruar me Relacion Teknik firmosur dhe vulosur nga Mbikëqyrësi i punimeve për korrigjimin, plotësimin dhe përmirësimin e projektit të objektit "*Restaurimi, Rikonstruksioni dhe Rehabilitimi i hapësirave në Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura*" (*Galeria e Arteve*). Përmes shkresës me nr. 1250/13 prot., datë 12.07.2023 nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të MK, është njoftuar mbikëqyrësi i punimeve "A" se "*... bazuar dhe në opionencën dhe mendimin e ekspertëve të kontraktuar për analizimin e propozimit, Ministria e Kulturës më datën 12.07.2023*"¹⁷ i është drejtuar zyrtarisht IKTK-së me kërkesë për të përcjellë për miratim në KKTKM propozimin për korrigjimin, plotësimin dhe përmirësimin e projektit të objektit "*Restaurimi, Rikonstruksioni dhe rehabilitimi i hapësirave në Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura, (Galeria e Arteve)*". Bazuar në kërkesën e bërë si më sipër, projekt preventivi i propozuar ka marrë miratimin e KKTKM përmes Vendimit nr. 513, datë 06.10.2023, administruar në këtë institucion me nr. 1280 prot., datë 06.10.2023. Sipas procesverbalit të mbajtur mes sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe ndjekësit të kontratës në datën 13.10.2023, punimet kanë rifilluar, kjo pas njoftimit nga ana e MK të sipërmarrësit përmes shkresës me nr. 1280/1 prot., datë 13.10.2023 për miratimin e projekt – preventivit të propozuar nga ana e KKTKM me nr. 513, datë 06.10.2023. Përmes aktit me nr. 6235 prot., datë 07.12.2023, mes palëve është miratuar amendimi i kontratës sipas të cilit është bërë rritja e vlerës së kontratës me 25 %, rishpërndarja e grafikut të likuidimit

¹⁷ Përmes shkresës me nr. 1250/12 prot., datë 12.07.2023.

ndër vite si dhe përcaktimi i datës së përfundimit të punimeve si datën 18.10.2025. Pra, afati i përfundimit të punimeve është shtyrë me gati 2 vite (1 vit, e 11 muaj e 20 ditë). Sipas shkresës së administruar në MK me nr. 6412 prot., datë 15.12.2023, ose 2 muaj pas nisjes së punimeve pas pezullimit të tyre, nga ana e mbikëqyrësit të punimeve, është paraqitur kërkesa për likuidimin e punimeve të situacionit nr. 2. Në zbatim të Urdhrit nr. 754 prot., datë 22.11.2023 të Sekretarit të Përgjithshëm *Për menaxhimin e Kontratës nr. 3252/25 prot., datë 10.11.2022 të MK me sipërmarrësin e punimeve, BOE 4, K.&C.D, me objekt Restaurimi, Rikonstruksioni dhe Rehabilitimi i Hapësirave në Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria e Arteve)*, nga ana e ndjekësit të kontratës z. O. P, përmes një MEMO me nr. 675 prot., datë 26.12.2023, drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të AK, është sugjeruar likuidimi financiar i këtij situacioni me vlerë 342,408,901.36 lekë me TVSH.

2024

Përmes shkresës së administruar në DRTKT me nr. 469 prot., datë 29.08.2024 nga ana e ndjekësit të kontratës, i është dërguar Ministrisë së Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) dokumenti me lëndë *Informacion mbi ecurinë në objektin MKAB (GKA)*. Ndër të tjera në këtë informacion është sqaruar se data e përfundimit të punimeve është data 28.10.2025. Gjithashtu, në relacion është cituar si më poshtë: “... referuar grafikut të punimeve dhe situatës në terren të zhvillimit të punimeve objekti aktualisht ka një ecuri pak të ngadalhtë në këto 6 muaj, pasi punimet e përforcimit të strukturës mbajtëse të objektit ekzistues kërkonte kohë në përgatitjen e saj që nga themelet deri në kolonat e katit të fundit. Zhvillimi i këtij procesi ka pasur ritme të ulëta pasi nuk kalohet dot në hapin tjetër pa u përforcuar themelet fillimisht dhe pa marrë markën e vetë Betoni dhe B/A gjë që kërkon kohë duke na krijuar ngadalësi punimesh në grafik. Duhet kuptuar që ky proces është bërë në çdo kat po njësojë dhe me një zhvillim ndjekës njëra pas tjetrës gjë që nuk të lejonte të punojë njëkohësisht në të gjithë objektin. Mendoj që punimet do të ecin me ritme shumë të mira dhe të shpejta në momentin e mbylljes së këtij procesi pasi do na lejojë të punojmë njëkohësisht në disa fronte.”

2025

Me shkresën e datës 18.06.2025, administruar në MEKI me nr. 5873/1 prot., datë 23.06.2025, nga ana e znj. A. P. i është sugjeruar Ministrit, Sekretarit të Përgjithshëm si dhe Zv. Ministrit, ngritja e një grupi pune me ekspertë të fushës dhe përfaqësues të GKA për të ndihmuar dhe ndjekur zbatimin e procesit të muzealizimit. Në vijim të sugjerimit si më sipër, sipas Urdhrit të Ministrit me nr. 805, datë 23.06.2025, administruar në MEKI me nr. 5873/2 prot., datë 23.06.2025, është bërë ngritja e grupit të punës me ekspertë të fushës dhe përfaqësues të GKA për monitorimin, koordinimin dhe ndjekjen e zbatimit të procesit të muzealizimit me përbërje të këtij grupi z. E. H, z. Z. P, znj. S. K, znj. A. D ekspertë arti si dhe z. O. L përfaqësues GKA. Këtij grupi i është ngarkuar detyra e aksesimit në fondin muzeor të GKA për të monitoruar procesin e identifikimit të objekteve në kuadër të linjës muzeore si dhe saktësimin e narrativës së linjës muzeore pas verifikimeve të nevojshme. Pas përfundimit të relacionit përkatës nga ana e grupit të punës të ngritur me urdhër si më sipër, nga ana e MEKI i është përcjellë ky material mbikëqyrësit dhe sipërmarrësit të punimeve, sipas shkresës me nr. 5873/3 prot., datë 02.09.2025. Përmes shkresës së sipërmarrësit të punimeve me nr. 660 prot., datë 11.09.2025, administruar në MEKI me nr. 5873/4 prot., datë 11.09.2025, nga ana e tij është përcjellë dokumenti me objekt “*Kërkesë për miratimin e Projekt-Preventivit të Ripunuar 2 dhe kërkesë për zgjatjen e afatit të realizimit të kontratës*”. Kjo shkresë rezulton të jetë dërguar në ministri 37 ditë përpara datës së përfundimit të punimeve. Në brendësi të kësaj shkrese është cituar si vijon:

“Referuar Oponencës Teknike nr. 6270/1 prot, dt. 17.11.2022 e cila është përcjellë me shkresë nr. 11300/1, dt. 07.10.2024 nga Autoriteti Kontraktor drejtuar Kontraktorit;

Referuar shkresës së Autoriteti Kontraktor me nr. 5873/3 prot., datë 02.09.2025, protokolluar nga Kontraktori me nr. 644, prot., datë 06.09.2025;

Referuar Shkresës së Autoritetit Kontraktor me datë 04.09.2025 drejtuar Kontraktorit në lidhje me Sistemit e Jashtme. Ju dorëzojmë bashkëngjitur listën e dokumentacionit si më poshtë renditur:

- *Relacion argumentues i propozimeve nga kontraktori*
- *Projekti arkitektonik i azhornuar*
- *Projekti konstruktiv i konstruksionit metalik*
- *Projekti elektrik i azhornuar*
- *Relacion dhe specifikime teknike të projektit*
- *Licenca e projektuesit*
- *Deklaratat teknike të projektuesit*
- *Policat e sigurimit të projektuesit*
- *Preventivi total i punimeve sipas propozimeve*
- *Matjet metrike*
- *Grafiku i rishikuar i punimeve*
- *Analizat teknike të çmimeve të rinj të propozuar*

Kjo kërkesë ju paraqitet për miratimin nga ana juaj të ndryshimeve të propozuara si dhe efektit të tyre në preventivin e kontratës. Po ashtu, referuar në dokumentacionin sa më sipër listuar, kërkohet aprovimi i Grafikut të Rishikuar të punimeve.”

Me aktin nr. 660/1 prot., të datës 22.09.2025, administruar në MTKS me nr. 135 prot., datë 29.09.2025 (ose 26 ditë¹⁸ përpara datës së përfundimit të punimeve referuar kontratës në fuqi në momentin e dërgimit të shkresës), sipërmarrësi i është drejtuar AK dhe për dijeni mbikëqyrësit me shkresën me objekt ‘Njoftim për përfundimin e afatit të lejes së ndërtimit dhe kërkesë për pezullimin e punimeve’. Në brendësi të kësaj shkrese nga ana e sipërmarrësit është cituar si më poshtë: “Kërkojmë të bëhet pezullimi i realizimit të punimeve në objekt, për shkak të përfundimit të afatit të kësaj leje ndërtimi, deri në azhornimin e afatit për këtë leje. Duam t’ju vëmë në vëmendje se arsyet për mos përfundimin e punimeve brenda afatit të lejes, ju janë bërë të ditura me anë të shkresës tonë nr. 660 prot., datë 11.09.2025”. Me aktin nr. 381/1 prot., të datës 29.09.2025, të mbikëqyrësit të punimeve “A”, administruar në MTKS me nr. 135/1 prot., datë 29.09.2025 (19 ditë¹⁹ përpara datës së përfundimit të punimeve referuar kontratës në fuqi në momentin e dërgimit të shkresës), mbikëqyrësi i punimeve i është drejtuar AK dhe për dijeni sipërmarrësit me shkresën me objekt ‘Njoftim për vonesa në kryerjen e punimeve, në objektin e Kontratës dhe propozim për pezullimin e punimeve në objekt për arsye të tejkalimit të afatit kohor të Lejes së Ndërtimit.’. Përmes kësaj shkrese nga ana e mbikëqyrësit është cituar ndër të tjera se “... afati kohor i kësaj leje dhe po ashtu afati i përfundimit të punimeve për ndërhyrjet ruajtëse, përfundon në datën 18 Tetor 2025. Kontraktuesi nuk mund të vazhdojë me realizmin në objekt të asnjë procesi pune, pas tejkalimit të afatit kohor të kësaj Leje. Bazuar në sa më sipër, propozojmë të bëhet pezullimi i punimeve në objekt, deri në rifreskimin e kushteve të lejes së ndërtimit dhe amendimin e kushteve të kontratës.”. Sipas shkresës së administruar në DRTKT me nr. 526/1 prot., datë 03.10.2025, administruar në MTKS me nr. 135/3 prot., datë 03.10.2025, rezulton se nga ana e ndjekësit të kontratës z. K. B, i caktuar në këtë pozicion sipas Urdhrit të Ministrit nr. 108, datë 28.08.2025,

¹⁸ Llogaritur nga dita e dërgimit të shkresës nga ana e sipërmarrësit.

¹⁹ Llogaritur nga dita e dërgimit të shkresës nga ana e mbikëqyrësit.

është paraqitur një relacion me objekt: *‘Informacion mbi njoftimin e datës 19.09.2025 të mbikëqyrësit të punimeve shoqërisë “A” k në lidhje me vonesat në kryerjen e punimeve, në objektin e kontratës dhe propozimin për pezullimin e punimeve në objekt për arsye të tejkalimit të afatit kohor të lejes së ndërtimit.’* në përgjigje të shkresës me nr. 135/1 prot., datë 29.09.2025. Në përfundim të këtij relacioni nga ana e ndjekësit të kontratës është sugjeruar pezullimi i punimeve të ndërtimit për objektin *“Restaurim, Rikonstruksion dhe Rehabilitimi i Hapësirave në Muzeun e Arteve të Bukura (Galeria e Arteve)”* deri në rifreskimin e lejes së ndërtimit. Me shkresën nr. 111/1 prot., datë 09.10.2025, nga ana e Ministrit të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sporteve (MTKS), është përcjellë për trajtim në DRTKT te ndjekësi i kontratës, shkresa me nr. 381 prot., datë 29.09.2025 e mbikëqyrësit të punimeve, së bashku me dokumentacionin shoqërues të hartuar nga ana e sipërmarrësit. Sipas shkresës së administruar në DRTKT me nr. 532/1 prot., datë 10.10.2025, administruar në MTKS me nr. 111/2 prot., datë 10.10.2025, rezulton se nga ana e ndjekësit të kontratës z. K. B, i caktuar në këtë pozicion sipas Urdhrit të Ministrit nr. 108, datë 28.08.2025, është paraqitur një relacion me objekt: *Mbi shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur nga mbikëqyrësi i punimeve, për objektin ‘Restaurimi, Rikonstruksioni dhe Rehabilitimi i Hapësirave në Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria e Arteve)’* në përgjigje të shkresës me nr. 111/1 prot., datë 09.10.2025. Në përfundim të këtij relacioni nga ana e ndjekësit të kontratës është sugjeruar vijimi i procedurës me ngritjen e grupit të punës për hartimin amendimit të kontratës. Me shkresën nr. 111/3 prot., datë 13.10.2025, përmes Urdhrit nr. 30, datë 13.10.2025, nga ana e Ministrit të MTKS është ngritur grupi i punës për shqyrtimin e dokumentacionit dhe hartimin e amendimit për ndryshimin e afatit të kontratës nr. 3047 prot, datë 10.06.2021 me përbërje të këtij komisioni znj. A. P Kryetare, z. S. I anëtar dhe znj. B. K anëtare. Sipas Urdhrit të mësipërm kompetenca e vlerësimit të nevojës për shtyrjen e afatit të kontratës i është lënë si detyrë grupit të mësipërm. Me shkresën nr. 111/4 prot., datë 17.10.2025, në zbatim të Urdhrit nr. 30, datë 13.10.2025, nga ana e grupit të punës është përgatitur dhe përcjellë tek Ministri dhe Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë materiali përkatës nga i cili është arritur në përfundimet si më poshtë:

- Afati i përfundimi të punimeve për ndërhyrjet ruajtëse, restaurimin, rikonstruksionin dhe rehabilitimin e hapësirave në "Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria Kombëtare e Arteve) të jetë data 18 gusht 2026.

- Autoriteti Kontraktor duhet të paraqesë kërkesë për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve sipas kalendarit (grafikut) të ri të punimeve, në zbatim të parashikimeve të ligjit nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij si dhe aplikimin pranë Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale.

Me marrjen e mendimit nga ana e grupit të punës të ngritur me Urdhër nr. 30, datë 13.10.2025, përmes aktit me nr. 111/5 prot., datë 17.10.2025 të lidhur mes Ministrit dhe BOE është bërë edhe amendimi i kontratës me afat të përfundimit të punimeve deri në datën 18.08.2026, pra me një shtyrje afati prej 10 muajsh.

RAPORTIMET E MBIKËQYRËSIT:

Tabela nr. 1

Viti	Periudha Raportuese	Raportuar (Po / Jo)	Shkresa ATELIER 4	Shkresa MEKI	Progresi në vlerë	Diferenca	Progresi në %
2021	Tetor 2021	Jo					
	Nëntor 2021	Jo					
	Dhjetor 201	Jo					
2022	Janar 2022	Jo					

	Shkurt 2022	Po					
	Mars 2022	Po					
	Prill 2022	Po					
	Maj 2022	Po					
	Qershor 2022	Jo					
	Korrik 2022	Jo					
	Gusht 2022	Jo					
	Shtator 2022	Jo					
	Tetor 2022	Jo	Zyrtarisht pezulluar				
	Nëntor 2022	Jo	Zyrtarisht pezulluar				
	Dhjetor 2022	Jo	Zyrtarisht pezulluar				
2023	Janar 2023	Jo	Zyrtarisht pezulluar				
	Shkurt 2023	Jo	Zyrtarisht pezulluar				
	Mars 2023	Jo	Zyrtarisht pezulluar				
	Prill 2023	Jo	Zyrtarisht pezulluar				
	Maj 2023	Jo	Zyrtarisht pezulluar				
	Qershor 2023	Jo	Zyrtarisht pezulluar				
	Korrik 2023	Jo	Zyrtarisht pezulluar				
	Gusht 2023	Jo	Zyrtarisht pezulluar				
	Shtator 2023	Jo	Zyrtarisht pezulluar				
	Tetor 2023	Po	5011 prot., datë 10.11.2023	-	153,100,966		13.86
	Nëntor 2023	Po	5061 prot., datë 11.12.2023	-	233,100,966	80,000,000	21.09
	Dhjetor 2023	Po	6024 prot., datë 10.01.2024	-	308,800,966	75,700,000	27.95
2024	Janar 2024	Po	6084 prot., datë 12.02.2024	990 prot., datë 13.02.2024	312,800,966	4,000,000	28.31
	Shkurt 2024	Po	-	-	318,300,966	5,500,000	28.81
	Mars 2024	Po	6153 prot., datë 11.04.2024	4777 prot., datë 12.04.2024	324,300,966	6,000,000	29.39
	Prill 2024	Po	-	6182 prot., datë 14.05.2024	331,300,966	7,000,000	29.98
	Maj 2024	Po	6265 prot., datë 10.06.2024	7771 prot., datë 12.06.2024	339,800,966	8,500,000	30.75

	Qershor 2024	Po	-	9027 prot., datë 11.07.2024	355,300,966	15,500,000	32.15
	Korrik 2024	Po	6352 prot., datë 09.08.2024	10209 prot., datë 12.08.2024	367,800,966	12,500,000	33.28
	Gusht 2024	Po	6388 prot., datë 10.09.2024	11204 prot., datë 12.09.2024	379,300,966 (Jo e gjithë vlera e certifikuar) ²⁰	11,500,000	34.33
	Shtator 2024	Po	6443 prot., datë 10.10.2024	12745 prot., datë 16.10.2024	388,800,966 (Jo e gjithë vlera e certifikuar)	9,500,000	35.19
	Tetor 2024	Po	Sjellë me observacion				
	Nëntor 2024	Po	Sjellë me observacion				
	Dhjetor 2024	Po	Sjellë me observacion				
2025	Janar 2025	Po	Sjellë me observacion				
	Shkurt 2025	Po	Sjellë me observacion				
	Mars 2025	Po			497,677,966 (Jo e gjithë vlera e certifikuar)		45.04
	Prill 2025	Po			508,177,966 (Jo e gjithë vlera e certifikuar)	10,500,000	45.99
	Maj 2025	Po			518,177,966 (por jo i certifikuar për pagesë)	10,000,000	46.89
	Qershor 2025	Po			520,200,000 (por jo i certifikuar për pagesë)	2,022,034	47.07
	Korrik 2025	Po			547,000,000 (por jo i certifikuar për pagesë)	26,800,000	49.42
	Gusht 2025	Po			587,200,000	40,200,000	53.14

²⁰ Shënim i mbikëqyrësit.

					(por jo i certifikuar për pagesë)		
	Shtator 2025	Po			640,200,000 (Jo e gjithë vlera e certifikuar)	53,000,000	57.92

Nga të dhënat e dorëzuara nga ana e subjektit të audituar, për sa i takon raportimeve të bëra nga ana e mbikëqyrësit të punimeve, disa prej materialeve rezultojnë me mangësi të ndryshme si më poshtë:

- Nuk japet informacion i detajuar në lidhje me zbatimin e grafikut të punimeve sipas atij të kontratës bazë apo sipas grafikut të rishikuar për zërat e punimeve por vetëm për kategori punimesh (*Punime ndërtimi, Instalime mekanike, Instalime elektrike, Punime sistemimi, Pajisje ndërtimi / mobilimi, Pajisje mekanike, Pajisje elektrike*).

- Në disa situacione pjesore, nga ana e sipërmarrësit nuk rezulton të jenë përgatitur vizatime dhe libreza masash për secilin prej tyre;

- Në muajin Shkurt 2024, është cituar nga ana e mbikëqyrësit se: *Vërehet një ritëm i ulët në zbatimin e punimeve në objekt. Nga ana e Kontraktorit është e nevojshme të shtohet numri i punëtorëve në kantier për të bërë të mundur rritjen e ritmit të punës.*

- Në muajt Mars – Prill – Maj – Qershor – Korrik – Gusht - Shtator 2024, është cituar nga ana e mbikëqyrësit se: *Vërehet një ritëm i ulët në zbatimin e punimeve në objekt. Nga ana e Kontraktorit është e nevojshme të shtohet numri i punëtorëve në kantier për të bërë të mundur rritjen e ritmit të punës. Me ritmet aktuale, nuk garantohej përfundimi i punimeve brenda afatit të parashikuar, në rast se nuk merren masa të menjëhershme. Është e nevojshme që të paraqitet një grafik i ripunuar nga ana e Kontraktorit.*

Në muajt Mars – Prill 2025, është cituar nga ana e mbikëqyrësit, njësojë siç është cituar për periudhën Shkurt – Shtator 2024 është cituar se: *Vërehet një ritëm i ulët në zbatimin e punimeve në objekt. Nga ana e Kontraktorit është e nevojshme të shtohet numri i punëtorëve në kantier për të bërë të mundur rritjen e ritmit të punës. Me ritmet aktuale, nuk garantohej përfundimi i punimeve brenda afatit të parashikuar, në rast se nuk merren masa të menjëhershme. Është e nevojshme që të paraqitet një grafik i ripunuar nga ana e Kontraktorit.*

Në raportin e muajit Maj 2025, ose 4.5 muaj nga data e përfundimit të punimeve, nga ana e mbikëqyrësit të punimeve, përveç sa është cituar në muajt e mëparshëm është cituar gjithashtu: *Tashmë, duke pasur parasysh progresin aktual dhe sasinë e mbetur të punimeve për tu realizuar, mund të thuhet me siguri që, punimet nuk mund të përfundojnë brenda afatit të miratuar të Kontratës.*

Në raportin e muajit Qershor 2025, nga ana e mbikëqyrësit është cituar se: *Vërehet ritëm i ulët në zbatimin e punimeve në objekt. Me ritmet aktuale, nuk garantohej përfundimi i punimeve brenda afatit të parashikuar, në rast se nuk merren masa të menjëhershme. Është e nevojshme që të paraqitet një grafik i ripunuar nga ana e Kontraktorit.*

Në raportin e muajit Korrik – Gusht – Shtator 2025, nga ana e mbikëqyrësit është cituar se: *Me ritmet aktuale, nuk garantohej përfundimi i punimeve brenda afatit të parashikuar, në rast se nuk merren masa të menjëhershme. Është e nevojshme që të paraqitet një grafik i ripunuar nga ana e Kontraktorit.*

➤ Në kantier janë zhvilluar takime dhe janë regjistruar ngjarje si më poshtë:

Me e-mail të datës 09.02.2022, nga ana e mbikëqyrësit të punimeve janë njoftuar palët (Autoritet Kontraktor, sipërmarrës) për kryerjen e takimeve javore si dhe temat e diskutimeve.

Data 15.02.2022

Nuk ka një koordinator të sigurisë të caktuar nga ana e Autoritetit Kontraktor. Bazuar në progresin aktual është realizuar 7 % e vlerës totale të punimeve të preventivit të kontratës. Kontraktori është në pritje të aprovimit të preventivit të ripunuar për të dorëzuar situacionin e radhës. Aktualisht janë vërejtur mangësi në plotësimin e kësaj dosjeje. Duhet të përcillen pranë IKTK Njoftimi për fillim punimesh, procesverbali i fillimit të punimeve dhe akt-dorëzimi i objektit pasuri kulturore.

Data 22.02.2022

Nuk ka një koordinator të sigurisë të caktuar nga ana e Autoritetit Kontraktor. Bazuar në progresin aktual është realizuar 7 % e vlerës totale të punimeve të preventivit të kontratës. Kontraktori është në pritje të aprovimit të preventivit të ripunuar për të dorëzuar situacionin e radhës. Aktualisht janë vërejtur mangësi në plotësimin e kësaj dosjeje. Duhet të përcillen pranë IKTK Njoftimi për fillim punimesh, procesverbali i fillimit të punimeve dhe akt-dorëzimi i objektit pasuri kulturore.

Data 15.03.2022

Nuk ka një koordinator të sigurisë të caktuar nga ana e Autoritetit Kontraktor. Bazuar në progresin aktual është realizuar 7 % e vlerës totale të punimeve të preventivit të kontratës. Aktualisht janë vërejtur mangësi në plotësimin e kësaj dosjeje. Duhet të përcillen pranë IKTK Njoftimi për fillim punimesh, Procesverbali i fillimit të punimeve dhe Akt-dorëzimi i objektit pasuri kulturore. Procesverbalet e firmosur nga AK nuk e kanë të përfshirë inxhinierin e trashëgimisë kulturore, të caktuar në vijim të shkresës nr. 3049 prot., datë 10.06.2022 MK, administruar në IKTK me 1032 prot., datë 11.06.2022.

Data 23.03.2022

Nuk ka një koordinator të sigurisë të caktuar nga ana e Autoritetit Kontraktor. Bazuar në progresin aktual është realizuar 7.1 % e vlerës totale të punimeve të preventivit të kontratës. Aktualisht progresi i punimeve është shumë i ulët. Aktualisht janë vërejtur mangësi në plotësimin e kësaj dosjeje. Duhet të përcillen pranë IKTK Njoftimi për fillim punimesh, Procesverbali i fillimit të punimeve dhe Akt-dorëzimi i objektit pasuri kulturore. Procesverbalet e firmosur nga AK nuk e kanë të përfshirë inxhinierin e trashëgimisë kulturore, të caktuar në vijim të shkresës nr. 3049 prot., datë 10.06.2022 MK, administruar në IKTK me 1032 prot., datë 11.06.2022.

Data 12.04.2022

Nuk ka një koordinator të sigurisë të caktuar nga ana e Autoritetit Kontraktor. Raportohet nga Kontraktori se progresi aktual i realizimit është 10 % e vlerës totale të punimeve të preventivit duke përfshirë ndryshimet e propozuara. Aktualisht progresi i punimeve është i ulët. Aktualisht në objekt nuk po punohet. Aktualisht dosja ka mangësi në plotësimin e saj. Nuk janë dorëzuar ende Akt dorëzimi i sheshit të Ndërtimit; Procesverbali i Fillimit të Punës; Njoftimet për fillimin e Punës;

Data 21.05.2022

Nuk ka një koordinator të sigurisë të caktuar nga ana e Autoritetit Kontraktor. Raportohet nga Kontraktori se progresi aktual i realizimit është 13 % e vlerës totale të punimeve të preventivit duke përfshirë ndryshimet e propozuara. Aktualisht progresi i punimeve është i ulët. Aktualisht dosja ka mangësi në plotësimin e saj. Duhet të përcillen pranë IKTK Njoftimi për fillim punimesh, Procesverbali i fillimit të punimeve dhe Akt-dorëzimi i objektit pasuri kulturore. Procesverbalet e firmosur nga AK nuk e kanë të përfshirë inxhinierin e trashëgimisë kulturore, të caktuar në vijim

të shkresës nr. 3049 prot., datë 10.06.2022 MK, administruar në IKTK me 1032 prot., datë 11.06.2022. Vërehet mungesë stafi në kantier. Kontraktori duhet të marrë masa të menjëhershme për prezencën e stafit përgjegjës në kantier.

Data 28.05.2022

Nuk ka një koordinator të sigurisë të caktuar nga ana e Autoritetit Kontraktor. Raportohet nga Kontraktori se progresi aktual i realizimit është 13 % e vlerës totale të punimeve të preventivit duke përfshirë ndryshimet e propozuara. Aktualisht progresi punimeve është i ulët. Aktualisht dosja ka mangësi në plotësimin e saj. Duhet të përcillen pranë IKTK Njoftimi për fillim punimesh, Procesverbali i fillimit të punimeve dhe Akt-dorëzimi i objektit pasuri kulturore. Procesverbalet e firmosur nga AK nuk e kanë të përfshirë inxhinierin e trashëgimisë kulturore, të caktuar në vijim të shkresës nr. 3049 prot., datë 10.06.2022 MK, administruar në IKTK me 1032 prot., datë 11.06.2022. Vërehet mungesë stafi në kantier. Kontraktori duhet të marrë masa të menjëhershme për prezencën e stafit përgjegjës në kantier.

AMENDIMET E KONTRATËS

Kontrata e zbatimit e lidhur sipas aktit nr. 3047 prot., datë 10.06.2021 ka pësuar tre amendime:

- Amendimi nr. 1 mes AK e përfaqësuar nga Titullari dhe BOE 4 & K. & I

Përmes aktit nr. 3047/2 prot., datë 08.07.2021, kontrata është amenduar duke bërë ndryshime për sa i takon likuidimit të kontratës ndër vite. Konkretisht është ndryshuar neni 7, pika 2

nga:

- a. Për Vitin 2021 do të likuidohen situacionet deri në vlerën 447,001,815 lekë;
- b. Për vitin 2022 do të likuidohen situacionet deri në vlerën 200,573,600 lekë;
- c. Për vitin 2023 do të likuidohet shuma e mbetur (413,308,978 lekë) bazuar në situacionet përkatëse.

në:

- a. Për Vitin 2021 do të likuidohen situacionet deri në vlerën 440,386,188 lekë;
- b. Për vitin 2022 do të likuidohen situacionet deri në vlerën 197,605,111 lekë;
- c. Për vitin 2023 do të likuidohen situacionet deri në vlerën 376,839,000 lekë;
- d. Për vitin 2024 do të likuidohen situacionet deri në vlerën 46,054,094 lekë;

- Amendimi nr. 2 mes AK e përfaqësuar nga Titullari dhe BOE 4 & K. & I

• Përmes aktit nr. 6235 prot., datë 07.12.2023, ose 2 vjet e 40 ditë pas datës së nisjes së punimeve, kontrata është amenduar duke bërë tre ndryshimet:

➤ Për sa i takon vlerës së kontratës duke e rritur atë në 1,326,012,495.35 lekë me TVSH, ose me një shtesë prej 25 % të kontratës bazë;

➤ Për sa i takon likuidimit të pjesës së mbetur të vlerës së kontratës prej 1,311,743,583.35 lekë me TVSH ajo është parashikuar të shpërndahet në vitet buxhetore si më poshtë:

- a. Për vitin 2023 do të likuidohen situacionet deri në vlerën 359,392,000 lekë me TVSH;
- b. Për vitin 2024 do të likuidohen situacionet deri në vlerën 650,000,000 lekë me TVSH;
- c. Për vitin 2025 do të likuidohen situacionet deri në vlerën 302,351,583.35 lekë me TVSH;

➤ Afati i ri i përfundimit të punimeve është caktuar data 18.10.2025. Kjo datë është 4 vite (pa 10 ditë) nga data e fillimit të punimeve.

- Amendimi nr. 3 mes AK dhe BOE 4 & K. & I

• Përmes aktit nr. 111/5 prot., datë 17.10.2025, ose gati 4 vite pas datës së nisjes së punimeve, kontrata është amenduar duke bërë ndryshimin si më poshtë:

1. Afati i përfundimi të punimeve për ndërhyrjet ruajtëse, restaurimin, rikonstruksionin dhe rehabilitimin e hapësirave në "Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria Kombëtare e Arteve) është data **18 qusht 2026**.

2. Autoriteti Kontraktor duhet të paraqesë kërkesë për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve sipas kalendarit (grafikut) të ri të punimeve, në zbatim të parashikimeve të ligjit nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij si dhe aplikimin pranë Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale.

Pra, nga sa më sipër afati i përfundimit të punimeve është shtyrë me 8 muaj.

Duke patur në konsideratë faktin se punimet e kontratës kanë nisur në datën 28.10.2021 (referuar shkresave me nr. 5599 prot., datë 28.10.2021 dhe nr. 5599/1 prot., datë 28.10.2021) dhe afati fillestar i kontratës ka qenë 24 muaj, rezulton se data e përfundimit të punimeve sipas kontratës bazë ka qenë data 28.10.2023.

Në fakt, amendimi i kontratës i kryer sipas aktit me nr. 6235 prot., datë 07.12.2023, është bërë 40 ditë pas datës në të cilën punimet e kontratës bazë duhet të kishin përfunduar.

Ecuria e situacioneve pjesore dhe likuidimeve përkatëse

Tabela nr. 2

Situacioni nr.	Vlera ²¹ e situacionit	Vlera e likuiduar	Vlera progresive (lekë)	Fatura	Data e regjistrimi	Data e pagesës
1	14,268,912	14,268,912	14,268,912	779/2021, datë 29.12.2021	19.01.2022	25.01.2022
2	342,408,901	288,659,823	302,928,735	1235/2023, datë 14.12.2023	27.12.2023	29.12.2023
3	13,663,247	13,663,247	316,591,982	1264/23, datë 27.12.2023	29.12.2023	03.01.2024
4	149,895,002	149,520,263	466,112,245	1717/2024, datë 27.12.2024	23.01.2025	27.01.2025
5	78,923,771	78,923,771	545,036,016	891/2025, datë 13.06.2025	12.08.2025	15.08.2025

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kontratën me objekt 'Restaurim, Rikonstruksion dhe rehabilitimi i hapësirave në Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria e Arteve', punimet e ndërtimit kanë nisur në datën 28.10.2021 në një kohë kur leja e ndërtimit i është dhënë zhvilluesit nga ana e KKT sipas aktit me nr. 636/1 prot., datë 08.02.2023 me afat 24 muaj. Sa më sipër është në kundërshtim me parashikimet e bëra në ligjin nr. 107/2014 "Për planifikim dhe zhvillim e territorit", i ndryshuar, neni 39 Leja e ndërtimit, ku përcaktohet se: "1. Leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim, riparim, restaurim apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 41 i këtij ligji."

Përmes amendimit nr. 2 të kontratës së sipërmarrjes me nr. 6235 prot., datë 07.12.2023, është ndryshuar ndër të tjera edhe data e përfundimit të punimeve, duke e shtyrë atë me gati 2 vite²² nga data e nisjes së punimeve, pra deri në datën 18.10.2025. Në nenin 3 të amendimit është parashikuar si më poshtë:

2. 'Afati i përfundimi të punimeve për ndërhyrjet ruajtëse, restaurimin, rikonstruksionin dhe rehabilitimin e hapësirave në "Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria Kombëtare e Arteve) sipas projektit të rishikuar më datë 18 tetor 2025.

3. Autoriteti Kontraktor para përfundimit të afatit të Lejes së Ndërtimit Nr. 5, datë 17.3.2021, sipas Dokumentit të Lejes së Ndërtimit nr. 636/1, datë 08.02.2023 duhet të paraqesë kërkesë për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve sipas kalendarit (grafikut) të ri të punimeve, në zbatim të

²¹ Në vlerën e tabelës së mësipërme është përfshirë edhe vlera e mbajtur e garancisë së punimeve.

²² 1 vit e 11 muaj e 20 ditë.

parashikimeve të ligjit nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij’.

Në fakt, sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se leja e parë ka qenë me afat dy vite dhe kjo leje nuk është rinovuar e për pasojë punimet kanë nisur pa leje.

Nga ana e investitorit (Ministria e Kulturës) dhe e mbikëqyrësit të punimeve e OE A nuk janë marrë masat e nevojshme për hartimin dhe dorëzimin rregullisht nga ana e këtij të fundit, të raporteve mujore për realizimin e zbatimit të grafikut të hollësishëm të punimeve. Deri në hyrjen në fuqi të VKM nr. 610, datë 22.09.2022 *“Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”,* veprimet dhe mosveprimet si më sipër janë në kundërshtim me parashikimet e bëra nga Udhëzimi nr. 3, datë 15.02.2001 *“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”,* i ndryshuar, pika 13 ku përcaktohet se: *“13. Mbikëqyrësi i punimeve kontrollon zbatimin e grafikut të hollësishëm të punimeve dhe i raporton çdo muaj investitorit për realizimin e tij. ... ”.* Gjithashtu, sa më sipër është në kundërshtim edhe me kontratën e shërbimit të lidhur sipas aktit me nr. 3306/14 prot., datë 22.07.2021 si dhe me Urdhrin e Ministrit të Kulturës me nr. 727, datë 10.11.2021, me nr. 5825 prot., datë 10.11.2021. Me hyrjen në fuqi të VKM nr. 610/2022 të cituar më sipër, veprimet dhe mosveprimet si më sipër janë në kundërshtim me parashikimet e bëra në nenin 7 ku përcaktohet se: *“Mbikëqyrësi i punimeve në bashkëpunim me zbatuesin e punimeve programon punimet që do të kryhen në objekt nëpërmjet një plani të shprehur në grafik për çdo muaj. Ai mbikëqyr grafikun e punimeve, kontrollon librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumentacionit që mbahet në objekt”,* nenin 8 ku përcaktohet se: *“1. Mbikëqyrësi ka detyrimin të raportojë te zhvilluesi, çdo 45 (dyzet e pesë) ditë për kryerjen e punimeve, sipas fazave të akteve të kontrollit, në përputhje me nenin 42, të këtij vendimi.”,* nenin 18 ku përcaktohet se: *1. Mbikëqyrësi i punimeve kontrollon zbatimin e grafikut të punimeve dhe i raporton çdo 45 (dyzet e pesë) ditë zhvilluesit për realizimin e tij, Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit/Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, si dhe autoritetit që lëshon lejen e ndërtimit. 2. Nëse ai konstaton vonesa në zbatimin e punimeve, njofton zhvilluesin për vonesat në kryerjen e punimeve të shoqëruar me arsyen e këtyre vonesave, edhe në intervalin midis dy raportimeve periodike.”* si dhe me kontratën e shërbimit të lidhur sipas aktit me nr. 3306/14 prot., datë 22.07.2021.

Pjesë e raportit për muajin Tetor 2023 janë edhe materialet fotografike sipas të cilave rezulton se gjatë muajit këtij muaji kanë qenë të realizuara të paktën zërat si më poshtë:

- Shtresa me beton të varfër e objektit të ri;
- Hidroizolimi dhe hekuri i pllakës së themelit;
- Betonimi i pllakës dhe lidhje e hekurit të kolonave të podrumit;
- Lidhja e hekurave të soletës e kuotës 0.00;
- Lidhja e hekurit të soletës të katit të parë;

Të dhënat e mësipërme dëshmojnë për faktin se punimet janë realizuar në fakt ende pa marrë miratimin e tyre nga ana e KKTKM. Gjithashtu, rezulton se edhe rishikimi i projekt – preventivit të punimeve dhe miratimi i tyre nga ana e grupit të ekspertëve të kërkuar përmes shkresës së Sekretarit të Përgjithshëm me nr. nr. 6579/2 prot., datë 02.03.2023 është kryer pas realizimit në fakt këtij punimeve, pjesë e këtij preventivi të dërguar për rishikim. Veprimet si më sipër janë në kundërshtim me parashikimet e bëra në VKM nr. 1125, datë 30.12.2020 *“Për miratimin e rregullave të projektimit, zbatimit të punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të tyre”, Kapitulli IV, ku përcaktohet se:*

18. Zbatuesi i punimeve nuk mund të ndryshojë më nismën e vet projektin ose përshkrimet teknike të tij.

19. Zbatuesi i punimeve i paraqet zhvilluesit kërkesë propozimet për korrigjime, plotësime apo situata të paparashikuara gjatë zbatimit të ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale. Zhvilluesi i kërkon mbikëqyrësit dhe projektuesit vlerësimin dhe miratimin e këtyre kërkesë propozimeve, brenda një afati të caktuar nga palët. Në rastet kur kërkesë propozimet ndikojnë në ndryshimin e projektit fillestar, ato paraqiten për shqyrtim në KKTKM dhe, pas miratimit me vendim, vijohet me realizimin e ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse. Vendimi i KKTKM-së për ndryshimet e projektit fillestar është i detyrueshëm për zbatim.”.

Nisur nga korrespondencat si më sipër rezulton se amendimi i afatit të përfundimit të punimeve në vetvete është mbështetur tek argumente jo reale. Konkretnisht, në pikat 5 dhe 6 të modifikimit të kontratës është cituar se:

“Duke qenë se ekzistojnë këto kushte paraprake:

5. Me shkresën nr. 636/4 prot., datë 28.9.2023, protokolluar në Ministrinë e Kulturës me nr.5032 prot., datë 02.10.2023 është njoftuar Dokumenti i Lejes së Ndërtimit nr.636/1, datë 08.02.2023, me afat 24 muaj;

6. Me Vendimin nr. 513, nr. 1280 prot., datë 6.10.2023 Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale ka miratuar ‘Rishikimin pjesor të projektit "Restaurim, Rikonstruksion dhe Rehabilitim i hapësirave në “Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria Kombëtare e Arteve)’, Monument Kulture i kategorisë së II-të, miratuar me Vendimin nr. 542, datë 29.12.2020 të KKTKM-së, me aplikues shoqëria A ShPK dhe zhvillues Ministria e Kulturës”.

Fakt është se punimet kanë nisur ende pa marrë lejen e ndërtimit dhe gjithashtu për projekt – preventivin e ripunuar është nisur implementimi i tij nga sipërmarrësi ende pa u bërë miratimi i tij nga autoriteti Kontraktor dhe KKTKM. Referuar kapaciteteve teknike të sipërmarrësit të punimeve, normativave orare të zërave të punimeve të realizuara si dhe imazheve të gjeneruara nga ana e Web rezulton se në gjatë vitit 2022 situata e punimeve në kantier ka qenë si më poshtë:



Foto nr. 1: Situata Nëntor 2021, një muaj pas datës së fillimit të punimeve

Burimi: Google Earth Pro



Foto nr. 2: Situata Mars 2022, katër muaj pas datës së fillimit të punimeve

Burimi: Google Earth Pro




Foto nr. 3: Situata Tetor 2022, njëmbëdhjetë muaj pas datës së fillimit të punimeve

Burimi: Google Earth Pro



Foto nr. 4: Situata Qershor 2023, nëntëmbëdhjetë muaj pas datës së fillimit të punimeve

Burimi: Google Earth Pro

Në mungesë të raportimeve, nga ana e Grupit të Auditimit u gjeneruan të dhënat si më sipër nga ku rezulton se gjatës kohës së pezullimit të punimeve 19.10.2022 – 13.10.2023, nga ana e sipërmarrësit është vijuar me zbatimin e tyre. Për rrjedhojë, nga palët është vepruar në kundërshtim me kuadrin ligjor që rregullon dhe disiplinon marrëdhënien Autoritet Kontraktor – Mbikëqyrës – Sipërmarrës.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se, të paktën nga ato raporte të administruara nga ana e Grupit të Auditimit, nga ana e mbikëqyrësit të punimeve për 15 muaj është konstatuar një ritëm i ulët i zbatimit të punimeve, është parë domosdoshmëria e rritjes së numrit të punëtorëve pasi me ritmin aktual nuk mund të arrihej afati i kontratës dhe gjithashtu është përmendur në vazhdimësi nevojja për rishikimin e grafikut të punimeve. Në lidhje me këto raporte rezulton të jenë vënë në dijeni ndjekësit e kontratës dhe autoriteti kontraktor MK / MEKI / MKTS dhe pavarësisht kësaj, në dispozicion të grupit të auditimit nuk rezulton asnjë vendimmarrje në lidhje me marrjen e masave për përmirësimin e gjendjes. Në asnjë prej amendamenteve të kryera, nuk janë marrë në konsideratë vonesat e vet kontraktorit të punimeve për shkak të numrit të vogël të punëtorëve të vendosur në dispozicion dhe ritmit të ulët të tyre por janë referuar në relacione / kontrata vetëm ato argumente të cilat supozohet të kenë patur si burim mungesën e veprimeve në kohë të Autoritetit Kontraktor, në një kohë kur, shkak për vonesat ka qenë edhe vet mungesa e ofrimit të kapaciteteve të nevojshme nga vet kontraktori i punimeve. Pavarësisht njoftimit të herëpashershëm të mbikëqyrësit për rishikimin e grafikut të punimeve, kjo nuk ka ndodhur dhe për pasojë amendimet e kontratave nuk mund të konsiderohen si të argumentuara dhe justifikuara në nivel teknik. Autoriteti Kontraktor nuk ka marrë masat e nevojshme për evidentimin e faktit se punimet kanë vijuar gjatë kohës së pezullimit të punimeve për ta reflektuar më pas këtë fakt edhe në amendimin e kryer dhe njëkohësisht nuk ka trajtuar në amendament shkaqet e ardhura prej vet kontraktorit. Veprimet si më sipër janë në kundërshtim me parashikimet e bëra në:

- Ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Kreu II *Përgjegjshmëria Menaxheriale*, neni 8, ku përcaktohet se: “1. Titullarët e njërive publike, të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të

objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe eficiencë. 8. Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore: a) hartimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ata drejtojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan- veprimeve për arritjen e objektivave; c) miratimin e sistemeve të menaxhimit të informacionit; ç) miratimin e sistemit të rregullave e të procedurave për ruajtjen, mbrojtjen e nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike, sipas udhëzimeve të nxjerra nga Ministri i Financave; d) miratimin e një strukture të përshtatshme organizative dhe vendosjen e linjave të raportimit, që mundësojnë kryerjen efektive të përgjegjësive të tyre; dh) rregullimin e funksionit të auditimit të brendshëm dhe garantimin e pavarësisë funksionale të tij; e) futjen e procedurave antikorupsion, bazuar në legjislacionin në fuqi; ë) sigurimin, nëpërmjet akteve të brendshme administrative, të zbatimit të rregullave për kontrollin e brendshëm.”

- Ligjin nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore”, neni 3 Parimet e trashëgimisë kulturore, pika 2, germa b, ku përcaktohet se:

“Zbatimi i këtij ligji bazohet në krijimin e kushteve për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, të politikave të qëndrueshme të zhvillimit të saj dhe sigurimin e qasjeve të barabarta të qytetarët për vlerat kulturore, duke respektuar parimet e mëposhtme:

b) Transparencë në menaxhimin e aktiviteteve për ruajtjen e trashëgimisë kulturore;

neni 4 Pasuritë kulturore, pika 2 ku përcaktohet se:

“2. Vlerat kulturore janë “pasuri publike” dhe gëzojnë mbrojtje nga strukturat e qeverisjes qendrore e vendore në interesin më të mirë të qytetarëve të Republikës së Shqipërisë.”

Neni 11 Funksioni i institucioneve publike ku përcaktohet se:

“1. Shteti siguron ruajtjen, mbrojtjen, vlerësimin dhe administrimin e trashëgimisë kulturore, në zbatim të dispozitave të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi.

2. Autoritetet shtetërore qendrore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore bashkërendojnë punën, koordinojnë, harmonizojnë dhe integrojnë aktivitetet, me qëllim sigurimin e ruajtjes, mbrojtjes, vlerësimit dhe administrimit të trashëgimisë kulturore, si dhe krijojnë kushtet për aksesimin e tyre nga publiku.”

Neni 12 Funksionet e ministrisë përgjegjëse për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, ku përcaktohet se:

“1. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore ushtron funksionet e ruajtjes, mbrojtjes, vlerësimit dhe administrimit të pasurive kulturore në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi.”

Neni 13 Kompetencat e ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, ku përcaktohet se:

Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore:

k) Ka përgjegjësinë e administrimit të pronave publike me vlera kulturore;

Neni 48 Lejet zhvillimore në zonat e rëndësisë kombëtare të trashëgimisë, ku përcaktohet se:

“1. Projektet për leje zhvillimore dhe kërkesa për ndërhyrje në zonat e rëndësisë kombëtare të trashëgimisë kulturore miratohen dhe zbatohen në përputhje me dispozitat e ligjit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe këtij ligji.

2. Lejet zhvillimore, të rikonstruksionit të ndërtesave dhe ato të infrastrukturës në qendrat historike, zonat arkeologjike A, B, duhet të miratohen fillimisht në KKTKM dhe më pas, sipas legjislacionit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit.”

Neni 72 Projektimi, zbatimi, mbikëqyrja, kolaudimi i ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse ku përcaktohet se:

“1. Projektimi, zbatimi, mbikëqyrja dhe kolaudimi i ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse të pasurive kulturore materiale kryhet nga subjektet e licencuara për këtë qëllim ose institucionet shtetërore të specializuara dhe të ngarkuara me ligj për mbrojtjen, ruajtjen dhe studimin e pasurive të trashëgimisë kulturore.

2. Zbatimi i punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse të pasurive kulturore, mbikëqyrja dhe kolaudimi i tyre u nënshtrohen vetëm parashikimeve të këtij ligji dhe për aq sa është e mundur, legjislacionit për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit.

3. Projektimi, zbatimi i punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse dhe mbrojtëse, mbikëqyrja dhe kolaudimi i tyre rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Neni 79 Leja për ndërhyrjet në pasuritë kulturore, ku përcaktohet se:

“1. Leja për ndërhyrje është e nevojshme për çdo ndërhyrje të parashikuar nga neni 77 i këtij ligji.

2. Dokumenti i lejes për ndërhyrje përshkruan të gjitha kushtet për kryerjen e punimeve në pasuritë kulturore, në përputhje me dokumentacionin shoqërues të kërkesës, projektit e preventivit, si dhe të normave e standardeve të përcaktuara në këtë ligj.

4. Përfituesi i lejes për ndërhyrje, pronari i pasurisë kulturore, zbatuesi dhe mbikëqyrësi i punimeve janë përgjegjës solidarë, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe dispozitave ligjore që rregullojnë veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë.”.

Përmes amendimit nr. 2 të kontratës së sipërmarrjes me nr. 6235 prot., datë 07.12.2023, është ndryshuar ndër të tjera edhe data e përfundimit të punimeve, duke e shtyrë atë me gati 2 vite²³ nga data e nisjes së punimeve, pra deri në datën 18.10.2025. Nga ana e AK, në amendimin e kontratës, një ndryshim i tillë është bazuar në argumentet si më poshtë:

“Duke qenë se ekzistojnë këto kushte paraprake:

2. Mbikëqyrësi i punimeve për objektin "Restaurim, rikonstrukcion hapësirave në Muzeun dhe rehabilitim "A" shpk me Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria e Arteve)", subjekti shkresën nr. 4380 prot., datë 27.09.2022, protokolluar në Ministrinë e Kulturës me nr. 5252 prot., datë 27.9.2022, ka paraqitur propozimin për miratim të preventivit të ripunuar, përfshirë punime shtesë dhe shtesë afati në realizimin e punimeve në këtë objekt;

3. Vendimi nr. 1125, datë 30.12.2020, i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të projektimit, zbatimit të punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse dhe mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të tyre”, Kreu IV “Zbatimi i punimeve për ndërhyrjet ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale”, pikat 19 dhe 20, parashikon se:

19. Zbatuesi i punimeve i paraqet zhvilluesit kërkesë propozimet për korrigjime, plotësime apo situata të paparashikuara gjatë zbatimit të ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale. Zhvilluesi i kërkon mbikëqyrësit dhe projektuesit vlerësimin dhe miratimin e këtyre kërkesë propozimeve, brenda një afati të caktuar nga palët. Në rastet kur kërkesë propozimet ndikojnë në ndryshimin e projektit fillestar, ato paraqiten për shqyrtim në KKTKM dhe, pas miratimit me vendim, vijohet me realizimin e ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse. Vendimi i KKTKM-së për ndryshimet e projektit fillestar është i detyrueshëm për zbatim.

20. Në rastet kur gjatë zbatimit të punimeve ruajtëse e mbrojtëse të pasurisë kulturore materiale paraqiten të nevojshme ndërhyrje të paparashikuara në kontratë, mbikëqyrësi i punimeve, pas miratimit të projektuesit, i paraqet zhvilluesit propozimet për ndërhyrjet e paparashikuara. Pas konfirmimit nga zhvilluesi, këto propozime paraqiten për miratim edhe në KKTKM.

²³ 1 vit e 11 muaj e 20 ditë.

4. Me vendimin nr. 05, datë 17.3.2021, të Këshilli Kombëtar të Territorit, “Për miratimin e lejes së ndërtimit për objektin “Restaurimi, rikonstruksioni, ekzistues dhe rehabilitimi shtesë anësore të ekzistues dhe rehabilitimi i hapësirave, në Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura”, me vendndodhje në Bashkinë e Tiranës”, është miratuar Leja e Ndërtimit.

5. Me shkresën nr. 636/4 prot., datë 28.9.2023, protokolluar në Ministrinë e Kulturës me nr. 5032 prot., datë 02.10.2023 është njoftuar Dokumenti i Lejes së Ndërtimit nr. 636/1, datë 08.02.2023, me afat 24 muaj;

6. Me Vendimin nr. 513, nr. 1280 prot., datë 06.10.2023 Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale ka miratuar “Rishikimin pjesor të projektit “Restaurim, Rikonstruksion dhe Rehabilitim i hapësirave në “Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria Kombëtare e Arteve)”, Monument Kulture i kategorisë së II-të, miratuar me Vendimin nr. 542, datë 29.12.2020 të KKTKM-së, me aplikues shoqëria “A” shpk dhe zhvillues Ministria e Kulturës.”

Në fakt, siç u shpjegua dhe më sipër:

1. Kontraktori ka vijuar me punimet pavarësisht faktit se projekti ka qenë në proces miratimi nga ana e AK, grupit të ekspertëve apo oponenca teknike;

2. Nuk rezulton që punimet të kenë qenë të pezulluara për periudhën e deklaruar 19.10.2022 – 13.10.2023;

3. Kontraktori ka vijuar me punimet pjesë e projektit të rishikuar pavarësisht faktit se këto punimeve dhe ky projekt nuk ka qenë akoma i miratuar nga ana e KKTKM;

4. Kontraktori ka nisur punimet në datën 28.10.2021 pavarësisht faktit se në këtë kohë ende nuk ishte zbardhur leja e ndërtimit.

Deri në momentin e miratimit të amendamentit të dytë të kontratës, OE ka pasur një ecuri shumë të ngadaltë dhe ritëm shumë të ulët pune, fakt ky që konfirmohet si nga vlera progresive e punës së kryer, si nga punimet e certifikuara ashtu edhe nga raportet mujore të mbikëqyrësit të punimeve. Sipas këtyre të fundit, gjatë gjithë kohës, **ecuria e punimeve ka qenë nën nivelin e parashikuar në grafikon e punimeve.**

Mbështetur në faktet si më sipër rezulton se ndaj kontraktorit të punimeve nuk janë marrë masat e nevojshme për ushtrimin e të drejtave dhe detyrave, në drejtim të përlllogaritjes së penaliteteve për çdo ditë vonesë përtej afatit të parashikuar në kontratë. Mbështetur në sa më sipër si dhe referuar raportimeve të bëra nga ana e mbikëqyrësit të punimeve, sipas të cilave data e fillimit të punimeve ka qenë data 28.10.2021, rezulton se vlera e pa aplikuar e penalitetit deri në datën e amendimit të kontratës (07.12.2023) është në masën prej **32,325,691 lekë** [$1/1000 \times (905,840,942.47 \text{ lekë}^{24} - 97,698,660 \text{ lekë}^{25}) \times 40 \text{ ditë}$]. Kjo shumë, duhet të ishte llogaritur si zbritje në situacionin e parë pasardhës të likuiduar ndaj kontraktorit të punimeve, kjo në zbatim të Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II Zbatimi i punimeve të ndërtimit, pika 8.2 ku përcaktohet se:

“8.2 Situacionet financohen nga investitori sipas kushteve që parashikohen në kontratë (sigurimi i kantierit, garancia e kontratës dhe e punimeve, paradhënia, periodiciteti, afatet e pagesës, **ndalesat për vonesat**, defektet e pakorrigjuara, gjobat), pasi kontrollohen e pranohen paraprakisht nga mbikëqyrësi i punimeve.”.

²⁴ Vlera e kontratës pa TVSH përpara amendimit të bërë në datën 07.12.2023.

²⁵ Vlera korresponduese e zbatuar, nga çmimi total i kontratës bazë. Vlera si më sipër është korrigjuar pas saktësimeve të observacioneve të sjella.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se nga ana e kontraktorit të punimeve, sipas shkresës me nr. 660 prot., datë 11.09.2025, administruar në MEKI me nr. 5873/4 prot., datë 11.09.2025 janë renditur si arsye të shtyrjes së afatit të punimeve ato si më poshtë:

- *Oponenca teknike e hartuar nga ana e UPT, ardhur në MK përmes shkresës me nr. 6270/1 prot., datë 18.11.2022 dhe në UPT me nr. 2378/5 prot., datë 17.11.2022 për projektin e zbatimit të objektit “Restaurimi, rikonstrukcion dhe rehabilitim i hapësirave në Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria e Arteve), Tiranë” i është përcjellë kontraktorit të punimeve përmes shkresës me nr. 11300/1 prot., datë 07.10.2024;*

- *Relacioni i hartuar nga ana e grupit të punës i ngritur për të ndihmuar dhe ndjekur zbatimin e procesit të muzealizimit i është përcjellë mbikëqyrësit dhe sipërmarrësit të punimeve, sipas shkresës me nr. 5873/3 prot., datë 02.09.2025.*

Nga analiza e dokumentacionit të vënë në dispozicion, arrihet në konkluzionin se:

- Nuk justifikohet dorëzimi tek kontraktori i punimeve i raportit të oponencës teknike me një vonesë prej gati 2 vitesh;

- Nuk justifikohet dhe nuk argumentohet në nivel teknik impakti i dorëzimit me vonesë të oponencës teknike tek kontraktori.

Në shtator 2025, OE ka cituar ndër të tjera si argument për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve, edhe dorëzimin në tetorin e vitit të mëparshëm (2024) të raportit të oponencës teknike. Një diferencë e tillë e shtrirë në kohë nuk justifikon dhe as nuk ka një lidhje të drejtë shkak-pasojë për vet faktin se në tetorin e vitit 2024, referuar të dhënave të marra nga raportet mujore të mbikëqyrësit të punimeve dhe pagesave të kryera ndaj kontraktorit deri në këtë periudhë, kontraktori ka qenë me një ritëm shumë të ulët punimesh dhe nuk dokumentohet pasoja në drejtim të vonesës së shkaktuar kontraktorit. Shënimi i oponencës teknike ka cituar si më poshtë:

“... i rekomandojmë Porositësit të kësaj Oponencë që të vlerësojë dhe rishikojë fasadën e objektit të ri që i shtohet volumit të MKAB, duke parashikuar një fasadë më uniforme dhe me ngjyrë më të qetë si dy objektet e reja në krah. Mendojmë që në këtë mënyrë, do të evidentohet më mirë objekti ekzistues dhe kështu objektet e frontit të dytë, vizualisht do të kthehen në një sfond të qetë në respekt të Ansambllit Arkitektonik të Godinave përgjatë Bulevardit.”

Sipas raporteve të mbikëqyrjes së punimeve nuk është deklaruar asnjë pretendim i kontraktorit në lidhje me këtë situatë. Referuar raportit të muajit mars 2025 citohet se: *AK i ka kërkuar Kontraktorit me shkresë zyrtare, marrjen në konsideratë të disa rekomandimeve të oponencës teknike, në lidhje me projekti. Propozimi i Kontraktorit pritet të paraqitet. Në muajt prill, maj, qershor, etj. 2025 është cituar se: “Kontraktori ka dhënë informacion për kontakte me kompani të cilat mund të ofrojnë materiale për realizimin e fasadës tek objekti i ri. Por deri në këtë moment nuk është paraqitur nga ana e kontraktorit, një propozim për këtë detaj”.*

Për sa i takon argumentit tjetër, në lidhje me projektin e linjës muzeale, në gjykim të grupit të auditimit ky pretendim i përmendur për të argumentuar zgjatjen e afatit nuk dokumentohet përmes grafikëve të rishikuar të punimeve, kjo me qëllim identifikimin e pasojës reale që kanë patur këto vonesa në realizimin e kontratës. Në tërësi, në lidhje me këtë kontratë, veprimet dhe mosveprimet kanë bërë që kontrata të tejkalojë me më shumë se 2 vite afatin fillestar të kontratës. Deri aktualisht, me amendamentin e fundi të kryer përmes aktit me nr. 111/5 prot., datë 17.10.2025 punimet kanë një afat të rishikuar kontrate prej 4 gati vite e 10 muaj, nga 2 vite që ishte parashikuar paraprakisht, afat ky i cili ka tejkaluar edhe grafikun e shpërndarjes së likuidimeve në vitet buxhetore. Vonesat e shkaktuara si rrjedhojë e zgjatjes së afatit të punimeve, kanë ndikuar drejt për drejt edhe në mos vënien në shfrytëzim të galerisë, përmes të cilës janë parashikuar të gjenerohen të ardhura të

konsiderueshme për buxhetin e shtetit (sipas projeksioneve jenë parashikuar nga 12,000,000 lekë për vitin 2026 deri në 56,000,000 lekë për vitin 2028).

Për sa më sipër, është mbajtur Akt Konstatimi nr. 12, datë 02.02.2026 dhe nga ana e ish Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë znj. Z. B, përmes postës elektronike të datës 19.03.2026 janë paraqitur observacionet si më poshtë trajtuar.

Pretendimi i subjektit:

“ ... lidhur me shtyrjen e afatit me 2 vite kur kërkesa ka qenë për 8 muaj sqaroj se kërkesa për shtyrjen e afatit të punimeve për 8 muaj i referohet kërkesës së përcjellë nga mbikëqyrësi i punimeve, subjekti A nëpërmjet shkresës nr. 4380 dt.27.09.2022, kur kontraktori ka qenë në vitin e parë të punimeve. Ndërsa në shtator të vitit 2023, për shkak se punimet kanë qenë të pezulluara për një periudhë kohe prej më shumë se 11 muaj, ashtu si e konstatoi edhe ju në projekt-raport, kur ai ka aplikuar për miratimin e projektit pranë KKTKM-së, ka argumentuar dhe paraqitur, pas miratimit të mbikëqyrësit, kërkesën me një grafik të ri punimesh prej 24 muaj bazuar edhe në ligjin nr. 27/2018 “Për trashëgiminë Kulturorë dhe Muzetë” pika 7, nenit 79, citojmë” Shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve bëhet vetëm një herë për një periudhë jo më të gjatë se afati fillestar i përcaktuar në lejen e ndërhyrjes, mbi bazën e një kërkesë të dorëzuar brenda afatit të vlefshmërisë së lejes dhe në çdo rast jo më vonë se 45 ditë përpara përfundimit të afatit të lejes”. Ndërsa, me Vendimin nr. 513, prot., datë 06.10.2023 KKTKM, ka miratuar “Rishikimin pjesor të projektit “Restaurim, Rikonstruksion dhe Rehabilitim i hapësirave në “Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria Kombëtarë e Arteve)”, Monument Kulture i kategorisë së II-të, miratuar më Vendimin nr. 542, datë 29.12.2020 të KKTKM-së, më aplikues shoqëria A me zhvillues Ministria e Kulturës, është miratuar grafiku i rishikuar i punimeve me afat 24 muaj. Për sa më sipër sqaroj se pretendimi i ngritur mbi mos argumentimin e afatit të grafikut të punimeve nuk qëndron, pasi çdo argument në lidhje me grafikun e punimeve për zbatimin e projektit të rishikuar është ezauruar në vlerësimin e Këshillit Teknik pranë KKTKM-së dhe gjatë mbledhjes së KKTKM, të specializuar për shqyrtimin e punimeve në objekte të trashëgimisë kulturore.

- Bazuar në grafikun e miratuar të punimeve, pjesë integrale e Vendimi Nr. 513 datë 06.10.2023 i KKTKM-së, Grupi i Punës, i ngritur më Urdhrin e Sekretarit të Përgjithshëm nr. 768, datë 24/11/2023, “Ngritjen e Grupit Të Punës Për Shqyrtimin e Dokumentacionit dhe Hartimin e Amendamentit për Modifikimin e Kontratës nr. 3047 prot, datë 10.6.2021, Më Objekt “Restaurim, Rikonstruksion dhe Rehabilitim i Hapësirave Në Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria e Arteve)”, të ndryshuar, ka shqyrtuar dokumentacionin e listuar në Relacionin nr. 6047/1 datë 14.12.2023 si dhe ka mbajtur në konsideratë periudhën nga Vendimi nr. 513 datë 6.10.2023 i KKTKM-së deri në përfundimin e procedurës administrative të brendshme për nënshkrimin e kontratës duke amenduar afatin e punimeve jo me 24 muaj sipas grafikut të punimeve të miratuar por deri më datë 18.10.2025.”.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Pretendimet si më sipër nuk merren në konsideratë nga ana e Grupit të Auditimit pasi ato nuk sjellin fakte shtesë dhe nuk i përmbahen akt konstatimit në tërësi, me të gjitha gjetjet e evidentuara por citojnë vetëm një pjesë të tij. Rikujtojmë se shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve është bërë duke cituar si argument edhe vonesën prej gati 12 muaj prej pezullimit të punimeve, kur në fakt Grupi i Auditimit ka provuar se ky pezullim ka qenë vetëm shkresor dhe jo real pasi punimet në terren kanë vijuar. Nga ana Juaj është miratuar një shtyrje afati e bërë për 8 muaj, shumë kohë pas kërkesës së kontraktorit dhe duke u mbështetur në argumente që nuk qëndrojnë. Për sa për sipër pretendimet nuk merren në konsideratë.

Pretendimi i subjektit:

“ ... lidhur me mos dorëzimin e raporteve mujore nga ana e mbikëqyrësit të punimeve sqarojë se nga momenti që unë kam marrë detyrën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës, në zbatim të Vendimit nr. 610, datë 22.9.2022, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve” dhe kushteve të kontratës, mbikëqyrësi ka bërë raportimin periodik mbi zbatimin e kontratës në këtë objekt, kjo provohet dhe pranohet dhe nga vetë audituesi (faqe 193 - 194), i cili ka konstatuar se raportimi ka qenë periodik gjatë periudhës kohore që unë kam ushtruar këtë detyrë, Tetor 2023 - Maj 2024, duke mbajtur në konsideratë se punimet kanë qenë të pezulluara në periudhën Tetor 2022 – Tetor 2023. Ndërsa, në periudhën maj – shtator 2022, AK ka patur një korrespondencë në vijim me Mbikëqyrësin në lidhje me kërkesën e bërë nga zbatuesi dhe miratuar nga mbikëqyrësi në lidhje me rishikimin e preventivit të punimeve (siç reflektohet edhe në korrespondencat e listuara nga ana juaj në faqen 187). Për rrjedhojë, për periudhën pas rifillimit të punimeve, mbikëqyrësi ka zbatuar detyrimin e raportimit pranë AK-së sipas përcaktimeve të VKM nr. 610, datë 22.09.2022, neni 8 që përcakton se: “Mbikëqyrësi ka detyrimin të raportojë të zhvilluesi, çdo 45 (dyzet e pese) ditë për kryerjen e punimeve, sipas fazave të akteve të kontrollit, në përputhje me nenin 42, të këtij vendimi.”

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Pretendimet si më sipër nuk merren në konsideratë nga ana e Grupit të Auditimit pasi ato nuk sjellin fakte shtesë dhe nuk i përmbahen drejtë konstatimeve të bëra. Sqarojmë se, periudha kohore gjatë të cilave ka munguar raportimi nga ana e mbikëqyrësit të punimeve ka qenë Tetor 2021 – Janar 2022, Qershor 2022 – Shtator 2022. Duke qenë se detyrën keni e keni ushtruar në periudhën 10.6.2022 deri në datë 14.5.2024, rezulton se gjatë kësaj kohe nuk janë marrë masat për dorëzimin rregullisht të raportimeve mujore nga ana e mbikëqyrësit. Për sa për sipër pretendimet nuk merren në konsideratë.

Pretendimi i subjektit:

“ ... lidhur me mos marrjen e masave të nevojshme për hartimin dhe dorëzimin nga OE A, të raporteve mujore në përputhje me situatën faktike” sqaroj si vijon. Referuar Ligjit Nr. 8402, datë 10.9.1998, i ndryshuar, Neni 7/1, pika 1, VKM nr. 610/2022, Udhëzimit nr. 3, datë 15.2.2001, të Këshillit të Ministrave Kreu I, kreu II, Udhëzimit nr. 5, datë 13.05.2005 Kreu I, pika 3.3 dhe vijimi i parashikimeve të këtij udhëzimi, përcakton se nga momenti i hartimit të procesverbalit dhe firmosjes së tij nga palët, përgjegjësia e kantierit dhe e gjithë veprimtarisë brenda në të është e sipërmarrësit (zbatuesit të punimeve). Për rrjedhojë AK, nuk ka asnjë të drejtë të hyjë në kantier. Për sa më sipër, AK për ndjekjen e ecurisë së zbatimit të kontratës bazohet në raportimin e mbikëqyrësit i ngarkuar ky i fundit ligjërisht për mbikëqyrjen e punimeve në kantier për llogari të AK-së. Gjithashtu, titullari i AK-së, bazuar në legjislacionin përkatës, ngarkon personin përgjegjës brenda institucionit për ndjekjen dhe raportimin e zbatimit të kontratës. Detyrat e Sekretarit të Përgjithshëm janë detyra administrative të cilat lidhen me menaxhimin dhe administrimin e dokumentacionit dhe burimeve të angazhuara dhe jo me verifikimin fizik të kantierit të ndërtimit, funksion i cili ezaurohet nga hallkat e sipër cituara. Gjithashtu, sqaroj dhe theksoj, se referuar konstatimit të kryerjes së punimeve gjatë periudhës së pezullimit të tyre dhe përpara amendimit të kontratës, nuk është administruar nga AK-ja asnjë akt konstatimi ose

dokument zyrtar nga mbikëqyrësi i punimeve ose ndjekësi i kontratës, i cili të dokumentojë kryerjen e punimeve gjatë periudhës së pezullimit.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Pretendimet si më sipër nuk merren në konsideratë nga ana e Grupit të Auditimit pasi ato nuk sjellin fakte shtesë nga ato të konstatuara gjatë fazës së auditimit në terren. Sqarojmë se përgjegjësia për sa përshkruani nuk është vetëm e mbikëqyrësit por edhe e zhvilluesit, kjo në referencë të Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për disiplinimin e punimeve të ndërtimit*”, i ndryshuar, neni 14/3 *Përgjegjësia e zhvilluesit*, pika 1 dhe 2 ku përcaktohet se:

“1. Zhvilluesi është solidarisht përgjegjës me projektuesin, zbatuesin, mbikëqyrësin dhe kolaudatorin e punimeve të ndërtimit për projektimin dhe kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, me dokumentet e planifikimit e kontrollit të zhvillimit dhe me legjislacionin në fuqi që rregullon veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, përfshirë dispozitat antisizmike, të sigurisë, të mbrojtjes nga zjarri, higjieno-sanitare, si dhe eficiencën energjetike.

2. Zhvilluesi është i detyruar të njoftojë menjëherë Inspektoratin Vendor të Mbrojtjes së Territorit ose, sipas rastit, Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, në rastet kur kryhen punime në kundërshtim me lejen e ndërtimit, me dokumentet e planifikimit e kontrollit të zhvillimit dhe me legjislacionin në fuqi që rregullon veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë.”

Pretendimi i subjektit:

“ ... lidhur me konstatimin nr.13.2 (faqe 204), ku evidentohet se nga mbikëqyrësi është raportuar për një ritëm të ulët të punës nga ana e kontraktorit dhe nr. 14 në faqen 207 ku citohet se “Deri në momentin e miratimit të amendimit të dytë të kontratës, OE ka pasur një ecuri shumë të ngadaltë dhe ritëm shumë të ulët pune...” shpjegoj se kjo situatë e konstatuar i referohet periudhës pas amendimit nr. 2 të kontratës të kryer më datë 7.12.2023, pasi përpara kësaj periudhe, për shkak të pezullimit të punimeve, nuk ka patur raporte të përcjella nga mbikëqyrësi i punimeve (edhe sipas tabelës përmbledhëse në faqet 13-15 të Akt - Konstatimit) dhe gjithashtu referuar citimit të projektraportit tuaj në faqen 195, “Në muajin Shkurt 2024, është cituar nga ana e mbikëqyrësit....” dhe “Në muajt Mars-Prill-Maj-Qershor-Korrik-Gusht-Shtator 2024”. Fakt, i cili, tregon se kjo rrethanë nuk ka ekzistuar përpara amendimit nr.2 dhe si rrjedhojë as nuk mund të trajtohej në momentin e nënshkrimit nga ana ime, në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, të amendimit nr.2 më datë 7/12/2023.”

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Pretendimet si më sipër nuk merren në konsideratë nga ana e Grupit të Auditimit pasi ato nuk sjellin fakte shtesë nga ato të konstatuara gjatë fazës së auditimit në terren. Sqarojmë se amendimi i kontratës nuk është i vetmi mjet për të përmirësuar gjendjen. Nga ana Juaj përveç mos marrjes së masave për raportim të rregullt, nuk janë përdorur instrumentet e kontrollit për përmirësuar situatën dhe përsheptimin e punimeve sipas afatit / grafikut të miratuar. Kjo qasje nuk është treguar edhe pas faktit se mbikëqyrësi i punimeve Ju ka vënë në dijeni, në ato raste kur ka raportuar, se ecuria e punimeve është shumë e ngadaltë dhe se kontraktori duhet të rrshtonte kapacitetet.

Gjithashtu, nga analiza e observacionit rezulton se nuk qëndrojnë dhe nuk merren në konsideratë argumentimet e dhëna në lidhje me fillimin e punimeve pa disponuar lejen e ndërtimit, amendimin e kontratës, etj.

Grupi i auditimit ka marrë në konsideratë observacionin në lidhje me vlerën e bazës llogaritëse mbi të cilën është llogaritur penalteti duke e ndryshuar nga vlera e kontratës së amenduar në vlerën e kontratës bazë.

Për sa më sipër, është mbajtur Akt Konstatimi nr. 12, datë 02.02.2026 dhe nga ana e mbikëqyrësit të punimeve OE A, është paraqitur observacioni i datës 12.02.2026, përcjellë në KLSH përtej afatit 7 ditor nga marrja dijeni si dhe observacioni i datës 05.03.2026 të cilët gjejnë trajtim në këtë Raport Përfundimtar Auditimi.

Pretendimi i subjektit:

“Situata 1:

Lidhur me pretendimin e ngritur në Projekt Raport për fillimin e punimeve pa leje ndërtimi, shoqëria A vlerëson të nevojshme të sqarojë kuadrin ligjor dhe administrativ në të cilin është zhvilluar procesi i zbatimit të projektit, si dhe kufijtë e rolit të mbikëqyrësit në këtë proces. Zbatimi i projektit për objektin “Restaurimi, rikonstruksioni dhe rehabilitimi i hapësirave në Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura” ka nisur mbi bazën e Vendimit nr. 542, datë 29.12.2020 të KKTKM, me të cilin është miratuar projekti i ndërhyrjes në objekt, në përputhje me Ligjin nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”. Bashkëngjitur...kopje të Vendimit nr. 542, datë 29.12.2020 të KKTKM. Ky vendim përbën akt administrativ individual të vlefshëm dhe ekzekutiv, të nxjerrë nga organi kompetent për ndërhyrjet në pasuritë e trashëgimisë kulturore materiale, dhe hyn në fuqi. Në kuptim të legjislacionit për trashëgiminë kulturore, miratimi i projektit nga KKTKM përbën fazën thelbësore të autorizimit të ndërhyrjes, mbi bazën e së cilës mund të zhvillohen fazat e zbatimit të projektit, në përputhje me kushtet dhe kriteret e miratuara. Procesi i mëvonshëm i plotësimit të dokumentacionit dhe i zbardhjes së vendimit të KKT për pajisjen me leje ndërtimi përfaqëson një procedurë administrative pasuese, tipike për objekte me status të posaçëm kulturor, dhe nuk e cenon vlefshmërinë apo efektin juridik të Vendimit nr. 542, datë 29.12.2020 të KKTKM. Për objekte muzeale dhe pasuri të trashëgimisë kulturore materiale, legjislacioni në fuqi njeh një regjim të posaçëm të ndërhyrjeve dhe nuk mund të trajtohen në mënyrë të njëjtë me ndërtimet e zakonshme në kuptim të legjislacionit të përgjithshëm të ndërtimit. Për rrjedhojë, nisja e punimeve mbi bazën e një vendimi në fuqi të KKTKM, ndërkohë që vijonte procedura administrative për zbardhjen e lejes së ndërtimit nga KKT sipas Vendimit të KKT Nr. 05 dt. 17.03.2021, nuk mund kurrësi të konsiderohet si ‘fillim punimesh pa leje ndërtimi’. Në këtë kontekst, edhe pretendimi se kontraktorit të punimeve i janë certifikuar dhe likuiduar vlera financiare përpara pajisjes me leje ndërtimi nuk qëndron. Certifikimi i situacioneve nga mbikëqyrësi është kryer mbi bazën e akteve administrative në fuqi dhe dokumentacionit tekniko-ligjor të miratuar, konkretisht mbi bazën e Vendimit nr. 542, datë 29.12.2020 të KKTKM dhe Vendimit të KKT nr. 05 dt. 17.03.2021, dhe nuk është realizuar në mungesë të çdo autorizimi ligjor. Certifikimi nga mbikëqyrësi ka karakter teknik dhe verifikues, duke u kufizuar në kontrollin e përputhjes së punimeve të kryera me projektin e miratuar dhe dokumentacionin teknik përkatës. Ky certifikim nuk përbën akt administrativ për vlefshmërinë e lejes së ndërtimit, as nuk përfaqëson vlerësim juridik të procedurave administrative të pajisjes me leje, kompetenca këto që nuk i takojnë mbikëqyrësit. Sa i përket rolit të mbikëqyrësit, sqarojmë se A ka ushtruar funksionin e saj teknik mbi bazën e akteve administrative në fuqi dhe dokumentacionit të miratuar, në përputhje me: Kontratën e mbikëqyrjes, VKM nr. 1125/2020, Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001, për aq sa ka qenë i zbatueshëm në periudhat përkatëse dhe në përputhje me legjislacionin e kohës dhe VKM nr. 610/2022. Në këtë kuadër, mbikëqyrësi ka ushtruar një rol teknik, kontrollues dhe raportues, në përputhje me kompetencat e përcaktuara në aktet ligjore dhe kontraktuale, dhe nuk ka kompetencë për vlerësimin juridik të procedurave të lejes së ndërtimit, as për pezullimin apo moszbatimin e vendimeve të organeve kompetente. Në vlerësimin e konstatimit të bërë, është gjithashtu e nevojshme të merret në konsideratë parimi i proporcionalitetit dhe i interesit publik,

i sanksionuar në Kodin e Procedurave Administrative, si element kontekstual në interpretimin e situatës faktike. Një vlerësim thjesht formal i momentit të pajisjes me leje ndërtimi, pa analizuar efektet konkrete që do të sillte mosvijimi i procesit restaurues në një objekt të trashëgimisë kulturore, nuk pasqyron në mënyrë të plotë kompleksitetin e çështjes dhe regjimin e posaçëm ligjor të zbatueshëm.

Situata 2:

Shoqëria A ka ushtruar funksionin e raportimit dhe mbikëqyrjes gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës në përputhje me natyrën specifike restauruese dhe konservuese të ndërhyrjeve në një pasuri të trashëgimisë kulturore materiale, me fazat reale të zhvillimit të punimeve dhe me ritmin faktik të zbatimit të kontratës, duke vepruar në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për çdo fazë të zbatimit. Konkretisht, shërbimet e mbikëqyrjes janë ushtruar në bazë të VKM nr. 1125, datë 30.12.2020, “Për miratimin e rregullave të projektimit, zbatimit të punimeve për ndërhyrje ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale, mbikëqyrjen dhe kolaudimin e tyre”, e cila rregullon në mënyrë të posaçme ndërhyrjet në pasuritë e trashëgimisë kulturore materiale, si dhe në përputhje me Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, për periudhën kur ky akt ka qenë në fuqi. Me hyrjen në fuqi të VKM nr. 610, datë 22.09.2022 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të Mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”, shërbimet e mbikëqyrjes dhe raportimit janë ushtruar në përputhje edhe me këtë akt nënligjor për aq sa nuk bie ndesh apo për parashikime të pa përcaktuara në VKM nr. 1125, datë 30.12.2020. Raportimi mujor formal është realizuar për periudhën Tetor 2023 – Shtator 2025, e cila përkon me fazat aktive të punimeve në objekt. Në këtë kuadër, raportet mujore janë hartuar dhe paraqitur në mënyrë të vazhdueshme gjatë këtyre fazave të zbatimit, përtej ndarjes periodike të evidentuar në Akt-Konstatim. Për periudhat para dhe pas këtyre fazave aktive, punimet kanë qenë të kufizuara, të ndërprera ose të fokusuara kryesisht në procese studimore, procedurale dhe administrative, të lidhura ngushtësisht me natyrën e posaçme të ndërhyrjes në një objekt të trashëgimisë kulturore materiale, çka e bënte raportimin mujor formal një veprim pa përmbajtje teknike reale dhe pa informacione shitesë. Pavarësisht mungesës së raporteve mujore formale për disa periudha, raportimi i ecursë së punimeve është realizuar në mënyrë të vazhdueshme, të dokumentuar dhe të verifikueshme përmes Minutave të Takimeve periodike në kantier, të mbajtura në dakordësi me të gjitha palët e përfshira në proces. Në këto minuta janë pasqyruar elementët thelbësorë të raportimit teknik, përfshirë progresin e punimeve, zbatimin e grafikut, problematikat e evidentuara, zgjidhjet teknike të propozuara, çështjet financiare dhe aspektet e koordinimit ndërinstitutional. Minutat janë hartuar nga mbikëqyrësi, janë shpërndarë tek të gjitha palët e përfshira dhe i janë përcjellë rregullisht Autoritetit Kontraktor, duke garantuar transparencë dhe informim të vazhdueshëm mbi ecurinë reale të projektit. Në aspektin juridik, kjo mënyrë raportimi është në përputhje me parimet e Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit vlerësimi i veprimtarisë administrative duhet të bazohet në përmbajtjen dhe efektet reale të saj dhe jo thjesht në formën formale të dokumentit, për sa kohë që qëllimi i raportimit është arritur dhe nuk janë cenuar të drejtat e palëve. Po ashtu, në kuptim të Kodit Civil, raportimi i realizuar në këtë mënyrë përbën shprehje të parimit të mirëbesimit dhe bashkëpunimit kontraktual, duke qenë se kjo praktikë është ndjekur në dakordësi të plotë ndërmjet palëve dhe pa asnjë kundërshtim gjatë kohës së zbatimit të kontratës. Detyrimet e mbikëqyrësit për raportim burojnë nga Kontrata e shërbimit e lidhur sipas aktit nr. 3306/14 prot., datë 22.07.2021, e cila duhet interpretuar në harmoni me kuadrin ligjor në fuqi në çdo fazë dhe me

natyrën specifike të objektit. Në këtë kuadër, mbikëqyrësi ka detyrim monitorojë ecurinë reale të punimeve, të informojë investitorin për problematika dhe të raportojë në fazat ku ekziston përmbajtje teknike reale për raportim, por nuk ka detyrim për prodhimin e raportimit formal periodik në mungesë të zhvillimit faktik të punimeve. Gjithashtu, në Akt-konstatim përmendet fakti që mungojnë raportimet e Mbikëqyrësit periudhën tetor 2024 – shkurt 2025, fakt që nuk qëndron pasi këto raporte janë dorëzuar kopje të tyre i gjeni në folderin e dokumentacionit shtesë që i bashkëngjitet këtij Observacioni. Për rrjedhojë, as për periudhën e zbatimit të Udhëzimit nr. 3/2001, as për periudhën pas hyrjes në fuqi të VKM nr. 610/2022, nuk mund të konkludohet se veprimet apo mosveprimet e mbikëqyrësit bien në kundërshtim me detyrimet ligjore për raportim dhe monitorim, pasi këto detyrime janë përmbushur në thelb, në mënyrë funksionale dhe në përputhje me kuadrin normativ përkatës të çdo faze.

Situata 3:

Punimet e pasqyruara në materialet fotografike dhe të përmendura në Situatën 3 janë realizuar nga Kontraktori i Punimeve pas miratimit paraprak të ndryshimit të projektit fillestar nga KKTKM, përmes Vendimit nr. 513, datë 06.10.2023, akt administrativ individual i vlefshëm dhe ekzekutiv, i cili ka autorizuar ndërhyrjet përkatëse në objekt si dhe mbi bazën e Lejes së ndërtimit të zbardhur nga Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT) sipas aktit nr. 636/1 prot., datë 28.10.2023. Në këtë kuptim, punimet kanë qenë të mbështetura në një bazë të plotë administrative dhe nuk janë kryer në mungesë miratimi nga organet kompetente. Në periudhën e muajit Tetor 2023, i vetmi element që nuk ishte ende formalizuar ishte akti i modifikimit të kontratës së punimeve, i cili është nënshkruar më vonë, sipas aktit nr. 6235 prot., datë 07.12.2023. Kjo rrethanë lidhet me aspektin kontraktual të marrëdhënies ndërmjet Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktorit dhe nuk cenon vlefshmërinë e autorizimit administrativ për realizimin e punimeve, as rolin dhe kompetencat e mbikëqyrësit. Punimet e realizuara përpara nënshkrimit të modifikimit të kontratës janë kryer nga Kontraktori nën përgjegjësinë dhe riskun e tij, pa miratim dhe pa certifikim financiar nga ana e mbikëqyrësit përpara formalizimit të aktit përkatës kontraktual. Mbikëqyrësi nuk ka miratuar situacionimin e këtyre punimeve jashtë kuadrit kontraktual të formalizuar dhe nuk ka prodhuar asnjë efekt financiar për Autoritetin Kontraktor në këtë fazë. Marrja e këtij risku nga Kontraktori nuk ka penalizuar palët e përfshira, por ka shërbyer për vijimin e procesit të zbatimit dhe shmangien e ndërprerjeve të panevojshme në ecurinë e punimeve. Në këtë kuadër, nuk qëndron pretendimi se veprimet apo mosveprimet e mbikëqyrësit bien në kundërshtim me parashikimet e VKM nr. 1125, datë 30.12.2020 “Për miratimin e rregullave të projektimit, zbatimit të punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse dhe mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të tyre”, pasi ndryshimi i projektit është miratuar nga organi kompetent, punimet civile janë realizuar mbi bazën e lejes së ndërtimit të lëshuar nga KKT dhe Vendimi i KKTKM i cili bazuar në Kapitullin IV, pikën 19 të VKM nr. 1125, datë 30.12.2020 është i detyrueshëm për zbatim. Për sa më sipër, vlerësojmë se konstatimet e ngritura në Situatën 3 të Akt-Konstatimit nuk pasqyrojnë saktë kuadrin ligjor dhe faktik të zhvillimit të punimeve, as ndarjen e përgjegjësisë ndërmjet Kontraktorit dhe Mbikëqyrësit. Mbikëqyrësi ka ushtruar rolin e tij teknik në përputhje me administrative në fuqi dhe ndarjen funksionale të kompetencave ndërmjet palëve. Për rrjedhojë, nuk rezulton shkelje e detyrimeve ligjore apo kontraktuale nga ana e shoqërisë A.

Situata 4:

Situata 4 e Akt-Konstatimit ndërton përfundime të përgjithshme mbi pretendime për shkelje të konstatuara në Situatat 1, 2 dhe 3, duke i lidhur këto me amendimin e afatit të përfundimit të punimeve dhe duke pretenduar se ky amendim mbështetet në argumente jo reale. Një pjesë

thelbësore e këtij arsyetimi mbështetet në interpretimin e imazheve të marra nga platforma Google Earth Pro, të cilat përdoren për të pretenduar vijimësi të punimeve edhe gjatë periudhave kur ato kanë qenë të pezulluara. Shoqëria A vlerëson se ky përfundim nuk qëndron, për arsye të mëposhtme:

Punimet për objektin kanë qenë zyrtarisht të pezulluara për periudha të caktuara, për arsye të dokumentuara në akte administrative të pranura ligjërisht dhe të njohura nga Autoriteti Kontraktor dhe nga të gjitha palët e përfshira në proces. Për rrjedhojë, prania vizuale e strukturave ekzistuese apo e elementëve të pandryshuar në terren nuk përbën në vetvete provë për zhvillim punimesh gjatë ndonjë periudhe pezullimi, aq më tepër kur kjo prani referohet mbi bazën e imazheve orientuese të platformës Google Earth Pro. Në këtë kontekst, theksojmë se Google Earth Pro:

- Nuk është burim zyrtar informacioni;
- Nuk është instrument i certifikuar për qëllime administrative apo audituese;
- Nuk garanton saktësinë kohore të imazheve të publikuara;
- Nuk identifikon natyrën e punimeve (aktive, të pezulluara apo gjendje statike);
- Nuk shoqërohet me procesverbal verifikimi në terren nga autoritete kompetente.

Imazhet e publikuara në këtë platformë janë produkte vizuale orientuese, të përditësuara në intervale të ndryshme kohore, pa garanci për përputhje me situatën reale në datën e pretenduar dhe pa mundësi verifikimi teknik apo juridik.

Në kuptim të Kodit të Procedurave Administrative, konstatimet administrative duhet të mbështeten në prova të ligjshme, të verifikueshme dhe të dokumentuara, si: procesverbale inspektimi; raporte teknike të mbikëqyrjes; akte administrative në fuqi; dokumentacion kontraktual dhe teknik. Përdorimi i imazheve nga Google Earth Pro nuk përmbush këto kritere dhe, për rrjedhojë, mund të shërbejë si provë në një akt-konstatim apo si bazë për atribuum përgjegjësie nuk administrative apo kontraktuale. Sa i përket amendimit të afatit të përfundimit të punimeve, sqarojmë se ky amendim nuk është mbështetur në të dhëna jo reale, por:

- në pezullimet faktike dhe të dokumentuara të punimeve;
- në procedurat administrative përkatëse dhe miratimet e dhëna nga KKTKM dhe KKT;
- në natyrën e ndërhyrjeve në një objekt të trashëgimisë kulturore materiale;
- në dokumentacionin zyrtar të ecursisë së projektit.

Çdo përpjekje për të kundërshtuar këto fakte mbi bazën e imazheve jozyrtare dhe të paverifikuara bie ndesh me parimin e objektivitetit, proporcionalitetit dhe sigurisë juridike, që duhet të udhëheqin veprimtarinë audituese dhe administrative. Për rrjedhojë, vlerësojmë se:

- përfundimet e nxjerra në Situatën 4 janë të pabazuara faktikisht;
- mbështeten në burime informacioni të papranueshme ligjërisht;
- nuk pasqyrojnë realitetin e zhvillimit dhe pezullimit të punimeve.

Si rrjedhim, lidhja e këtyre përfundimeve me pretendimin për shkelje nga ana e mbikëqyrësit nuk qëndron, pasi nuk merr në konsideratë dokumentacionin zyrtar, aktet administrative në fuqi dhe kufijtë realë të kompetencave dhe përgjegjësi të mbikëqyrësit.

Situata 5:

Kontrata e sipërmarrjes e lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktorit të Punimeve ka pasur një afat total zbatimi prej 24 (njëzet e katër) muajsh, me datë fillimi të punimeve më 28.10.2021. Zbatimi i kontratës ka vijuar normalisht deri në datën 19.10.2022, kur punimet janë pezulluar zyrtarisht për arsye të rishikimit të projekt-preventivit, pra pas rreth 12 muajsh pune efektive. Në këtë moment, nga afati fillestar kontraktual kishin mbetur ende 12 muaj të pa

ezauruar. Me shkresën e Kontraktorit nr. 451 prot., datë 20.09.2022, është kërkuar shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve me 8 (tetë) muaj shtesë, duke marrë në konsideratë:

-2 muajt e mbetur nga kontrata fillestare;

-nevojën për kohë shtesë për përballimin e pasojave të rishikimit të projektit.

Në këto kushte, në momentin e paraqitjes së kërkesës, Kontraktori kishte parashikuar përfundimin e punimeve brenda një afati total prej 20 muajsh efektivë pune (12 muaj të mbetur + 8 muaj shtesë). Megjithatë, procedurat administrative për rishikimin dhe miratimin e projekt-preventivit, përfshirë miratimin nga KKTKM, procesin e oponencës teknike, ngritjen dhe funksionimin e grupit të punës nga Autoriteti Kontraktor kanë kërkuar një kohë të konsiderueshme për t'u finalizuar, duke u përmbyllur vetëm me Amendimin nr. 2 të kontratës së sipërmarrjes, sipas aktit nr. 6235 prot., datë 07.12.2023.

Si rezultat, nga data e depozitimit të kërkesës së Kontraktorit (20.09.2022) deri në formalizimin e amendimit të kontratës (07.12.2023) ka kaluar një periudhë prej rreth 15 muajsh, gjatë së cilës afati fillestar kontraktual ka vijuar të konsumohet në aspektin formal dhe Kontraktori nuk i kishte më në dispozicion 12 muajt e mbetur nga kontrata fillestare për përfundimin e punimeve. Në këtë kontekst, dhe me qëllim harmonizimin e afatit të kontratës së punimeve me afatin e lejes së ndërtimit, shmangien e mospërputhjeve të vazhdueshme ndërmjet afateve kontraktuale dhe atyre administrative të miratuara nga KKTKM dhe KKT, Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktori i Punimeve, pas aprovimit të projekt-propozimit nga të gjitha organet kompetente, kanë vendosur që afati i ri i përfundimit të punimeve të caktohet më 18.10.2025, datë e cila përkon edhe me afatin e përfundimit të lejes së ndërtimit. Ky vendim përbën një zgjidhje racionale, proporcionale dhe ligjërish të justifikuar, e cila synon unifikimin e afateve dhe garantimin e përfundimit korrekt të punimeve, pa cenuar interesin publik dhe pa krijuar situata të përsëritura formale të mospërputhjes së afateve. Në këtë kuadër, rritjeksojmë se pretendimi i rishprehur se gjatë periudhës së pezullimit, punimet kanë vijuar nuk qëndron, pasi punimet kanë qenë zyrtarisht të pezulluara, çdo veprim i kryer në këtë periudhë ka qenë i kufizuar dhe i lidhur me procese procedurale dhe përgatitore dhe nuk ka prova ligjërish të vlefshme që dëshmojnë vijim të punimeve ndërtimore gjatë kësaj periudhe.

Situata 7:

Ndërton pretendimin se, përmes amendimit nr. 2 të kontratës së sipërmarrjes me nr. 6235 prot., datë 07.12.2023, është ndryshuar data e përfundimit të punimeve deri më 18.10.2025 në mënyrë të pajustificuar, duke u bazuar në argumente të cilat, sipas Akt-Konstatimit, nuk pasqyrojnë realitetin faktik dhe ligjor të zbatimit të kontratës. Shoqëria A vlerëson se ky përfundim nuk qëndron, për arsyet e mëposhtme. Kontrata e sipërmarrjes ndërmjet Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktorit të punimeve ka pasur një afat fillestar prej 24 muajsh, me datë fillimi të punimeve 28.10.2021. Në datën 19.10.2022, pra pas rreth 12 muajsh pune, punimet janë pezulluar zyrtarisht për shkak të nevojës për rishikim të projekt-preventivit, duke lënë të pae zauruar 12 muaj nga afati fillestar kontraktual. Me shkresën nr. 451 prot., datë 20.09.2022, Kontraktori ka kërkuar shtyrje të afatit me 8 muaj, duke pasur parasysh afatin e mbetur kontraktual prej 12 muajsh dhe nevojën për kohë shtesë për realizimin e punimeve sipas projektit të rishikuar. Megjithatë, procedurat administrative për miratimin e projektit të rishikuar (KKTKM, oponencë teknike, grup vlerësimi nga Autoriteti Kontraktor) janë finalizuar vetëm me amendimin nr. 2 të kontratës, datë 07.12.2023, pra pas një periudhe rreth 15-mujore nga depozitimi i kërkesës së Kontraktorit. Për pasojë, afati i mbetur kontraktual nuk ishte më realisht i disponueshëm për zbatim. Në këtë kontekst, Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktori, pas miratimit të projektit nga të gjitha organet kompetente, kanë vendosur që afati i ri kontraktual të unifikohe me afatin e Lejes

Ndërtimit, duke përcaktuar si datë përfundimi 18.10.2025, në përputhje me dokumentacionin së urbanistik dhe kulturor në fuqi. Pretendimi se punimet kanë vijuar gjatë periudhës së pezullimit nuk qëndron dhe nuk mbështetet në dokumentacion zyrtar. Ky pretendim është analizuar dhe kundërshtuar në mënyrë të detajuar edhe në Situatat pararendëse dhe mbetet i pabazuar faktikisht. Në lidhje me faktin që nga ana e mbikëqyrësit është raportuar progres i ulët i punimeve, sqarojmë se ky raportim nuk përbën mangësi apo mos ushtrim të detyrës, por përkundrazi përfaqëson pasqyrim objektiv dhe profesional të situatës reale në kantier. Progresi i ulët ka qenë pasojë direkte e kufizimeve faktike dhe kontraktuale që lidhen me procesin e rishikimit të projektit dhe pritjen e miratimeve përkatëse nga organet kompetente. Gjatë kësaj periudhe, Kontraktori ka qenë i limituar të kryejë vetëm ato procese pune që nuk prekeshin nga projekt-propozimi i rishikuar (për të cilin pritej miratimi nga instancat përkatëse), dhe që mund të realizoheshin pa rrezikuar punime të panevojshme, të dyfishta apo të pasigurta teknikisht. Një pjesë e konsiderueshme e punimeve kryesore nuk mund të zhvillohej pa miratimin përfundimtar të projektit të rishikuar. Në këtë kuadër, raportimi i progresit të ulët nga ana e mbikëqyrësit reflekton kufizimet reale të zbatimit, pasqyron saktësisht ritmin faktik të punimeve dhe dëshmon ushtrimin korrekt të rolit monitorues dhe raportues. Ky raportim përforcon faktin se punimet nuk kanë vijuar në mënyrë të pandërprerë gjatë periudhës së pezullimit, dhe se mbikëqyrësi nuk ka maskuar apo relativizuar vonesat, por i ka evidentuar ato në mënyrë transparente dhe të dokumentuar. Pretendimi se Kontraktori është favorizuar përmes mosaplikimit të penaliteteve dhe se amendimi i kontratës ka shërbyer për shmangien e tyre nuk qëndron. Në kushtet kur punimet kanë qenë të pezulluara për arsye të dokumentuara, ritmi i ulët i punimeve është raportuar vazhdimisht nga mbikëqyrësi por siç u sqarua më lart, Kontraktori ka qenë i limituar të kryejë vetëm ato procese pune që nuk prekeshin nga projekt-propozimi i rishikuar dhe afati kontraktual është rikonfiguruar për t'u përputhur me afatin e Lejes së Ndërtimit, nuk mund të flitet për përfitim të padrejtë apo shmangie të penaliteteve të cilat në optikën tonë nuk qëndrojnë, por për një rregullim kontraktual të bazuar në realitetin faktik dhe administrativ të projektit. Në dritën e sa më sipër, vlerësojmë se përfundimet e nxjerra në Situatën 7 nuk marrin në konsideratë kronologjinë reale të ngjarjeve, nuk reflektojnë kufizimet faktike dhe administrative të zbatimit të kontratës dhe nuk pasqyrojnë në mënyrë të drejtë rolin korrekt, raportues dhe monitorues të mbikëqyrësit. Për rrjedhojë, pretendimet për shkelje nga ana e mbikëqyrësit dhe për favorizim të Kontraktorit nuk qëndrojnë as faktikisht, as ligjërisht.

Situata 8:

Vlerëson si të pajustificuar shtyrjen e afatit kontraktual të punimeve, duke e lidhur këtë me progresin e cilësuar si të ulët të punimeve dhe me pretendimin për favorizim të Kontraktorit. Shoqëria A vlerëson se ky konstatim nuk pasqyron në mënyrë të saktë rrethanat faktike, teknike dhe ligjore që kanë ndikuar në ecurinë e projektit dhe në vendimmarrjen për shtyrjen e afatit. Së pari, shtyrja e afatit kontraktual nuk është bazuar në elementë formalë apo subjektivë, por në rrethana reale, të dokumentuara dhe të pavarura nga vullneti i palëve, të lidhura drejtpërdrejt me natyrën komplekse të ndërhyrjes në një pasuri të trashëgimisë kulturore materiale dhe me procedurat e detyrueshme të miratimit institucional. Një faktor thelbësor ka qenë procesi i oponencës teknike dhe rishikimit të projektit, përfshirë nevojën për riprojektimin e fasadës së objektit të ri. Kjo nevojë është administruar zyrtarisht nga Kontraktori me shkresën nr. 11300/1 prot., datë 07.10.2024, pra rreth një vit përpara afatit kontraktual të përfundimit të punimeve më datë 28.10.2025. Gjatë kësaj periudhe, janë zhvilluar procese të domosdoshme projektimi, verifikimi teknik dhe kërkimi për zgjidhje të përshtatshme materiale dhe teknologjike, si në tregun vendas ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Duhet theksuar se materialet dhe sistemet e

parashikuara për fasadën e objektit të ri nuk kanë qenë të disponueshme në mënyrë të menjëhershme në treg, për shkak të kërkesave të larta teknike, estetike dhe të qëndrueshmërisë, si dhe të varësisë nga furnitorë të specializuar dhe palë të treta, të cilat nuk janë nën kontrollin e Kontraktorit apo Autoritetit Kontraktor. Këto procese furnizimi, prodhimi dhe certifikimi kanë shkaktuar vonesa objektive, të dokumentuara dhe të justifikuara teknikisht. Një tjetër element thelbësor i pa përmendur në Akt-konstatim ka qenë vështirësia objektive në sigurimin e materialeve autentike për fasadën ekzistuese, konkretisht teserinat "vendi 5x5", të parashikuara në preventivin fillestar për ruajtjen e identitetit të objektit si monument kulture, Kategoria II. Ky material rezulton të jetë prodhim i ish-Fabrikës së Porcelanit, e cila prej vitesh nuk operon më, duke e bërë furnizimin identik praktikisht të pamundur në tregun vendas. Për këtë arsye, janë kryer kërkime të gjera në tregun rajonal dhe ndërkombëtar, të shoqëruara me korrespondencë të dokumentuar me furnitorë të ndryshëm, pa të cilat vijimi i punimeve të fasadës dhe proceseve të varura prej saj nuk ka qenë teknikisht i mundur. Kjo situatë është diskutuar dhe raportuar rregullisht gjatë takimeve periodike në kantier dhe është adresuar sapo është mundur një zgjidhje alternative e përshtatshme e gjetur me shumë vështirësi në tregun ndërkombëtar, e paraqitur për miratim nga Kontraktori me shkresën nr. 500 prot., datë 10.07.2025, duke ruajtur plotësisht vlerat teknike, estetike dhe funksionale të projektit. Gjithashtu, në vlerësimin e arsytimit për shtyrjen e afatit duhet të merret në konsideratë edhe procesi i shtimit të fuqisë elektrike dhe ndërhyrjet në rrjetin energjetik, të cilat kanë kërkuar koordinim ndërinstitutional dhe kanë sjellë pezullimin e përkohshëm të disa punimeve kyçe, si energjizimi i kabinës së re, vendosja e gjeneratorit dhe spostimi i kabinës ekzistuese në administrim të OSHEE-së. Këto ndërhyrje ndikojnë drejtpërdrejt edhe në elementë të rrjetit publik dhe nuk mund të realizohen pa procedura dhe afate të përcaktuara nga institucione të treta. Në këtë kuadër, progresi i punimeve i cilësuar si i ulët nuk përbën tregues të mungesës së angazhimit apo paaftësisë organizative të Kontraktorit apo favorizimit të pretenduar nga Mbikëqyrësi dhe Autoriteti Kontraktor, por pasqyron kufizimet reale teknike dhe procedurale për kryerjen vetëm të atyre proceseve të punës që nuk vareshin nga projektet e rishikuara dhe miratimet përkatëse ndërinstitutionale. Ky progres është raportuar në mënyrë transparente dhe të vazhdueshme nga Mbikëqyrësi, në përputhje me dokumentacionin faktik dhe fazat reale të zbatimit të kontratës. Në aspektin ligjor, vlerësojmë se rrethanat e mësipërme përkojnë edhe me situatën e veçantë të krijuar në tregun e materialeve ndërtimore, të njohur zyrtarisht përmes Aktit Normativ nr. 10, datë 18.05.2022, i cili është ende në fuqi. Ky akt parashikon shprehimisht se vonesat në zbatimin e kontratave publike për punë, të lidhura me efektet e kësaj situatë të veçantë, nuk konsiderohen shkelje të kushteve kontraktore dhe nuk shoqërohen me aplikim penalitetesh ndaj operatorëve ekonomikë. Për rrjedhojë, shtyrja e afatit kontraktual është mbështetur në arsye reale, të dokumentuara dhe objektive, në përputhje me parimet e proporcionalitetit, realizueshmërisë teknike dhe interesit publik. Kjo shtyrje nuk përbën favorizim të Kontraktorit, por reflektim të domosdoshëm kushteve faktike dhe ligjore të zbatimit të një projekti kompleks restaurimi, në të cilin Mbikëqyrësi ka ushtruar rolin e tij teknik dhe raportues brenda kufijve të kompetencave të përcaktuara nga kontrata dhe legjislacioni në fuqi. Në përfundim të sa më sipër, shoqëria A sh.p.k. vlerëson se konstatimet e paraqitura në Projekt Raport nuk pasqyrojnë në mënyrë të plotë realitetin faktik, teknik dhe ligjor të ushtrimit të rolit të mbikëqyrësit. Nga shqyrtimi i secilës situatë rezulton se veprimtaria e mbikëqyrjes është ushtruar në përputhje me aktet administrative në fuqi, kontratën e shërbimit dhe kuadrin ligjor përkatës, brenda kufijve të kompetencave të përcaktuara ligjërisht. Observacionet e paraqitura tregojnë se mbikëqyrësi ka përmbushur detyrimet e tij teknike dhe raportuese, pa pasur kompetencë për vlerësime juridike apo vendimmarrje administrative që u

përkasin organeve të tjera kompetente. Në mungesë të elementëve provues që të krijojnë një lidhje të drejtpërdrejtë dhe të individualizuar ndërmjet veprimeve konkrete të mbikëqyrësit dhe pasojave të pretenduara, nuk rezulton bazë ligjore për atribuem përgjegjësie ndaj tij. Në këtë kuadër, shoqëria A mbetet e angazhuar për bashkëpunim institucional dhe profesional, duke kërkuar që këto sqarime dhe observacione të merren në konsideratë në përputhje me parimet e ligjshmërisë, proporcionalitetit dhe objektivitetit në auditimin publik.”

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Situata 1:

Pretendimet e dhëna nga ana Juaj në lidhje me lejen e ndërtimit nuk merren në konsideratë nga ana e Grupit të Auditimit pasi ato nuk qëndrojnë dhe nuk i përmbahen drejtë dhe saktë parashikimeve të kuadrit ligjor në fuqi. Sqarojmë se baza ligjore e konstatuar si e pa respektuar i takon ligjit nr. 107/2014 *“Për planifikim dhe zhvillim e territorit”*, i ndryshuar. Vendimi i dhënë nga ana e KKTKM me nr. 542, datë 29.12.2020 i takon kompetencave të këtij këshilli sipas parashikimeve të ligjit nr. 27/2018 *‘Për trashëgësiminë kulturore dhe muzetë’*. Rikujtojmë se po në zbatim të këtij ligji, në nenin 48 citohet se:

“1. Projektet për leje zhvillimore dhe kërkesa për ndërhyrje në zonat e rëndësisë kombëtare të trashëgimisë kulturore miratohen dhe zbatohen në përputhje me dispozitat e ligjit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe këtij ligji.

2. Lejet zhvillimore, të rikonstruksionit të ndërtesave dhe ato të infrastrukturës në qendrat historike, zonat arkeologjike A, B, duhet të miratohen fillimisht në KKTKM dhe më pas, sipas legjislacionit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit.”. Për sa më sipër pretendimet Tuaja nuk qëndrojnë.

Situata 4:

Në lidhje me materialet e gjeneruara nga Google Earth Pro sqarojmë se ato janë një informacion i përdorshëm nga ana e Grupeve të Auditimit edhe në praktika të tjera të mëparshme. Përveç kësaj, sqarojmë faktin se konkluzioni i arritur për kryerje punimesh në fazën gjatë së cilës ato janë deklaruar si të pezulluara, është mbështetur edhe tek fakti se punimet e raportuara si të kryera në muajin Tetor 2023 kanë qenë pamundësisht ta përealizueshme në një afat kohor të shkurtër sic është periudha 14.10.2023 – 31.12.2023 (17 ditë pune kalendarike). Pra, informacionet e administruara janë dokumentet zyrtare por edhe burime të tjera aletrnative të aksesueshme. Në rastin konkret, këto informacione janë të tillë që mbështesin faktin se gjatë periudhës së pretenduar si të pezulluar, kontraktori ka qenë duke kryer punime.

Situata 5:

Pretendimet e dhëna nga ana Juaj edhe në lidhje me situatën 5 nuk merren në konsideratë nga ana e Grupit të Auditimit pasi edhe çështja e trajtuar nën këtë situatë, lidhet me faktin që gjatë periudhës së pretenduar se punimet kanë qenë të pezulluara, në gjykimin tonë punimet kanë vijuar. Për rrjedhojë edhe argumentimet dhe sqarimet e dhëna për afatin e shtyrjes nuk qëndrojnë.

Situata 7:

Pretendimet tuaja në lidhje me pikën 7 janë marrë pjesërisht në konsideratë nga ana e Grupit të Auditimit. Megjithatë, sqarojmë faktin se auditimi ka në fokus përputhshmërinë dhe në rastin konkret, është analizuar faktet dhe rrethanat, ato çka përshkruhen në këto dokumente zyrtare.

Për sa i takon pretendimeve të situatës 8 sqarojmë se vendimmarrja e gabuar në drejtim të amendamentit të afatit të punimeve, si veprim apo mosveprim nuk është përgjegjësi e mbikëqyrësit të punimeve.

Grupi i auditimit merr në konsideratë observacionin për sa i takon periudhës Shkurt – Maj 2022 dhe Tetor 2024 – Shkurt 2025, pas sqarimeve dhe materialeve shtesë të sjella me observacion në

lidhje me raportimin, por duke theksuar rëndësinë e raportimit sipas një formati të unifikuar, kjo pavarësisht situatave / ngjarjeve të ndodhura gjatë zbatimit të punimeve.

Për sa më sipër, është mbajtur Akt Konstatimi nr. 9, datë 02.02.2026 dhe nga ana e ish Drejtorit të DRTK Tiranë z. O.P, përmes postës elektronike të datës 11.02.2026 janë paraqitur observacionet si më poshtë trajtuar.

Pretendimi i subjektit:

“Në lidhje me situatën 1, referuar VKM nr. 610/2022, shtojca 1 bashkëlidhur, akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit mbahet nga Mbikëqyrësi i Punimeve, Zbatuesi i Punimeve dhe Zhvilluesi (përfaqësuesi Ligjor i tij). Referuar urdhri tim si menaxher Projekti nr. 5825 prot, datë 10.11.2021, nuk kam pasur asnjëherë detyrën e përfaqësuesit ligjor për këtë objekt”

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Pretendimet si më sipër nuk merren në konsideratë nga ana e Grupit të Auditimit pasi ato nuk sjellin fakt shtesë. Rikujtojmë se përgjegjësia Juaj nuk qëndron në dhënien e lejes por, si ndjekës kontrate, nisja e punimeve nuk duhet të ishte realizuar pa disponuar më parë atë nga ana e organeve kompetente.

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me situatën nr. 2 ... për periudhën nëntor 2021 – maj 2022, Menaxheri i Projektit ka marrë informacionin e nevojshëm mbi ecurinë e kantierit nëpërmjet takimeve javore të zhvilluara nga mbikëqyrësi, zbatuesi dhe përfaqësuesi i AK-së duke parashtruar edhe problematikat e kantierit. Për periudhën kohore të pezulluar normalisht sipas përcaktimeve ligjore s'ka raportim, pasi raporti në vetvete hartohet nga mbikëqyrësi për ti raportuar AK-së zhvillimin dhe ecurinë e punimeve në kantier. Për periudhën pas Amendimit të dytë të kontratës ka raporte periodike të mbikëqyrësit të punimeve.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Pretendimet si më sipër nuk merren në konsideratë nga ana e Grupit të Auditimit pasi ato nuk sjellin fakt shtesë. Rikujtojmë se nga auditimi rezultoi se ka patur periudhë kohore ku punimet kanë vijuar por ka munguar raportimi.

Pretendimi i subjektit:

Referuar situatës 3 të paraqitur nga audituesi sqaroj se gabimet e kryera në raport janë përgjegjësi e mbikëqyrësit të punimeve. Referuar Urdhrit nr. 5825 prot, datë 10.11.2021 “Përcaktimin e përfaqësuesit të autoritetit kontraktor (MK) me detyrën Menaxher Projekti, përgjegjës për ndjekjen dhe çështjet e ekzekutimit të kontratës me objekt “Restaurim, Rikonstruksion dhe Rehabilitim i hapësirave në “Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria Kombëtarë e Arteve)”, urdhri është ngritur në zbatim të nenit 34 të kontratës nr. 3047, datë 10.06.2021. Referuar nenit 34 të kontratës së sipërcituar “Përfaqësimi i Palëve” citon :

- 1. Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose strukturë organizative, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës tjetër, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me ekzekutimin e kontratës.*
- 2. Palët mund të emërojnë persona ose struktura organizative shtesë për tu përfaqësuar në veprime ose veprimtari të veçanta, duke njoftuar me shkrim kompetencat e të emëruarve respektive.*

Pra nga sa më sipër, sqaroj se kompetencat e mia kanë qenë organizative dhe administrative dhe jo teknike.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Pretendimet si më sipër nuk merren në konsideratë nga ana e Grupit të Auditimit pasi ato nuk sjellin fakt shtesë nga ato të konstatuara gjatë fazës së auditimit në terren.

Pretendimi i subjektit:

Sa i takon situatës 4 dhe 5 sqaroj se Menaxheri i kontratës, për shkak se punimet kanë qenë të pezulluara, nuk ka pasur asnjë kërkesë apo nevojë për të vizituar kantierin e punimeve. Kantieri referuar akteve ligjore dhe nën ligjore të fushës së ndërtimit është përgjegjësi e zbatuesit dhe mbikëqyrësit të punimeve. Referuar amendimit të afatit, unë në cilësinë e menaxherit të kontratës nuk kam pasur asnjë funksion vendim-marrës por vetëm koordinues ashtu si edhe vetë audituesi e citon në akt kostatim. ...

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Pretendimet si më sipër nuk merren në konsideratë nga ana e Grupit të Auditimit pasi ato nuk sjellin fakt shtesë nga ato të konstatuara gjatë fazës së auditimit në terren.

8. Kontrata me objekt “Hartim projekti për ndërtimin e një objekti/qendre të re multifunkionale në funksion të së ardhmes së edukimit artistik të fëmijëve në kryeqytet, pranë Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë dhe Teatrit të Kukullave”, viti 2021

Në zbatim të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- *Praktika e zbatimit të kontratës së shërbimit me objekt ‘Hartim projekti për ndërtimin e një objekti/qendre të re multifunkionale në funksion të së ardhmes së edukimit artistik të fëmijëve në kryeqytet, pranë Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë dhe Teatrit të Kukullave’;*
- *Praktika e Urdhër shpenzimit dhe dokumentacioni shoqërues;*
- *Etj.*

Për shërbimin e projektimit për këtë projekt, në shtator të vitit 2021 është zhvilluar procedura përkatëse e prokurimit me nr. REF-06221-09-23-2021 me objekt *Hartim projekti për ndërtimin e një objekti/qendre të re multifunkionale në funksion të së ardhmes së edukimit artistik të fëmijëve në kryeqytet, pranë Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë dhe Teatrit të Kukullave* nga ana e Autoritetit Kontraktor Ministria e Kulturës. Në përfundim të procedurës, sipas aktit me nr. 6758 prot., datë 31.12.2021, është lidhur kontrata e shërbimit mes Autoritetit Kontraktor Ministria e Kulturës (MK) e përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm znj. E. Ç dhe BOE i & S & X të përfaqësuar këta nga ana e OE R me administrator z. G. A dhe me vlerë të kontratës 49,200,000 lekë pa TVSH dhe me afat dorëzimi projekti 30 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës. Ndjekëse e kontratës rezulton të ketë qenë znj. A. L, për të cilën nuk disponohet urdhri përkatës për detyrën e ngarkuar²⁶. Përmes shkresës me nr. 449/1 prot, datë 28.01.2022, nga ana e ofruesit të shërbimit I RI, është bërë kërkesë për shtyrje afati për arsye të pushimeve në datat 1-4 janar si dhe për efekt të ligjit nr. 77/2021 “Për Miratimin e Aktit Normativ, me fuqinë e Ligjit, nr. 23, datë 26.5.2021, “Për disa ndryshime në Aktin Normativ nr.3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, ‘Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19’, të ndryshuar”. Sipas dokumentacionit të dorëzuar nga ana e subjektit të audituar nuk rezulton të ketë patur amendim të kësaj kontrate shërbimi. Në vijim, sipas shkresës së administruar në Ministrinë e Kulturës me nr. 449/4 prot., datë 01.02.2022, nga ana e ofruesit të shërbimit është paraqitur në Ministri shkresa me lëndë: *Dorëzim i Fazës së Katërt: Projekt Zbatim për objektin: "Hartim projekti për ndërtimin e një objekti/qendre të re multi funksionale në*

²⁶ Në dispozicion të Grupit të Auditimit u vendosën dokumente ku znj. A.L ka firmosur në cilësinë e ndjekësit të kontratës, por jo vet urdhri i emërimit të saj për këtë detyrë.

funksion të së ardhmes së edukimit artistik të fëmijëve në kryeqytet, pranë Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë dhe Teatrit të Kukullave". Në përmbajtje të kësaj shkrese përcjellëse citohet përmbajtja si më poshtë:

- *Projekti arkitektonik – 5 kopje*
- *Raport arkitektonik – 5 kopje*
- *Projekti akustik – 5 kopje*
- *Raport akustik – 5 kopje*
- *Projekti strukturor – 5 kopje*
- *Raport strukturor – 5 kopje*
- *Projekti elektrik – 5 kopje*
- *Raport elektrik – 5 kopje*
- *Projekti mekanik – 5 kopje*
- *Raport mekanik – 5 kopje*
- *Projekti i interierit – 5 kopje*
- *Projekti i teknologjive të skenës – 5 kopje*
- *Raport i teknologjive të skenës – 5 kopje*
- *Projekti i efikasitetit energjitike, Raporti, Çertifikimi – 5 kopje*
- *Raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis – 5 kopje*
- *Raport gjeologjik – 5 kopje*
- *Raport sizmik – 5 kopje*
- *Rilevim topografik – 5 kopje*
- *Preventiv – 5 kopje*
- *Specifikime teknike – 5 kopje*
- *Grafiku i punimeve – 5 kopje*
- *CD – 1 kopje.*

Me Urdhër të Ministrit nr. 52, datë 01.02.2022 është bërë ngritja e komisionit të marrjes në dorëzim të projektit për *'Ndërtimin e një objekti/qendre të re multi funksionale në funksion të së ardhmes së edukimit artistik të fëmijëve në kryeqytet, pranë qendrës kombëtare të kulturës për fëmijë dhe teatrit të kukullave'*, me përbërje të tij z. A. O, z. A. N dhe znj. M. T. Me shkresën nr. 449/6 prot., datë 16.02.2022, komisioni ka mbajtur procesverbalin përkatës të marrjes në dorëzim të projektit lidhur me dorëzimin nga projektuesi të materialeve për të verifikuar nëse janë respektuar kërkesat e DST. Në vijim, nga ana e AK i janë kërkuar projektuesit ndryshime për efekt të kërkesave të oponencës teknike, kërkesave të Bashkisë Tiranë për rishikimin e Projektit, rishikimit të çmimeve për efekt të rritjes së tyre bazuar në aktin normativ nr. 10/2022. Marrja përfundimtare në dorëzim rezulton të jetë kryer sipas procesverbalit me nr. 449/8 prot., datë 27.07.2022 të mbajtur mes komisionit të marrjes në dorëzim dhe ofruesit të shërbimit R me përfaqësues ligjor z. G.A. Produkti objekt kontrate është bërë hyrje në magazinë sipas fletë hyrjes nr. 41, datë 27.07.2022. Në vijim, me Urdhër të Ministrit të Ministrisë së Kulturës znj. E.M nr. 491, datë 29.07.2022, me nr. 449/11 prot., datë 29.07.2022 është urdhëruar kryerja e pagesës ndaj ofruesit të shërbimit në vlerën prej 49,200,000 lekë me TVSH. Nisur nga sa më sipër, me e-mailin e datës 26.01.2026 nga ana e Grupit të Auditimit u kërkuua vënia në dispozicion e materialeve bashkëlidhur shkresës së dorëzuar nga ana e projektuesit të objektit *Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë dhe Teatri i Kukullave*, të administruar në Ministrinë e Kulturës me nr. 449/4 prot., datë 01.02.2022 duke cituar ... *mjafton CD kopja e dorëzuar*. Në përgjigje të kësaj kërkesë, nga ana e subjektit nuk u dorëzua materiali CD fizik i sjellë nga projektuesit por disa materiale në format digjital me përmbajtje si më poshtë:

 Dosja - 01 ARCHITECTURE me përmbajtje:

211223_QKKF-TK_IMAGES (17 faqe);
ACAD-RILEVIMI Teatri i Kukllave-Layout1 (1 faqe);
Signed_ArchP1 (11 faqe);
Signed_ArchP2 (6 faqe);
Signed_ArchR (22 faqe);

✚ Dosja - 02 STRUCTURE me përmbajtje:

Signed_GA-01-07 (7 faqe);
Signed_K-AS-01-09 (9 faqe);
Signed_K-K-01-29 (29 faqe);
Signed_K-PS-01-11 (11 faqe);
Signed_K-S-01-11 (11 faqe);
Signed_K-SH-01-05 (5 faqe);
Signed_K-SP-01-05 (5 faqe);
Signed_K-T-01-07 (7 faqe);
Signed_K-TH-01-03 (3 faqe);

✚ Dosja - 03 ELECTRICAL me përmbajtje:

Raport Teknik_E (44 faqe);
Signed_P1_El (18 faqe);
Signed_P2_El (18 faqe);

✚ Dosja - 04 MEKANIK me përmbajtje:

- Nëndosja - 04 HIDRO me përmbajtje:
Signed_H01_TK_20220302 (1 faqe);
- Nëndosja - 05 HVAC me përmbajtje:
Signed_TKHVAC20220302 (11 faqe);
- Nëndosja - 06 FIRE PROTECTION me përmbajtje:
Signed_Z01_TK_20220302 (1 faqe);
- QKFTK_Fire Report (10 faqe);
- QKKFTK_Raport Teknik_M (24 faqe);
- QKKFTK_Specifikimet Teknike dhe Rregullat e Montimit (48 faqe);

✚ Dosja - 07 PREVENTIVI me përmbajtje:

Signed_Preventiv (2 faqe);

✚ Dosja - 08 GRAFIKU I PUNIMEVE me përmbajtje:

Signed_Grafikpunimesh (1 faqe).

Materialet si më sipër nuk rezultojnë të jenë konform parashikimeve kontraktuale dhe sipas kërkesave të termave të referencës e njëkohësisht nuk përmbushin kriterin e një evidence të besueshme auditimi. Gjithashtu, këto materiale edhe pse në stampën e tyre citojnë *Janar 2022* kanë vulë digjitale të datës 02.03.2022, nuk janë të plota (sipas kërkesave të termave të referencës) dhe nuk janë të nënshkruara nga të gjithë projektuesit. Ndodhur në këto kushte, nga ana e Grupit të Auditimit, në aktin e konstatimit të mbajtur për këtë praktikë u evidentua fakti se për kërkesën e bërë sipas e-mailit të datës 26.01.2026 nuk u vendos në dispozicion asnjë dokument korrespondues i atyre të deklaruara nga ana e OE R si të dorëzuara në datën 01.02.2022, përmes shkresës me nr. 449/4 prot., datë 01.02.2022. Referuar termave të referencës, në kapitullin 5 Raportimi citohet se:

“Të gjitha raportet duhet të dorëzohen në formë të shtypur dhe elektronike.

Burimet e informacionit duhet të referohen dhe të përfshihen në një listë të plotë të gjithë profesionistët dhe organizata (përfshirë adresat dhe numrat e telefonit) me të cilët janë kryer

takime dhe diskutime. Vizatimet dhe raportet duhet të shtypen në 5 (pesë) kopje origjinale në gjuhën shqipe. 1 (një) CD me të gjitha materialet në formatin PDF në shqip dhe me të gjitha materialet në formatet përkatëse (acad, docx, xlsx, avi, etj.). Dokumentet duhet të dorëzohen zyrtarisht me fletën e inventarit. Të gjitha dokumentet e shtypura fillimisht duhet të nënshkruhen nga të gjithë projektuesit.

Nga ana e Komisionit të ngritur sipas Urdhrit të Ministrit nr. 52, datë 01.02.2022, gjatë marrjes në dorëzim përmes procesverbalit të datës 16.02.2022, është cituar se:

“ ... komisioni ka kontrolluar të gjithë dokumentacionin e dorëzuar nga projektuesi duke evidentuar që janë respektuar të gjitha pikat e Dokumenteve Standarde të Tenderit.”. Nisur nga kjo, në dispozicion të grupit të auditimit duhet të ishte vendosur ndër të tjera edhe CD i kërkuar me e-mailin e datës 26.01.2026.

Për sa më sipër lidhur me mangësitë në drejtim të mos administrimit dhe dorëzimit të materialeve të nevojshme për kryerjen e auditimit ngarkohen me përgjegjësi ish Titullarët e AK znj. E. C, znj. Z. B, znj. A. P, znj. Ll. M dhe Titullari aktual z. S. B si dhe anëtarët e komisionit të marrjes në dorëzim z. A. O, z. A. N dhe znj. M. T.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së punimeve me objekt *‘Ndërtimi i një objekti / qendre të re multifunksionale në funksion të së ardhmes së edukimit artistik të fëmijëve në kryeqytet, pranë qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë dhe Teatrit të Kukullave’*, projekti i së cilës është hartuar nga ana e OE I ShPK rezulton se projekti ka pasur mangësi në detaje të cilat kanë pamundësuar vijimin e punimeve në lidhje me:

- detajet e fasadës (catwalk-et dhe parapetet);
- skicat e konstruksioneve metalike të rrëshqitëses në tarracë;
- realizimin e shkallëve të brendshme të katit të VI dhe të VII;
- plan-sistemimet dhe ballkonet e oborrit të brendshëm;
- projektin e teatrit veror;
- etj.

Këto detaje janë konstatuar gjatë zbatimit të punimeve në objekt dhe kanë sjellë vonesa në ecurinë e punimeve, pezullime të përkohshme duke e bërë të pamundur përfundimin sipas grafikut të miratuar të punimeve. Si pasojë edhe e mangësive të projektit konstruktiv, punimet kanë qenë të pezulluara për 53 ditë, nga data 01.06.2023 – 24.07.2023. Përveç detajeve si më sipër, citohet se ka munguar projekti i skenografisë dhe ai i akustikës, si elemente esenciale për përfundimin e projektit dhe të nevojshme për integrimin me sistemet e tjera. Nga sa më sipër, arrihet në konkluzionin se nga ana e AK nuk janë marrë masat e nevojshme për dorëzimin e një produkti konform kërkesave të detyrës së projektimit, administrimit e dokumentacionit në arkivë të materialeve të sjella nga ana e projektuesit.

Për sa më sipër, është mbajtur Akt Konstatimi nr. 14, datë 02.02.2026 dhe nga ana e BOE I & S & X (firmosur nga ana e OE I), është paraqitur observacioni i datës 09.03.2026, përcjellë në KLSH sipas shkresës me nr. 951/26 prot., datë 13.03.2026.

Pretendimi i subjektit:

“...Dorëzimi i projektit është vërtetuar sipas shkresës me nr. 449/4 prot., datë 01.02.2022 si dhe sipas procesverbalit me nr. 449/8 prot., datë 27.07.2022 të mbajtur mes komisionit të marrjes në dorëzim dhe ofruesit të shërbimit, me anë të të cilit projekti është marrë në dorëzim përfundimisht dhe pa kushte nga Ministria e Kulturës si dhe është magazinuar sipas fletës së magazinimit nr. 41, datë 29.07.2022. Në këtë kuadër dëshirojmë t'i sjellin në vëmendje MTKS Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit

publik i cili përcakton ndër të tjera Pika 5: ..., Pika 7 ..., Pika74: ... Pika 76: ... Gjithashtu, në zbatim të këtij udhëzimi, MK është përgjegjëse për përcaktimin e rregullave për marrjen në dorëzim dhe ruajtjen e aktiveve (pika 5), për monitorimin e tyre (pika 7) si dhe për kontrollin vjetor të aktiveve të dorëzuara (pika 74). Dispozitat ligjore të sipërcituara saktësojnë se përgjegjësia për marrjen në dorëzim, ruajtjen dhe kontrollin vjetor të tij është përgjegjësi ekskluzive e Ministrisë...

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Grupi i auditimit merr pjesërisht në konsideratë observacionin në lidhje me aplikimin e penaltetit duke riformuluar dhe riadresuar rekomandimin në lidhje me këtë çështje.

9. Zbatimi i kontratës me objekt Loti III “Blerje pajisje për kabinetet Mekanike/Elektronike”, me vlerë 46,290,500 lekë pa TVSH

Nëpërmjet shkresës nr. 1447/17 prot., datë 13.11.2024, Operatori i Blerjeve të Përqendruara ka përcjellë dokumentacionin për lidhjen e kontratës për procedurën e prokurimit, duke bashkëlidhur dokumentacionin e procedurës dhe ofertës së operatorit të shpallur fitues. Në formularin e ofertës teknike janë paraqitur artikujt që do të furnizohet, 6 artikuj për shkollën “Petro Sota”, Fier dhe 21 artikuj për Shkollën e Mesme “Enver Qiraxhi” Pogradec, në total 27 artikuj. Në këtë formular janë paraqitur nominalisht artikujt, emri i kompanisë prodhuese, origjina e mallit, emërtimi i katalogut të produktit dhe numri i faqes dhe i referencës në katalogun e prodhuesit, si dhe certifikimet respektive të produkteve.

Ndërmjet AK “MEKI” dhe OE “L” shpk është lidhur kontrata e furnizimit nr. 14479/1 prot., datë 27.11.2024, me vlerë totale prej **46,290,500 lekë pa TVSH** dhe **55,548,600 lekë me TVSH**, me afat zbatimi 4 muaj. Në nenin 5.2 të kontratës përcaktohet se dorëzimi i mallit do të bëhet direkt pranë shkollave përkatëse.

Nëpërmjet Urdhrit të Ministrit nr. 14479/4, datë 12.12.2024 është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të mallit, i përbërë nga Xh. P, N. M, N. Sh. Me urdhrin nr. 568 me nr. 5616 Prot., datë 18.04.2025 është bërë ndryshimi i anëtarit të grupit N. M me S.L. Në komisionin e marrjes në dorëzim të mallit nuk rezulton të jetë përfshirë personi përgjegjës për materialin (magazinieri), në kundërshtim me pikën 43 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

1. Nëpërmjet procesverbalit të datës 27.12.2024 (i pa protokolluar), Komisioni ka dokumentuar marrjen në dorëzim të një pjese të artikujve, përkatësisht për 11 artikuj për shkollën “Enver Qiraxhi, Pogradec. Artikujve u është bërë hyrje në magazinë nëpërmjet fletë-hyrjes nr. 36, datë 27.12.2024. OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 1276, datë 21.01.2025**, në vlerën prej **8,580,000 lekë**, bazuar në Faturën elektronike nr. 8/2024, datë 27.12.2024. Komisioni ka dokumentuar dorëzimin e pajisjeve në shkollë nëpërmjet procesverbalit të datës 30.12.2024.

2. Nëpërmjet procesverbalit të datës 10.04.2025 (i pa protokolluar), i nënshkruar nga përfaqësues të Shkollës “Enver Qiraxhi” Pogradec dhe OE “L” shpk, është dokumentuar marrja në dorëzim 5 artikujve, në vlerën prej **14,010,600 lekë me TVSH**, pasqyruar në Fletë-hyrjen në magazinë nr. 11, datë 10.04.2025, cituar “Aktive në ruajtje”. Veprimi i mësipërm është kryer në mungesë të dokumentit autorizues për punonjësit respektivë, pasi Komisioni i marrjes në dorëzim ishte përcaktuar në Urdhrin e Ministrit nr. 1089, datë 12.12.2024, komision i cili sipas nenit 5.4 të kontratës ka detyrimin të hartojë procesverbalin përkatës menjëherë me mbërritjen e mallrave. Për kryerjen e veprimeve të paautorizuara, duke marrë në dorëzim pajisjen ngarkohen me përgjegjësi

punonjësit e Shkollës “Enver Qiraxhi” Pogradec që kanë nënshkruar procesverbalin e datës 10.04.2025 (emrat janë vetëm me shkrim dore).

Nëpërmjet procesverbalit të datës 09.05.2025 (i pa protokolluar), Komisioni ka dokumentuar marrjen në dorëzim të 5 artikujve. Në PV citohet se *“grupi i punës... pas marrjes dijeni për ndryshimin e përbërjes së komisionit nëpërmjet njoftimit elektronik të datës 25.04.2023, u vu në kontakt me përfaqësuesit e shkollës dhe nisi procesin e verifikimit të dorëzimit të pajisjeve. Duke marrë në konsideratë shpërndarjen gjeografike të shkollave përfituese, si dhe detyrat e tjera funksionale të anëtarëve të komisionit, procesi i verifikimit dhe marrjes përfundimtare në dorëzim ka kërkuar kohë të shtuar”*. Ndryshimi i grupit të marrjes në dorëzim ka ndodhur rreth 8 ditë pas procesverbalit të marrjes në dorëzim të hartuar nga përfaqësuesit e Shkollës profesionale Korçë. Në nenin 5.4 të kontratës përcaktohet specifikisht se *“Menjëherë me mbërritjen e mallrave në vendin e përcaktuar, Komisioni për marrjen në dorëzim të mallrave do të hartojë procesverbalin e pritjes së mallit, i cili do të nënshkruhet nga të dy palët, në çastin e pritjes së mallrave në vendin e dorëzimit”*. Për sa më sipër, për veprimet dhe mosveprimet në kundërshtim me Urdhrin nr. 1089, datë 12.12.2024 dhe nenin 5.4 të kontratës, ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e komisionit të marrjes në dorëzim Xh. P, S.L., N Sh. Artikujve u është bërë hyrje në magazinë nëpërmjet fletë-hyrjes nr. 39, datë 09.05.2025. OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 823, datë 03.07.2025**, në vlerën prej **14,010,600 lekë**, bazuar në Faturën elektronike nr. 35/2025, datë 10.04.2025. Komisioni ka dokumentuar me PV përkatës shpërndarjen e artikujve në shkollat respektive.

3. Nëpërmjet procesverbalit të datës 26.03.2025 (i pa protokolluar), i nënshkruar nga përfaqësues të Shkollës “Petro Sota” Fier dhe OE “L” shpk, është dokumentuar marrja në dorëzim 6 artikujve, në vlerën prej **20,608,800 lekë** me TVSH, pasqyruar në Fletë-hyrjen në magazinë nr. 1, datë 26.03.2025, cituar *“Aktive në ruajtje”*. Nëpërmjet procesverbalit të datës 26.03.2025 (i pa protokolluar), i nënshkruar nga përfaqësues të Shkollës “Enver Qiraxhi” Pogradec dhe OE “L” shpk, është dokumentuar marrja në dorëzim 5 artikujve, në vlerën prej **12,349,200 lekë** me TVSH, pasqyruar në Fletë-hyrjen në magazinë nr. 10, datë 26.03.2025, cituar *“Aktive në ruajtje”*. Veprimi i mësipërm është kryer në mungesë të dokumentit autorizues për punonjësit respektivë, pasi Komisioni i marrjes në dorëzim ishte përcaktuar në Urdhrin e Ministrit nr. 1089, datë 12.12.2024, komision i cili sipas nenit 5.4 të kontratës ka detyrimin të hartojë procesverbalin përkatës menjëherë me mbërritjen e mallrave. Për kryerjen e veprimeve të paaautorizuara, duke marrë në dorëzim pajisjen ngarkohen me përgjegjësi punonjësit e Shkollës “Enver Qiraxhi” Pogradec dhe Shkollës “Petro Sota” Fier që kanë nënshkruar procesverbalin e datës 10.04.2025 (emrat janë vetëm me shkrim dore).

Nëpërmjet procesverbalit të datës 09.05.2025 (i pa protokolluar), Komisioni ka dokumentuar marrjen në dorëzim të 11 artikujve. Në PV citohet se *“grupi i punës... pas marrjes dijeni për ndryshimin e përbërjes së komisionit nëpërmjet njoftimit elektronik të datës 25.04.2023, u vu në kontakt me përfaqësuesit e shkollës dhe nisi procesin e verifikimit të dorëzimit të pajisjeve. Duke marrë në konsideratë shpërndarjen gjeografike të shkollave përfituese, si dhe detyrat e tjera funksionale të anëtarëve të komisionit, procesi i verifikimit dhe marrjes përfundimtare në dorëzim ka kërkuar kohë të shtuar”*. Ndryshimi i grupit të marrjes në dorëzim ka ndodhur rreth 28 ditë pas procesverbalit të marrjes në dorëzim të hartuar nga përfaqësuesit e Shkollave. Në nenin 5.4 të kontratës përcaktohet specifikisht se *“Menjëherë me mbërritjen e mallrave në vendin e përcaktuar, Komisioni për marrjen në dorëzim të mallrave do të hartojë procesverbalin e pritjes së mallit, i cili do të nënshkruhet nga të dy palët, në çastin e pritjes së mallrave në vendin e dorëzimit”*. Për sa më sipër, për veprimet dhe mosveprimet në kundërshtim me Urdhrin nr. 1089, datë 12.12.2024

dhe nenin 5.4 të kontratës, ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e komisionit të marrjes në dorëzim Xh. P, S.L, N. Sh.

Nëpërmjet procesverbalit të datës 09.05.2025 (i pa protokolluar), Komisioni ka dokumentuar marrjen në dorëzim të pjesës së mbetur të artikujve, përkatësisht 6 artikuj për Shkollën profesionale “Petro Sota”, Fier dhe 5 artikuj për Shkollën e Mesme “Enver Qiraxhi” Pogradec. Artikujve u është bërë hyrje në magazinë nëpërmjet fletë-hyrjes nr. 37, datë 09.05.2025. OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 824, datë 03.07.2025**, në vlerën prej **32,958,000 lekë**, bazuar në Faturën elektronike nr. 35/2025, datë 26.03.2025. Komisioni ka dokumentuar me PV përkatës të datës 21.05.2025 shpërndarjen e artikujve në shkollat respektive.

Në të gjitha rastet, Komisioni ka përcaktuar në procesverbalet e marrjes në dorëzim artikujt sipas sasive dhe çmimit, *por nuk ka dokumentuar kryerjen e verifikimit lidhur me prodhuesin dhe vendin e origjinës, sipas ofertës dhe formularit teknik të paraqitur nga operatori ekonomik në fazën e ofertimit*, në kundërshtim me nenin 107, pika 6, të RPP-së, nenin 6.3 të Kontratës nr. 14479/1 prot., datë 27.11.2024, si dhe me Rekomandimet e vazhdueshme të APP-së mbi problematikat e konstatuara gjatë zbatimit të kontratave të furnizimit të mallrave, ndër të fundit përcaktuar në pikën 7 të Rekomandimit të APP-së nr. 2118 prot., datë 04.03.2024, ku citohet se PV *duhet të përshkruajë me saktësi mallrat e furnizuara me treguesit e tyre sasiorë, cilësorë dhe të vlerës, si dhe të gjitha veprimet e kryera për verifikimin e mallrave të lëvruar, dokumentacionin shoqërues dhe çdo të dhënë të nevojshme* që i japin këtij dokumenti forcën e një prove ligjore ose administrative, për të garantuar përputhshmërinë jo vetëm me DST, por edhe me ofertën e paraqitur nga operatori. Edhe në procesverbalet e shpërndarjes në shkollat përkatëse, nuk janë përcaktuar elementët identifikues të artikujve sipas ofertës teknike, si emri i prodhuesit dhe vendi i origjinës.

10. Zbatimi i kontratës me objekt Loti IV “Blerje pajisje për kabinetet bujqësore”

Nëpërmjet shkresës nr. 1447/8 prot., datë 31.10.2024, Operatori i Blerjeve të Përqendruara ka përcjellë dokumentacionin për lidhjen e kontratës për procedurën e prokurimit, duke bashkëlidhur dokumentacionin e procedurës dhe ofertës së operatorit të shpallur fitues. Në formularin e ofertës teknike janë paraqitur artikujt që do të furnizohet, 5 artikuj për Shkollën Profesionale “Charles Telford Erickson”, Golem-Kavajë dhe 10 artikuj për Shkollën Profesionale e Shërbimeve Korçë, në total 15 artikuj. Në këtë formular janë paraqitur nominalisht artikujt, emri i kompanisë prodhuese, origjina e mallit, emërtimi i katalogut të produktit dhe numri i faqes dhe i referencës në katalogun e prodhuesit, si dhe certifikimet respektive të produkteve.

Ndërmjet AK “MEKI” dhe OE “AZ” shpk është lidhur kontrata e furnizimit nr. 13895/3 prot., datë 18.11.2024, me vlerë totale prej **30,786,500 lekë pa TVSH** dhe **36,943,800 lekë me TVSH**, me afat zbatimi 60 ditë. Në nenin 5.2 të kontratës përcaktohet se dorëzimi i mallit do të bëhet direkt pranë shkollave përkatëse.

Nëpërmjet Urdhrit të Ministrit nr. 1084, datë 12.12.2024 është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të mallit, i përbërë nga Xh.P, G. K, E. B. Në komisionin e marrjes në dorëzim të mallit nuk rezulton të jetë përfshirë personi përgjegjës për materialin (magazinieri), në kundërshtim me pikën 43 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

1. Nëpërmjet procesverbalit të datës 19.12.2024 (i pa protokolluar), Komisioni ka dokumentuar marrjen në dorëzim të një pjese të artikujve, përkatësisht për 10 artikuj për Shkollën Profesionale e Shërbimeve Korçë. Artikujve u është bërë hyrje në magazinë nëpërmjet fletë-hyrjes nr. 20, datë 19.12.2024. OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 1274, datë 20.01.2025**, në

vlerën prej **26,912,280 lekë**, bazuar në Faturën elektronike nr. 89/2024, datë 19.12.2024. Komisioni ka dokumentuar me PV përkatës shpërndarjen e artikujve në shkollat respektive.

2. Nëpërmjet procesverbalit të datës 19.12.2024 (i pa protokolluar), Komisioni ka dokumentuar marrjen në dorëzim të pjesës së mbetur të artikujve, përkatësisht 5 artikuj për Shkollën Profesionale “Charles Telford Erickson”, Golem-Kavajë. Artikujve u është bërë hyrje në magazinë nëpërmjet fletë-hyrjes nr. 20, datë 19.12.2024. OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 1275, datë 21.01.2025**, në vlerën prej **10,031,520 lekë**, bazuar në Faturën elektronike nr. 88/2024, datë 19.12.2024. Komisioni ka dokumentuar me PV përkatës shpërndarjen e artikujve në shkollat respektive.

Në të dyja rastet, Komisioni ka përcaktuar në procesverbalet e marrjes në dorëzim artikujt sipas sasive dhe çmimit, *por nuk ka dokumentuar kryerjen e verifikimit lidhur me prodhuesin dhe vendin e origjinës, sipas ofertës dhe formularit teknik të paraqitur nga operatori ekonomik në fazën e ofertimit*, në kundërshtim me nenin 107, pika 6, të RPP-së, nenin 6.3 të Kontratës nr. 13895/3 prot., datë 18.11.2024, si dhe me Rekomandimet e vazhdueshme të APP-së mbi problematikat e konstatuara gjatë zbatimit të kontratave të furnizimit të mallrave, ndër të fundit përcaktuar në pikën 7 të Rekomandimit të APP-së nr. 2118 prot., datë 04.03.2024, ku citohet se PV *duhet të përshkruajë me saktësi mallrat e furnizuara me treguesit e tyre sasiorë, cilësorë dhe të vlerës, si dhe të gjitha veprimet e kryera për verifikimin e mallrave të lëvruar, dokumentacionin shoqërues dhe çdo të dhënë të nevojshme* që i japin këtij dokumenti forcën e një prove ligjore ose administrative, për të garantuar përputhshmërinë jo vetëm me DST, por edhe me ofertën e paraqitur nga operatori. Edhe në procesverbalet e shpërndarjes në shkollat përkatëse, nuk janë përcaktuar elementët identifikues të artikujve sipas ofertës teknike, si emri i prodhuesit dhe vendi i origjinës.

11. Zbatimi i kontratës me objekt “Blerje automjeteve për nevojat e MEKI”

Nëpërmjet shkresës nr. 10518/1 prot., datë 27.09.2024, Drejtori i Drejtorisë së Aseteve dhe Shërbimeve të Përgjithshme pranë MEKI i ka shpjeguar situatën në lidhje me automjetet që ka në dispozicion dhe ka kërkuar pajisjen e institucionit me automjete të reja për përmirësimin e kushteve të punës të stafit të MEKI. Është ngritur grupi i punës për përllogaritjen e fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknike me urdhrin nr. 902 datë 30.10.2024. Grupi i punës ka hartuar specifikimet teknike dhe ka dërguar kërkesat për ofertë për llogaritjen e fondit limit i cili është 24,406,049 lekë pa TVSH. Nëpërmjet shkresës nr. 12894/13 prot., datë 06.11.2024, drejtuar OBP, Ministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit ka kërkuar zhvillimin e procedurës së prokurimit për blerje e automjeteve, sipas llojit dhe sasive në kërkesën nga njësia, si më poshtë:

Nr.	Automjete	Sasia
1	Automjet tip Furgon	1
2	Automjet tip Fuoristrad	1
3	Automjet tip SUV	1
4	Automjet tip Autoveturë	2
5	Automjet elektrik	1

Nëpërmjet shkresës administruar në MEKI me nr. 15809 prot., datë 17.12.2024, OBP ka përcjellë autorizimin për lidhje kontrate, sipas kërkesave nga MEKI, me OE “Eu” shpk, me ofertë ekonomike 24,320,000 lekë pa TVSH, duke bashkëlidhur dokumentacionin shoqërues të procedurës së prokurimit.

Ndërmjet MEKI dhe OE “Eu” shpk është lidhur kontrata e furnizimit nr. 15809/3 prot., datë 24.12.2024, me vlerë totale prej 24,320,000 lekë pa TVSH dhe 28,412,000 lekë me TVSH, me afat lëvrimi 40 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës.

Nëpërmjet Urdhrit nr. 1155, datë 26.12.2024 është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të automjeteve, i përbërë nga I. L, E. M dhe A. Sh.

Konstatim:

Në komisionin e ngritur për marrjen në dorëzim të mallit nuk rezulton të jetë i përfshirë dhe punonjësi i ngarkuar me përgjegjësi materiale (magaziner), veprim ky në kundërshtim me pikën 43 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30 datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësit e sektorit publik”*: 43. Komisioni përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tri veta, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi materiale.

1. Nëpërmjet PV të datës 26.12.2024 (i paprotokolluar), Komisioni i marrjes në dorëzim ka pranuar autoveturën Skoda Octavia sedan 2.0 TDI 150 PS automatik, duke bashkëlidhur edhe kushtet e garancisë për ku janë të përfshira dhe specifikimet teknike të automjetit, që përputhen me specifikimet teknike të përcaktuara në ofertë. Automjeti është shoqëruar me faturën elektronike nr. 2664/2024, datë 26.12.2024, në vlerën prej 2,904,000 lekë. Automjeti është bërë hyrje nëpërmjet Fletë-hyrjes nr. 34, datë 26.12.2024.

2. Nëpërmjet PV të datës 26.12.2024 (i paprotokolluar), Komisioni i marrjes në dorëzim ka pranuar autoveturën Skoda Octavia sedan 2.0 TDI 150 PS automatik, duke bashkëlidhur edhe kushtet e garancisë për ku janë të përfshira dhe specifikimet teknike të automjetit, që përputhen me specifikimet teknike të përcaktuara në ofertë. Automjeti është shoqëruar me faturën elektronike nr. 2665/2024, datë 26.12.2024, në vlerën prej 2,904,000 lekë. Automjeti është bërë hyrje nëpërmjet Fletë-hyrjes nr. 33, datë 26.12.2024.

3. Nëpërmjet PV të datës 26.12.2024 (i paprotokolluar), Komisioni i marrjes në dorëzim ka pranuar Fouristrada 2 Landrover Discovery Sport D165 Diesel Automatik, duke bashkëlidhur edhe kushtet e garancisë për ku janë të përfshira dhe specifikimet teknike të automjetit, që përputhen me specifikimet teknike të përcaktuara në ofertë. Automjeti është shoqëruar me faturën elektronike nr. 2663/2024, datë 26.12.2024, në vlerën prej 5,554,000 lekë. Automjeti është bërë hyrje nëpërmjet Fletë-hyrjes nr. 30, datë 26.12.2024.

4. Nëpërmjet PV të datës 26.12.2024 (i paprotokolluar), Komisioni i marrjes në dorëzim ka pranuar Furgon Renault trafic L2H1 2.0 dCI 110, manual, duke bashkëlidhur edhe kushtet e garancisë për ku janë të përfshira dhe specifikimet teknike të automjetit, që përputhen me specifikimet teknike të përcaktuara në ofertë. Automjeti është shoqëruar me faturën elektronike nr. 2666/2024, datë 26.12.2024, në vlerën prej 4,056,000 lekë. Automjeti është bërë hyrje nëpërmjet Fletë-hyrjes nr. 31, datë 26.12.2024.

5. Nëpërmjet PV të datës 26.12.2024 (i paprotokolluar), Komisioni i marrjes në dorëzim ka pranuar SUV Elektrik Volvo EX 30, Single Motor Extended Range, duke bashkëlidhur edhe kushtet e garancisë për ku janë të përfshira dhe specifikimet teknike të automjetit, që përputhen me specifikimet teknike të përcaktuara në ofertë. Automjeti është shoqëruar me faturën elektronike nr. 2662/2024, datë 26.12.2024, në vlerën prej 3,386,000 lekë. Automjeti është bërë hyrje nëpërmjet Fletë-hyrjes nr. 32, datë 26.12.2024.

6. Nëpërmjet PV të datës 26.12.2024 (i paprotokolluar), Komisioni i marrjes në dorëzim ka pranuar Fouristrada 1 Volvo XC90 B5(D) AËD Automatik, duke bashkëlidhur edhe kushtet e garancisë për ku janë të përfshira dhe specifikimet teknike të automjetit, që përputhen me specifikimet teknike të përcaktuara në ofertë. Automjeti është shoqëruar me faturën elektronike nr. 2661/2024, datë 26.12.2024, në vlerën prej 9,144,000 lekë. Automjeti është bërë hyrje nëpërmjet Fletë-hyrjes nr. 29, datë 26.12.2024.

Nga ana e grupit të marrjes në dorëzim është mbajtur një procesverbal po në datën 26.12.2024 ku shpjegohet se vlera totale në kontratën e nënshkruar nga institucioni dhe OE “Eu” shpk është gabim për shkak se vlera reale e automjeteve është 474,000 lekë pa TVSH më pak nga faturat që vet OE “Eu” shpk ka dorëzuar. Drejtoria e prokurimeve më pas nga mbajtur një procesverbal që kjo vlerë është marrë nga oferta që vetë OE “Eu” shpk ka ofertuar në Operatorin e Blerjeve të Përqendruara dhe si i tillë OE “Eu” shpk duhet të deklarojë që nuk ka pretendime të tjera përveç vlerës reale të automjeteve. Me deklaratën e protokolluar në MEKI me nr. 15809/11 datë 08.01.2025 OE “Eu” shpk ka sqaruar që ka një lapsus në vlerën totale të ofertuar dhe se vlerat për çdo automjet është vlera e saktë.

2.5 Procedurat e realizuara në zbatim të thirrjeve për financim në mbështetje të artit, kulturës, trashëgimisë dhe inovacionit.

Në zbatim të drejtimit 5 dhe 7 të Programit të Auditimit nr. 951/1 Prot, datë 13/10/2025, i ndryshuar, të ushtruar në Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit (Ish-Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe ish-Ministrisë së Kulturës) u kërkua informacion i detajuar për të gjitha format e financimeve në mbështetje të artit, kulturës, trashëgimisë dhe inovacionit 2022-2025, evidenca me aplikuesit dhe përfituesit e kësaj mbështetje, duke evidentuar emrin e subjektit, numrin e kontratës, datën, afatin dhe vlerën e financiar, realizimin e këtyre kontratave etj., informacion ky i cili u vendos në dispozicion pjesërisht. Në veprimtarinë e saj Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit (ish MEKI dhe ish MK) udhëhiqet nga përcaktimet e Strategjisë Kombëtare për Kulturën 2019-2025 VKM nr. 903 datë 24.12.2019, e cila identifikon 5 objektiva specifik dhe një plan veprimi për to. Në këtë strategji Objektivi Specifik nr. 1 është “Krijimi i një mjedisi të qëndrueshëm ligjor dhe institucional për zhvillimin e artit dhe kulturës” dhe qëllimi i politikës është “Përmirësimi dhe zgjerimi i tregjeve kulturore përmes legjislacionit, nga i cili do të përfitojnë krijuesit, krijimtaria artistike dhe kulturore dhe trashëgimia kulturore”. Në planin e veprimit për këtë objektiv janë parashikuar 3 produkte për realizim nga ministria përgjegjëse për kulturën dhe institucionet e varësisë që janë:

1. *Paketa e legjislacionit primar/ligjeve e finalizuar (reforma e ligjeve në fuqi/ligje të reja);*
2. *Paketa e legjislacionit dytësor/e finalizuar (akte nënligjore);*
3. *Fushata informuese/ ndërgjegjësimi për paketën ligjore.*

Nga auditimi është konstatuar se ky objektiv dhe kjo politikë nuk është ndjekur dhe zbatuar. Gjithashtu është konstatuar se nuk ka një grup pune të ngritur për ndjekjen dhe monitorimin e realizimit të kësaj strategjie. Nga auditimi është konstatuar se ende nuk rezulton të jetë hartuar dhe miratuar strategjia e re kombëtare për periudhën 2026-2030. Nga intervistat me stafin është sqaruar se kjo strategji është në proces. Ministria Turizmit Kulturës dhe Sportit menaxhon në portofolin e saj dy programe buxhetore që mbështesin dhe financojnë artin, kulturën dhe trashëgiminë, programi 08230 *Arti dhe kultura* dhe 08220 *Trashëgimia kulturore dhe muzetë*. Këto dy programe buxhetore në ekzekutimin e shpenzimeve të tyre, përveç legjislacionit të përgjithshëm që rregullon menaxhimin e sistemit buxhetor dhe shpërndarjen e fondeve me transparencë dhe ligjshmëri në Republikën e Shqipërisë zbatojnë edhe një ligj të veçantë të fushës që është ligji nr. 10352 datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, i ndryshuar. Ligji nr. 25/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10352 datë 18.11.2010 për artin dhe kulturën” në nenin 4 *Financimi i projekteve dhe veprimtarive artistike e kulturore përcakton se:*

“1. Ministria përgjegjëse për artin dhe kulturën, nga fondi buxhetor i miratuar për çdo vit, financon:

a) projekte të paraqitura nga persona fizikë, juridikë, vendas ose të huaj, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre artin dhe kulturën;

b) projekte dhe veprimtari artistike e kulturore, të cilat konsiderohen të rëndësishë së veçantë dhe që kanë një buxhet që arrin mbi 40 për qind të fondit vjetor për projekte.

2. Ky fond nuk i nënshtrohet legjislacionit të prokurimit publik.

3. Procedurat, që ndiqen për financimin e projekteve artistike, sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të këtij neni, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Gjithashtu në nenin 5 Miratimi i veprimtarive artistike e kulturore përcaktohet se:

“1. Miratimi i veprimtarive artistike e kulturore për artin dhe kulturën bëhet nga ministri përgjegjës për artin dhe kulturën, me propozimin e kolegjiut, të përbërë nga:

a) personalitete të gjinive të ndryshme të artit, të përcaktuara me urdhër të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën;

b) nëpunës civilë të nivelit të lartë dhe të mesëm, drejtues të strukturave përgjegjëse, që mbulojnë secilën nga gjinitë e artit në ministrinë përgjegjëse për artin dhe kulturën.

2. Kriteret dhe afatet në lidhje me kërkesë-propozimet për mbështetje financiare, të parashikuara në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 26, përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën.”

dhe në nenin 6 Kompetencat e kolegjiut përcakton se:

“1. Kolegjiut ka këto kompetenca:

a) përzgjedh dhe klasifikon projektet e artit nga pikëpamja e vlerave artistike, kulturore, edukative sociale dhe ekonomike;

b) miraton veprimtari artistike-kulturore për artin dhe kulturën, në përputhje me përcaktimet e bëra në nenin 26 të këtij ligji;

c) nxit krijimtarinë artistike kombëtare dhe i propozon ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën organizimin e konkurseve kombëtare dhe skema të tjera vlerësimi në gjini të ndryshme të artit. 2. Mënyra e funksionimit të kolegjiut përcaktohet me urdhër të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën.”

dhe së fundmi në nenin 8 përcaktohet se:

“Ministria përgjegjëse për artin dhe kulturën, në zbatim të politikave të saj, organizon konkurse kombëtare dhe skema të tjera vlerësimi në gjini të ndryshme të artit. Kushtet dhe masa e shpërblimit të fituesit përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën.”

Në nenin 35 të ligjit përcaktohet se:

“1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 10, 16, 18, 26 e 34 të këtij ligji.”.

Nga auditimi është konstatuar se Ministria përkatëse nuk ka përcjellë për miratim pranë Këshillit të Ministrave aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji dhe neneve specifike të cituara në ligj me qëllim rregullimin e domosdoshëm të zbatimit të tij. Gjithashtu nuk është hartuar asnjë udhëzim i përhershëm nga Ministria në vite me qëllim përcaktimin e rregullave të qarta në shpenzimin dhe ekzekutimin e buxhetit të parashikuar për artin dhe kulturën, që nuk i nënshtrohet ligjit të prokurimit publik, duke përfshirë këtu edhe kritere konkrete në zbatim të ligjit mbi të cilat evidentohen llojet e shpenzimeve që i nënshtrohen rregullimit të ligjit për artin dhe kulturën, dhe atyre që i nënshtrohen rregullave të prokurimit publik.

Ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” në nenin 5 përcakton se: “Menaxhimi financiar dhe kontrolli është një sistem politikash, procedurash, veprimtarish dhe kontrollesh, nëpërmjet të cilave burimet financiare janë planifikuar, drejtuar dhe kontrolluar për të mundësuar dhe influencuar ofrimin me efikasitet dhe efektshmëritë shërbimeve publike. Ky

sistem vendoset, ruhet dhe përditësohet rregullisht nga titullari i njësise publike dhe vihet në zbatim nga i gjithë personeli, me qëllim për të adresuar risqet e për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësise publike do të arrihen nëpërmjet:

a) veprimtarive efektive, të efektshme dhe me ekonomi;

b) pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;

c) informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota; ç) mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.”

Sa më sipër, nga auditimi është konstatuar se për një periudhë 15 vjeçare, nga miratimi i ligjit për artin dhe kulturën në 2010, nuk janë krijuar mekanizmat e domosdoshme për funksionimin e një sistemi kontrolli të brendshëm me qëllim mirë menaxhimit e fondeve të planifikuara për artin, kulturën dhe trashëgiminë. Referuar neneve 23, 24, 25 dhe 26 të Urdhrit të Ministrit nr.620 datë 13.05.2025 për “Miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit” është konstatuar se veprimtaria e këtyre drejtorive rregullohet vetëm në mënyrë të përgjithshme pa identifikuar detyrat dhe përgjegjësitë për secilin pozicion dhe sektor, duke krijuar kështu paqartësi mbi ndarjen e detyrave dhe caktimin e përgjegjëseve.

Nga auditimi është konstatuar se nuk janë miratuar të plota gjurmët e auditimit lidhur me procedurën e aplikimit, miratimit dhe monitorimit të fondit të ndihmës ekonomike për individët dhe financimit të shoqatave, veprim ky në kundërshtim me ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 16, pika 2, ku përcaktohet se: “Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësise dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësise publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit”, ku sikurse përcakton edhe neni 4, pika 19 “Gjurma e auditimit përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve.”

Gjithashtu, nuk janë përcaktuar në aktet e brendshme veprimtaritë e kontrollit sikurse përcakton ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 22, pika 1 dhe 3 “Titullarët e njësive publike miratojnë veprimtaritë e kontrollit, përfshirë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut. Veprimtaritë e kontrollit përmbajnë, minimalisht: procedurat për raportimin, mbikëqyrjen, vlerësimin e efikasitetit dhe të efektivitetit të veprimtarive; procedurat e monitorimit;”

Nga auditimi është konstatuar se mungon një sistem informacioni dhe komunikimi që të sigurojë dokumentimin e të gjitha këtyre veprimtarive, proceseve dhe transaksioneve nëpërmjet dokumentimit dhe qarkullimit të dokumenteve, që përmbajnë rregullat për përgatitjen, formatimin, lëvizjen, përdorimin dhe arkivimin e dokumenteve sikurse përcaktohet në nenin 23, pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Gjithashtu, nuk është hartuar një regjistër risku nga strukturat përkatëse me risqe të identifikuara të kësaj veprimtarie sa i takon miratimit, zbatimit dhe monitorimit të ekzekutimit të këtyre shpenzimeve. Grupi i auditimit ka kërkuar informacion të detajuar mbi shpenzimet e planifikuara, realizuara dhe numrin e projekteve financuar nga programet e artit, kulturës dhe trashëgimisë sipas të gjitha procedurave të aplikuara nga Ministria dhe të dhënat evidentohet në tabelën më poshtë.

Nga informacioni i vendosur në dispozicion fondet e miratuara nën programet 08230 “Arti dhe kultura” dhe 08220 “Trashëgimia kulturore dhe muzetë” nga llogaria 604/605 për vitet 2022, 2023, 2024 dhe 2025 janë alokuar nëpërmjet thirrjeve publike të organizuara, nëpërmjet kërkesave jashtë thirrjeve, nëpërmjet VKM-ve të veçanta, javëve kulturore ndërkombëtare, bonusit të rijetëzimit, culturealb dhe skemave të financimit të huaj.

Tabela 1: Fonde të miratuara dhe realizuara për art/kulturë/trashëgimi (milion lekë)

	2022			2023			2024			2025		
Mënyra miratimit të projekteve	1*	2*	3*	1*	2*	3*	1*	2*	3*	1*	2*	3*
Nga thirrjet	185	140	?	237	182	?	201	124	?	256	292	?
Jashtë thirrjeve	106	154	?	26	140,6	?	11	68,7	?	20	23	?
VKM	7	200	?	1	130	?	3	5,6	4,9	-	-	-
Bonusi rijetëzimit	41	100	99,6	58	144	69,8	-	60	48	-	22,5	2,5
JKN	416	98	96	288	130	120,7	364	121,	115	378	144	45,3
CultureAlb	ska	ska	ska	ska	ska	ska	ska	Ska	ska	144	50	16,9
Projekte fin. huaj	3	88	15,5	6	18,8	11,5	7	435,8	36	9	838,8	15
Total	758	780	208	616	746	190,6	586	815,5	204	683	1,321	79,8

Burimi: DPAK, DAFTK dhe Sektori Financës

(1)Numër projektsh;(2)Financimi i projekteve;*(3) Realizimi i projekteve.

Sikurse evidentohet edhe në tabelë, gjatë viteve 2022-2025 janë shpenzuar fonde buxhetore, të cilat kanë ndjekur procedura të ndryshme miratimi. Një pjesë e mbështetjes financiare është dhënë nëpërmjet thirrjeve publike të shpallura me urdhër Ministri, procedurë kjo pjesërisht e rregulluar në bazë të urdhrave të Ministrisë dhe pjesërisht e standartizuar me formularë dhe anekse. Një pjesë tjetër e mbështetjes është dhënë nëpërmjet procedurave të tjera të brendshme jashtë thirrjeve publike bazuar në ligjin për artin dhe kulturën sipas intervistave me subjektin. Një pjesë tjetër e mbështetjes është miratuar me VKM të veçanta siç janë projektet *Art në hapësira publike* në 2022, *Festivali i Gjirokastrës* në 2023 dhe *80 vjetori i çlirimit në 2024*. Sikurse evidentohet edhe në tabelë për një pjesë të këtyre shpenzimeve ka qenë e pamundur të identifikohet vlera e realizuar për financimet në mënyrë të detajuar sipas procedurave edhe pse fondet ndjekin rrugë të ndryshme miratimi dhe zbatimi nuk disponohen të diferencuara nga strukturat përkatëse. Me qëllim evidentimin e të gjitha projekteve të mbështetura me fonde buxhetore nga programet buxhetore 08230 *Arti dhe kultura* dhe 08220 *Trashëgimia kulturore dhe muzetë* pavarësisht procedurës së ndjekur në miratimin e tyre është kërkuar informacion i detajuar në evidenca Excel por edhe dosjet e procedurave për vitet 2022, 2023, 2024 dhe 2025. Grupi i auditimit ka kërkuar dhe i janë vendosur në dispozicion evidencat me informacion të detajuar për periudhën 2022-2025 në nivel projekti mbi aplikimet, miratimin dhe zbatimin për:

- 1) Projektet në vijim të thirrjeve publike për mbështetje financiare në zbatim të politikave;
- 2) Projektet jashtë thirrjeve publike;
- 3) Projektet me VKM të veçanta;
- 4) Projektet e “Bonusit të rijetëzimit”;
- 5) Projektet e “Javës kulturore ndërkombëtare”;
- 6) Projektet e “CultureAlb” apo ditëve shqiptare nëpër botë.

Realizimi sipas evidencave në nivel projekti për të gjitha kategoritë e sipër evidentuara është vendosur pjesërisht në dispozicion. Në vijim trajtohen në mënyrë më të detajuar sipas kategorive të sipër evidentuara procedurat e miratimit dhe realizimit sipas kampioneve të përzgjedhura për testim.

1. Projekte me thirrje publike

Grupi i auditimit ka kërkuar informacion të detajuar mbi numrin dhe vlerën e projekteve që kanë aplikuar dhe atyre që janë financuar me procedurat e thirrjeve publike në mbështetje të artit, kulturës dhe trashëgimisë në vitet 2022, 2023, 2024 dhe 2025. Gjithashtu u kërkuar informacion i detajuar edhe për realizimin e projekteve të financuara, informacion ky i pa vendosur në dispozicion. Në tabelën nr.2 më poshtë është bërë pasqyrimi i përmblendhur i këtyre dhënave / projekteve bazuar në evidencat Excel të dërguara nga DPPZHK.


Tabela 2: Projektet 2022,2023,2024 dhe 2025 nga thirrjet publike

Viti	Projekte me Thirrje (1)	Numër aplikimesh (2)	Vlerë aplikimesh (3)	Numër fituesish (4)	Vlerë fituesish (5)	% fitues numër (6)=(4)/(2)	% fitues vlerë (7)=(5)/(3)	Realizimi në vlerë (8)	Realizimi në % (9)=(8)/(5)
2022	1	499	236,602,699	185	140,164,600	37%	59%	?	?
2023	1+2	736	1,373,620,712	237	195,672,000	32%	14%	?	?
	(1) Art-kulture	600	1,244,629,147	195	165,020,000	33%	13%	?	?
	(2) Artizanat	136	128,991,565	42	30,652,000	31%	24%	?	?
2024	1	555	1,348,460,983	201	124,396,300	36%	9%	?	?
2025	5	670	1,167,252,335	277	262,056,395	41%	22%	?	?
	1+2	449	922,423,181	176=149 + 27 ankime	235.700.000 205,500,000+3 0.200.000 (ankime)	39%	26%	?	?
	(1)Ngjarje	298	465,252,774	110	109,500,000	37%	24%	?	?
	(2)Organiz.	151	457,170,407	39	96,000,000	26%	21%	?	?
	3+4	216	183,588,013	96	54,691,000	44%	30%	?	?
	(3)Krijimtari	86	65,516,841	53	30,000,000	62%	46%	?	?
	(4)Artizanat	130	118,071,172	43	24,691,000	33%	21%	?	?
	(5)Mobilitet	10	7,552,200	6	1,865,395	60%	25%	?	?

Burimi: DPPZHK

Sikurse evidentohet në tabelë për vitin 2022 janë mbështetur financiarisht 59% e vlerës së aplikuar, për vitin 2023 rreth 14%, për vitin 2024 akoma më pak rreth 9% dhe në vitin 2025 rreth 26% e vlerës.

Grafiku nr.1: Aplikimi dhe financimi i projekteve me thirrje publike



Burimi: DPPZHK

Grupi i auditimit ka shqyrtuar dhe konstatuar si më poshtë vijon për procedurat e ndjekura në miratimin e projekteve fituese me thirrje në vitet 2022, 2023, 2024 dhe 2025, si dhe realizimin e projekteve nëpërmjet kampionit të zgjedhur për testim sipas periudhave.

Procedura 2022

Për vitin 2022 janë evidentuar 499 aplikime për mbështetje buxhetore me vlerë 236,602,699 lekë, prej të cilave janë shpallur fitues 185 projekte me vlerë 140,164,600 lekë.

Nga auditimi i procedurës është konstatuar se përgjatë procedurës nga vlerësimi/propozim miratimi, lidhja e kontratës dhe monitorimi i tyre janë përfshirë në disa raste të njëjtët punonjës konkretisht z. A. A. ka qenë pjesë e kolegjiut që vlerëson projektet, ka nënshkruar kontratat dhe ka marrë pjesë edhe në monitorimin e tyre bazuar në Urdhrin e Ministrit. Kjo praktikë bie ndesh me parimet e menaxhimit financiar dhe kontrollit të shpenzimeve publike, sipas të cilave një punonjës nuk duhet të përfshihet në disa etapa të procesit vendimmarrës dhe të garantohet ndarja e detyrave, hierarki dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

Përzgjedhja e kampionit është bërë në bazë vlere. Për vitin 2022 nga shqyrtimi i 29 praktikave të projekteve me thirrje, rezultoi si më poshtë:

- Në 2 raste mungon aneksi 4 “Formular i aktiviteteve”;
- Në 16 raste anekset janë të pa nënshkruara nga aplikanti;
- Në 10 raste fituesit e projektit kanë kërkuar shtyrje të afatit, nga të cilat në 4 raste kërkesa e shtyrjes është pa datë dhe numër protokolli dhe në 3 raste kërkesa për shtyrje është bërë pasi ka përfunduar afati i kontratës. Në asnjë nga 10 rastet e mësipërme nuk është nënshkruar një amendim kontrate;
- Në 4 raste është financuar 100% e vlerës së projektit dhe 4 raste është miratuar 100% e vlerës së kërkuar;
- Nga 15 dosjet e zbatimit që u shqyrtuan rezultoi se në to gjenden dokumentet justifikues sipas parashikimeve të nenit 6 të kontratës “Financimi dhe modalitetet e pagesës” ku përcaktohet se *“Kjo shumë do të paguhet sipas fazave të mëposhtme: Faza e parë: 60% e shumës së akorduar “Përfituesi” e përfiton jo më vonë se 30 ditë para datës së zhvillimit të aktivitetit. Paga do të realizohet me paraqitjen e faturës tatimore. Faza e dytë: 40% e shumës së akorduar “Përfituesi” e përfiton pas realizimit dhe përfundimit të veprimtarive të parashikuara në Aneksin 1 dhe 2 dhe në çdo rast pas dorëzimit të të gjithë dokumenteve origjinale (apo kopje të noterizuara) justifikues që vërtetojnë zbatimin e detyrimeve të parashikuara në këtë kontratë. Kjo shumë do të derdhet në llogarinë bankare të “Përfituesit” sipas të dhënave të përcaktuara në Aneksin 2 të kësaj kontrate. Paga do të realizohet pas paraqitjes së faturës tatimore”, por në 3 raste u konstatuan mangësi si më poshtë vijon:*

1. Projekti “Memoria Kolektive -Laboratori Kreativ” i subjektit Shoqata “T.E” me vlerë 1,500,000 lekë.

Nga grupi i auditimit u konstatua se:

- 3 (tre) pagesa në vlerën 179,000 janë paguar pas përfundimit të afatit 31.07.2022, konkretisht 2 pagesat e bëra për znj. R.C në datën 10.08.2022 në vlerën 59,500 lekë secila në total 119,000 lekë dhe pagesa e bërë për z. Xh.A në datën 26.08.2022 në vlerën 60,000 lekë. Ndërsa tatimi në burim për muajin Korrik 2022, i deklaruar nga subjekti me detyrimin principal 204,634 lekë, i cili për arsye të mos pagesës në afat, deri në datën 29.09.2022 ka gjeneruar gjobë 4,666 lekë dhe interes 1,161 lekë në total 210,461 lekë, rezultoi të jetë paguar vetëm 50,517 lekë në datën 29.09.2022, pra 30 ditë pas paraqitjes së faturës dhe 27 ditë pas hartimit të raportit final si dhe nuk është likuiduar i plotë detyrimi. Nga sa më sipër rezultoi se subjekti Shoqata “T.E” është likuiduar në datën 05.10.2022, 159,944 lekë më shumë nga sa ka justifikuar me pagesa e dorëzuara.

- Hartimi dhe nënshkrimi i Raporti final nr. 4775 prot., datë 02.09.2022 nga. z. A. A, Drejtori i Drejtorisë së Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Kulturës, duke qenë edhe nënshkrues i kontratës me subjektin përfitues, është në kundërshtim me nenin 8, pika 8/d, të ligjit nr. 10296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, pikën 3.3 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar nëpërmjet Urdhrit të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.

2. Projekti “Digjitalizimi i Mësonjëtores së Parë Shqipe” i subjekti “R.T” PF me vlerë 1,500,000 lekë.

Nga grupi i auditimit u konstatua se:

Sipas parashikimeve të nenit 6 të kontratës “Financimi dhe modalitetet e pagesës” ku përcaktohet se “Kjo shumë do të paguhet sipas fazave të mëposhtme: Faza e parë: 60% e shumës së akorduar “Përfituesi” e përfiton jo më vonë se 30 ditë kalendarike para datës së zhvillimit të aktivitetit. Paga do të realizohet me paraqitjen e faturës tatimore. Faza e dytë: 40% e shumës së akorduar “Përfituesi” e përfiton pas realizimit dhe përfundimit të veprimtarive të parashikuara në Aneksin 1 dhe 2 dhe në çdo rast pas dorëzimit të të gjithë dokumenteve origjinale (apo kopje të noterizuara) justifikues që vërtetojnë zbatimin e detyrimeve të parashikuara në këtë kontratë. Por në praktikën bashkëngjitur urdhër shpenzimit si dokumente justifikues të shpenzimeve ndodhen vetëm fatura nr. 12368/2022 nga “Sh.C” me vlerë 53,990 lekë dhe FDP të sigurimeve shoqërore për Mars-Korrik 2022 në total 47,084 lekë. Në dosje gjendet deklarata e z. R.T, në të cilën deklarohet se 8 zëra të preventivit janë zhvilluar nga vet ai me vlerë 1,420,000 lekë, shumë për të cilën nuk gjendet listë pagesa për z. R.T që ka zhvilluar produktin dhe nuk dokumentohet kryerja e pagesës së tatimit në burim për shërbimin prej $15\% \times 1,420,000$ lekë i barabartë me 213,000 lekë.

- Hartimi dhe nënshkrimi i Raporti final nr. 4946 prot., datë 14.09.2022 nga. z. A. A, Drejtori i Drejtorisë së Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Kulturës, duke qenë edhe nënshkrues i kontratës me subjektin përfitues, është në kundërshtim me nenin 8, pika 8/d, të ligjit nr. 10296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, pikën 3.3 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar nëpërmjet Urdhrit të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.

3. Projekti “Një udhëtim me një arkitekt” i subjekti Shoqata “P. H” me vlerë 1,500,000 lekë.

Nga grupi i auditimit u konstatua se në 3 raste likuidimi i faturave, në vlerë totale 203,000 lekë, është bërë në llogarinë Anjeza Puka (nënshkruese e kontratës së financimit) me përshkrim “Kthim borxhi për pagesë faturash” dhe në 1 rast në shumën 47,000 lekë likuidimi është bërë në llogarinë E. C me përshkrim “Kthim borxhi për pagesë faturash”. Pra likuidimet e faturave nuk janë bërë në llogarinë e subjektit që ka lëshuar faturën, por të personave që janë të angazhuar pranë shoqatës “P.H”. Sa më sipër nuk vërtetohet në se janë bërë apo jo pagesat e këtyre faturave, duke qenë se mungojnë edhe kuponat e kasës bashkëngjitur faturës siç përcaktohet edhe në pikën 6 të nenit 5 “Te drejtat dhe detyrimet e “Përfituesit” të kontratës për mbështetjen financiare i cili citon se: “Shpenzimet e kryera nga “Përfituesi, për të gjithë zërat e financuara nga financuesi, duhet të justifikohen me dokumentet e mëposhtëm origjinale apo kopje të noterizuara:

-Kontratë shërbimi me të tretët; faturë tatimore dhe dokumentacion (likuidim i pagesave bankare ose kupon i kasës për likuidimet cash;

-Faturë tatimore për blerjet e shoqëruara me likuidim bankar ose për blerjet cash, kuponin e kasës fiskale;

-Për pagesat e honorarëve personat juridik, fizik duhet të paraqesin kontrata me individët, list pagesa shoqëruar me deklarin e tatimit mbi burimin, xhirimin bankar për degën e tatimeve sipas legjislacionit në fuqi;

-Për financimet që i jepen individëve përfitues, shumës totale do ti mbahet tatimi në burim sipas legjislacionit në fuqi;

-Raporti financiar i detajuar ëdy kopje;

-Raport përshkrues nga “Përfituesi” mbi realizimin e veprimtarive që financohen nga financuesi sipas kësaj kontrate.”

Sa më sipër shpenzimet e faturave për te cilat pagesa nuk është me likuidim bankar ose për blerjet cash, me kuponin e kasës fiskale nuk përmbushin kushtin e dokumentit justifikues.

Procedura 2023

Gjatë vitit 2023 janë evidentuar 736 aplikime për mbështetje buxhetore me vlerë 1,373,620,712 lekë, prej të cilave janë shpallur fitues 237 projekte me vlerë 195,672,000 lekë. Përzgjedhja e kampionit është bërë në bazë vlere. Për vitin 2023 nga shqyrtimi i 33 praktikave të projekteve me thirrje, rezultoi si me poshtë:

- Në 1 rast mungon aneksi 4 “Formular i aktiviteteve”;
- Në 18 raste anekset janë të pa nënshkruara nga aplikanti;
- Në 1 rast është financuar 100% e vlerës së projektit dhe 3 raste është miratuar 100% e vlerës së kërkuar;
- Nga 17 dosjet e zbatimit që u shqyrtuan rezulton se në to gjenden dokumentet justifikues sipas parashikimeve të nenit 6 të kontratës “Financimi dhe modalitetet e pagesës” ku përcaktohet se *“Kjo shumë do të paguhet sipas fazave të mëposhtme: Faza e parë: 60% e shumës së akorduar “Përfituesi” e përfiton jo më vonë se 30 ditë para datës së zhvillimit të aktivitetit. Pagesa do të realizohet me paraqitjen e faturës tatimore. Faza e dytë: 40% e shumës së akorduar “Përfituesi” e përfiton pas realizimit dhe përfundimit të veprimtarive të parashikuara në Aneksin 1 dhe 2 dhe në çdo rast pas dorëzimit të të gjithë dokumenteve origjinale (apo kopje të noterizuara) justifikues që vërtetojnë zbatimin e detyrimeve të parashikuara në këtë kontratë. Kjo shumë do të derdhet në llogarinë bankare të “Përfituesit” sipas të dhënave të përcaktuara në Aneksin 2 të kësaj kontrate. Pagesa do të realizohet pas paraqitjes së faturës tatimore”*, por në 1 rast u konstatuan mangësi si më poshtë vijon:

1. Projekti “Njoh traditën dhe kulturën përmes lojës” i subjektit M.B PF me NIPT: J91326001G me vlerë 1,900,000 lekë.

Nga grupi i auditimit u konstatua:

-Nga e-maillet bashkëngjitur praktikës dhe nga citimi në Memo nr. 340/22 prot., datë 22.09.2023 rezulton se subjekti ka kërkuar shtyrje afati në datë 10.07.2023, (10 ditë me vonë se sa afati i përcaktuar në Aneksin I të kontratës. Gjithashtu në memon e mësipërme citohet se DKFPK shprehet se:

- Kërkesat e paraqitura brenda afateve të kontratës, duke marrë parasysh arsyet e shtyrjes të trajtohen pozitivisht nga ana e Ministrisë së Kulturës”
- Sa i përket kërkesave të parregullta, paraqitur pranë Ministrisë së Kulturës jo zyrtarisht, në momentin e dorëzimit të dokumentacionit justifikues financiar në mbyllje të projektit, sugjerojmë që kërkesa e tyre të shqyrtohet individualisht rast pas rasti dhe të vlerësohen shkaqet e shtyrjes së afateve, si edhe problematikat që kanë sjellë pamundësinë e realizimit në kohë të aktiviteteve të projektit.
- Duke marrë parasysh se projektet e sipërcituara, edhe pse me vonesa në afatet e paracaktuara të përfundimit të tyre, janë zhvilluar dhe kanë paraqitur dokumentacion të rregullt provues për aktivitetet e projekteve, të merret në konsideratë kërkesa e tyre.

Pavarësisht sa më sipër, mungon miratimi nga struktura përgjegjëse për shtyrjen e afatit. Mungon Amendimi i Kontratës për shtesën (marrëveshja e re), duke qenë se ka ndryshuar njeri nga kushtet themelore të kontratës fillestare.

Procedura 2024

Për vitin 2024 janë evidentuar 555 aplikime për mbështetje buxhetore me vlerë 1,348,460,983 lekë, prej të cilave janë shpallur fitues 201 projekte me vlerë 124,396,300 lekë. Përzgjedhja e kampionit është bërë në bazë vlere. Për vitin 2024 nga shqyrtimi i 20 praktikave të projekteve me thirrje, rezultoi si me poshtë:

- Në 5 raste anekset janë të pa nënshkruara nga aplikanti;
- Në asnjë rast nuk është financuar 100% e vlerës së projektit dhe nuk është miratuar 100% e vlerës së kërkuar;
- Në 3 raste mungojnë vërtetimet për pagesat e detyrimeve tatimore, ku dokumentohet që organizata nuk ka detyrime të pashlyera sa i takon sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimore;
- Nga 13 dosjet e zbatimit që u shqyrtuan rezultoi se në to gjenden dokumentet justifikues sipas parashikimeve të nenit 5 të kontratës “Financimi dhe modalitetet e pagesës” pika 3: *“Përfituesi” do të përfitojë si para financim për fillimin e realizimit të projektit jo më vonë se 30 ditë pas nënshkrimit të kontratës, vlerën 60% të financimit të përfituar. Pagesa do të realizohet me paraqitjen e faturës tatimore. dhe pika 4: “Përfituesi” do të përfitojë 40% të vlerës së financimit pas realizimit dhe përfundimit të projektit objekt financimi i kësaj kontrate, dhe në çdo rast, pas dorëzimit të të gjithë dokumenteve origjinale (apo kopje të noterizuara) justifikues që vërtetojnë zbatimin e detyrimeve të parashikuara në këtë kontratë (neni 4, pika 6) dhe konfirmimit të dokumentacionit nga struktura përgjegjëse”:*

Përbërja e komisionit dhe përputhshmëria me kriteret ligjore

Ligji nr.25/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10352 datë 18.11.2010 për artin dhe kulturën” në nenin 5 Miratimi i veprimtarive artistike e kulturore përcakton se:

“1. Miratimi i veprimtarive artistike e kulturore për artin dhe kulturën bëhet nga ministri përgjegjës për artin dhe kulturën, me propozimin e kolegjiut, të përbërë nga:

a) personalitete të gjinive të ndryshme të artit, të përcaktuara me urdhër të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën;

b) nëpunës civilë të nivelit të lartë dhe të mesëm, drejtues të strukturave përgjegjëse, që mbulojnë secilën nga gjinitë e artit në ministrinë përgjegjëse për artin dhe kulturën.

2. Kriteret dhe afatet në lidhje me kërkesë-propozimet për mbështetje financiare, të parashikuara në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 26, përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën.”

në nenin 6 Kompetencat e kolegjiut përcaktohet se:

“1. Kolegjiut ka këto kompetenca:

a) përzgjedh dhe klasifikon projektet e artit nga pikëpamja e vlerave artistike, kulturore, edukative sociale dhe ekonomike;

b) miraton veprimtari artistike-kulturore për artin dhe kulturën, në përputhje me përcaktimet e bëra në nenin 26 të këtij ligji;

c) nxit krijimtarinë artistike kombëtare dhe i propozon ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën organizimin e konkurseve kombëtare dhe skema të tjera vlerësimi në gjini të ndryshme të artit.

2. Mënyra e funksionimit të kolegjiut përcaktohet me urdhër të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën.”

Urdhri nr. 123 datë 28.02.2023 “Për miratimin e rregullores së mënyrës së funksionimit të kolegjiut” në nenin 4 Anëtarët e kolegjiut përcakton se:

“Në Ministrinë përgjegjëse për artin dhe kulturën, Kolegjiut ngrihet si organ kolegjiut në fushën e veprimtarive artistike e kulturore i përbërë nga jo më pak se 3 anëtarë. Kryetari dhe anëtarët

emërohen nga ministri përgjegjës për kulturën me propozim të strukturës përgjegjëse që ndjek projektin kulturor dhe artistik.

1. Kolegji përbëhet nga:

a. Personalitete të gjinive të ndryshme të artit, të përcaktuara me urdhër të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën;

b. Personalitetet përzgjidhen rast pas rasti, sipas fushës që përfshin projekti/projektet;

c. Nëpunës civil të nivelit të lartë dhe të mesëm, drejtues të strukturave përgjegjëse, që mbulojnë secilën nga gjinitë e artit në ministrinë përgjegjëse për artin dhe kulturën dhe institucionet në varësi të kësaj ministrie.

2. Kryetari drejton mbledhjen e Kolegjiumit, drejton diskutimet dhe siguron zbatimin e ligjit dhe marrjen e vendimeve të drejta.

3. Kolegjiumi ka në kompetencë të tij:

a. të shqyrtojë, përzgjedh dhe klasifikojë projektet e artit dhe kulturës nga pikëpamja e vlerave artistike, kulturore, edukative sociale dhe ekonomike;

b. të shqyrtojë dokumentacionin shoqëruar të projektit/projekteve;

c. të miratojë veprimtari artistike-kulturore për artin dhe kulturën, në përputhje me përcaktimet e bëra në nenin 26 të ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010 "Për artin dhe Kulturën" i ndryshuar;"

Në vijim të sa më sipër është ngritur kolegji për vlerësimin e projekt propozimeve me Urdhër të Ministrit nr. 95 prot., 834/2 datë 01.03.2024 për *"Ngritjen e kolegjiut që do të shqyrtojë, vlerësojë dhe paraqesë për miratim projekte në fushën e artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore të paraqitura në thirrjen për aplikim, financim dhe mbështetje me fonde publike nga MEKI për vitin 2024"*, me përbërje si vijon: z. K. D, Ekspert i Jashtëm, Kryetar, z. A. B, Drejtor Qendra Kombëtare Kulturore e Fëmijëve, z. N. K, Drejtor Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale, znj. I.P, Drejtor Drejtoria e Politikave dhe Strategji të Zhvillimit Kulturor dhe znj. E. P, Drejtor Drejtoria e Zhvillimit të Politikave të Kulturës. Sa më sipër nga auditimi është konstatuar se është plotësuar kriteri ligjor i sipër cituar dhe në ligj edhe në rregullore për të patur në përbërje të kolegjiut *"nëpunës civil të nivelit të lartë dhe të mesëm, drejtues të strukturave përgjegjëse"*, por nuk evidentohet të jetë përmbushur kriteri i parë për *"Personalitete të gjinive të ndryshme të artit"*.

Procedura 2025

Për vitin 2025 janë evidentuar 670 aplikime për mbështetje buxhetore me vlerë 1,167,252,335 lekë, prej të cilave janë shpallur fitues 277 projekte me vlerë 262,056,395 lekë.

Propozimi i Kolegjiumit me vendimin nr.4291/3 datë 31.03.2025 për ankimimet rezulton të jetë i pa argumentuar dhe plotësuar me dokumentacion shtesë të shqyrtuar nga ky kolegjiut në ndryshimin e vendimit të kolegjiut të parë.

Përzgjedhja e kampionit është bërë në bazë vlere. Për vitin 2025 nga shqyrtimi i 38 praktikave të projekteve me thirrje, rezultoi si me poshtë:

- Në 2 raste është financuar 100% e vlerës së projektit dhe 11 është miratuar 100% e vlerës së kërkuar;

- Në 1 rast subjekti është tërhequr nga gara pas nënshkrimit të kontratës dhe kalimit të 60% të fondit, fond të cilin e ka kthyer mbrapsht;

- Në dosjet e shqyrtuara gjenden dokumentacioni i kërkuar sipas shtojcës 8 -Lista e Dokumenteve;

Për sa i përket zbatimit të kontratave të projekteve me thirrje nga këto 38 praktika të shqyrtuara të 2025, likuidimi i vlerës 40% rezultoi që ishte bërë vetëm për 5 kontrata të cilat po i citojmë në vijim, ndërsa për pjesën tjetër të kontratave likuidimet janë bërë gjatë muajit Janar 2026.

1. Projekti “Rritja e kapaciteteve e të rinjve për Trashëgiminë Kulturore” i subjektit Qendrës “T.E” me vlerë 3,500,000 lekë.

Nga grupi i auditimit u konstatua se si dokument justifikues për zërin 6 të preventivit “*Dieta për stafin*” janë paraqitur urdhër shërbimet me destinacion Durrës, për menaxherin dhe financierin, pagesa bankare në shumën 90,000 lekë vetëm për menaxherin, e llogaritur për 20 ditë me 4,500 lekë/ditë, ndërsa për financierin është bashkëngjitur një deklarata e financierit që ka marrë shumën prej 63,000 lekë, e llogaritur kjo për 14 ditë me 4,500 lekë/ditë. Në total për të dy personat janë llogaritur dhe paguar dieta në shumën **153,000 lekë**.

Veprimet si më sipër janë në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” të ndryshuar kreu **III. Trajtimi financiar i punonjësve për përballimin e shpenzimeve të shërbimit bëhet i diferencuar, sipas distancës së shërbimit nga qendra e punës, si më poshtë vijon: 1. Për shërbime në një largësi deri në 50 km jashtë qendrës së punës, trajtimi financiar i punonjësit përfshin vetëm shpenzimet e transportit, në rastin kur transporti nuk realizohet nga vetë institucioni**, Ligji nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, neni 50, pika 1/h. “Shpenzimet të cilat tejkalojnë kufijtë e përcaktuar me ligj apo me akte nënligjore në fuqi, pika 1/k) “Shpenzimet për pagat, shpërblimet dhe forma të tjera të të ardhurave personale që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e punës, të paguara të punësuarve, duke përfshirë administratorët dhe **që nuk janë bërë nëpërmjet sistemit bankar** ose institucioneve të parasë elektronike të licencuara nga Banka e Shqipërisë; udhëzimi i MF nr. 26, datë 8.9.2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar pika 1. Shpenzimet të cilat tejkalojnë kufijtë e përcaktuar me ligj apo me akte nënligjore. Kufizimi i dietave. Përfitimet e punonjësve të cilët, për nevoja pune të tatimpaguesi, dërgohen me shërbim jashtë vendit efektiv të punës kufizohen në: v. Pagesa për udhëtim brenda vendi, jo më tepër se çmimi i biletave interurban të miratuara për transportin publik.

Shpenzimet e sipër cituara nuk duhet të njiheshin dhe si të tilla as nuk duhet të ishin paguar nga ana e strukturave përkatëse.

2. Projekti “Përmes Edukimit dhe krijimtarisë, drejt Trashëgimisë” i subjektit Qendrës “D.F” me vlerë 2,000,000 lekë.

Nga grupi i auditimit u konstatua se si dokument justifikues për zërin 12 “*Dieta ushqim*” dhe 13 “*Akomodim*” të preventivit janë paraqitur urdhër shërbimet (dieta) me destinacion Durrës për 12 netë për menaxherin dhe financierin e projektit (nga 6 për secilin) me vlerë 4,000 lekë/dita në total 48,000 lekë. Faturat e hotelit Durrës për 12 netë fjetje me 5,000 lekë /nata në total 60,000 lekë, për menaxherin dhe financierin e projektit, pagesa të cilat janë bërë cash. Në total për të dy personat janë llogaritur dhe paguar dieta në shumën **108,000 lekë**.

Veprim në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” të ndryshuar kreu **III. Trajtimi financiar i punonjësve për përballimin e shpenzimeve të shërbimit bëhet i diferencuar, sipas distancës së shërbimit nga qendra e punës, si më poshtë vijon: 1. Për shërbime në një largësi deri në 50 km jashtë qendrës së punës, trajtimi financiar i punonjësit përfshin vetëm shpenzimet e transportit, në rastin kur transporti nuk realizohet nga vetë institucioni**, Ligji nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, neni 50, pika 1/h. “Shpenzimet të cilat tejkalojnë kufijtë e përcaktuar me ligj apo me akte nënligjore në fuqi, pika 1/k) “Shpenzimet për pagat, shpërblimet dhe forma të tjera të të ardhurave personale që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e punës, të paguara të punësuarve, duke përfshirë administratorët dhe **që nuk janë bërë nëpërmjet sistemit bankar** ose institucioneve të parasë elektronike të licencuara nga Banka e Shqipërisë; udhëzimi i MF nr. 26, datë 8.9.2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar pika 1. Shpenzimet të cilat tejkalojnë

kufijtë e përcaktuar me ligj apo me akte nënligjore. Kufizimi i dietave. Përfitimet e punonjësve të cilët, për nevoja pune të tatimpaguesi, dërgohen me shërbim jashtë vendit efektiv të punës kufizohen në: v. Pagesa për udhëtim brenda vendi, jo më tepër se çmimi i biletave interurban të miratuara për transportin publik.

Shpenzimet e sipër cituara nuk duhet të njiheshin dhe si të tilla as nuk duhet të ishin paguar nga ana e strukturave përkatëse.

Përbërja e komisionit dhe përputhshmëria me kriteret ligjore

Në vijim të sa u evidentua më sipër për kriteret ligjore dhe nënligjore të përbërjes së kolegjiut për vlerësimin e projekt propozimeve është ngritur kolegjiut për vlerësimin e projekt propozimeve me Urdhrin e Ministrisë. 188 prot., 16497/3 datë 06.02.2025 për *“Ngritjen e kolegjiut që do të shqyrtojë, vlerësojë dhe paraqesë për miratim projekte në fushën e artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore të paraqitura në thirrjen për aplikim, financim dhe mbështetje me fonde publike nga MEKI për vitin 2025”*, me përbërje si vijon: znj.A.P, Drejtor i Përgjithshëm, Kryetar; znj.I.P, Drejtor i DPSZHK, Anëtar; znj.B. K, Drejtor i DZHPK, Anëtar; z.A.N, Drejtor i TKOBAP, Anëtar; znj.M.Q, Drejtor QKKF, Anëtar; z.Gj.P, Drejtor i TKEKS, Anëtar;znj.M.M, Eksperte e Jashtme, Anëtar.

Sa më sipër nga auditimi është konstatuar se është plotësuar kriteri ligjor i sipër cituar dhe në ligj edhe në rregullore për të patur në përbërje të kolegjiut *“nëpunës civil të nivelit të lartë dhe të mesëm, drejtues të strukturave përgjegjëse”*, por nuk evidentohet të jetë përmbushur kriteri i parë për *“Personalitete të gjinive të ndryshme të artit”*.

Konstatim për gjurmët e auditimit që mungojnë për pikët e kolegjiut.

Nga auditimi i veprimtarisë dhe vendimmarrjes së kolegjiut për vlerësimin dhe përzgjedhjen e projekteve për mbështetje financiare në vitet 2022, 2023, 2024 dhe 2025 është konstatuar se në vendimmarrjet 2022, 2023 dhe 2024 nuk gjenden gjurmë të dokumentimit të vlerësimit për kriteret mbi të cilat është marrë vendimi, përshkruese apo nëpërmjet pikëve për secilin projekt dhe për të gjitha projektet sipas viteve në total. Për vendimmarrjen e vitit 2025 është vendosur në dispozicion dosja me pikëzimin e projekteve sipas kriterëve të përcaktuara për secilin anëtar, por nuk ka një evidencë totale të pikëve të dhëna për të gjitha aplikimet e ardhura të firmosur nga anëtarët e kolegjiut, veprim ky në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*, i ndryshuar si dhe me Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, të cilat parashikojnë detyrimin për vendosjen dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm që sigurojnë gjurmë auditimi të plotë, transparencë, dokumentim të mjaftueshëm dhe prova të besueshme mbi proceset vendimmarrëse që lidhen me përdorimin e fondeve publike. Mungesa e dokumentimit të plotë të vlerësimit sipas kriterëve të miratuara cenon parimet e transparencës, barazisë dhe llogaridhënies, krijon pamundësi për verifikimin e objektivitetit të procesit të përzgjedhjes dhe rrit riskun për vendimmarrje subjektive, me risk të shtuar në përdorimin joefektiv dhe joekonomik të fondeve publike.

2. Projekte jashtë thirrjeve publike (të brendshme)

Grupi i auditimit ka kërkuar informacion të plotë për të gjitha projektet e mbështetura financiarisht nga fondi Art/Kulture/Trashëgimi jashtë thirrjeve publike, pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën më poshtë për vitet 2022, 2023, 2024 dhe 2025. Sikurse evidentohet edhe në tabelë për vitin 2022 janë miratuar rreth 154 milionë lekë, për 2023 rreth 104 milion lekë, për vitin 2024 rreth 90 milion lekë dhe për vitin 2025 rreth 23 milion lekë. Vlëra e saktë e realizimit të këtyre projekteve në total nuk u vendos në dispozicion.

Tabela 3: Financim i projekteve jashtë thirrjeve publike 2022,2023,2024,2025.

Viti	Drejtoria	Projektet	Buxheti i projektit	Fondi aplikuar	Fondi miratuar	% Miratuar	Realizim
2022	DPAK	28	46,554,017	46,554,017	46,554,017	100%	?
	DAFTK	78	NUK KA INFORMACION		107,284,475	-	?
	Totali	106	NUK KA INFORMACION		153,838,492	-	?
2023	DPAK	17	118,932,199	118,932,199	118,932,199	100%	?
	DAFTK	10	NUK KA INFORMACION		19,790,000	-	?
	Totali	27	NUK KA INFORMACION		104,437,116	-	?
2024	DPAK	10	85,136,081	85,136,081	85,136,081	100%	?
	DAFTK	3	NUK KA INFORMACION		4,400,000	-	?
	Totali	13	NUK KA INFORMACION		89,536,081	-	?
2025	DPAK	9	48,662,629	19,412,629	16,262,629	84%	?
	DAFTK	3	NUK KA INFORMACION		7,000,000	-	?
	Totali	12	NUK KA INFORMACION		23,262,629	-	?
Totali		158	NUK KA INFORMACION		405,881,790	-	?

Burimi: Drejtoria Politikave Art Kulturë dhe Drejtoria AFTK.

Nga auditimi është konstatuar se si nga Zyra e Protokoll Arkivës si nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Kulturës nuk është mbajtur një regjistër i veçantë për këto kërkesa me qëllim evidentimin e tyre dhe krijimin e gjurmëve të domosdoshme të auditimit, ndryshe nga sa përcaktohet edhe në urdhrat e Ministrit për mbështetje financiare. Grupi i auditimit ka kërkuar nga zyra e protokoll arkivës dhe struktura përkatëse të vendosen në dispozicion të gjitha kërkesat për mbështetje financiare jashtë thirrjes publike për vitin 2024. Nga auditimi i evidencës së vendosur në dispozicion për vitin 2024, të hartuar me kërkesë të grupit të auditimit, evidencë e cila nuk jep siguri për plotësinë, saktësinë dhe mjaftueshmërinë e saj, është konstatuar se gjatë vitit 2024 janë regjistruar 15 kërkesa për mbështetje financiare, prej të cilave janë miratuar për mbështetje financiare vetëm 4 kërkesa dhe 11 të tjerat nuk kanë marrë mbështetje financiare dhe nuk ka një informacion të plotë dhe shterues mbi ecurinë dhe mbylljen e praktikës, bashkëlidhur Aneksi nr.4. Nga kryqëzimi të dhënave në këtë evidencë të hartuar me evidencat e drejtorive të artit dhe kulturës konstatohet të mos jenë përfshirë projektet e financuara jashtë thirrjeve “QDC” për 4,000,000 lekë, S.F për 400,000 lekë, si dhe 8 projekte të financuara nga drejtoria e politikave (I) I. D- Ambasada Austriake 313,500 lekë, Love as a glass of water- Bialja e Venecias 2024 28,158,600 lekë , Pjesëmarrja në Sanremo Junior 2024-K.I 300,000 lekë, Festivali filmit- E.B 260,000 lekë, CEI, SEECP, BSEC 2024- Presidenca rajonale e Shqipërisë 1,729,000 lekë, 90 vjetori M. Xh 1,469,420 lekë, Vizita e Presidentit Erdogan në Tiranë 606,250 lekë, G.B 500,000 lekë, çka dëshmon për mungesë të përgjithshme rregullimi të këtyre procedurave dhe evidentimit të qartë në bazë kriteresh të aktivitetit funksional të ministrisë në bazë programesh dhe projekteve artistike kulturore të paraqitura pranë saj me qëllim financimin në zbatim të ligjit për art kulturë dhe strategjisë kombëtare për kulturën. Nga auditimi është konstatuar se nuk ka një procedurë të standardizuar dhe të rregulluar në akte nënligjore mbi trajtimin e kërkesave për mbështetje financiare që vijnë pas thirrjes publike. Nga auditimi është konstatuar se për këto projekte të financuara jashtë procedurës së thirrjeve publike, procedura e miratimit ka filluar me dorëzimin e kërkesës së subjekteve përfituese në Ministri. Pas kësaj kërkesë hartohet nga DKFPK memo drejtuar Ministrit për mbështetje financiare dhe me propozimin për ngritjen e kolegjiut dhe sekretarisë teknike. Bashkëlidhur kësaj memo nuk gjenden anekset e standardizuara me dokumentacionet e domosdoshme për aplikuesit si në memot e hartuara për projektet me thirrje publike. Më tej procedura vijon me Urdhrin e Ministrit për ngritjen e kolegjiut dhe sekretarisë teknike dhe proces verbalin e kolegjiut me propozimin për financim të projektit firmosur nga anëtarët e kolegjiut, vendimin përkatës të kolegjiut dhe në përfundim Urdhrin e Ministrit për

mbështetje financiare. Nga auditimi është konstatuar se kjo procedurë e ndjekur për financimin e projekteve, e cila përfaqëson një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm përcaktuar në ligj për konkurrimin e aplikuesve dhe përzgjedhjen e atyre që do të financohen nëpërmjet një procesi transparent dhe publik, është e pa rregulluar në akte nënligjore dhe për rrjedhojë është e pa qartë se cilat janë kriteret e zbatuara nga strukturat përkatëse në zhvillimin e procedurës nga dorëzimi i kërkesës së aplikuesit te miratimi i financimit. Sikurse evidentohet edhe më sipër ka kërkesa të pa trajtuara dhe të trajtuara financiarisht për të cilat nuk evidentohet asnjë argument dhe dokumentacion justifikues mbi vendimmarrjen.

Nga auditimi i praktikave të përzgjedhura në kampionin e testimit sipas Aneksit nr. 2 të akt konstatimit është konstatuar sa më poshtë trajtuar. Nga shqyrtimi i 10 praktikave të projekteve jashtë thirrjeve, me vlerë totale financimi 33,780,000 lekë rezultoi si më poshtë:

- Në të gjitha rastet rezulton se nuk ka asnjë argumentim mbi nevojën urgjente apo të parashikueshme për financim jashtë rregullit të përgjithshëm, thirrjes publike në art kulture. Në programin e aktivitetit të subjektit aplikues, për projektin “T.FEST” citohet se “ky është një projekt që vijon që prej 2012”; ndërsa në projektin “Evidence për monumentet e kulturës” në kërkesë citohet si nevojë financimi projekti për evidentimin e një ngjarje që ka ndodhur 2 vjet më parë.
- Në 1 rast fusha e veprimtarisë së aktivitetit të OJF nuk ka natyrë art dhe kulture, referur akt themelimit dhe statutit, ndryshe nga sa përcaktohet në nenin 26 pika 1/a të ligji nr.10 352, datë 18.11.2010 “Për Artin dhe Kulturën”;
- Në 6 raste është financuar 100% e vlerës së projektit;
- Në 3 raste në dosje mungon kërkesa për financim e cila është hallka e parë e cila inicion një projekt jashtë thirrjes;
- Në 5 raste në dosje mungon programi i aktivitetit detajimi i projektit për financim;
- Nga 7 raste që subjekti është organizatë/OJF, në 4 mungon vërtetimi i tatimeve që subjekti nuk ka detyrime dhe në 2 raste gjendet vetëm kopje e NIPT-it.
- Në 1 rast në dosje nuk ka asnjë nga dokumentet e kërkuara për OJF-të dhe organizatat e kërkuara në procedurat e realizuara me thirrje publike.
- Nga 8 dosjet e zbatimit që u shqyrtuan rezulton se në to gjenden dokumentet justifikues sipas parashikimeve të nenit 6 të kontratës “Financimi dhe modalitetet e pagesës”, por në 2 raste u konstatuan mangësi si më poshtë vijon:

1. Projekti “Para dhe pas tërmetit - Evidence për monumentet e kulturës” i subjektit Qendrës “T.E” me vlerë 3,200,000 lekë.


Nga grupi i auditimit u konstatua se subjekti nuk ka marrë paradhënie, likuidimi i nënkontraktëve nëpërmjet llogarive bankare është bërë pas datës 13.03.2023, datë në të cilën është bërë likuidimi i subjektit “T.E”, në datë 24.05.2023. Referuar raportit përfundimtar rezulton se projekti e ka shtrirë veprimtarinë e tij 6 site: Kalaja e Bashtovë, Muzeu Etnografik në Kavajë, Kulla Veneciane në Durrës, Hamami në Durrës, Muzeu Arkeologjik Durrës dhe Kisha e Shën Andonit në Kepin e Rodonit. Kontrata mban datë 21.12.2022 ndërsa raporti përmbledhës datë 30.12.2022, pra gjithsej projekti ka zgjatur 10 ditë. Nga verifikimi rezulton se janë paguar dieta në vlerën 100,000 lekë për dy persona nga stafi organizues. Si dokument justifikues për zërin 2 të preventivit “*Dieta për stafin organizator*” janë paraqitur urdhër shërbimet me destinacion Kavajë të cilat citojnë udhëtimet në datat 01.12.2022-05.12.2022 dhe 07.12.2022-11.12.2022, për znj. E. Z, dhe datat 15.12.2022-19.12.2022 dhe 21.12.2022-25.12.2022, për znj. K.B. Nga sa më sipër rezulton 16 nga ditët e udhëtimit janë jashtë periudhës në të cilën është zhvilluar projekti. Përveç kësaj është llogaritur si dietë ditore 5,000 lekë/ditë, bashkëngjitur urdhër shërbimit nuk ka fature akomodimi në hotel. Veprimet si më sipër janë në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010, “Për trajtimin

financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” të ndryshuar kreu **III. Trajtimi financiar i punonjësve për përballimin e shpenzimeve të shërbimit bëhet i diferencuar, sipas distancës së shërbimit nga qendra e punës, si më poshtë vijon: 1. Për shërbime në një largësi deri në 50 km jashtë qendrës së punës, trajtimi financiar i punonjësit përfshin vetëm shpenzimet e transportit, në rastin kur transporti nuk realizohet nga vetë institucioni**, Ligji nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, neni 50, pika 1/h. “Shpenzimet të cilat tejkalojnë kufijtë e përcaktuar me ligj apo me akte nënligjore në fuqi, pika 1/k) “Shpenzimet për pagat, shpërblimet dhe forma të tjera të të ardhurave personale që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e punës, të paguara të punësuarve, duke përfshirë administratorët dhe **që nuk janë bërë nëpërmjet sistemit bankar** ose institucioneve të parasë elektronike të licencuara nga Banka e Shqipërisë; udhëzimi i MF nr. 26, datë 8.9.2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar pika l. Shpenzimet të cilat tejkalojnë kufijtë e përcaktuar me ligj apo me akte nënligjore. Kufizimi i dietave. Përfitimet e punonjësve të cilët, për nevoja pune të tatimpaguesi, dërgohen me shërbim jashtë vendit efektiv të punës kufizohen në: v. Paga për udhëtim brenda vendi, jo më tepër se çmimi i biletave interurban të miratuara për transportin publik. Shpenzimet e sipër cituara nuk duhet të njiheshin dhe si të tilla as nuk duhet të ishin paguar nga ana e strukturave përkatëse.

Projektet me thirrje publike dhe projektet jashtë thirrjes publike

Në grafikun më poshtë evidentohet në total mbështetja financiare për projektet e artit, kulturës dhe trashëgimisë nga Ministria për vitet 2022, 2023, 2024 dhe 2025 dhe në mënyrë të veçantë mbështetja nëpërmjet procedurës së thirrjeve publike dhe nëpërmjet procedurës jashtë thirrjeve publike.

Grafiku nr.2: Projekte me thirrje publike dhe jashtë thirrjeve publike



Burimi: DPAK dhe DAFTK

Sikurse evidentohet edhe në grafik, për vitin 2022 nga totali i vlerës së financimit prej 294,003,092 lekësh 48% janë alokuar nëpërmjet thirrjes publike dhe 52% jashtë thirrjes publike. Për vitin 2023 nga totali i vlerës së financimit prej 300,109,116 lekësh 65% janë alokuar nëpërmjet thirrjes publike dhe 35% jashtë thirrjes publike. Për vitin 2024 nga totali i vlerës së financimit prej 213,932,381 lekësh 58% janë alokuar nëpërmjet thirrjes publike dhe 42% jashtë thirrjes publike. Për vitin 2025 nga totali i vlerës së financimit prej 285,319,024 lekësh 92% janë alokuar nëpërmjet thirrjes publike dhe 8% jashtë thirrjes publike. **Pra përqindja e financimit të projekteve jashtë thirrjes ka ardhur me trend ulës, por pa një rregullim të qartë me modalitete dhe kriterë të caktuar.**

Përqindja e financimit të projekteve

Nga auditimi i evidencave të vendosura në dispozicion për projektet e financuara me thirrje publike dhe ato të financuara jashtë thirrjeve publike është konstatuar se projektet financohen nga Ministria

në përqindje të ndryshme të buxhetit të kërkuar duke filluar nga 50% deri në 100% të vlerës së kërkuar, por në disa raste edhe në 100% vlerës së projektit në total. Sa më sipër është konstatuar se nuk ka kritere të përcaktuara në akte nënligjore që rregullojnë vendimmarrjen për masën e financimit të projekteve dhe nuk evidentohen gjurme auditimi mbi këtë vendimmarrje nga kolegjiunet për të 4 vitet e audituara.

Projekte të miratuara për individ brenda dhe jashtë thirrjeve publike

Nga auditimi i evidencave të projekteve të mbështetura financiarisht brenda thirrjeve dhe jashtë thirrjeve është konstatuar se janë financuar në vlerën 225,503,400 lekë 312 projekte për individë të detajuar sipas viteve në tabelën më poshtë dhe detajuar në aneksin nr. 3 të akt konstatimit, në kundërshtim për përcaktimet e nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 25/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10352 datë 18.11.2010 për artin dhe kulturën” në të cilën përcaktohet se:

“1. Ministria përgjegjëse për artin dhe kulturën, nga fondi buxhetor i miratuar për çdo vit, financon:

a) projekte të paraqitura nga persona fizikë, juridikë, vendas ose të huaj, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre artin dhe kulturën”.

Tabela nr.4: Projekte individësh lekë

Nr.	Viti	Numër projektsh	Vlerë projektsh
1	2022	72	51,893,400
2	2023	108	103,170,000
3	2024	57	27,040,000
4	2025	75	43,400,000
	Totali	312	225,503,400

Burimi: DPAK dhe DAFTK

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacini me shkresën nr.951/27 datë 13.03.2026, nga znj.Ll. M, znj.A.P, znj.I. P, z.G. B, znj.E. B, znj.V. D dhe znj.L.V ku janë shprehur objeksionet si më poshtë vijon.

Pretendimi i subjektit: Referuar rekomandimeve të dhëna në kuadër të këtij auditimi nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, ju falënderojmë për vlerësimet dhe rekomandimet e paraqitura, të cilat i konsiderojmë një kontribut të rëndësishëm në drejtim të përmirësimit të kuadrit rregullator dhe të forcimit të praktikave administrative në institucionin tonë. Në këtë kuadër, ju bëjmë me dije se Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit ka nisur procesin e punës për përgatitjen e ndryshimeve ligjore në ligjin nr. 10352, datë 18.11.2010, "Për artin dhe kulturën", i ndryshuar. Ky proces është parashikuar gjithashtu në Planin e Përgjithshëm të Punës së Këshillit të Ministrave (PPAP) për vitin 2026, me synim miratimin e ndryshimeve gjatë katërmujorit të fundit të këtij viti. Ndryshimet e propozuara synojnë përmirësimin dhe plotësimin e kuadrit ligjor që rregullon procedurat e mbështetjes financiare për projektet artistike dhe kulturore, si dhe forcimin e mekanizmave që garantojnë transparencën, standardizimin dhe mirëadministrimin e fondeve publike në këtë fushë. Paralelisht me këtë proces dhe në funksion të adresimit të rekomandimeve të dhëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, deri në momentin e miratimit të ndryshimeve ligjore, Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit ka ndërmarrë disa masa konkrete administrative për përmirësimin e procedurave që lidhen me menaxhimin dhe administrimin e thirrjeve publike për mbështetje financiare në fushën e kulturës. Në këtë drejtim: a) Me Urdhrin e Ministrit nr. 150, datë 25.02.2026, është miratuar Rregullorja "Për mënyrën e funksionimit të Kolegjiunet në fushën e veprimtarive artistike dhe kulturore", e cila përcakton më qartë organizimin, funksionimin dhe procedurat e vendimmarrjes së këtij organi në procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të projekteve. b) Me Urdhrin e Ministrit nr. 198, datë 10.03.2026, është miratuar Kontrata Tip "Për mbështetje financiare me fonde publike", në fushën e kulturës, me qëllim standardizimin e marrëdhënieve kontraktore

ndërmjet institucionit dhe përfituesve të mbështetjes financiare, si dhe rritjen e transparencës dhe përgjegjshmërisë në administrimin e fondeve publike. Sa më sipër, masat e ndërmarra përbëjnë hapa konkretë në drejtim të adresimit të rekomandimeve të paraqitura në projekt-raportin e auditimit dhe tregojnë angazhimin e institucionit për përmirësimin e mëtejshëm të praktikave administrative në këtë fushë. Në përfundim, ju sigurojmë se "Institucioni ynë do të vijojë të ndjekë në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e masave të ndërmarra, me qëllim adresimin e plotë të rekomandimeve të dhëna dhe përmirësimin e mëtejshëm të praktikave administrative." Bashkëlidhur gjeni dokumentacionin,

Qëndrim i grupit të auditimit: Sa trajtuar më sipër grupi i auditimit vlerëson angazhimin serioz të MTKS në hartimin dhe zbatimin e menjëherëshëm të planit të masave në zbatim të rekomandimeve të draftuara në PR, realizimi i të cilave do të jetë subjekt vlerësimi në përmbushje të afatit 6 mujor.

Regjistër i veçantë për projektet dhe inventarizimi dosjeve

Nga auditimi është konstatuar se nuk është mbajtur një regjistër i veçantë nga zyra e protokoll arkivës, por edhe strukturat përkatëse sipas kompetencës sikurse përcaktohet edhe në urdhrat e Ministrit për ngritjen e Kolegjiumeve, me qëllim evidentimin e plotë dhe të saktë të këtij aktiviteti. Gjithashtu është konstatuar se për secilën praktikë aplikimi dhe miratimi projekti nuk ka inventarizim të dosjeve me dokumentacionin e detyrueshëm për dokumentim në sipas përcaktimeve të nenit 19, pika 1 të Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, në mbështetje të ligjit nr.9154, datë 06.11.2003 *"Për arkivat"*.

Javët kulturore ndërkombëtare

Prej vitit 2022 në zbatim të politikave dhe strategjisë për artin dhe kulturën ish Ministria e Kulturës dhe më pas ish MEKI kanë ideuar dhe më pas realizuar programin *'Javët Kulturore Ndërkombëtare'* të organizuar në bashkëpunim me shtetet pjesëmarrëse. Në të 4 edicionet e realizuara është synuar arritja e objektivave si më poshtë vijon:

- Promovimi i përhershëm i Shqipërisë, si një destinacion mikpritës, tërheqës dhe autentik, për zhvillim të qëndrueshëm të potencialeve ekonomike, natyrore dhe sociale të vendit, në funksion të turizmit kulturor;
- Edukimi mbi dialogun ndërkulturorë dhe tolerancën, qytetarinë vepruese, vlerat demokratike, angazhimin shoqëror, duke rritur kështu kompetencat e artistëve të rinj në praktikimin e vazhdueshëm të kulturës së tolerancës në komunitetet ku jetojnë;
- Vlerësimi dhe promovimi i të gjitha iniciativave të artit dhe kulturës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
- Inkurajimi i pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të komuniteteve në sektorët e artit, kulturës dhe trashëgimisë;
- Zhvillimi i aktiviteteve masive dhe cilësore;
- Mirëkuptimi dhe bashkëpunimi midis institucioneve dhe artistëve nga kultura të ndryshme;
- Përmirësimi i bashkëpunimit me Ambasadat, me qëllim realizimin në kohë dhe me cilësi nga ana e tyre të programit të javëve respektive.

Për sa i përket tipologjisë së aktiviteteve të javëve kulturore, theksojmë fushat multikulturore, si: *Koncert / muzikë; Balet / kërcim / valle popullore / flamenco / performancë; Shfaqje teatrale; Shfaqje filmi / kinema; Gastronomi; Ekspozitë; Aktivitete me fokus librin / letërsia; Aktivitet me fokus sportin / akrobaci / arte marciale; Trashëgimi Kulturore / folklor, kostumografi, etj.*

Ndër të tjera, “Javët Kulturore Ndërkombëtare”, si program në vetvete ka në fokus intensifikimin e marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe vendeve të tjera pjesëmarrëse, me qëllim promovimin e artistëve shqiptarë dhe Shqipërisë, si një vend me potencial të lartë artistik, e jo vetëm, përmes shkëmbimit të eksperiencave dhe intensifikimit të sektorëve artistik dhe industrive kreative. Grupi i auditimit ka kërkuar dhe i është vendosur në dispozicion informacioni i detajuar për buxhetin e planifikuar dhe realizuar të programit të javëve kulturore ndërkombëtare realizuar nga Ministria për vitet 2022, 2023, 2024 dhe 2025. Nga informacioni vendosur në dispozicion është hartuar tabela nr.5 më poshtë, e cila përmbledh këto të dhëna.

Tabela nr.5

lekë

Viti	Shpenzime të përgjithshme*	Shpenzime grupi i parë i shteteve	Shpenzime grupi i dytë i shteteve	Buxheti total	Realizimi vlerë	Realizimi %
2022	30,016,172	46,966,667	22,703,122	99,685,961	96,027,630	96
2023	23,590,836	37,489,144	71,507,529	132,587,509	120,785,092	91
2024	46,164,138	17,728,231	55,791,224	119,683,593	115,084,623	96
2025	32,152,800	24,361,252	33,412,644	89,926,696	54,337,429	60
Total	131,923,946	126,545,294	183,414,519	441,883,759	386,234,774	87

Burimi: DPAK dhe DAFTK

****Te shpenzimet e përgjithshme përfshihen shpenzime brandimi, pagesa kordinatorës dhe shpenzime për ceremoni hapje/mbyllje**

Sikurse evidentohet, të dhënat e buxhetit të planifikuar evidentuar në tabelë nuk përputhen me ato të pasqyruara në tabelën nr. 1 më sipër po ashtu të vendosura në dispozicion nga strukturat përkatëse. Nga auditimi është konstatuar se kjo veprimtari nis me hartimin e memos propozuese nga Drejtoria e Politikave për Artin dhe Kulturën drejtuar Ministrit dhe Sekretarit të Përgjithshëm në të cilën evidentohet nevoja dhe vlerat kulturore të këtij programi, si dhe propozimi për ngritjen e kolegjiut dhe sekretarisë teknike. Më tej vijon me Urdhrin e ministrit në të cilin përcaktohen anëtarët e Kolegjiut dhe ku përcaktohet se ngarkohet Kolegjiut të shqyrtojë projektin bazuar në memot dhe dokumentacionin plotësues të paraqitur nga drejtoria e përmbajtjes, të mbahen procesverbalet për shqyrtimin e projektit, si dhe të shqyrtohen dhe trajtohen çështje të tjera në funksion të projektit rast pas rasti referuar rregullores së Kolegjiut. Gjithashtu ka vijuar me memo për propozime konkrete të eventeve dhe shpenzimeve sipas nevojës më tej është mbledhur kolegjiut, i cili ka mbajtur procesverbalet përkatëse në vlerësimin e propozimeve dhe dokumentacionit të shqyrtuar sipas rastit, në bazë të të cilit ka nxjerr vendim me propozimet konkrete për Ministrin, vendim ky që është pasuar me urdhrat e ministrit për miratimin e realizimit të financimit të projektit JKN. Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për të 4 vitet e realizimit të JKN është konstatuar se edhe pse ky është një program i Ministrisë në bashkëpunim me përfaqësitë e huaja në zbatim të Strategjisë Kombëtare për Kulturën dhe politikave për mbështetjen e kulturës me fokus intensifikimin e marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe vendeve të tjera pjesëmarrëse dhe promovimin e artistëve shqiptarë dhe Shqipërisë, që përfaqëson një veprimtari të Ministrisë sipas fushës së saj të përgjegjësisë nuk është trajtuar si i tillë, por si projekt kulturor në kuptim të nenit 4 të ligjit nr.25/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10352 datë 18.11.2010 për artin dhe kulturën” dhe eventualisht edhe procedurat e ndjekura në miratim dhe zbatim të buxhetit respektiv. Nga auditimi i dokumentacionit të JKN është konstatuar se edhe pse programi “Javët Kulturore Ndërkombëtare” ka qenë një program i përvitshëm prej vitit 2022 planifikimi i aktiviteteve dhe buxhetit analitik nuk është realizuar në vitin paraardhës, por ka nisur në muajin prill të vitit korrent. Në zbatim të këtij program ka vijuar ekzekutimi shpenzimeve detajuar në aneksin nr.1 të PRA për vitet 2022, 2023, 2024 dhe 2025.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr.951/27 datë 13.03.2026, nga znj.A. P, znj.I. P dhe znj.S. Q, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë vijon.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me trajtimin dhe zbatimin e veprimtarisë "Javët Kulturore Ndërkombëtare (JKN)", si deri në momentin që do kemi miratimin e ligjit "Për Artin dhe Kulturën", sqarojmë se referuar rekomandimeve të lëna, MTKS aktualisht ka filluar punën për Rregulloren e funksionimit të Javëve Kulturore Ndërkombëtare. Në lidhje me konstatimin mbi zbatimin e procedurave të prokurimit për financimin e aktiviteteve në fushën e kulturës, sqarojmë se mbështetja financiare për projektet dhe veprimtaritë kulturore është trajtuar në përputhje me kuadrin ligjor specifik që rregullon fushën e artit dhe kulturës. Konkretisht, në përputhje me ligjin nr. 10352, datë 18.11.2010, "Për artin dhe kulturën", i ndryshuar, institucionet përgjegjëse kanë të drejtë të mbështesin financiarisht projekte dhe iniciativa kulturore në funksion të zhvillimit dhe promovimit të artit dhe kulturës. Në këtë kontekst, vlen të theksohet se Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 768, datë 15.12.2021, "Për përcaktimin e llojeve të shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike...", në nenin 1. pika 6, përcakton shprehimisht se grantet dhe projektet për kulturën përjashtohen nga zbatimi i këtij vendimi. Për rrjedhojë, financimi i projekteve kulturore nuk trajtohet si procedurë prokurimi publik për shërbime, por si mbështetje financiare për projekte kulturore, në zbatim të legjislacionit sektorial në fuqi. Në këto kushte, procedurat e ndjekura për mbështetjen financiare të projekteve kulturore janë realizuar në përputhje me kuadrin ligjor përkatës dhe nuk janë në fushën e zbatimit të procedurave të prokurimit publik të parashikuara në VKM Nr. 768, datë 15.12.2021 Për përcaktimin e llojeve të shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike, llojeve të shërbimeve të veçanta, për të cilat mund të rezervohet e drejta e pjesëmarrjes së organizatave në procedurat e prokurimit publik, si dhe rregullave të detajuara për prokurimin e tyre". Duke ju falenderuar, lutemi në marrjen në konsideratë të këtij materiali.

Qëndrim i grupit të auditimit: Sa trajtuar më sipër grupi i auditimit vlerëson angazhimin serioz të MTKS në hartimin dhe zbatimin e menjëherëshëm të planit të masave në zbatim të rekomandimeve të draftuara në PR, realizimi i të cilave do të jetë subjekt vlerësimi në përmbushje të afatit 6 mujor. Sa i takon argumenteve mbi procedurat e JKN konstatojmë se nuk ka informacion dhe dokumentacion shtesë nga sa administruar më pare, si dhe sqarojmë se shërbimet apo mallrat e ngjashme apo identike që prokurohen në institucione dhe Ministri të tjera janë subjekt i këtij ligji edhe në MTKS, dhe vetëm pjesa e shërbimeve të veçanta dhe specifike të fushës për të cilat është hartuar edhe një ligj i veçantë, pra ligji nr.10352, datë 18.11.2010, "Për artin dhe kulturën", realizohen në bazë të përcaktimeve të tij. Sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.

3. Projektet me VKM të veçanta

Grupi i auditimit ka kërkuar dhe i është vendosur në dispozicion informacion mbi projektet Art/Kulture/Trashëgimi të rregulluara me VKM të veçantë të cilat pasqyrohen në tabelën nr. 7 më poshtë. Për vitin 2022 ka patur vetëm një VKM me buxhetin më të madh për të 4 vitet në shqyrtim prej 200 milion lekësh, për vitin 2023 ka 1 VKM dhe për vitin 2024 ka 2 VKM, ndërsa për vitin 2025 nuk ka patur projekte me VKM të veçantë.

Tabela nr.7: Projekte me VKM të veçantë

Viti	VKM	Titulli projektit	Buxhet projekti	Buxhet i miratuar	Aplikues	Fitues	Realizim projekti
2022	Nr. 306 datë 11.05.2022	Art në hapësirat publike	200,000,000	224,615,923	139	7	208,389,738

2023	Nr. 228 datë 1304.2023	Festivali Folklorik Kombëtar, Gjirokastrë	130,065,200	130,000,000	1	1	125,315,300
2024	Nr. 32 datë 17.01.2024	Konkurs idesh për logon e 80 v. të çlirimit	350,000	350,000	64	1	?
	Nr. 324 datë 29.05.2024	Fushata "Unë jam shqiptar"	2,040,000	1,920,000	3	1	1,920,000
	Nr. 324 datë 29.05.2024	Evente rinore me këngë patriotike	3,018,000	2,703,000	3	1	2,703,000
2025	-	-	-	-	-	-	-

Burimi: DPAK dhe DAFTK

Grupi auditimit ka përzgjedhur për testim projektin “*Art në hapësira publike*” realizuar në zbatim të VKM nr. 306 datë 11.05.2022 “*Për procedurat që ndiqen për financimin e projekteve artistike*” me buxhet të planifikuar 200 milion lekë, 139 aplikues dhe 7 kontrata të lidhura. Procedura e ndjekur për shpërndarjen dhe ekzekutimin e buxhetit të këtij projekti vijon si më poshtë.

Nëpërmjet memos nr. 363 prot., datë 25.01.2022 Kabineti i Ministrit mbi realizimin e projekt-propozimit “*Art në Hapësira Publike*”, ka propozuar, me qëllim vijimin e projekt-idesë, realizimin e një agjende ndër-institucionale nëpërmjet titullarëve/niveleve të larta drejtuese, për bashkëpunim dhe identifikim të hapësirave publike të veçanta, me interes për rrjetin social dhe rrjetin rrugor kombëtar. Në këtë kuadër, janë kontaktuar institucionet e linjës si vijon: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë; Ministria e Turizmit dhe Mjedisit; Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Ministria e Arsimit dhe Sportit; Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Nëpërmjet shkresës nr. 659 prot., datë 08.02.2022 Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës znj. E.Ç., i ka dërguar kërkesë Bashkisë Tiranë për mbështetje të Qendrës së Restaurimit dhe Realizimit të Veprave të Artit, si një sipërmarrje e rëndësishme në realizimin e veprave të artit me materiale profesionale, mjete logjistike, atelie dhe kapacitete profesionale të mjaftueshme, për mundësinë e realizimit të veprave monumentale në hapësira publike, në përmasat që synon ky projekt, në mbështetje të VKM nr. 510 datë 18.07.2012 “*Për shpalljen e konkurseve kombëtare dhe ndërkombëtare për realizimin e veprave monumentale të artit pamor*”, kreun III, pika 3 i cili parashikon se: “*Qendra e Realizimit të Veprave të Artit (QRVA) do të jetë realizuesja më e parë për realizimin e monumentit, në rast se teknologjia e saj e mundëson një gjë të tillë*”. Në kuadër të bashkëpunimit me “A” mbi nevojat dhe prioritetet për ngritjen e kapaciteteve dhe zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta ndër-institucionale, duke marrë në konsideratë faktin se “*P A A S*” është një agjenci qeveritare që prodhon art publik, është vlerësuar si e nevojshme dhe e vlefshme dërgimi i kërkesë me nr. 642 prot., datë 07.02.2022 për mundësinë e përfitimit të ekspertizës nga ky institucion, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të punës në fushën e artit në hapësirat publike në vendin tonë. Në vijim të komunikimit ndër-institucional nga ana e Ministrisë së Kulturës janë paraqitur kërkesat e mëposhtme:

Kërkesë për bashkëpunim drejtuar 5 institucioneve të sipërcituara, nr. 543 prot., datë 01.02.2022; Në përgjigje të cilave kanë ardhur pranë Ministrisë së Kulturës shkresat si më poshtë:

-Shkresa e ardhur nga ARRSH, nr. 543/1 prot., datë 14.02.2022, nëpërmjet të cilës ARRSH ka sugjeruar si akse më të rëndësishme për instalimin e veprave të artit akset: Shkodër - Hani i Hotit, Rreth rrotullimi i Orikut, Unaza e Tiranës, Rruga e Kombit, Rruga e Arbrit.

-Shkresa nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, nr. 543/2 prot., datë 02.03.2022 ka propozuar emrat e pesë shkollave në të gjithë Shqipërinë si hapësira të mundshme ku mund të vendosen veprat e artit.

Në vijim, janë realizuar memo nga Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit Kulturor (DPSZHK), drejtuar Ministrit, si më poshtë:

Memo informuese nr. 642/1 prot., datë 18.03.2022 për mbështetjen që “A” ka shprehur parimisht për realizimin e ekspertizës, në përmirësimin e mëtejshmen të punës së artit në hapësirat publike në vendin tonë.

Memo nr. 363/1 prot., datë 23.03.2022, mbi fillimin e procedurës për projektin “*Art në Hapësira Publike*”, në të cilën shprehet se, pas identifikimit të hapësirave publike bazuar në propozimet e dhëna nga institucionet publike qendrore, do të ndiqen proceset e mëposhtme:

1. Ngritja e Grupit Ndërinstitucional të Punës, i cili përcakton përshtatshmërinë e hapësirës publike dhe parametrat e veprës së artit;
2. Ngritja e Kolegjiut, i cili bashkërendon punën me Grupin Ndërinstitucional të Punës, si dhe me çdo institucion të interesuar. Kolegjiu, krahas drejtuesve të sistemit të Ministrisë së Kulturës, asistohet nga ekspertë të fushës për hartimin e thirrjes publike të konkurrimit, sipas specifikave për çdo hapësirë publike;
3. Shpallja e konkursit kombëtar/ ndërkombëtar për realizimin e veprave të artit në hapësira publike, me afat dorëzimi të bocetit dhe projekt-idesë brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e shpalljes së konkursit;
4. Ngritja e Jurisë Kombëtare/ Ndërkombëtare, për vlerësimin e projekt-idesë, bocetit/ maketit, përfshirë fondin financiar dhe fazat e realizimit të projektit;
5. Njoftimi i fituesit dhe nënshkrimi i kontratës me artistin fitues;
6. Periudha e realizimit dhe instalimit të veprës/veprave të artit;
7. Inaugurimi i veprës/ veprave të artit.

Nga auditimi u konstatua se pavarësisht se Qendra e Restaurimit dhe Realizimit të Veprave të Artit Tirana në varësi të Bashkisë Tiranë nëpërmjet shkresës nr. 659/2 prot., datë 25.03.2022, z. A. R, Drejtor i Qendrës është shprehur se: “*Qendra e Restaurimit dhe Realizimit të Veprave të Artit Tirana disponon studio-atelie me kapacitet të mjaftueshëm për prodhimin e veprave monumentale të ideuar për hapësira publike. Kemi staf të kualifikuar dhe pajisje profesionale për realizimin e veprave në teknika të ndryshme si derdhje bronzi dhe metalesh të tjera, gdhendje guri mermeri graniti instalacione të ndryshme prej metali ose materiale të tjera duke cituar edhe listën e pajisjeve dhe aparaturave që disponojnë . Por sipas raportit narrativ mbi parashikimin për zhvillimin e projektit, pajisjet dhe hapësirat e nevojshme për realizimin instalacioneve, duhet të jenë shumë më të sofistikuara nga ato që Qendra e Restaurimit dhe Realizimit të Veprave të Artit Tirana, thotë se disponon. Referuar sa më sipër në memon nr. 363/1 datë 23.03.2022, DPSZHK shprehet se: “Në këto kushte të mos funksionimit të Qendrës së Realizimit të Veprave të Artit (QRVA), si institucion në varësi të Ministrisë së Kulturës, propozojmë ngritjen e një grupi pune për analizimin dhe vlerësimin e mundësive ligjore dhe administrative për realizimin e këtij projekti, si dhe duke qenë se projekti “Art në hapësirat publike” është një projekt me tipologji me të gjerë të artit kombëtare dhe ndërkombëtar (sikurse përcaktuar në seksionin “Tipologjia e veprave” dhe “Objektivat kryesore për realizimin e projektit”), është e nevojshme që të vlerësohet bazueshmëria në akte nënligjore në fuqi, në aspekt të përditësimit dhe përmirësimit të tyre.”. Nëpërmjet urdhrit nr. 363/2 prot., nr. 151, datë 23.03.2022, “Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin, rishikimin dhe hartimin e akteve nënligjore në kuadër të realizimit të projektit “Art në Hapësira Publike”, grupi i punës ka përgatitur relacionin përkatës me datë 30.03.2022. Më pas, është vijuar me zbardhjen e projekt-vendimit, po me datë 30.03.2022, i cili është përcjellë për mendim në të njëjtën datë. Pas procedurave të ndjekura për dhënie mendimi dhe pas dakordësisë së institucioneve përkatëse, është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 306, datë*

11.05.2022, *“Për procedurat që ndiqen për financimin e projekteve artistike”* i cili ndër të tjera në kreun IV. Dispozita të fundit pika 1, cton se *Vendimi nr. 510, datë 18.7.2012, i Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e konkurseve kombëtare dhe ndërkombëtare për realizimin e veprave monumentale të artit pamor në hapësirat publike”*, shfuqizohet. Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 306, datë 11.05.2022, *“Për procedurat që ndiqen për financimin e projekteve artistike”*, është iniciuar dhe administruar dokumentacioni sipas parashikimeve në këtë VKM. Në zbatim të urdhrin nr. 2778/1 prot., nr. 277, datë 18.05.2022, Grupi Ndërinstitucional i Punës, referuar edhe komunikimeve të zhvilluara, ka përgatitur dhe paraqitur Relacionin mbi vlerësimin e hapësirave të propozuara, në kuadër të projektit *“Art në Hapësira Publike”* (AHP), me nr. 3167 prot., datë 07.06.2022 sipas të cilit fillimisht janë vlerësuar 27 lokacioneve të propozuara nga ARRSH-ja dhe në përfundim është dakordësuar për propozim lista prej 18 hapësirash publike për realizimin e projektit AHP. Bazuar në relacionin e këtij grupi, është vijuar procedura me Urdhrin e Ministrit nr. 3167/1 prot., nr. 354, datë 09.06.2022, për miratimin e përcaktimit të hapësirave publike, të vlerësuara nga, për vendosjen e veprave të artit në kuadër të projektit AHP. Në zbatim të procedurave të përcaktuara në VKM nr. 306, datë 11.05.2022, procedurat *“Mbi ngritjen e kolegjiut në kuadër të projektit AHP”* dhe miratimin dhe mbulimin e shpenzimeve të Kolegjiut. Kolegjiu ka vijuar procedurat nëpërmjet mbajtjes dhe miratimit të dokumentacionit dhe me Vendimin nr. 1, nr. 2849/7 prot., datë 23.05.2022 është vendosur propozimi pranë Ministrit të Kulturës të procedurave për realizimin e planit të punës dhe hartimin e termave të thirrjes nga kolegjiu duke vlerësuar procedurat teknike dhe artistike të organizimit të konkurrimit publik ndërkombëtar për projektin *“Art në Hapësira Publike”* (AHP). Me Vendimin e Kolegjiut nr. 4, nr. 2849/19 prot., datë 20.06.2022, është paraqitur propozimi për shpalljes së konkursit ndërkombëtar për realizimin e projektit AHP/Materiali mbi shpalljen publike, duke përfshirë kriteret objektive. Pas këtij vendimi Ministri me Urdhrin nr. 2849/20 prot., nr. 379, datë 21.06.2022 ka urdhëruar shpalljen e konkursit ndërkombëtar, për realizimin e projektit AHP, materiale mbi shpalljen publike në gjuhën shqipe dhe anglisht. Në zbatim të urdhrin, është përgatitur shkresa nr. 3574 prot., datë 30.06.2022, për shprehjet e interesit, të cilat i janë përcjellë revistave ndërkombëtare të artit, bashkëngjitur komunikimet drejtuar faqeve ndërkombëtare për publikim. Me Urdhrin nr. 4429/1 prot., nr. 551, datë 19.08.2022, për ngritjen e Jurisë Ndërkombëtare për vlerësimin e projekteve më të mira artistike në kuadër të AHP, në të cilin është miratuar përbërja e jurisë si më poshtë: Z. H. Xh (Skulptor), Kryetar; Znj. F. P (Arkitekthe, kuratore), Anëtar; Z. M. B, (Historian arti, kurator), Anëtar; Z. B. S, (Historian arti, kurator), Anëtar; Z. G. H, (Piktor), Anëtar.

Me Urdhrin e Ministrit nr. 555, datë 22.08.2022, nr. 4511/1 prot., datë 22.08.2022 për ndryshim në urdhrin nr. 285, datë 20.05.2022 është përzgjedhur përbërja e Kolegjiut si në vijim: znj. M. P (Arkitekthe), Kryetar, z. D. Z (Artist), Anëtar, z. G. Gj (artist, kurator, menaxher arti), Anëtar, znj. D. A (Këshilltar Ministri), Anëtar dhe z. A. A, (Drejtor i Drejtorisë së Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Kulturës), Anëtar. Kolegjiu dhe Juria, në vijim të VKM nr. 306/2022, pas përfundimit të afatit të aplikimeve në kuadër të konkursit ndërkombëtar AHP, ka vijuar procedurat nëpërmjet:

Memos informuese nr. 4511/6 prot., datë 23.08.2022 nga DPAK / Sekretaria Teknike, drejtuar Kolegjiut mbi projekt - propozimet e paraqitura në kuadër të përfundimit të aplikimeve të konkursit AHP, ku citohet se janë paraqitur gjithsej 139 projekt-ide nga artistë shqiptar dhe të huaj. Procesverbal nga Kolegjiu nr. 2, mbi shqyrtimin dhe përcjelljen e listës së artistëve që kanë shprehur interes në kuadër të konkursit AHP pranë jurisë ndërkombëtare, nr. 4511/7 prot., datë 29.08.2022; Vendim i Kolegjiut nr. 2, nr. 4511/8 prot., datë 29.08.2022, për përcjelljen e listës

së artistëve tek juria ndërkombëtare. Vlerësimet nga juria të projekt aplikimeve janë bërë nëpërmjet e-maileve datë 31.08.2022 nga z. H. Xh, datë 02.09.2022 nga znj. F. P datë 04.09.2022 nga z. B. S, datë 05.09.2022 – z. M.B dhe datë 06.09.2022 – z. G. H. Me Vendimin e Jurisë nr. 4511/11 prot., datë 06.09.2022 është bërë kualifikimi i 30 projekteve për në fazën e dytë të cilit i janë bashkëngjitur edhe pikëzimet e jurisë për secilin nga 132 projektet e vlerësuara. Me Urdhrin nr. 592, datë 06.09.2022, Ministri ka urdhëruar shpalljen e projekt-ideve të kualifikuara nga juria ndërkombëtare për fazën e dytë të konkursit AHP.

Faza e II:

Pas komunikimit me artistët aplikues mbi vendimmarrjen e Jurisë për fazën e parë të konkursit dhe në zbatim të VKM nr. 306/2022, është vijuar faza e dytë e konkursit AHP 2022, nëpërmjet veprimeve dhe dokumentacionit si më poshtë:

Nëpërmjet memos informuese nr. 5196 prot., datë 23.09.2022 Sekretaria Teknike drejtuar Kolegjiumit, mbi paraqitjen e dokumentacionit plotësues nga artistët për projekt-idetë e kualifikuara në fazën e dytë.

Procesverbal nr. 3 i Kolegjiumit, për dërgimin e projekteve tek Juria Ndërkombëtare, nr. 5196/1 prot., datë 04.10.2022.

Procesverbal i Jurisë, nr. 5196/2 prot., datë 04.10.2022; mbi vlerësimin e 30 projekt-ideve nëpërmjet sistemit të pikëzimit (5 në gjuhën shqipe për secilin anëtar dhe 2 në gjuhën angleze për 2 anëtarë). Vendim i Kolegjiumit nr. 5196/3 prot., datë 04.10.2022 mbi vlerësimin e Jurisë. Procesverbal nr. 4 i Kolegjiumit, mbi vlerësimin e projekt-propozimeve, nr. 5196/4 prot., datë 05.10.2022; Shënim shtesë 2: Vlerësimi i pikëzimit është kryer nga z. G. Gj, znj. M. P, z. A.A, z. D.Z dhe znj. D.A, datë 05.10.2022. Vendim i Kolegjiumit mbi kualifikimin përfundimtar të projektit fitues në kuadër të AHP, nr. 5196/5 prot., datë 05.10.2022 nëpërmjet të cilit Kolegjiumi ka vendosur propozimin pranë ministrit të Kulturës, për klasifikimin përfundimtar të artisteve konkurrues në kuadër të konkursit ndërkombëtar “Art në Hapësirat Publike”, ku jenë dërguar gjithsej 8 projekte si më poshtë vijon:

Tabela 8: Projektet Fituese të Konkursit Ndërkombëtar "Art në hapësirat publike" për vitin 2022

Nr.	Artisti fitues	Përshkrimi i projektit	Vendndodhja
1	K. K	Projekti: Meteor"	Rreth-rrotullimin Golem (plazh), Kavajë, me kordinata N 41°14'51.9" E 19°31'12.9"
2	L. R	Projekti: "Wolf Coming"	Rreth-rrotullimin Hyrje Koplik-Shkodër, Hani i Hotit, me koordinata N 42°11'33.9" E 19°27'20.1"
3	E. K	Projekti: "Mbërritja e Zogjve"	Kryqëzimi/ mbikalimi "Pallati me Shigjeta", Tiranë, me koordinata N 41°19'17.9" E 19°47'22.1
4	K. H	Projekti: "Terminal OF Tirana"	I vendosur në hyrje të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza"
5	S. S	Projekti: "Zabel"	Rreth rrotullimin dalje Koplik, Hani Hotit Shkodër
6	B. B	Projekti: "Përpykja e vazhdueshme"	"Mali i Robit"
7	V. Dh	Projekti: "Foleza"	Mbikalimi Plepa, Durrës, përballë Tropikal
8	A. M	Projekti: "Albanian Key"	Rreth rrotullimi Bypassi Lindor i Shkodrës

Burimi: MEKI, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Urdhri i Ministrit të Kulturës nr. 702, datë 17.10.2022, nr. 5196/6 prot., 17.10.2022 “Për miratimin e projekteve fituese të konkursit ndërkombëtar AHP”, të propozuara nga Kolegjiumi me në vendimin nr. 5196/5 prot., datë 05.10.2022. Shkresa e njoftimit për publikim në Buletinin e Njoftimeve, nr. 5196/7 prot., datë 20.10.2022. Lidhur me këtë procedurë pranë Ministrisë së Kulturës janë paraqitur 6 ankime nga pjesëmarrës të s’kualifikuar, pas të cilëve me shkresën nr. 6045 prot., datë 03.11.2022 është paraqitur pranë Ministrisë së Kulturës nga znj. B. B kërkesa për

dorëheqje nga ky konkurs, duke iu referuar ankimit publik ndaj veprës. Shqyrtimi i ankesave është bërë nga grupi i ngritur në zbatim të urdhrit të Ministrit të Kulturës nr. 730 datë 27.10.2022 *“Për ngritjen e grupit të punës për shqyrtimin e ankimimeve të paraqitura në kuadër të vlerësimit të konkursit ndërkombëtar “Art në hapësirat publike” 2022* i cili ka marrë në shqyrtim të gjitha ankesat e fazës së parë dhe të dytë të vlerësimit të projekteve, duke qenë se të gjitha ankimet, sipas grupit, kanë qenë brenda afatit të ankimit të parashikuar në VKM 306/2022. Gjithsej janë administruar 8 ankesa dhe pas shqyrtimit të tyre ka hartuar Relacion nr. 6164 prot., datë 08.11.2022 drejtuar Ministrit dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës. Në përfundim për secilin ankues janë dhënë argumentet dhe kanë kthyer përgjigjet e ankesave si dhe është proceduar me propozimin për ndryshim të Urdhrit të Ministrit të Kulturës nr. 702, datë 17.10.2022, duke qenë se artistja znj. B. B ka kërkuar tërheqjen nga konkursi.

Nga auditimi u konstatua se procedura e njoftimit të urdhrit nr. 592, datë 06.09.2022, *“Për shpalljen e projekt-ideve të kualifikuara nga juria ndërkombëtare për fazën e dytë të konkursit AHP”* është bërë në faqen zyrtare të uebi-t të Ministrisë së Kulturës, në datën 7 Shtator 2022 me titull *“Shpallja e fituesve të fazës së parë të konkursit ndërkombëtar “Art në hapësira publike”* Ndërsa publikimi i Urdhrit të Ministrit të Kulturës nr. 702, datë 17.10.2022 *“Për miratimin e projekteve fituese të konkursit ndërkombëtar AHP”*, është bërë në datën 18 Tetor 2022 me titull *“Lista e projekteve fituese në kuadër të konkursit ndërkombëtar, “Art në hapësira publike” 2022.* Nga verifikimi rezulton se asnjëri nga këto njoftime nuk përmban informacion në brendësi. Por bazuar në pikën 13 të kreut II të VKM nr.306 datë 11.05.2022 *“Për procedurat që ndiqen për financimin e projekteve artistike”*, i cili citon se *“Ministri përgjegjës për artin dhe kulturën miraton projektin fitues, i cili publikohet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për artin dhe kulturën dhe Buletin e Njoftimeve Publike, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga data e shpalljes së fituesit”*, publikimi i listës së fituesve të projektit *“Art në hapësira publike” 2022* është bërë në Buletin nr. 146 datë 24 Tetor 2022.

Sa trajtuar më sipër, është paraqitur observacioni nga znj. I. P, Drejtor Drejtorie i Politikave për Artin dhe Kulturën, dhe znj. S. Q specialiste, me shkresën nr. 244/38 prot., datë 13.03.2026 protokolluar në KLSH me nr. 951/27 prot. datë 13.03.2026, në lidhje me sa trajtuar në projekt raport nr. 244/36, datë 18.02.2026, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

Pretendimi i subjektit:

Sa konstatuar në këtë pjesë të raportit, DPAK i është drejtuar me datë 26.02.2026 AKSH-it me email elektronik, duke kërkuar bashkëpunimin e tyre për zgjidhjen e kësaj problematike, me qëllim verifikimin dhe mundësimin e aksesueshmërisë së materialeve në fjalë brenda publikimeve zyrtare. Në përgjigje të AKSHI-it, jemi informuar se *“Nga verifikimi rezulton se problematika e konstatuar lidhet me postime të vjetra të migruara nga website-i i mëparshëm (kultura.gov.al) në faqen mtk.gov.al.*

Si pasojë e procesit të migrimit dhe e përditësimeve të platformës, disa element teknike nuk janë njohur nga konfigurimi aktual i faqes ç’ka ka sjellë mosshfaqjen e plotë të përmbajtjes për disa postime. Pas kryerjes së update të faqeve përkatëse informacioni afishohet”.

DPAK ka kryer verifikimin në faqen zyrtare të MTKS nga ku rezulton se dy publikimet e sipërcituara në datat 7 shtator dhe 18 Tetor 2022 janë tashme të aksesueshme.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin e paraqitur më sipër, sqarojmë se në analizën dhe vlerësimin e situatës nuk merren në konsideratë zhvillimet dhe faktet e reja të ndodhura pas periudhës së auditimit.

Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Pas dorëheqjes se njërit nga artistet projekti “Art në hapësira publike” ka vijuar për 7 fituesit e tjerë sipas anekseve bashkëngjitur PRA. Pavarësisht se fondi i miratuar në fillim për mbështetjen e këtij projekti ka qenë 200,000,000 lekë i cili është alokuar me Aktin normativ nr.3 datë 12.03.2022, gjatë viteve 2022-2024 ka pësuar ndryshime, shtesa dhe pikësime si më poshtë vijon:

Tabela 10: Ndryshimet buxhetore për "Art në hapësirat publike" lekë

Viti	Projekti	Titulli proj.	Buxheti i miratuar	Ndryshimet	Ndryshimet në vlerë	Totali
2022	91203 AM	Art në hapsirat publike	0	04-2022	200,000,000	200,000,000
			200,000,000	11-2022	-61,819,369	138,180,631
			138,180,631	11-2022	-36,720,000	101,460,631
2023			200,000,000	05-2023	-77,000,000	123,000,000
			123,000,000	11-2023	78,064,000	201,064,000
			201,064,000	12-2023	-100,000,000	101,064,000
2024			50,000,000	09-2024	7,300,000	57,300,000
			57,300,000	12-2024	43,075,160	100,375,160

Burimi: MEKI, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Në kuadër të realizimit dhe prezantimit të projektit "Art në hapësirat publike" janë zhvilluar edhe 4 procedura të tjera shërbimesh evidentuar si më poshtë vijon.

- 1 procedurë për “Shërbimin topografik me dron në kuadër të projektit AHP” me vlerë realizimi 980,000 lekë pa TVSH;
- 1 procedurë për “Eventin e lançimit të konkursit ndërkombëtar AHP” me vlerë realizimi 132,000 lekë pa TVSH;
- 1 procedurë për “Për organizimin e konferencës për shtyp për prezantimin e projekteve fituese” me vlerë realizimi 231,000 lekë pa TVSH ;
- 1 procedurë për “Shërbimit të përkthimit zyrtar të dokumenteve” me vlerë realizimi 500,000 lekë pa TVSH.

Këto shërbime janë trajtuar nga Ministria si projekte kulturore në kuptim të nenit 4 të ligjit nr.25/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10352 datë 18.11.2010 për “Artin dhe Kulturën” dhe eventualisht edhe procedurat e ndjekura në miratim dhe zbatim të buxhetit respektiv.

Nga grupi i auditimit u testua një dosje e zbatimit të projektit si më poshtë vijon.

1. Projekti Art në hapësirat publike "Terminal of Tirana" subjektit fitues artisti: K. H, Poloni / Menaxheri I Projektit: “Tirana Art Lab – Qendra për Artin Bashkëkohor (A. D)” me vlerë 35,622,586.1 lekë me TVSH.

- Sipas nenit 8 të kontratës pagesa do të bëhet e ndarë në tre pjesë, pjesa e parë, pagesë fillestare parafinancim prej 50% të shumës së kontratës, pjesa e dytë 25% të shumës së kontratës, pas marrjes në dorëzim të raportit përshkrues, dokumentacionit justifikues të aktivitetit si dhe shpenzime të kryera brenda 60 ditëve pas parapagimit të parë konfirmuar me kontrata shërbimi me të tretë, fatura tatimore të mbledhura sipas legjislacionit tatimor në fuqi. Pjesa e tretë e pagës 25% i paguhet përfituesit në përfundim të vendosjes përfundimtare të veprës fituese si dhe inaugurimit të saj. Me urdhër-shpenzimi nr. 587, datë 05.08.2024 është bërë likuidimi i shumës prej 5,000,000 lekë likuidim pjesor i faturës nr. 1/2024 datë 07.03.2024, e llogaritur si 25% e vlerës së kontratës nr. 1348 prot., datë 16.03.2023 të lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, përfaqësuar nga znj. Z.B, Sekretar i Përgjithshëm, në cilësinë e “Financuesit” dhe znj. K. H, shtetase Polake, artiste fituese e konkursit me veprën artistike me titull "Terminal of Tirana", në hapësirën publike në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” në Tiranë, në kuadër të edicionit të parë të Konkursit ndërkombëtar “Art në hapësirat publike” për fitin 2022, në cilësinë e “Përfituesit”.

Afati i realizimit të projektit sipas nenit 4 të kontratës është nga nënshkrimi kontratës deri me 31.08.2023. Bashkëngjitur këtij urdhër-shpenzimi gjenden të gjithë dokumentet justifikues sipas kërkesa dhe specifikimeve të kontratës. Likuidimit i diferencës së faturës 07.03.2024 është bërë me urdhër shpenzimin nr. 752 datë 24.09.2024.

4. Projektet e “Bonusit të rijetëzimit”

“Bonusi i rijetëzimit”, është pjesë e Fondit Kombëtar të Kujdesit të Trashëgimisë Kulturore Materiale përdoret për mbështetjen e politikës kombëtare të mbrojtjes ruajtjes dhe zhvillimin e vlerave të trashëgimisë kulturore materiale. Kjo nismë është një ndihmë në formë granti, për të gjithë ata individë që janë pronarë të një objekti në qendrat historike të qyteteve dhe kanë iniciativën për ta zhvilluar më tej atë duke kontribuar në zhvillimin ekonomik lokal. Bonusi i rijetëzimit ka si qëllim restaurimin dhe rijetëzimin e objekteve në qendrat historike zonave arkeologjike të qyteteve në mënyrë të qëndrueshme, apo duke gjeneruar të ardhura dhe punësim për komunitetin ose objekteve të veçanta me status pasurie kulturore. Aplikues për bonusit janë pronarët dhe përdoruesit e ligjshëm të pasurive të paluajtshme që janë pjesë e ansambleve historike urbane, qendrave historike, zonave arkeologjike ose objekteve të veçanta me status pasuri kulturore. Me anë të këtij bonusi i ofrohet aplikantëve mbështetje financiare për restaurim, mirëmbajtje, dhe përshtatje për zhvillim aktiviteti ekonomik në këto objekte. Për periudhën objekt auditimi 2022 – 2025, procedura e miratimit të fondeve të bonusit është realizuar në dy faza thirrjesh që janë “Bonus i Rijetëzimit 1” dhe “Bonus i Rijetëzimit 2”, respektivisht në vitin 2022 dhe 2023, ku gjatë kësaj periudhe struktura e Ministrisë së Kulturës nuk kishte një njësi të posaçme për administrimin e fondeve të parashikuara. Për të administruar këto thirrje u krijuan struktura AD-HOC me urdhër të ministrit për çdo vit, si përcaktohet në pikën 7/1 të VKM Nr. 737, datë 17.09.2020 “Për përcaktimin e rregullave për administrimin e fondit kombëtar të kujdesit të trashëgimisë kulturore materiale”, i ndryshuar, “...7/1 Deri në miratimin e strukturës përgjegjëse për administrimin e të ardhurave të Fondit, krijohet një strukturë Ad Hoc për administrimin e Fondit, e cila miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore...”. Në vitin 2024 sipas organikës së miratuar me Urdhër Kryeministri nr. 37, datë 19.02.2024, për Ish-Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (ish MEKI), ka përfshirë në strukturë Drejtorinë e Administrimit të Fondit të Trashëgimisë Kulturore, Artit, Kulturës dhe Projekteve, e cila ka në detyrat e saj menaxhimin dhe administrimin e të ardhurave të Fondit, si përcaktohet në pikën 5, 6 dhe 7 të VKM Nr. 737, datë 17.09.2020 “Për përcaktimin e rregullave për administrimin e fondit kombëtar të kujdesit të trashëgimisë kulturore materiale”, i ndryshuar, kjo strukturë brenda Ministrisë u plotësua dhe filloi të funksionojë në Gusht 2024. Objekt i financimit janë ndërhyrjet si më poshtë:

1. Ndërhyrje të mirëmbajtjes dhe konservuese në pasuritë e paluajtshme në pronësi private, të tilla si: mirëmbajtje, restaurim çatie, fasada, muraturë, porta, dritare. *Vlera e financimit deri në 1,000,000 lekë, si në 2022 dhe në 2023.*

2. Ndërhyrje për restaurim/ rijetësim të pjesshëm ose të plotë në pasuritë e paluajtshme, në pronësi private, që janë pjesë përbërëse e: - ansambleve historike urbane; - qendrave historike (QH); - zonës së mbrojtur në kufi me QH, që ka ndikim në peisazhin historik urban të saj; - lagjeve të banuara brenda mureve rrethues të kalave; - ose kanë statusin pasuri kulturore si objekte të veçanta jashtë këtyre zonave.

Vlera e financimit deri në 5,000,000 lekë (për vitin 2022) dhe 6,000,000 lekë (për vitin 2023).

Veprimtaria ekonomike e propozuar në aplikimet për financim, me karakter rijetëzues, në kuptim të Ligjit 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muze” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij,

mund të jetë, por pa u kufizuar, për shërbim hotelerie, dyqan souvenir/ artizanati/ antikuari/ bizhuterish, librari, videoteka, galeri arti dhe mjete pune, punishte, gastronomi për produktet vendase, pikë informacioni për turistët, agjenci turistike.

Procedura e aplikimit:

Procedura e aplikimit për të përfituar nga programi “Bonus për rijetësim”, për vitet 2022 – 2023, është realizuar online në sistemin e-Albania, shërbimi e-leje “Aplikim për leje ndërhyrje në pasuritë kulturore materiale dhe Bonus Rijetësimi”. Fazat që ndiqen janë si vijon:

- Aplikimet vijnë në vijim të shpalljes së thirrjes nga ish-MK.
- Aplikimet e bëra, paraqiten në sistemin e-lejet të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK) për tu administruar (regjistruar të dhënat e aplikantëve në databazën përkatëse), e më pas kalojnë për shqyrtim dhe miratim në KKTKM.
- Në përfundim të afatit të thirrjes vijohet me shqyrtimin dhe miratimin e aplikimeve.
- Aplikimet të cilat miratohen në KKTKM, përcillen pranë ish-MK për vijim të procedurave.
- Në Ministri krijohet struktura përgjegjëse Ad – Hoc, me Urdhër të Ministrit të Kulturës, e cila shqyrton aplikimet për përfitimin e bonusit të rijetëzimit.
- Struktura Ad-Hoc në rast se konstaton mungesë të dokumentacionit të aplikimit, por jo më shumë se 50% e tij, brenda 5 (pesë) ditëve pune bën me dije aplikuesin për plotësimin e dokumentacionit të munguar.
- Dokumentacioni i munguar duhet të dorëzohet nga aplikuesi brenda 5 (pesë) ditëve pune. Nëse aplikuesi nuk e sjell të plotësuar dokumentacionin të plotë, humbet të drejtën për të qenë pjesë e “Bonusit të Rijetëzimit”, por e vazhdon procesin për marrjen e lejes sipas procedurave të zakonshme të ofrimit të këtij shërbimi.
- Struktura Ad-Hoc brenda 45 ditësh nga data e përfundimit të afatit të Thirrjes bën vlerësimin e aplikimit referuar dokumentacionit shoqërues dhe projektit të miratuar nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale.
- Pas kësaj i paraqet për miratim ministrit listën me emrat e aplikuesve fitues dhe vlerën e financimit për mbështetje nga “Bonusi i Rijetëzim”, bën njoftimin e aplikuesve të përzgjedhur online, si dhe shpalljen e fituesve në faqen zyrtare online të Ministrisë së Kulturës.

Tabela 11: Bonusi rijetëzimit

Viti	Fondi i caktuar (Lekë)	Realizimi i fondit në %	Numri i aplikimeve	Numri i fituesve	Periudha e aplikimit	Urdhri për AD-HOC
2022	100,000,000	97%	96	41	09.05.2022 – 05.06.2022	Urdhri Nr. 101, datë 25.02.2022
2023	144,000,000	48%	98	58	30.01.2023 – 10.03.2023	Urdhri Nr. 193, datë 23.03.2023
2024	60,000,000	80%	-	-	-	-
2025	22,544,000	11.3%	-	-	-	-

Burimi: Të dhënat nga MTKS (ish-MK)

Grupi i auditimit ka përzgjedhur për testim 7 dosje nga evidencat 3 prej të cilave nga thirrja e vitit 2022 dhe 4 prej të cilave nga thirrja 2023, të cilat janë trajtuar si më poshtë vijon:

Për vitin 2022:

Urdhri i Ministrit nr. 101, datë 25.02.2022, “Për krijimin e strukturës Ad-Hoc, Për menaxhimin e fondit kombëtar të kujdesit të trashëgimisë kulturore materiale”, i cili sipas rregullores do të kryej vlerësimin e aplikantëve.

Në thirrjen e parë në vitin 2022, bazuar në vendimin e komisionit Ad – Hoc nr. 1087/11 prot., datë 29.07.2022 janë shpallur fitues 41 individë gjithsej. Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore,

me shkresën nr 1598/1 prot., datë 13.10.2022, protokolluar në MK me nr. 5665 prot., datë 14.10.2022, ka përcaktuar mbikëqyrësit dhe kolaudatorët e punimeve, për çdo kontratë.

A. Dosja nr.1 me aplikues F.GJ.

Konstatim:

Nga auditimi i dosjes vendosur në dispozicion grupit të auditimit u konstatua se:

a. Zbatuesi i punimeve nuk ka dokumentuar me licencë që të vërtetoj kryerjen e punimeve elektrike në kundërshtim me germa a pika 1 kreu III të VKM Nr.42, datë 16.1.2008 *“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”*, ku cilësohet se: *“...Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrojë veprimtari të caktuar, sipas: Kategorive të punimeve të zbatimit duke u mbështetur në profilin e diplomës universitare të individëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë...”*.

b. Referuar dokumentacionit teknik vënë në dispozicion grupit të auditimit, pjesë e dosjes, si projektit të miratuar nga KKTKM dhe specifikimeve teknike hidroizolimi i çatisë do të realizohet me letër katrama ndërsa referuar preventivit të punimeve do të realizohet sipas zërit H/izolim çatie me lesh guri ose polisterol mbi tavane dhe nën çati me konstruksione metalike dhe fletë mushamaje. Në dosje mungon korrespondenca mbi evidentimin e kësaj mospërputhje dhe dokumentacioni fotografik mbi mënyrën e realizimit të këtij detaji në kundërshtim me germa dh pika 16 kreu IV të VKM Nr. 1125, datë 30.12.2020, *“Për miratimin e rregullave të projektimit, zbatimit të punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të tyre”*, ku cilësohet: *“....Drejtuesi teknik i restaurimit ka këto të drejta dhe detyra: njofton menjëherë mbikëqyrësin e punimeve për pasaktësitë, mospërputhjet, mungesat e të dhënave në vizatimet, përshkrimet e specifikimet teknike, paraqet propozimet e veta dhe pret udhëzimet e tij...”*;

c. Në dosjen teknike mungojnë dokumentacioni si më poshtë:

- procesverbalet e punimeve të maskuara nuk janë të shoqëruar me foto/video;
- situacione pjesore për kryerjen e 70 % të punimeve;
- relacioni përfundimtar i detajuar i hartuar nga mbikëqyrësi i punimeve është vetëm për 70%, në dosje.

Sa më sipër është në kundërshtim me germën a pika 21 kreu IV të VKM Nr. 1125, datë 30.12.2020, *“Për miratimin e rregullave të projektimit, zbatimit të punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të tyre”*, ku cilësohet *“....Dokumentacionin administrativo-teknik...”*.

B. Dosja nr.2 me aplikues M.D.

Konstatim:

Nga auditimi i dosjes vendosur në dispozicion grupit të auditimit u konstatua se:

a. Zbatuesi i punimeve dhe mbikëqyrësi i punimeve i caktuar nga përfituesi nuk ka dokumentuar disponimin e licencës për punime restauratore në kundërshtim me pikën 1 neni 72 të Ligjit Nr. 27/2018 *“Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”*, ku cilësohet se *“... Projektimi, zbatimi, mbikëqyrja dhe kolaudimi i ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse të pasurive kulturore materiale kryhet nga subjektet e licencuara për këtë qëllim ose institucionet shtetërore të specializuara dhe të ngarkuara me ligj për mbrojtjen, ruajtjen dhe studimin e pasurive të trashëgimisë kulturore....”*.

b. Referuar dokumentacionit teknik vënë në dispozicion grupit të auditimit, nuk konstatohet asnjë dokument i dosjes teknike (si ditar, procesverbale, libreza masash ose dokumentacion fotografik) që të vërtetoj realizimin e punimeve si: Skelë me tubo fasade 8m, Panele metalike për skele, Shtrese termoizoluese me polisterol t=10 cm – për të cilën ne raportin e zbatimit të punimeve

theksohet është realizuar me fletë guajane 4 mm bituminoze e granular, në kundërshtim me pikën 2.8 të specifikimit teknike sipas projektit të miratuar nga KKTKM, ku cilësohet se: “...Kontraktori duhet të bëjë fotografi me ngjyra sipas udhëzimeve të Mbikëqyrësit të Punimeve në vendet e punës për të demonstruar kushtet e sheshit përpara fillimit, progresin gjatë punës së ndërtimit dhe mbas përfundimit të punimeve...”. Sa më sipër është në kundërshtim me pikën 17 kreu IV të VKM Nr. 1125, datë 30.12.2020, “Për miratimin e rregullave të projektimit, zbatimit të punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të tyre”, ku cilësohet “...Zbatuesi i punimeve mban procesverbale të shoqëruara me materiale fotografike ose filmike për të gjithë zërat e ndërhyrjeve, veçanërisht për punimet e maskuara...”; c. Në dosjen teknike mungojnë dokumentacioni si vijon:- akt dorëzimi i sheshit të ndërtimit; - libri i sigurimit teknik të punonjësve; - akt konstatime; - ditari i punimeve; - librezat e masave; - procesverbalet e punimeve të maskuara të shoqëruar me foto/video; - certifikatat e cilësisë së materialeve; - proces verbal i zbatimit të punimeve.

Sa më sipër është në kundërshtim me germën a pika 21 kreu IV të VKM Nr. 1125, datë 30.12.2020, “Për miratimin e rregullave të projektimit, zbatimit të punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të tyre”, ku cilësohet “...Dokumentacionin administrativo-teknik...”.

C. Dosja nr.3 me aplikues A.A.

Konstatim:

Nga auditimi i dosjes vendosur në dispozicion grupit të auditimit u konstatua se:

a. Zbatuesi i punimeve nuk ka dokumentuar me licencë që të vërtetoj kryerjen e punimeve elektrike në kundërshtim me germa a pika 1 kreu III të VKM Nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ku cilësohet se: “...Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrojë veprimtari të caktuar, sipas: Kategorive të punimeve të zbatimit duke u mbështetur në profilin e diplomës universitare të individëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë...”.

b. Referuar dokumentacionit teknik vënë në dispozicion grupit të auditimit, nuk konstatohet asnjë dokument i dosjes teknike që të vërtetoj realizimin e punimeve të cilat kanë një vlerë të madhe të situacionuar si: Restaurim mur guri me teknike shqep qep, Konsolidimi strukturor i themeleve egzistuese, në kundërshtim me pika 17 kreu IV të VKM Nr. 1125, datë 30.12.2020, “Për miratimin e rregullave të projektimit, zbatimit të punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të tyre”, ku cilësohet “...Zbatuesi i punimeve mban procesverbale të shoqëruara me materiale fotografike ose filmike për të gjithë zërat e ndërhyrjeve, veçanërisht për punimet e maskuara...”;

c. Në dosjen teknike mungojnë dokumentacioni si me poshtë:

- procesverbalet e punimeve të maskuara të cilat nuk janë shoqëruar me foto/video;
- certifikatat e cilësisë së materialeve.

Sa më sipër është në kundërshtim me germën a pika 21 kreu IV të VKM nr. 1125, datë 30.12.2020, “Për miratimin e rregullave të projektimit, zbatimit të punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të tyre”, ku cilësohet “Dokumentacionin administrativo-teknik...”.

Për vitin 2023:

Urdhri nr. 193, datë 23.03.2023, “Për krijimin e strukturës Ad-Hoc, Për menaxhimin e fondit kombëtar të kujdesit të trashëgimisë kulturore materiale”, i cili sipas rregullores do të kryej vlerësimin e aplikantëve. Në thirrjen e dytë në vitin 2023, janë shpallur fitues dhe janë financuar

58 individë gjithsej, bazuar në Urdhër nr. 478, datë 31.07.2023, nr. 1342/11 prot., “Për miratimin e listës përfundimtare të aplikantëve të kualifikuar fitues në kuadër të programit bonusi i rijetësimit, thirrja II” dhe Urdhër nr. 506, datë 22.08.2023, nr. 4405 prot., “Për financimin me fonde publike të projekteve fituese në kuadër të programit bonusi i rijetësimit thirrja II”. Vlera totale e financimit për përfituesit e bonusit të rijetësimit, thirrja II është përcaktuar gjithsej 198,469,730 lekë. Kjo vlerë është e ndarë në dy vite, për vitin 2023 vlera totale e financimit është përcaktuar në vlerën 142,513,529 lekë; dhe për vitin 2024 vlera totale e financimit është përcaktuar në vlerën 55,956,200 lekë. Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, me shkresën nr. 1053/2 prot., datë 29.09.2023, protokolluar në MK me nr.4441/1 prot., datë 02.10.2022, ka përcaktuar mbikëqyrësit dhe kolaudatorët e punimeve, për çdo kontratë.

D. Dosja nr.4 me aplikues G.Zh.

Konstatim:

Nga auditimi i dosjes vendosur në dispozicion grupit të auditimit u konstatua se:

a. Referuar dokumentacionit teknik vënë në dispozicion grupit të auditimit, pjesë e dosjes, në preventivin e punimeve të miratuar nga KKTKM, evidentohen zëra preventivi në shumë totale të pa specifikuar dhe detajuara, konkretisht Instalime Elektrike dhe Instalime Hidraulike në shumën totale prej 400,000 lekë pa TVSh secila. Duke qenë se dhe në situacionin përfundimtar këto dy zëra pune janë likuiduar në formë lump sum, duke mos evidentuar punimet që janë kryer brenda këtyre shumave, këto dy shuma duhet të detajoheshin me zëra pune në përputhje me manualët në fuqi të çmimeve në kundërshtim me germa b, (i), pika 21 kreu IV të VKM nr. 1125, datë 30.12.2020, “Për miratimin e rregullave të projektimit, zbatimit të punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të tyre”, ku cilësohet “...libreza e masave, ku pasqyrohen volumet faktike të punimeve. Libreza e masave mbahet për çdo objekt pasuri kulturore materiale, që ka preventiv dhe është dokumenti bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve, të kontratës dhe situacioneve. Në të pasqyrohen vëllimet metrike të punimeve dhe skica gradualisht me zhvillimin e tyre...”;

b. Në dosjen teknike mungojnë dokumentacioni si me poshtë:

- procesverbalet e punimeve të maskuara nuk janë të shoqëruar me foto/video;
- librezat e masave për situacionin pjesore për kryerjen e 70 % të punimeve;
- relacioni përfundimtar i detajuar i hartuar nga mbikëqyrësi i punimeve.

Sa më sipër është në kundërshtim me germën a pika 21 kreu IV të VKM Nr. 1125, datë 30.12.2020, “Për miratimin e rregullave të projektimit, zbatimit të punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të tyre”, ku cilësohet “....Dokumentacionin administrativo-teknik...”.

E. Dosja nr.5 me aplikues I.K.

Konstatim:

Nga auditimi i dosjes vendosur në dispozicion grupit të auditimit u konstatua se:

Në dosjen teknike mungojnë dokumentacioni si me poshtë:

- procesverbalet e punimeve të maskuara nuk janë të shoqëruar me foto/video;
- librezat e masave për situacionin pjesore për kryerjen e 70 % të punimeve.

Sa më sipër është në kundërshtim me germën a pika 21 kreu IV të VKM nr. 1125, datë 30.12.2020, “Për miratimin e rregullave të projektimit, zbatimit të punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të tyre”, ku cilësohet “....Dokumentacionin administrativo-teknik...”.

F. Dosja nr.6 me aplikues V.T.

Konstatim:

Nga auditimi i dosjes vendosur në dispozicion grupit të auditimit u konstatua se:

a. Referuar dokumentacionit teknik vënë në dispozicion grupit të auditimit, pjesë e dosjes, në preventivin e punimeve të miratuar nga KKTKM, evidentohen zëra preventivi në shumë totale të pa specifikuar dhe detajuara, konkretisht Instalime Elektrike dhe Instalime Hidraulike në shumën totale prej 500,000 lekë pa TVSh dhe 200,000 lekë pa TVSh, këto dy shuma duhet të detajoheshin me zëra pune në përputhje me manualët në fuqi të çmimeve.

b. Në dosjen teknike mungojnë dokumentacioni si me poshtë:

- procesverbalet e punimeve të maskuara nuk janë të shoqëruar me foto/video;
- librezat e masave për situacionin pjesore për kryerjen e 70 % të punimeve.

Sa më sipër është në kundërshtim me germën a pika 21 kreu IV të VKM nr. 1125, datë 30.12.2020, *“Për miratimin e rregullave të projektimit, zbatimit të punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të tyre”*, ku cilësohet *“....Dokumentacionin administrativo-teknik...”*.

G. Dosja nr.7 me aplikues XH.K.

Konstatim:

Nga auditimi i dosjes vendosur në dispozicion grupit të auditimit u konstatua se:

Në dosjen teknike mungojnë dokumentacioni si me poshtë:

- procesverbalet e punimeve të maskuara nuk janë të shoqëruar me foto/video;
- librezat e masave për situacionin pjesore për kryerjen e 70 % të punimeve.
- Akt kolaudimi dhe certifikata e marrjes në dorëzim të përkohshëm të objektit;
- relacioni përfundimtar i detajuar i hartuar nga mbikëqyrësi i punimeve. Në kundërshtim me germa a pika 21 kreu IV të VKM Nr. 1125, datë 30.12.2020, *“Për miratimin e rregullave të projektimit, zbatimit të punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të tyre”*, ku cilësohet *“....Dokumentacionin administrativo-teknik...”*.

2.6 Vlerësimi i Vlerësimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe veprimtarisë së Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm.

Në zbatim të pikës 6 të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni, si më poshtë:

- Dokumentacion i vënë në dispozicion nga MEI dhe MTKS lidhur me sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollin;
- Dokumentacion i vënë në dispozicion nga MEI dhe MTKS lidhur me veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm.

Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit pranë Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit u realizua bazuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*, i ndryshuar, Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, si dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të këtij ligji, sipas përcaktimeve të të cilit, menaxhimi financiar dhe kontrolli është një sistem politikash, procedurash, veprimtarish dhe kontrollesh, nëpërmjet të cilave burimet financiare janë planifikuar, drejtuar dhe kontrolluar, për të mundësuar dhe influencuar ofrimin me efikasitet dhe efektivitet të shërbimeve publike.

Kontrolli i brendshëm përbëhet nga pesë komponentë të ndërlidhur, të cilët ndërveprojnë me njëri-tjetrin, si më poshtë:

- Mjedisi i kontrollit;
- Menaxhimi i riskut;
- Aktivitetet e kontrollit;
- Informimi dhe komunikimi;

- Monitorimi.

Nëpërmjet VKM nr. 30, datë 17.01.2024, është përcaktuar fusha e përgjegjësisë shtetërore e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Në pikën 4 të këtij vendimi është vendosur shfuqizimi i VKM nr. 110, datë 02.03.2022 dhe VKM nr. 607, datë 20.10.2021, për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore, përkatësisht për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe për Ministrinë e Kulturës. Mjedisi i kontrollit përshkruan kushtet bazë të nevojshme për krijimin e një mjedisi të përshtatshëm kontrolli në një njësi të caktuar. Faktorët e mjedisit të kontrollit përfshijnë integritetin, vlerat etike dhe aftësinë e stafit të njësisë, filozofinë e drejtimit dhe stilin e punës, mënyrën sesi menaxhimi cakton përgjegjësi dhe të drejta dhe organizon e zhvillon stafin, si dhe përkushtimin dhe orientimet që jep niveli drejtues. Ky mjedis ndikohet më tej nga struktura organizative e njësisë dhe marrëdhëniet e llogaridhënies. Pas krijimit të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, nëpërmjet shkrijës dhe bashkimit të njësive brenda dy Ministrive, përkatësisht Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Kulturës, si dhe pas përcaktimit të fushës së përgjegjësisë shtetërore të MEKI-t nëpërmjet VKM nr. 30, datë 17.01.2024, nëpërmjet Urdhrit të Kryeministrit nr. 37, datë 19.02.2024, është miratuar struktura dhe organika e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Pavarësisht sa më sipër, Rregullorja e Brendshme e organizimit dhe funksionimit në MEKI është miratuar në vitin 2025, duke bërë që për më tepër se 1 vit, MEKI të operojë pa një rregullore të brendshme ku të përcaktohen qartazi detyrat dhe përgjegjësitë e punonjësve dhe njësive brenda MEKI-t, për të garantuar arritjen e objektivave institucionale. Në pyetësin e vetëvlerësimit për vitin 2024, drejtuar DPH/KBFB nëpërmjet shkresës nr. 3283/1 prot., datë 27.02.2025, citohet se *“Ministria ka rregullore të brendshme të miratuar nga titullari i institucionit nr. 92, datë 19.02.2020 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e brendshëm në Ministrinë e Kulturës”...”*. Pavarësisht ndryshimit të fushës së përgjegjësisë shtetërore, duke shtuar përgjegjësinë shtetërore lidhur me ekonominë dhe inovacionin, MEKI ka vijuar të konsiderojë Rregulloren e brendshme të dedikuar vetëm për ministrinë përgjegjëse për kulturën, pa kryer përditësimet e nevojshme. Nëpërmjet Urdhrit të Ministrit nr. 1042, datë 27.11.2024, është miratuar Kodi i Etikës së MEKI-t. Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këto objektiva do të realizohen. Menaxhimi i riskut mundëson vendimmarrjen cilësore, parashikimin më të mirë dhe optimizimin e burimeve në dispozicion, që kanë të bëjnë me prioritetet dhe shmangien e problemeve të ardhshme që mund të shfaqen për arritjen e objektivave të vendosura. Nga auditimi u konstatua se, për vitin 2024 nuk janë marrë masa për ngritjen e Grupit për menaxhimin e riskut, hartimin e regjistrit të riskut, nuk janë hartuar planet e veprimit për menaxhimin e riskut, dhe rrjedhimisht nuk është raportuar bazuar në planet e menaxhimit të riskut. Për vitin 2025, nëpërmjet Urdhrit të Ministrit nr. 647, datë 21.05.2025, i ndryshuar me Urdhrin nr. 767, datë 16.06.2025, është ngritur Grupi i Menaxhimit të Riskut. Nëpërmjet Urdhrit nr. 646, datë 21.05.2025, Sekretari i Përgjithshëm i MEKI-t ka deleguar procesin teknik të koordinimit të menaxhimit të riskut te Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve, proces i konkluduar me hartimin dhe miratimin e regjistrit të riskut.

Aktiviteti i njësisë së auditit të brendshëm

Për vitin 2022

Sipas Urdhrit të Kryeministrit nr. 164, datë 05.10.2017 *“Për miratimin e strukturës dhe të organikës së MK”*, njësia e auditimit të brendshëm pranë Ministrisë së Kulturës funksionon në

nivel sektori dhe përbëhet prej 3 punonjës, 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë. Pavarësisht plotësimit të vendit vakant në fund të muajit korrik 2022, pra plotësimit të numrit të punonjësve të sektorit sipas strukturës së miratuar, nga muaji gusht e në vijim sektori vazhdon të funksionojë me përbërjen 1+1, sepse specialisti jurist në datën 10.08.2022 u largua nëpërmjet dorëheqjes. Gjatë vitit raportues janar-dhjetor 2022 nuk është ngritur e për pasojë nuk ka funksionuar Komiteti i Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Kulturës. është përcaktuar programimi i llojit të angazhimeve të auditimit; plan i cili është rishikuar, në zbatim të përcaktimeve të çështjes 3.5 Rishikimi i planeve strategjike dhe vjetore të auditimit të brendshëm, të Kapitullit III, të Manualit të Auditimit të Brendshëm. Në planin vjetor të auditimit për vitin 2022, miratuar nga Ministri i Kulturës me shkresën 5276/2 prot., datë 18.10.2021, janë përfshirë 7 misione auditimi, nga të cilat 5 auditime të llojit “i kombinuar”, 1 një auditim i përputhshmërisë dhe 1 auditim tematik mbi zbatimin e rekomandimeve. Pas rishikimit, planifikimi konsiston në 5 misione, të realizuara si më poshtë vijon:

1. “Albafilm” sha, auditim i kombinuar;
2. Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore (DRTK) Tiranë, Berat; Gjirokastrë; Korçë, Vlorë; Shkodër, konsiderohet një angazhim auditimi i përputhshmërisë;
3. Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit (AQSHF), auditim i kombinuar;
4. Aparati i Ministrisë së Kulturës; iniciuar nga titullari;
5. Verifikim i zbatimit të rekomandimeve (2021).

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se janë hequr misionet e auditimit të planifikuara në (i) Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, (ii) Teatrin Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli” dhe (iii) Njësinë IPA, dhe është shtuar “Aparati i Ministrisë së Kulturës”, iniciuar nga titullari. Në raportin vjetor për vitin 2022 citohet se “*subjektet të cilat nuk janë audituar gjatë vitit 2022, janë planifikuar të auditohen gjatë vitit 2023*”.

Numri i rekomandimeve të dhëna gjithsej gjatë vitit 2024 është 85, prej të cilave 11 janë rekomandime për përmirësimin e sistemeve; 63 rekomandime janë të karakterit organizativ; 9 rekomandime janë për arkëtime dhe 2 janë rekomandime të tjera.

Për vitin 2023

Sipas Urdhrit të Kryeministrit nr. 164, datë 05.10.2017 “*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së MK*”, njësia e auditimit të brendshëm funksionon në nivel sektori dhe përbëhet prej 3 vetë, 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë. Gjatë vitit 2023 sektori ka funksionuar me përbërjen 1+1. Në planin vjetor të auditimit për vitin 2023, miratuar nga Ministri i Kulturës me shkresën nr.5151/1 prot., datë 21.10.2022 janë përfshirë 6 misione auditimi, 5 prej të cilave janë të llojit “i kombinuar” dhe 1 auditim tematik mbi zbatimin e rekomandimeve. Gjatë vitit ushtrimor 2023, konkretisht në muajin maj, me kërkesë të titullarit është urdhëruar kryerja e auditimit pranë Muzeut Historik Kombëtar; angazhim i cili diktoi rishikimin e planit vjetor të auditimit gjatë muajit qershor 2023. Gjatë muajit dhjetor 2023, pas analizës në lidhje me realizimin e angazhimeve, u diktua sërish rishikimi i planit vjetor. Vlen të theksojmë se rishikimi i planit vjetor nuk ndryshoi numrin e angazhimeve të auditimit të planifikuara për vitin 2023, por ndryshoi subjektet e identifikuara për auditim. Pra, planifikimi fillestar i numrit të misioneve të auditimit ka qenë 6; pas rishikimit ky planifikim rezulton në 6 misione dhe realizimi është 6 misione, si më poshtë vijon:

1. Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit (QKLL), auditim i kombinuar;
2. Muzeu Historik Kombëtar (MHK), me kërkesë të titullarit;
3. Cirku Kombëtar (CK), auditim i kombinuar;
4. Teatri Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli” (TKEKS), auditim i kombinuar;
5. Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale (QKVT), auditim i kombinuar;

6. Verifikim i zbatimit të rekomandimeve (2022).

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se janë hequr misionet e auditimit të planifikuara në (i) Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, (ii) Teatrin Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor (TKOBAP) dhe (iii) Njësinë IPA, dhe janë kryer auditimet në (i) “Muzeun Historik Kombëtar”, me kërkesë të titullarit, (ii) Cirkun Kombëtar dhe (iii) Qendrën Kombëtare të Veprimtarive Tradicionale. Numri i rekomandimeve të raportuara gjithsej gjatë këtij viti është 168, prej të cilave 37 janë rekomandime për përmirësimin e sistemeve; 2 rekomandime janë për përmirësimin e kuadrit ligjor; 105 rekomandime janë të karakterit organizativ; 19 rekomandime janë për arkëtime dhe 5 janë rekomandime të tjera.

Për vitin 2024

Gjatë vitit 2024, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm (DAB), pjesë e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, me përbërje 1 drejtor, 2 përgjegjës sektori dhe 4 specialist audit, ka funksionuar, si më poshtë:

- Nga muaji janar 2024, për 8 muaj, DAB ka funksionuar me vetëm 1 specialist audit, pa drejtor dhe pa përgjegjës sektori.

- Në muajin gusht janë rekrutuar 2 specialistë audit, pra nga muaji gusht 2024 deri në muajin nëntor 2024 ka pasur në përbërje 3 specialistë audit, pa drejtor dhe pa përgjegjës sektori.

- Në muajin nëntor janë plotësuar vendet e drejtorit të DAB dhe një përgjegjës sektori (ngritje në detyrë nga nivel specialisti, duke krijuar një vakancë në pozicionet e specialistëve të AB).

Planifikimi i auditimeve për vitin 2024 përfshinte gjithsej 8 angazhime auditimi, si më poshtë:

1. Zyra e administrimit dhe koordinimit të Parkut Kombëtar Butrint, auditim i kombinuar;
2. TKOBAP, auditim i kombinuar;
3. Biblioteka Kombëtare, auditim i kombinuar;
4. Njësia IPA, auditim i kombinuar;
5. Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale (QKVT), auditim i kombinuar;
6. Auditim performance me temë “Sigurimi i integritetit të koleksioneve muzeore”;
7. Cirkun kombëtar, auditim financiar;
8. Verifikim i zbatimit të rekomandimeve.

Planifikimi vjetor për auditimet e miratuara të vitit 2024 ish-Ministria e Kulturës, nuk u realizua. Gjithashtu, nuk rezulton të jetë miratuar asnjë plan i rishikuar auditimi, kjo pasi në 17 janar 2024 u krijua ministria e re (MEKI), e cila ishte në proces rishikimi organik, ku ishte pjesë edhe drejtoria e auditimit të brendshëm. Në këto kushte, në raportin vjetor të aktivitetit të DAB pranë MEKI, gjatë vitit 2024 citohet se janë realizuar vetëm 4 (katër) misione auditimi, si më poshtë vijon:

1. Parku i Butrintit, me kërkesë të titullarit;
2. Parku Arkeologjik Apolonia Fier, me kërkesë të titullarit;
3. Teatri Kombëtar Operas dhe Baletit AP, auditim i kombinuar;
4. Shoqëria Albafilm sh.a, auditim i kombinuar.

Nga auditimi u konstatua se, 2 angazhimet e përfshira në raportim, përkatësisht Parku i Butrintit dhe Parku Arkeologjik Apolonia Fier, të cituara me kërkesë të titullarit, nuk janë angazhime auditimi, si linjë e tretë kontrolli. Nëpërmjet Urdhrave të Ministrit (i) nr. 536, datë 19.07.2024 dhe (ii) nr. 537, datë 26.07.2024, janë ngritur grupet e punës të inspektimit lidhur me veprimtarinë e zyrave të administrimit dhe koordinimit, përkatësisht (i) të Parkut Kombëtar Butrint dhe (ii) të Parqeve Arkeologjike Apoloni & Bylis, duke autorizuar ndër të tjerë z. F. I, specialist nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm. Në Urdhër specifikohet se ndër detyrat e grupeve të punës janë shqyrtimi i veprimtarisë së zyrave të administrimit, sa i përket shërbimeve të ofruara ndaj publikut lidhur me

aksesin në struktura, pajisjen me biletë, audioguidat, ciceronet, si dhe monitorimin e veprimtarisë ditore të biletarisë dhe administrimin e të gjithë dokumentacionit lidhur me përfitimin e këtyre shërbimeve nga publiku dhe administrimin e pamjeve filmike të kamerave të sigurisë në këto struktura. Përpos faktit se këto angazhime nuk kanë qenë misionet auditimi dhe rrjedhimisht nuk duhet të ishin raportuar si të tillë, në pikën 2.3 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit përcaktohen linjat e mbrojtjes së fondeve publike, ku në pikën 2.3.2 përcaktohet se *linja e dytë e mbrojtjes* përbëhet nga drejtues dhe punonjës të caktuar me funksione specifike, sikurse janë anëtarët e tjerë të grupeve të inspektimit të ngritura me Urdhrat përkatës të Ministrit, nga drejtoritë kryesore të menaxhimit pranë MEKI. Kjo linjë kontrolli është vendosur për të mbështetur menaxhimin duke sjellë ekspertizë profesionale, optimizimin e proceseve, kontrole të përputhshmërisë, si dhe monitorime menaxheriale krahas linjës së parë, për të ndihmuar në sigurimin e menaxhimit të efektshëm të riskut dhe kontrollit. *Linja e tretë e mbrojtjes*, sipas përcaktimit në pikën 2.3.3 të Manualit të MFK-së, nga ana tjetër, jep siguri për menaxhimin e lartë për përpjekjet e linjës së parë dhe të dytë, të pajtueshme me pritshmëritë e titullarit. *Auditimi i brendshëm* është një aktivitet i pavarur, që jep siguri dhe këshilla dhe është i projektuar për t'i shtuar vlerë dhe përmirësuar operacionet e njësisë, ku nominalisht citohet se *nuk lejohet të kryejë funksione menaxhimi operacional*. Si e tillë, linja e tretë është një siguri dhe jo një funksion menaxhimi, çka e ndan atë nga linja e dytë e mbrojtjes. Thënë këtë, pavarësisht se inspektimet e iniciuara me Urdhër Ministri janë një praktikë e mirë për të garantuar optimizimin e proceseve dhe sigurimin e menaxhimit të efektshëm të riskut dhe kontrollit, përfshirja e punonjësve të DAB-së në procese të tilla që i përkasin linjave të dyta të kontrollit është në kundërshtim me pikën 2.3.3 të Manualit të MFK-së. Për vitin 2024, DAB pranë MEKI-t nuk rezulton të ketë iniciuar dhe kryer angazhim auditimi lidhur me ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve, duke mos ndjekur zbatimin e 168 rekomandimeve të dhëna në 6 misionet e auditimit të realizuara përgjatë vitit 2023, në kundërshtim me UMFE nr. 42, datë 27.10.2020 “*Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik*”. Në Raportin vjetor për vitin 2024, vijon të evidentohet problematika lidhur me plotësimin e strukturës së DAB-së, ku citohet se “*Jo vetëm gjatë vitit raportues 2024, por që nga viti 2020 e në vijim, auditimi ka funksionuar vetëm me dy punonjës, pra me përbërjen 1+1. Në muajin gusht kjo drejtori u plotësua me 2 specialistë të tjerë dhe në nëntor u plotësua me 1 përgjegjës sektori dhe 1 drejtor auditimi... Referuar standardit 2030-Administrimi i Burimeve, sipas të cilit drejtuesi i auditimit të brendshëm duhet të sigurojë se burimet e auditimit të brendshëm janë të përshtatshme, të mjaftueshme dhe të shpërndara në mënyrë efektive për të përmbushur planin e miratuar, mund të jepet siguria për mjaftueshmërinë e burimeve; e pas arritjes së kësaj sigurie, mund të vazhdojmë me sigurinë për përshtatshmërinë e shpërndarjen në mënyrë efektive të tyre. Pamjaftueshmëria e burimeve njerëzore, e ndërthurur me vlerësimin e riskut reputacional e vendimmarrjen për fillimin e angazhimit të auditimit, ka sjellë pasojë në planin vjetor të vitit 2024; duke u ekspozuar ndaj riskut operacional të vetë njësisë së auditimit; pra në mos përmbushjen e plotë të objektivave*”.

Numri i rekomandimeve të raportuara gjithsej gjatë këtij viti është 70, prej të cilave 13 janë rekomandime për përmirësimin e sistemeve; 37 rekomandime janë të karakterit organizativ; 4 rekomandime janë për arkëtime dhe 16 janë rekomandime të tjera.

Për vitin 2025

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm (DAB) si pjesë e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit ka në përbërje 1 drejtor, 2 përgjegjës sektori dhe 4 specialistë auditimi, por që aktualisht funksionon me 1 drejtor, 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë auditimi për janar-shtator 2025.

DREJTORIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË MEKI								
								Janar – Shtator 2025
Nr	Subjekte të synuara për tu audituar	Auditime Gjithsej	Auditime te kryera	Auditime Jashtë Plani	Auditime te pakryera	Auditime te cilat do ndryshohet plani i audituar nga KLSH	Totali Përfunduar	Audituesit & Ecuria e Procesit
a.	1	2						
1	Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (I.K.T.K.)	1	1				1	Përfunduar
2	Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale	1			1			Në vazhdim
3	Inspektorati Shtetëror i Mbikqyrjes së Tregut (ISHMT)	1				1		Audituar nga KLSH 12.03.2025
4	Njësia IPA	1				1		Audituar nga BE
5	Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA)	1			1			Parashikuar të auditohet nga KLSH
6	Biblioteka Kombëtare	1			1			Pa audituar
7	Aparati i Ministrisë	1	1				1	Përfunduar
8	D.R.T.K. Gjirokastrë	1			1			Pa audituar
9	Qendra Muzeore Berat, Muzeu Ikonografik “Onufri” dhe Muzeu Etnografik Berat	1			1			MTKS
10	Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit	1	1				1	Ne fazën e Projekt raportit 9.9.25
11	Enti Kombëtar i Banesave	1				1		Anuluar, auditohet nga audit i tyre i brendshëm
12	Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB)	1	1				1	Përfunduar
13	Verifikim i zbatimit të rekomandimeve (2024-2025)	1	1				1	Përfunduar
14	Teatri Kombëtar Tematik	1		1			1	Përfunduar
15	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	1		1			1	Përfunduar
16	Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë	1		1			1	Përfunduar
17	Petrol Alba sh.a	1		1			1	Përfunduar
	Totali	17	5	4	5	3	9	

Për sa më sipër, nga 13 angazhime auditimi të planifikuara për vitin 2025, për 9-mujorin e vitin 2025 nga MEKI janë realizuar gjithsej 5 auditime. Gjithashtu, janë realizuar edhe 4 auditime jashtë planit. Nga 8 auditime të planifikuara të pakryera, 3 auditime janë përfshirë në kolonën “*Auditime për të cilat do të ndryshohet plani*”, pasi (i) ISHMT është audituar nga KLSH-ja, (ii) Njësia IPA citohet “*audituar nga BE*” dhe (iii) Enti Kombëtar i Banesave citohet “*anuluar pasi auditohet nga audit i tyre i brendshëm*”. Sa i përket 5 të tjera të pakryera, ato janë përkatësisht (i) Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Intelektuale, (ii) Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), (iii) Biblioteka Kombëtare, (iv) DRTK Gjirokastrë dhe (v) Qendra Muzeore Berat, Muzeu Ikonografik “Onufri” dhe Muzeu Etnografik Berat.

Konkluzione:

- DAB pranë MEKI-t ka operuar vazhdimisht me strukturë organizative të paplotësuar, duke ndikuar në realizimin vjetor të planit të auditimeve. Pamjaftueshmëria e burimeve të DAB, duke bërë që në grupet e auditimit të përfshihet edhe Drejtori i Drejtorisë dhe Përgjegjësi i Sektorit, ka pamundësuar gjithashtu rishikimin e brendshëm të cilësisë përtej nivelit të përgjegjësit të grupit të auditimit, sipas përcaktimeve në Kapitullin VII të Manualit të Auditimit të Brendshëm.

- Për vitin 2024, për shkak të ristrukturimit, DAB pranë MEKI-t ka funksionuar për rreth 8 muaj me vetëm 1 specialist audit, pa drejtor dhe pa përgjegjës sektori. Për 3 muaj të tjerë deri në nëntor 2024 ka funksionuar me 3 specialistë audit, sërish pa drejtor dhe pa përgjegjës sektori. Vetëm në muajin nëntor është plotësuar pozicioni i Drejtorit të Drejtorisë së Auditit të Brendshëm dhe i Përgjegjësit të Sektorit të Auditimit të Sigurisë (ky i fundit me ngritje në detyrë nga nivel specialist). Për shkak të mungesës së burimeve njerëzore, DAB nuk e ka zbatuar Planin vjetor të auditimeve, ku nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se ishin planifikuar 8 misione auditimi. Ky plan ishte miratuar në Ministrinë e Kulturës, përpara organizimit të ri si MEKI, dhe nuk rezulton të ketë dalë asnjë akt që shfuqizon apo ndryshon planin vjetor të auditimeve, në mënyrë të tillë që të përshtatet me aktivitetin dhe fushëveprimin e ri të Ministrisë për Ekonominë, Kulturën dhe Inovacionin. Në këtë kuadër, DAB gjatë vitit 2024 ka kryer vetëm 2 angazhime auditimi, përkatësisht në TKOBAP dhe Albafilm sh.a.

- Nëpërmjet Urdhrave të Ministrit (i) nr. 536, datë 19.07.2024 dhe (ii) nr. 537, datë 26.07.2024, specialisti i DAB-së është përfshirë në aktivitete të linjës së dytë të mbrojtjes, si grupe inspektimi për veprimtaritë e zyrave të administrimit të Parkut të Butrintit dhe Parkut të Apolonisë. Linja e tretë e mbrojtjes, sipas përcaktimit në pikën 2.3.3 të Manualit të MFK-së, nga ana tjetër, jep siguri për menaxhimin e lartë për përpjekjet e linjës së parë dhe të dytë, të pajtueshme me pritshmëritë e titullarit. Auditimi i brendshëm është një aktivitet i pavarur, që jep siguri dhe këshilla dhe është i projektuar për t'i shtuar vlerë dhe përmirësuar operacionet e njësisë, ku nominalisht citohet se *nuk lejohet të kryejë funksione menaxhimi operacional*. Si e tillë, linja e tretë është një siguri dhe jo një funksion menaxhimi, çka e ndan atë nga linja e dytë e mbrojtjes. Thënë këtë, pavarësisht se inspektimet e iniciuara me Urdhër Ministri janë një praktikë e mirë për të garantuar optimizimin e proceseve dhe sigurimin e menaxhimit të efektshëm të riskut dhe kontrollit, përfshirja e punonjësve të DAB-së në procese të tilla që i përkasin linjave të dyta të kontrollit është në kundërshtim me pikën 2.3.3 të Manualit të MFK-së.

- Për vitin 2024, konstatohet se DAB pranë MEKI-t nuk ka kryer angazhim auditimi për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna gjatë vitit 2023. DAB pranë MEKI-t ka realizuar auditimin për zbatimin e rekomandimeve gjatë vitit 2025 (për rekomandimet e dhëna 2024-2025), por nga të dhënat e vënë në dispozicion rezulton të jenë trajtuar gjithsej vetëm 37 rekomandime të dhëna pranë TKOBAP, ndërkohë që nuk është verifikuar ecuria dhe niveli i zbatimit të rekomandimeve për 168 rekomandime të dhëna gjatë vitit 2023 dhe 33 (70 gjithsej – 37 TKOBAP) rekomandime të tjera të dhëna gjatë vitit 2024.

IV. REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, u konstatua se për vitet 2022, 2023, 2024 dhe 2025 nuk evidentohet asnjë takim i dokumentuar i Grupit të Menaxhimit Strategjik, i zhvilluar me qëllim bashkërendimin e punës gjatë procesit të përgatitjes së PBA-ve dhe finalizimit të dokumentit përfundimtar të buxhetit, në kundërshtim me pikën 1 të nenit 27 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*”, i ndryshuar, si dhe me pikën 3, paragrafi 2.2.4 të Udhëzimit të MFE nr. 16, datë 20.07.2016, “*Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike*”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 , faqet 220-226 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: Titullari i Institucionit të Ministrisë përgjegjëse për kulturën për të garantuar saktësinë dhe plotësinë e të gjithë elementeve të PBA-së të marrë masa, që të kryhen të gjitha takimet e GMS, si dhe të jenë të dokumentuara të paktën 4 herë në vit.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi buxhetin e MEKI-t u konstatua një numër i konsiderueshëm rishikimesh buxhetore, shoqëruar me rishpërndarje fondesh. Konkretisht, në vitin 2022 janë kërkuar 30 transferime buxhetore, 3 prej të cilave janë miratuar me Akte Normativ (AN nr.3 datë 12.03.2022, AN nr.12 datë 29.07.2022 dhe AN nr.17 datë 01.12.2022), të cilat kanë prekur zëra të ndryshëm buxhetor. Gjatë vitit 2023 janë kërkuar 17 transferime buxhetore, 2 prej të cilave janë miratuar me Akt Normativ (AN nr. 5, datë 18.10.2023, AN nr.6 datë 14.12.2023) dhe për vitin 2024 janë kërkuar 20 transferime buxhetore 3 prej të cilave janë miratuar me Akte Normative (AN nr. 1, datë 21.02.2024; AN nr. 3, datë 28.08.2024; AN nr. 5, datë 19.12.2024).

Sikurse evidentohet më sipër, një pjesë e ndryshmeve rezultoi nga ndryshimet me akte normative të kryera nga Ministria e Financave dhe në raste të tjera janë ndryshime të iniciuara me kërkesat e vetë MEKI-t për rialokime të fondeve.

Numri i lartë i rishikimeve buxhetorë përgjatë vitit është tregues që ndikon negativisht efektivitetin e procesit të planifikimit buxhetor dhe me ndikim negativ në realizimin e treguesve të buxhetit.

Gjithashtu nga auditimi i rishikimeve të kërkuara, në disa raste u konstatua se nga institucioni dhe nga njësitë e varësisë nuk ka argumentim si: a) arsyet e mos planifikimit në kohën e përgatitjes së buxhetit; b) produktet, që përfitohen nga veprimtaritë, që do të financohen nga kërkesat shtesë; c) kontributin në qëllimet dhe objektivat e politikave; ç) zërat e tjerë të fondeve buxhetore të miratuara, që mund të reduktohen për të siguruar fondin e nevojshëm. Shumica e institucioneve të varësisë dërgojnë e-maile vetëm me kërkesën për rialokimin e kërkuar, shtim/pakësim në zëra të caktuar, pa kryer një analizim apo argumentim të këtyre kërkesave.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*” pika 71 dhe 75.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet 14-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit të marrë masa për një planifikim më të drejtë bazuar në vlerësime të shpenzimeve faktike dhe projekteve të ardhshme, me qëllim minimizimin e rishpërndarjeve pa cënuar realizimin e plotë të të gjithë zërave buxhetorë, si dhe për të siguruar që procesi i planifikimit të jetë efektiv dhe të pasqyrojë gjendjen reale të zbatimit të buxhetit. Çdo kërkesë

buxhetore nga institucioni qendror apo nga njësitë e varësisë të shoqërohen me argumentimin e duhur dhe elementët e përcaktuar në udhëzimin përkatës.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm u konstatua se kërkesat buxhetore për projekte të reja të investimeve publike brenda tavaneve buxhetore nuk janë shoqëruar me formularët F2-Formulari i Konceptimit të investimit për shpenzime administrative kapitale (FKISHAK, F3-Formulari i Konceptimit të Projektit të Investimit (FKPI), jo në përputhje me shtojcën 2,3 të VKM nr.887, datë 27.12.2022 “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”, i ndryshuar. Gjithashtu, kërkesat shtesë buxhetore për projekte të reja të investimeve publike nuk janë shoqëruar me formularin F-1 Formulari i Prezantimit të Projekt-Idesë (FPPI), jo në përputhje me shtojcën 1 të VKM nr.887, datë 27.12.2022 “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”, i ndryshuar. Nga auditimi është konstatuar se ka disa mungesa në analizën e programeve buxhetore ku janë evidentuar, mungesa e raporteve dhe analizave gjinore si pjesë e planit buxhetor afatmesëm, si dhe kryerjen e seancave dëgjimore me përfaqësues të shoqërisë civile, ku përkatësisht në programin “Tregu i Punës”, programi “Sigurimet Shoqërore” për të evidentuar përfituesit femra për secilin nga programet. Në disa raste treguesit e performancës në nivel qëllimi janë vendosur dhe në nivel objektiv, ku përkatësisht në programin “Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë” dhe programin “Mbështetje për mbikëqyrjen e tregut, infrastrukturës cilësisë dhe pronës industriale”, dy elemente të cilat janë krejtësisht të ndryshëm nga njëra tjetra. Gjithashtu është konstatuar se jo në të gjitha rastet janë shpjeguar dhe janë argumentuar kërkesat shtesë në relacionin përmbledhës siç është rasti i kërkesave shtesë në programet “Mbështetja për Zhvillimin Ekonomik” dhe “Strehimi” në kundërshtim me pikën 8 të kapitullit 1 të Udhëzimit të MFE nr.7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet 14-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1 Rekomandimi: Ekipet e Menaxhimit të Programeve në bashkëpunim me sektorin e buxhetit të marrin masa për plotësimin e të gjitha formularëve për kërkesat buxhetore për projektet e reja të investimeve, si brenda ashtu edhe jashtë tavaneve buxhetore,, duke argumentuar çdo kërkesë shtesë, si dhe për çdo program buxhetor të kryhet analiza gjinore.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për 7 projekte investimi të çelura në vitin 2024 me një vlerë prej 339,176,10 lekë, 2 projekte në vitin 2023 me vlerë 153,430,260 lekë, si dhe 2 projekte në vitin 2022 me vlerë 101,100,000 lekë, janë çelur pa ndjekur procedurat e ciklit të miratimit në kuadër të menaxhimit të mirë të investimeve publike, sipas përcaktimeve të VKM nr. 887, datë 27.12.2022, “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”, Aneksi 1.Këto projekte nuk kanë kaluar në procesin ligjor të miratimit të Planit Buxhetor Afatmesëm, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe Udhëzimet plotësuese “Për zbatimin e buxhetit” për vitin 2022, 2023 2024. Gjithashtu, u konstatuan projekte investimi në tejkalim të planifikimit në Programin Buxhetor Afatmesëm, konkretisht:

- Projekti i investimit – “Restaurimi për ndërtesën e Fondit të Bibliotekës Kombëtare (Faza1) është parashikuar në PBA 2022-2024 në shumën 14,500,000 lekë, dhe është realizuar në shumën 26,077,768 lekë, me një tejkalim në vlerën 11,112,671 lekë.

- Projekti i investimit – “Restaurim, Rikonstruksion dhe Rinovim i sallës Koncerteve ne Universitetin e Arteve, Tiranë) është parashikuar në PBA 2022-2024 në shumën 99,829,000 lekë, dhe është realizuar në shumën 171,252,114 lekë, me një tejkalim në vlerën 5,479,245 lekë.

- Projekti i investimit me kod 18AE707– “Rrjetëzimi i Piramidës Tiranë është parashikuar në PBA 2023-2025 në shumën 110,000,000 lekë, dhe është realizuar në shumën 448,039,000 lekë, me një diferencë prej 338,039,000 lekë në tejkalim të planifikimit;

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i bdryshuar dhe Udhëzimi Plotësues i MFE nr. , datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit 2023” pika 21.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet 14-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit të marrë masat e nevojshme në mënyrë që në periudhat në vijim të eliminohen praktikatat e çeljes së projekteve të reja pa kaluar në procedurat e ciklit të menaxhimit të investimeve publike, me qëllim respektimin e disiplinës buxhetore.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procesit të inventarizimit të aktiveve në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit u konstatua se sipas raportit të përgatitur nga komisioni i ngritur me Urdhrin nr. 7, datë 01.02.2024, identifikimi i mëtejshëm i aktiveve të përfshira në listën e magazinës “MK (Materiale konsumi)” nuk ka qenë i mundur, duke nxjerrë në pah mungesën e plotësisë së realizimit të procesit të inventarizimit, në drejtim të përcaktimit të sasisë dhe cilësisë së aktiveve.

Nga verifikimi i kartelave personale të punonjësve, mbi inventarin e aktiveve në ngarkim të tyre, rezultoi se në 15 raste punonjësit janë larguar nga puna dhe nuk kanë nënshkruar kartelat; në 14 raste gjendja kontabël ishte më e madhe se sa gjendja në përdorim e aktiveve dhe në 10 raste gjendja kontabël ishte më e vogël se sa gjendja në përdorim e aktiveve. Pra në 24 raste nuk ishin marrë masa për vlerësimin dhe sistemimin e kartelave të aktiveve. Gjithashtu nga raporti i sipër përmendur rezultoi një listë me aktive të konstatuara për nxjerrje jashtë përdorimit, si dhe një listë me kartela të punonjësve që kanë nevojë për veprime sistemuese, për të cilat nuk ishte ndërmarrë asnjë veprim, deri në përfundimin e auditimit në terren, në kundërshtim me pikën 87 të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar duke sjellë mangësi në paraqitjen e situatës reale të gjendjes pasurore në pasqyrat financiare të ministrisë pas riorganizimit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 40-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1 Rekomandimi: Nëpunësi autorizues i Ministrisë përgjegjëse për Kulturën dhe Ministrisë përgjegjëse për Ekonominë, të marrë masa për finalizimin e procesit të plotë të inventarizimit fizik të të gjitha aktiveve në pronësi të tyre, duke përfshirë aktivet në ngarkim të punonjësve, artikujt në magazinë, si dhe aktivet e evidentuara nga Komisioni i Inventarizimit si “jashtë funksionit”, të cilat pas përfundimit të inventarizimit të vijnë me procedurat e vlerësimit të mëtejshëm, deri në paraqitjen e gjendjes faktike në regjistrat kontabël.

Deri në fund të vitit 2026

6. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i saktësisë dhe ekzistencës, së elementëve të pasqyrave financiare të vitit 2024 të Ministrisë së Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) rezultoi se, pavarësisht bashkimit institucional të Ekonomisë pjesë e ish-Ministirsë së Financave dhe

Ekonomisë me Ministrinë e Kulturës, që prej muajit Janar 2024 me anë të VKM-së nr. 30, datë 17.01.2024, ky fakt nuk është reflektuar në pasqyrat financiare. Mungon evidentimi i aktiveve, të drejtave dhe detyrimeve që i përkasin asaj, si dhe reflektimin e situatës në regjistrat kontabël për të mundësuar një paraqitje reale të situatës në regjistrat kontabël, sipas përcaktimeve të pikën 26, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar. Llogaria e vetme e pozicionit financiar që është ndarë është llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” dhe procesi i ndarjes së aktiveve ka përfunduar me datë 17.10.2025.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 40-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1 Rekomandimi: Titullari i Ministrisë përgjegjëse për Kulturën dhe Ministrisë përgjegjëse për Ekonominë të marrin masat për të përfunduar ndarjen fizike mes dy ish Ministrive lidhur me të drejtat dhe detyrimet, si dhe të autorizojnë reflektimet e ndarjes në regjistrat kontabël, me qëllim përgatitjen e pasqyrave financiare që garantojnë paraqitjen e situatës reale të të drejtave dhe detyrimeve.

Deri në fund të vitit 2026

7. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i zërave të pasqyrës së pozicionit financiar të Ministrisë së Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) rezultoi si më poshtë:

-Për llogarinë 210 “Toka, Troje, Terrene”, i cili përfaqëson vlerën e tokë/ truall në pronësi të Ministrisë së Kulturës, rezultoi se nga ministria nuk disponoheshin kartela të sakta të regjistrimit të tokave dhe terreneve ku të pasqyrohet numri i pronësisë dhe vlera e tyre, (mungonin kartelat e regjistrimit të pronësisë në ASHK), në kundërshtim me nenin 6, pika 1, Ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” i ndryshuar .

Për llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione” kartelat nuk përmbanin informacionin e kërkuar për çdo zë siç kërkohet në pikën 30 të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

- Nga verifikimi i elementëve analitikë të llogarisë 231 “Për aktive afatgjata materiale” rezultoi e mbivlerësuar në shumën 9,754,680 lekë, pasi në këtë llogari janë përfshirë rikonstruksione dhe ndërtime mbi aktive të institucioneve në varësi të MEKI-t. Konkretisht, vlera e projektit “Restaurim dhe Muzealizimi i ish banesës së Toptanasve (Muzeu Besa)”, që i përket llogarisë 230, është regjistruar në mënyrë të dyfishtë edhe në llogarinë 231, në kundërshtim me kreu II, pika 18 e Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 8, datë 09.03.2018 “Procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar. Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” rezultoi e mbivlerësuar në shumën 10,993,406 lekë në pasqyrën e pozicionit financiar të datës, 31.12.2024 pasi dy zëra të saj ju referohen detyrimeve të lindura gjatë 2024 dhe si të tilla duhet të përfshiheshin në llogarinë 401 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”.

-Llogari 600 “Paga personel i përhershëm” ishte e mbivlerësuar me 5,363,461 lekë, kjo pasi në të janë përfshirë edhe pagesat e detyrimeve në zbatim të vendimeve gjyqësore për punonjësit e larguar nga puna. Llogaria 601 “Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore” paraqitej e nënvlerësuar me 3,493,083 lekë. Vihet re se vlera e sigurimeve të pasqyruara në PASH është e njëjtë me shumën e llogarisë 601 tek shpenzimet buxhetore janar-dhjetor 2024, pra nuk është marrë në konsideratë fakti që pagat e Janar 2023 janë shpenzime të periudhës 2023 dhe ato të Dhjetor 2024 i takojnë shpenzimeve të vitit 2024, në kundërshtim me normat e përcaktuara në pikën 10.3 të Udhëzimit nr. 23 datë 09.03.2014, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 49-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1 Rekomandimi: Titullari i Ministrisë përgjegjëse për Kulturën dhe Ministrisë përgjegjëse për Ekonominë të marrë masat e nevojshme organizative dhe administrative për përfundimin e procesit të regjistrimit të të gjitha pasurive të paluajtshme në pronësi të institucionit pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, duke garantuar pajisjen me dokumentacion të rregullt pronësie dhe pasqyrimin e saktë të tyre në regjistrat kontabël. Gjithashtu, të ngarkohen strukturat përgjegjëse për ndjekjen dhe monitorimin e këtij procesi, si dhe të sigurohet përditësimi periodik i të dhënave, në përputhje me legjislacionin në fuqi për administrimin e pronës shtetërore.

Në vijimësi

7.2 Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë përgjegjëse për kulturën të marrë masa për kryerjen e veprimeve korrigjuese në llogaritë përkatëse të shpenzimeve dhe në deklaratat tatimore, në retrospektivë, me qëllim pasqyrimin e informacionit sa më të plotë dhe të saktë në pasqyrat financiare.

Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa për kryerjen e veprimeve korrigjuese, duke reflektuar vlerat reale të shpenzimeve për paga dhe kontribute për vitin 2024 në pasqyrat financiare.

Brenda vitit 2026 dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i pagesave të kryera nga MEKI të gjeneruara nga sistemi SIFQ (961 urdhër shpenzime në total për vitin 2024), për respektimin e afatit të pagesave për detyrimet, afati 30 ditor, rezultoi se në 405 raste rezultoi shkelje e disiplinës buxhetore, për shkak të mos likuidimit në kohë të faturave tatimore, të cilat krijojnë premisa për lindjen e penalteteve, veprime në mospërputhje me nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor” i ndryshuar, si dhe UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 184.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 49-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1 Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë përgjegjëse për kulturën në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit të forcojnë monitorimin e zbatimit të afatit 30-ditor për pagesa, duke vlerësuar edhe mundësinë e krijimit të një mekanizmi automatik sinjalizimi në sistemin SIFQ për rastet që i afrohen afatit ligjor të pagesës.

Brenda vitit 2026 dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik dhe të konkurrimit publik në 3 raste (procedura me objekt “Ndërhyrje restauruese në Mozaikun e Tiranës”, me fond limit 154,901,302 lekë pa TVSH, procedura me objekt “Ndërtimi i një objekti/qendre të re multifunksionale në funksion të së ardhmes së edukimit artistik të fëmijëve në kryeqytet, pranë qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë dhe Teatrit të Kukullave”, me fond limit 1,035,362,461.19 lekë pa TVSH dhe procedura e konkurrimit publik me objekt “Ndërhyrje emergjente në objektin Monument Kulture Kategorja I “Ura e Matit”, me fond limit 46,663,423 lekë pa TVSH) u konstatuan parregullsi në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe në përcaktimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, të cilat nuk janë në përputhje me natyrën, përmasën dhe objektin e prokurimit dhe nuk i përshtaten procedurës së zhvilluar, në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenet 36 dhe 77, si dhe me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021, neni 78, pika 2, pasi janë vendosur kërkesa për kapacitete të paargumentuara teknikisht dhe të palidhura drejtpërdrejt me realizimin e kontratës, janë kërkuar profile

profesionale dhe eksperiencë pa analizë dhe argumentim mbi domosdoshmërinë e tyre, është përcaktuar numër minimal stafi teknik pa u bazuar në preventivin dhe grafikun e punimeve, si dhe janë vendosur kriteret kualifikimi që tejkalojnë dokumentet standarde dhe kufizojnë konkurrencën, duke cenuar parimet e barazisë dhe garantimit të konkurrencës.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.4 faqet 69-189 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1 Rekomandimi: Njësitë e prokurimit dhe njësitë e hartimit të dokumenteve të konkurrimit publik të marrin masa për përcaktimin e kriterëve për kualifikim gjithmonë në përputhje me objektin e kontratave, të argumentuara teknikisht, për të siguruar ekonomicitet dhe eficiencë në procedurat e prokurimit publik.

Në vijimësi

10. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrimit publik, në 3 raste, pasi operatorët ekonomikë të shpallur fitues nuk kanë përmbushur kriteret e veçanta dhe/ose të përgjithshme të kualifikimit të përcaktuara në DST/DSKP.

Këto mangësi lidhen me mosplotësimin e kërkesave për kapacitet ekonomik e financiar, mungesën e përvojës së mëparshme, mosdisponimin e licencave të nevojshme sipas ndarjes së punimeve në bashkim operatorësh, mospërmbushjen e kriterëve për licencim dhe eksperiencë në pasuri kulturore, si dhe mungesën e dokumentacionit për detyrimet tatimore dhe përputhshmërinë e objektit të veprimtarisë me objektin e kontratës. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 92, si dhe me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, pika 2.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.4 faqet 69-189 të Raportit të Auditimit)

10.1 Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor të marrë masa t’i kushtojë vëmendje të shtuar procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomikë nga Komisionet e Vlerësimit të Ofertave, me qëllim reduktimin e riskut të kualifikimit të operatorëve që nuk përmbushin kriteret e përcaktuara, si dhe shmangien e rrezikut për moszbatimin e kontratave në afatet dhe cilësinë e kërkuar.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratave (kontratat me objekt “*Loti I ‘Blerje pajisje për kabinetet Hoteleri – Turizëm*”, me vlerë 34,453,180 lekë pa TVSH; “*Loti II ‘Blerje pajisje për kabinetet e shërbimit të mjeteve të transportit*”, me vlerë 34,879,770 lekë pa TVSH; “*Loti III ‘Blerje pajisje për kabinetet Mekanike/Elektronike*”, me vlerë 46,290,500 lekë pa TVSH; “*Loti IV ‘Blerje pajisje për kabinetet bujqësore*”, me vlerë 30,786,500 lekë pa TVSH; si dhe kontrata me objekt “*Blerje pajisje TIK*”, me vlerë 30,920,000 lekë pa TVSH) u konstatua se në 4 raste komisionet e marrjes në dorëzim nuk kanë dokumentuar verifikimin e prodhuesit dhe vendit të origjinës së mallrave sipas ofertës dhe formularëve teknikë të paraqitur në fazën e ofertimit, në kundërshtim me nenin 107, pika 6, të Rregullores së Prokurimit Publik, me nenin 6.3 të kontratës nr. 15638/3 prot., datë 23.12.2024, si dhe me rekomandimet e Autoritetit të Prokurimit Publik; në 5 raste furnizimet nuk janë marrë në dorëzim nga komisionet e ngritura me urdhër përkatës, por nga persona të paautorizuar (punonjës të institucioneve përfituese), në kundërshtim me nenin 5.4 të kontratave përkatëse; si dhe në 1 rast, në kuadër të kontratës “*Blerje pajisje TIK*”, procesverbali i marrjes në dorëzim është nënshkruar pa pjesëmarrjen e specialistit të fushës, mallrat janë magazinuar dhe është pranuar fatura përkatëse pa përfunduar verifikimi teknik dhe pa shënimin “vlerë në ruajtje”, në kundërshtim me pikën 49 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për

menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, duke pamundësuar ndërmarrjen e hapave korrigjuese në rast të mospërputhjes me specifikimet teknike.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.4 faqet 69-189 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

11.1 Rekomandimi: Komisionet e marrjes në dorëzim të marrin masa për dokumentimin e verifikimeve të kryera për artikujt e furnizuar jo vetëm në raport me specifikimet teknike dhe kontratën e lidhur, por edhe me ofertën e pranuar gjatë fazës së procedurës së prokurimit.

Në vijimësi

11.2 Rekomandimi: Personi me përgjegjësi materiale të marrë masa për pranimin e artikujve në magazinë vetëm pas kryerjes së verifikimeve të nevojshme lidhur me përputhshmërinë e artikujve të furnizuar nga komisionet përkatëse të marrjes në dorëzim.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me kontratën me objekt “Ndërhyrje restauruese në Mozaikun e Tiranës, ndërtim godine”, viti 2022, rezultuan mangësi në drejtim të projektit të hartuar, në kundërshtim me parashikimet e bëra në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 5/1 “Përgjegjësia e projektuesit”, pika 3 gjerat a dhe b. Gjithashtu, rezultuan mospërputhje nga krahasimi i të dhënave mes relacionit dhe projektit konstruktiv, si dhe projektit As build (sipas faktit). Sa më sipër veprime në kundërshtim me parashikimet e bëra në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 4 Përgjegjësia e projektuesit, pikat 1, 3 dhe 4, VKM nr. 514/2007 e “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pikat 2, 3, 9, 11 dhe 12, Udhëzimin nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Struktura e kostos së punimeve të ndërtimit. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.4 faqet 69-189 të Raportit të Auditimit)*

12.1 Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sporteve, të merren të gjitha masat e nevojshme për hartimin e projekteve me terma të plotë reference me qëllim shmangien e ndryshimeve të paargumentuara gjatë fazës së zbatimit të kontratës, si dhe për lidhjen e kontratave të sigurimit të përgjegjësisë profesionale me hartuesit e projekteve me qëllim rritjen e garancive dhe zvogëlimin e riskut ndaj pasojave të pasaktësive në projektim. Gjithashtu, hartimi i raporteve të auditimit të energjisë të kryhet sipas projektit të zbatimit dhe jo vetëm sipas projekt-idesë fillestare.

Në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës me objekt “Ndërhyrje restauruese në Mozaikun e Tiranës, ndërtim godine”, viti 2022, rezultoi se gjatë zbatimit të saj janë miratuar dy rishikime të projekt-preventivit, të cilat nuk janë mbështetur me argumentim të plotë dhe nuk janë shoqëruar me sqarime tekniko-ekonomike. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu I, pikat 3.4, 7.3 dhe 8.2.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.4 faqet 69-189 të Raportit të Auditimit)

13.1 Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sporteve, të merren të gjitha masat e nevojshme për të argumentuar në nivel teknik dhe ekonomik ndryshimet e projekt preventivave të punimeve përpara miratimit të tyre, me qëllim garantimin e përdorimit me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve publike.

Në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës me objekt *‘Ndërhyrje restauruese në Mozaikun e Tiranës, ndërtim godine’* dhe *‘Restaurim, Rikonstrukcion dhe rehabilitimi i hapësirave në Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria e Arteve)’* u konstatua se punimet kanë nisur përpara dhënies së lejes së ndërtimit nga ana e KKT, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 107/2014 *“Për planifikim dhe zhvillim e territorit”*, i ndryshuar, neni 39 *Leja e ndërtimit*, pika 1. Gjithashtu, rezultoi se kjo e fundit, ashtu sikurse ajo me objekt *“Zbatimi i punimeve për restaurimin, rikonstrukcionin dhe rinovimin e sallës së koncerteve në Universitetin e Arteve në Tiranë”*, viti 2021, janë prokuruar sipas parashikimeve të bëra nga ligji nr. 27/2018 *‘Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë’*, VKM nr. 425/2020 *‘Për procedurat e përzgjedhjes së subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore’*, i ndryshuar si dhe Udhëzimit të Ministrit të Kulturës nr. 269, datë 11.08.2020 *‘Për miratimin e dokumenteve standarde të konkurrimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të pajisura me licencë, për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore’* pasi zona ku është parashikuar të realizohet investimi është Monument Kulture i kategorisë së parë (Mozaiku në Bllokun Partizani, I-07). Në fakt, sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, nga palët nuk janë marrë masat e nevojshme për miratimin në KKTKM të ndryshimeve në projekt – preventivët përkatës. Sa më sipër është në kundërshtim me parashikimet e bëra në Ligjin nr. 27/2018 *“Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”*, neni 38, pika 2, germa b, c, ç, VKM nr. 208/2019 *“Për përbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”*, kapitulli II, pika 13, kapitulli IV, pika 1, VKM nr. 1125, datë 30.12.2020 *“Për miratimin e rregullave të projektimit, zbatimit të punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të tyre”*, Kapitulli IV, pika 18 dhe 19. (Trajtuar më hollësisht në pikën 2.4 faqet 69-189 të Raportit të Auditimit)

14.1 Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sporteve, të merren masat e nevojshme për të siguruar që punimet të mos fillojnë apo të vijnë pa u pajisur më parë me të gjitha miratimet e kërkuara nga organet kompetente, si në fazën e nisjes së punimeve ashtu edhe gjatë zbatimit të ndryshimeve të tyre.

Në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratave për shërbime, rezultoi se në të paktën 3 raste, konkretisht në objektet *Ndërhyrje restauruese në Mozaikun e Tiranës, ndërtim godine, Ndërhyrje emergjente në objektin monument kulture Ura e Matit dhe Restaurim, Rikonstrukcion dhe rehabilitimi i hapësirave në Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria e Arteve)* nga ana e kontraktorëve të shërbimeve nuk është raportuar rregullisht në AK mbi zbatimin e kontratës së punimeve sipas parashikimeve të bëra në kontratat përkatëse të shërbimit të lidhura me AK. Sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 610, 22.09.2022 *“Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”*, neni 5, pika 1, neni 7, neni 8, neni 18, si dhe kontratat respektive të lidhura mes palëve.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.4 faqet 69-189 të Raportit të Auditimit)

15.1 Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sporteve, të merren të gjitha masat e nevojshme për të garantuar kryerjen e shërbimit dhe raportimit nga ana e mbikëqyrësve të

punimeve me qëllim sigurimin e informacionit të nevojshëm në drejtim të vendimmarrjes institucionale.

Në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës me objekt “Zbatimi i punimeve për restaurimin, rikonstrukcionin dhe rinovimin e sallës së koncerteve në Universitetin e Arteve në Tiranë”, viti 2021, rezultoi se mes palëve janë miratuar dy rishikime të projekt preventiv të kontratës nga të cilët i fundit prej tyre në vlerën prej 47,572,888 lekë me TVSH (gati 10 % e vlerës totale të kontratës), është kryer 14 ditë përpara datës së përfundimit të punimeve. Sa më sipër është në kundërshtim me parashikimet e bëra në nenin 29 Ndryshimi i Porosisë të kontratës së sipërmarrjes si dhe me Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, pika 7, nën pikat 7.1 dhe 7.3, VKM nr. 1125, datë 30.12.2020 “Për miratimin e rregullave të projektimit, zbatimit të punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të tyre”, Kreu IV, pika 5, germa b, pika 19, pika 20. Gjithashtu, në lidhje me këtë kontratë rezultoi se janë miratuar ndryshime të paargumentuara në mënyrë shteruese nga ana teknike dhe deri në përfundimin e punimeve të kontratës nuk janë respektuar specifikimet teknike për 3 zëra punimesh. Sa më sipër është në kundërshtim me parashikimet e bëra në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7/1, “Përgjegjësia e mbikëqyrësit”, pikat 1 dhe 2, neni 12, VKM nr. 610, 22.09.2022 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”, neni 1, pika 1, neni 7, neni 8, pikat 1 dhe 2, neni 12, neni 15, neni 22, VKM nr. 15.8.2007²⁷ “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me VKM nr. 664/2012, pika 1, 2, 3, 8, 9, 10 dhe 12, Udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu II, pika 3; Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, pika 1.2, 38.1, 8.2, 8.3, Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve e lidhur sipas aktit 3278/12 prot., datë 26.06.2021, Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve e lidhur sipas aktit me nr. 3580 prot., datë 07.07.2023, Kontratën e lidhur sipas aktit me nr. 904/12 prot., datë 02.04.2021 mes AK dhe BOE; Urdhrin e Titullarit për ndjekjen e kontratës; etj.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.4 faqet 69-189 të Raportit të Auditimit)

16.1 Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sporteve, të merren të gjitha masat e nevojshme për të miratuar ndryshimet e projekt – preventivëve të punimeve përpara realizimit në fakt të tyre. Miratimet të shoqërohen me relacione argumentuese e sqaruese duke përkrahur qartë nevojën, domosdoshëmrinë dhe përfitimet / përmirësimet që i sjellin AK këto ndryshime.

Në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratave për punë / shërbime rezultoi se nga ana e Ministrisë së Kulturës / Ministrisë së Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit, sot Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit nuk është ushtruar një kontroll dhe monitorim i rregullt dhe efektiv i ndjekjes së kontratave, duke shkaktuar si pasojë edhe mos vënien në shfrytëzim të aseteve.

²⁷ Aktualisht i shfuqizuar por në fuqi në momentin e realizimit të kontratës.

Konkretisht, në kontratën me objekt “*Restaurim, Rikonstruksion dhe rehabilitimi i hapësirave në Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria e Arteve)*” rezultoi se janë bërë ndryshime në kontratë për të shtyrë afatin e punimeve, por arsyet (argumentet) e dhëna për këtë shtyrje nuk janë bindëse, të forta ose të bazuara në prova thelbësore. Vonesat e shkaktuara si rrjedhojë e zgjatjes së afatit të punimeve, kanë ndikuar drejtpërdrejt edhe në mos vënien në shfrytëzim të galerisë, përmes të cilës janë parashikuar të gjenerohen të ardhura të konsiderueshme për buxhetin e shtetit (*sipas projeksioneve janë parashikuar nga 12,000,000 lekë për vitin 2026 deri në 56,000,000 lekë për vitin 2028*). Sa më sipër janë në kundërshtim me ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, Kreu II, neni 8, pikat 1, 8 germa a, c, ç, d, dh, e, ligjin nr. 27/2018 “*Për trashëgiminë kulturore*”, neni 3, pika 2, germa b, neni 4, pika 2, neni 11, pikat 1 dhe 2, neni 12, pika 1, neni 13 *Kompetencat e ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore*, germa k, neni 48, pikat 1 dhe 2, neni 72, pikat 1, 2 dhe 3, neni 79 pika 1, 2 dhe 4. (Trajtuar më hollësisht në pikën 2.4 faqet 69-189 të Raportit të Auditimit)

17.1 Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sporteve, të merren të gjitha masat e nevojshme për të rritur dhe intensifikuar përpjekjet në drejtim të kontroleve dhe monitorimit të rregullt të ndjekjes së kontratave, me qëllim vënien në shfrytëzim të aseteve sipas parashikimeve të plan buxheteve përkatës. Gjithashtu, përpara realizimit të amendamenteve në afat të kontratave, të kryhen analiza të sakta, të plota, shteruese dhe gjithëpërfshirëse të argumentuara në nivel teknik, me qëllim shmangien e qëndrimeve në dukje subjektive.

Në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Ministria përgjegjëse për kulturën nuk ka ndjekur dhe zbatuar në mënyrë efektive objektivat dhe masat e parashikuara në dokumentin strategjik për zhvillimin e artit dhe kulturës, duke mos siguruar përmbushjen e produkteve të planifikuara në drejtim të konsolidimit të kuadrit ligjor dhe institucional, si dhe nuk rezultoi të jetë ngritur një mekanizëm i dedikuar për ndjekjen, monitorimin dhe raportimin e zbatimit të strategjisë. Po ashtu, deri në përfundim të auditimit nuk rezultoi të jetë hartuar dhe miratuar strategjia e re sektoriale pas përfundimit të periudhës së mëparshme, duke krijuar një boshllëk planifikimi dhe orientimi për politikat publike dhe mbështetjen financiare në fushën e artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore.

Nga auditimi u konstatua se, pavarësisht menaxhimit të programeve buxhetore për artin, kulturën dhe trashëgiminë kulturore, nuk janë nxjerrë aktet nënligjore dhe aktet e brendshme rregullatore të nevojshme për zbatimin e plotë të kuadrit ligjor, duke munguar rregulla të qarta për procedurat e financimit, ndarjen e përgjegjësisë, gjurmët e auditimit, veprimtaritë e kontrollit dhe administrimin e dokumentacionit në kundërshtim me kërkesat e nenit 16, 19 dhe 22 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar, si dhe me kërkesat e Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (Kapitulli III), ku përcaktohen detyrimet për përcaktimin e procedurave të brendshme të dokumentuara, vendosja e aktiviteteve të kontrollit dhe sigurimi i gjurmës së auditimit për çdo proces që lidhet me administrimin e fondeve publike, duke sjellë dobësi në sistemin e kontrollit të brendshëm, mungesë transparence dhe gjurmueshmërie në vendimmarrje, si dhe rritje të riskut në administrimin e fondeve publike që nuk i nënshtrohen rregullave të prokurimit publik.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.5 faqet 189-220 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

18.1 Rekomandimi: Ministria përgjegjëse për kulturën të marrë masa për hartimin dhe miratimin e një kuadri të plotë rregullativ për financimin e artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore, duke përcaktuar qartë procedurat, kriteret dhe përgjegjësitë për përdorimin e fondeve publike, si dhe

duke formalizuar mekanizmat e kontrollit të brendshëm, gjurmët e auditimit dhe proceset e aplikimit, miratimit dhe monitorimit të financimeve, me qëllim garantimin e transparencës dhe menaxhimit efektiv të fondeve.

Menjëherë

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Urdhrit të Ministrit nr. 620, datë 13.05.2025 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit”, si dhe i rregulloreve dhe praktikave të ndjekura për vlerësimin dhe financimin e projekteve në fushën e artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore, u konstatua se kuadri i brendshëm rregullator nuk ka siguruar ndarje të qartë të detyrave dhe përgjegjësi për strukturat dhe pozicionet përkatëse, si dhe mungon një regjistër risku dhe analiza e rreziqeve për proceset e miratimit, zbatimit dhe monitorimit të shpenzimeve. Po ashtu, rregullorja e funksionimit të kolegjiemeve për vlerësimin e projekteve nuk përcakton kriteret dhe procedura të standardizuara për përzgjedhjen e anëtarëve, mënyrën e vlerësimit dhe vendimmarrjes, ndërsa veprimtaria e tyre nuk dokumentohet dhe nuk argumentohet në mënyrë të plotë, duke munguar gjurma e auditimit për diskutimet, vlerësimet dhe pikëzimin e projekteve. Financimi i projekteve është realizuar në përqindje të ndryshme (deri në 100% të vlerës), pa u mbështetur në kriteret të formalizuara dhe pa evidencë të gjurmueshme të arsyetimit të vendimmarrjes. Këto mangësi janë në kundërshtim me kërkesat e neneve 16, 19 dhe 22 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, si dhe me kërkesat e Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, dhe kanë sjellë dobësi në sistemin e kontrollit të brendshëm, paqartësi në ndarjen e përgjegjësi, mungesë transparence dhe gjurmueshmërie në vendimmarrje, si dhe rritje të riskut në administrimin e fondeve publike.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.5 faqet 189-220 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

19.1 Rekomandimi: Ministria përgjegjëse për kulturën të marrë masa për rishikimin e akteve të brendshme rregullatore, me qëllim mirëdokumentimin e ndarjes së detyrave, përgjegjësi dhe linjave të llogaridhënies për strukturat përkatëse, si dhe përmirësimin e instrumenteve të menaxhimit të riskut dhe të procedurave të përzgjedhjes e financimit të projekteve.

Menjëherë

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit dhe zbatimit të kontratave për financimin e projekteve në fushën e artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore u evidentuan disa mangësi në dokumentacione të kërkuar, referuar kërkesave të neneve 16 dhe 22 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, si dhe me kërkesat e Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.5 faqet 189-220 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

20.1 Rekomandimi: Ministria përgjegjëse për kulturën të marrë masa për standardizimin, formalizimin dhe digjitalizimin e procedurave të miratimit dhe zbatimit të kontratave për projektet e financuara në fushën e artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore, duke përcaktuar qartë dokumentacionin e detyrueshëm për çdo fazë të procesit dhe duke vendosur sisteme të strukturuar për administrimin dhe gjurmimin e tij, me qëllim garantimin e transparencës, rritjen e llogaridhënies dhe sigurimin e një gjurme të plotë auditimi për çdo vendimmarrje dhe ndryshim kontraktual.

Menjëherë

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i evidencave të projekteve të mbështetura financiarisht për individët nga ministria përgjegjëse për kulturën, me thirrje publike dhe jashtë thirrjeve publike, u konstatua se financimi i tyre ishte kryer në kundërshtim me nenin 4, pika 1 të Ligjit nr. 25/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, i cili parashikon që financimi të jepet për projekte të paraqitura nga persona fizikë ose juridikë që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre artin dhe kulturën. Në këto raste nuk evidentohet dhe nuk mundësohet verifikimi i plotë i këtij kriteri për individët përfitues, pasi mungon dokumentacioni që provon lidhjen e veprimtarisë së tyre me fushën e artit dhe kulturës, duke krijuar mungesë të bazës dokumentare dhe pamundësi për të garantuar përputhshmërinë e përfituesve me kërkesat ligjore për dhënien e fondeve publike.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.5 faqet 189-220 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

21.1 Rekomandimi: Ministria përgjegjëse për kulturën të shqyrtojë procedurat e financimit të projekteve, me qëllim përafrimin e praktikës me kriteret ligjore në fuqi, përmes qartësimit të kriterëve për aplikuesit dhe përmirësimit të kontroleve, në funksion të mirë përdorimit të fondeve publike.

Menjëherë

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për katër vitet e zbatimit të programit “Javët Kulturore Ndërkombëtare” (JKN) u konstatua se, pavarësisht se ky program përfaqëson një veprimtari institucionale të ministrisë përgjegjëse për kulturën, e realizuar në funksion të zbatimit të politikave publike dhe dokumenteve strategjike në fushën e kulturës, nuk është trajtuar dhe administruar si program institucional, por është konsideruar dhe zbatuar si projekt kulturor individual. Ky program nuk është as “*projekt i paraqitur nga persona fizikë, juridikë, vendas ose të huaj, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre artin dhe kulturën dhe as projekt dhe veprimtari artistike e kulturore, që konsiderohet i rëndësishëm së veçantë dhe që njëkohësisht me buxhet arrin mbi 40 për qind të fondit vjetor për projekte*” siç përcakton neni 26 i Ligjit nr. 10352 datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, i ndryshuar.

Si pasojë, procedurat e miratimit, planifikimit dhe zbatimit të buxhetit janë ndjekur sipas praktikave të financimit të projekteve, duke krijuar paqartësi në klasifikimin, administrimin dhe kontrollin e kësaj veprimtarie.

Gjithashtu, u evidentua se, ndonëse programi JKN është zbatuar në mënyrë të vazhdueshme çdo vit që nga viti 2022, planifikimi i aktiviteteve dhe i buxhetit analitik nuk është realizuar në vitin paraardhës, por ka nisur gjatë vitit korrent, duke kufizuar parashikueshmërinë financiare, planifikimin e burimeve dhe monitorimin efektiv të zbatimit të programit, në kundërshtim me parimet e planifikimit, programimit dhe menaxhimit të burimeve publike të përcaktuara në Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, si dhe në Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.5 faqet 189-220 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

22.1 Rekomandimi: Ministria përgjegjëse për kulturën të marrë masa për qartësimin dhe formalizimin e statusit të programit “Javët Kulturore Ndërkombëtare”, duke e trajtuar dhe administruar atë si veprimtari institucionale dhe program të Ministrisë, në përputhje me objektivat strategjike dhe fushën e saj të përgjegjësisë, si dhe në zbatim të procedurave të përcaktuara për planifikimin, miratimin dhe zbatimin e buxhetit në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH, si dhe ligjin për prokurimin publik dhe ligjin për artin dhe kulturën në varësi të secilit aktivitet.

Njëkohësisht, ministria të sigurojë që planifikimi i aktiviteteve dhe i buxhetit analitik të programit të realizohet në mënyrë paraprake, në kuadër të procesit vjetor të planifikimit buxhetor, me qëllim përmirësimin e parashikueshmërisë, eficiencës së përdorimit të fondeve dhe forcimin e monitorimit dhe kontrollit të zbatimit të këtij programi.

Menjëherë

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se procedura e njoftimit të urdhrit nr. 592, datë 06.09.2022, “Për shpalljen e projekt-ideve të kualifikuara nga juria ndërkombëtare për fazën e dytë të konkursit AHP” është bërë në faqen zyrtare të web-it të Ministrisë së Kulturës, në datën 7 Shtator 2022 me titull “Shpallja e fituesve të fazës së parë të konkursit ndërkombëtar “Art në hapësira publike”, ndërsa publikimi i Urdhrit të Ministrit të Kulturës nr. 702, datë 17.10.2022 “Për miratimin e projekteve fituese të konkursit ndërkombëtar AHP”, është bërë në datën 18 Tetor 2022 me titull “Lista e projekteve fituese në kuadër të konkursit ndërkombëtar, “Art në hapësira publike” 2022. Nga verifikimi i faqes zyrtare të web-it të ministrisë përgjegjëse për kulturën, deri në përfundimin e fazës së auditimit të terren, rezultoi se asnjëri nga këto njoftime nuk ka të publikuar listën e fituesve. Po ashtu edhe në dosjen fizike nuk administrohet ky njoftim i publikuar në web. Veprim në kundërshtim me pikën 13 të kreut II, të VKM nr.306, datë 11.05.2022 “Për procedurat që ndiqen për financimin e projekteve artistike”. Publikimi i listës së fituesve të projektit “Art në hapësira publike” 2022 është bërë në Buletin nr. 146, datë 24 Tetor 2022.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.5 faqet 189-220 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

23.1 Rekomandimi: Drejtoria përgjegjëse për Artin dhe Kulturën, të marrë masa për respektimin e formës së publikimit të njoftimeve zyrtare, në mënyrë që këto njoftime të jenë të plota, të sakta dhe të aksesueshme për të gjithë të interesuarit, duke siguruar kështu rritjen e transparencës dhe besueshmërisë së proceseve të financimit të projekteve artistike.

Menjëherë dhe në vijimësi

24. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i praktikave të projekteve me thirrje për periudhën e audituar u evidentuan disa mangësi në dokumentacion, përfshirë mungesë ose mosplotësim të anekseve, dokumente të panënshkruara, kërkesa për shtyrje afatesh të pambështetura plotësisht me dokumentacion justifikues dhe të pa reflektuara në amendime kontraktuale, si dhe mungesë të disa dokumenteve verifikuese nga përfituesit, në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në “Hapjen e thirrjes për grande lidhur me kulturën dhe krijimtarinë” dhe në kontratat e mbështetjes financiare, si dhe me nenin 4, pika 19, të Ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.5 faqet 189-220 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

24.1 Rekomandimi: Kolegjiumi për projektet e artit dhe kulturës në Ministrinë përgjegjëse për kulturën, të marrë masa që përpara shpalljes së projekteve fituese të dokumentojë në forme shkresore administrimin dhe verifikimin e dokumentacionit të paraqitur nga subjektet, në përputhje me kriteret e kualifikimit të kërkuara në “Hapjen e thirrjes për grande lidhur me kulturën dhe krijimtarinë”.

Menjëherë dhe në vijimësi

25. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i aktivitetit të Njesisë së Auditit të Brendshëm u konstatua se, për vitin 2024, NJAB nuk ka kryer angazhim auditimi për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna gjatë vitit 2023. DAN pranë MEKI-t ka realizuar auditimin për zbatimin e rekomandimeve gjatë vitit 2025, ku rezultoi të jenë verifikuar vetëm 37 rekomandime të dhëna për

TKOBAP, ndërkohë që nuk është verifikuar ecuria dhe niveli i zbatimit të rekomandimeve për 168 rekomandime të dhëna gjatë vitit 2023 dhe 33 rekomandime të tjera të dhëna gjatë vitit 2024, në kundërshtim me kreun II, të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 42, datë 27.10.2020 “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.6 faqet 220-226 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

25.1 Rekomandimi: Drejtuesi i NJAB të marrë masa për planifikimin dhe kryerjen e angazhimit të auditimit mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga NJAB, të pambuluara nga auditimet e mëparshme, me qëllim përcaktimin nëse gjetjet e auditimeve janë adresuar në mënyrën e duhur dhe rekomandimet e dhëna janë zbatuar sipas afateve dhe kritereve të përcaktuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

26. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i realizuar mbi strukturën organizative dhe burimet njerëzore të MEKI-it u konstatua se, pavarësisht miratimit të strukturës së re me Urdhrin e Kryeministrit nr.37, datë 19.02.2024 dhe nr. 204, datë 23.10.2024 “Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit”, i ndryshuar, ajo nuk është plotësuar sipas organikës së miratuar. Për vitin 2024 në një total prej 281 pozicioneve të planifikuara në strukturë edhe pas shpalljeve të kryera nga institucioni, numri mesatar faktik i punonjësve ka qenë 207, duke rezultuar në 74 pozicione vakante. Për vitin 2025, në një total prej 281 pozicioneve të planifikuara në strukturë edhe pas shpalljeve të kryera nga institucioni, numri mesatar faktik i punonjësve ka qenë 236, duke rezultuar në 45 pozicione vakante. Kjo situatë tregon një mospërputhje të vazhdueshme ndërmjet numrit të planifikuar dhe atij real të punonjësve, e cila mund të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë në efikasitetin e funksionimit të ministrisë, realizimin në kohë dhe me cilësi të objektivave institucionale, si dhe në mbingarkesën e mundshme të punës për stafin ekzistues.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqet 62-69 të Raportit të Auditimit)

26.1 Rekomandimi: Ministria përgjegjëse për kulturën, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, të marrë masa për plotësimin e vendeve vakante në përputhje me organikën e miratuar, me qëllim garantimin e përmbushjes së objektivave institucionale.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASA SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, gërma (b) dhe (c) si dhe mbështetur në ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 98-102, Titulli i njësive në bashkëpunim me nëpunësin zbatues, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, të nxirren aktet administrative përkatëse, dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **62,285,028 lekë**, sipas gjetjeve dhe rekomandimeve të trajtuara më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës me objekt “Ndërhyrje restauruese në Mozaikun e Tiranës, ndërtim godine” rezultoi se në përfundim të procedurës së prokurimit është lidhur kontrata përkatëse e punimeve me vlerë 179,259,167 lekë me TVSh sipas aktit me nr. 1815/24 prot., datë 19.08.2022 mes AK/Ministria e Kulturës, si dhe OE “F” ShPK me afat 24 muaj. Nga krahasimi i volumeve të situacionuara e të likuiduara, si dhe atyre të kryera në fakt rezultoi një diferencë me pasojë dëm ekonomik në vlerën **760,949 lekë pa TVSH**. Sa më sipër

është në kundërshtim me parashikimet e bëra në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7/1, pikat 1 dhe 2, neni 12, VKM nr. 610, 22.09.2022 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”, neni 1, pikat 1 dhe 2, neni 12, neni 15, neni 22, Udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu II, pika 3, Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, pika 1.2, pika 3, pika 8.1, pika 8.2 dhe pika 8.3, Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve e lidhur sipas aktit nr. 41185/17 prot., datë 30.09.2022, Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve e lidhur sipas aktit me nr. 8731/2 prot., datë 30.06.2025, Kontratën e lidhur sipas aktit me nr. 41185/17 prot., datë 30.09.2022 mes AK dhe OE, Urdhrat e Titullarit për ndjekjen e kontratës, etj.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.4 faqet 69-189 të Raportit të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sporteve, të merren të gjitha masat e nevojshme administrative dhe ligjore duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës prej **760,949 lekë pa TVSH** ndaj Kontraktorit të punimeve OE “F” ShPK, si shumë e likuiduar për punime të pa kryera në fakt për kontratën nr. 1815/24 prot., datë 19.08.2022 me objekt “Ndërhyrje restauruese në Mozaikun e Tiranës, ndërtim godine”.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës me objekt “Zbatimi i punimeve për restaurimin, rikonstrukcionin dhe rinovimin e sallës së koncerteve në Universitetin e Arteve në Tiranë”, viti 2021 rezultoi se në përfundim të procedurës së prokurimit është lidhur kontrata përkatëse e punimeve me vlerë 482,798,847 lekë me TVSh, sipas aktit me nr. 904/12 prot., datë 02.04.2021 mes AK/Ministria e Kulturës, si dhe BOE “K & U”, të përfaqësuar nga BOE “K & U”, me afat 14 muaj. Referuar dokumentacionit të dosjes teknike rezultoi se përmes shkresës nr. 5581/1 prot., datë 11.12.2023, nga ana e grupit të ndjekjes së kontratës është hartuar një relacion për përfundimin e zbatimit të punimeve të kontratës, sipas së cilit numri i ditëve për të cilat është aplikuar penaliteti është përlllogaritur si 41 ditë. Në fakt, nga analiza e relacionit rezultoi se ky numër nuk është përlllogaritur saktë pasi numri i ditëve për të cilat punimet janë ndërprerë ka qenë 27, çka do të thotë se numri i ditëve mbi të cilat do të duhet të ishte aplikuar penaliteti është 73 ditë. Për rrjedhojë duke bërë llogaritjet rezultoi se ndaj kontraktorit do të duhet të ishin aplikuar penalitetet në vlerën prej 12,282,374 lekë, ose **4,911,441 lekë më tepër nga vlera e mbajtur deri aktualisht**. Përveç sa më sipër, nga analiza e kronologjisë së dokumentacionit të vënë në dispozicion, duke analizuar korrespondencat pjesë e dosjes teknike rezultoi se kontraktori i punimeve, gjatë periudhës kohore në të cilën ka qenë në tejkallim të afatit ka qenë duke punuar me zëra punimesh jo domosdoshmërisht të lidhur me kushtet atmosferike, çka do të thotë se argumenti i lidhur me kushtet atmosferike nuk duhet të ishte marrë në konsideratë. Referuar Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, pika 9 citohet se: “Mbikëqyrësi i punimeve ka të drejtë të ndërpresë punimet për arsye të ndikimit të kushteve klimatike në to, kundrejt një zgjatjeje korresponduese të afatit.”. Sa më sipër është në kundërshtim gjithashtu edhe me parashikimet e bëra në ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Kreu II Përgjegjshmëria Menaxheriale neni 8, Kontratën e sipërmarrjes së punimeve të lidhur sipas aktit nr. 904/12 prot., datë 02.04.2021, neni 27.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.4 faqet 69-189 të Raportit të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sporteve, të merren të gjitha masat e nevojshme administrative dhe ligjore duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës prej **4,911,441 lekë** ndaj Kontraktorit të punimeve **BOE “K & U”**, si diferencë e pa aplikuar e penalitetit për shkak të përlogaritjeve të gabuara në numrin e ditë vonesave për kontratën nr. 904/12 prot., datë 02.04.2021 me objekt *“Zbatimi i punimeve për restaurimin, rikonstruksionin dhe rinovimin e sallës së koncerteve në Universitetin e Arteve në Tiranë”*.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës me objekt *“Zbatimi i punimeve për restaurimin, rikonstruksionin dhe rinovimin e sallës së koncerteve në Universitetin e Arteve në Tiranë”*, viti 2021 rezultoi se, në përfundim të procedurës së prokurimit është lidhur kontrata përkatëse e punimeve me vlerë 482,798,847 lekë me TVSh sipas aktit me nr. 904/12 prot., datë 02.04.2021 mes AK /Ministria e Kulturës dhe BOE “K.U”, të përfaqësuar nga OE K.A me afat 14 muaj.

Nga krahasimi i volumeve të situacionuara e të likuiduara si dhe atyre të kryera në fakt rezultoi një diferencë në 8 zëra punimesh, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **1,884,625 lekë pa TVSH**. Sa më sipër është në kundërshtim me parashikimet e bëra në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, *“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”*, i ndryshuar, neni 7/1, *“Përgjegjësia e mbikëqyrësit”*, pikat 1 dhe 2, neni 12, VKM nr. 610, 22.09.2022 *“Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”*, neni 1, pika 1, neni 7, neni 8, pikat 1 dhe 2, neni 12, neni 15, neni 22, VKM nr. 15.8.2007 *“Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”*, i ndryshuar me VKM nr. 664/2012, pika 1, 2, 3, 8, 9, 10 dhe 12, Udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 *“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”*, i ndryshuar, Kreu II pika 3; Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 *“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”*, pika 1.2, 38.1, 8.2, 8.3, Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve e lidhur sipas aktit 3278/12 prot., datë 26.06.2021, Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve e lidhur sipas aktit me nr. 3580 prot., datë 07.07.2023, Kontratën e lidhur sipas aktit me nr. 904/12 prot., datë 02.04.2021 mes AK dhe BOE; Urdhrin e Titullarit për ndjekjen e kontratës; Etj.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.4 faqet 69-189 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1 Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sporteve, të merren të gjitha masat e nevojshme administrative dhe ligjore duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës prej **1,884,625 lekë** ndaj Kontraktorit të punimeve **BOE “K & U”**, si shumë e likuiduar për punime të pa kryera në fakt për kontratën nr. 904/12 prot., datë 02.04.2021 me objekt *“Zbatimi i punimeve për restaurimin, rikonstruksionin dhe rinovimin e sallës së koncerteve në Universitetin e Arteve në Tiranë”*.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës me objekt *“Ndërhyrje emergjente në objektin monument kulture Ura e Matit”*, viti 2023 rezultoi se në përfundim të procedurës së prokurimit është lidhur kontrata përkatëse e punimeve me vlerë 55,991,574 lekë me TVSH sipas aktit me nr. 6367/9 prot., datë 27.12.2023 mes AK/Ministria e Kulturës dhe BOE “A. & A”, të përfaqësuar nga OE “A.N.K” me afat 30 ditë.

Nga krahasimi i volumeve të situacionuara e të , si dhe atyre të kryera në fakt rezultoi një diferencë në 4 zëra, me pasojë dëm ekonomik vlerën **5,986,400 lekë pa TVSH**.

Sa më sipër është në kundërshtim me parashikimet e bëra në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7/1, “Përgjegjësia e mbikëqyrësit”, pikat 1 dhe 2, neni 12, VKM nr. 610, 22.09.2022 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”, neni 1, pika 1, neni 7, neni 8, pikat 1 dhe 2, neni 12, neni 15, neni 22, VKM nr. 15.8.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me VKM nr. 664/2012, pika 1, 2, 3, 8, 9, 10 dhe 12, Udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu II Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, pika 3; Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, pika 1.2, 38.1, 8.2, 8.3, Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve e lidhur me UPT & Ministrisë së Kulturës sipas aktit nr. 353/18 prot., datë 05.01.2024, neni 7 Detyrime të Kontraktuesit, Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve e lidhur sipas aktit me nr. 11170/8 prot., datë 19.12.2024; Etj.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.4 faqet 69-189 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1 Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sporteve, të merren të gjitha masat e nevojshme administrative dhe ligjore duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës prej **5,986,400 lekë pa TVSH** ndaj Kontraktorit të punimeve **BOE “A & A”**, si shumë e likuiduar për punime të pa kryera në fakt për kontratën nr. 6367/9 prot., datë 27.12.2023 me objekt “Ndërhyrje emergjente në objektin monument kulture Ura e Matit”.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës me objekt “Restaurim, Rikonstruksion dhe rehabilitimi i hapësirave në Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria e Arteve)”, viti 2021 rezultoi se në përfundim të procedurës së prokurimit është lidhur kontrata përkatëse e punimeve me vlerë 1,060,884,393.36 lekë me TVSh sipas aktit me nr. 3047 prot., datë 10.06.2021 mes AK /Ministria e Kulturës si dhe BOE “4& K. & I”, të përfaqësuar nga OE “4 A” me afat 24 muaj. Në vijim kontrata ka pësuar 3 amendime të ndryshme. Mbështetur në evidencat dokumentare rezultoi se, ndaj OE nuk janë marrë masat e nevojshme për aplikimin e penaliteteve për çdo ditë vonesë përtej afatit të parashikuar në kontratë. Mbështetur në sa më sipër si dhe referuar raportimeve të bëra nga ana e mbikëqyrësit të punimeve, sipas të cilave data e fillimit të punimeve ka qenë data 28.10.2021, rezultoi se vlera e pa aplikuar e penalitetit deri në datën e amendimit të kontratës (07.12.2023) është në masën prej **32,325,691 lekë** [$1/1000 \times (905,840,942.47 \text{ lekë}^{28} - 97,698,660 \text{ lekë}^{29}) \times 40 \text{ ditë}$]. Kjo shumë, duhet të ishte llogaritur si zbritje në situacionin e parë pasardhës të likuiduar ndaj kontraktorit të punimeve, kjo në zbatim të Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, pika 8.2. Veprimet dhe mosveprimet përveç sa cituar më sipër rast pas rasti, janë në kundërshtim edhe me parashikimet e bëra në ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Kreu II neni 8, Kontratën e sipërmarrjes së punimeve të lidhur sipas aktit nr. 3047 prot., datë 10.06.2021, neni 27.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.4 faqet 69-189 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1 Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sporteve, të merren të gjitha masat e nevojshme administrative dhe ligjore duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës prej **32,325,691 lekë** ndaj Kontraktorit të punimeve “4 & K & I”, si penalitet

²⁸ Vlera e kontratës pa TVSH.

²⁹ Vlera korresponduese pa TVSH e zbatuar, nga çmimi total i kontratës.

i pa aplikuar për shkak të 40 ditë vonesë në drejtim të përfundimit të punimeve për kontratën nr. 3047 prot., datë 10.06.2021 me objekt “Restaurim, Rikonstruksion dhe rehabilitimi i hapësirave në Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria e Arteve”.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës me objekt “Ndërtimi i një objekti / qendre të re multifunksionale në funksion të së ardhmes së edukimit artistik të fëmijëve në kryeqytet, pranë qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë dhe Teatrit të Kukullave”, viti 2022 rezultoi se në përfundim të procedurës së prokurimit është lidhur kontrata përkatëse e punimeve me vlerë 1,200,539,142 lekë me TVSh sipas aktit me nr. 3252/25 prot., datë 10.11.2022 mes AK /Ministria e Kulturës dhe BOE “2 & B & K”, të përfaqësuar nga OE “2.T”, me afat 24 muaj. Nga analiza e tabelës së situacioneve, faturave tatimore dhe urdhër shpenzimeve nga ato me nr. 1 deri në 11 rezultoni se përmes pagesës së situacionit pjesor nr. 2, kontraktorit të punimeve i është paguar diferenca tepër në vlerë prej **16,415,922 lekë me TVSH**. Sa më sipër ka ndodhur për shkak të likuidimit përmes urdhër shpenzimit nr. 882, datë 18.09.2023 të vlerës progresive të punimeve (66,370,311 lekë me TVSH) dhe jo të vlerës pjesore të tyre (49,954,388 lekë me TVSH). Veprimet dhe mosveprimet në kundërshtim me parashikimet e bëra nga Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 35.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.4 faqet 69-189 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1 Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sporteve, të merren të gjitha masat e nevojshme administrative dhe ligjore duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës prej **16,415,922 lekë me TVSH** ndaj Kontraktorit të punimeve “2 & B & K”, si pagesë e kryer tepër në situacionin pjesor nr. 2 në kontratën me nr. 3252/25 prot., datë 10.11.2022 me objekt “Ndërtimi i një objekti / qendre të re multifunksionale në funksion të së ardhmes së edukimit artistik të fëmijëve në kryeqytet, pranë qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë dhe Teatrit të Kukullave”.

Menjëherë

D. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi u konstatua se nga ish-MEKI janë ekzekutuar gjithsej 19 vendime gjyqësore, në vlerën totale prej 526,006,386 lekë, ku të analizuara sipas llojit dhe vlerës si më poshtë:

- 9 Vendime gjyqësore për ish-punonjësit në vlerën totale prej 40,735,705.5 lekë, ku vlera e përmbaruesit 2,103,928 lekë;
- 7 Vendime gjyqësore për shpronësime në vlerën totale prej 476,963,395 lekë, ku vlera e përmbaruesit 13,730,161 lekë;
- 3 Vendime gjyqësore detyrime të tjera në vlerën totale prej 8,307,286 lekë, ku vlera e përmbaruesit 447,408 lekë.

Vendimet gjyqësore nuk janë ekzekutuar vullnetarisht nga MEKI, pas marrjes së njoftimit të vendimit të formës së prerë dhe kthimit të tij në titull ekzekutiv, por është zbatuar nëpërmjet urdhrave të ekzekutimit të lëshuara nga përmbarues privatë, veprime në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, nenin 130, nenin 451/a dhe nenin 510/a, duke paguar tarifa përmbarimore në vlerën totale prej 16,311,497 lekë.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.3, faqet 62-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sporteve të merren masa që në vijimësi të procedohet në përputhje në aktet rregullative, me qëllim garantimin e menaxhimit me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike për shpenzimet mbi vendimet gjyqësore për ish-punonjësit, shpronësimet dhe detyrime të tjera të cilat për periudhën e audituar rezultojnë në shumën totale prej **54,943,274.5 lekë**.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës me objekt “Ndërhyrje emergjente në objektin monument kulture Ura e Matit”, viti 2023 rezultoi se në përfundim të procedurës së prokurimit është lidhur kontrata përkatëse e punimeve me vlerë 55,991,574 lekë me TVSH sipas aktit me nr. 6367/9 prot., datë 27.12.2023 mes AK/ Ministria e Kulturës dhe BOE “A & AS”, të përfaqësuar nga OE A.N. me afat 30 ditë. Nga krahasimi i volumeve të situacionuara e të likuiduara, si dhe atyre të kryera në fakt rezultoi se në situacionin përfundimtar janë përfshirë edhe zërat si më poshtë, për të cilët janë likuiduar edhe vlerat respektive për sasitë përkatëse:

- Zëri *Ekskavator 0.5 m³*, 80 orë pune, vlera prej 200,000 lekë pa TVSH;
- Zëri *Buldozer S-80/100 KF*, 80 orë pune, vlera prej 280,000 lekë pa TVSH;
- Zëri *Kamion 25-30 ton*, 80 orë pune, vlera prej 168,000 lekë pa TVSH;

Sipër librezës së masave këta zëra nuk janë të justifikuar në mënyrë analitike por janë të vendosur në mënyrë direkte prej 80 orë pune. Nga sa më sipër vlera prej **648,000 lekë pa TVSH** konsiderohet si përdorim pa efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet i fondeve.

Sa më sipër është në kundërshtim me parashikimet e bëra në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7/1, “Përgjegjësia e mbikëqyrësit”, pikat 1 dhe 2, neni 12, VKM nr. 610, 22.09.2022 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”, neni 1, pika 1, neni 7, neni 8, pikat 1 dhe 2, neni 12, neni 15, neni 22, VKM nr. 15.8.2007³⁰ “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me VKM nr. 664/2012, pika 1, 2, 3, 8, 9, 10 dhe 12, Udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu II Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, pika 3; Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, pika 1.2, 38.1, 8.2, 8.3, Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve e lidhur me UPT & Ministrisë së Kulturës sipas aktit nr. 353/18 prot., datë 05.01.2024, neni 7 Detyrime të Kontraktuesit, Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve e lidhur sipas aktit me nr. 11170/8 prot., datë 19.12.2024; Etj.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.4 faqet 69-189 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1.Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sporteve, të merren të gjitha masat e nevojshme për marrjen në dorëzim të projekteve dhe preventivave nga specialistë të fushës, me qëllim zvogëlimin e riskut për pasaktësi materiale, si dhe shmangien e përdorimit pa efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve publike.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nga shqyrtimi i 50 dosjeve të zbatimit të projekteve me thirrje dhe jashtë saj, me vlerë totale 97,318,200 lekë, në 3 dosje janë financuar për llogari të subjekteve përfutuese të projekteve me thirrje dhe jashtë saj, dieta, shpenzime hoteli dhe

³⁰ Aktualisht i shfuqizuar por në fuqi në momentin e realizimit të kontratës.

udhëtimi për aktivitete të zhvilluara në qytetin e Durrësit, në vlerë totale 361,000 lekë, në kundërshtim me VKM nr.997, datë 10.12.2010, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” të ndryshuar kreu III, Ligji nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, neni 50, pika 1/h, pika 1/k), Udhëzimi i MF nr. 26, datë 8.9.2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar pika l.

- Nga auditimi u konstatua se nga shqyrtimi i 50 dosjeve të zbatimit të projekteve me thirrje dhe jashtë saj, me vlerë totale 97,318,200 lekë, në 3 (tre) raste subjekteve përfituese të projekteve me thirrje dhe jashtë saj, janë likuiduar në vlerë totale 602,944 lekë me shumë nga sa kanë justifikuar me pagesat e dorëzuara. Sa më sipër bie ndesh pikën 6, të nenit 5 “Te drejtat dhe detyrimet e “Përfituesit” të kontratës për mbështetjen financiare.

Vlera dietave dhe e pagesave të pa justifikuara, në total **963,944 lekë** konsiderohet përdorim pa ekonomikitet, pa efektivitet dhe pa efikasitet të fondeve publike.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.5 faqet 189-220 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1 Rekomandimi: Titullari i Ministrisë përgjegjëse për kulturën, të marrë masa që, në përcaktimin kriterëve të kualifikimit të “Hapjes së thirrjes për grande lidhur me kulturën dhe krijimtarinë” aplikantët të paraqesin preventivë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

E. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 15 “*Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së*”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, nenin 58 “*Llojet e masave disiplinore*”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe në VKM-në nr.115, datë 05.03.2014 “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*”, i **rekomandojmë** Titullarit të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sporteve për të gjithë punonjësit e trajtuar me përgjegjësi dhe me shkelje në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masave përkatëse disiplinore.

Për sa më sipër, paraqitet ky Raport Auditimi.